

Të Mos Harrojmë

**Kujtesa e
Totalitarizmit
në Europë**

**DORACAK PËR NXËNËS TË SHKOLLAVE TË MESME
KUDO NË EUROPE**

BOTIMI I DYTË

**EDITUAR NGA NEELA WINKELMANN-HEYROVSKÁ
AND GILLIAN PURVES**





Me mbështetjen e Programit Europa për Qytetarët të Bashkimit European

Botimi i parë i këtij doracaku u financua me mbështetjen e Komisionit European. Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorëve dhe Komisioni nuk mund të mbajë përgjegjësi për çdo përdorim që mund t'i bëhet informacionit që përmbahet në të.

MIRËNJOHJE

Platforma e Kujtesës dhe Ndërgjegjes Europiane dëshiron të falënderojë Fondacionin Kombëtar Polak për mbështetjen e tij që mundësoi botimin e dytë të këtij libri, gjithashtu edhe të gjithë autorëve, institucioneve dhe organizatave që kontribuan me historitë jetësore.

RRETH KËTIJ LIBRI

Ju po hapni botimin e dytë, të zgjeruar të Doracakut për Shkolla krijuar nga Platforma e Kujtesës dhe Ndërgjegjes Europiane për të mbështetur edukimin historik modern në klasë në mbarë Europën. Libri është botuar fillimisht në vitin 2013 dhe është përkthyer deri më sot në gjuhë. Koleksioni i tanishëm përfshin 37 histori tronditëse nga jeta e njerëzve të prekur nga totalitarizmi i shekullit të kaluar nga 20 vende të ndryshme europiane, përfshi në këtë edicion Francën, Spanjën, Italinë dhe Shqipërinë.

Në mënyrë që të demonstrojmë imapktin që totalitarizmi ka në shoqëri, ne kemi përzgjedhur biografite e njerëzve që u prekën nga diktaturat komuniste, fashiste dhe naziste kundër dëshirës së tyre. Ju do takoni fëmijë e të rritur, burra e gra, njerëz nga sfera të ndryshme të jetës, kristianë, hebrenj, romë, myslimanë dhe njerëz, besimi i të cilëve nuk cilësohet. Disa prej tyre luftuan me qëndresë, disa mbijetuan, të tjerët fatkeqësisht janë zhdukur.

Ndërsa historitë jetësore shpesh të prekin me dhimbjet dhe vuajtjet e mëdha që persekutorët, mbështetësit dhe ndihmësit fanatikë të totalitarizmit shkaktuan mbi qeniet njerëzore, njëkohësisht, ato kanë edhe forcë frymëzuese – duke lartësuar dashurinë për lirinë, dinjitetin njerëzor, qëndrueshmërinë, guximin, besimin dhe vlerat demokratike.

Në parafjalën e botimit të dytë, historiani britanik Roger Moorhouse ngre pyetjen e rëndësishme të persekutorëve. Si mund të qenë aq mizorë dhe të shkaktonin një dhunë të tillë në shoqëri? Shpjegimi mund të gjendet në një fjalë: Traumë.

Një vështrim i shpejtë në historinë e botës na tregon sa i dhunshëm ka qenë civilizimi njerëzor. Ata të rritur që jetojnë në frikë, stres dhe dhunë traumatizojnë më tej fëmijët e tyre. Trauma emocionale dhe fizike e përjetuar në fëmijëri mund të shpjerë në zhvillimin e çrregullimeve të personalitetit, si narcizmi, sociopatia dhe psikopatia, të cilat manifestohen me mungesë empatie apo qoftë edhe kënaqësi prej lëndimit të të tjerëve. Në këtë mënyrë, fëmijët e viktimizuar mund të bëhen nesër të rritur persekutorë. Në të kaluarën ka pasur shumë njerëz që kanë përjetuar nivele të ulëta empatie, të cilët mund të mobilizoheshin për të dëmtuar të tjerët.

Ne e dimë sot se traumat e pashëruara transferohen në një nivel epigjenetik, familjar, shoqëror dhe kulturor te brezat e ardhshëm. Ne ende po trajtojmë trashëgiminë e traumave të shekullit të njëzetë në Europë sot. Është detyra jonë e rëndësishme të shërojmë shoqëritë tona në mënyrë që fëmijët tanë të mund të jetojnë në empati, lumturi dhe dashuri. Si të veprojmë për ta arritur këtë?

Para së gjithash, ne duhet të mbrojmë demokracinë cilësore. Demokracia ka evoluar si forma më e mirë e qeverisjes për të siguruar paqen, sundimin e ligjit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, prosperitetin dhe lumturinë

në shoqëri. Jemi në rrugë të mbarë. Kjo mund të jetë epoka më paqësore e historisë njerëzore. Shumica e vendeve në botë janë demokraci. Si rezultat, ne po ndalojmë së zhvilluar luftëra. Niveli i dhunës në botë është në rënie, duke i dhënë hapësirë komunikimit dhe mirëkuptimit.

Në këtë mjedis të sigurt, shërimi nga trauma kërkon rrëfimin e historive personale, dëgjimin e tyre me empati, pranimin e emocioneve dhe ndërmarrjen e hapave për të rivendosur drejtësinë. Vetëm atëherë mund të ndodhë pajtimi midis persekutorëve të mëparshëm dhe viktimave në shoqëritë e ndara. Vetëm atëherë ne do të jemi në gjendje të kalojmë nga e kaluara në të tashmen dhe të trajtojmë me efikasitet çështjet e ngutshme sot, të tilla si ndryshimet klimaterike globale.

Prandaj, ne po sjellim versionin e ri, të zgjeruar të Doracakut tonë te brezi i ri i Europës, në mënyrë që ata të mësojnë dhe kuptojnë se si gjërat janë të ndërlidhura. Që ata të jenë vigjilentë dhe ngrihen për të mbrojtur demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Që ata të rriten në një botë të shëruar nga hijet e traumave totalitare.

Këtë tekst ndërkombëtar ia kushtojmë kujtesës të miliona europianëve të pafajshëm që ranë viktimat të totalitarizmit, atyre që rezistuan dhe atyre që luftuan për të rivendosur një shoqëri të lirë, demokratike. Ata nuk do të harrohen.

Neela Winkelmann-Heyrovská

Autore e doracakut

Drejtoreshë e Platformës Europiane të Kujtesës dhe Ndërgjegjes 2011-2018

Materiale shtesë audiovizuale të këtij libri mund të gjenden në
www.memoryandconscience.eu/multimedia

PËRMBAJTJA

Falënderime	2
Rreth këtij libri	3
Përmbajtja	5
Regjimet totalitare dhe autoritare	7
Hyrje	
Parathënie e botimit të dytë (nga Roger Moorhouse)	8
Memorja tragjike e regjimeve totalitare europiane (nga Prof. Stéphane Courtois).	11
SUEDI	
Raoul Wallenberg. Një rrëfenjë e kurajossë madhe (nga Penny Schreiber).	18
ESTONI	
Enn Sarv. Lufta kundër dy totalitarizmave (nga Toomas Hiio).	28
Inge Syltenová dhe Heinz Drosihn. Një histori dashurie (nga Meelis Maripuu dhe Lukáš Příbyl).	36
LETONI	
Edward Anders (Eduards Alperovičs). Të shmangësh Holokaustin (nga Edward Anders and Valters Nollendorfs).	46
Benita Plezere-Eglite. Papritmas – Siberia (nga Benita Plezere-Eglite and Valters Nollendorfs).	56
LITUANI	
Juozas Lukša. Jeta e një partizani (nga Darius Juodis).	66
Juliana Zarchi. Një jetë e re e ndërprerë (nga Vilma Juozevičiūtė).	76
POLONI	
Witold Pilecki. Njeriu që doli vullnetar për në Aushvic (nga Jacek Pawłowicz).	86
Danuta “Inka” Siedzik. Një jetë e regjimit të shpirtit (nga Dr hab. Grzegorz Berendt).	98
GJERMANI	
Margarete Blank. Një portret (nga Dr. Birgit Sack)	108
Heinz Brandt. Rezistenca kundër socializmit kombëtar dhe stalinizmit (nga Bert Pampel dhe Siegfried Reiprich).	118
AUSTRI	
Alma Rosé. Häftlingsfrau Nr. 50831 (nga Łukasz Martyniak).	128
HOLLANDË	
Marinus Soeters. Kujtime lufte (nga Marinus Soeters dhe Sion Soeters).	138
REPUBLIKA ÇEKE	
Milada Horáková. Një grua që i qëndroi besnike bindjeve të saj (nga Zora Dvořáková).	148
Josef Bryks. Arratisjet e Josef Bryks (nga Luděk Navara).	156
SLLOVAKI	
Jozef Remža. Një fat tragjik drejt rrugës së lirisë (nga Ľubomír Morbacher, Ph.D.).	168
Fedor Gál. Udhëtimi i ish-kurtëri gjatë (nga Fedor Gál dhe Prof. Peter Zajac).	178

HUNGARI

- Cardinal József Mindszenty.** Ndërgjegjia hungareze (nga Tamás Stark). 188
József Ungár. Një luftëtar i rezistencës anti-komuniste (nga Dorottya Baczoni). 198

SLLOVENI

- Ivana and Viktor Valič.** Një jetë në tre regjime totalitare (nga Andreja Valič Zver, Ph.D.). 204
Jože Pučnik. Historia e një disidenti (nga Andreja Valič Zver, Ph.D.). 210

RUMANI

- Aristina Pop Săileanu.** Një karusel terrori (nga Romulus Rusan). 218
Remus Radina. Një njeri normal në një botë anormale (nga Romulus Rusan). 222

BULLGARI

- Lyudmila Slavova.** Një lule në makinerinë ogurzezë (nga Angel Filchev). 228
Georgi Markov. Zëri i Bullgarisë (nga Gillian Purves). Fashizmi ynë (nga Georgi Markov). 238

MOLDAVI

- Aglaia Arapu.** I mbijetuari i vetëm (nga Igor Casu, Ph.D.). 248
Gheorghe David. Viktima e mjekësisë ndëshkuese (nga Igor Casu, Ph.D.). 252

UKRAINE

- Omelyan Kovch.** Një prift, një patriot, një njeri i drejtë (nga Volodymyr Birchak dhe Volodymyr Viatrovych). 258
Oleksandra Radchenko. Persekutuar për kujtesën e saj (nga Volodymyr Viatrovych). 266
Ayshe Seitmuratova. Historia e një populli që refuzon të vdesë (nga Ali Khamzin). 274

FRANCË

- Mother Maria Skobtsova.** Një revolucionare që u kthye në shenjtorë (nga Dr. Antoine Arjakovsky). 284

SPANJË

- Federico García Lorca.** Vrasja e një poeti të butë (nga Prof. Dr. José M. Faraldo). 292
Margarita Nelken. Një politikane, të cilësiu desh të arratiset drejt Meksikës (nga Dr. Luis Horrillo Sánchez). 298

ITALI

- Ada Rossi.** Një nënë e Bashkimit Europian (nga Simone Zoppellaro dhe stafi editorial i Gariwo). 306
Gino dhe Luciana De Marchi. Beteja e një vajze të re për kujtesën e të atit (nga Simone Zoppellaro). 312


SHQIPËRI

- Viktor Martini.** Historia e një familje qëndrestarësh (nga Valbona Bezati). 318
Ylber dhe Shpresa Merdani. Dënimi i një poeti dhe një histori dashurie me fund të lumtur (nga Valbona Bezati). 324

- Përballja me totalitarizmin në nivel europian. 331
Rezoluta e Parlamentit Europian për Ndërgjegjen dhe Totalitarizmin. 332
Rezoluta e Parlamentit Europian për Rëndësinë e Kujtesës Europiane për të Ardhmen e Europës. 336
Pasthënie. 342
Shkurtime. 345

REGJIMET TOTALITARE DHE AUTORITARE

Kjo pasqyrë e thjeshtuar përshkruan periudhën e shekullit të 20-të dhe regjimet autoritare dhe totalitare, të cilat do t'i ndeshni në historitë e publikuara në këtë tekst. Llojet e regjimeve jo-demokratike janë markuar me ngjyra të ndryshme.



1 GJERMANI LINDORE 2 PROTEKTORATI I BOHEMIAS DHE MORAVIAS (SIPËR), SLLOVAKI (POSHTË) 3 ZONAT ANEKSUAR E ITALISË 4 LUFTA CIVILE

REGJIMI KOMUNIST / PUSHTIMI

DEMOKRACIA E KUFIZUAR

REGJIMI NAZIST / PUSHTIMI

FASHIZMI / REGJIMI AUTORITAR / ALEATET E GJERMANISË NAZISTE

PARATHËNIE E BOTIMIT TË DYTË

Sistemet politike totalitare dominuan Europën për pjesën më të madhe të shekullit të 20-të. Duke filluar me lindjen e Bashkimit Sovjetik nën sundimin e Leninit, pastaj në Itali nën sundimin e Musolinit - ku u krijua termi "totalitarizëm", që përshkruante dëshirën e fashizmit për të kontrolluar çdo aspekt të jetës së një individi - totalitarizmi arriti kulmin e tij të zyrtë me shfaqjen e Bashkimit Sovjetik nën sundimin e Stalinit, rreth vitit 1929, dhe me Gjermaninë nën sundimin e Rajhut të Tretë.

Për pjesën më me fat që jetonte në gjysmën perëndimore të Europës, idetë që mbështesin këtë sistem politik - intoleranca ndaj dallimeve, detyrimi dhe persekutimi politik - u zhdukën me rënien e Rajhut të Tretë të Hitlerit në vitin 1945. Megjithatë, këto ide dhe metoda politike nuk vdiqën; në fakt me zgjerimin Bashkimit Sovjetik në perëndim, ato vazhduan deri në vitin 1989, dhe në vetë Bashkim Sovjetik deri në vitin 1991.

Duke pasur parasysh këtë jetëgjatësi, dhe natyrisht natyrën thelbësisht toksike të totalitarizmit, dikush mund të ketë imagjinuar se ato periudha të kontrollit të tij në Europë dhe gjetkë, do të qenë të njohura për ne; do të qenë një element kryesor i njohur i planprogrameve të historisë në shkolla dhe kurseve universitare, dhe kështu një pjesë thelbësore e kuptimit tonë kolektiv të botës. E megjithatë, njohuritë tona për këtë temë janë në rastin më të mirë fragmentare, dhe kufizohet nga një ndarje e thellë rajonale. Në Europën Perëndimore, dhe veçanërisht në Gjermani dhe botën anglishtfolëse, Holokausti zë pjesën më të madhe në historinë e shekullit të 20-të. Si rrjedhojë, ne kemi një kuptim të arsyeshëm të përbashkët të Rajhut të Tretë të Hitlerit dhe sesi politika e saj totalitare dhe idetë raciste çuan në gjenocidin kundër hebrenjve të Europës. Por, përtej kësaj, Bashkimi Sovjetik i Stalinit, për të mos përmendur regjimet komuniste të imponuara në Europën Lindore nga Moska pas vitit 1945, kanë marrë relativisht pak vëmendje, dhe në të vërtetë, ndonjëherë shihen përmes një lente mjaft progresive "optimiste", në të cilën krimet e tyre minimizohen.

Sidoqoftë, në Europën Qendrore dhe Lindore, dhe posaçërisht në ato zona që përjetuan pushtimin nazist dhe sovjetik, kuptimi i temës është më i mirë; qartësia dhe konteksti i dhënë nga përvoja e drejtpërdrejtë historike. Prandaj, nuk duhet të na habitë që pjesa më e madhe e rrëfimeve në këtë libër - raporte të rezistencës dhe persekutimit - vijnë nga gjysma lindore e kontinentit evropian. Përvoja e totalitarizmit atje ishte jo vetëm më e gjatë, por në shumë vende pushtimet e njëpasnjëshme naziste dhe sovjetike kanë sjellë nevojën e menjëhershme për të kuptuarin kolektiv.

Raportet e riprodhuara këtu variojnë gjerësisht, si gjeografikisht dhe nga tema. Ato përfshijnë burra dhe gra, hebrenj si dhe johebrenj, të njohurit dhe të panjohurit. Kur i lexon, tronditesh menjëherë nga trimëria dhe këmbëngulja e atyre që guxuan të rezistojnë, shpesh duke duruar përndjekje, poshtërime, tortura dhe përgjigje akoma më të këqija. Histori të tilla duhet të jenë një frymëzim për të gjithë ne, që po jetojmë në luks në kohë shumë më komode, për të qëndruar të palëkundur për të mbrojtur idealet e tolerancës, respektit reciprok dhe lirisë që kanë kontribuar aq shumë në suksesin e botës sonë.

E gjithë kjo na jep një pamje të shkëlqyer të totalitarizmit, por është një pamje vetëm nga perspektiva e viktimave. Po autorët e krimeve? Si mendonin ata? Çfarë i motivoi ata? Përgjigjeve për ato pyetje mund t'u mungojë ajo nevoja e menjëhershme e zymtë dhe drama njerëzore e historive të viktimave, por gjithsesi ato mbeten thelbësore nëse duam të kuptojmë si duhet sistemet totalitare të qeverisjes. Mbi të gjitha, autorët e krimit ishin po aq njerëzorë sa viktimat e tyre, të prirur ndaj të njëjtave dobësi dhe të njëjtave emocione. Edhe ata kishin familje. Edhe ata dashuronin dhe qeshnin. Për të kuptuar totalitarizmin duhet patjetër t'i kuptojmë edhe ata.

Stereotipi i autorit të krimit, që na është ofruar nga kultura popullore, është shpesh ai i psikopatit ose sociopatit, rojës pazemër të kampit, ose oficerit të kuruar për qeshës të SS-së. Natyrisht që është e pamundur ta lemë tërësisht mënjanë këtë stereotip, por ka pak gjasa që këto dy tipe psikologjike të mbipërfaqësoheshin gjerësisht në radhët e SS-së ose NKVD-së së Stalinit. Motivimi, pra, duhet të kërkohet diku tjetër; në ideologji, indoktrinim dhe në tipare krejt njerëzore si pajtueshmëria dhe frika.

Për pakicat që ishin të motivuara nga idetë, sistemet totalitare u themeluan të gjitha mbi ideologji të hollësishme, të cilat jo vetëm shpjeguan të kaluarën dhe të tashmen, por siguruan një vizion tërheqës të së ardhmes; një e ardhme për të cilën - në mënyrë thelbësore - duhej luftuar dhe për të cilat duhej sakrifikuar. Besimtarët panë në këto ideologji një sistem besimi i cili kishte një karakter universal, pseudo-fetar, plot me rituale, relike, ceremoni dhe mesia të mundshëm. Ç'është më e rëndësishmja, ato sisteme besimi i vunë veprimet e besimtarit në shërbim të një të mire më të madhe, duke i dhënë një ndjenjë justifikimi ideologjik, i cili mund të kapërcente moralin. Më shumë se kaq, besimtarët kishin rolin - nderin, madje - të vepronin si pretorianë, pararojë e asaj bote më të mirë që do të vinte. Ishte një kompleks ndjenjash që u përmblohdhën nga Heinrich Himmler, kreu i SS-së, në një fjalim në vitin 1943, në të cilin ai justifikoi Holokaustin, duke thënë: "Ne kemi të drejtën morale, ne kemi detyrimin ndaj popullit tonë, të vrasim njerëzit që do të na vrisnin."

Komunizmi Sovjetik, natyrisht, bëri pretendime edhe më të mëdha për justifikimin moral, duke veshur luftën e tij të klasave dhe rregullimin radikal të shoqërisë në retorikën e pakundërshtueshme të barazisë dhe përparimit. Nuk ka asnjë justifikim për të penguar "pashmangshmërinë shkencore" të komunizmit; ata që dyshuan u përqeshën për "vetëdijen e tyre false", ata që nuk arritën të arrinin objektivat e tyre të paarritshëm të kuotave u vlerësuan si "shkatërrues", ata që guxuan të rezistonin u denoncuan si fashistë. Pjesa më e madhe ishin të pafajshëm dhe viktimat të fatit të keq, denoncimit anonim ose paranojës kolektive. Lista e personave që do të gjykoreshin - dhe dënoreshin - si "anti-sovjetik" ishte gjithëpërfshirëse, që nga tregtarët dhe pronarët e tokave të filatelistët dhe folësit e esperantos. Miliona të panumërt u dërguan në kampet Gulag, ose në mërgim në Siberi. Ata më të pafatët thjesht u ekzekutuan. Vrasësit e NKVD-së vërtet besonin se po e bënin botën një vend më të mirë; ekzekutim pas ekzekutimi.

Në botën reale, natyrisht, ideologji të tilla komplekse si nazizmi ose komunizmi sovjetik zakonisht kuptohen vetëm pjesërisht nga ata që i ndjekin. Për shumicën, indoktrinimi zëvendëson mirëkuptimin e mirëfilltë. Duke filluar me arsimin fillor, fëmijëve u paraqitet një narrativë e njëanshme, i rreshtuar sipas ideologjinë sunduese, në të cilën idetë ose pikëpamjet rivale injorohen ose përqeshen. Në përputhje me ambicien totalitare, ndikimet e prindërve duhet

të margjinalizohen, kështu që në moshë të vogël, fëmijët regjistrohen me forcë në organizatat rinore të drejtuara nga shteti - "Rinia Hitleri", ose "Komsomol" - në të cilat mund të vazhdohet indoktrinimi i tyre . Nëse prindërit e një fëmije i rezistojnë këtij procesi, ose vazhdojnë të mbështesin idetë me të cilat regjimi nuk pajtohet, atëherë lidhja familjare duhet të priset; fëmijët inkurajohen të informojnë për prindërit e tyre, dhe nëse është e nevojshme ata - për "mbrojtjen e tyre" - do të hiqen nga kujdesi prindëror, dhe prindërit do të merren nga sistemi i drejtësisë penale. Historia e Pavlik Morozov, 13-vjeçari që denoncoi babanë e tij tek autoritetet sovjetike, u mbajt në BRSS si një shembull heroik për të gjithë fëmijët.

Kështu të indoktrinuar, mirëkuptimi i tyre i frenuar, i përforcuar vazhdimisht nga propaganda, qytetarët e shteteve totalitare praktikisht arritën në moshë madhore të paaftë për të kuptuar mendimet dhe idetë që bien ndesh me ato të tyre; më shumë se kaq, ata u shkolluan të besonin se ide të tilla jo vetëm që ishin të gabuara, ato ishin të rrezikshme dhe ato që i përkrahnin duhet të heshtnin, të ndëshkoheshin, madje edhe të shfaroseshin. Atyre iu tha se vetëm atëherë bota e premtuar - Rajhu i Madh Gjerman, ose Parajsa e Punëtorëve Sovjetikë - do të përparonte edhe lulëzonte.

Atyre që nuk ishin ende të bindur ose që ruanin ende gjurmët e të menduarit të vjetër, u privuan nga çdo mundësi për të vepruar në mënyrë të pavarur nga presioni shoqëror. Rezistenca ndaj nazizmit dhe komunizmit sovjetik kërkonte trimëri dhe angazhim të jashtëzakonshëm, sepse edhe veprat më të vogla të mospajtimit mund të vinin jetën në rrezik. Ndoshta prandaj nuk është çudi që shumë pak - më pak se 0.5% e popullsisë në rastin e Gjermanisë naziste - u angazhuan në veprimtari për rezistencë. Shumica dërrmuese zgjodhi të përshtatej, pajtohej dhe bashkëpunonte.

Prandaj, kur mendojmë për regjimet totalitare të përfaqësuara këtu nëpërmjet raporteve të viktimave, duhet të mendojmë edhe për autorët e këtyre krimeve; dhe ndonëse i dënojmë veprimet e tyre duhet të përpiqemi me sa mundemi të kuptojmë qëllimet e tyre, pse mendonin ashtu dhe si ishin manipuluar dhe helmuar nga vetë sistemet politike që mbrojtën. Ndoshta vetëm atëherë do të mund të kuptojmë tërësisht si u krijuan këto regjime, si u ngritën, si e përjetësuan veten dhe si vazhduan të bënin masakrat që bëjnë. Dhe ndoshta vetëm atëherë do të mund të vlerësojmë plotësisht vlerat sociale dhe politike - demokracinë, lirinë, tolerancën, sinqeritetin - këto janë ende mbrojtja jonë më e mirë kundër mënyrave totalitare të të menduarit.

Ky libër është një shtesë e mirëpritur e letërsisë mbi totalitarizmit, një temë që akoma merr shumë më pak vëmendje nga ç'duhet në sistemet tona të arsimit. Shpresoj se do të nxisë një kuptim më të mirë të regjimeve të urryera të përfaqësuara këtu, dhe do të shërbejë si një kujtesë për rreziqet bashkëkohore të ekstremizmit politik dhe intolerancës. Ju uroj suksese.

Roger Moorhouse
Historian, Anëtar i Royal Historical Society
Buckinghamshire, Britani e Madhe

KUJTESA TRAGJIKE E REGJIMEVE TOTALITARE TË EUROPËS

Europa përjetoi dy tragjedi të mëdha në shekullin e 20-të. E para ishte lufta në vitet 1914-1918, e zhvilluar nga vendet me qytetërime antike dhe kultura të zhvilluara. Të tronditur nga nacionalizmi i dhunshëm ato u përfshinë në një konflikt të vullshëm që zgjati katër vite të gjata dhe shkaktoi vdekjen në betejë të miliona ushtarëve. Mund të argumentojmë se luftërat datojnë që nga ditët më të lashta të antikitetit – thjesht kujtoni shkrimet e Homerit për Luftën e Trojës - dhe se gjatë Luftës së Parë Botërore ligjet e luftës respektoheshin në pjesën më të madhe të kohës: të burgosurit e luftës nuk u vranë, civilët nuk u masakruan dhe çdo vend mund të nderonte të vdekurit e tij. Përveç kësaj, konflikti çoi në rënien e katër perandorive të mëdha europiane, që lejoi shumë kombe të krijonin një ekzistencë të pavarur në kufij të sigurt, si dhe sisteme demokratike dhe parlamentare të niveleve të ndryshme.

Ndryshe nga sa më sipër, gjatë viteve 1920-1930 u shfaq një fenomen politik i pashembullt në histori: totalitarizmi, i cili çoi në tragjedinë më të madhe që Europa kishte parë ndonjëherë, kujtimi i të cilit ende sot lë gjurmë të thella në secilin nga vendet tona.

Totalitarizmi lindi në Rusi pas puçit të organizuar në Shën Petersburg më 7 nëntor 1917 nga Bolshevikët, një parti ekstremiste revolucionare e udhëhequr nga Vladimir Lenin. Mund të themi se fillesa e tij daton më 18 janar 1918, kur Bolshevikët shpërndanë me dhunë asamblenë e parë kushtetuese të zgjedhur lirisht në Rusi, nga më shumë se 40 milionë votues. Ky regjim i ri u imponua përmes diktaturës, terrorit dhe luftës civile, duke hedhur themelin e sistemit totalitar: një monopoli i trefishtë i një partie që zotëron pushtetin politik, botëkuptimin ideologjik, mjetet e prodhimit, si dhe shpërndarjen e të mirave materiale. Monopoli i trefishtë mund të imponohej vetëm duke përdorur terrorin masiv si një metodë qeverisjeje që pretendonte të revolucionarizonte shoqërinë dhe të krijonte "njeriun e ri".

Lenini vdiq në janar 1924 dhe pushteti sovjetik u mor shpejt nga Joseph Stalin, i cili zgjeroi dhe sistematizoi parimet totalitare të vendosura nga Lenini. Pas një lufte civile shkatërrimtare midis 1918 dhe 1922, e cila shkaktoi miliona vdekje, nga 1929 e tutje Stalini rindezi dinamikat totalitare me anë të kolektivizimit të detyruar të bujqësisë, e cila kulmoi me një katastrofë urie të organizuar nga qeveria në 1932-1933 kundër fshatarësisë ukrainase, duke çuar në vdekjen nga uria të disa miliona njerëzve brenda pak muajsh. Ukrainasit e quajnë këtë Holodomor, një term i njëjtë me Shoah për hebrenjtë. Paralelisht, Stalini krijoi një sistem të gjerë të kampeve të përqendrimit të quajtur Gulag, dhe në vitet 1936-1938 ai nisi Terrorin e Madh, kundër kategorive shoqërore dhe pakicave kombëtare, i cili vrau më shumë se 700,000 njerëz.

Modeli totalitar komunist u kopjua me shpejtësi nga dy udhëheqës të tjerë totalitarë: Benito Mussolini në Itali duke filluar në 1922 dhe Adolf Hitler në Gjermani në 1933. Sidoqoftë, diktatorët Fashistë dhe Nazistë, deri në 1939, nuk i dhanë dimension të plotë kriminal natyrës së tyre totalitare. Ishte aleanca midis Hitlerit dhe Stalinit në gusht-shtator 1939, që nxiti Luftën e Dytë Botërore, duke çuar në tragjedinë e dytë të madhe europiane të shekullit të 20-të, e cila tejkaloi të parën përtej çdo krahasimi.

Polonia ishte viktima e parë e shpërthimit vrasës të regjimeve naziste dhe komuniste. Ata jo vetëm që shkatërruan shtetin polak brenda pak javëve, por u përpoqën të shfarosnin elitat polake, siç dëshmon nga njëra anë kampi në Auschwitz, i cili u ngrit nga nazistët më 1940 për të burgosur dhe vrarë rezistencën polake, dhe në anën tjetër nga masakra ndaj oficerëve polakë në Katyn nga policia politike e Stalinit në pranverën e vitit 1940. Që prej fillimit, lufta u dha fuqive totalitare mundësinë që të përfshiheshin në masakra të fshehta ndaj civilëve dhe dëbime kolektive duke synuar grupe të popullsisë që përcaktoheshin sipas kriterëve ideologjike: racore për nazistët - drejtuar posaçërisht për hebrenjtë e burgosur në geto, dhe shoqërore për komunistët - që synonin elitat ekonomike të dëbuara me familjet e tyre në Bashkimin Sovjetik (BS). Pas triumfit të ushtrive të Hitlerit dhe Stalinit midis shtatorit 1939 dhe qershorit 1940, tashmë mund të pritej më e keqja: nga Atlantiku në Paqësor dhe nga Oqeani Arktik në Mesdhe, civilizimi antik i Europës, djepi i krishtëritimit dhe demokracia, rrezikonte të shkatërrohej midis dy sistemeve gjigante totalitare.

Prishja e aleancës totalitare dhe sulmi i Gjermanisë ndaj BS më 22 qershor 1941 shënuan fillimin e fazës më ekstreme të vrasjeve masive. Në korrik 1941, nazistët filluan "zgjidhjen përfundimtare të Çështjes Hebreje", vrasjen sistematike të hebrenjve sovjetikë. Kjo masakër u shtri më pas në të gjithë Europën në një gjenocid që la më shumë se pesë milionë të vdekur dhe rezultoi virtualisht në zhdukjen e hebrenjve në Europën Qendrore dhe Lindore. Në të njëjtën kohë, nazistët bënë gjithashtu një luftë shfarosëse kundër sllavëve, duke lënë miliona të burgosur sovjetikë të vdisnin nga uria, në kundërshtim me të gjitha ligjet e luftës. Si kundërpërgjigje, regjimi sovjetik mbajti disa të burgosur dhe në 1944 dhe 1945 ai dëboi popuj të tërë nga jugu i Rusisë - Çeçenët, Tatarët e Krimesë dhe të tjerët - dhe dëboi të gjithë popullsinë gjermane nga Prusia Lindore.

Kjo dhunë ekstreme duket sikur e ktheu luftën e shekullit të 20-të në nivelin barbar të luftërave të antikitetit, kur të mposhturit u masakruan sistematikisht ose u kthyen në skllëvër, kur qytete dhe kombe të tëra u zhdukën plotësisht. Sa i çuditshëm "progresi i qytetërimit", i cili ka lënë gjurmë dhe shenja të pashlyeshme që ende ndjehen dhe sot në të gjithë Europën. Kjo është arsyeja pse ka kaq shumë rëndësi që brezat e rinj, të lindur në një Europë të unifikuar dhe paqësore, t'i kuptojnë këto çështje të së kaluarës dhe historisë.

Sigurisht, disfata ushtarake e Gjermanisë naziste dhe Italisë fashiste, dënimi publik dhe zyrtar i regjimit nazist dhe krimeve të tij në Gjykimet e Nurembergut në vitet 1945-1946, mundësoi përkujtimin tragjik të viktimave dhe

nderimin e tyre. Në dhjetor 1948, nën udhëheqjen e avokatit polak Raphael Lemkin, i cili shpiku fjalën "gjenocid", Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (OKB) miratoi një rezolutë që dënon këtë krim masiv dhe një natyrën unike të Shoah. Sot, me përjashtim të disa refuzuesve dhe grupeve ekstremiste neo-naziste, askush në Europë nuk e kujton në mënyrë të lavdishëme nazizmin apo fashizmin.

Përkundrazi, Europa që para luftës, por kryesisht nga viti 1945 në 1980 ka ruajtur një kujtim të fuqishëm të lavdishëm të Komunizmit, bazuar në kontributin e rëndësishëm të Ushtrisë së Kuqe në mposhtjen e Gjermanisë naziste, në pjesëmarrjen e partive Komuniste në rezistencën antifashiste pas 22 qershorit 1941, dhe më në fund mbi mitin e "çlirimit" sovjetik të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore 1944-1945. Ky "çlirim" u përkthye në sovjetizimin ose komunizimin e dymbëdhjetë vendeve europiane që më parë ishin të pavarura. Mbi këto vende u imponuan diktaturat totalitare komuniste. Pas vitit 1945, në BS dhe në "demokracitë popullore" të ndryshme, si dhe në Europën Perëndimore pasoi një glorifikim i kujtesës mbi komunizmin, nën ndikimin e partive të fuqishme komuniste, veçanërisht në Francë dhe Itali duke përzier me mjeshtëri fitoren mbi nazizmin dhe triumfin e modelit politik e shoqëror komunist.

Do duhej të prisnim deri në nëntor 1989 rrëzimin e Murit të Berlinit dhe të të gjithë regjimeve komuniste në Europën Lindore – dhe më pas për dhjetorin 1991 që shënon rënien e BS, që ky kujtim i lavdishëm i komunizmit të fillonte të venitej nën efektin e trefishtë që sollën rifitimi i fjalës së lirë të viktimave të panumërta të regjimeve komuniste, hapja e arkivave komuniste dhe puna e historianëve. Botimi i "Librit të Zi të Komunizmit" (përpjekja e parë për një vlerësim të përgjithshëm të krimeve të regjimeve komuniste) në nëntor 1997 dhe përkthimi i tij në shumicën e gjuhëve europiane, u shoqërua nga debate të panumërta publike, të cilat ndihmuan që kujtesa tragjike e komunizmit të ekspozohej publikisht. Me këtë rast, të gjithë ishin në gjendje të gjykonin distancën që ndante kujtimet e shekullit të 20-të në Europën Perëndimore dhe atë Lindore, të ndara përgjysmë nga Perdja e Hekurt nga viti 1945-1946, të cilat kanë filluar të ribashkohen gjatë viteve 1989-1991.

Dikush do të mendonte se rënia e Komunizmit dhe ribashkimi i Europës do të favorizonte një përpjekje të zakonshme në lidhje me historinë dhe kujtesën e "Europës sonë" dhe "Europës tjetër". Megjithatë, më shumë se tridhjetë vjet pas rënies së Murit të Berlinit, Europa përballet ende me qëndrueshmërinë e tre formave tejet të dallueshme të kujtesës së komunizmit, veçanërisht ato të lidhura me Luftën e Dytë Botërore. Një pjesë e madhe e Europës Qendrore dhe Lindore, në veçanti vendet Balltike dhe pjesa perëndimore e Ukrainës, ruajnë një kujtim tragjik të komunizmit që shënjohet nga pushtimi i Ushtrisë së Kuqe, terrori masiv dhe dyzet e pesë vjet diktaturë, censurë dhe burgosje.

Përkundrazi, Europa Perëndimore ka gëzuar paqe dhe prosperitet që nga viti 1945 falë mbrojtjes amerikane. Por ajo shpesh kultivon një kujtim të lavdishëm të komunizmit bazuar në kujtesën e asaj që François Furet e ka quajtur

"thirrja universale e revolucionit të tetorit", në antifashizmin e viteve 1930 (Fronti Popullor, Lufta Civile Spanjolle, etj.) dhe në pjesëmarrjen aktive të komunistëve në rezistencën ndaj pushtimeve naziste dhe fashiste pas 22 qershorit 1941. Për gjysmë shekulli propaganda e fuqishme komuniste ka punuar të instalojë një kujtim të ekzagjeruar të antifashizmit që konsiderohet nga komunistët një monopol, si dhe të instalojë një amnezi të aleancës sovjetiko-naziste dhe më përgjithësisht të dimensionit totalitar të regjimeve Komuniste. Ky fenomen u zbulua papritur nga polemikat e dhunshme që pasuan në Francë dhe në të gjithë Europën pas botimit të "Librit të Zi të Komunizmit".

Ndërsa Rusia është zënë në kurthin e një kujtimi të ndarë në dy pjesë, tragjik dhe të lavdishëm në të njëjtën kohë. Nga njëra anë, gjurmët e kujtesës së terrorit, Gulagu dhe diktatura ndikojnë në të gjithë shoqërinë, një pjesë e së cilës i përket kategorisë së viktimave, ndërsa pjesa tjetër kategorisë së qeverisë dhe xhelatëve, por nganjëherë të dyve. Nga ana tjetër pushteti post-komunist është i angazhuar në rindërtimin e një identiteti rus, bazuar në kujtesën e "Luftës së Madhe Patriotike" dhe fitores mbi Gjermaninë naziste më 1945, por duke fshehur krimet masive të luftës civile dhe të viteve 1930 me po aq mjeshtëri sa ato të viteve 1939-1941 dhe më pas në 1944-1953, kryesuan aneksimin dhe sovjetizimin e shumë kombeve që është pretenduar haptas si një "çlirim" nga Presidenti rus Vladimir Putin.

Ndërkohë, një hap i rëndësishëm në rrugën për ribashkimin e kujtesave u krye më 25 janar 2006, kur Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, e kryesuar nga anëtari suedez i Parlamentit Göran Lindblad, miratoi një rezolutë që dënonte krimet e regjimeve komuniste. Megjithatë, fakti që një numër i madh deputetësh votuan kundër rezolutës, dëshmon për vështirësinë e njohjes së kujtesës tragjike të viktimave të panumërta të regjimeve komuniste.

Parlamenti Europian vijoi me rezolutën e tij të 2 prillit 2009 mbi Ndërgjegjen Europiane dhe Totalitarizmin. Kësaj here shumica dërrmuese e Parlamentit propozoi 17 pika që synonin arritjen e një vlerësim të drejtë dhe dakortësimin me trashëgiminë e përbashkët europiane të totalitarizmit.

Një shenjë tjetër pozitive ndodhi në 14 tetor 2009, kur Parlamenti Europian organizoi një konferencë zyrtare në Bruksel me rastin e 70 vjetorit të pakteve Gjermano-Sovjetike të 23 gushtit dhe 28 shtatorit 1939, të cilat çuan në shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore. Në shenjë simbolike pajtimi, konferenca u kryesua nga polaku Jerzy Buzek, Presidenti i Parlamentit Europian, me pjesëmarrjen e paraardhësit të tij në këtë post, gjermani Hans-Gert Pöttering, si dhe presidenti i parë i Lituanisë jokomuniste, Vytautas Landsbergis, ish-kryeministri i Estonisë, Mart Laar, si dhe shumë historianë. Kështu që nga 1939 deri në 1989, përkujtimi i gëzueshëm i rënies së Murit të Berlinit nuk ka errësuar një tjetër ngjarje më tragjike.

Sot, shumica e vendeve europiane janë ribashkuar politikisht, ligjrisht dhe ekonomikisht në gjirin e Bashkimit Europian. Por ne jemi akoma larg një kujtese të përbashkët europiane që do të përfshinte në të njëjtën masë tragjeditë

e shkaktuara nga dy sistemet e mëdha totalitare - naziste dhe komuniste. Kjo është arsyeja pse iniciativa e ndërmarrë nga Platforma e Kujtesës dhe Ndërgjegjes Europiane është kaq e rëndësishme dhe kaq e vlefshme – që të botohet një tekst për të gjithë të rinjtë europianë, në gjuhë të ndryshme, i cili kujton emrat e burrave dhe grave nga vende të ndryshme të Europës që rrezikuan jetën për t'i rezistuar shtypjes totalitare dhe për të ruajtur idealet më të mira të asaj që Europa i ofron botës: tolerancën, lirinë e mendimit, refuzimin e ekstremizmit dhe kulturën e demokracisë dhe qeverisjes parlamentare, e cila vetëm mund të sigurojë paqe lokale dhe ndërkombëtare. Brezat e rinj duhet të ndërgjegjësohen për privilegjin nga i cili nuk kanë përfituar gjyshërit e tyre: jeta në një Europë të ribashkuar, paqësore dhe demokratike. Ata duhet të kuptojnë se ruajtja e këtij privilegji nënkupton një betejë të përditshme. Asgjë nuk mund të merret kurrë si e mirëqenë.

Stéphane Courtois

Historian, Drejtor i Kërkimeve në Qendrën Kombëtare për Kërkime Shkencore

Autor i Librit të Zi të Komunizmit

Paris, Francë

SUEDIA



NJË VEND DEMOKRATIK

Suedia qëndroi neutrale në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore. Gjatë Luftës së Dimrit midis Bashkimit Sovjetik dhe Finlandës në 1939-1940, Suedia për të ruajtur neutralitetin e saj refuzoi lutjet e Finlandës për ndërhyrje ushtarake, megjithatë mijëra vullnetarë suedezë luftuan në Finlandë kundër Bashkimit Sovjetik. Suedia gjatë Luftës së Parë Botërore furnizoi Gjermaninë me mineral hekuri, çeliku dhe pjesë makinerie, por në të njëjtën kohë mbështeti rezistencën norvegjeze dhe në 1943 ndihmoi në shpëtimin e hebrenjëve danezë nga dëbimi për në kampet e përqendrimit.

Suedia u bë një strehë për refugjatët nga Danimarka dhe Norvegjia gjatë pushtimit të tyre nga Gjermania. Shumë fëmijë finlandezë jetuan në Suedi gjatë luftës. Në 1944-1945 dhjetëra mijëra Estonezë, Letonezë dhe Lituanëzë u strehuan në Suedi për t'i shpëtuar pushtimit sovjetik.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Suedia vazhdoi me politikën e saj të neutralitetit, duke qëndruar jashtë NATO-s dhe iu bashkua BE-së vetëm pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, nga 1 janari 1995. Suedia ka pranuar vazhdimisht refugjatë nga rajone të ndryshme të botës, që arratiseshin për të shpëtuar nga shkeljet e të drejtave të njeriut dhe ende vazhdon të pranojë.

RAOUL WALLENBERG lindi në një familje të pasur suedeze më 4 gusht 1912. Babai i tij vdiq tre muaj para se të lindte Raoul. Raoul jetoi me të jëmën dhe gjyshen e tij gjatë viteve të para të jetës së tij. Mamaja e tij, maj, u martua përsëri në 1918 dhe pati dy fëmijë të tjerë të cilët u rritën me Raoul dhe kishin një marrëdhënie shumë të ngushtë. Në rini Raoul mori një edukim të përzgjedhur në Francë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), si dhe kaloi kohën duke punuar në Afrikën e Jugut dhe Palestinë. Në 1944, Raoul u gjetë në një pozicion të veçantë, duke ndihmuar hebrenjtë hungarezë t'i shpëtonin makinës naziste të vdekjes. Në një operacion që përfshiu ambasadën Suedeze në Budapest dhe Bordin Amerikan të Refugjatëve të Luftës, ai u përpoq të shpëtonte sa më shumë që ishte e mundur hebrenj të mbetur të Hungarisë. Gjatë këtij operacioni u shpëtuan dhjetëra mijëra jetë, ndoshta deri në 100,000. Në mes të janarit 1945, Wallenberg u rrëmbye nga sovjetikët dhe nuk u pa më.



KOLEKSIONI PRIVAT I
NINA LAGERGREN,
FOTO: KARL GABOR

Raoul Wallenberg

Një Rrëfenjë e Kurajos së Madhe

shkruar nga Penny Schreiber¹

R Raoul Wallenberg lindi në fillim të shekullit të 20-të në Stokholm, në dy familje të shquara suedeze. Babai i tij, i quajtur gjithashtu Raoul Wallenberg, ishte një oficer i ri detar kur u martua në fund të vitit 1911 me maj Wising, vajza e një neurologu të njohur. Bashkimi i tyre premtes u kthye shpejt në tragjedi. Oficeri i ri i marinës u sëmur nga kanceri dhe vdiq tre muaj para se të lindte djali i tij.

Raoul Wallenberg lindi më 4 gusht 1912, në komoditetin viktorian të shtëpisë verore të gjyshes së tij në Kapptsä, pranë Stokholmit. Raoul gjatë viteve të para jetoi me nënën dhe gjyshen e tij.

Familja Wallenberg ishte shumë e njohur, si në Suedi dhe në të gjithë botën. Babai i Raulit ishte një oficer i Marinës Suedeze dhe gjyshi i tij nga babai, Gustav, ishte ambasadori i Ambasadës Suedeze në Japoni. Xhaxhallarët e Raulit, Jacob dhe Marcus Wallenberg, ishin bankierë të suksesshëm që themeluan Bankën Enskilda në Suedi. Wallenbergë të tjerë ishin diplomatë dhe peshkopë të Kishës Lutherane. Mamaja e tij gjithashtu vinte nga një familje prestigjioze. Babai i saj, Per, ishte profesori i parë i neurologjisë në Suedi. Stërgjyshi i maj, i cili ishte hebre dhe quhej Benedicks, u vendos në Suedi dhe u bë një argjendar dhe përfundimisht këshilltar financiar i mbretit.

Maj u martua përsëri në 1918, kur Wallenberg ishte gjashtë vjeç, me Frederick von Dardels i cili shumë shpejt u bë administratori i spitalit Karolinska, më i madhi në Suedi. Von Dardels kishte dy fëmijë, Nina dhe Guy, të cilët u rritën me Raoul duke krijuar një marrëdhënie shumë të ngushtë.

Wallenberg ishte shumë i lidhur me nënën dhe njerkun e tij. Ai gëzoi liri të pazakontë, që njerku i tij ia lejoi që nga koha kur ishte i ri. Gjyshi i tij nga babai, Gustav Wallenberg, ishte mentori dhe i besuari i tij. Si një diplomat që udhëtonte shumë, Gustavi donte ta mbante Raoul të lirë nga shqetësimet kufizuese të borgjezisë suedeze dhe ta shndërronte atë në një qytetar të botës.

Ndërsa rritej, qe gjyshi Wallenberg që u kujdes për arsimin e tij, duke menduar se ai do të vazhdonte traditën e familjes së tij me bankierë, diplomatë dhe politikanë shumë të respektuar. Në vitin 1930, Raoul Wallenberg mbaroi shkollën e mesme me notat më të larta në rusisht dhe vizatim. Menjëherë pas kësaj ai shkoi të përfundonte nëntë muajt e shërbimit të detyruar ushtarak. Pas shërbimit ushtarak,

¹ Version i shkurtuar; riprodhuar me lejen e mirësjellshme të komitetit të Wallenberg, Universiti i Miçiganit.

Gustav Wallenberg e dërgoi atë për një vit në Universitetin e Poitiers, në Francë, për të përsosur frëngjishten. Ai tashmë zotëronte shumë mirë anglishten, gjermanishten dhe rusishten.

Pas kësaj, në 1931, Wallenberg vendosi të ndiqte traditën e rrënjës nga burrat e tjerë të familjes së tij: ai ndoqi një arsim kolegji në Shtetet e Bashkuara.

JETA E KOLEGJIT

Gustav Wallenberg admironte nxitjen dhe praktikitetin e amerikanëve dhe donte që nipi i tij me shpirt artistik të ndiqte fushën e tij të dëshiruar të studimit në Amerikë, arkitekturën. Ai dhe Raoul përjashtuan Ligën Ivy për karakterin shumë snobist që ajo paraqiste dhe zgjodhën Universitetin e Miçiganit, si shkollë shumë e vlerësuar e arkitekturës, ashtu edhe për reputacionin si një universitet publik që tërhiqte studentë të talentuar, të cilët nuk mund t'i përballonin shkollat më prestigjioze lindore.

Kur Raoul donte të aplikonte në Shkollën e Ekonomikut të Stokholmit, Gustav çuditërisht tha jo, duke këmbëngulur ta dërgonte nipin e tij jashtë vendit. Gustav Wallenberg nuk i fshehu motivet e tij të errëta. Ai kishte frikë se gratë dinake të Stokholmit do t'ia prishnin projektin e tij të investimit. Ai e paralajmëroi nipin e tij me gjuhë të ashpër, të mos lejonte të zihej në kurth nga "hienat" dhe "të ngecej me një familje", para se ata të përmbushnin planin e tyre. Përbuzja është një fjalë shumë e butë për të përshkruar pikëpamjen e Gustav Wallenberg për gratë. "Kur joshesh nga hijeshia e gruas së re, mos harro kurrë se bukuria e një gruaje nuk është asgjë më shumë se dhjami i shpërndarë pak a shumë mirë nën lëkurë", i shkruajti ai një herë nipit të tij.

Fragment nga një artikull i shkruar nga Ingrid Carlberg për gazetën "Dagens Nyheter".

"Jam shumë i impresionuar nga Amerika," i shkruajti Raoul gjyshit të tij, dy vjet pas mbërritjes së tij aty. "Njerëzit janë të thjeshtë dhe të mirësjellshëm, mikpritës dhe të lehtë për t'u marrë vesh." Motra e Wallenberg, Nina Lagergren, e përshkruante atë si një "anti-snob" që "donte leximin, Chaplin dhe vëllezërit Marx". Hante hot-dog, vishte atlete dhe preferonte të quhej "Rudy". Një shok tjetër i klasës, Frederick Graham, në një artikull të vitit 1985 për "Michigan Alumnus" i tha Lillian Stafford, se Wallenberg nuk donte të bashkohej me një vëllazëri sepse "kjo do ta izolonte atë nga një shtresë e caktuar studentësh".

Gjatë pushimeve shkollore, Wallenberg shëtiti përreth Shteteve të Bashkuara, Kanada dhe Meksikë duke bërë autostop. Në një letër drejtuar gjyshit të tij në fund të verës së tij të parë këtu, ai ofroi një shpjegim të gjatë se pse preferonte të bënte autostop. "Kur udhëton si endacak, gjithçka është ndryshe. Duhet të jesh në gatishmëri gjatë gjithë kohës. Je në kontakt të ngushtë me njerëz të rinj çdo ditë. Autostopi të trajnonë në diplomaci dhe takt."

Në shkurt 1935, Wallenberg përfundoi studimet Bachelor në arkitekturë. Ai u diplomua me nderime

dhe fitoi medaljen e argjendtë të Institutit Amerikan të Arkitektëve, për nivelin më të lartë shkollor.

EKSPERIENCA NË BIZNES

Pasi u largua nga universiteti, Wallenberg jetoi dhe punoi në Afrikën e Jugut për gjashtë muaj, pastaj shkoi në Palestinë, ku punoi si praktikant te një miku i gjyshit të tij, një bankier hebre nga Holanda. Gustav kishte ende shpresë se e ardhmja e nipit të tij që në perandorinë financiare të familjes.

Në librin "Wallenberg: Heroi i Humbur", gazetarja me origjinë hungareze, Kati Marton, vëren se kjo praktikë mësimi rezultoi të ishte një edukim i një lloji tjetër. Dikur pjesë e klasës së mesme të begatë në qytetet gjermane, hebrenjtë tashmë po dyndeshin në Palestinë "të shndërruar në lypës të rreckosur nga ligjet e Nurembergut".

Raoul takoi shumë refugjatë hebrenj në konviktin ku po qëndronte, si dhe përmes mentorit të tij holandez. Ai dëgjoji historitë e tyre për heqjen e të gjitha të drejtave nga Rajhu Gjerman dhe shndërrimin e tyre në "jopersona". Marton beson se "përshtypja që ky segment i përulur i njerëzimit la tek ai ishte e përhershme".

Në pranverën e vitit 1937, Gustav Wallenberg vdiq papritur. Raoul humbi jo vetëm babanë e tij zëvendësues, por edhe mentorin i cili kishte formësuar karrierën e tij të re. Me vdekjen e gjyshit të tij, shkruan Kati Marton, "në një shoqëri që ende kërkonte sponsorë, Raoul Wallenberg, i mirëarmatosur për sukses, nuk e gjeti atë". Gjatë katër viteve të ardhshme, Wallenberg u rropat. Diploma e tij amerikane nuk e kualifikoi atë për të punuar si arkitekt në Suedi. Ai filloi dy biznese, por asnjëri nuk rezultoi i suksesshëm.

Ai vazhdonte të mbetej thellësisht i shqetësuar për hebrenjtë në Gjermaninë naziste, mbante kontakte me refugjatët që ishin arratisur në Suedi dhe siguronte në mënyrë anonime subvencione ushqimore për ndonjë familje në nevojë.

Më 1941, Jacob Wallenberg, xhaxhai dhe kumbari i Raulit, e sistemoi atë në Stokholm pranë Kálmán Lauer, një hungarez që drejtonte një firmë eksport-importi midis Stokholmit dhe Europës Qendrore. Si hebre,



Raul Wallenberg, afërsisht 23 vjeç.

KOLEKSIONI PRIVAT I NINA LAGERGREN, FOTO: KARL GABOR

Lauer e kishte gjithnjë e më të vështirë të udhëtonte në Hungari, që ishte tregu kryesor për specialitetin e produkteve të tij ushqimore. Raoul Wallenberg mori përsipër filialet jashtë vendit të firmës. Aftësia e tij mahnitëse për të mësuar gjuhë e bëri atë të paçmuar për Lauer, dhe kështu filloi të udhëtonte shpesh në Budapest, një qytet që shpejt u bë i dashur për të.

BUDAPESTI DHE HEROIZMI

Popullsia hebre e Budapestit jetonte si në rrethim. Nga pranvera e vitit 1944, çdo komunitet tjetër i madh hebre në Europë ishte shkatërruar dhe Adolf Eichmann kishte ardhur në Hungari i vendosur për të përfunduar "Zgjidhjen Përfundimtare" të Hitlerit para se të mbaronte lufta. Ai po dërgonte me shpejtësi në dhomat e gazit 10,000 deri në 12,000 hebrenj në ditë.



Patenta Hungareze e Wallenberg më 1944.

KOLEKSIONI PRIVAT I NINA LAGERGREN, FOTO: KARL GABOR

Ndonëse me vonesë, qeveria amerikane po përpiquej ta ndalonte atë. Atë pranverë, Presidenti Roosevelt dërgoi Iver Olsen në Stokholm si një përfaqësues zyrtar i Bordit Amerikan të Refugjatëve të Luftës.

Olsen po kërkonte një burrë të gatshëm të ecte në nofullat e makinës naziste të vdekjes, dikë që fliste si hungarisht, ashtu edhe gjermanisht, dikë të pavarur që nuk do të kishte nevojë për shumë mbikëqyrje apo drejtim. Një prej njerëzve që Olsen takoi në Stokholm ishte Kálmán Lauer. Lauer menjëherë rekomandoi partnerin e tij të ri të biznesit, Raoul Wallenberg. Për Wallenberg, oferta e Olsen ishte e parezistueshme, një mundësi për të arritur diçka vërtet të rëndësishme. Kështu që ai pranoi të shkonte në Hungari, dhe arriti aty me tren në korrik 1944.

Wallenberg teknikisht ishte i atashuar në ambasadën Suedeze në Budapest, megjithëse me këmbënguljen e tij, ai nuk iu nënshtrua kufizimeve të zakonshme të vendosura mbi diplomatët. Përpjekjet e tij gjatë gjashtë muajve të ardhshëm ishin të guximshme, të zgjuara, jashtëzakonisht krijuese dhe tmerrësisht kurajoze.

Në Budapest, Wallenberg krijoi shpejt një zyrë dhe "punësoi" 400 vullnetarë hebrenj për ta drejtuar atë. Ai menjëherë urdhëroi stafin e tij të hiqnin yjet e verdhë që mbanin për t'u dalluar si hebrenj, duke u thënë: "Tani jeni nën mbrojtjen diplomatike suedeze". Misioni i tij për të shpëtuar atë që kishte mbetur nga popullsia hebre hungareze ishte në proces.

Wallenberg shpiku një pasaportë speciale suedeze, Schutz-Pass. Ishte një dokument shumëngjyrësh,

imponues, me pamje zyrtare. Pa i marrë leje askujt ai deklaroi se mbajtësi i këtij dokumenti kishte imunitet nga deportimi në kampet e vdekjes. Wallenberg ua shpërnda pasaportat e tij hebrejve pa dallim. Vetëm përmes tyre mendohet të kenë shpëtuar 20,000 hebrej.

Duke përdorur fondet e tij amerikane, Wallenberg kërkoi nëpër qytet për ndërtesa me qira. Ai përfundimisht gjeti tridhjetë e dy, të cilat i deklaroi si "ndërtesa ekstraterritoriale" të mbrojtura nga imuniteti diplomatik suedez. Në një klasë arkitekture në Universitetin e Miçiganit, Wallenberg qe vlerësuar "shkëlqyer" për hartimin e një projekti strehimi me kosto të ulët për 4,500 njerëz në gjashtëmbëdhjetë blloqe të qytetit. Në Budapest ai gjeti një mënyrë "për të vendosur 35,000 njerëz në ndërtesa të projektuara për më pak se 5,000".

"Shtëpitë e sigurta" të Wallenberg shpëtuan mijëra jetë hebreje, përfshirë atë të një profesori të Universitetit të Miçiganit, Andrew Nagy dhe nënës së tij. Nagy, i cili atëherë ishte katërmëdhjetë vjeç, gjithmonë do ta kujtojë natën e Krishtlindjes 1944, kur banorët e shtëpisë së sigurt ngjitur me të u nxorën nga shtretërit e tyre, marshuan drejt lumit Danub dhe u qëlluan nga nazistët. Hebrejtë shpesh i lidhnin tre së bashku në një rresht në bregun e Danubit. Personi i mesëm qëlluhej, duke rënë kështu të tre në ujin e ngrirë për t'u mbytur. Një grua nga zyra e Wallenberg solli në kujtesë një rast kur Wallenberg dëgjoji se nazistët hungarezë po gjuanin gratë dhe fëmijët në lumë. Ai pyeti stafin e tij se kush mund të notonte. "Ne shkuam, ishte një natë e ftohtë - dhe u hodhëm në Danub. Uji ishte i ftohtë i akullt." Ata shpëtuan pesëdhjetë ose gjashtëdhjetë njerëz.

Në Budapest, Wallenberg punonte vazhdimisht duke fjetur vetëm katër orë në natë. Ai ishte një burim frymëzimi për zviceranët dhe suedezët neutralë që punonin në misionet e ngjashme humanitare për Kryqin e Kuq dhe për ata që punuan krah tij. Por mbase edhe më e rëndësishme ishte aftësia e tij për të ringjallur shpresën tek ata që besuan se ishin të dënuar.

Wallenberg ishte i njohur për nazistët, të cilëve ai u jepte ryshfet, i manipulonte, u kundërvijë dhe i sulmonte pa u lodhur. Eichmann i referohej atij si "qeni hebre Wallenberg". Ndërsa vjeshta e vonë u kthye në dimër, jeta e Wallenberg rrezikohej gjithnjë e më shumë. Një ditë makina e tij u hodh në erë. Ai filloi të flinte çdo natë në një vend tjetër.

Me afrimin e trupave sovjetike, nazistët rritën sulmet e tyre ndaj popullsisë hebreje të Budapestit. Në ditët e fundit të pushtimit, trupat gjermane, së bashku me nazistët hungarezë, u mblodhën rreth getos së hebrejve duke u përgatitur për një masakër. Kur mësoi për planin, Wallenberg u përball me komandantin nazist duke e bindur atë se nëse ai lejonte sulmin në geto, Wallenberg do të kujdesej që ai të varej pas luftës për krime kundër njerëzimit. Nazisti i frikësuar, i cili e dinte që Hitleri po mposhte, e anuloi sulmin. Jetët e 70,000 hebrejve u shpëtuan.

Kërcënimi nuk përfundoi me tërheqjen naziste. Ndërsa gjermanët filluan të iknin nga Budapesti, nazistët hungarezë sunduan rrugët, duke vrarë hebrej ku t'ua kapte syri. Qyteti dikur i bukur ishte kthyer në një ferr të tmerrshëm.

Për dy muaj, Wallenberg kishte dëgjuar armët sovjetike në periferi të Budapestit. Duke e ditur që ushtria së shpejti do të zhvendosej në qytet, ai filloi të praktikonte rusishten e tij shkollore. Ai shpresonte të takohej me udhëheqësit sovjetikë për të filluar planifikimin e rehabilitimit të shoqërisë së shkatërruar të Budapestit.

Një mëngjes, në mes të janarit 1945, njëzet sovjetikë mbërritën në derën e Wallenberg. Duke folur me një rusishte të çalë, Wallenberg u shpjegoi misionin e tij për të shpëtuar hebrenjtë dhe kërkoi që të dërgohej tek autoritetet më të larta sovjetike. Ai kaloi atë natë në selinë ruse në Budapest. Të nesërmen u kthye në shtëpi me një eskortë shoqëruese për të marrë sendet e tij. Miqtë e përshkruanin atë të qetë, por me një prerje në zërin e tij, duke i siguruar ata që do të kthehej pas rreth një jave. Miqtë dhe familja nuk e panë më kurrë Wallenberg.

ZHDUKJA DHE FATI I PANJOHUR

Pse u arrestua Wallenberg nga sovjetikët? Një arsye mund të ketë qenë se Iver Olsen, amerikani që e rekrutoi atë, ishte gjithashtu agjent në Zyrën e Shërbimeve Strategjike të SHBA, institucioni paraardhës i CIA-s. Sovjetikët ishin të vetëdijshëm për këtë dhe shumë paranojakë. Një spiun sovjetik që ishte infiltruar në Kryqin e Kuq në Budapest e kishte mbikëqyrur nga afër Wallenbergun. Për të, motivet humanitare të Wallenberg qenë thjesht të pakonceptueshme. Ai doli në përfundimin se Wallenberg ishte një agjent i dyfishtë që punonte për amerikanët dhe gjermanët. Sovjetikët kur marshuan për të pushtuar Budapestin nuk donin të merreshin me enigma kaq të rrezikshme.

Wallenberg u besonte komunistëve vetëm pak më shumë se nazistëve, por e la veten të binte në duart e tyre, sepse shpresonte se sovjetikët do ta lejonin atë të qëndronte në Hungari, për të marrë pjesë në rimëkëmbjen e shoqërisë së pasluftës.

Në kohën kur u rrëmbye, heroizmi i Wallenberg ishte i panjohur për botën në përgjithësi. Suedia është fqinji i afërt i Rusisë dhe qeveria suedeze ishte më e interesuar për të mbajtur marrëdhënie të mira me BS sesa për të zbuluar se çfarë kishte ndodhur me një shtetas Suedez të punësuar nga SHBA. Në prill 1945, Averell Harriman, në emër të Departamentit të Shtetit të SHBA, i ofroi qeverisë suedeze ndihmën amerikane për të hetuar mbi fatin e Wallenberg. Oferta e tij u refuzua prerazi. Vetëm pas qershorit 1946, nën presionin e opinionit publik suedez dhe Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, ministri suedez në Moskë më në fund kërkoi një intervistë me diktatorin sovjetik Joseph Stalin për të diskutuar rreth Wallenberg. Megjithëse Zyra e Jashtme Suedeze kishte prova se Wallenberg ishte burgosur në Moskë, ministri u shpreh vullnetarisht se ai personalisht besonte se humanitari i madh ishte vrarë në Budapest. Stalini nuk e kundërshtoi këtë rrugëdalje të lehtë që iu ofrua.

Komploti i heshtjes vazhdoi për njëmbëdhjetë vjet. Familjarët e afërt të Wallenbergut kurrë nuk hoqën dorë nga shpresa për ta gjetur dhe që nga momenti i zhdukjes ngulmonin pa pushim në zgjidhjen e çështjes.

Vetëm në 1957, gjatë çmpirjes politike pas vdekjes së Stalinit, sovjetikët thyen heshtjen e tyre zyrtare ndaj fatit të Wallenberg. Ata pranuan se ai i kishte mbijetuar luftës dhe madje që Stalini e kishte mbajtur atë të burgosur në kohën e takimit me ministrin suedez në vitin 1946. Por ata pretenduan se Wallenberg, një 32 vjeçar i shëndetshëm në kohën kur u rrëmbye, kishte vdekur në burg nga një atak kardiak dy vjet më vonë. Kjo mbeti linja zyrtare deri në vjeshtën e vitit 2000.

Për tridhjetë e pesë vjet, historia e Wallenberg mbeti e panjohur jashtë Suedisë. Vetëm në vitin 1980 Elenore Lester, në një artikull të njohur tashmë në gazetën “New York Times”, solli në vëmendjen e botës historinë e Wallenberg. Vitin pasardhës, Presidenti Reagan e bëri Raoul Wallenberg një qytetar nderi të Shteteve të Bashkuara, një nder ky që i ishte dhënë më parë vetëm Winston Churchill.

Njohja e vonuar e arritjeve të Wallenberg ka bërë që misteri i fatit të tij të jetë edhe më prekës. Pavarësisht përpjekjes së Rusisë për të mbyllur çështjen, ata që punojnë në emër të trashëgimisë së Wallenberg vazhdojnë të këmbëngulin për informacione në lidhje me të. Provat bindëse që ai ishte gjallë për shumë kohë gjatë pesëdhjetë e gjashtë viteve të fundit janë te pamundura të hidhen poshtë. Opinioni publik suedez i janë paraqitur vetëm raportimet vëzhguese për Wallenberg që ish-të burgosurit sovjetik në Gulag kanë dhënë për mediat ndërkombëtare.

Në vitin 2000 Komiteti Hebre Amerikan publikoi një broshurë nga William Korey që përmbledh me përpikmëri historinë e rastit Wallenberg. Afër fundit të këtij rrëfimi dëshpërues, Korey shpjegon se si komisioni ruso-suedez i themeluar më 1990 me urdhër të Guy von Dardel, gjysmë vëllait të Wallenberg, për të kërkuar në arkivat e burgjeve ruse për informacion mbi Wallenberg sabotohej nga ndryshimi i vazhdueshëm i politikave ruse dhe pamundësia absolute për të fituar akses në dosjet kryesore të KGB-së.

Korey beson se qeveria amerikane ende mund të sjellë një ndryshim. "Fati i Wallenberg është diskutuar midis Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë në nivelet më të ulëta diplomatike dhe kryesisht në kontekstin e procesit të Helsinkit, i cili është krijuar për të informuar publikun për shkeljet e të drejtave të njeriut, jo për të prodhuar një rezultat të menjëhershëm thelbësor," shkruan Korey. "Qytetari i nderit' unik i Amerikës meriton më shumë".

Në prill 2001, Komiteti Raoul Wallenberg në SHBA



Pasaportë-Mbrojtjeje (Schutz-Pass).

KOLEKSIONI PRIVAT I NINA LAGERGREN, FOTO: KARL GABOR

botoi një shkrim prej tetë faqesh "Kronologjia e rastit Raoul Wallenberg". Në këtë kronologji janë përfshirë detajet e çdo vëzhgimi të raportuar për Wallenberg dhe takimi me të në Rusi nga shokët e tij të burgut që nga viti 1945. I fundit ishte në një kamp burgimi 150 milje larg Moskës në vitin 1987.

Në fillim të shekullit 21 duket si një fakt i padiskutueshëm që qeveria ruse vazhdon të qëndrojë midis botës dhe së vërtetës për atë që i ndodhi Raoul Wallenberg pas 17 janarit 1945.

Ndërsa vazhdon të shkruhet kapitulli i fundit mbi fatin e Wallenberg, njohja e vlerave të kontributit të tij në Hungari vazhdon të rritet. Në Izrael, ai nderohet në Yad Vashem – përkujtimorja e Jeruzalemit për viktimat e Holokaustit - si më i shquari i "Johebrenjve të Drejtë" (Righteous Gentiles).

Në vitin 1985, ambasadori amerikan në OKB, Jeane Kirkpatrick, duke folur në dyzet vjetorin e arrestimit të Raoul Wallenberg, tha se Wallenberg "është shëndrruar në më shumë se njeri, madje edhe në më shumë se hero. Ai simbolizon një konflikt qendror të epokës sonë, i cili është vendosmëria për të qëndruar njerëzor dhe të kujdesshëm dhe të lirë përballë tiranisë. Ajo që Raoul Wallenberg përfaqësoi në Budapest nuk ishte asgjë më pak se ndërgjegjja e botës së civilizuar ”.

TË DHËNA RRETH WALLENBERG

shkruar nga Ingrid Carlberg

1945: On 17 January a warrant for Raoul Wallenberg’s arrest is issued. He is brought to Moscow’s Lubyanka prison where he arrives on 6 February.

1947: In a diplomatic note to Sweden the Soviet Union claims that Raoul Wallenberg “does not exist in the Soviet Union,” and that “he is unknown to us.”

1957: After convincing reports from German prisoner-of-war witnesses the Soviet Union admits that Raoul Wallenberg has been held in the Soviet Union. He is now reported to have died from a heart attack on 17 July 1947.

1989: Raoul Wallenberg’s half-brother and half-sister are invited to Moscow, where the KGB hands over a wooden box containing, among other things, their brother’s diplomatic passport, address book and calendar from 1944.

2009: The archives of the Federal Security Service of the Russian Federation (FSB) releases a statement that a certain “prisoner number 7” interrogated on 22 and 23 July 1947, “very likely” was Raoul Wallenberg. In spite of this, the official Russian policy is still the same as in 1957 – that Raoul Wallenberg died from a heart attack on 17 July 1947.

□ LEXIME TË MËTEJSHME: INGRID CARLBERG: THERE IS A ROOM WAITING FOR YOU HERE, THE STORY OF RAOUL WALLENBERG [KA NJË DHOMË QË JU PRET KËTU. HISTORIA E RAOUL WALLENBERG], NORSTEDTS FÖRLAG, SUEDI, 2012

KONTRIBUT I INSTITUTIT PËR INFORMIMIN E KRIMEVE TË KOMUNIZMIT

ESTONIA



Estonia shpalli pavarësinë në shkurt të vitit 1918 pas rënies së Carit të Ruisë dhe arriti ta mbrojë atë me sukses gjatë luftës së zhvilluar mes viteve 1918-1920 kundër Ruisë Sovjetike.

PUSHTIMI KOMUNIST

Sipas protokollit sekret të Paktit Molotov-Ribbentrop të 23 gushtit 1939, Estonia u caktua në “sferën e ndikimit” Sovjetik dhe u pushtua nga Bashkimi Sovjetik në qershor 1940. Sovjetizimi i detyruar dhe arrestimet politike filluan menjëherë. Viti i parë sovjetik kulmoi me dëbimin masiv të rreth 10,000 burrave, grave dhe fëmijëve në qershor 1941. Më shumë se 30,000 burra estonezë u mobilizuan me Ushtrinë e Kuqe në verën e 1941 para se Gjermania të pushtonte Estoninë nga korriku deri në tetor 1941.

PUSHTIMI NAZIST

Nën pushtimin gjerman mbi 8,000 qytetarë e banorë estonezë, përfshirë 1,000 hebrenjë të mbetur në Estoni, u ekzekutuan nga nazistët dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas. Mbi 70,000 burra, pjesa më e madhe e tyre të mobilizuar shërbyen në njësi të ndryshme të forcave të armatosura gjermane, përfshirë divizionin SS estonez.

PUSHTIMI KOMUNIST

Ushtria e Kuqe e pushtoi vendin përsëri në vjeshtën e vitit 1944 dhe 20,000 estonezë të tjerë u mobilizuan përpara pranverës së 1945. Shtypjet sovjetike vazhduan nga viti 1944. Një dëbim masiv i 20,000 individëve u krye në mars 1949. Pas dëbimit, rezistenca aktive e armatosur e “vëllezërve pyjorë” u shua. Pas vdekjes së Stalinit, arrestimet politike u lehtësuan, por regjimi mbeti shtypës deri në fund të viteve 1980. Estonia e rifitoi pavarësinë e saj pas të ashtuquajturit “Singing Revolution”, në gusht 1991.

ENN SARV u lind në familjen e një mjeku më 1921. Ai ishte anëtar i rezistencës kombëtare estoneze gjatë pushtimeve sovjetike dhe naziste. Ai ishte një nga aktivistët e rinj që mbështeste politikanët që kërkonin një “rrugë të tretë” midis sovjetikëve dhe nazistëve. Ai u burgos nga të dy regjimet midis viteve 1944 dhe 1956 dhe u dërgua në Gulag. Pas lirit të tij ai arriti të mbaronte studimet akademike dhe të kishte sukses në jetën e tij profesionale. Pasi Estonia rifitoi pavarësinë e saj në verën 1991, ai u bë një lider opinioni me ndikim të lartë. Vdiq në mars 2008. Punët e tij të publikuara mbi vazhdimësinë ligjore estoneze citohen shpesh nga studiuesit.



KOLEKSIONI I FAMILJES
SARV

Enn Sarv

Të luftosh kundër dy totalitarizmave

shkruar nga Toomas Hiio

PREJARDHJA DHE RINIA NË PRAG TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Enn Sarv u lind në familjen e një mjeku. I ati Nikolai (1884-1950), i përkiste brezit të parë të estonezëve me diplomë universitare. Gjatë studimeve të tij në Universitetin e Tartu, përpara Luftës I Botërore, ai u bë anëtar i vëllazërisë më të vjetër studentore kombëtare estoneze, Shoqëria Studentore Estoneze. Pasi mori pjesë në Luftën I Botërore dhe në Luftën Estoneze për Pavarësi, ai shërbeu si mjek në qytetin e Tallinn-it më 1920-1940. Në vitin 1920 ai u martua me Elfriede Stalinski, e bija e një nënoficeri polak të ushtrisë cariste, i cili qëndroi në Tallinn pasi përfundoi shërbimin e tij. Enn ishte djali i tyre i parë.

Enn nga ana tjetër ishte një anëtar i gjeneratës së parë të estonezëve, i cili të gjithë programin mësimor e kishte kryer në estonisht (në vitet 1890, gjuha e mësimdhënies në gjimnaze² dhe në Universitetin e Tartu u ndryshua nga gjermanisht në rusisht. Universiteti i Tartu ka ekzistuar qysh para vitit 1919). Ai ishte diplomuar shkëlqyeshëm nga një prej shkollave të mesme më të mira në Estoni, me gjermanishte dhe frëngjishte të rrjedhshme; latinishtja dhe greqishtja ishin gjithashtu pjesë e programit mësimor. Në vitin e fundit shkollor ai mori pjesë në një konkurs të organizuar nga Legata Franceze në Tallinn dhe u shpërblye me një bursë shkollore dy-javore në Francë, në verën e vitit 1939. Udhëtimi në Europë në prag të Luftës I Botërore, veçanërisht kthimi i tij në Berlinin e pushtuar nga ethet dhe përgatitjet e luftës la mbresa të forta tek ai. Si një prej të diplomuarve më të mirë të shkollës së mesme në Estoni, një përfaqësues i Kishës Katolike në Estoni, duke e njohur atë nëpërmjet kontakteve të afërta me komunitetin e vogël katolik në Estoni, i ofroj një bursë shkollore në Vatikan. Enn e refuzoi ofertën. Ai ishte pagëzuar si besimtar luteran, por siç u shpreh më vonë, shqetësimi kryesor ishte kushti i beqarisë që kufizonte priftërinjtë katolikë. Kështu ai filloi studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tartu në vjeshtën e vitit 1939 dhe ashtu si i ati u anëtarësua në Shoqërinë Studentore Estoneze.

¹ Shkolla të mesme të krahasueshme me shkollat gramatikore britanike

Shumë studentë në Universitetin e Tartu ishin të pakënaqur me disa tipare të regjimit autoritar estonez, veçanërisht kufizimet në jetën publike, megjithëse më të lehta në krahasim me vendet autoritare të Europës Lindore. Shumë anëtarë të Shoqatës Studentore ishin mbështetës të fortë të Jaan Tõnisson (1868-1941, ekzekutuar nga sovjetikët), udhëheqës i opozitës demokratike dhe anëtar nderi i vëllazërisë. Enn Sarv gjithashtu u pajtua me pikëpamjet politike të Tõnisson, të cilat mund të përshkruhen si kombëtare dhe demokratike, deri në fund të jetës së tij. Studentët shprehën kundërshtimin e tyre kryesisht gjatë festimeve dhe ngjarjeve të tjera duke bërë skica që tallnin udhëheqësit politikë dhe figurat publike, përfshirë këtu edhe drejtuesit e universitetit. Ata diskutuan pareshtur çështjet dhe zgjedhjet politike të vendit të tyre, njësoj siç veprojnë edhe sot studentët e çdo vendi.

Lufta tashmë kishte filluar. Situata e Estonisë ishte e njëjtë me atë të shteteve të tjera të Europës Lindore që gjendeshin midis Gjermanisë dhe Bashkimit Sovjetik, kërcënuese, madje e pashpresë. Humbja e shpejtë e Polonisë në shtator ishte një tronditje. Në tetor 1939, Estonia nën kërcënimin e Bashkimit Sovjetik me sulm ushtarak, u detyrua të pranonte kërkesat e tij, dhe u nënshkrua një marrëveshje mossulmi. Bazat ushtarake Sovjetike u vendosën në Estoni së bashku me 25,000 ushtarë të Ushtrisë së Kuqe. Kur filloi Lufta e Dimrit² ndërmjet BS dhe Finlandës, Estonisë i duhej të qëndronte neutrale për shkak të marrëveshjes me sovjetikët, gjë e cila u quajt që atëherë e turpshme nga estonezët. Finlandezët ishin kombi më i afërt me estonezët; 20 vite më parë vullnetarët finlandezë erdhën të luftonin për pavarësinë e Estonisë. Për më tepër, neutraliteti estonez ishte shkelur rëndë nga sovjetikët – Forca Ajrore e tyre përdori fushat e aviacionit estonez për të bombarduar Finlandën.

PUSHTIMI I PARË SOVJETIK

Në qershor 1940, BS filloi pushtimin përfundimtar të vendeve balltike. Estonia, Letonia dhe Lituania u detyruan të pranojnë ultimatumet sovjetike me kërkesat për ndryshimin e qeverive. Ushtria e Kuqe pushtoi shtetet Baltike. Sovjetikët u përpoqën ta paraqisnin pushtimin si rezultat i zhvillimeve të brendshme, i ashtuquajtur “revolucionit socialist” sipas teorisë dogmatike marksiste-leniniste. Prandaj anëtarët e qeverisë së re, të piketuar nga përfaqësuesit sovjetikë, por të emëruar nga Presidenti Päts, ishin kryesisht figura publike të njohur për simpatitë e tyre të majta. Task forca e policisë sekrete sovjetike, e cila erdhi në Estoni bashkë me trupat sovjetike, filloi menjëherë arrestimet politike.

Tre javë pas pushtimit përfundimtar sovjetikët organizuan “zgjedhjet”, brenda të njëjtës fundjavë në Lituani, Letoni dhe Estoni. Sipas legjislacionit të vjetër, zgjedhjet në Estoni ishin planifikuar të vazhdonin në mënyrën sovjetike, me një kandidat të vetëm në secilin rreth elektoral dhe të gjithë kandidatët u zgjedhën nga

² Nëntor 1939 – Mars 1940

emisarët sovjetikë me ndihmën e bashkëpunëtorëve të tyre vendas. Lëvizja kombëtare estoneze u përpoq ta pengonte planin e sovjetikëve. Ata vendosën kandidatin e tyre në secilin rreth elektoral. Enn Sarv mori pjesë në gjetjen e kandidatëve që ishin të gatshëm të garonin kundër kandidatëve të sovjetikë. Ai mbajti kontakte me ta, si dhe përmbushi detyra të tjera praktike. Kjo ishte e rrezikshme – pasi policia sekrete sovjetike kontrollonte të gjithë shoqërinë dhe shumë aktivistë kombëtarë u arrestuan. Pak ditë para zgjedhjeve, emisari më i lartë sovjetik në Estoni, Andrei Zhdanov, anëtar i rrethit të ngushtë të Stalinit, urdhëroi anulimin e të gjithë kandidatëve kombëtarë; zgjedhjet u kryen sipas mënyrës sovjetike me rezultate të falsifikuara të më shumë se 90% të zërave mbështetës të kandidatëve sovjetikë. Më pas, pjesa më madhe e kandidatëve kombëtarë u arrestuan dhe u dërguan në *Gulag*. Sidoqoftë, fushata përfaqësoi aktin e parë të bashkimit kundër sovjetizimit duke përforcuar qarqet antisovjetike në Estoni, mbështetur gjerësisht nga populli.

Gjatë një viti të pushtimit sovjetik, sistemi shtetëror estonez u shkatërrua, prona private dhe pronësia e tokës u shfuqizuan, mijëra estonezë u arrestuan për arsye politike dhe mbi 10,000 estonezë - burra, gra e fëmijë u dëbuan në BS gjatë një dëbimi masiv në qershor 1941, i ngjashëm me dëbimet e kryera në Letoni dhe Lituani.

SISTEMI GULAG

Termi Gulag është një shkurtim në rusisht për Glavnoje upravleniye ispravityelno-trudovoykh lagerey i koloniy – Drejtoria Kryesore e Kampeve të Punës. Ishte emri i departamentit të Komisarariatit Popullor (d.m.th. Ministria) i Punëve të Brendshme të BS, përgjegjës për kampet e burgimit. Termi Gulag u bë sinonim i terrorit politik sovjetik dhe përsa i përket masave që u morën ishte në të njëjtin nivel me kampet gjermane të përqëndrimit. Shumica e kampeve të burgimit u ngritën në zona të largëta lindore e veriore të BS me qëllim që të shfrytëzonin profesionin e të burgosurve në kushte të rënda klimatike. Dënimet ishin të gjata – shpeshherë 10 vjet, dhe deri 25 vjet pas Luftës II Botërore. Shpesh rregullat e brendshme në kampe ishin në dorë të kriminelëve profesionist. Të burgosurit politikë dhe kriminelët, gjithashtu burrat e gratë u ndanë në kampe të ndryshme vetëm në fund të viteve 1940. Miliona të burgosur vdiqën në Gulag për shkak të dhunës, mungesës së trajtimit mjekësor e ushqimor, dhe punës së rëndë e të rrezikshme. Kampet e parë të Gulag u ndërtuan në 1918. Shumica e të burgosurve politikë që mbijetuan u liruan gjatë gjysmës së dytë të viteve 1950, pas vdekjes së Stalinit.

PUSHTIMI GJERMAN – BURGOSJA E PARË

Trupat Gjermane filluan të pushtonin Estoninë në korrik 1941. Estonezët, edhe pse historikisht anti-gjermanë (dhe këto ndjenja u përforcuan gjatë pushtimit gjerman të 1918), i mirëpritën si çlirimtarë njësitë Wehrmacht. Mendjet e njerëzve kishin ndryshuar shumë gjatë një viti nën shtypjen Sovjetike. Ata pak politikanë estonezë që i kishin mbijetuar regjimit shtypës sovjetik filluan menjëherë diskutime thelbësore



Enn Sarv me gruan e tij Karin dhe djalit e parë Laur në Vorkuta, 1954.
KOLEKSIONI I FAMILJES SARV

për të ardhmen e vendit. Nëpunësit publikë dhe politikanët e periudhës autoritare të Presidentit Päts, por edhe ish-radikalët e djathtë, përbënin fuqinë punëtore për të ashtuquajturin “vetë-administrim estonez” gjatë pushtimit gjerman. Shpresa fillestare e popullsisë se gjermanët do rikthenin pavarësinë estoneze, u shua shpejt. Anëtarët e ish-opozitës demokratike filluan të kërkonin një “rrugë të tretë” midis sovjetikëve dhe nazistëve. Karta e Atlantikut, e nënshkruar nga presidenti Franklin Roosevelt dhe kryeministri Winston Churchill në gusht 1941 që premtonte rivendosjen e lirisë për të gjithë vendet e pushtuara pas Luftës II Botërore, u bë gur themeli për shpresat e tyre.

Enn Sarv arriti ta shmangte mobilizimin në Ushtrinë e Kuqe para tërheqjes së sovjetikëve në 1941. Gjatë pushtimit gjerman ai vazhdoi studimet dhe punën njëkohësisht në redaksinë e një stacioni radioje me qendër në Tallinn. Ai ishte një prej aktivistëve të rinj që mbështetën politikanët e “rrugës së tretë”. Ata ndërmjetësuan informacione nga Estonia nëpërmjet Finlandës dhe Suedisë tek ish-përfaqësuesit

diplomatik estonezë, të cilët ishin pozicionuar jashtë vendit (në Suedi, Finlandë, dhe Britani e Madhe), të cilët nga ana e tyre përpiqeshin të shpërndanin informacion mbi Estoninë përmes diplomatëve të Aleatëve Perëndimorë. Ndër të tjera, Enn Sarv dhe miqtë e tij shpërndanë fletëpalosje dhe gazeta të fshehta dhe ndihmuan në arratisjen e rreth tre mijë burrave estonezë në Finlandë që të shmangin mobilizimin gjerman, i cili filloi në pranverën e vitit 1943. Këta burra i'u bashkuan ushtrisë finlandeze, ku formuan regjimentin estonez.

Në shkurt 1944 u krijua një Komitet Kombëtar i Republikës Estoneze, një organ ekzekutiv i fshehtë i shtetit Estonez me bord të zgjedhur. Komiteti Kombëtar arriti të mblidhte shumicën e politikanëve estonezë të mbijetuar, qëllimi i të cilëve ishte rivendosja e shtetësisë estoneze në fund të luftës dhe njohjen ndërkombëtare të saj. Enn Sarv ishte një prej aktivistëve të rinj të Komitetit Kombëtar, duke përbushur detyra komunikative dhe informative. Ai ishte gjithashtu autor i një numri buletinesh informative të fshehta rreth situatës në Estoni, të cilat i'u dërgoheshin fshehurazi përfaqësuesve estonezë në Finlandë e Suedi.

Shërbimi Gjerman i Sigurimit (SD) me bashkëpunëtorët estonezë kishte mbajtur nën vëzhgim për një kohë të gjatë aktivitetet e fshehta kombëtare estoneze. Në prill 1944 disa qindra njerëz, përfshirë Enn Sarv, të cilët ishin aktivë me lëvizjen kombëtare të fshehtë, u arrestuan nga SD. Sarv ishte nën hetim

deri në tërheqjen e gjermanëve nga Estonia në shtator 1944. Shumë gjëra absurde morën rëndësi nën regjimet totalitare. Fillimisht Enn Sarv nuk u hetua për shërbimet e tij nacionaliste, por për prejardhjen e hamendësuar hebreje, për shkak të nënës së tij polake me “pamje jo estoneze”, dhe gjenealogjia e tij e detajuar u përpilua nga SD. Gjatë ditëve të fundit të tërheqjes gjermane në shtator 1944, shumë të burgosur thjesht u liruan nga rojet estoneze të burgut, por disa prej tyre, përfshirë Enn Sarv u transferuan në kampet e përqëndrimit Stutthof në Poloni. Ai ia doli t’i mbijetonte kampit dhe marshimit vdekjeprurës të evakuimit nga kampi në dimrin e 1945, tashmë i infektuar me tifo, dhe përfundimisht u lirua nga Ushtria e Kuqe sovjetike së bashku me të burgosurit e tjerë, të cilët ishin lënë të vdisnin në kazermat e ndërtuara posaçërisht për të prekurit nga tifoja.

Situata e ish-të burgosurve të kampit të përqëndrimit, edhe pse të liruar nga sovjetikët, vazhdoi të ishte e rrezikshme. Ata u kontrolluan nga policia sekrete sovjetike, disa u arrestuan dhe disa u detyruan të riadhesoheshin në BS. Enn Sarv qëndroi afër me një ish-të burgosur të kampit rus të përqëndrimit dhe diku në Poloni, bashkë me këtë shok, Enn u anëtarësua si “një vullnetar i kalorësisë së Ushtrisë së Kuqe të marshal Rokossovsky”, siç rrëfeu më vonë me krenari ironike. Ai për shkak të tifos ishte shumë i dobët të kalëronte pa ndihmen e dikujt, por sidoqoftë e kreu shërbimin.

BURGOSJA E DYTË DHE VITET NË GULAG

Enn Sarv u çmobilizua nga Ushtria e Kuqe në tetor 1945; u rikthye në Estoni dhe vazhdoi studimet me ndërprerje në Universitetin e sovjetizuar të Tartu. Megjithatë, në janar 1946 ai u arrestua nga policia sekrete sovjetike për pjesëmarrjen e tij në opozitën kombëtare gjatë pushtimit Sovjetik në 1940-1941 dhe atij gjerman, u dënua për spiunazh me shtatë vjet në Gulag dhe këto vite i kaloi në kampin Vorkuta. Babai i tij me anëtarët e tjerë të familjes u dëbua nga vendet Baltike. Gjatë dëbimit masiv të marsit 1949; ai vdiq vitin pasardhës në internim në Siberinë lindore. Enn Sarv u lirua nga kampi në 1953, pas vdekjes së Stalinit, por nuk u lejua të kthehej në Estoni. Ai punoi për katër vjet si inxhinier miniere në Vorkuta me statusin e një të ashtuquajturit të internuar. E dashura e tij shkoi tek ai në Vorkuta në 1953, ku u martuan dhe në 1954 lindi djali i tyre i parë. Gjatë viteve 1955-1960 ai u pranua në Institutin Politeknik të Leningradit³ me statusin e të ashtuquajturit “student në distancë” i industrisë së minierave. Në 1957 u lirua nga internimi dhe u kthye në Estoni. Ai siguroi jetesën si përkthyes i pavarur (Rusisht, Gjermanisht, Frëngjisht); ndër të tjera, libri i Alexandr Solzhenitsyn “Një ditë në jetën e Ivan Denisovich”, ishte një ndër veprat që ai përktheu në estonisht së bashku me presidentin e mëvonshëm estonez Lennart Meri⁴.

³ Shën Petersburgu i sotëm

⁴ 1929 – 2006; ai u dëbua në Siberi me prindërit e tij në 1941 - 46

Gjatë 1961-1964 Enn Sarv studioi matematikë në Universitetin e Tartu dhe u diplomua me nderime. Sipas legjislacionit sovjetik, vetëm individët nën 35 vjeç mund të studionin me kohë të plotë; të tjerët kishin mundësinë të studionin si “student në distancë” nëse plotësonin kushtin e punës me kohë të plotë. Enn Sarv shkoi te rektori i universitetit dhe iu referua deklaratës së udhëheqësit sovjetik të bërë pas vdekjes së Stalinit që ish-të burgosurit nga burgu Gulag të drejtat civile të të cilëve ishin rivendosur, kishin të drejtë t’i riktheheshin profesionit që kishin përpara arrestimit. Enn Sarv ishte student në kohën që u arrestua dhe kërkoi të drejtën për vazhdimin e studimeve. Ai u lejua të studioje.

Ndonëse u rivendosën zyrtarisht të drejtat civile, të burgosurit politik e liruar kishin kaluar pengesa të shumta në jetën e tyre personale dhe profesionale. Vetë fakti që dikush ishte arrestuar ose dëbuar për arsye politike, bënte autoritetet të dyshonin jo vetëm për personin në fjalë, por edhe për fëmijët e tyre. Atyre u ishin ndaluar disa profesione dhe vende pune, u ishte ndaluar banimi në rajone të caktuara (në varësi të dënimit), përballëshin me probleme serioze kur donin të udhëtonin jashtë vendit, etj. Por BS tashmë ishte infektuar me urrejtje. Ligjet nuk u bënë kurrë më të ashpra se ç’ishin gjatë kohës së Stalinit. Ish-të burgosurit politikë kishin mundësi të bënin një jetë pak a shumë normale brenda kushteve dhe rregullave të “Perdes së Hekurt”.

Nga viti 1965 deri më 1988 Enn Sarv punoi si inxhinier informatik dhe shef departamenti në institucionet e Akademisë së Shkencave të RSSE⁵.

LIDER OPINIONI NË ESTONINË E LIRË

Që nga fillimi i lëvizjes për rifitimin e pavarësisë në 1987 e deri në vdekjen e tij Enn Sarv ishte anëtar aktiv i organizatave të ndryshme civile për ish-njerëzit e prekur nga regjimi shtypës (Bashkimi i ish të burgosurve politikë, Bashkimi i Forcave Kombëtare dhe Demokratike, etj). Ai ishte ndër përkthyesit e “Librit të Zi të Komunizmit” me autor Stéphane Courtois, të përkthyer në estonisht (botuar në vitin 2000). Deri kur vdiq, ai shkroi shumë artikuj, më së shumti për të drejtat e njerëzve të përndjekur dhe për temën e vazhdimësisë ligjore estoneze. Ai mori pjesë gjithashtu në hartimin e disa akteve ligjore për Republikën e Estonisë, një nga të cilat ishte edhe Personat e Shtypur nga Akti i Fuqive Pushtuese (2003).

Kërkimi dhe aprovimi i konceptit të vazhdimësisë ligjore estoneze ishte puna e fundit e jetës së tij. Shtetet e Bashkuara dhe shumë vende të tjera Perëndimore nuk e njohën kurrë drejtimin e vendeve Baltike nga BS. Më 23 korrik 1940 nënsekretari i SHBA Sumner Welles publikoi një deklaratë në të cilën Qeveria e SHBA dënoi “asgjësimin e pavarësisë politike dhe integritetit territorial” e të tre shteteve Baltike. Ishte fillimi i të ashtuquajturës politikë e mosnjohjes. Gjatë gjithë periudhës së pushtimit në 1940-

⁵ Republika Sovjetike Socialiste Estoneze

1991 Estonia kishte përfaqësimet e saj të jashtme dhe pasaportat, të lëshuara nga ata dhe të njohura nga vendet udhëheqëse perëndimore si dokumenta udhëtimi. U krijua një qeveri mërgimtare në Suedi pas Luftës II Botërore.

Në 1991 pavarësia estoneze u rivendos mbi parimin e vazhdimësisë ligjore. Mbi atë bazë, statuti i shtetit estonez nuk lindi si shkak i shpërbërjes së BS në 1991, por Estonia e sotme është një shtet identik me Republikën Estoneze të themeluar më 1918. Është e rëndësishme jo vetëm në kuptimin e teorisë ligjore, ligjit ndërkombëtar dhe identitetit kombëtar, por gjithashtu për disa arsye shumë praktike. Legjislacioni i politikës së nënshtetësisë dhe pronësisë së Estonisë bazohet mbi këtë koncept. Ishte shumë e nevojshme për të shmangur ndikimin e ndryshimeve të popullsisë (shkaktuar nga fluksi i qindra mijëra punëtorëve nga BS “i vjetër” që nga fundi i viteve 1940) në politikën estoneze. Vetëm individët që ishin qytetarë estonezë ose ata që kishin prindër estonezë mund ta rimerrnin ose fitonin automatikisht shtetësinë estoneze në qershor 1940; të gjithë të tjerët duhej të aplikonin për natyralizim. Nuk kishte asnjë pronë private në BS e aq më pak pronësi toke, prandaj reforma e pronësisë ishte e lehtë të kryhej në bazë të parimit të rikthimit të së drejtave të pronësisë të vitit 1940. Ndonëse kishte diskutime të nxehta mbi këto tema në vitet 1990, politikat u kryen me sukses.

Enn Sarv e përfundoi analizën e tij mbi vazhdimësinë ligjore estoneze në një studim të botuar në 1977. Titulli i tij mund të përkthehet në anglisht si “Askush nuk mund t’i rezistojë ligjit – objektivat estonezë dhe ligji ndërkombëtar”. Ai shkroi një artikull hyrës për botimin e dokumentave të Komitetit Kombëtar të Republikës së Estonisë dhe Qeverinë Estoneze në mërgim (2004). Korrespondenca e tij me Heinrich Mark, Kryeministri i fundit i Qeverisë estoneze në mërgim në vitet 1990-1992, u botua më 2012.

Enn Sarv vdiq në mars 2008. Ai u nderua me dekoratën më të lartë kombëtare të Estonisë “National Coat of Arms”. Veprat e tij mbi vazhdimësinë ligjore estoneze citohen shpesh nga studiuesit.

KONTRIBUT I INSTITUTIT ESTONEZ TË KUJTESËS HISTORIKE



Pritja nga Presidenti i Estonisë në Ditën e Pavarësisë, 24 shkurt 2008. Nga e majta në të djathtë: Epp Sarv, mbesa e Enn Sarv; Enn Sarv; Tomas Hendrik Ilves, Presidenti i Estonisë; Znj. Evelin Ilves, sekretari i Presidentit.

ZYRA E PRESIDENTIT TË ESTONISË

HEINZ DROSIHN ishte një burrë i SS dhe rojtar i kampit të përqëndrimit Ereda në Estoni. Kur mbërriti në kamp një transport grash çeke dhe gjermane ai ra në dashuri me një nga të burgosurat çeke, INGE SYLTENOVÁ.

Ajo ushtroi ndikim të pabesueshëm te ai, duke e detyruar atë të ndryshonte sjelljen e dikurshme çnjerëzore kundrejt të burgosurve dhe arriti të siguronte trajtim më të mirë për ata. Historia e tyre e dashurisë zgjati tre muaj. Në shkurt 1944, kur eprorët e tij e morën vesh për lidhjen, Heinz u zëvendësua nga një rojtar i ri dhe ai u zhduk. Inge u arratis tre ditë më vonë. Dy të arratisurit nuk mundën fatkeqësisht ta zbatonin planin e largimit së bashku nga Estonia në Skandinavi. Ata u kapën shpejt dhe u ekzekutuan në shkurt ose mars 1944, edhe pse disa thonë që ata kryen vetëvrasje së bashku.



ARKIVI I
LUKÁŠ PŘIBYL



ARKIVI I
LUKÁŠ PŘIBYL

Inge Syltenová dhe Heinz Drosihn

Një histori dashurie

shkruar nga Meelis Maripuu dhe Lukáš Přibyl

ESTONIA NË KTHETRA TË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Në prag të Luftës II Botërore, Estonia ishte në sferën e ndikimit të menjëhershëm të dy prej fuqive më të mëdha të Europës, BS dhe Gjermanisë. Sidoqoftë, protokollin sekret i paktit Molotov-Ribbentrop i nënshkruar më 23 gusht 1939 e la Estoninë përfundimisht në sferën e ndikimit të BS. Duke përdorur lidhjen e tij me Gjermaninë si një aleate faktike në fazën e parë të luftës, BS pushtoi Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë në qershor 1940 duke i kërcënuar këto vende me luftë në të njëjtën kohë kur vëmendja e botës ishte fokusuar në fushatën e Hitlerit në Francë. Në 22 qershor 1941 filloi një fazë e re e Luftës II Botërore kur shpërtheu lufta midis Gjermanisë dhe BS. Forcat gjermane përparuan drejt lindjes sipas planit të Operacionit Barbarossa dhe ndër të tjera, rrethuan territoret e vendeve Baltike. Forcat gjermane pushtuan territorin estonez në korrik 1941 dhe arritën ta zotëronin të gjithë Estoninë në tre javë e gjysmë.

Terrori sovjetik që kishte sunduar në Estoni për një vit dhe që kishte çuar në vdekjen e mijërave njerëzve u zëvendësua menjëherë nga terrori i regjimit nacional-socialist. Nënndësuesit gjermane *Einsatzgruppe* përparuan në prapavijë pas linjës së frontit që të zgjidhnin problemet

PAKTI MOLOTOV – RIBBENTROP (PAKTI HITLER – STALIN)

Ky Traktat jo-sulmi midis Gjermanisë dhe Bashkimit Sovjetik, i nënshkruar më 23 gusht 1939 nga ministri dhe punëve të jashtme Joachim von Ribbentrop dhe Vyacheslav Molotov, ishte një parakusht për fillimin e Luftës II Botërore nga Gjermania Naziste. Pakti siguroi mospërfshirjen në luftë të BS në Europë.

Traktati përmbante një protokoll të fshehtë, i cili ndau rajonet e Europës Lindore në “sfera ndikimi”. Sipas protokollit dhe ndryshimeve të mëvonshme të tij BS pranoi interesin e Gjermanisë për pjesën perëndimore të Polonisë dhe Gjermania pranoi interesin e sovjetikëve për pjesën lindore të Polonisë, Finlandës, Estonisë, Letonisë, Lituanisë dhe Bessarabia-s Rumune.

Lufta shpërtheu në shtator 1939. Polonia u nda sipas protokollit. Në Luftën e Dimrit 1939-1940 BS dështoi në mposhtjen e Finlandës. Në verën e 1940 shtetet Baltike dhe Bessarabia u pushtuan nga BS. Ndryshimet territoriale në Europën Lindore (përveç Finlandës), të parashikuara nga protokollin i fshehtë, mbetën në fuqi deri në shpërbërjen e BS, i cili e bëri të ditur ekzistencën e protokollit sekret vetëm më 1989.

me armiqtë politikë e racistë të regjimit. *Sonderkommando* 1a mbërriti në Estoni me lista të përgatitura paraprakisht për individët që do arrestoheshin: mes tyre ishin drejtues politikë të Republikës së Estonisë, po ashtu dhe figura kryesore nga periudha e pushtimit sovjetik. Në pjesën më të madhe ishte tepër vonë t'i gjeje ata njerëz sepse regjimi sovjetik tashmë i kishte arrestuar figurat kryesore të Republikës së Estonisë dhe i kishte dërguar ata drejt lindjes, ndërkohë vetë figurat komuniste, shumica ishin larguar në BS me Ushtrinë e Kuqe.

REPRESIONET E AUTORITETEVE GJERMANE

Shtypjet në masë të gjerë të koordinuara nga Policia e Sigurimit Gjerman (SiPo) dhe Shërbimi i Sigurimit (SD) sidoqoftë filluan në Estoni. Afërsisht 19,000 njerëz u arrestuan në Estoni gjatë vitit të parë të pushtimit Gjerman. Rreth 7,500 e atyre njerëzve të arrestuar u liruan brenda atij viti, rreth 5,500 u dërguan

në kampe përqendrimi, dhe mbi 5,500 u ekzekutuan, përfshirë afërsisht 1,000 hebrenjtë e mbetur estonezë. Estonia u shpall vendi i parë dhe i vetëm pa hebrenj në janar të 1942 në Konferencën famëkeqe të Wannsee (Berlin). Tre të katërtat e rreth 4,000 hebrenjve estonezë qenë larguar drejt BS para mbërritjes së linjës së frontit. Vetëm pak nga ata që mbetën pas arritën të fshiheshin. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së pushtimit gjerman 1941-1944, Policia e Sigurimit Gjerman arrestoi dhe ndaloi 21,000 deri në 25,000 njerëz për kohë të shkurtër apo të gjatë, prej të cilëve 8,000 u ekzekutuan.

Të arrestuarit ishin kryesisht banorë vendas, të cilët ishin akuzuar për politikë dhe vepra të tjera penale (aktivitete të dëmshme për ekonominë e kohës së luftës, spekulim ose aktivitete të ngjashme me të, dhe më pak për vepra kriminale). Një total prej 17 institucionesh burgu dhe kampe të përkohshme përqendrimi, personeli i të cilëve ishte nga radhët e popullit estonez, u punësuan në varësi të policisë që të mbanin të burgosur personat

e arrestuar. Riorganizimi u krye në verën e 1942 kur katër qendra ndalimi u emëruan kampe pune dhe riedukimi (Arbeits- und Erziehungslager); pjesa e mbetur ishin qendrat e ndalimit policor (Polizeiliche Haftanstalt). Në pjesën më të madhe banorët vendas e vuanin dënimin e tyre në qendrat lokale të ndalimit.

KONFERENCA E WANNSEE

Konferenca e WANNSEE ishte një takim fshehtë i 15 zyrtarëve të lartë të Rajhut të Tretë të Sigurisë Shtetërore, Inteligjencës, Qeverisë, Partisë Naziste dhe Territoreve të pushtuara me qëllim vendosjen e "zgjidhjes përfundimtare të çështjes hebreje". Konferenca u mbajt në WANNSEE, pranë Berlinit dhe u drejtua nga Reinhard Heydrich, Shef i Zyrës Qëndrore të Sigurimit të Rajhut dhe njëkohësisht Zv/Mbrojtës i rajoneve Bohemia dhe Moravia, dhe sipas sekretarit të regjistrimit, Adolf Eichmann, një nga organizuesit kryesorë të Holokaustit. Në takim u diskutuan aspekte të ndryshme të politikës ndaj hebrenjve, por edhe metodat dhe format e "zgjidhjes përfundimtare të çështjes hebreje në Europë". Minutat e takimit u gjetën më 1947 dhe u publikuan si provë e planit të asgjësimit të hebrenjve nga nazistët.

KUTI NJOFTIMI

Të burgosurit nuk u dërguan masivisht në kampet e përqendrimit në Gjermani para pranverës së 1944, kur u shfaq sërish rreziku i pushtimit të Estonisë nga Ushtria e Kuqe. Ajo çfarë është përshkruar më lart, sidoqoftë përbën thjesht një kapitull të politikës represive që autoritetet pushtuese gjermane organizuan në territorin estonez dhe ishte kryesisht e kufizuar vitin e parë të pushtimit gjerman.

HEBRENJTË NGA VENDET E HUAJA NË ESTONI

Hebrenjtë e sjellë nga vendet e huaja në Estoni përbëjnë një kapitull të veçantë. Tre regjimente hebrejsh u dërguan tek SiPo dhe SD gjermane në Estoni si punëtorë një-përdorimësh. Rreth njëmijë hebrejsh çekë nga getoja në Theresienstadt ishin të parët që erdhën në fillim të shtatorit 1942, dhe në fund të po atij muaji erdhi regjimenti i dytë, i përbërë prej rreth njëmijë hebrejsh nga Frankfurti dhe Berlioni. Rreth 400 deri në 500 të rinj u zgjodhën nga prurjet te stacioni hekurudhor dhe u dërguan në kampin Jägala në Estoninë Veriore. Pjesa e mbetur, një total prej rreth 1,600 njerëz u ekzekutuan ditën e mbërritjes në zonën e artilierisë ushtarake Kalevi – Liiva afër kampit. Nga rreth 2,000 hebrejsh që u sollën në Estoni në shtator 1942, thuhet se 74 njerëz i mbijetuan luftës.

Deri në qershor të 1944 kur gjermanët u përballën me kërcënimin e dëbimit nga Estonia, rreth 300 hebrejsh francezë përfunduan atje. Ata ishin pjesë e të ashtuquajturit “Karvani Nr. 73” i cili ishte dërguar për ekzekutim nga kampi i përqendrimit Dancy në Paris drejt lindjes. Shumica e grupeve nga Dancy u dërguan në territore të Polonisë, megjithatë një pjesë e vogël e një transporti nisur drejt Lituanisë mbërriti në Estoni. Disa prej të burgosurve kishin vdekur rrugës nga etja dhe nxehtësia. Gjatë dy-tre muajve në vazhdim u kryen përzgjedhje periodike ndërmjet të burgosurve, të cilët arrinin në Tallinn ku personat e dobët ekzekutoheshin. Në shtator 1944 kur burgjet dhe kampet u boshatisën ndërsa fronti afrohej, 34 hebrejsh francezë që ishin ende gjallë arritën në kampin Stutthof nga Estonia.

Në Estoni nuk u ndërjuan kampe të vdekjes masive siç u bë në territorin polak, por prapë nuk kishte shpëtim nga kampet e punës së detyruar. Dështimi ushtarak i Gjermanisë në Frontin Lindor i lënë pa naftën kaukaziane për të cilën kishin shpresuar, si dhe mungesa gjithnjë e në rritje e benzinës dhe naftës e bëri industrinë kimike minerare të naftës së Estonisë ndërmarrjen më të rëndësishme ekonomike të luftës në vendet Baltike. Në mënyrë që të përmbushte nevojat e fuqisë punëtore të industrisë minerare të naftës, kampi i përqendrimit Vaivara u vendos në Estoni në verën e vitit 1943 nën urdhërat e SS-Reichsführer Heinrich Himmler së bashku me një rrjet prej 20 kampesh fushore në varësi të kampit Vaivara. Rrjeti Vaivara mbeti i vetmi kamp në Estoni, i cili ishte nën juridiksionin e Departamentit Kryesor Ekonomik dhe Administrativ të SS (SS Wirtschafts-Verwaltungshauptamt).

Administrata e kampeve përbëhej nga udhëheqës SS të dërguar në Estoni, të kryesuar nga komandanti i kampit SS-Hauptsturmführer Hans Aumeier, i cili kishte shërbyer në kampe përqendrimi që prej 1939.

Ai mbërriti në Estoni nga Auschwitz, ku kishte qenë komandant i kampit parandalues të burgimit. Pasi u largua nga Estonia vazhdoi shërbimin e tij në Norvegji. Aumeier u var në burgun Montelupich në Krakow në 1948 bashkë me 20 kriminelë të tjerë lufte që kishin shërbyer në kampin e përqendrimit në Auschwitz. Nënjesitë e batalionit policor të përbërë nga estonezët, rusët dhe gjermanët në shërbim të “organizatës së vdekjes” u përdorën si roje kampi. Fuqia punëtore e përbërë nga hebrenjë u soll në kampin e ri kryesisht nga getot e vendosura në Lituani dhe Letoni, gjithsej rreth 10,000 gjatë një viti që funksionoi kampi. Ky ishte pikë së pari një kamp i punës së detyruar dhe të burgosurit që bëheshin të paaftë për punë dërgoheshin jashtë Estonisë me pretekstin e “rimëkëmbjes”, si dhe në Auschwitz, ku me shumë mundësi ekzekutoheshin.

Situata ndryshoi në fund të verës së 1944 kur gjermanët përballë sulmit të Ushtrisë së Kuqe nuk mundën të boshatisnin të gjithë burgun. Gjermanët filluan t’i ekzekutonin në vend të burgosurit. Shembulli më i njohur i një veprimi të tillë është ekzekutimi i afro 2,000 hebrenjve në 19 shtator 1944 në kampin Klooga, i cili ishte kampi i fundit aktiv i asaj kohe.

Afërsisht 12,500 hebrenj u sollën në Estoni nga vendet e huaja gjatë viteve të pushtimit gjerman. Rreth 7,500 deri 7,800 prej tyre ose u zhdukën ose u ekzekutuan në Estoni. Afërsisht 4,600 të burgosur u morën përsëri nga Estonia në kampe të tjera drejt fundit të luftës. Rreth 100 hebrenj kishin mbijetuar në Estoni kur forcat gjermane u tërhoqën.

DEGJENERIMI I HUMANIZMIT⁶

Inge Syltenová ishte një grua e re çeko-hebreje, të cilën autoritetet gjermane e dëbuan në Estoni në shtator 1942 bashkë me rreth njëmijë të tjerë fatkeqë nga geto në Theresienstadt. Ata mbërritën në Estoni me ndjenja të trazuara dhe të paqarta për atë që i priste. Ata besuan se ishin sjellë në Estoni për të punuar, edhe kur te moshuarit dhe familjet me fëmijë të vegjël u ndanë nga të rinjtë dhe u dërguan me autobus – gjoja në një kamp me kushte më të mira jetese, para së të vinte vjeshta. Realisht, qëndrimi i tyre i përkohshëm mori fund pak kilometra larg në dunat e rërës në zonën e aritlierisë Kalevi – Liiva. Inge dhe dyqind shoqet e saj u vendosën në kampin Jägala, ku qëndruan disa muaj në mëshirën e oficerëve policorë të punësuar nga rradhët e popullit estonez. Ata refuzonin të besonin për fatin e shokëve të tyre të ekzekutuar edhe pse banorët vendas iu treguan se kishin parë trupat e viktimave.

Mbërritja në kamp pasi lanë geton ishte hapi tjetër drejt vorbullës degjeneruese të rrethanave të jetës së tyre. Situata ishte kontradiktore. Prapë ia dolën të mbanin një pjesë të dinjitetit të tyre njerëzor.

⁶ Historia është bazuar në artikullin e Lukáš Přibyl të titulluar “Die Geschichte des Theresienstädter Transports 'Be' nach Estland”, botuar në Studimet dhe Dokumentet Terezín (8/2001). Një dokumentar i titulluar “Transportet e harruara në Estoni” u prodhua nga i njëjti autor me këtë temë në 2009. Shiko www.forgottentransports.com.

U lejuan të vishnin rrobat e tyre, ngarkesa e punës ishte e lehtë (kryesisht duke seleksionuar rrobat dhe sendet personale të të burgosurve të ekzekutuar), dhe për shkak të mbikqyrjes së dobët ata gjithashtu linin kampin herë pas here për të mbledhurar manaferra e gjera të tilla ne pyll dhe për të siguruar ushqim shtesë nga estonezët që jetonin aty afër. Prapë shumë gjëra vareshin nga tekat e rojeve dhe kryesisht nga administrata e kampit. Komandanti i kampit Aleksandër Laak ekzekutonte sipas tekave të tij të burgosurit e sëmurë dhe ata që nuk bashkëpunonin, përfshirë të burgosurat të detyruar me forcë të qenë dashnoret e tij.

Më pas, Inge dhe shoqet e saj të mbijetuara u dërguan në burgun qëndror të Tallinn. Jeta e mbyllur në qelitë me lagështirë të burgut, puna e rëndë fizike në fushat e ndërtimit në qytet dhe në port ishte një hap tjetër në rrugën e degjenerimit të kushteve të tyre. Sidoqoftë, grave ende iu la në një farë mase mundësia të kujdeseshin për higjienën e tyre personale nëpër qeli, të përdornin veshje gjumi dhe të shkonin në punë veshur me rrobat e tyre pa pasur nevojë madje të mbanin Yllin e verdhë të Davidit. Ishte edhe më e lehtë të kontaktoje me njerëzit jashtë sistemit të burgut kur punoje në Tallinn: Estonezë, gjermanë dhe marinarë hollandezë, të cilët pavarësisht rrethanave përpiqeshin të sillnin lehtësim në kushtet e përditshme të jetesës së të burgosurve. Në pamje të parë, duket krejt e pabesueshme që duke injoruar rregullat për punëtorët meshkuj vendas, disa nga zonjat e reja ia dilnin të largoheshin nga vendet ku punonin për në qytet nën shoqërimin e rojeve, për të vizituar apo drekuar me të njohurit e tyre të rinj, madje dhe për të shkuar në floktore.

Në mes të tetorit të vitit 1943, ato gra hebreje çeke dhe gjermane të kampit Jägala që ishin akoma gjallë u dërguan më tej në kampin e punës së detyruar të Vaivaras në Estoninë Verilindore nën komandën e SS. Kjo ishte padyshim një tronditje e vërtetë si për moralin ashtu dhe për fizikun e grave që kishin provuar tashmë jetën në geto dhe në kampe. Ishte i pari kamp i vërtetë përqendrimi. Kushtet e jetesës dhe të punës u bënë jashtëzakonisht më të ashpra krahasuar me përvojat e mëparshme. Gratë e reja duhej të kryenin çdo ditë punë të rënda fizike në dëborë dhe në të ftohtin e acartë, të detyruar nga rojet SS. Nuk kishte mundësi për të siguruar ushqim jashtë kampit sepse furnizimi ishte i pakët. Ajo zonë industriale ishte plot



Gratë hebreje nga transporti duke kryer punë të detyruar në portin e Tallinn.

ARKIVA I LUKÁS PRIBYL

me hebrej dhe robër lufte, të cilët ishin të gjithë të dënuar të punonin me detyrim, dhe po të gjithë qenë gati të shfrytëzonin edhe shansin më të vogël për të siguruar ushqim.

Gratë hebreje çeke dhe gjermane megjithatë dallonin qartazi nga shumica e hebrejve, kryesisht nga ata me origjinë polake, lituaneze dhe letoneze. Ato u bënë një dhe u përpoqën ta mbështesnin njëra – tjetrën në çdo mënyrë të mundshme. Ato ishin akoma në gjendje relativisht të mirë fizike, përpiqeshin të kujdeseshin për pastërtinë dhe akoma vishnin rrobat e tyre personale të pastra dhe të denja. Kishte shumë të ngjarë që vinin nga grupe shoqërore të klasës së lartë dhe meqë dinin gjermanisht, mund të komunikonin lirshëm me stafin e kampit. Kjo krijoi një situatë ku gjermanët që punonin në fabrikë, ndonjëherë edhe disa nga stafi i kampit i konsideronin ato si të barabarta me ta dhe rrallë si hebrej “inferiorë”, gjë e cila reflektohej në sjelljet dhe komunikimin e tyre me të burgosurit.

ËNGJËLLI MBROJTËS

Inge Syltenová ishte vendosur në Ereda, një degë e kampit Vaivara, bashkë me gra të tjera hebreje çeke dhe gjermane. Këtu, marrëdhëniet njerëzore brenda kampit u zhvilluan në një mënyrë krejtësisht të paparashikuar. E burgosura tepër e re, Inge Syltenová, ra në sy të përgjegjësit SS të kampit Ereda, *Unterscharführer*⁷ Heinz Drosihn kur të internuarit e rinj arritën në stacionin hekurudhor. Që nga ai moment, jetët e tyre morën një rrjedhë tërësisht të re, edhe pse as ata vetë nuk e kuptuan menjëherë. Deri atëherë,



Inge me vëllain e saj Peer, nënën Melanie dhe motrën Ruth, 1939.

ARKIVA E LUKÁŠ PŘIBYL

rojtari i kampit Drohsin nuk kishte rënë në sy për ndonjë sjellje të mirë ndaj të burgosurve të kampit. Ai kishte qenë një “SS i zakonshëm çnjerëzor”. Inge ishte sëmurë kur arriti në kampin e ri dhe fillimisht u vendos në korridorin e të sëmurëve. Rojtari i kampit e vizitoi atë menjëherë, duke shprehur shqetësimin e tij nëse zonjusha e re ishte ftohur.

Është e pamundur për ne të dimë sot se çfarë mendoi fillimisht Inge për atë përkujdesje të ngrohtë nga ana e Drosihn. Mbase i sillte ndërmend kohën kur kaloi në kampin Jägala, kur përgjegjësi i kampit Aleksander Laak përzgjidhte për vete “dashnoret” mes të burgosurave, të cilat

⁷ “Unterscharführer”, grada më e ulët e nënificerit në shërbimin e SS nazist, i cili ishte organ represiv i Partisë Punëtore Nationalsocialiste Gjermane (NSDAP) [shënim i përkthyeses].

më vonë i ekzekutonte. Gjithsesi, Inge vendosi t'i përdorte interesat e përgjegjës të kampit ndaj saj për të përkrahur interesat e përbashkëta të të burgosurve. Zonjusha e re iu përgjigj se nuk kishte më shumë ftohtë se pjesa tjetër e të burgosurve dhe nuk do të pranonte t'i ofronin batanije derisa t'u jepej dhe të tjerëve batanije. Ajo u soll në të njëjtën mënyrë për sa i përket ushqimit, por ky ishte vetëm fillimi. Marrëdhënia e veçantë midis Inges dhe përgjegjës të kampit dihej që në fillim nga pjesa më e madhe e kampit dhe shumë shpejt u bë akoma dhe më e pabesueshme. Inge u transferua në zonën e kampit ku qëndronte përgjegjësi dhe zyrtarisht u bë kuzhinierja e tij personale, megjithëse detyrat e gatimit i përmbushte një tjetër i burgosur.

Fakti që një e burgosur femër e përdorte interesin e rojtarit të kampit ndaj saj, për kushte më të mira jetese ose trajtim të privilegjuar për veten dhe shoqet e saj, nuk është ndonjë gjë e jashtëzakonshme. Inge, megjithatë pati një ndikim të pashembullt tek Drosihn, duke e demonstruar këtë publikisht. Inge u bë menjëherë ëngjëlli mbrojtës për të gjithë kampin, duke ndërhyrë në situata që dukeshin të pabesueshme në atë kohë në jetën e zakonshme të kampit. Për shembull, ajo i rrëmbeu haptazi kamzhikun nga dora përgjegjës të kampit kur ai donte të ndëshkonte një të burgosur me të dhe e ndaloi që të sillej ashtu në të ardhmen. Përgjegjësi i kampit, i cili më parë e kishte përdorur kamzhikun pa hezitim për të ndëshkuar të burgosurit, vërtet zbatoi urdhërin e saj. Një herë të burgosurit që po ktheheshin nga një vend pune larg kampit i kapi një stuhi dëbore dhe disa prej tyre nuk ishin në gjëndje të ktheheshin në kamp me forcat e tyre. Inge i shpëtoi jetët e tyre (të paktën atë herë) duke këmbëngulur që përgjegjësi i kampit të dërgonte slita të tërhequra nga kuajtë për të marrë të burgosurit e mbetur në rrugë.

ARRATISJA DHE KAPJA

Shumë shpejt u bë e qartë nga të pranishmit se lidhja midis Inge dhe Drosihn ishte diçka më tepër sesa shfrytëzimi i një të burgosure nga përgjegjësi i kampit sipas tekave të tij. Kuzhinieri i përgjegjës të kampit dëshmoi se si dy javë pas njohjes së tyre, Drosihn i kishte grisur spaletat nga uniforma dhe tha që nuk donte të ishte më pjesë e SS. Në realitet, ai natyrisht që vazhdoi të zbatonte detyrat zyrtare në mënyrë të rregullt, duke bërë një jetë të dyfishtë të pazakontë që ra në sy të zyrtarëve të tjerë gjermanë, punonjësve të *Organizatës Todt* që kishin kontakt me kampin, por edhe të tjerëve gjithashtu. Është e habitshme që kjo jetë relativisht e dyfishtë mundi të zgjaste rreth tre muaj para se të ndërhynte drejtuesi i kampit Vaivara. Erich Scharfetter, i cili njihej nga të burgosurit si një sadist i tmerrshëm, u emërua përgjegjësi i ri i përkohshmën i kampit Ereda. Drejtori me përgjegjësin e ri të kampit erdhën për kontroll në shkurt 1944, në bazë të denoncimit të dikujt, me sa dukej. Drosihn nuk ishte në kamp atë moment. Inge, e cila nuk kishte vajtur në punë me të burgosurit e tjerë, u gjet në kushte jetese krejtësisht luksoze për një të burgosur. Ajo u rrah dhe u mor në pyetje. Pak më vonë, në kamp u shfaq Drosihn, i cili me të kuptuar situatën, u largua menjëherë pa thënë asnjë fjalë. Kur përgjegjësi i ri i kampit pyeti të burgosurit për Drosihn ata mohuan

ta kishin parë atë dhe ai nuk u pa më kurrë. Tre ditë më vonë, u zhduk edhe Inge. Atë e kishte ndihmuar Gisela Danzigerová, shoqe e saj prej kohesh, e cila kishte shërbyer si kuzhinierë e Drosihn. Ajo dhe një e burgosur tjetër e re kishin gërmuar një tunel poshtë gardhit me tela që rrethonte kampin dhe Inge u arratis përmes tij.

Vijuan hetimet e të burgosurve të tjerë në kamp. Ata e dinin që Inge dhe Drosihn ishin arratisur së bashku, por prapë nuk e dinin ku fshiheshin të arratisurit. Sipas kuzhinieres Gizela Danzigerová, e cila kishte parë bashkëjetesën e çiftit të pazakonshëm më afër se kushdo tjetër, dy të rinjtë duheshin dhe gjatë jetesës në kamp ata e kishin harruar komplet se ku ndodheshin. Plani që ata kishin hartuar për t'u larguar nga Estonia drejt Skandinavisë nuk ishte aq bindës në atë moment, por jo krejtësisht i perealizueshëm sepse varkat lundronin fshehtas drejt Finlandës dhe Suedisë gjatë sezonit të transportit. Nevojiteshin lidhje të besueshme me banorët vendas bregdetarë që të gjenin dikë që t'i kalonte përtej. Disa gjermanë kishin gjetur mundësi të tilla. Sidoqoftë nën kushtet e dimrit, Gjiri i ngrirë i Finlandës, i gjerë 80 kilometra, duhej të kalohej në këmbë ose me ski. Pak veta ndër banorët vendas kishin arritur të arratiseshin në këtë mënyrë, asnjë nga personazhet e historisë sonë nuk ishte gati për këtë. Ata duhet t'ia dilnin të fshiheshin dhe pastaj në pranverë pasi të shkrinte akulli në det të shihnin mundësinë për t'u larguar.

Të arratisurit u kapën relativisht shpejt edhe pse rrethanat e sakta të kapjes së tyre nuk dihen. Ka të ngjarë që çifti i dashuruar të ketë kryer vetëvrasje në çastin e fundit, megjithëse ka të dhëna se ata u qëlluan menjëherë sa u kapën. Burrat SS i varrosën kufomat pranë njëri-tjetrit diku në pyll dhe vendndodhja e saktë nuk dihet, por historia e tyre po.

Kjo histori, në pamje të parë e pabesueshme, është sjellë tek ne kryesisht nga kujtimet e gjalla të shoqeve të saj të burgut. Vetëmohimi i një burri SS, rikthimi i tij te vlerat njerëzore dhe shikimi i atyre vlerave tek të burgosurit që qëndronin para tij, nuk munden të ndryshojnë tërë sistemin sigurisht. Ky ishte thjesht një pushim i shkurtër, ndërsa shoqet e Inges vazhduan të përjetonin degjenerimit e kushteve të tyre. Situata e të mbijetuarve u bë akoma dhe më e keqe në verën e vitit 1944 pas evakuimit të tyre nga Estonia në kampin e përqendrimit Stutthof, megjithatë ata kishin përjetuar forcën që u kishte dhënë ndjesia e të pasurit dikë afër dhe ndihma e përbashkët. Ndoshta Inge fillimisht e pa lidhjen me Heinz thjesht si një mundësi për të përmirësuar situatën e saj dhe të shoqeve të saj në kamp, megjithatë nga lidhja e tyre lindi një dashuri padyshim e përbashkët. U bë provë e gjallë për këdo rreth tyre se mbi të gjitha të dy palët si burrat SS, ashtu dhe hebrenjtë, janë qenie njerëzore me fuqitë dhe dobësitë e tyre, dhe se jeta nuk është kurrë bardhezi.

KONTRIBUT I INSTITUTIT ESTONEZ TË KUJTESËS HISTORIKE

LETONIA



Letonia shpalli Pavarësinë në nëntor 1918. Letonia luftoi për pavarësinë e saj kundër Ruisë Sovjetike dhe njërive vullnetare gjermane në vitet 1918-1920.

PUSHTIMI KOMUNIST

Sipas protokollit sekret të paktit Molotov-Ribbentrop më 23 gusht 1939, Letonia u caktua në "sferën e ndikimit" Sovjetik dhe u pushtua nga Bashkimi Sovjetik në qershor 1940. Sovjetizimi i detyrueshëm së bashku me arrestimet politike filluan menjëherë; në qershor 1941 më shumë se 15,000 individë u dëbuan.

PUSHTIMI NAZIST

Wehrmacht pushtoi Letoninë në qershor dhe korrik 1941. Riga, kryeqyteti Letonez u bë një qendër e Reichskommissariat (komisariat i Rajhut) Lindor, i cili përfshinte Letoninë, Estoninë, Lituaninë dhe Bjellorusinë. Dhjetëra mijëra qytetarë dhe banorë letonezë, duke përfshirë më shumë se 60,000 hebrenj letonezë u ekzekutuan nga nazistët dhe bashkëpunëtorët e tyre lokalë, gjatë pushtimit gjerman. Më shumë se 100,000 burra, shumica e tyre të mobilizuar (ushtarakë), shërbyen në njësi të ndryshme gjermane, duke përfshirë dy divizione SS Letoneze.

PUSHTIMI KOMUNIST

Letonia u ripushtua nga Sovjetikët në verën e vitit 1944. Sovjetikët filluan menjëherë shtypjet politike, të cilat arritën kulmin me dëbimin masiv të më shumë se 40,000 individëve në mars 1949. Pas dëbimit, u shua rezistenca aktive e armatosur e "vëllezërve pyjorë". Arrestimet politike u lehtësuan pas vdekjes së Stalinit, por regjimi mbeti shtypës deri në fund të viteve 1980. Fronti popullor letonez pro-pavarësisë fitoi zgjedhjet më 1990 dhe Letonia rifitoi pavarësinë në gusht 1991.

EDWARD ANDERS (fillimisht Eduards Alperovičs) lindi në Liepāja, Letoni, në vitin 1926, në një familje hebreje. Babai i tij Adolfs punonte si eksportues drithërash. Eduard dhe nëna e tij Erika i mbijetuan Holokaustit duke pretenduar

në mënyrë të rreme se ajo ishte me prejardhje ariane e gjetur dhe e rritur nga prindër hebrej, ndërsa babai i tij, vëllai dhe shumë të afërm të tjerë u vranë. Edward dhe Erika arritën ta ruanin këtë bluf për dy vjet, duke qendruar në një gjendje gjysëm ligjore dhe duke patur vazhdimisht frikë se mos zbuloheshin.

Kur Ushtria e Kuqe hyri përsëri në Letoni

më 1944, Edward dhe nëna e tij u larguan për në Gjermani dhe më pas emigruan në SH.B.A. në vitin 1949.

Edward aty do të bëhej profesor kimie dhe specialist i mirënjohur në fushën e kimisë meteorite. Tani është në pension dhe jeton në Kaliforni.



EDWARD ANDERS

Edward Anders

Të shmangësh Holokaustin

shkruar nga Edward Anders (i njohur më parë si Eduards Alperovičs)
teksti italik nga Valters Nollendorfs

“Geht”, u tha polici gjerman 15-vjeçarit Eduards dhe vëllait të tij më të madh Georgs që qëndronin në oborrin e mbushur të burgut, “ikni”. Kjo fjalë i shpëtoi ata nga i njëjti fat me të 2,749 hebrenjve nga qyteti port i Letonisë, Liepāja, të cilët u vranë nga xhelatët nazistë në ditët në vijim. Babai i tyre, Adolfs Alperovičs, ishte ekzekutuar disa ditë më parë. Ishte ideja e tij për të shpëtuar familjen duke shpikur historinë se gruaja e tij, Erika, ishte me prejardhje gjermane dhe kështu dy djemtë ishin vetëm gjysmë hebre. I ndihmoi dhe fati që as nëna dhe as djemtë nuk dukeshin “hebrenj” sipas standardeve naziste. Ndhimoi gjithashtu fakti që ata letonezë që e dinin të vërtetën i ndihmuan ta fshihnin këtë të vërtetë, kurse ata që nuk e dinin, kurrë nuk e morën vesh. Georgs vdiq nga ethet e tifos dhe difteria. Erika dhe Eduards ishin të vetmit anëtarë të familjes që i shpëtuan Holokaustit. Kjo është historia e Eduards Alperovičs, tani i njohur si Edward Anders. Në teks përdoren versionet anglisht të emrave

Të dielën herët në mëngjes, më 22 qershor 1941, u zgjuam nga shpërthime të përsëritura. Radio na tregoi arsyen: Gjermania naziste kishte sulmuar Bashkimin Sovjetik (BS)!

Ne ishim të kënaqur. Një vit më parë, BS kishte pushtuar dhe aneksuar Letoninë, duke e kthyer vendin tonë të lirë në një koloni të shtetit policor sovjetik. Njerëzit arrestoheshin në mesnatë, për t'u vrarë ose dëbuar në Siberi. Shtëpitë dhe bizneset u konfiskuan - jo vetëm biznesi i eksportit të babait tim, por edhe dyqane të vogla artizanale. Hapësirat e banimit ishin të kufizuara, duke detyruar shumë familje të strehoeshin nëpër kabina (zakonisht shtëpiza të vogla ku qëndronte personi ndihmës i një shtëpie, të ngjashme me kasollet e gjahtarëve në pyje). Vetëm tetë ditë më parë, më 14 qershor 1941, policia sekrete sovjetike kishte dëbuar më shumë se 15,000 njerëz në Gulag ose në internim të përhershëm në Siberi. Edhe ne u urdhëruam të paketojmë bagazhet dhe të prisnim të na marrin. Për fat të mirë strehuesi ynë, një punëtor i ri Letonez, ishte bërë major në Gardën e Kufirit Sovjetik, dhe pas disa shakave që shkëmbyem, pranoi të na hiqte nga lista.

Ne e dinim për antisemitizmin e Hitlerit dhe duhet të ishim shumë të shqetësuar, por ne u besuam gjermanëve. Pjesa më e madhe e Letonisë ishte qeverisur nga fisnikët gjermanë prej shekujsh, gjermanishtja flitej gjerësisht nga njerëz të arsimuar dhe në Luftën e Parë Botërore, Letonia Perëndimore ishte pushtuar për tre vjet nga trupat gjermane të disiplinuar dhe të civilizuar. Një vit pas sundimit sovjetik, ne

menduan se Gjermania do të ishte më pak e keqe, po kështu mendonin edhe refugjatët hebrej nga Gjermania naziste. Askush nuk priste një Holokaust; aq më pak prisnim punën e detyruar dhe humbjen të disa të drejtave civile.

VITI VDEKJEPRURËS 1941

Trupat gjermane pushtuan qytetin tim të lindjes, Liepāja, më 29 qershor, një javë pas fillimit të luftës. Pjesa më e madhe e qendrës së qytetit u shkatërrua. Rrugët ishin kthyer në rrënoja të djegura, të mbushura me kratere bombash dhe të spërkatura me xhama të thyer.

Brenda disa orësh gjërat u bënë shumë të ashpra. Nuk e dinim që në fillim të vitit 1941 Hitleri kishte vendosur të vriste të gjithë hebrejtë në Bashkimin Sovjetik gjatë pushtimit të tij. Kjo do të bëhej nga skuadrat speciale të vrasjeve – katër grupe sulmuese, *Einsatzgruppen*, secili me rreth 600-900 burra të stërvitur për "Zgjidhjen Finale" dhe që vinin direkt mbas ushtrisë. Ata organizuan masakra dhe ekzekutime të inskenuara për t'u dukur si veprime spontane të hakmarrjes nga banorët lokalë kundër "shtypësve të tyre hebre-bolshevikë". *Einsatzgruppe A* u caktua në shtetet Baltike dhe një nga ekipet e saj arriti në Liepāja ditën e parë të pushtimit. Ai pushkatoi menjëherë disa hebrej, duke përfshirë dhe kushëririn time Alya, dhe organizoi një forcë vullnetare Letoneze të "etë-Mbrojtjes" për të çrrënjësuar komunistët dhe për të shërbyer si polici ndihmëse.

Nazistët menjëherë morën kontrollin e shtypit Letonez, duke fajësuar hebrejtë për të gjitha të këqijat e pushtimit Sovjetik. Kjo propagandë u hodh poshtë nga shumë Letonezë, veçanërisht nga ata që kishin njohur personalisht hebrej. Një pakicë Letoneze e besoi të paktën një pjesë të kësaj propagande,

veçanërisht që hebrejtë ishin përgjegjës për dëbimet, torturat dhe vrasjet sovjetike dhe u bënë armiqësorë ndaj hebrejve.

Komandanti i Marinës Gjermane lëshoi një sërë rregullash për hebrejtë, duke i urdhëruar ata të vendosnin shenja të verdha në gjoks dhe në shpinë, duke vendosur shtetrrethimin, duke ndaluar ata nga plazhet, parqet, pedonalet dhe transporti publik, dhe duke u kërkuar meshkujve nga 16 në 60 vjeç të paraqiteshin çdo ditë në Sheshin e Qendrës së Zjarrit për punë të detyruar. Hebrejtë kapeshin çdo ditë, torturoheshin dhe merreshin me vete nga gjermanët. Dëshmitarët okularë shpejt raportuan se ata dërgoheshin



Dita e parë e pushtimit të Liepāja, 1941.

ARKIVA E FOTOVE USHMM

në ndonjë park apo plazh, urdhëroheshin të gërmonin varret e tyre dhe ekzekutoheshin. Disa hebrenj u përpoqën të shpëtonin jetën e tyre duke ndërruar fenë dhe u kthyer me nxitim në të krishterë, por kjo nuk i ndihmoi.

Në këtë situatë dëshpëruese, babai im Adolf shpiku një plan për të shpëtuar të paktën gruan dhe dy djemtë e tij, duke përfituar nga pamja jonë ariane. Nëna ime Erika duhej të pohonte se ajo nuk ishte fëmija biologjik i prindërve të saj hebrenj, por një pasardhëse e krishterë e braktisur në pragun e derës së tyre. Kjo do ta bënte vëllanë tim George dhe mua gjysmë hebrenj: qytetarë të klasit të dytë, por që përjashtoheshim nga shumica e rregullave naziste për hebrenjtë.

Nëse do ta dinim që lufta do të zgjaste edhe katër vjet, kurrë nuk do të kishim marrë guximin të ndiqnim planin e babait tim. Shumë nga njerëzit në qytetin e vogël me 60,000 banorë ishin në dijeni që historia jonë qe një gënjeshtër. Doli që njerëzit të cilët e dinin nuk donin të na lëndonin dhe njerëzit që donin të na lëndonin, nuk e dinin.

Tani na duhej të bindnim nazistët për historinë sonë. Fatmirësisht, në vitet 1930, Erika kishte mbajtur korrespondencë me një sekt të krishterë, shoqërinë Rosicrucian në Kaliforni, për shëndetin e saj dhe problemet me vjehrrën e saj. Për shëndetin e saj, ata i dërguan asaj receta për sallatë selino, etj. Lidhur me vjehrrën e saj, ata sugjeruan të kthente faqen tjetër dhe të besonte te Jezu Krishti. Kjo tashmë mund të ndihmonte për të provuar orientimin e saj të krishterë.

Pasi bënë prova mbi përrallën e birësimit, Erika dhe George shkuan te Shërbimi Gjerman i Sigurisë (SD). Ndhimuar nga pamja e saj e bukur, sharmi dhe talenti i saj në aktrim, ajo e bindi shefin SD të na përjashtonte nga rregullat për hebrenjtë. Lejekalimet e lëshuara nga SD na shpëtuan nga arrestimi dhe ekzekutimi. I morëm ato pothuajse ditën e fundit, pasi vrasjet masive të burrave hebrenj ndodhnin çdo ditë, duke arritur kulmin e një “gjuetie” të madhe në datat 22-25 korrik ku u vranë 1,100 burra.

Unë dhe George arritëm të mbanim punët tona verore, por kur ato mbaruan nuk na u lejua të vazhdonim shkollën dhe as nuk gjenim dot punë. Babai ynë Adolf punonte si fermer në një fermë të izoluar, e cila e mbante të sigurt gjatë kërkimeve, por pas korrjeve nuk ishte më i nevojshëm për fermerin. Tani babait i duhej të paraqitej për punë në Sheshin e Qendrës së Zjarrit, por për shkak të vrasjeve kjo



Familja e Grinfeld dhe të tjerë duke u dërguar për ekzekutim më 15 dhjetor 1941, fati i tmerrshëm nga i cili Edward Anders dhe vëllai i tij mezi shpëtuan kur iu thanë të “shkoni” pikërisht atë mëngjes. Nga e djathta në të majtë: Ruben-Aron Grinfeld (15) me bluzë të errët, mamaja e tij Ita-Belle (38) dhe motrat, Ester-Liebe (13) dhe Cilia (9, të cilës i dallohen vetëm këmbët dhe fundi).

ARKIVA E FOTOVE USHMM

ishte shumë e rrezikshme për hebrenjtë e spikatur. Kështu që ai vendosi të fshihej në apartamentin tonë. Përgatitëm një vend të fshehtë në qilar, prapa një pirlgu me dru zjarri. Sa herë që binte zilja e derës, ai duhej të ngjitej mbi drutë dhe të fshihej. Kjo rezultoi e padobishme. Kujdestari në bodrum kishte dëgjuar zërin e babait tim dhe e denoncoi atë në polici. Më 2 dhjetor, kur u ktheva në shtëpi një mesditë, pas një tjetër kërkimi të pafytyrshëm pune, dëgjova zhurmën e druve të zjarrit duke u rrëzuar në dysheme dhe një gjerman që i bërtiste babait. Ai përgjigjej: "Por unë nuk jam kriminel". Ishin fjalët e fundit që i dëgjova të shqiptonte. Nëntë policë të udhëhequr nga një rreshter gjerman kishin kontrolluar apartamentin dhe ishin gati të largoheshin, kur dikujt prej tyre i lindi ideja të shikonte pas druve të zjarrit.

MENDUAM QË MBETËM JETIMË

Policia i mori me vete të dy prindërit e mi. Unë dhe George menduam se tani ishim jetimë, por një javë më vonë u hap dera u dhe Erika hyri brenda, dukej shumë e zbehtë. Ajo qe liruar, por Adolfi do të pushkatohej.

Siç rezultoi, ai do vritej mbas gjashtë ditësh. Kreu i SS Heinrich Himmler kishte urdhëruar një përshpejtim të Holokaustit në shtetet Baltike, kështu që pasi u vranë 25,000 hebrenj të Rigës në fund të nëntorit dhe në fillim të dhjetorit, radhën e kishte Liepāja.



Porta e burgut të grave.
ARKIVA E FOTOVE USHMM

Në orën 4 të mëngjesit më 15 dhjetor u zgjova nga drita që po ndriçonte dhomën time të gjumit. Dy policë Letonezë qëndronin në dhomë, me pushkë mbi shpatulla. Na thanë mua dhe George të visheshim dhe të shkonim pas tyre. Duke e ditur se po shkonim drejt një varri masiv, protestuam dhe treguam lejekalimet, por kjo hajmali papritmas e kishte humbur fuqinë e saj. Megjithatë, policia nuk e mori Erikën, e cila kërkoi të vinte me ne.

Na u deshën rreth dy orë e gjysëm për të arritur tek Burgu i Grave në qytet, vetëm dhjetë blloqe larg. Duhej të ndalonim në çdo bllok pak a shume dhe të ktheheshim me fytyrë nga muri. Disa prej policëve të armatosur me pushkë qëndronin

pas nesh për të na ruajtur, ndërsa të tjerët hynin në shtëpi për të mbledhur familje hebreje, kryesisht gra dhe fëmijë.

Vazhdonim t'u thoshim policëve që na ruanin, duke protestuar se lejekalimet tona na përjashtonin

nga arrestime të tilla. Një polic i ri u zemërua shumë, na mallkoi dhe i kërkoi rreshterit që ta linte të na qëllonte në vend si paralajmërim. Nuk e dëgjua më përgjigjen e rreshterit, por ajo u duk sikur e qetësoi të riun për momentin.

Ishim ndër të fundit që arritëm në burg dhe na urdhëruan të rreshtoheshim pranë portës, me fytyrë nga muri. Në këtë orë duhet të ishte mjaft errët, por oborri ishte tejet i ndriçuar nga prozhektorët. Atje ishin të mbledhur rreth 500 hebrenj, duke dëgjuar me vëmendje ndërkohë që një polic gjerman bënte apelin. Kur ne mbërritëm, ai kishte arritur të shkronja K.

Disa minuta më vonë, u afruan disa prej policëve Letonezë që na kishin arrestuar, të udhëhequr nga një polic gjerman. Duke i shpjeguar pse kishim protestuar kundër arrestimit tonë, i thamë se nëna jonë ishte gjermane dhe i treguam lejekalimet tona. Na nguli sytë për pesë sekonda shumë të gjatë, ndoshta duke kërkuar për tiparet tona hebreje të listës së tij, dhe më pas na largoi me fjalën e vetme geht (shkoni), ndërsa i bëri me shenjë portierit të na linte të iknim.

Porta u hap, ne dolëm në rrugë dhe gati sa nuk u përplasëm me mamanë tonë. Duke na menduar të vdekur, ajo po përpiquej të hynte në burg për të patur të njëjtin fat me ne. Përgjatë tre orëve e gjysmë që nga arrestimi kishim qëndruar krejtësisht të qetë, edhe pse e dinim se ku po shkonim. Por tani që ishim të lirë, patëm ca të dridhura të mira.

Për tre ditë, viktimat marshuan ose u çuan në grupe të vogla në ish-poligonin e qitjes të ushtrisë letoneze Šķēde, 11 km në veri të burgut, ku 2.749 hebrenj u ekzekutuan mbi bazën e akuzave zyrtare gjermane.

Ne i kishim shpëtuar vdekjes falë tekës momentale të një polici gjerman. Fatmirësisht nuk e dinim që lufta do të zgjaste edhe 1,240 ditë. Siç dhe do ta zbulonim, mbijetesa kërkonte disa mrekulli, shumë fat dhe vendimin e duhur në momente kritike - sipas instinktit, rastësisë apo mprehtësisë.

TË LUASH PËR KOHËN

Pas masakrës së dhjetorit, SD na konfiskoi me shpejtësi lejet dhe na tha që të zgjidhnim statusin tonë në zyrën e Komisionerit Gjerman të Rrethit për Kurzem¹. Zyrtari që merrej me çështje të tilla, z. Buttgerit, na dha një leje tre-mujore me kusht që mamaja (1) të divorcohej nga babai, (2) të merrte dy dëshmi që konfirmonin historinë e saj të birësimit nga njerëzit që e kishin njohur atë shumë kohë para luftës, dhe (3) të dorëzonte një certifikatë pagëzimi që vërtetonte origjinën e saj të krishterë. Kështu filloi jeta jonë "në këste 90-ditore".

Divorci ishte i thjeshtë, pasi babai ishte vrarë një muaj më parë. Dëshmitë ishin krejtësisht të lehta,

¹ Courland, regjion historik i Letonisë

pasi dy gra Letoneze të guximshme dhe të dhembshura - Herta Kārklīņš dhe Sofija Zīverts - ranë dakord të shkruanin histori imagjinare që mbështetnin pretendimin tonë. Asnjëra prej tyre nuk mori para megjithëse e dinin që po rrezikonin jetën e tyre.

Certifikata e pagëzimit ishte më e vështira. Buttgerreit mendoi se regjistrat e kishës Baltike Gjermane ishin zhvendosur në një arkiv në Poznań (Posen) në vitet 1939-41, kur shumica e gjermanëve baltikë (gjithashtu të referuar ndonjëherë si “baltikët gjermanë”) u zhvendosën në zonën e dikurshme polake. Postës në fillim të vitit 1942 i duheshin katër deri në gjashtë javë për secilën rrugë, kështu që tre muajt tanë kishin mbaruar ndërkohë, ne thjesht kishim një letër që thoshte se të dhënat e kishës nuk ishin në adresën që u kishim shkruar fillimisht. Z. Buttgerreit na dha një zgjatje tre-mujore, por kur sërish nuk kishim asgjë përfundimtare për t'i treguar, ai me zor të madh na e zgjati lejen me tre muaj, duke na paralajmëruar se kjo ishte hera e fundit.

Së shpejti mësuam se të dhënat ishin në Zyrën e Gjendjes Civile në Riga, por që ishte e mbyllur për momentin. Dyshonim nëse Buttgerreit do ta zgjaste sërish përjashtimin tonë, prandaj filluam të mbyllim llogaritë tona me botën meqë afati tre-mujor po afrohej.

Megjithatë, kur mamaja dhe vëllai shkuan në zyrën e Buttgerreit në ditën e takimit, mësuam se ai ishte transferuar. Pasardhësi i tij, Z. Pusill, nuk dinte asgjë për sa kishte ndodhur më parë, dhe kështu Erika, me ndihmën e George e tregoi historinë në një dritë pozitive dhe mori një tjetër zgjatje afati.

Kjo taktikë funksionoi të paktën edhe një herë, kur Pusill, gjithashtu, u transferua. Ndërkohë, Zyra e Gjendjes Civile ishte rihapur. Në verën e vitit 1943, ne zbuluam se jo vetëm një, por dy vajza ishin pagëzuar Erika tre muaj para ditëlindjes së mamasë time (pretendohet ditëlindje të jetë caktuar dita kur ajo u gjet nga “prindërit birësues”). Por burri i ri në zyrën e komisarit të zonës (*Gebietskomissar*²), Gutschmidt, ishte mjaft i zgjuar për të kuptuar se një kërkim i tillë, veçanërisht pasi ajo vetë po e kryente atë, mund të vazhdonte përgjithmonë. Në fund të vitit 1943 ai refuzoi të rinovonte lejekalimet tona.

Prisnim të na binte shpata e Demokleut mbi krye, duke hamendësuar nëse policia do të na arrestonte në punë apo në shtëpi, dhe nëse ndodhte kjo e fundit, do ishte ditën apo natën. Por asgjë nga këto nuk ndodhi. Arsyet mbetën të panjohura për ne, mbase Gutschmidt duke mos dashur të kishte gjak në duar, nuk e kishte njoftuar Shërbimin e Sigurisë. Antisemitët vendorë të cilët na kishin denoncuar vazhdimisht në polici në vitet 1941-42, dukej se kishin hequr dorë, duke menduar se kishim lidhje me rangun më të lartë, dhe sipas një thashethemi që dëgjuam, me dikë nga stafi i Hermann Göring!

Pse kishim ne lidhje me Reichsmarschall Göring, i cili ishte i dyti pas Hitlerit, nuk e morëm vesh. Ajo që mund të ketë filluar këtë thashethem ishte, se Erika punoi si një nëpunëse e dosjeve me kohë të pjesshme në një zyrë të vogël prej katër personash, i quajtur *Ostland Eisenhandelsgesellschaft GmbH der Reichswerke të Rajhut "Hermann Göring"*. Kompania Tregtare e Hekurit Ostland Ltd. e Punët e Rajhut Hermann Göring

² Zyra e Komisionerit të zonës

ishte thjesht një zyrë blerëse që kanalizonte prodhimin e fabrikës lokale të telit në një kompleks gjigand industrial në Gjermani me emrin Göring. Por një letonez mesatar që shihte Erikën të hynte dhe të dilte nga një ndërtesë që kishte këtë tabelë, dhe matufepsej nga fjalët e mëdha gjermane, mund të konkludonte se ajo kishte një lidhje të drejtpërdrejtë me Göring. Unë do të doja ta falënderoja personin që i filloi thashethemet, pasi as vetë ne nuk mund të kisha shpikur një më të mirë.

Duke qënë se situata e tyre ushtarake u përkeqësua gjatë viteve 1942-43, gjermanët u bënë më të gatshëm të pranonin ndihmë nga grupet etnike të përbuzura. Hitleri kishte thënë në korrik 1941 se midis Gjermanisë dhe Uraleve vetëm gjermanët do të mbanin armë. Ky rregull u bë më elastik në fund të vitit 1941, kur Himmler filloi të krijojë “Batalionet e Policisë Vullnetare Letoneze”. Shumica e anëtarëve të tyre ishin rekrut, por fjala "vullnetar" anashkaloi Konventën e Hagës, e cila ndalon rekrutimin e civilëve në zonat e pushtuara. Në shkurt 1943, menjëherë pas Stalingradit, Hitleri urdhëroi formimin e një "Legjioni Vullnetar SS Letonez", termin "vullnetar" shërbeu përsëri si gjethe fiku (maskim).

Në nëntor 1943, George u rekrutua në Batalionin e 20-të të Policisë Letoneze. Si një "gjysmë hebre", ai u caktua në një "kompani pune" mes të ashtuquajturve “raca të llumit”, Romë, Ukrainas, Lituanez dhe Polakë. Pesë javë më vonë George u shkarkua, pasi oficeri ndërlidhës gjerman i batalionit përcaktoi se gjysmë-hebrenjtë nuk kishin të drejtë të shërbenin në njësitë bashkëpunuese me policinë gjermane. Ai u kthye në shtëpi, por vdiq i rrënuar nga ethet e tifos dhe difteria. Ajo bombë na goditi më fortë sesa vdekja e 24 të afërmve tanë të mbetur më 1941. Tani ishim vetëm mamaja ime Erika dhe unë.

VAJTJA NË PERËNDIM


Situata ushtarake gjermane vazhdoi të përkeqësohej. Aleatët Perëndimorë zbankuan në Normandi më 6 qershor 1944 dhe sovjetikët filluan sulmin e tyre të verës më 23 qershor. Ushtria e Kuqe kaloi kufirin letonez më 18 korrik. Tani lufta po përparonte në oborrin tonë të pasmë.

Me sovjetikët përsëri në tokën letoneze, gjermanët ofruan të lejojnë refugjatët e besueshëm të kërkonin azil "të përkohshëm" në Gjermani, deri në "fitoren përfundimtare" të pritur. Unë e arsyetova këtë si mundësinë tonë të vetme për t'u çliruar nga Aleatët Perëndimorë, sepse nuk kishte asnjë shans që amerikanët ose britanikët të shkonin në Liepāja para Ushtrisë së Kuqe. Një vit nën Stalinin ishte i mjaftueshëm!



Edward dhe bashkëshortja Joan në 80 vjetorin e datëlindjes së tij.

EDWARD ANDERS



Poster njoftimi për fjalimin që do mbante Edward Anders në Kaliforni, USA, 2012.

EDWARD ANDERS

Refugjatët e ardhshëm duhej të merrnin dëshmi politike, për t'u siguruar që vetëm njerëz të besueshëm me një histori të pastër do të futeshin në Gjermani. Megjithatë, ne nuk kishim më një lejekalim që na përjashtonte nga ligjet kundër hebrenjve dhe unë nuk kisha pasaportë, edhe pse më kërkohesh një e tillë që kur kisha mbushur 16 vjeç më 1942. Pavarësisht kësaj, ne aplikuaam.

Nuk e dimë se si ndodhi, por ne e morëm dëshminë. Në lejen time ishte ngjitur një pusullë ku thuhej se si mashkull i grupmoshës midis 16 dhe 60 vjeç nuk më lejohej të largohesha. Por të paktën tani ishim në gjendje të aplikonim për nënën time.

Disa kohë më parë, unë pata "Arjanizuar" pasaportën e Erikës, duke fshirë emrin e saj të mesëm Hebraik, Rachel, me hipoklorit natriumi. Reagenti zbardhi bojën, por gjithashtu ndryshoi dhe sfondin blu të zbehtë. Kështu që e shpërndava hipokloritin në të gjithë këndin e poshtëm të djathtë, për ta bërë atë të dukej si njollë kafeje. Edhe pse e dija që shoku im i klasës George Spektor dhe familja e tij ishin pushkatuar më 1941 për një falsifikim të ngjashëm, si adoleshent tipik moskokëçarës nuk e mendova për së dyti. Kjo ende e la mbiemrin e dyfishtë të vajzërisë së mamasë time (Šeftelovics-Leventals), nga të cilat pjesa e parë dukej shumë hebre ose sllave, dhe pjesa e dytë

ndoshta hebre për një Letonez, por më pak për një gjerman, i cili mund të mos e dinte që shqiptimi në letonisht tingëllonte shumë hebre "Löwenthal". Por eksperimentimi i mëtejshëm ishte përtej aftësive të mia modeste të falsifikimit.

Në zyrën e *Gebietskomissar* nga katër nëpunësit zgjedha atë që ishte më i ngarkuar, kalova në radhën e saj dhe e binda me lehtësi të mos e përfshinte "Šeftelovics" dhe të shkruante "Volksdeutsche" (gjerman etnik) për kombësinë. Shefi i saj që do të firmoste dokumentin e qortoi për shkrimin "Volksdeutsche", meqë Erika nuk ishte regjistruar siç duhet. Por, në inat e sipër, ai nuk arriti të vërente se vajza gjithashtu kishte lënë pa shkruar "Šeftelovics". Tani ne kishim një ID të përshtatshme të arjanizuar për Erikën.

Në fillim të tetorit, ndalimi i largimit të burrave u hoq për pak kohë dhe ne menjëherë bëmë kërkesë për kalim. U nisëm më 15 tetor 1944 me rreth 2,000 refugjatë të tjerë në një anije transporti të mbushur me pleshta për në Gdansk. Me të mbërritur, Dogana Gjermane vulosi ID-të tona me shqiponjën naziste, duke legjitimuar kështu kopjen time të dyshimtë për një pasaportë: një ID jozyrtare nga një shkollë korrespondence në Potsdam.

Një tren na çoi në Stargard, Pomerania, ku na vendosën në një kamp tranzitor. Unë u sëmura

me difteri – një fat i mirë, siç rezultoi më vonë. Tre javë më vonë u regjistruam në një hotel dhe ndërsa plotësoja formularin e regjistrimit të policisë, më pyetën nëse isha gjysmë apo çerek çifut. Mësuar nga babai im të them të vërtetën, isha gati të shkruaja "po" kur papritmas më erdhi shkëndija që askush nuk më njihnte këtu. Shkrova "gjerman", grisa të gjitha dokumentet që i referoheshin prejardhjes tonë hebreje, i hodha në tualet dhe zbraza ujin.

Disa ditë më vonë, ne morëm një tren për në Komotau (Chomutov³) në Sudetenland, ku familja e një ish strehuesi - një zyrtar hekurudhe i quajtur Fischer - na kishte ftuar të qëndronim me ta. Ishim të mirëpritur për aq sa kohë zgjati proshuta jonë letoneze. Pas kësaj, duke u paraqitur si refugjatë gjermanë etnikë, morëm një dhomë në një apartament.

Shpejt u sëmura nga miokarditi - një ndërlikim i zakonshëm kur të rriturit marrin difteri - dhe kalova dy muaj në spital. Zyra Shtetërore e Punësimit më dërgoi njoftime për t'u paraqitur për punë si roje i armatosur për punëtorët skllëvër dhe robërit e luftës. Për sa kohë që isha në spital, mund t'i shmangesha thirrjeve javore, por sapo të lirohesha, më duhej të paraqitesha te mjeku i Zyrës së Punësimit. Pas disa përrhyerjesh të gjurit, pulsi m'u rrit deri në 200, gjë që e bindi doktorin të më justifikonte nga puna deri më 15 maj 1945. Si për fat, lufta përfundoi në 8 maj 1945.

Vetëm 2% e hebrenjve në Letoni i mbijetuan pushtimit nazist. Rreth 90% u pushkatuan më 1941, duke kursyer kryesisht tregtarë të rëndësishëm dhe familjet e tyre. Seleksionimet e mëtejshme eliminuan njerëzit e moshuar, fëmijët nën 12 vjeç dhe hebrenjtë e tjerë "të padobishëm", duke lënë vetëm një pjesë prej rreth 4% të cilët u dëbuan në kampe gjermane të përqendrimit në vjeshtën e vitit 1944. Kushtet brutalisht të vështira në kampe dhe gjatë marshimeve të vdekjes lanë gjallë deri në fund të luftës vetëm më të fortët, rreth 1.5%, së bashku me 0.5% të cilët ishin fshehur nga letonezët e dhembshur.

Një mësim që kam marrë në Luftën e Dytë Botërore është të mos bëj përgjithësime urrejtjeje për asnjë grup etnik ose fetar, por t'i gjykoj njerëzit si individë. Gjatë luftës kam takuar mjaft letonezë, gjermanë e rusë të denjë, fisnikë dhe trima, për t'u imunizuar kundër paragjyqimeve.

Edward, dhe mamaja e tij Erika, emigruan nga Gjermania në Shtetet e Bashkuara në 1949. Ai ndryshoi mbiemrin e tij në Anders, dhe më pas u bë një profesor kimie dhe specialist i mirënjohur shkencor në fushën ezoterike të kimisë së meteorit. Tani është në pension dhe jeton në Kaliforni.

□ shkurtuar dhe përshtatur nga libri i autorit "Amidst Latvians during Holocaust" [Midis letonezëve gjatë Holokaustit], Occupation Museum of Latvia, Riga, 2011.

KONTRIBUT I SHOQATËS SË MUZEUT TË PUSHTIMIT TË LETONISË

³ Republika Çeke e sotme [shënim i botuesit]

Njëmbëdhjetë vjeçarja BENITA PLEZERE u dëbua me familjen e saj nga Letonia në rajonin Omsk të Siberisë më 1949, sepse babai i saj u konsiderua "kulak" (pronar i pavarur toke).

Ajo vizatoi fotografi nga dëbimi, të udhëtimit me tren në Siberi dhe të jetës së saj atje dhe i dërgoi ato si kartolina te tezja e saj në Riga.

Tezja e saj i ruajti dhe tani ato janë një pasuri e çmuar e Muzeut të Pushtimit të Letonisë.

Më vonë, Benita bëri përshkrimin e fotografive. Pas vdekjes së Stalinit, Benita dhe familja e saj u lejuan të ktheheshin nga ajo që supozohej të ishte dëbimi për gjatë gjithë jetës. Në vitin 2007,

Benita dhe mbesa e saj njëmbëdhjetë vjeçare, e cila gjithashtu pëlqen të vizatojë, u takuan me Mbretëreshën Elizabeth në Muze, ku disa nga fotografitë e saj janë paraqitur në stendat e ekspozitës.



KOLEKSIONI PRIVAT I
BENITA PLEZERE- EGLITE

Benita Plezere-Eglite

Papritmas - Siberi

Vizatimet dhe narracioni nga Benita Plezere-Eglite
përshtatja dhe teksti italic nga Valters Nollendorfs

Është dita e njëzet e pestë e marsit 1949, dita e parë e pushimeve të pranverës për nxënësit e shkollës në fshatin e vogël Annenieki në Letoninë Perëndimore. Ishtë një ditë për të fjetur gjumë. Kur nxënësja njëmbëdhjetë vjeçare Nita zgjohet, ajo sheh burra të armatosur që urdhërojnë familjen e saj të paketojnë plaçkat dhe të largohen. Asnjë shpjegim: nxitoni, nxitoni. Me kamion në zonën e grumbullimit, pastaj në stacion; të gjithë në karrocerinë e makinave të mallrave. Pa bileta, pa formalitete, pa pajisje. Treni lëviz përpara dhe në drejtim të lindjes, larg nga shtëpia drejt së panjohurës. Përmes maleve Ural, në drejtim të lindjes dhe ec e ec, dhe papritmas - Siberia.

Babai i Nitës është fermer, nëna e saj është mësuese. Ajo ka një vëlla dhe motër më të madhe, të dy nxënës shkolle. Ata jetonin në ambjentet e shkollës kur i larguan. Ata janë mes më shumë se 44,000 letonezëve të urdhëruar nga qeviria sovjetike të dëbohen nga Letonia në Siberi. Tridhjetë e tre vagona trenash – për të mos u kthyer më. Pse? Ata janë njerëz që nuk e pëlqejnë pushtimin sovjetik të vendit të tyre dhe rregullin e ashpër: fermerë që nuk duan të heqin dorë nga fermtat e tyre familjare, njerëz që mbështesin "Vëllezërit Pyjorë" të Letonisë që luftojnë kundër regjimit të huaj për të rifituar pavarësinë e tyre. Bashkimi Sovjetik ka komandën: atë që qeveria komuniste e urdhëron në Moskë, qeveria komuniste sovjetike në Letoni e zbaton. Ushtria sovjetike ndjek urdhrat dhe dërgon trupa për të mbledhur njerëz. Për më shumë se 44,000 Letonezë, papritmas: Siberia.

Nita e vogël pëlqen të vizatojë. Ajo vizaton dhe ngjyros piktura mbi çfarë i ndodh asaj vetë dhe familjes së saj gjatë rrugës për në Siberi dhe i dërgon vizatimet e saj si kartolina tek kumbara e saj në Letoni. Kur diktatori sovjetik Joseph Stalin vdes më 1953, urdhri për të mos u kthyer më, hiqet, dhe më 1956, familja lejohet të kthehet në Letoni, por jo në Annenieki. Nita është rritur për të qenë Benita; por tashmë asgjë nuk është më si më parë.

Kjo është historia e së voglës Nita Plezere siç tregohet nga e rritura Benita Eglite më 1993.

Ishtë dita e parë e pushimeve tona shkollore: të gjithë ishim duke fjetur. Ishte mëngjes herët. Kur u zgjuam, pamë burra me pamje orientale me pushkë. Na u dhanë vetëm njëzet minuta për t'u veshur dhe për të marrë diçka me vete. Ishim të mërzitur, nuk mund të bënim asgjë, por ata vetëm thoshin: nxitoni, nxitoni, mos rrini ulur, lëvizni. Kështu që të gjithë kapëm çna zuri dora dhe dolëm jashtë për te kamioni i tyre. Babai kishte qenë në hambar duke mjelë lopën dhe erdhi me kusinë e qumështit në dorë, macja akoma në



Herët në mëngjes. Një kamion me karrocerë në shkollën Annenieki ku ne banojmë. Babai duke shkuar tek hambari.

MUZEUMI I PUSHTIMIT TË LETONISË

nga lista. Pak rëndësi kishte familja e tij e lënë pas dhe se ai ishte një komunist - numrat duhej të ishin të saktë. U tha që drejtoresha e shkollës na kishte paralajmëruar: Ju jeni në listë, ndoshta është më mirë të mos qëndroni në shtëpi atë ditë. Burri i saj ishte një çekist - një njeri i KGB-së. Por pastaj ajo ose u frikësua ose ndryshoi mendje, dhe kishte thënë: "Jo, jo, flini të qetë në shtëpi, asgjë nuk do të ndodhë." Nuk besonim se kishim arsye pse të frikësoheshim. Prindërit tanë punonin shumë, rritën fëmijët e tyre, nuk u ngatërruan



Ne jemi duke iu afruar stacionit të fundit hekurudhor të Bërzupe, në Letoni.

MUZEUMI I PUSHTIMIT TË LETONISË

shpatullat e tij. Ai e kishte parë kamionin në oborr dhe e kishte kuptuar: po vijnë të na marrin.

Na dërguan në ndërtesën e Komitetit Ekzekutiv të Fshatit Annenieki. U ulëm atje, ndërsa ata vazhduan të sillnin më shumë njerëz: familje me plaçkat e tyre. Disa kishin më shumë gjëra me vete; disa thjesht nga një valixhe dore. Edhe ne kishim shumë pak gjëra. Sigurisht, ne e njihnim njëri-tjetrin dhe u befasuam të shihnim aty edhe një djalë sovjetik, pronar i vogël toke - ndoshta e kishin ngatërruar me dikë tjetër që mbante të njëjtin mbiemër. Edhe një *istrebitel* - një milic civil sovjetik - u soll brenda. Ia morën armën dhe i thanë të vazhdonte, sepse mungonte dikush

me politikë. Ne nuk patëm frikë dhe qëndruam në shtëpi. Por doli që emrat tanë ishin në listë.

Ata na çuan në stacionin hekurudhor Biksti. Një tren i gjatë me shumë, shumë vagona ishte atje. Kishte njerëz nga e gjithë zona - të moshuar, të rinj, foshnje. Në fillim na thanë se nuk do të shkonim shumë larg - vetëm në kufirin e Letonisë. Por pasi kaluam Bërzupe, stacioni i fundit në Letoni, treni vazhdonte e vazhdonte. Stacionet vinin njëri pas tjetrit, të gjithë quheshin *kipyatok* - ujë i zier, menduam. Shpresonim e shpresonim të mërzitur deri sa kaluam Malet Urale. Pastaj pamja u bë e papërshkrueshme e bukur. Një grua e moshuar, e cila kishte vdekur në tren, u lidh në një çarçaf dhe u hodh në lumin Irtysh kur treni


kaloi mbi një urë.

Treni u shkarkua në Omsk, kryeqyteti i Rajonit Omsk, rreth 4,300 km nga Letonia. Njerëzit u ngarkuan me kamionë dhe u drejtuan në jug për në vendin e tyre të zhvendosjes së përhershme në stepat e rrethit Odessky, në kufirin e Kazakistanit të sotëm.

Kishte toka të rrafshëta, vetëm stepa, pa pemë. Kur binte borë, bora ishte e thellë dhe mbetej për një kohë të gjatë. Premë copa akulli dhe i përdorëm ato si dritare. Kemi djegur kashtë dhe pleh të thatë lopësh për nxehtësi. Nuk kishim asnjë dokument apo pasaportë. Të rriturit duhej të regjistroheshin çdo javë. Kur vendasit kuptuan se nuk ishim monstra, na lejuan të regjistroheshim më rrallë - vetëm një herë në muaj. Prindërit tanë u thirrën në KGB - policia sekrete Sovjetike - dhe u morën në pyetje. Ne fëmijët nuk e kuptonim. Mamaja ime, për shembull, kishte qenë anëtare e Gardës së Brendshme Letoneze. Burri i KGB e thirri atë, e bëri të qëndronte përballë murit, mbushi revolverin e tij dhe e urdhëroi atë të rrëfehej. “Por nuk kisha asgjë për të thënë. Unë gjithmonë kisha dhënë mësim fëmijëve në të njëjtën shkollë, kurrë nuk vrava dhe as plaçkita askënd,” më tha nëna ime më vonë.

Qyteti i Omsk ishte 100 kilometra larg fshatit Odesskoye ku ishim vendosur. Më vonë na lejuan të udhëtonim për në Omsk. Nuk kishte transport publik. Shkuam në rrugën kryesore dhe pritëm derisa dikush të na merrte në makinë. Ishim me fat që mund të qëndronim në këtë fshat qendror. Kryetarët e *kolkoz* - fermë kolektive - vinin nga fshatrat e zonës dhe, si në një treg sklevërish, zgjodhën punëtorët më të fortë pa fëmijë. Kjo është arsyeja pse familja jonë mbeti.

Ndodhej një klinikë, qendra e kolkoz dhe një shkollë e mesme. Kishte disa fëmijë oficerësh në shkollë. Ata ishin më të shëtitur dhe ishin më tolerantë ndaj të huajve sesa vendasit. Ata që ishin dërguar në fshatra të tjera, kishin kushte shumë më të këqija. Vendasit ishin jomiqësorë, të dyshimtë



Treni duke u zbratur në stacionin hekurudhor në Omsk dhe ne po hipim prapë në kamion.

MUZEUMI I PUSHTIMIT TË LETONISË



Shkolla e fshatit Odesskoye.

MUZEUMI I PUSHTIMIT TË LETONISË



Pularia e fshatit Kolkhoz.

MUZEUMI I PUSHTIMIT TË LETONISË

bashkuar dhe ne nuk donim të ishim ndryshe.

Mamaja duhej të bënte punë të rënda. Në fillim asaj iu desh të përzgjidhte patatet e fermës kolektive në qilarët e magazinimit. Këta qilarë ishin të mëdhenjë dhe të thellë dhe gjysma e patateve ishin të kalbura. Të kalburat u hodhën; pjesa tjetër u mbollë. Më vonë Mamja u caktua në një pulari. Një sëmundje e syve ishte përhapur atje. Kolkoshi shiti me çmim të ulët gjithë pulat e ngordhura. Nënës sime i kishin pëlqyer gjithmonë pulat. Ajo filloi të kujdeset dhe t'i kurojë ato. Numri i pulave u rrit. Nëna i shpërndau vezët me ndërgegjegjshmëri dhe mbajti gjithçka të pastër. Ne e ndihmuam atë. Gjela deti dhe pata u shtuan në fermë. Zakonisht ata nuk mbijetojnë atje, por ne dinim të kujdeseshim për to, dhe ata jetuan.



Babai duke sjellë kashtë për qetë. Vendasit nuk mund të bënin një grumbull kaq të madh.

MUZEUMI I PUSHTIMIT TË LETONISË

dhe të pashkolluar. Nuk kishte shkolla, ose vetëm katër klasat e fillores. Vajzat e kolegut të mamasë time mbetën të paarsimuar, sepse ishin shumë të mëdha për klasën e katërt.

Ne fëmijët hezitoni të flasim letonisht. Kur një Letonez kaloi shkollën gjatë rrugës për në dyqan, na pa në oborrin e shkollës dhe tha *labdien!* - ditë e mirë - në Letonisht, ne ikëm që fëmijët e tjerë të mos na dëgjonin duke folur një gjuhë të huaj. Ne ishim kaq të ndrojtur sepse fëmijët e tjerë do të na ngacmonin: *fashist, fashistskij yazik - fashist, gjuhë fashiste*. Edhe midis nesh - ishim katër nga ne Letonezët në të njëjtën klasë - ne flisnim vetëm rusisht. Na u desh të bashkoheshim me *Komsomol* - Rininë Komuniste. Në të vërtetë nuk kishim zgjedhje tjetër. E gjithë klasa ishte

Mamaja së fundmi mori një vërtetim nga mjeku duke thënë se nuk mund të bënte punë të rëndë. Ajo donte të jepte mësim, por iu tha që shkolla nuk kishte asnjë pozicion për të. Ajo u caktua në zyrë dhe njerëzit atje u habitën që ajo mund të shkruante mirë pa gabime dhe të bënte llogaritjet matematikore. Kjo ishte e pazakontë. Shefi i mamasë ishte një kazak - ai ishte llogaritari

kryesor. Ai ishte gjysmë i arsimuar dhe kishte mësuar mbajtjen e llogarive, por ai nuk dinte shumë. Kur pa që nëna ime dinte më shumë, ai e la atë të bënte të gjithë punën. Gjithësesi, ai ishte shefi.

Babait iu desh të bënte punën më të rëndë në fermën kolektive. Nuk kishte kuaj, ndoshta për shkak të klimës ekstreme, vetëm qe. Kjo është ajo ku mësua rreth jetës në një fermë kolektive. Letonezët ishin punëtorë të zellshëm dhe nuk vidhnin. Vendasit ishin mësuar me një stil tjetër: ata përdornin qese të vogla me grurë të vjedhur për të blerë pije. Ata rrisnin vetëm gjëra që nuk kishin nevojë për lërim apo prashitje - patate ose lakër. Letonezët filluan të rritnin lule, e cila ishte një mrekulli për vendasit: si rritet dhe lulëzon e gjitha? Një agronom letonez mbollti një pemishte molle me specie rezistente ndaj ngrirjes.

Shumë nga Letonezët e tjerë të dëbuar erdhën për të vizituar Babain - mësues dhe njerëz të tjerë të shkolluar. Ata gjoja erdhën për të luajtur muzikë. Babai im i binte basit dhe pjesa tjetër instrumente të tjera. Por në fakt të gjithë dëgjuan radion dhe thanë: "Jo, jo, ata do të na lirojnë së shpejti." Britanikët dhe Amerikanët do të vinin dhe do të çlironin Letoninë. Gjithçka është vetëm për momentin, shpresa ishte:



Kasollja jonë mbi një qilar.

MUZEUMI I PUSHTIMIT TË LETONISË

DËBIMET SOVIETIKE

Dëbimi është transferimi i detyruar i një pjese të popullsisë si masë ndëshkimore.

Në Bashkimin Sovjetik dëbimet u kryen nga fillimi i viteve 1920 deri në vdekjen e Stalinit. Grupet etnike ose kombe të tëra u dëbuan nga rajone të përcaktuara; ndër të tjerë kishte grupe të tilla si kozakë, gjermanë, polakë, koreanë dhe çeçenë. Një arsye tjetër për dëbimin ishte të konsideroheshin një "armik shoqëror" - kulakët (fshatarë të pasur), "kundërrevolucionarë dhe nacionalistë", anëtarë të disa kongregacioneve fetare, etj. Pas Luftës së Dytë Botërore mijëra u dëbuan gjithashtu nga Europa Lindore nën kontrollin e Sovjetikëve.

Familjet e tëra u dëbuan dhe zakonisht për tërë jetën e tyre. Ata u transportuan në vendet e largëta lindore (Siberia dhe Azia Qendrore) dhe në veri të Bashkimit Sovjetik. Një qëllim ishte përdorimi i punës së tyre në pylltari, bujqësi, etj. Ata duhej të jetonin në vendbanime të veçanta nën mbikëqyrjen e zyrtarëve të Sigurimit të Shtetit.

Numri i përgjithshëm i të dëbuarve Sovjetik vlerësohet në gjashtë milion dhe shkalla e vdekjes ishte e lartë. Të dëbuarit e mbijetuar mundën të kthehen në atdheun e tyre pas vdekjes së Stalinit, por ata dhe fëmijët e tyre u trajtuan në disa aspekte si qytetarë të klasit të dytë deri në shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik.

"Jo, jo, jo për shumë kohë, është vetëm e përkohshme." Ne nuk pranuan të hidhnim rrënjët në Siberi - shkolla, kolkhozi, gjithçka ishte vetëm për tani.

Na u dha bukë që nuk e kishim parë më parë: dukej bukur dhe ngrihej lart mbi tigan kur piqej. Gratë ruse dinin ta piqnin, por ishte shumë e hidhur sepse fushat e grurit ishin plot pelin. Farat kishin të njëjtën peshë me grurin, kështu që ato nuk mund të ndaheshin me anë të shirjes. Letonezët sugjeruan që nxënësit e shkollës duhet të shkonin dhe të shkullnin pelin ndërsa ishte ende në lulëzim. Vendasit u habitën: si ndodhi që buka nuk është më e hidhur Në të vërtetë, nuk kishte asnjë rus të vërtetë këtu, kryesisht ukrainas dhe gjermanë nga rajoni i Vollgës. Por të gjithë flisnin rusisht. Gjyshet ende flisnin gjuhët e tyre amtare, por të rinjtë e fshehnin gjuhën e tyre amtare: ata e shmangën atë, nuk e përdorën atë dhe përfundimisht e harruan atë.

Vendbanimi ynë i parë ishte një kasolle mbi një qilar. Orenditë tona: një sobë, një shtrat me kashtë, një fuçi për një tryezë. Ne fëmijët i bënim detyrat e shtëpisë në kutitë në të cilat kishim marrë pako me postë nga Letonia. Minjtë me gëzim të zhurmshtëm menduan kashtën. Romantike...

Shtëpia jonë ishte një *zemlyanka*, një kasolle dheu, gjysmë e varrosur nën tokë. Ne e blemë atë nga nevoja, sepse nuk kishim ku jetonim tjetër. Babai shtoi një stallë, në të cilën mbanim një lopë, një derr dhe pula. E bindëm veten se ishte vetëm e përkohshme ... të mos lidheshim shpirtërisht me asgjë. Ne shpresonim se Letonia do të bëhej e lirë dhe ne do të ishim të lirë gjithashtu. Letrat dërgoheshin andej dhe këtej në gjuhë të koduar.



Benita dhe mbesa e saj, Estere Litvinska, duke takuar Mbretëreshën e Anglisë Elizabeth II.

AMBASADA E MBRETËRISË SË BASHKUAR NË LETONI

Gradualisht, ata na lanë të largohemi. Një familje papritur mori leje të largohej herët në 1956. Pastaj të gjithë filluam të shqetësoheshim: pse ne nuk kishim marrë leje? Unë kisha mbaruar shkollën e mesme dhe doja të vazhdoja studimet. Motrat e mamasë, tezet e mia, jetonin në kryeqytetin e Letonisë, Riga. Mendova se mund të jetoja me to dhe të studioja në Letoni. Por në Omsk më thane se kisha ardhur me familjen dhe mund të largohesha vetëm me familjen time. Kështu që u regjistrova në Universitetin e Omsk, por në tetor na lejuan të largoheshim. U përpoqëm të shisnim gjithçka me nxitim, përfshirë edhe lopën. Nxituam të blejmë bileta treni. Therëm derrin dhe gatuam mishin për udhëtim, por na u desh ta hidhnim pjesën më të madhe sepse nuk e e lamër që mishi të ftohej siç duhet. Ishim aq të ngazëllyer sa lamër gjysmën e sendeve tona vetëm që të mund të iknim, të iknim sa më shpejt. Shumë pak letonezë zgjodhën të qëndronin. Ata

që qëndruan kryesisht e bënë këtë sepse ishin martuar me vendas.

Letonia, megjithatë, në të vërtet nuk po na priste. Prindërit e mi kishin frikë të ktheheshin në fermën e tyre. Kishte zëra se do të na merrnin përsëri dhe do të dërgonin mbrapsht - kishte pasur raste të tilla. Halla jonë Olga Plezere jetonte në Vidzeme, në Letoninë veriore, dhe ne shkuam drejt e tek ajo. Ne tre fëmijët shkuam për të studiuar në Riga. Prindërit tanë shkuan për të parë fermën. Ishte shkatërruar. Fqinjët tanë miq nuk ishin më atje. Toka jonë bujqësore tani i përkiste një kolkhozi. Askush nuk jetonte në shtëpi. Pjesët e saj prej druri ishin përdorur për dru zjarri dhe kishin mbetur vetëm themelet.

Vizatimet e Nita-s, të fshehura larg e në mënyrë të sigurt, panë dritën e ditës përsëri në 1989, kur Letonia po dilte e lirë nga Bashkimi Sovjetik. Tani ato mund të shihen në Muzeun e Pushtimit të Letonisë në Riga. Kur Mbretëresha Elizabeth II e Anglisë vizitoi Letoninë dhe Muzeun në 2007, ajo i pa vizatimet. Benita ishte e ftuar të takonte Madhërinë e Saj. Ajo solli mbesën e saj njëmbëdhjetë vjeçare, e cila gjithashtu pëlqen të vizatojë - dy breza më vonë dhe larg Siberisë.

□ Përshtatur nga Ar bërna acim [Through the Eyes of a Child=Përmes syve të një fëmije], botuar me lejen dashamirëse të Benita Plezere-Eglite nga Fondacioni "Letonia gjatë 50 viteve të Pushtimit" në bashkëpunim me Projektin Kombëtar të Historisë Gojore të Institutit të Filozofisë dhe Sociologjisë të Akademisë Letoneze të Shkencave, Riga, 1996.

KONTRIBUT I SHOQATËS SË MUZEUT TË PUSHTIMIT TË LETONISË

LITUANIA

Pavarësia lituaneze u shpall në shkurt 1918. Lituania luftoi për pavarësinë e saj kundër Rusisë Sovjetike, Ushtrisë vullnetare të Rusisë Perëndimore dhe Polonisë në 1918-1920. Polakët kapën Rajonin Vilnius në tetor 1920. Në 1923 Litanët kapën Memelin (Klaipėda) në Prusinë Lindore.

PUSHTIMI KOMUNIST

Në mars të vitit 1939 Gjermania ripushtoi Klaipėda. Sipas protokollit sekret të Paktit Molotov-Ribbentrop të 23 gushtit 1939 Lituania u caktua në "sferën e ndikimit" Gjerman, por më vonë u transferua në atë Sovjetike. Pas disfatës së Polanisë, në tetor 1939 Bashkimi Sovjetik ia transferoi rajonin e Vilnius Litanisë, por vendi duhej të lejonte 20,000 trupa të Ushtrisë së Kuqe të vendoseshin në territorin e tij. Bashkimi Sovjetik pushtoi Lituani në qershor 1940. Sovjetizimi me forcë dhe arrestimet politike filluan menjëherë dhe arritën kulmin me dëbimin e më shumë se 17,000 individëve në qershor 1941.

PUSHTIMI NAZIST

Wehrmacht pushtoi Lituani në qershor 1941. Gjatë pushtimit Gjerman mijëra qytetarë dhe banorë lituanëzë, përfshirë rreth 195,000 hebrenj lituanëzë, u asgjësuan. U formuan organizata të ndryshme rezistence kundër gjermanëve, megjithëse mijëra lituanëzë shërbenin gjithashtu në njësi të ndryshme ushtarake të formuara nga gjermanët.



PUSHTIMI KOMUNIST

Ushtria e Kuqe hyri në Lituani në verën e vitit 1944. Shpërtheu rezistenca e armatosur anti-Sovjetike që zgjati nëntë vjet. Në maj 1948 u dëbuan deri në 40,000 njerëz, në mars 1949 rreth 30,000 dhe në tetor 1951 rreth 17,000. Pas vdekjes së Stalinit dëbimet ndaluan, por regjimi mbeti shtypës deri në fund të viteve 1980. Lëvizja demokratike Sajūdis fitoi zgjedhjet në 1990 dhe Lituania shpalli pavarësinë më 11 mars 1990, megjithatë pavarësia e vërtetë u rifitua vetëm në gusht 1991.

JUOZAS LUKŠA lindi më 10 gusht 1921 në një familje fermerësh në një fshat Të Lituanisë Jugore. Ai kishte tre vëllezër. Ai studioi arkitekturë në një universitet në kryeqytetin Kaunas.

Pasi Lituania u bë pjesë e Bashkimit Sovjetik në 1940,

Juozas braktisi studimet për t'u bashkuar me lëvizjen e rezistencës anti-Sovjetike; pas ripushtimit nga sovjetikët ai u bashkua me rezistencën partizane kundër tyre. Në 1947 ai kaloi Perden e Hekurt dy herë për të kërkuar mbështetje jashtë vendit për pavarësinë Lituanëze dhe për të bërë kontakte

me lituanëzët në mërgim. Gjatë kohës që ishte në Francë, shkruajti një libër për partizanët Lituanëzë të quajtur Luftëtarët për Liri. Atje u takua dhe u martua me gruan e tij. Në vitin 1950, i motivuar nga dashuria për vendine tij dhe duke kujtuar betimin e tij për besnikëri ndaj vëllezërve të tij të armëve, ai shkoi me parashutë përsëri në Lituani. Ai u tradhtua dhe u vra nga forcat sovjetike të sigurisë në 1951.



MUZEUMI I
VIKTIMAVE
TË GENOCIDIT

Juozas Lukša

Jeta e një Partizani

shkruar nga Darius Juodis

VITET E PARA

Partizani i ardhshëm, Juozas Albinas Lukša, lindi në 10 gusht 1921 në familjen fermere të Simanas dhe Ona Lukša në fshatin Juodbūdis në rrethin administrativ Veiveriai të Qarkut Marijampolė. Luftėtari i ardhshëm i lirisė e kaloi fėmijėrinė nė kėtė fshat. Juozas kishte tre vėllezėr: Jurgis, Antanas dhe Stasys. Juozas ndoqi shkollėn fillore nė fshatin aty pranė Mozūriškės dhe u diplomua nė para-gjimnazin¹ e Veiveriai. Ai vazhdoi studimet nė Kaunas, i cili ishte kryeqyteti i Lituanisė nė atė kohė, nė gjimnazin pėr djem Aušra. Nė vitin 1940, ai u diplomua nga gjimnazi dhe nė tē nējtin vit hyri nė Fakultetin e Arkitekturės nė Universitetin Vytautas Magnus.

Viti 1940 ishte njė vit večanėrisht i rėndėsishėm nė historinė e Lituanisė. Nė vitin 1939, si rezultat i marrėveshjeve tē fshehta midis Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisė Naziste, Republika e Lituanisė, si dhe dy vendet e tjera Baltike, Letonia dhe Estonia, ra nėn sferėn e ndikimit tē Bashkimit Sovjetik. Dy agresorėt ndanė Poloninė dhe mē pas filluan aktivitetet e tyre kundėr shteteve Baltike. Nė 1939, bazat ushtarake tē Ushtrisė sė Kuqe u vendosėn nė kėto shtete dhe nė qershor 1940, pasi BS kishte dhėnė ultimatume, u vendosėn forca shtesė nė kėto vende dhe kjo ishte gozhda e fundit nė arkivol pėr ato. Dita fatale pėr Lituaniē ishte 15 qershor 1940. Sovjetikėt me ardhjen nė pushtet u pėrpoqėn tē krijonin njė pamje tē ligjshmėrisė dhe vepruan me shpejtėsi, nė mēnyrė qē populli Lituanes tē mos ishte nė gjendje tē kuptonte zhvillimin e shpejtė tē ngjarjeve.

Nė gusht 1940, Lituania zyrtarisht dhe nė dukje vullnetarisht, u pėrfshi nė BS dhe filloi shkatėrrimi i simboleve tē shtetėsisė. Kėto aktivitete inkurajuan lituanesėt, qē tē bashkohen me lėvizjen e rezistencės; u krijuan organizata tē nėndheshme dhe filloi tē rritej numri i njerėzve tē angazhuar nė aktivitete anti-Sovjetike, duke pėrfshirė Juozas Lukša.

Nė mars 1941, Lukša u bashkua me organizatėn e nėndheshme tē quajtur Fronti Aktivist Lituanes,

¹ Para shkollės sė mesme (vitet midis fillores dhe tē mesmes) [shėnim i botuesit]

ku bëri një betim. Në pritje të momentit vendimtar për të vepruar, anëtarët e organizatës shpërndanë fletëpalosje anti-Sovjetike. Më vonë, kur Lukša u arrestua ai i tha hetuesit "qëllimi i organizatës ishte të krijonte një Lituani të lirë".

Në qershor 1941, grupi i tyre i aktivistëve të nëndheshëm u zbulua. Shërbimi Sovjetik i sigurimit zbuloi dhe arrestoi shokët aktivistë të Lukša dhe më 5 (ose 6) qershor arrestoi dhe Lukša. Ai u burgos në Burgun e Punës së Rëndë të Kaunas dhe u mor në pyetje në mënyrë që të mblidheshin prova rreth asaj që sovjetikët e quajtën veprimtari "kundër-revolucionare". Në mënyrë të pashmangshme, të gjithë ata që u arrestuan i priste burgimi në kampet e punës. Megjithatë, planet sovjetike në Lituani u ndërprejnë nga lufta Sovjetiko-Gjermane që shpërtheu në 22 qershor 1941. Kur filluan operacionet e luftës, disa të burgosur arritën të thyejnë dyert e qelive të tyre dhe të shpëtojnë me sukses, por disa të tjerë nuk ishin me aq fat. Para arratisjes, disa nga të burgosurit u dëbuan nga Kaunas dhe u qëlluan nga NKVD. Lukša ishte ndër ata me fat që arritën të largoheshin. Më 23 qershor, ai u kthye në fshatin e tij të lindjes.

PUSHTIMI GJERMAN

Trupat sulmuese Gjermane pushtuan territorin e Lituanisë brenda një jave. Pushtimi Nazist filloi. Të gjitha shpresat e ushqyera gjatë kryengritjes anti-Sovjetike për të rivendosur shtetin, u zbehën në qershor 1941. Qeveria Naziste nuk e njohu Qeverinë e Përkohshme të Lituanisë dhe nuk kishte ndërmend t'i rikthente pavarësinë Lituanisë. Për ata, kjo ishte thjesht një "hapësirë jetësore" në të cilën nuk kishte vend për Lituanëzët. Në ditët e para të pushtimit nazist, forca e re pushtuese filloi shtypjet, përfshirë këtu dhe vrasjen e hebrenjve në vende të ndryshme të Lituanisë.

Për aq kohë sa universiteti mbeti i hapur (nazistët më vonë e mbyllën atë), Lukša vazhdoi studimet e tij të arkitekturës. Veprimet çnjerëzore të nazistëve ishin thirrje për rezistencë. Nëntoka e paarmatosur anti-Naziste filloi të formohej. Lukša u bashkua me organizatën e nëndheshme të Frontit Lituanëz. Aktivitetet e nëndheshme përfshinin, shpërndarjen e botimeve të nëndheshme, prodhimin e dokumenteve të falsifikuara, bojkotimin e masave të marra nga autoritetet e okupimit, etj. Kur makina naziste e luftës nisi të shkërmoqej në Lindje, filluan përgatitjet për betejë të armatosur kundër ushtrisë Sovjetike që përparonte.

KTHIMI I USHTRISË SË KUQE

Në verën e vitit 1944, Ushtria e Kuqe u kthye në Lituani. Në këtë periudhë u shfaq organizimi spontan i luftës partizane kundër autoriteteve sovjetike. Njësi të mëdha partizane u krijuan në pyje. Shtypjet Sovjetike dhe mobilizimi i detyruar i burrave Lituanëzë në Ushtrinë e Kuqe, e nxiti edhe më

shumë rezistencën. Pritej që aleatët perëndimorë të mbështesnin luftën kundër fuqisë Sovjetike, sepse u kuptua që pas disfatës së Gjermanisë naziste pa dyshim që do të lindte një konflikt midis fituesve.

Me kalimin e kohës e gjithë familja e Lukša u bashkua me lëvizjen anti-Sovjetike të rezistencës. Në fillim të vitit 1945, Jurgis vëllai i Juozas u arrestua, por ata arritën ta nxirrnin nga burgu. Në fillim, Juozas Lukša u përpoq të vazhdonte studimet dhe të punonte në universitet, por më pas ai u përfshi më aktivisht në punën e nëndheshme. Më 10 shkurt 1945, ai u bashkua me organizatën e nëndheshme, Këshilli Çlirimtar i Lituaniës (LIT), qëllimi i të cilit ishte të krijonte një qendër politike për të udhëhequr nëntokën anti-Sovjetike dhe për të koordinuar veprimet e saj. Zbulimi i kësaj organizate nga sigurimi Sovjetik dhe arrestimi i disa anëtarëve të saj, në qershor 1945, bëri që Lukša të bashkohej me Lëvizjen Partizane Lituaneze (LPS). Organizata nëntokësore e LPS kishte qëllime të ngjashme me LIT. Me udhëzimin e kësaj organizate, Lukša duhej të krijonte kontaktonte me partizanët.

Në atë kohë, njësitë individuale partizane kërkonin kontakte dhe përpiqeshin të krijonin struktura të përbashkëta. Më 15 gusht 1945, u themelua Rrethi Usharak Tauras, i cili bashkoi gradualisht partizanët e Suvalkija, një rajon etnografik i Lituaniës. Juozas Lukša vinte nga ky rajon, kështu që ai kontaktoi luftëtarët e lirisë të kësaj njësie. Pas takimeve me komandantët partizanë Zigmąs Drunga (pseudonimi Mykolas Jonas) dhe Juozas Stravinskas (pseudonimi Žiedas) dhe të tjerë, Lukša u ngarkua me krijimin e një brigade në Kaunas. Më vonë ai përmendi se data e saktë e atij takimi ishte 20 gusht 1945. Në nëntor 1945, ai u detyrua bashkë me vëllain e tij Stasys, të largohej nga qyteti Kaunas dhe të fillonte jetën e tij si partizan. Pas kësaj, ai u bashkua me Rrethin Usharak Tauras, Brigadën e partizanëve Geležinis Vilkas dhe u emërua menjëherë shefi i Seksionit të Shtypit dhe Propagandës. Në bashkëpunim me luftëtarët të tjerë, ai filloi të botonte gazetën Kovos Kelio (Në Rrugën e Luftës). Partizanët e kuptuan se përveç luftës së armatosur, lufta e informacionit ishte shumë e rëndësishme. Botimet nëntokësore partizane duhej të kompensonin propagandën sovjetike, të informonin njerëzit për situatën në Lituani dhe jashtë saj dhe të mbanin gjallë shpresën e lirisë. Disa tirazhe të gazetës ishin botuar në qindra kopje.

Kjo veprimtari u shoqërua me përndjekje dhe përplasje me armikun. Në 1944-1945, autoritetet sovjetike, me



Juozas Lukša (larg majtas) me partizanët/trupat pas kthimit të tij në Lituani. Pylli Kazlų Rūda. Tetor 1950.

MUZEUMI I VIKTIMAVE TË GENOCIDIT

ndihmën e trupave të brendshme, njoftuan procesin e legalizimit (me qëllim që të joshnin luftëtarët e pyjeve, duke pretenduar se do t'i shkarkonin nga faji) dhe si rezultat shkatërruan njësi të mëdha partizane. Në 1946, partizanët u nevojit të zgjidhnin një tjetër strategji. Ata nisën një komplot akoma më të madh dhe vepruan në grupe të vogla. Nga ana tjetër, forcat sovjetike të sigurisë rritën presionin dhe thurën plane të reja. Juozas Lukša, i cili u bë partizan në atë kohë, i duhej të vepronte në këto rrethana. Për shkak të konspiracionit, ai duhej të ndryshonte pseudonimet. Një nga pseudonimet e tij të para ishte Vytis.

Ishte jo pak e vështirë të botohej shtypi nëndheshëm. Botuesit vriteshin vazhdimisht, ndërsa shpërndarësit arrestoheshin. Duke kuptuar situatën, Lukša më vonë shkroi: “Shokë Lituanë, vlerësoni thesarin e shtypit të nëndheshëm, sepse kushton gjak”. Kishte gjithashtu një mungesë të vazhdueshme materialesh (letër, bojë, makina shkrimi, etj.). Blerja e materialeve shoqërohej po ashtu me rrezik.

LUFTA PËR PAVARËSI

Pavarësisht humbjeve, partizanët vazhduan punën e tyre të bashkimit. Në 1946, Jonas Deksnys (pseudonimi Alfonsas, Hektoras) dhe Vytautas Staneika (pseudonim Meškis) u kthyen nga Perëndimi në Lituani. Ata gjithashtu dëshironin që lëvizja partizane të ishte e bashkuar dhe u përpoqën të krijonin lidhje me Perëndimin. Pavarësisht se nuk kishin një mandat të qartë nga organizatat e emigrantëve lituanëzë, ata nuk u frenuan të merrnin vetë iniciativë, veçanërisht ambiciozi Jonas Deksnys (Alfonsas, Hektoras). Në këtë aktivitet u përfshi si i infiltruar agjenti i aftë i Sigurimit Sovjetik, Juozas Markulis (pseudonim Erelis) (agjenti i MGB Ažuolas), sikur do përfaqësonte Komitetin e Vienybë në Vilnius (ndonëse ky komitet u shkatërrua nga forcat e sigurisë në pranverën e atij viti).

Më 6 qershor, në prani të personave të mësipërm, të partizanit Lukša dhe të tjerëve, u themeluan Lëvizja e Përgjithshme e Rezistencës Demokratike (BDPS) dhe Komiteti Suprem për Rivendosjen e Lituaniës (VLAK). Lukša, si përfaqësues i Frontit Lituanëz, së bashku me të tjerët, nënshkruan deklaratat për krijimin e këtyre dy organizatave. VLAK do të drejtonte luftën për çlirimin e të gjithë vendit dhe BDPS do të kryente punë politike. Shpejt pas kësaj, u krijua Shtabi Suprem i Forcave të Armatosura (VGPS) për të udhëhequr partizanët.

Agjenti i përmendur, Ažuolas, i cili kishte liri të konsiderueshme veprimi dhe sugjeronte masa veprimi për sigurinë Sovjetike, ishte në pozitë udhëheqëse në këto organizata. Propozimet e tij në lidhje me rezistencën e armatosur ishin të ngjashme me ato të Alfonsas (Hektoras), i cili përcaktoi idenë e rezistencës pasive. Në thelb, kjo do të thoshte që partizanët do të ndërprisnin operacionet aktive, do të zgjidhnin për legalizimin dhe do të prisnin për luftën midis Sovjetikëve dhe Perëndimit. Në këtë rast, qëllimi i sigurimit të shtetit Sovjetik, MGB, ishte të shkatërronte lëvizjen e rezistencës, nën maskën e unifikimit të nëntokës.

KUPTIMI PAS EMRAVE QË JU VIHESHIN PARTIZANËVE INDIVIDËVE DHE GRUPEVE

Tauras	Dem
Žiedas	Unazë/lulëzim
Geležinis Vilkas	Ujk i hekurt
Vytis	Kalorës
Meškis	Ari
Erelis	Shqiponjë
Ažuolas	Lis
Vienybė	Bashkim, unitet
Birutė	Dukeshë Lituaneze e shek të 14
Skirmantas	Dukë Lituanez i shekullit të 12
Kęstutis	Duka i Madh i Lituanisë në shekullin e 14
Mažytis	I vogël (faktikisht ky partizan ishte shumë i gjatë)
Vytautas	Duka i Madh i Lituanisë në shekullin e 15
Daumantas	Duka i Madh i Lituanisë në shekullin e 13
Sakalas	Skifter
Vanagas	Fajkua
Litas	Monedha e Lituanisë së pavarur

Për të arritur këto qëllime, ata lejuan partizanët të vepronin të papenguar për disa kohë. Shpejt, Alfonsas (Hektoras) shkoi te Erelis në Vilnius dhe ra nën ndikimin e tij. Në vjeshtën e vitit 1946, Lukša u zhvendos gjithashtu në Vilnius për të krijuar BDPS dhe VGPS me të tjerët. MGB përfshiu agjentët e saj të tjerë në këtë lojë. Sigurimi Sovjetik u përpoq të merrte nën kontroll ngjarjet dhe të takohej me komandantët e partizanëve. MGB madje e lejoi Alfonsas, të shoqëruar nga njerëzit e MGB, të largohej nga vendi, duke pritur ta kontrollonte atë jashtë vendit. Gjithësesi, kur takimi i të gjithë partizanëve po afrohej (në janar 1947), Lukša me shokët e tij zbuluan që Ažuolas ishte agjent i MGB. Kjo ndodhi në dhjetor 1946 dhe Lukša së bashku me shokët e tjerë arritën të largoheshin në kohë nga Vilnius dhe të shtynin datën e takimit.

U bënë përpjekje thelbësore që të paralajmëroheshin partizanët e komandave të tjera për kërcënimin, por në atë kohë jo të gjithë e besuan. Partizanët e Rrethit Ushtarak Tauras vendosën të krijojnë një Presidium të ri të BDPS dhe një VGPS të ri. Ata gjithashtu vendosën të dërgojnë përfaqësuesit e tyre në Perëndim dhe të merrnin përsipër kanalën e komunikimit me Perëndimin që kontrollohej nga MGB. Juozas Lukša ishte një përfaqësues i tillë.

Komandantët e Rrethit Ushtarak Tauras gjithashtu vendosën që qendra e veprimtarive nëntokësore të krijohej në qytetin e Kaunas. Kjo do të lejonte betejën të zhvendosej nga fshati në qytet dhe të ndihmonte mbajtjen e kontakteve me partizanët e zonave të tjera. Prandaj, më 12 janar 1947, u themelua Brigada Birutë dhe Lukša u emërua komandant i saj. Pseudonimi i Lukša-s në atë kohë ishte Skirmantas dhe menjëherë pas pak kohe iu dha grada Oficer i Ri i Urdhërit. Njëkohësisht ai po bëhej gati të shkonte në Perëndim. Jurgis Krikščiūnas nga Rrethi Ushtarak Dainava u bë shoku i tij i udhëtimit për në Perëndim.

Në fund të prillit ose në fillim të majit 1947, të dy partizanët, me ndihmën e partizanëve vendas, kaluan kufirin Sovjetik-Poloni, i cili ruhej nga shërbimet kufitare Sovjetike. Në atë kohë, pseudonimi i Lukša ishte Kęstutis. Dy të dërguarit partizanë me ndihmën e atyre pak pikave kontakti që njihnin, ia dolën të arrinin me sukses në Gdynia. Pothuajse rastësisht u takuan atje me Alfonsas (Hektoras), të cilin e informuan për provokimet e MGB-së dhe situatën e përgjithshme. Shkruajtën një letër që ia adresonin shefit të shërbimit diplomatik Lituanëz në mërgim, Stasys Lozoraitis e disa të tjerëve dhe ia dhanë atij ta dorëzonte. Megjithatë, nuk morën ndonjë ndihmë të mirëfilltë dhe u desh të ktheheshin në Lituani.

Në qershor, ata luftuan gjatë rrugës së kthimit për në Lituani dhe shpejt arritën te Komandanti i Rrethit Ushtarak Tauras për të raportuar mbi ekzekutimin e detyrës së tyre. Meqenëse ata nuk kishin detyra specifike nga jashtë, ata filluan të përgatiteshin për një rrugëtim tjetër. Më 15 gusht, Lukša u vlerësua me gradën e Oficerit të Garancisë partizane dhe u emërua shef i Seksionit të Inteligjencës Ushtarake të Tauras. Tre muaj më vonë iu dha grada Master Rreshter. Në të njëjtin vit, Lukša pësoi tragjedi personale. Vëllezërit e tij Jurgis dhe Stasys u vranë dhe vëllai i tij Antanas u arrestua. Babai i tij i mbytur nga hidhërimi u sëmur dhe vdiq, ndërsa nëna e tij u detyrua të largohej nga shtëpia dhe të fshihej.

RRUGËTIMI DREJT PERËNDIMIT PËR TË KËRKUAR MBËSHTETJE

Siç u përmend më lart, pas rrugëtimit të parë në Perëndim, përgatitjet filluan për të dytin. Këtë herë Lukša kishte kompetencat e Presidiumit të BDPS. U vendos gjithashtu se ishte më e sigurt që kufiri Polak të kalohej në Kaliningrad Oblast. Këtë herë, Lukša u shoqërua nga partizani Kazimieras Pyplys (Mažytis), një veteran i shumë betejave. Ata përdorën përkatësisht pseudonimet Skrajūnas dhe Audronis. Më 15 dhjetor 1947, me ndihmën e partizanëve të tjerë, ata arritën në Poloni. Këtë herë kishin shumë dokumenta me vete, përfshirë memorandumimin për Kombet e Bashkuara, një thirrje drejtuar Papës Pius XII, si dhe dokumenta të tjera për të demonstruar situatën në Lituani. Në Gdynia u takuan me Alfonsas (Hektoras) dhe në fillim të shkurtit 1948 u nisën me anije për në Suedi.

Jashtë vendit, të dërguarit partizanë u përballën me copëzimin e emigrantëve lituanëzë. U diskutua gjatë se kush ishte mund të ishte i aftë dhe kush mund ta përfaqësonte ligjërisht vendin jashtë. Ndodhën dhe konflikte me Alfonsas (Hektoras), i cili besonte se përfaqësonte forcat e nëntokës jashtë vendit. Prapë,

Lukša arriti të kontaktojë me Komitetin Suprem për Çlirimin e Lituanië (VLIK) (kryesuar nga Mykolas Krupavičius), një organizatë emigrantësh. Më 12 korrik 1948 në Baden-Baden (Gjermani), u mor vendimi që lufta për çlirim të përfaqësohej nga partizanët në Lituani, dhe nga VLK jashtë saj. Lukša pastaj vazhdoi të kërkonte mbështetje për rezistencën kombëtare. Për të fituar përvojë, në 1948, ai filloi studimet në shkollën e inteligjencës Franceze dhe në 1949, në shkollën e inteligjencës amerikane. Në të njëjtën kohë, ai po përgatitej për kthimin e tij në Lituani. Shoqëruesi i tij Audronis u kthye në Lituani në 1949 me shokë të tjerë.

Edhe pse partizanët lituanëzë po përjetonin humbje, ata vazhduan punën e tyre të bashkimit. Qendër e këtyre aktiviteteve u bë Lituania Perëndimore. Iniciativën e mori Jonas Žemaitis (pseudonimi Vytautas), një komandant partizan. Në 1949, në takimin e përfaqësuesve partizanë, u krijua autoriteti suprem - Lëvizja për Luftën për Liri të Lituanië (LLKS) dhe Vytautas u zgjodh komandant i lëvizjes. Vytautas e dinte që Lukša ishte jashtë vendit dhe e emëroi atë shef të Seksionit Politik të Njësisë Publike të LLKS si dhe përfaqësues të LLKS jashtë vendit.

Gjatë qëndrimit të tij jashtë vendit, Lukša përgatiti librin Luftëtarët për Liri² me pseudonimin e Daumantas. Ai gjithashtu u takua me gruan e tij të ardhshme Nijolė Bražėnaitė dhe u martua me të në 23 korrik 1950. Pas vetëm një jave bashkëjetesë, Lukša iu nevojiti të largohej prej saj për t'u marrë me përgatitjet e mëtejshme të kthimit në Lituani. Ai e kuptoi se çfarë e priste. Në një letër drejtuar gruas së tij ai i shkruajti: "Ka gjasa që unë të kthehem në pluhurin e atdheut tonë të përgjakshëm".

Më 3 tetor 1950, Lukša, së bashku me parashutistët Benediktas Trumpys (pseudonimi Rytis) dhe Klemensas Širvys (pseudonimi Sakalas), u kthyen në Lituani. Ata sollën disa dokumente dhe një mbështetje të vogël financiare për rezistencën e armatosur. Menjëherë pas kësaj kontaktuan me partizanët. Lukša shkoi të punonte në Shtabin e Forcave të Mbrojtjes të LLKS (nën komandantin Adolfas Ramanauskas, pseudonimi Vanagas) nën pseudonimin Mykolaitis. Më 25 nëntor 1950, Lukša u emërua



Juozas Lukša (i pari djathtas) me kryetarët e Komitetit Supreme për Çlirimin e Lituanië. Gjermania Perëndimore, 1948.

MUZEUMI I VIKTIMAVE TË GENOCIDIT

² Titulli origjinal në Letonisht Partizanai už geležinės uždangos u pėrkthye si Partizanėt pas Perdes së Hekurt. U publikua fillimisht në 1950. Libri u publikua në Anglishte në 1975 me titullin Luftëtarët për Liri. [shënim i botuesit]



Juozas Lukša dhe Nijolė Bražėnaitė-Lukšienė në natyrë rreth Tübingen në muajin e tyre të mjaltit.

KORRIK 1950 MUZEUMI I VIKTIMAVE TË GENOCIDIT

arritën të kalonin disa radiograme në Perëndim, por si rezultat i persekutimeve radio-transmetuesi humbi. Forcat sovjetike të sigurisë mësuan se Lukša ishte kthyer në Lituani dhe kishte filluar manovra të ndryshme operationale. Mësuan gjithashtu për mbërritjen e një grup tjetër parashutistësh (dy parashutistë Julijonas Būtėnas, pseudonim Stėvė dhe Jonas Kukauskas, pseudonim Gardenis, mbërritën në prill 1951). Siguria Sovjetike zhvilloi një skemë që pretendonte ardhjen e parashutistëve nga Perëndimi, por në fakt këta ishin agjentë të MGB-së që të kërkonin të krijonin kontakt me Lukša-n. Letërkëmbimi me Lukšën filloi nëpërmjet lajmëtarëve, por Lukša u bëri pyetje për të cilat parashutistët e rremë nuk mund t'i dinin përgjigjet. Kështu që operacioni përfundoi pa rezultat për MGB.

Megjithatë, gjatë një operacioni tjetër të MGB, një parashutist i vërtetë, Gardenis, u kap ndërsa parashutisti tjetër u vra. MGB arriti ta rekrutojë parashutistin e kapur dhe shpejt e përfshin në lojën operationale, pasi ky dinte t'u përgjigjej pyetjeve të Lukša. Gjatë verës së vitit 1951, Lukša e testoi me kujdes bashkëluftëtarin e tij dhe më në fund ra dakord ta takonte. Forcat Sovjetike po ashtu u përgatitën për takimin. Agjentët e ndërhyrjes së shpejtë ishin të përgatitur për të kryer arrestimin e Lukša dhe përdorën ushtrinë e brendshme për ta rrethuar luftëtarin. Më 4 shtator, Lukša u zu në pritë dhe u vra në fshatin Pabartupis, Qarku i Kaunas. Vendi i varrimit të tij ende nuk dihet. MGB e vlerësoi operacionin si të dështuar, sepse partizani nuk u zu i gjallë.

Republika e Lituanisë i vlerësoi shumë cilësitë dhe përpjekjet e veçanta të Lukša-s. Me dekretin e 20 nëntorit 1997 të Presidentit të Lituanisë, Lukša iu dha Urdhri i Klasit I të Kryqit Vytis dekorata më

shëf i Njësisë së Inteligjencës të Komandës së Lartë të LLKS. Në të njëjtin vit, ai u vlerësua me Kryqin i Klasit të 1-rë i Betejës për Liri (me shpata) dhe titullin e nderit të Njeriu Trim Luftëtar i Lirisë. Këto ishin titujtë më të lartë partizane. Në maj 1951, ai u transferua për të punuar në Selinë e partizanëve të Rajonit të Lituanisë Jugore (nën Komandantin Sergijus Staniškis, pseudonim Litas).

PRITA

Në atë kohë, forcat sovjetike të sigurisë morën kontrollin e shumë zonave dhe situata e partizanëve gradualisht po përkeqësohej; vdekjet u bënë të zakonshme. Parashutisët

e lartë ushtarake; më 22 dhjetor 1999, iu dha statusi i Ushtarit Vullnetar; dhe me urdhërin e 15 janarit 1998 të Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Lituanisë, iu dha grada major (pas vdekjes).

Kujtimet e Juozas Lukša janë botuar shumë herë në Lituani dhe jashtë saj. Ato janë përkthyer në anglisht, suedisht dhe gjermanisht.

KONTRIBUT I QENDRËS KËRKIMORE TË GENOCIDIT DHE QËNDRESËS SË LITUANISË

JULIANA ZARCHI lindi në Kaunas, Lituani, në vitin 1938, nga një nënë gjermane dhe baba lituanez me origjinë hebre.

Babai i saj u vra gjatë pushtimit nazist.

Si gjysmë hebre, Juliana tre vjeçare u

nda nga mamaja e saj

gjermane dhe iu desh

të jetonte në geton

hebreje të Kaunas.

Pasi i shpëtoi getos,

mamaja dhe gjyshja

e mbajtën Julianan të

fshehur në banesën

e tyre, për pjesën e

mbetur të pushtimit

nazist.

Kur Ushtria Sovjetike

u zhvendos në

Kaunas në 1944,

familja Zarchi i

priste me padurim si

çlirues, por Sovjetikët

filluan një spastrim

të gjermanëve etnikë dhe mamaja

me vajzën u vendosën forcërisht në

Taxhikistan në Azinë Qendrore.

Ato nuk u liruan nga internimi deri në

vitin 1961. U kthyen në Kaunas, ku

Juliana jeton ende sot e kësaj dite.

Nëna e saj vdiq në 1991, pa u lejuar

kurrë të kthehej në Gjermani, në

atdheun e saj të dashur.



KOLEKSIONI FAMILJAR
I JULIANA ZARCHI

Juliana Zarchi

Një Jetë e Re e Ndërprerë

shkruar nga Vilma Juozevičiūtė

Fati i Juliana Zarchi është një shembull i përsosur se si diktaturat totalitare dominuese në EUROPE në shekullin e 20 prishën dhe shkatërruan jetën e njerëzve. Lindur në një familje në të cilën prindërit ishin të kombësive të ndryshme, Juliana u persekutua si fëmijë nga regjimi nazist se ishte gjysmë hebre dhe nga regjimi Sovjetik se ishte gjysmë gjermane.

Babai i Juliana Zarchi, Mausha (Mauša) Zarchi, lindi në 1902 në Lituani në një familje hebreje që jetonte në qytetin e Ukmergė. Pasi mbaroi gjimnazin, i riu u largua nga Lituania dhe studioi filozofi, histori dhe ekonomi politike në Gjermani dhe Zvicër. Në vitin 1928, ai mbrojti disertacionin e Ph.D në Universitetin e Bazelit.

Nga viti 1928 deri më 1936, ai punoi si shef divizioni të një kompanie reklamash në Dyseldorf, ku takoi Gerta Urchs, e cila punoi si sekretare dhe ishte katër vjet më e re se ai. Njohja e tyre shumë shpejt u kthye në dashuri, por për shkak të legjislacionit racist që ekzistonte atëherë në Gjermani, Mausha dhe Gerta nuk mund të martoheshin: një burrë hebre nuk mund të martohet me një grua ariane gjermane. Meqenëse Mausha kishte nënshitetësi Lituaneze, ata vendosën të martoheshin në Lituani, e cila ishte e pavarur në atë kohë dhe nuk kishte kufizime raciste ndaj njerëzve me kombësi të ndryshme. Pavarësisht kësaj, Lituania në ato vite nuk kishte një institucion për martesë civile; martesat regjistroheshin vetëm nga bashkësitë fetare, prandaj pas mbërritjes në Lituani, Gerta u kthye nga Katolike në Judaizëm dhe u martua me Mausha në 1934 në një sinagogë. Martesa me një shtetas Lituanez, e lejoi Gertan të merrte nënshitetësinë Lituaneze.

Si i huaj, Mausha mundi të punonte dhe të jetonte në Gjermani vetën deri në vitin 1937. Në vitin 1937, leja e tij e punës nuk u zgjat dhe kështu regjimi i Hitlerit e detyroi familjen e re të linte Gjermaninë. Ata u vendosën në Lituani. Dr. Mausha Zarchi u punësua për gazetën hebreje që botoheshin në Kaunas. Ai punoi dhe si specialist reklamashe në kompani të ndryshme. Ndërkohë, Gerta ishte shtëpiake.

VITET E PARA

Më 10 maj 1938, një vajzë me emrin Juliana lindi në familjen Zarchi. Menjëherë pas lindjes së saj,



Juliana e vogël me të atin,
Kaunas, 1939.

KOLEKSIONI FAMILJAR I JULIANA ZARCHI

gjyshja e saj, Margarete Urchs, mbërriti nga Düsseldorf në Lituani. Ajo ndihmoi në rritjen e Julianës së vogël dhe jetoi me familjen e vajzës së saj derisa vdiq në vitin 1945.

Juliana u rrit e rrethuar nga dashuria dhe kujdesi, dhe fëmijëria e saj e hershme ishte plot dritë e shkëlqim. Fatkeqësisht, kjo nuk zgjati shumë.

Në vitin 1940, në përputhje me protokollet sekrete të marrëveshjeve të nënshkruara nga BS dhe Gjermania në 1939, Lituania u pushtua nga fqinji i saj lindor, Bashkimi Sovjetik. Pushtimi solli vuajtjet e para në familjen Zarchi.

Siç u përmend më parë, orgjina e Dr. Mausha Zarchi është nga qyteti i Ukmergë. Shumë të afërm të tij me familje e tyre jetonin atje: babai i tij, vëllezërit, motra, hallat dhe xhaxhallarët e tij. Motra e tij e madhe, Chëola Koltun, me burrin e saj Uriasz, drejtonin një librari. Fillimisht, autoritetet sovjetike shtetëzuan pronën e tyre dhe në qershor 1941 dhe kur filluan dëbimet e para masive në Lituani, ata u dërguan në Siberi. Burri i saj u veçua nga familja dhe u burgos

në një kamp pune, ndërkohë Chëola dhe vajza e saj Eta u gjendën në Altai. Një vit më vonë, në verën e vitit 1942, pothuajse gjysma e të gjithë të dëbuarve Lituanëz u morën nga Altai për t'u dërguar në Detin Laptev në veri të Yakutia, ku kushtet ishin aq të vështira sa njerëzit e dinin që i priste një vdekje e sigurtë. Chwola dhe vajza e saj ishin midis atyre të dënuara nga ky fat. Eta u sëmur gjatë rrugës dhe vdiq nga ethet. Chwola gjithashtu vdiq në internim në Yakutia. Pas internimit të familjes së Chwola, vetëm djali i saj Benjamin mbeti në Lituani. Ai studioi në Kaunas dhe jetoi me xhaxhain e tij, Mausha Zarchi.

Në fakt, Chwola nuk ishte e para nga familja e madhe Zarchi që vuajti nga regjimi Sovjetik. Vëllai më i ri i Dr. Mausha Zarchi, Salomon, i magjepsur nga ideja e krijimit të një republike autonome socialiste hebreje në Lindjen e Largët afër kufirit kinez Birobijan – u largua në mes të viteve 1930. Fatkeqësisht, ai u arrestua gjatë viteve të Pastrimit të Madh dhe në 1937 ose 1938 vdiq në një kamp pune Sovjetik.

NJË FAMILJE E NDARË

Më 22 qershor 1941, as një javë pas dëbimeve të tmerrshme masive, filloi lufta midis BS dhe Gjermanisë. Kur njësitë e Wehrmacht³ filluan të përparonin me shpejtësi në territorin e Lituaniës, Dr. Mausha Zarchi vendosi të tërhiqej, pasi intuitivisht parashikoi se po vinin kohë të vështira dhe të tmerrshme për hebrenjtë. Ai vendosi të linte familjen e tij - gruan, vajzën dhe vjehrrën - në Kaunas. Ai mendoi se meqë ato ishin gjermane, do të ishin

³ Forcat e armatosura të bashkuara të Gjermanisë nga 1935 deri 1945 [shënim i botuesit]

më të sigurt nëse do të qëndronin në shtëpi, në banesën e tyre komode dhe të rehatshme në Rrugën Vytautas. Me të u largua vetëm Benjamin, nipi i tij student. Gjatë gjithë periudhës së pushtimit nazist, Gerta Zarchi shpresonte se burri i saj kishte arritur të tërhiqej në Bashkimin Sovjetik. Vetëm pas kthimit të disa prej miqve të tij në Lituani, ajo zbuloi se burri i saj nuk ishte larguar fare nga Lituania; pasi u nda nga miqtë dhe kolegët e tij nga gazeta hebraike, ai shkoi në Ukmergë ku jetonin të afërmit e tij. Ai me siguri vdiq bashkë me gjithë të tjerët që u pushkatuan jo shumë larg Ukmergë në Pyllin Pivonija, vendi ku u masakruan hebrenjtë dhe ku 6,000 njerëz u vranë në kohët naziste nga 18 gusht deri më 5 shtator 1941.

Pas largimit të burrit të saj, Gerta Zarchi, nëna dhe vajza e saj mbetën vetëm në një vend që ishte i huaj për to. Familjarët e burrit të saj ishin vranë dhe ato nuk kishin asnjë të afërm ose miq të tjerë. Ato as lituanisht nuk mund të flisnin. Duke jetuar me Mausha, Gerta ishte ndjerë e sigurt dhe e mbrojtur, por tani iu desh të kujdesej vetë për gjithçka. Katastrofa i goditi shpejt: rezultoi që vajza e saj trevjeçare me flokë të artë Juliana, si gjysmë hebre, duhej të dërgohej në një geto hebreje në periferi të qytetit, në Vilijampolë. Ishte e pamundur të mos i bindej këtij ligji, prandaj Gerta ishte e vendosur të shkonte në geto së bashku me vajzën e saj. Ajo u ndalua nga një i njohur i quajtur Franz Vocelka. "Nëse të gjithë shkojmë në getto, kush do të na shpëtojë nga atje?" i tha ai. Franz Vocelka ishte me orgjinë Çek etnik nga Austria, por për njëzet vitet e fundit ai kishte jetuar dhe punuar në Kaunas në shtypshkronjën Spindulys. Gruaja e tij, Feiga, ishte hebre dhe duhej të transferohej në geto së bashku me fëmijët e tyre. Juliana e vogël u vendos të ishte nën përkujdesjen e saj. Kështu, për disa kohë, vajza jetoi e ndarë nga nëna e saj. Ndërkohë, Gerta shkonte shpesh në geto për ta parë të paktën nga larg vajzën e saj.

Ishte shumë e rrezikshme që fëmijët të jetonin në një geto; pasi ata nuk punonin dhe nuk ishin të dobishëm për autoritetet pushtuese, ata mund të vriteshin gjatë çdo ekzekutimi të zakonshëm të hebrenjve. Kështu që Franz Vocelka ishte i vendosur ta shpëtonte atë nga atje sa më shpejt që të ishte e mundur. Z. Vocelka kontribuoi duke ndihmuar shumë njerëz që të shpëtonin; si specialist i grafikës, ai mund të falsifikonte me shkathësi dokumente për shumë hebrenj të fshehur. Ai gjithashtu mbajti lidhje me shpëtuesit e tjerë të hebrenjve nga getoja. Ishte ky njeri që mori përsipër të merrte fshehurazi nga getoja Julianën e vogël fillimisht dhe më vonë të gjithë familjen e tij. Juliana nuk mban mend shumë, por ajo e di nga historitë e mamasë së saj për planin e marrjes së vajzës së vogël fshehurazi nga getoja. Ajo supozohej të çohet te dy gratë polake që jetonin në Kaunas dhe fshihnin hebrenjtë, por mamja e Juliana e frikësuar se do të ndahej përsëri nga fëmija i saj, vendosi ta fshihte atë në shtëpi. Vizitat



Një fonogramë nga Lituania për Sergei Kruglov, Zëvendës Komisar i Brendshëm I BS, në për gatitje për dëbimin e familjeve gjermane. 300 familje ishin planifikuar për dëbim, duke përfshirë 291 burra, 396 gra dhe 313 fëmijë deri në 16 vjeç. Vilnius, 9 prill 1945.

ARKIVA SPECIALE E LITUANISË

në shtëpinë e saj ishin të rralla, pasi nuk kishte shumë të njohur. Juliana e mbante të fshehur në kuzhinë ose në një dhomë të vogël ngjitur me të. Pothuajse të gjithë periudhën e pushtimit nazist Juliana e kaloi e fshehur në shtëpinë e saj dhe vetëm nga fundi u dërgua në një komunitet të motrave Karmelite në Kaunas, ku mësoi gjuhën Lituaneze.

DËRGIMI NË INTERNIM

Ndërkohë, rrjedha e luftës midis BS dhe Gjermanisë vazhdonte të ndryshonte. Gjermanët u tërhoqën nga Lituania pas betejave të ashpra. Më 1 gusht 1944, Ushtria Sovjetike u zhvendos në Kaunas. Gerta Zarchi i priste me padurim si çliruese. Ajo shpresonte se nuk do të kishte më nevojë të fshihte ose të kishte frikë për jetën e vajzës së saj dhe se lehtësimi i madh do të vinte. Fatkeqësisht, shpresat e saj ishin të kota. Autoritetet Sovjetike kishin për qëllim të zgjidhnin llogaritë me të gjithë ata që kishin luftuar kundër tyre, ose që kishin ndihmuar gjermanët gjatë luftës me çfarëdo mënyre tjetër. Në përputhje me rezolutat sekrete, të gjithë personat me kombësi gjermane ose që kishin të lidhur ngushtë me njerëz të kombësisë gjermane, duhej të internoheshin në rajonet e largëta të BS. Kur lufta po vazhdonte ende, më 7 shkurt 1945, Vasyli Chernyshov, Zëvendës Komisar i Brendshëm i BS, nënshkroi një urdhër sekret ku thuhej se të gjithë banorët e kombësisë gjermane duhej t'i largonin një herë e përgjithmonë nga Lituania dhe t'i vendosnin në Republika Socialiste Sovjetike Autonome Komi, ku do të punonin në prodhimin e produkteve të drurit.

Sipas të dhënave të gjermanëve që jetonin në çdo rreth, duke përfshirë familje me kombësi të përziera, rreth 1.000 njerëz, ose 300 familje, duhej të internoheshin. Dëbimet filluan në prill të vitit 1945. Njerëz nga 14 rrethe të ndryshme dhe qyteti i Kaunas u internuan. Juliana dhe nëna e saj Gerta ishin midis 63 familjeve që u internuan nga Kaunas. Gjyshja e Juliana, Margarete Urchs u përfshi gjithashtu në listën e njerëzve që do të internoheshin, por vdiq në janar 1945. Askujt nuk i interesoi që familja kishte vuajtur rëndë gjatë viteve të pushtimit nazist; ato kishin humbur babanë dhe burrin e tyre, vetë Juliana e vogël ishte e mbyllur në një geto dhe i kishte shpëtuar me vdekjes vështirësi (gjatë pushtimit nazist, rreth 195,000, ose 95%, e hebrenjve u vranë në Lituani).

Mamaja e Juliana u dërgua në zonën ku grumbullonin të dëbuarit. Me një vajzë të vogël dhe duke mos ditur lituanisht apo rusisht, ajo ndjehej e humbur dhe e hutuar. Megjithatë, në një situatë kaq të pashpresë, fati dërgoi disa njerëz të mirë që e ndihmuan të fliste me Rusët dhe që u bënë miq besnikë. Bashkë ndanë problemet e tyre të mëdha dhe gëzimet e vogla në internimin e largët.

Vagona bagëtish u mbushën plot me njerëz, që u mbajtën atje për disa ditë derisa të silleshin të dëbuarit nga të gjitha rrethet. Grupi nga Kaunas u nis më 3 maj 1945. Megjithatë, ata u dërguan në Taxhikistan dhe jo në Komi. Në minutën e fundit u vendos që gjermanët e zellshëm të përdoren për "ndërtimin e Komunizmit" jo në Veriun e Largët, por në Azinë Qendrore.

Udhëtimi i vështirë dhe rraskapitës zgjati plot një muaj. Ambjentet e mbyllura ishin të nxehta dhe

mbytesë dhe njerëzit nuk kishin ujë. Gjatë rrugës për në vendin e internimit, më 10 maj, Juliana mbushi shtatë vjeç. Një udhëtim i gjatë me kamion i priste pas mbërritjes në Stalinabad (tani Dushanbe), kryeqyteti i Takhikistanit. Të dëbuarit u dërguan në fshatin Uyaly në luginën e lumit Vakhsh përmes një kalimi malor. Lugina në kufi me Afganistanin ishte e njohur për prodhimin e pambukut, i njohur gjithashtu si "ari i bardhë". Klima e nxehtë dhe e lagësht ishte veçanërisht e përshtatshme për llojin e pambukut egjiptian. Ky lloj pambuku ka fibra të holla e të gjata dhe piqet në kohë të ndryshme, prandaj mblidhej me dorë pa përdorur asnjë makineri. Lugina kishte mungesë punëtorësh, prandaj u sollën të dëbuarit nga Lituania dhe më vonë më shumë gjermanë etnikë nga Ukraina. Sistemi Sovjetik i pa të dëbuarit si një forcë e lirë pune.

Sipas kujtimeve të Juliana, kur u sollën të dëbuarit nga Lituania, "tregtarët" (menaxherët e fermave kolektive përreth) erdhën dhe zgjodhën punëtorët. Kjo i sillte ndërmend asaj tregjet e skllëvërve të kohërave antike dhe koloniale të përshkruara në librat shkollorë. Fillimisht u zgjodhën dhe u morën më të fortët, ndërsa familjet me fëmijë të vegjël ose të moshuar iu desh të prisnin radhën e tyre për një kohë të gjatë. Qëndrimi dhe rrobat e nënës së Julianës i jepnin asaj pamjen e një banori të qytetit, që nuk ishte mësuar të bënte punë të vështirë fizike. Prandaj, Juliana dhe nëna e saj shkuan në fermën kolektive të menaxherit i cili erdhi i fundit dhe nuk kishte mundësi perzgjedhje.

Të dëbuarit u vendosën në shtëpi të vogla pa dritare, të bëra me kashtë dhe argjilë, të quajtura kibitkas. Ishte jashtëzakonisht e vështirë të punoje në fushat e pambukut nën diell kur ishte 50 gradë. Sidoqoftë, të dëbuarit nga Lituania nuk kishin zgjidhje tjetër. Ata mund të burgoseshin për "mungesë në punë" (shmangie nga puna), shëndeti dhe jeta e tyre madje kishin pak vlerë. Nxehtësia dhe sëmundjet i vranë të dëbuarit një nga një. Ata ishin të sëmurë nga malarja, ethet, dizenteria dhe sëmundje të tjera të rënda. Vuajtën mungesën e ushqimit dhe u desh të hanin lëkura shalqi dhe breshka për të shmangur urinë. Rreth 300 të dëbuar që nuk mund të duronin kushtet e vështira të internimit vdiqën në dimrin e parë të viteve 1945-1946.

NJË GODITJE E RRALLE E FATIT

Juliana dhe nëna e saj gjithashtu mund të kishin patur të njëjtin fat të trishtë. Njerëzit do mund të thonin "Kjo grua trupmadhe gjermane me një fëmijë do të vdesë e para". Puna në fushat e pambukut ishte shumë e



Juliana dhe mamaja e saj në azil në Tadhikistan, 1952.
KOLEKSIONI FAMILJAR I JULIANA ZARCHI

vështirë për Gerta Zarchi; ajo nuk kishte forcën fizike për të punuar me një shat të madh. Megjithatë, një herë të vetme ato patën një fat të mirë. Një kompani po kërkonte rrobaqepës që kishin makinat e tyre të qepjes dhe nëna e Julianës e kishte sjellë me vete makinën e saj të qepjes. Ajo e kishte marrë makinën si dhuratë për pjesëmarrjen në krijimin e një fushate reklamuese, gjatë kohës kur punonte në një kompani reklamash në Dyseldorf. Ajo aplikoi për punë në kompani, ndonëse nuk ishte rrobaqepëse shumë e mirë. Në këtë mënyrë ajo u largua nga ferma kolektive dhe u zhvendos në Kuibyshevsk.

Kur u bë e dukshme se ajo ishte rrobaqepëse e dobët dhe se makina e saj e qepjes ishte më e përshtatshme për qëndruesin sesa për të qepur xhaketa të përforcuara me mbyshje, Gerta Zarchi duhej të bënte punë të tjera: të mbronte fushat e pjeprave dhe shalqinjve nga çakenjtë, të thurte pambukun dhe të bënte qilima me kashtë. Ajo bëri gjithçka që të mund të qëndronte në Kuibyshevsk dhe të mos kthehej në fermën kolektive dhe në fushat e pambukut. Kur i mbaronte ushqimi, ajo shkëmbente ose shiste stolitë e saj ose sende të tjera të vlefshme.

Në fillim vendasit nuk kishin besim tek të dëbuarit dhe shmangnin komunikimin me ta, madje mund të hidhnin dhe gurë ndaj tyre, por kjo nuk zgjati shumë. Ata shpejt bënë njohje dhe filluan të komunikonin. Gjithashtu të mira ishin dhe marrëdhëniet midis të dëbuarve nga Lituania dhe familjeve gjermane nga Rusia që u internuan në Tashkistan. Juliana u miqësua me fëmijët e e fqinjëve Lituanëz dhe Gjermanë, në mënyrë që ata të ishin si vëllezër dhe motra; ata ndanin gjithçka.

Kur erdhi shtatori, Juliana filloi shkollën. Ishte e vështirë për të ta kuptonte mësuesen, sepse nuk dinte rusisht dhe përveç kësaj u sëmur me fruth. Sëmundja ishte e rëndë. Vajza me ethe dhe e dobët mund të shtrihej vetëm në dyshemenë e barrakave prej balte. Mjekët ishin të pakët, metodat e trajtimit ishin të papërshtatshme dhe ajo pothuajse vdiq ngaqë kishte zemër të dobët. Pasi u shërua nuk vazhdoi shkollën, por



Juliana (e dyta djathtas) me student të tjerë në Stalinabad, Tadzhikistan, rreth 1950.

KOLEKSIONI FAMILJAR I JULIANA ZARCHI

ndoqi kopshtin. Mësoi pak rusisht dhe filloi shkollën përsëri në vjeshtën pasuese, kur ishte tetë vjeç. Nuk kishte shumë kohë për të mësuar. Çdo vit e gjithë shkolla duhej të mblidhte pambuk nga shtatori deri në dhjetor. Fëmijët e vegjël u dërguan të mbledhnin copëzat që u kishin shpëtuar të rriturve. Studentët gjithashtu duhej të shkonin të mblidhnin pambuk në fermën kolektive. Gjëja më e rëndësishme ishte të plotësoheshin normat e caktuara.

Gjatë kohës që Juliana ishte e sëmure, mamaja e saj Gerta takoi një mjeke me origjinë gjermane. Ajo ishte e dëbuar nga Ukraina. Njohja e saj e re e ndihmoi Gerta-n të gjente punë në një qendër shëndetësore. Në fillim Gerta pastronte

dyshe-menë. Më vonë, kur mësoi disa rusisht, ajo punoi në tavolinën e pritjes dhe gjithashtu u bënë injeksione të sëmurëve, pasi kishte mungesë të personelit mjekësor. Disa kohë më vonë ajo u punësua në një spital, si infermiere në Departamentin e Sëmundjeve Infektive. Në këtë mënyrë, duke bërë disa punë, ajo mund të mbante veten dhe vajzën e saj. Puna e e rëndë, klima e nxehtë dhe përvojat e dhimbshme e bënë gruan bukuroshe dhe elegante, të plakej para kohe, fytyra e saj u veshur nga rrudhat e thella.

Kur Stalini vdiq në 1953, kushtet në internim u lehtësuan. Deri në atë kohë, të dëbuarit duhej të raportnin në zyrën e komandantit të NKVD çdo muaj dhe nuk mund të ndryshonin vendbanimin e tyre ose të largoheshin nga vendbanimi pa leje të veçantë. Pavarësisht kësaj, edhe pas vdekjes së Stalinit, ata nuk mund të ktheheshin në Lituani. Për Julianën dhe nënën e saj, internimi nuk mbaroi deri në 1961.

Juliana ëndërronte që pas mbarimit të shkollës, të studionte për mjekësi. Fatkeqësisht, ekzistonin kuota të veçanta për të studiuar mjekësi dhe ajo si e dëbuar nuk u pranua. Për fat ajo fliste gjermanisht rrjedhshëm dhe për këtë arsye mundi të regjistrohej për të studiuar filologji Gjermane në Institutin Pedagogjik Stalinabad.

JULIANA KTHEHET NË LITUANI

Në vitin 1962, pasi kishte mbaruar studimet dhe ishte liruar nga internimi, Juliana vendosi të vizitonte miqtë e saj në Lituani, saktësisht, familjen e Helene Czapski-Holzman në Kaunas. Juliana dhe nëna e saj kishin qenë shumë të afërtë me këtë familje gjatë viteve të luftës. Piktorja Helene Czapski-Holzman ishte gjithashtu gjermane, dhe burri i saj Max Holzman ishte hebre. Gjatë pushtimit nazist, Max Holzman dhe vajza e tij e madhe Maria u vranë. Helene, e cila ndihmoi dhe vet në shpëtimin e shumë hebrenjve, u bë shumë afër me Gerta Zarchi, me të cilën kishin fat të ngjashëm. Helene dhe vajza e saj Margarete e mbështetën Gerta Zarchi madje dhe kur ajo u dëbua (në fakt, në 1945 Helene dhe vajza e saj ishin gati për t'u dëbuar pasi ishin gjermane, por në minutën e fundit, njerëzit që ajo kishte shpëtuar gjatë pushtimit arritën disi të merrnin një leje aq ato të qëndronin në Lituani). Helene e mirëpriti përzemërsisht që do I bënte Juliana. Kur Juliana mbërriti në Lituani, Helene e ndihmoi atë të gjente një punë dhe të fillonte një jetë të re atje.

Në 1963, pasi kaloi 18 vjet në Taxhikistan, u kthye në Kaunas edhe mamaja e Juliana. Në fakt, Gerta Zarchi dëshironte me dëshpërim të kthehej në atdheun e saj, Gjermani, por kërkesat që ajo paraqiti u refuzuan; autoritetet sovjetike nuk i dhanë asaj leje të largohej për në Gjermani. Dhimbja e humbjes së atdheut të saj e torturoi derisa vdiq në 1991.

Pas vdekjes së mamasë së saj, Juliana mbeti vetëm, e vetmja e mbijetuar nga ish familja e madhe, e ngrohtë dhe e gjallë e Zarchi.

CONTRIBUTED BY THE GENOCIDE AND RESISTANCE RESEARCH CENTRE OF LITHUANIA

POLONIA



Shtetëformimi i Polonisë u rivendos pas Luftës së Parë Botërore. Polonia mundi bashkimin sovjetik në luftën e 1919-1920 dhe nënshkroi marrëveshje jo-agresioni me Bashkimin Sovjetik dhe Gjermaninë në vitet 1930.

PUSHTIMI NAZIST

Sipas protokollit sekret të paktit Molotov-Ribbentrop të 23 gushtit 1939 Polonia u nda midis Gjermanisë dhe Bashkimit Sovjetik. U sulmua nga të dy vendet në shtator 1939. Në qershor 1941, pasi filloi lufta midis Gjermanisë dhe Bashkimit Sovjetik, e gjithë Polonia e para luftës u pushtua nga gjermanët.

Gjatë luftës u zhdukën rreth gjashtë milion qytetarë dhe banorë polakë, mes tyre tre milion hebrenj. Më shumë se 20,000 oficerë polakë dhe nëpunës civilë, të kapur nga sovjetikët në 1939, u ekzekutuan gjatë masakrës së Katyń në 1940. Në ish-Poloni u krijuan nga nazitët, kryesisht për hebrenjtë, kampet kryesore të shfarosjes. Në pranverën e vitit 1943 u shtyp nga gjermanët kryengritja e Getos së Varshavës. Rezistenca polake filloi menjëherë pas pushtimit. Akti më spektakolar i shtetit nëntokësor polak dhe Ushtrisë Vendase (Armia Krajowa) ishte Kryengritja e Varshavës në gusht 1944.

REGJIMI KOMUNIST

Qeveria polake në mërgim ishte e vendosur në Londër që nga viti 1940. Pas çlirimit të pjesës Lindore të Polonisë nga Ushtria e Kuqe, sovjetikët shfuqizuan njohjen e tyre të qeverisë polake dhe ngritën një qeveri pro-sovjetike në korrik 1944. Gjatë 1944-1947, mbështetur nga bashkimi sovjetik, pushteti në Poloni ra në duart e komunistëve përmes terrorit masiv, mashtrimit zgjedhor dhe propagandës. U ndërtua një shoqëri e tipit sovjetik dhe filluan shtypjet politike veçanërisht kundër anëtarëve të Armia Krajowa. Protesta të rëndësishme u zhvilluan kundër pushtetit komunist në 1970 në Gdańsk dhe në 1980, kur u themelua lëvizja e lirë sindikaliste Solidarność (Solidariteti). Futja në fuqi e ligjit ushtarak në 1981, shtypi për një kohë lëvizjen anti-komuniste. Nga 1989 Polonia u shndërrua në një shoqëri demokratike.

WITOLD PILECKI lindi më 13 maj 1901 në Olonets në Rusinë veriore, në një familje polake me origjinë nga rajoni Nowogródek. Në vitin 1910, Witold u transferua me familjen e tij në Vilnius, Lituani, ku ndoqi një shkollë tregtare dhe, në 1913, u bashkua me një organizatë të fshehtë të skautëve. Gjatë Luftës së Parë Botërore ai ishte një "student-ushtar", duke alternuar midis periudhave të studimit dhe luftimeve aktive. Ai mori pjesë në luftën Polako-Sovjetike të 1919-1920.

Në vitin 1931 ai u martua me gruan e tij Maria dhe patën një djalë dhe një vajzë. Si oficer i kalorësisë ai luftoi gjermanët në Luftën e Dytë Botërore dhe më pas iu bashkua nëntokës.

Në vitin 1940 ai doli vullnetar për të shërbyer si i infiltruar në kampin e përqendrimit Auschwitz, për të mbledhur informacion dhe për të organizuar atje një lëvizje të rezistencës polak. Ai e përfundoi me sukses misionin e tij dhe u arratis nga kampi në 1943.

Gjatë Kryengritjes së Varshavës, kur ishte Kapite u kap nga gjermanët, por më pas u lirua nga amerikanët. Në 1947 u arrestua nga policia sekrete Komuniste Polake dhe e akuzoi për spiunazh. Ai u dënua me vdekje dhe u ekzekutua në 1948



KOLEKSION I INSTITUTIT
TË PËRKUJTESËS
KOMBËTARE

Witold Pilecki

Burri që Doli Vullnetar për në Auschwitz

shkruar nga Jacek Pawlowicz

Një ushtar i palëkundur, një ushtar i mallkuar, një ushtar i "Republikës së humbur të Polonisë", njeriu i fundit i kalorësisë të Republikës së Polonisë, një vullnetar për Auschwitz dhe një nga gjashtë anëtarët më të guximshëm të lëvizjes së rezistencës Europiane gjatë Luftës së Dytë Botërore - Witold Pilecki.

Ai është një simboli i një Polonie që u shkatërrua në mënyrë të pakthyeshme në pothuajse çdo aspekt nga pushtuesit e saj: Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania Naziste. Ai i përkiste brezit dëshira kryesore e të cilit ishte që Polonia të rifitonte pavarësinë dhe që punoi më pas për madhështinë e Polonisë. Ai brez u rrit me traditën e vazhdueshme të kryengritjeve kombëtare dhe u formua nga motoja: "ZOTI - NDERI - ATDHEU".

HISTORIA FAMILJARE DHE VITET E PARA

Witold Pilecki lindi më 13 maj 1901 në Olonets në Rusinë veriore, por familja polake Pilecki ishte me origjinë nga rajoni Nowogródek¹. Si një akt represioni për pjesëmarrjen e gjyshit të Witold (Józef Pilecki) në Kryengritjen e janarit 1863, autoritetet cariste konfiskuan pothuajse të gjithë tokën e familjes. Si pasojë, familja Pileckis u shpërndanë në të gjithë Perandorinë Ruse duke u përpjekur të siguronin jetesën. Babai i Witold, Julian, i diplomuar në Institutin e Pylltarisë në Petersburg, pranoi një pozicion pylltari në Karelia në veri të Rusisë. Ai u transferua në Olonets, ku u takua dhe u martua me Ludwika Osiecimska. Aty u lind Witold, njëri nga pesë fëmijët e Pileckis. Në përpyetje për të shmangur rusifikimin e fëmijëve të tyre, në 1910 Pileckis vendosi të lëvizte në Vilnius². Fatkeqësisht, për arsye financiare Julian Pilecki duhej të qëndronte në Olonets dhe të vazhdonte punën e tij si një inspektor me përvojë në Administratën Pyjore Shtetërore. Ludwika dhe fëmijët shkuan në Vilnius pa të. Pas mbërritjes së tyre

¹ Sot Bjellorusi [shënim i botuesit]

² Atëherë një qytet Polak, por tani kryeqyteti i Lituaniës [shënim i botuesit]

Witold shkoi në një shkollë tregtare, ku në 1913 iu bashkua një organizate të fshëhtë të skautëve.

NJË USHTAR/STUDENT DHE LUFTËTAR POLAKO-SOVJETIK

Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore në 1914 i befaso i Pileckis ndërsa ishin me pushime në qytetin e llixhave Druskininkai. Ludwika e ndodhur në Vilnius-in e rrezikuar nga ushtria gjermane, nuk mundi të shkonte te burri i saj, i cili ishte akoma në Olonets. Në vend të kësaj, ajo shkoi tek nëna e saj e cila jetonte në Hawryłkowo në rajonin e Mogilev . Fëmijët vazhduan arsimin e tyre në shkollat e qytetit Orel, ku Witold themeloi trupën e tij të parë për skautët.

Pavarësisht luftës në vazhdim, familja bëri një jetë të qetë deri në fillim të vitit 1918, kur filloi revolucioni bolshevik në rajonin e Mogilev. Të nxitur nga agjitorët bolshevikë, fshatarët filluan të plaçkisnin pasuritë dhe të vrisnin pronarët e tyre. E frikësuar për jetën e fëmijëve të saj, Ludwika Pilecka u kthye me ta në Vilnius, ku qëndroi për disa javë. Pa asnjë të ardhur në xhep, ajo shkoi në pronën e shkatërruar të Sukurcze afër Lidës, e cila ishte në pronësi të vjehrrës së saj Flawia Pilecka. Ishte e vetmja pasuri familjare që autoritetet cariste nuk e konfiskuan, pasi ishte regjistruar nën emrin Domejko - mbiemri i vajzërisë së gjyshes së Witold.

Në vjeshtën e vitit 1918 Witold Pilecki u kthye në Vilnius, i cili ishte nën pushtimin gjerman. Ai u bë student i shkollës së mesme të rinjve Joachim Lelewel dhe u bashkua me organizatën e fshehtë të Ushtrisë Polake Organizata (Polska Organizacja Wojskowa, POW). Qëllimi i tij nuk ishte të vazhdonte shkollën. Ndërsa polakët në qendër të vendit festonin pavarësinë e tyre të sapo rifitur, banorët e kufirit lindor vazhdonin betejën e armatosur për liri. Më 20 dhjetor 1918 Witold ndërpreu arsimimin e tij dhe së bashku me një grup skautësh, u regjistruan të sherbenin në çetat e Vetëmbrojtjes të Vilniusit të organizuara nga Gjenerali Władysław Wejtko. Ata morën kontrollin e qytetit në prag të Vitit të Ri në 1918. Ai luftoi kundër sabotimit komunist dhe më pas mbrojt Vilniusin kundër ushtrisë bolshevike. Një skautist me përvojë dhe instruktor skautist, ai komandoi mbrojtjen e barrikadës në Portën e Agimit.

Fatkeqësisht, gjatë natës nga 5 deri më 6 janar 1919, çetat e Vetëmbrojtjes të Vilniusit u detyruan të tërhiqeshin nga qyteti. Witold Pilecki nuk u dorëzua dhe u bashkua me një çetë kalorësie të Vetëmbrojtjes të Vilnius, e cila komandohej nga vëllezërit Władysław dhe Jerzy (i njohur si "Łupaszka") Dąmbrowski. Ai luftoi me atë çetë deri në vjeshtën e vitit 1919. Mori pjesë në pothuajse të gjitha betejat kryesore të çetës, kundër forcave të alternuara Gjermane, Bjelloruse, Ukrainase dhe Bolshevike, ai gjithashtu mori pjesë në kapjen e Brest, Lida, Baranowicze, Minsk, por dhe të qyteteve të tjera.

Një ushtar / student, Witold Pilecki u çmobilizua në 1 tetor 1919 dhe u kthye në Vilnius, ku vazhdoi

³ Bjellorusia e sotme [shënim i botuesit]

arsimin në shkollën e mesme të të rinjve Joachim Lelewel. Ai gjithashtu rifilloi aktivitetin e tij të skautimit dhe themeloi Ekipin e 8-të të Djemve Skautist të Vilnius, anëtarët e së cilës ishin kryesisht ushtarë të rinj të çmobilizuar.

As atëherë nuk arriti të ishte student për një kohë të gjatë. Me kërcënimin e ri bolshevik që vinte nga lindja, Witold Pilecki u fut në ushtri në korrik 1920. Atë kohë ai u caktua në Kompaninë e Parë të Djemëve Skautist të Vilnius në regjimentit 201 të këmbësisë dhe u dërgua për të mbrojtur Grodno.

Përballë ushtrisë bolshevike që përparonte, ai me çetën e tij arriti në Varshavë, ku rastësisht u takua me komandantin e tij të mëparshëm Łupaszka. Ai "sulmues" legjendar dhe vëllai i tij ishin duke formuar Regjimentin Vullnetar 211 Niemen Uhlan, të cilit Witold iu bashkua në 12 gusht 1920. Si Uhlan i togës së 3-të të skuadriljes së 2-të ai luftoi p.sh. në Płock, Mława, Chorzele, Druskininkai, Stołbce dhe Kojdanów, në këtë të fundit ishte kur mbaroi lufta Polako-Sovjetike.

Banor i Vilnius, në tetor 1920 ai me regjimentin e tij mori pjesë në fushatën e Vilnius të gjeneralit Lucjan Żeligowski për të rifituar në favor të Polonisë territoret që bolshevikët i dorëzuan Lituanisë në gusht 1920.

PARTIA KOMUNISTE E BASHKIMIT SOVJETIK, BOLSHEVIKËT - KPSS

Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, KPSS (Komunisticheskaya partiya sovyetskovo soyuza) ishte një parti radikale e krahut të majtë, fillimet e së cilës datojnë që nga fillimi i shekullit 20 dhe ndarja graduale e partisë socialdemokrate në Rusinë cariste. Radikalët përreth Vladimir Ilyich Lenin (emri origjinal Ulyanov) u bënë të pavarur organizativisht në kongresin e partisë në Pragë në 1912, kur ata miratuan emrin Partia e Punëtorëve Social Demokrat (Bolshevikët). Emri i partisë ndryshoi disa herë gjatë dekadave në vijim. Parimet themelore të axhendës së saj përfshinin diktaturën e proletariatit, terrorin revolucionar, demagogjinë shoqërore dhe orientimin antifetar. Struktura e partisë kishte karakter ushtarak. Komunistët tradicionalisht hodhën poshtë jo vetëm regjimin carist, por edhe modelin e demokracisë liberale parlamentare. Në nëntor 1917 bolshevikët shfrytëzuan faktin se qeveria ruse u dobësua pas rënies së regjimit carist për të filluar një revolucion të dhunshëm në Shën Petersburg. Në janar 1918 ata shpërndanë Asambleshën Kushtetuese në të cilën kishin shumicën. Pasi fituan luftën civile dhe pas dështimit të ndërhyrjeve të huaja, ata gradualisht e zgjeruan fuqinë e tyre në pjesë të tjera të ish-perandorisë cariste. Pas vdekjes së Leninit në 1924 Joseph Vissarionovich Stalin (emri original Dzhughashvili) u ngrit në udhëheqjen e partisë. Emri i tij u bë sinonim i sundimit totalitar dhe terrorit masiv. Pas rënies së Nikita Sergejevich Hrushchov në 1964 Leonid Ilyich Brezhnev u bë udhëheqësi i KPSS. Gjatë sundimit të tij, ndikimi Sovjetik në botë arriti kulmin. Në të njëjtën kohë, regjimi ra në një krizë të thellë ekonomike. Sidoqoftë, anëtarësia e partisë bolshevike u rrit në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve; në vitin 1917 kishte 40,000 anëtarë, në fund të viteve 1930 numri ishte afërsisht 1.5 milion, duke arritur kulmin në 19 milion anëtarë në fillimin e viteve 1990. Në 1985 Mikhail Sergejevich Gorbachov mori udhëheqjen e KPSS. Ai reagoi ndaj problemeve të vazhdueshme me reformat. Rezultati i papritur i atyre reformave ishte shembja e bllokut Sovjetik dhe përfundimisht edhe i Bashkimit Sovjetik. Pas një përpjekje për gusht shteti të dhunshëm në verën e vitit 1991 nga disa anëtarë të udhëheqjes së partisë, KPSS-ja u ndalua. Një nga pasuesit e saj në detyrë është partia Komuniste e Federatës Ruse.

Pas përfundimit të fushatës, më 1 janar 1921, klasi i parë Uhlan Witold Pilecki u lirua nga ushtria për të vazhduar arsimin dhe për të vazhduar sërish aktivitetin e tij të skautëve.

Në shkurt 1921 Witold u bashkua me Bashkimin e Sigurisë Kombëtare (*Związek Bezpieczeństwa Kraju, ZBK*), ku ai bëri një kurs trajnimi nënoficeri dhe u bë komandant-instruktor i një dege të ZBK në Nowe Świąciany. Në maj të atij viti ai kaloi provimet e shkollës së mesme përpara Bordit të Provimit për Ish Ushtarët (*Komisja Egzaminacyjna dla Byłych Wojskowych*) në Vilnius. Në atë kohë ai zotëronte tre gjuhë të huaja: frëngjisht, gjermanisht dhe rusisht.

Ai filloi të studionte në Universitetin Stefan Batory si një student i jashtëzakonshëm i Shkollës së Arteve të Bukura. Fatkeqësisht, ai u detyrua të ndërpresë studimet dhe të gjejë punë fitimprurëse për shkak të mungesës së parave, sëmundjes së rëndë të babait të tij, i cili ishte liruuar nga një burg bolshevik dhe faktit që pasuria Sukurcze (në të cilën jetuan prindërit e tij, vëllezërit dhe motra e vogël) ishte në borxh për shkak të luftës dhe qiramarrësve të pandershëm.

Fillimisht, ai punoi si sekretar i Bashkimit të Shoqatave të Fermerëve të Rajonit të Vilnius (*Związek Kółek Rolniczych Ziemi Wileńskiej*) dhe më pas si sekretar i magjistratit të ndjekjes penale të Rrethit të 2-të Gjyqësor në Vilnius. Në atë kohë ai filloi studimet me korrespondencë në Fakultetin Bujqësor të Universitetit në Poznań.

NJË PERIUDHË DISI QYTETARE

Gjatë gjithë asaj periudhe ai bëri përpjekje për të rimarrë pasurinë e Sukurcze. U zhvendos në pronën e shkatërruar të familjes dhe filloi ta modernizonte atë. U specializua në prodhimin e farës së tërfilit dhe qumështit.

Atij i mungonte ushtria. Në vitin 1925 ai iu nënshtrua trajnimit në Regjimentin e 26-të Wielkopolski Uhlan të vendosur në Baranovichi. Në 1926 ai u promovua në gradën toger i dytë i rezervës që prej 1923. Pothuajse çdo vit ai bëri stërvitje ushtarake në Regjimentin e 26-të Uhlan dhe nga 1931 në Qendrën e Trajnimit të Kalorësisë (Centrum Wyszkozenia Kawalerii) në Grudziądz.

Në kthesën e vitit 1929 dhe 1930 Witold takoi gruan e tij të ardhshme Maria Ostrowska - një mësuese e re në një shkollë fillore në fshatin Krupa. Ata u martuan në 7 prill 1931 dhe u transferuan në Sukurcze, ku lindi djali i tyre Andrzej në 1932, pasuar një vit më vonë nga vajza e tyre Zofia.

Ai jo vetëm që punoi në pasurinë e tij, por gjithashtu po bëhej gjithnjë e më aktiv shoqëror. Ai ishte kreu i Brigadës Vullnetare të Zjarrfikësve dhe kryetar i një bulmetoreje. Ai krijoi edhe një shoqatë të fermerëve me vendasit dhe ndihmoi ata në nevojë. Në prill të vitit 1932 ai organizoi Stërvitjen

Ushtarake të Kalërimit "Krakus"⁴ në rrethin e Lidës, e cila u bë vartëse e Divizionit të 19-të të Këmbësoresisë të Ushtrisë Polake.

Në vitin 1937 iu dha Kryqi i Argjendtë i Meritës (*Srebrny Krzyż Zasługi*) për punën e tij shoqërore.

Pavarësisht se kishte shumë gjëra në mendje, ai gjithashtu gjeti kohë për të shkruar poezi dhe për të pikturuar. Dy nga pikturat e tij kanë mbijetuar në kishën famulltare në Krupa.

LUFTA E DYTË BOTËRORE

Në mes të vitit 1939 Polonia urdhëroi mobilizimin në rast të një lufte me Gjermaninë. Më 26 gusht 1939 filloi mobilizimi i kalorësis të Divizionit të 19-të të Këmbësoresisë. Toger i 2 në Rezervë Witold Pilecki sapo mori lajmin organizoi një pikë mobilizimi në fshatin Krupa dhe menjëherë pas kësaj ai dhe vartësit e tij u bashkuan me njësinë.

Divizioni i 19-të i Këmbësoresisë së Ushtrisë "Prusy" [Prusia] arriti në zonën e përqendrimit afër Piotrków më 4 shtator 1939 dhe filloi të përgatitej për mbrojtje. Ditën tjetër Trupa Gjermane XVI e Blinduar zhvilloi një sulm duke i detyruar njësitë polake të tërhiqeshin drejt Tomaszów Mazowiecki. Gjermanët shkatërruan skuadriljen e Lida Uhlan të komanduar nga Toger i 2 Pilecki, gjatë luftimeve të ashpra në Wolborz. Ushtarët e shpërndarë me Pileckin midis tyre, kaluan lumin Vistula dhe u bashkuan me Divizionin e 41-të të Këmbësoresisë, që po rikrijohej afër Włodawa. Në atë kohë Witold u bë zëvendës i komandantit të kalorësisë së divizionit, major Jan Włodarkiewicz. Divizioni u shkatërrua më 22 shtator 1939 pas luftimeve të ashpra, por Witold Pilecki nuk u dorëzua. Ai vazhdoi të luftonte me Uhlanët e tij në një çetë partizane deri në 17 tetor 1939.

Ndërsa Pilecki po luftonte me Ushtrinë Gjermane, familja e tij më e afërt në Sukurcze u gjend nën pushtimin Sovjetik. Për të shmangur arrestimin nga NKVD, gruaja dhe fëmijët e tij u fshehën në zonën



Maria Ostrowska dhe Witold Pilecki në ditën e tyre të martesës, 7 prill 1931.

KOLEKSION I INSTITUTIT TË KUJTESËS KOMBËTARE

⁴ Krakusi – trajnim ushtarak kalërimi për studentët e shkollës së mesme në Poloninë e para-luftës [shënim i përkthyeses]

vendase. Maria në prill 1940 arriti të kalonte kufirin gjermano-sovjetik për të shkuar te prindërit e saj që jetonin në Ostrów Mazowiecka⁵ dhe në fund të atij muaji Toger i 2-të Witold Pilecki u takua me familjen e tij për herë të parë që nga shpërthimi i luftës.

Pas mbërritjes së tij në Varshavë, e cila ishte nën pushtimin gjerman, Pilecki rivendosi kontaktin me major Jan Włodarkiewicz dhe filluan të krijonin një organizatë të fshehtë për të vazhduar luftën për pavarësi. Më 9 nëntor 1939 gjatë një takimi në apartamentin e Eleonora Ostrowska (kunata e Pileckit) u

mor një vendim për të themeluar një organizatë ushtarake fshehtë – Ushtria e Fshehtë Polake (*Tajna Armia Polska*, TAP). Të nesërmen anëtarët e saj bënë një betim para At Jan Zieja.

Në Varshavë Witold Pilecki ishte fshehur nën emrin e supozuar të Tomasz Serafiński. Serafiński nuk ishte një figurë e trilluar, por një toger në rezervë që kishte marrë pjesë në mbrojtjen e Varshavës. I plagosur pas kapitullimit të kryeqytetit, ai nuk ishte zënë rob, por fshihej në një apartament sekret. Në dhjetor 1939 Serafiński u transferua në një apartament tjetër dhe la pas dokumentet e tij prapa. Pilecki i gjeti kur u strehua atje pas tij. I bindur se pronari i tyre kishte vdekur për shkak të lëndimeve të përherëshme, Pilecki thjesht ndryshoi fotot në dokumente dhe filloi t'i përdorë ato.



Pilecki me gruan dhe fëmijët e tij, Ostrów Mazowiecka, 1934.

KOLEKSION I INSTITUTIT TË KUJTESËS KOMBËTARE

NJË VULLNETAR PËR NË AUSCHWITZ

Arrestimet midis ushtarëve të TAP, numri në rritje i të burgosurve në kampin gjerman të përqendrimit në Auschwitz dhe përhapja e reputacionit të tij të keq, nxitën

komandën e TAP për të kryer një operacion inteligjence në kamp.

Toger i 2-të Witold Pilecki doli vullnetarisht për të ndërmarrë misionin me dijeninë e Komandantit të Përgjithshëm Gjeneral Stefan Rowecki (pseudonimi Grot) të Unionit të Armatosur Luftarak (*Związek Walki Zbrojnej*, ZWZ). Pilecki i lejoi gjermanët ta arrestonin si Tomasz Serafiński gjatë një arrestimi në masë në rrethin e Varshavës të Żoliborz më 19 shtator 1940.

⁵ Vendlindja e saj në Poloninë verilindore [shënim i botuesit]

Ai u transportua në kampin e përqendrimit Auschwitz bashkë me 1,705 persona të tjerë (i ashtuquajtur "transporti i dytë i Varshavës") natën e 21 shtatorit 1940. Numri i tij i kampit ishte 4859.

Çastet e para pas shkarkimit të makinave e bindën atë se kampi ishte "ferri në tokë". Të burgosurit formuan një kolonë dhe të detyruar marshuan për në kamp. Gjatë rrugës për në kamp goditeshin dhe u turruan qentë. Gjatë marshimit, për të terrorizuar të burgosurit, e qëlluan me armë njërin prej tyre me pretendimin e arratisjes. Pastaj rojet SS pushkatuan edhe dhjetë të burgosur, duke pretenduar se ata ishin bashkërisht përgjegjës për atë akt rebelimi. Për fat të mirë, në atë natë të tmerrshme Witold Pilecki humbi vetëm dy dhëmbë. Një fragment i raportit që ai shkroi pas arratisjes së tij thotë: "Ata rrëzuan dy dhëmbët e mi të parë, sepse unë kisha pjetën me numrin tim të kampit në dorë dhe jo në dhëmbë siç dëshironte Bademeister⁶ atë ditë. Unë u godita në nofull me një shufër të rëndë. Dy dhëmbë ranë. Kishte pak gjak".

Në tetor 1940 Pilecki dërgoi mesazhin e parë nga Aushvici duke përshkruar kushtet në kamp. Disa javë më vonë, mesazhi iu transferua Komandantit të Përgjithshëm të ZËZ, gjeneralit Stefan Rowecki (Grot), i cili më pas urdhëroi që mesazhi të dërgohej në Londër nëpërmjet kutisë me shkronja të vdekura "Anna"⁷ në Stokholm. Mesazhi arriti në destinacionin e tij në 18 mars 1941.

Gjatë asaj kohe Witold Pilecki tashmë po organizonte fshehtësisht në kamp Organizatën e Bashkimit Ushtarak (*Związek Organizacji Wojskowej*, ZOW). Qëllimet që ai specifikoi ishin: "të mbanin lart shpirtrat e shokëve të burgosur duke dërguar dhe përhapur lajme nga jashtë, të organizonin racione ushqimore shtesë dhe veshje për të burgosurit nëse ishte e mundur, të transferonin informacione jashtë kampit dhe - mbi të gjitha - të përgatisim çetat tona për të marrë kontrollin mbi kamp kur të paraqitet nevoja, kur të ketë urdhër për të hedhur armë ose forcë të gjallë (parashutist) këtu". Kontaktet e vendosura falë ushtarëve të TAP, të cilët ishin arrestuar më parë dhe kishin qenë më gjatë në Auschwitz, veçanërisht mjeku Władysław Dering, shpejt sollën efektet e dëshiruara. Kontakti i parë i ashtuquajtur "pesë" ishte krijuar tashmë në vjeshtën e vitit 1940 dhe përbëhej pothuajse ekskluzivisht nga ushtarë të TAP. Pas disa kohësh, struktura kishte njerëzit e saj në të gjithë *Kommandos*⁸ të Auschwitz I dhe Auschwitz II-Birkenau. Në mes të vitit 1942 organizata kishte tashmë rreth 600 të burgosur, mbi 100 prej të cilëve u betuan para Pilecki.

Informacioni nga kampi transferohej gradualisht në raporte te Komanda e Lartë e Ushtrisë Vendase në Varshavë.

⁶ Përgjegjësi i vendeve të larjes [shënim i përkthyeses]

⁷ Metodë që përdorej për të kaluar sende midis dy personave, duke përdor vendndodhje të përcaktuar secrete. Kjo nënkupton që personat nuk është e nevojshme të dakohen drejtpërdrejt [shënim i botuesit]

⁸ Detajat e punës [shënim i botuesit]

Në shenjë vlerësimi të veprimtarisë së Witold Pileckit në Auschwitz, Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë Vendase, Gjeneral Stefan Rowecki (Grot) e ngriti atë në gradën e Togerit në 11 nëntor 1941.

Në pranverën e vitit 1943 Gestapo i kampit filloi arrestimet midis komplotistëve. Për pasojë, Toger Pilecki u arratis gjatë natës nga 26 deri më 27 prill 1943 me Jan Redzej (i cili kishte qenë në kamp me emrin e rremë të Jan Retko; numri i kampit 5430) dhe Edward Ciesielski (numri i kampit 12969). Kështu e përmbloodhi ai qëndrimin e tij në Auschwitz pas arratisjes: "gjatë daljes kisha disa dhëmbë më pak se në momentin e mbërritjes sime atje dhe kisha një kockë të gjoksit të thyer, kështu që pagova një çmim shumë të ulët për një periudhë të tillë të kaluar në atë sanatorium".

Pilecki u arratis kryesisht për të raportuar personalisht rreth situatës në kamp në Komandën e Lartë të Ushtrisë Vendase dhe për të marrë pëlqimin e eprorëve të tij për të përgatitur një operacion ushtarak për lirin e të burgosurve.

Ai arriti në Varshavë vetëm më 22 shtator 1943, pas një periudhe fsheheje në Bochnia dhe Nowy Wiśnicz, ku takoi Tomasz Serafiński e vërtetë, i cili në atë kohë ishte përfaqësues lokal dhe komandant i Ushtrisë Vendas Crakow.

Në kryeqytet Pilecki u bë anëtar aktiv i nëntokës nën emrin e rremë të Roman Jezierski. Ai më pas shkoi në Ostrów Mazowiecka, ku u bashkua me gruan e tij. Nga ai moment ai e shihte atë mjaft shpesh, por me fëmijët e tij u takua vetëm disa herë. Gjatë një prej atyre vizitave ai u tha atyre moton e tij: "Duajeni atdheun tuaj. Duajeni besimin tuaj të shenjtë dhe traditën e Kombit tuaj. Rrituni për të qenë burra të nderit, gjithmonë besnikë ndaj vlerave tuaja më të larta, të cilave ju duhet t'u kushtoni gjithë jetën tuaj".

Pas arratisjes së tij Witold Pilecki u interesua shumë për ngjarjet në Auschwitz, por komanda nuk e miratoi projektin e tij për të sulmuar kampin.

Më 19 shkurt 1944 Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë Vendase, Gjenerali Tadeusz Komorowski (pseudonimi Bór) promovoi Toger Witold Pilecki në gradën e *rotmistrz* (ekuivalent i Kapitenit⁹ që nga 11 nëntori 1943 për veprimtarinë e tij heroike në Auschwitz.

KRYENGRITJA DHE PUNA E VARSHAVËS PËR FORCAT E ARMATOSURA POLAKE NË PERËNDIM

Pushtimi i Polonisë tashmë ishte i sigurt që do të ndryshonte nga Gjermanët tek Sovjetikët, kështu

⁹ Grada e Pilecki praktikisht u njehsua me emrin e tij, kështu që zakonisht referohet si rotmistrz Pilecki, shpesh shkurtimisht si 'rtm'

që komanda e Ushtrisë së Brendshme filloi të krijonte një organizatë të re të fshehtë të koduar "NIE" (Niepodległość - Pavarësia). Ajo organizatë e kuadrove ushtarak duhej të vazhdonte luftën pro pavarësisë, pas marrjes së territoreve polake nga Ushtria e Kuqe. Pilecki (emri i ri dhe emri i koduar: Witold Smoliński dhe T-IV përkatësisht) gjithashtu u caktua të merrte pjesë në ato përpjekje organizative, megjithëse ato u ndërpre në mënyrë të shpejtë me shpërthimin e Kryengritjes së Varshavës.

Ai luftoi në rrethin e Varshavës në Ëola pranë rrugëve Towarowa, Pańska, Miedziana, Żelazna dhe Sheshit Starynkiewicza. Zona që ai mbrojtë u njoh si "Fortesa e Witold"¹⁰; ishte një prej fortesave partizane që u mbrojtë më gjatë dhe nuk ra kurrë në duart e gjermanëve.

Pas rënies së Kryengritjes, më 5 tetor 1944 Rtm. Witold Pilecki dhe ushtarët e njësies "Chrobry II" përfunduan në kampin në Ożarów, nga ku u transportuan në kampin e POW në Lamsdorf (Łambinowice afër Opole) dhe më pas te POW i oficerëve [Oflag] në Murnau. Numri i tij i POW ishte 101892.

Kampi u çlirua më pas nga Ushtria Amerikane më 28 prill 1945 Rtm. Witold Pilecki mbeti atje për një kohë, duke u përgatitur për largimin e tij në Korpusin II Polak të komanduar nga Gjenerali Władysław Anders, i cili ishte vendosur në Itali. Ai u largua nga Murnau më 9 korrik 1945 bashkë me një grup oficerësh dhe raportoi gadishmërinë për detyrë vetëm pas dy ditësh.

Në atë kohë ai ishte vendosur në San Gregorio, ku bisedoi dy herë me Gjeneralin Anders dhe një herë me Gjeneralin Tadeusz Pełczyński. Ai u bë një oficer i inteligjencës i Departamentit II të Korpusit II Polak dhe po përgatitej për transferim në Poloni. Detyra e tij ishte të organizonte një rrjet spiun për të mbledhur çdo informacion në lidhje me situatën në vend.

Më 22 tetor 1945 u nis për në Poloni si Roman Jeziński. Udhëtoi përmes Romës, Bolonjës, Bremen, Regensburg dhe Pragës i shoqëruar nga Maria Szczęsna (pseudonim Rysia) dhe Bolesław Niewiarowski. Arriti në Varshavë më 8 dhjetor 1945.

Gradualisht vendosi disa kontakte. Ai krijoi rrjetin e tij të bashkëpunëtorëve dhe informatorëve, që i zgjodhi midis ish-ushtarëve të TAP dhe anëtarëve të fshehtë të Auschwitz. Ai mori informacion konfidencial mbi funksionimin e NKVD dhe Zyrës së Sigurisë (Urząd Bezpieczeństwa, UB), intensifikimin e terrorit, aktivitetin e nëntokës ushtarake pro pavarësisë, zgjedhjet e manipuluar dhe mbi bashkëpunimin ekonomik midis Polonisë dhe Rusisë Sovjetike. Raportet iu dërguan stafit të Korpuseve Polake II në Itali.

Në qershor 1946 Kapitani Jadwiga Mierzejewska (Danuta) i komunikoi atij urdhrin e Gjeneralit Władysław Anders, të emigronte menjëherë në Perëndim për të shmangur arrestimin.

Ishte urdhri i vetëm që Rtm. Witold Pilecki nuk zbatoi.

Ai nuk donte të largohej nga vendi për dy arsye. E para, nuk kishte askënd të cilit mund t'i ngarkonte përsipër aktivitetin që ai kishte filluar dhe e dyta, nuk donte të braktiste familjen e tij.

Por laku rreth tij po shtrëngohej gjithnjë e më shumë.

¹⁰ "Fortesa e Witold" duket të jetë e njëjta me "Fortesën Ordon", e bërë e njohur nga poema eponime e Adam Mickiewicz për rezistencën heroike [shënim i përkthyeses]

ARRESTIMI NGA POLICA SEKRETE KOMUNISTE POLAKE

Funksionarët e UB-së arrestuan Pilecki më 8 maj 1947 (ose ndoshta më 5 maj). Ai menjëherë iu nënshtrua hetimit jashtëzakonisht të egër, të mbikëqyrur personalisht nga koloneli Józef Różański - drejtori i Departamentit të Hetimit të Ministrisë së Sigurisë Publike (*Ministerstwo Bezpieczeństwa Publicznego*, MBP). Gjatë një prej pushimeve në seancë, Pilecki i rraskapitur i pëshpëriti gruas së tij: "Auschwitz nuk ishte asgjë në krahasim me këtë".

Disa nga akuzat e ngritura kundër Pilecki ishin: "gjatë periudhës nga korriku 1945 deri më 8 dhjetor 1945 në Itali dhe prej atëherë e tutje deri në ditën e arrestimit të tij, domethënë deri më 8 maj 1947, veproi në territorin Polak në dëm të Shtetit Polak si një agjent rezident i paguar i inteligjencës së huaj i drejtuar nga stafi i Ander Corps II dhe me urdhër të Ander ai organizoi një rrjet spiun në territorin Polak, duke rekrutuar personat e mëposhtëm për të punuar si informatorë: Tadeusz Szturm de Sztrem, Makary Sieradzki, Witold Różycki, Stanisława Skłodowska, Antoni Czajkowski dhe të tjerët; ai mbante kontakte personale organizative të vazhdueshme me të sipërpërmendurit dhe ka drejtuar veprimtarinë e tyre duke u dhënë udhëzime dhe urdhra, ai mbledhi në apartamentet komplotiste në Varshavë... informacione dhe dokumente që ishin sekret shtetëror dhe ushtarak të marra nga inteligjenca politike, ushtarake dhe ekonomike ... Nga nëntori 1946 deri në arrestimin e tij më 8 maj 1947 në Varshavë ai punoi në bashkëpunim me anëtarët e rrjetit spiun... - Tadeusz Płuzański, Leszek Kuchciński dhe Waclaw Alchimowicz - duke përgatitur një vrasje të dhunshme të funksionarëve të Ministrisë së Sigurisë Publike."

Rtm Witold Pilecki në dëshminë e tij para gjykatës, e mohoi akuzën e spiunazhit duke deklaruar: "Unë nuk isha një agjent rezident, por vetëm një oficer Polak. Unë isha vetëm duke iu bindur urdhrave të mia deri në arrestim. Unë nuk isha i vetëdijshëm se isha fajtor për spiunazh dhe kërkoj nga Ju i nderuar ta marrë këtë në konsideratë gjatë dhënies së dënimit."¹¹ Dënimi u bë i ditur në mesditë më 15 mars 1948. Rtm. Witold Pilecki, Maria Szelałowska dhe Tadeusz Płuzański u dënuan me vdekje; Makary Sieradzki mori burgim të përjetshëm, ndërsa të tjerët do të kalonin shumë vite në burg.

Pilecki i bëri kërkesë Presidentit Komunist të Polonisë Bolesław Bierut për falje. "Unë kam punuar për të mirën e Polonisë tërë jetën time. Kurrë nuk më shkoi në mendje që veprimtaria ime ishte spiunazh sepse nuk veprova për të mirën e një fuqie të huaj; i dërgova informacione çetës time polake."

Të dënuarit e tjerë me vdekje dhe mbrojtësit e tyre ndoqën shembullin e Pileckit. Bolesław Bierut ndryshoi dënimet me vdekje të Maria Szelałowska dhe Tadeusz Płuzański në burgim të përjetshëm, por ai nuk e fal Rtm. Witold Pilecki.

Dënimi u ekzekutua më 25 maj 1948 në burgun që ndodhet në Rrugën Rakowiecka Nr 37 në

¹¹ Në traditën ligjore polake, nuk ka juri gjyqësore, vendimi dhe dënimi merren gjykatësi ose trupi gjykoës [shënim i përkthyeses]

Varshavë. Ekzekutori ishte Kapter Śmietański. Kështu, shumë vite më vonë, At Jan Stępień - shok i burgut në Mokotów - përshkroi momentet e fundit të "vullnetarit për Auschwitz": “Nuk do ta harroj kurrë atë pamje. Dy të dënuar po shoqëroheshin. I pari që erdhi ishte Witold Pilecki. Goja e tij ishte lidhur me një shirit të bardhë. Dy roje po e mbanin nga krahet. Këmbët e tij mezi preknin tokën. Nuk e di nëse ai ishte i vetëdijshëm. Ai dukej të ishte krejtësisht i vetëdijshëm”.

Kujtimi i Rotmistrz Witold Pilecki nuk vdiq dhe vlerat e tij nuk u harruan, pavarësisht përpjekjeve të mëdha të komunistëve.

Pasi Polonia rifitoi pavarësinë në 1989, shumë fshatra dhe qytete në Poloni i vunë emrin shkollave, rrugëve, banesave dhe parqeve në nder të këtij njeriu të jashtëzakonshëm.

Pllaka që përkujtojnë "vullnetarin në Auschwitz" mund të shihen në muret e shumë vendeve të shenjta dhe kishave në Poloni. Është ngritur përkujtime gjithashtu dhe në vendin nga ku Witold Pilecki u largua vullnetarisht për tek "ferri në tokë" në 19 shtator 1940.

Më 1 tetor 1990 Rtm. Witold Pilecki dhe të dënuarit e tjerë u shfajësuan plotësisht - dënimi i turpshëm dhe penal i vitit 1948 u hoq plotësisht. Në korrik 2006 Presidenti Polak Lech Kaczyński dekoroi pas vdekjes Rtm. Witold Pilecki me Urdhri i Shqiponjës së Bardhë për meritat dhe përkushtimin e tij ndaj atdheut dhe më 7 maj 2008 Senati Polak miratoi një rezolutë për të rivendosur kujtesën popullore të heroit Rotmistrz Witold Pilecki në Poloni.

KONTRIBUT I INSTITUTIT TË KUJTESËS KOMBËTARE

DANUTA SIEDZIK was lindi më 3 shtator 1928 në fshatin Guszczewino në Poloninë veri-lindore. Ajo kishte dy motra. Babai i saj Waclaw ishte një pylltar. Në vitin 1940 ai u arrestua nga sovjetikët dhe u dëbua, për të mos u kthyer më në shtëpi. Pas arrestimit të Waclaw, familja u detyrua të linte kabinën e pylltarëve ku kishin jetuar. Mamaja e Danutës, Eugenia u bashkua me Ushtrinë Vendase, një lëvizje polake e rezistencës. Ajo u arrestua dhe u ekzekutua nga Gestapo në 1943. Danuta, nga ana tjetër, u bashkua me Ushtrinë Vendase. Pas hyrjes së Ushtrisë së Kuqe në Poloni, ajo u bë ndihmësmjete në një njësi të rezistencës anti-komuniste. Ajo u arrestua nga policia sekrete komuniste në qershor 1946. Në një gjyq teatral (dmth një proces gjyqësor i mbajtur para publikut me qëllim që më shumë të ndikojë ose kënaqë opinionin publik sesa të vërë drejtësi) ajo u akuzua në mënyrë të rreme për vrasje të funksionarëve të policisë sekrete dhe urdhërim të ushtarëve të tjerë. Ajo u dënua me vdekje dhe u ekzekutua nga skuadra e pushkatimit pa mbushur 18 vjeç.



KOLEKSION I INSTITUTIT
TË PËRKUJTESËS
KOMBËTARE

Danuta "Inka" Siedzik

Një Jetë e Re e Guximshme

shkruar nga Dr hab. Grzegorz Berendt

Pushtimi gjerman i ndjekur shpejt nga ai Sovjetik ndryshoi jetën e miliona qytetarëve të Republikës së Dytë Polake¹². Lufta përfshi një brez të ri të rinjsh të rritur në Poloninë e rilindur. Ata mësuan që në shkollë për luftën, betejat dhe sakrificën për vendin dhe për kombin.

Ata dëgjuan për të nga të afërmit dhe veteranët e tyre të luftës pro pavarësisë, gjatë takimeve familjare, festimeve të shumta patriotike dhe në organizatat e rinisë dhe të Kishës. Por në vitin 1939 dhe gjatë viteve që pasuan ata u përballën me sfida, ngjarje dramatike dhe lloje karakteresh të cilat nuk mund t'i imagjinonin. Dhjetëra mijëra prej tyre e kaluan provën që jeta u vuri përpara.

Danuta Siedzik, vajza e Waclaw dhe Eugenia née Tymińska, i përkiste brezit të të rinjve të rritur në një atmosferë pohimi të pavarësisë dhe krenarisë në shtetin e tyre. Danuta lindi më 3 shtator 1928 në fshatin Guszczewino në rrethin Bielsk Podlaski në rajonin e Podlasie. Babai i saj ishte një pylltar. Ai ishte dëbuar për veprimtarinë e tij anti-cariste, të cilën e filloi gjatë studimeve në Universitetin e Teknologjisë në Shën Petersburg. Ai nuk u kthye në Poloninë e pavarur deri në vitin 1926 dhe shpejt u martua me Eugenia-n. Vitin pasardhës lindi vajza e tyre e parë Wiesława, e ndjekur nga Danuta dhe Irena përkatësisht në 1928 dhe 1931. E gjithë familja jetonte në shtëpizën e pylltarëve Olchówka pranë Narewka. Atmosfera në shtëpi ishte e përshkruar nga patriotizmi falë përpjekjeve të prindërve dhe gjyshërve.

PUSHTIMI SOVJETIK

Pas 17 shtatorit 1939 atdheu i Siedziks ra nën pushtimin Sovjetik, kështu që përvojat e tyre të para të dhimbshme ishin shtypjet bolshevike. Waclaw u arrestua më 10 shkurt 1940 dhe duroi një hetim çnjerëzor. Pastaj ai bëri një punë rraskapitëse në një minierë ari. Pas nënshkrimit të një traktati midis Kryeministri Władysław Sikorski me qeverinë Sovjetike më 30 korrik 1941 (Marrëveshja Sikorski-Mayski), Waclaw Siedzik rifitoi lirinë e tij, së bashku me dhjetëra mijëra shtetas polakë të liruar nga kampe dhe burgje. Ai arriti të shkonte në një qendër të ushtrisë polake në BS. Pas disa muajsh u largua nga ajo "tokë çnjerëzore"

¹² Polonia midis Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore

dhe shkoi në Persi me transportet e para të trupave dhe civilëve. Fatkeqësisht, periudha e dëbimit e kishte lodhur dhe në qershor 1943 ndërroi jetë në Teheran. Familja mësoi për të gjitha këto vetëm pas luftës.

Pas arrestimit të burrit të saj, Eugenia dhe vajzat e saj u detyruan të linin shtëpizën e pylltarëve. Në prill 1940 Eugenia u vendos në fshatin Narewka dhe ishte atje kur gjermanët pushtuan BS qershor 1941. Ajo bë anëtare aktive e Ushtrisë Vendase (*Armia Krajowa*, AK), por fatkeqësisht Gestapo u informua për këtë. U arrestuar në 1943 dhe u torturua gjatë hetimeve. Ajo u përkeqësua nga tifoja dhe përfundoi në spitalin e burgut. Në shtator 1943, Eugenia u ekzekutua diku në një pyll afër qytetit Białystok, duke lënë jetime vajzat e saj adoleshente, për të cilat përkujdeseshin të afërmit e tyre.

Në Shjetor 1943 Wiesława dhe Danuta u bashkuan me Ushtrinë Vendase. Pak a shumë pas një viti, ata u dërguan në një kurs trainimi për paramedikë. Ata u bënë anëtarë aktivë të rrjetit të fshehtë AK, që kryesohej nga pylltari Stanisław Wołoncej (pseudonimi Konus) nga Narewka. Në tetor 1944 Danuta, e cila ishte vetëm 16 vjeç, ishte bërë një nëpunëse në inspektoratin e pyjeve në Narewka. Muajtë kaluan të mbushur me punë dhe veprimtari të fshehta.

Fakti që ushtria gjermane u dëbua nga Polonia, nuk do të thoshte se vendi rimori pavarësinë. Sovjetikët duke planifikuar të krijonin një shtet të ri të varur me një regjim të ri në Poloni, filluan të "likuidojnë" njerëzit dhe zonat që nuk pranonin shtetin e ri të punëve. Mbështetësit e Sovjetikëve ishin komunistë që para 1945 i përkisnin strukturave politike dhe ushtarake në varësi të Moskës. Ata do të bëheshin thelbi i kuadrove të shtetit të ri. Shumë shpejt ata rekrutuan mijëra karrieristë, të cilët u bashkuan me partinë në pushtet - Partinë e Punëtorëve të Polonisë (*Polska Partia Robotnicza*, PPR). Shkalla dhe intensiteti i terrorit kundër terrenit anti-sovjetik dhe pro-pavarësisë, patën një efekt të dyfishtë. Pas kasaphanës të Luftës së Dytë Botërore, shumica e polakëve miratuan një strategji të mbijetesës nën regjimin e ri: ata e sfiduan atë kryesisht përmes mbështetjes së partive të opozitës ligjore. Nga ana tjetër, mijëra ushtarë të nëntokës vazhduan aktivitetin e tyre dhe ruajtën gatishmërinë luftarake. Ata nuk mund të pranonin paligjshmërinë dhe pandëshkueshmërinë e forcave sovjetike të vendosura në Poloni dhe nuk e njohën autoritetin e qeverisë kukull Komuniste. Dukej se ende kishte një shans të rifitohej sovraniteti.

Brigada e 5-të Vilnius e Ushtrisë Vendase të fshehtë (ndonjëherë e quajtur "Brigada e Vdekjes"), komandohej nga një oficer i karrierës së paraluftës, major Zygmunt Szendzielarz (pseudonimi Łupaszko). Ajo luftoi në rajonin e Vilniusit kundër gjermanëve dhe nacionalistëve lituanëzë dhe më pas kundër sovjetikëve. Në korrik 1944 komandanti vendosi të transferojë forcat e mbetura për në territorin polak brenda kufijve të rinj. Në fund të asaj vere çeta kishte arritur në Podlasie, gjithashtu dhe çeta të tjera të ushtarëve të palëkundur po luftonin atje.

SHËNDRIMI NË "INKA"

Danuta Siedzikówna u bashkua me brigadën në rrethana dramatike në maj 1945. Zyra e Sigurisë Publike (*Urząd Bezpieczeństwa Publicznego*, UBP) kishte arrestuar të gjithë punonjësit e inspektoratit pyjor në Narewka, nën dyshimin e bashkëpunimit me nëntokën pro-pavarësisë. Ndërsa po transportoheshin për në Białystok, afër Hajnówka, autokolona u sulmua nga ushtarët e një patrulle të komanduar nga "Konus". Irena, më e vogla nga motrat Siedzik, ishte dëshmitare e asaj ngjarjeje. Duke mos pasur asgjë për të humbur, Danuta u bashkua me Brigadën e 5-të Vilnius të Ushtrisë Vendase. Ajo u bë ndihmësmjeke në skuadronin e komanduar nga Toger i 1-rë Marian Pluciński (pseudonimi Mścisław). Pseudonimi i saj i fshehtë "Inka" ishte një tregues për emrin e shoqes së saj të dashur.

Pas disa muajsh majori Szendzielarz urdhëroi që çeta të shpërndahej. Përqendrimi i fundit i të gjitha forcave u zhvillua në 7 shtator 1945, në shtëpinë e pylltarëve Stoczek në komunën Poświętne. Vetëm disa ushtarë mbetën në pyll. Inka ishte ndër ata që duhej të ktheheshin në jetën e ligjshme. Ajo shkoi në shkollën e mesme të tw rinjve në Nierosno, në komunën Dąbrowa Białostocka. Sipas dokumenteve të saj të mëvonshëm, ajo përfundoi dy vjet arsim të mesëm. Në gusht 1945, Qeveria e Përkohshme e Bashkimit Kombëtar (*Tymczasowy Rząd Jedności Narodowej*) shpalli një amnisti, megjithatë Inka vendosi të mos u tregonte autoriteteve komuniste kontaktet e saj me nëntokën.

Frika e ekspozimit nga Zyra e Sigurisë (*Urząd Bezpieczeństwa*, UB) e shtyu atë të fillonte punë në inspektoratin pyjor Miłomłyn pranë Ostróda, punë të cilën e gjeti me ndihmën e vjerrit të saj pylltar Stefan Obuchowicz. Filloi të punojë atje në janar 1946. E dëshmoi identitetin e saj me një dokument ndoshta të lëshuar nga Bordi Komunal në Białystok. Sipas dokumentit ajo ishte Danuta Ina Zalewska e lindur më 3 shtator 1928 në Wołkowysk. Në dokumenti gjithashtu deklarohet se në fund të luftës ajo kishte bërë punë të detyruar në Prusi, nga ku u kthye në 1945. Siç mund ta shohim, disa nga të dhënat e Danuta Siedzik u ruajtën, duke përfshirë emrin dhe datën e lindjes së saj.

Inka nuk punoi gjatë në Miłomłyn, sepse në fund të shkurtit ajo rinovoi kontaktin e saj me çetën, e cila ndërkohë kishte filluar të transferonte forcat e saj në provincën Olsztyn. U paraqit një plan për



Në skuadriljen e Żelazny (Hekuri), Verë 1946.

KOLEKSION I INSTITUTIT TË KUJTESËS KOMBËTARE

të filluar aktivitetin partizan në provincën Gdańsk. Ishte një nisëm e guximshme duke marrë parasysh faktin që anëtarët e çetës nuk njihnin as zonën dhe as popullsinë e saj. Ata do të ndihmoheshin nga të riatdhesuarit nga kufiri veri-lindor, të cilët kishin filluar të vendoseshin në Pomerania në pranverën e vitit 1945. Nëntoka konsideroi gjithashtu përdorimin e porteve detare si kanale komunikimi me polakët në Perëndim, të cilët ishin dëbuar për shkak të qëndrimit të tyre pro pavarësisë.

PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Vitet e para pas luftës, popullsia në qytetet e provincës Gdańsk ndryshoi në shkallë masive. Gjermanët po dëboheshin dhe vendin e tyre e zunë polakët, që vinin nga rajone të tjera të Polonisë së pasluftës dhe nga territoret e Republikës së Dytë të Polonisë që ishin përfshirë në BS. Dhjetëra mijëra njerëz u vendosën në Gdańsk Pomerania, Pomerania Perëndimore, Warmia dhe Masuria. Ishte një rrethanë e favorshme për ata që duhej të linin zonën ku njiheshin identiteti i tyre. Anëtarët pro pavarësisë të nëntokës mund të lëvizin në Gdańsk, Sopot, ose në qyteza dhe qytete të tjera të rrethit. Disa i dhanë fund veprimtarisë së tyre nëntokësore dhe u përpoqën të jetonin si civilë, ndërsa të tjerët vazhduan luftimet. Ata që ishin të lidhur me Brigadën e 5-të Vilnius të Ushtrisë Vendase mbërritën në Pomerania në 1945. Ngritën një rrjet pikash kontakti, të cilat do të ishin një pikë mbështetjeje për çetën.

Ndryshimet e popullsisë ishin më pak radikale në fshatrat e Gdańsk Pomerania sesa në qytezat dhe qytet e tij. Gjermanët u dëbuan edhe nga zonat rurale, por shumica e banorëve të tyre ishin polakë. Ushtria e Brendshme ishte në një pozitë të vështirë pasi nuk kishte gëzuar mbështetje masive në atë zonë. Organizata më e rëndësishme e fshehtë anti-gjermane në rajonin e Gdańsk (Pomerania), ishte Organizata Ushtarake nëntokësore "Pomeranian Griffin" (*Tajna Organizacja Wojskowa "Gryf Pomorski"*). Struktura organizative e "Griffin Pomeranez" ishte relativisht e dendur dhe gjatë viteve 1942-1945 ajo kishte dhe grupe të armatosura të fshehura në pyje. Organizata ndërpreu veprimtarinë në mars 1945, pasi komandantët e saj menduan se lufta e mëtejshme ishte e pamundur. Njëri prej tyre u bëri thirrje ushtarëve që të merren me rindërtimin e vendit.

Ushtarët e Ushtrisë së Kuqe, NKVD, përfaqësuesit e qeverisë së Varshavës, veçanërisht funksionarët e Zyrës së Sigurisë dhe aktivistëve të PPR, çuditërisht ndihmuan ata që dëshironin të luftonin kundër Sovjetikëve dhe regjimit Komunist në Pomerania. Ushtarët e Ushtrisë së Kuqe u sollën si fitimtarë në një territor të pushtuar. Ata bënë krime kundër popullatës civile jo vetëm gjatë operacioneve të vijës së frontit, por edhe për shumë muaj më pas. Këto krime nuk ishin vetëm kundër pakicës gjermane, por edhe kundër shumicës lokale polake. Përdhunimet, grabitjet, madje edhe vrasjet ishin të zakonshme. Disa prej përfaqësuesëve të regjimit të ri dinin pak për realitetin e pushtimit gjerman në territoret e përfshira në Rajh. Ata i trajtuan polakët që jetonin atje dhe që kishin qenë në Volksliste, si gjermanë etnikë të

urryer dhe renegatë që kishin ndihmuar pushtuesin, si njerëz me origjinë gjermane. Në fillim të regjimit të ri, Kashubianët dhe banorët e Kociewie (sllavët vendas) shpesh quheshin gjermanë ose aboriginë në raportet e mbikëqyrësve të rrethit UBP. Sipas përkufizimit ata u trajtuan si grupe që nuk mund t'u besohesh. Funkzionarët abuzuan me ligjin dhe nuk i pëlqyen vendasëve.

Faza e parë e organizimit të strukturave të reja AK në Pomerania, ishte transferimi i stafit të Rajonit AK Vilnius, që ndodhi në tetor 1945. Ushtarët e Brigadës së 5-të Vilnius të AK dhe komandanti i tyre erdhën në Pomerania pas disa javësh. Kur ushtarët e major Szendzielarz arritën në provincën Gda Gsk, ishin e vetmja çetë partizane atje. Vetëm 40-60 partizanë ishin në një gjendje gatishmërie luftarake. Në mënyrë që të vazhdonin aktivitetin e tyre, ata duhej të fitonin besimin e popullatës lokale dhe ta bindnin atë se ata u përpoqën për pavarësinë e Polonisë. Përndryshe ata nuk do të gjenin streha të sigurta ose nuk do të merrnin informacionin e duhur për të luftuar dhe për të shmangur kërkimet e organizuara nga bezpeka polake dhe sovjetike¹³. Kjo nuk ishte aspak e lehtë. Fillimisht popullata lokale nuk i besonte asnjë të huaji, se i druhej provokimit. Por gjatë gjithë gjashtë muajve kur skuadriljet e majorit "Łupaszka" operonte në Kaszuby, Kociewie dhe Powiśle (në rajonin e Gdańsk) jugor ata kishin mbështetje të vazhdueshme ose të përkohshme prej rreth 200 personash: fermerë, punonjës të shërbimit pyjor dhe punonjës të hekurudhave shtetërore polake.

Inka iu bashkua përsëri çetës në fillim të marsit 1946. Ajo u caktua në skuadriljen e komanduar nga Zdzisław Badocha (pseudonimi Żelazny) dhe u një ndihmës mjeke. Operacioni i skuadriljeve të major Łupaszka në provincën Gdańsk ishte shumë i guximshëm. Ata ishin në lëvizje të vazhdueshme - nga shkurti i vitit 1946 ata ndonjëherë qarkullonin me makina të nevojshme ushtarake, për të arritur në vendin ku do vepronin kundër Zyrës së Sigurisë (UB) dhe NKVD. Ushtarët çarmatosën stacionet e Milicisë Qytetare (*Milicja Obywatelska*, MO) dhe ndëshkuan funksionarët e saj, të cilët i njihnin se ishin shërbëtor komunist, të dëmshëm për popullsinë lokale. Funkzionarët e tjerë të MO nuk u dëmtuan. Anëtarët dhe informuesit tepër të zellshëm të PPR u sulmuan. Popullsia u informua për qëllimet e vërteta, natyrën e pranisë së Sovjetikëve në Poloni dhe për karakterin e regjimit Komunist. Burimet për të blerë

THE DEUTSCHE VOLKSLISTE (LISTA E POPULLSISË GJERMANE)

Pas sulmit në Poloni dhe pushtimit të një pjese të territorit të saj, Guvernatori i Rajhut në Wartheland Arthur Greiser lëshoi një dekret më 28 tetor 1939, sipas të cilit anëtarët lokalë të pakicës gjermane mund të kërkonin shtetësinë gjermane. Ata që ishin të interesuar të përfshiheshin në Deutsche Volksliste, do të ndaheshin në katër grupe sipas origjinës, aftësive gjuhësore dhe anëtarësisimit në organizatat politike. Bazuar në këtë, ata do t'u garantoheshin të drejta dhe privilegje, duke përfshirë racione të ndryshme ushqimore. Një qasje e ngjashme hyri në praktikë më vonë në territoret e tjera të pushtuara, veçanërisht në Ukrainë dhe Francë.

KUTI NJOFTIMI

¹³ Zyrë e Sigurisë Publike

ushqime dhe produkte të tjera të nevojshmerisë së përditshme, u përfituan përmes shpronësimeve. Vartësit e Łupaszka vepronin në grupe relativisht të vogla, zakonisht me rreth 20 ushtarë. Këto quheshin skuadrilje dhe kishin komandantë të rinj: Zdzisław Badocha (pseudonimi Żelazny), Olgierd Christa (pseudonimi Leszek) dhe Leon Smoleński (pseudonimi Zeus). Detyrat e tjera u kryen nga grupi i komanduar nga Feliks Salamowicz (pseudonimi Zagończyk).

Si anëtare e skuadriljes së Żelazny, Danuta "Inka" Siedzik mori pjesë për shembull në aksionin e trenit në stacionin Tleń, në rrethin Świecie, të zhvilluar më 4 maj 1946. Skuadrilja pas këtij aksioni u zhvendos në rrethin Tuchola. Veprimi më spektakolar u zhvillua në 19 maj, kur skuadrilja shkatërroi stafin e shtatë stacioneve MO dhe dy posteve të UB (policisë sekrete komuniste) në rrethet Kościerzyna dhe Starogard Gdański. Më 23 maj skuadrilja u përlesh me një njësi të MO pranë fshatit Podjazdy në rrethin Kościerzyna. Një funksionar i MO dhe një aktivist i UB u vranë, ndërsa tre funksionarë të MO u plagosën. Më vonë njëri prej tyre akuzoi Siedzikun, se kishte qëlluar me pistoletë drejt tij dhe se kishte marrë disa nga pajisjet ushtarake. Veprimtaria tjetër ishte më 10 qershor, kur Danuta me skuadriljen e saj morën pjesë në një përleshje afër fshatit Tulice në rrethin Sztum. Laelazny u plagos. Pasi kishin mundur funksionarët e MO dhe UB, Toger i 1-rë Olgierd Christa "Leszek" urdhëroi partizanët të ekzekutonin dy funksionarë të UB. Më vonë, ai incident u përdor gjithashtu kundër Inkës. Një nga veprimet e fundit, në të cilën ajo mori pjesë si një ndihmës mjeke e skuadriljes Żelazny, ishte prita në stacionin hekurudhor Bąk në rrethin Czersk më 24 qershor. Partizanët ndaluan një tren të linjës Gdynia – Katowice, për të kërkuar Sovjetikët. Pesë Sovjetikë u kapën dhe u pushkatuan. Inka u urdhërua të mbikëqyrte punonjësit e stacionit, në mënyrë që ata të mos përpiqeshin të paralajmëronin MO ose UB. Në fillim të majit Żelazny urdhëroi që asaj t'i jepej një Mauser kalibër 6.35.

Henryk Wojczyński (pseudonimi Mercedes) - një nga të paktët ushtarë me leje drejtimi - ishte i dashuri i saj gjatë operacionit të çetës në Pomerania. Aftësia e tij e çmuar erdhi në ndihmë kur çetës iu nevojiti të shkonte në vendet e reja të akomodimit dhe veprimit.

Lajmëtarët femra, të cilët mbanin urdhra të nevojshëm për të koordinuar funksionimin e skuadriljeve individuale, luajtën një rol jetësor. Është lehtësisht e imagjinueshme vështirësia e detyrës për ato gra, të cilat nuk ishin të njohura me rajonin Gdańsk, pasi ishin nga rajone të tjera të Polonisë. Ato kontaktuan me Kashubianët, të cilët flisnin gjuhën e tyre dhe me banorët Kociewie, të cilët kishin dialektin e tyre. Vendasit e dinin mirë se kishin të bënin me të sapoardhur. Inka u përball mirë me këto probleme të përditshme. Ajo arriti në vendet dhe njerëzit e përcaktuar, duke zbatuar urdhërat e epropolit të saj.

KAPJA DHE GJYQI

Misioni i fundit i Siedzik ishte një udhëtim në Malbork dhe Olsztyn, i urdhëruar nga zëvendësi i Żelazny - Toger i 1-rë Leszek (Żelazny tashmë kishte vdekur). Ndhmës mjekja duhte të merrte ilaçe shumë të nevojshme për çetën. Ajo u nis nga Gdańsk më 13 shkurt. Disa prej të njohurëve të saj jetonin

atje, duke përfshirë të afërmit e saj të ngushtë: motrën Irena dhe xhaxhain Bruno Tymiński - një student i Universitetit të Teknologjisë në Gdańsk. Inka qëndroi në banesën e motrave Mikołajewski në Gdańsk-rzeszcz në Wróblewskiego Nr. 7. Motrat Mikołajewski ishin nga Vilnius. Mbrëmja dhe nata nga 19 deri më 20 korrik kaluan në një atmosferë të gëzueshme, të mbushur me biseda dhe këngë. Por shtëpia ishte nën mbikëqyrje. Herët në mëngjes funksionarët e UBP hynë në apartament dhe arrestuan Inkën. Ndoshta nuk do të ishte e mundur, po të mos ishte tradhëtia nga ndihmësmjekja dhe lajmëtarja Regina Żychlińska-Modras. Pasi ishte kapur, Regina kishte vendosur të bashkëpunonte me bezpeka-n. Ajo kishte dhënë një dëshmi të hollësishme mbi çetën dhe kishte ekspozuar shumë njerëz.

Vendimi për vendosjen e "Ina Zalewska" në qendrën e paraburgimit në Gdańsk, lëshuar më 20 korrik nga prokurori publik ligjor Kapiten Adolf Brunicki ka mbijetuar. Dokumentet e 31 korrikut mbajnin tashmë mbiemrin e vërtetë të Danutës.

Zyrtarët hetues nga Zyra Provinciale e Sigurisë Publike (*Wojewódzki Urząd Bezpieczeństwa Publicznego*, WUBP) në Gdańsk, donin që Siedzik të dëshmonte për veprimtarinë e çetës të komanduar nga majori "Łupasza" dhe ndihmësit e tij. Ajo ishte kërcënuar, torturuar dhe poshtëruar.

Andrzej Stawicki, oficeri hetues i Gdańsk WUBP, përgatiti padinë njëmbëdhjetë ditë pas arrestimit. Më 31 korrik ai kërkoi dënimin me vdekje. Gjyqi do të zhvillohej në Gjykatën Rajonale Ushtarake në Gdańsk. Akuzat kryesore ishin: sulmi i supozuar i armatosur ndaj funksionarit të MO Longin Ratajczak, gjatë përlëshjes pranë fshatit Podjazdy dhe inkurajimi i vrasjes së funksionarëve të UB gjatë aksionit në Tulice. Një akuzë tjetër ishte armëmbajtja pa leje.

Më 2 gusht 1946 Józef Bik (shefi i Seksionit të Hetimeve të Gdańsk WUBP) i dërgoi një letër Prokurorit Ushtarak të Qarkut në Sopot. Ajo na thotë shumë për metodat e përdorura nga regjimi në atë kohë. Bik kërkoi një gjykim të shkurtuar: "Njëkohësisht, unë kërkoi që Kryetari i Drejtësisë të informohet se data e seancës do të jetë 3 gusht 1946, pasi dëshmitarët janë njoftuar për paraqitje në ditën e seancës, përmes mesazheve telefonike."

Gjykatësi lexoi aktakuzën e përgatitur nga WUBP gjatë seancës së parë, që siç rezultoi ishte dhe seanca e fundit. Inka nuk kishte mundësi të lexonte paraprakisht dokumentin. Ajo deklaroi se ishte e pafajshme për të shtënat në drejtim të funksionarit të MO dhe për nxitjen e vrasjes të funksionarit të UB. U lexuan dëshmitë e dëshmitarëve të prokurorisë që nuk u paraqitën, si dhe u lexuan dëshmitë që dhanë dëshmitarët e pranishëm. Pothuajse të gjithë dëshmuan kundër saj. Ajo nuk e mohoi që kishte qenë në çetë, dhe as që kishte mbajtur armë zjarri për disa javë në mënyrë të paligjshme. Pyetjet e bëra nga avokati sugjerojnë, që ai u përpoq të mbështeste vijën e mbrojtjes me pretendimin se klienti i tij ishte bashkuar në çetë, nuk kishte pasur trajnim ushtarak dhe nuk kishte marrë pjesë në operacionet ushtarake. Vetë Siedzik, rrëfeu vetëm për një operacion ushtarak dhe që po mbikëqyrte dhomën telegrafike në stacionin hekurudhor Bąk.

U lexuan më pas dëshmitë që dhanë dëshmitarët e prokurorisë. Pas kësaj, prokurori publik

paraqiti kërkesën që akuzat të konsideroheshin si të provuara dhe e akuzuara të denohej me vdekje. Proçedurat e përshkruara zgjatën vetëm dy orë. Në orën 6 të mbrëmjes, gjykatësit u tërhoqën për të diskutuar vendimin, të cilin ata e shpallën gjysmë ore më vonë. Ishte në përputhje me atë për të cilën kishte kërkuar prokurori publik - Inka u dënua me vdekje, humbje të përhershme të të drejtave civile publike dhe të drejtave të tjera, si dhe konfiskim të pronës së saj. Seanca përfundoi në orën 6.45 pasdite. Hetimi i shkurtër dhe një seancë dëgjimore në gjykatë, ishin të mjaftueshme për të deklaruar të miturën fajtores për veprimet, prej të cilave ajo vetëm për njërën deklaroi fajësinë. Duhet theksuar se Danuta Siedzik ishte e vetmja grua e dënuar me vdekje nga Gjykata e Rrethit Ushtarak Gdańsk. Arsytet e urrejtjes së hidhur të vrasësve të gjykatës staliniste mbeten të panjohura.

Avokati i caktuar nga gjykata kërkoi nga Presidenti i Këshillit Kombëtar të Shtetit Bolesław Bierut ta falte të dënuarën, duke theksuar se ishte e mitur dhe jetime, dhe se kishte qëndruar në çetë me insistimin e të fejuarit të saj. E dënuara nuk e nënshkroi lutjen. Bierut e refuzoi atë më 19 gusht 1946. Danuta priste ekzekutimin e dënimit në qendrën e paraburgimit në Rrugën Kurkowa prapa Gjykatës Rajonale Krahinore në Gdańsk.

Familjarët e saj morën një mesazh sekret të kontrabanduar nga qendra e paraburgimit. Ajo shkroi: «Jam e trishtuar që duhet të vdes. Thuaji gjyshes sime se bëra gjënë e duhur. »

Data e ekzekutimit ishte caktuar për 28 gusht 1946. Danuta Siedzik ishte ende e mitur. Momentet e saj të fundit i njohim nga dëshmia e At Marian Prusak, i cili u thirr për të kryer ritet e fundit tek ajo. Siedzik nuk vdiq e vetme. Një ushtar tjetër i palëkundur - Feliks Selmanowicz, pseudonimi Zagończyk - u ekzekutua me të. Ai ishte një ushtar profesionist i paraluftës, luftoi në mbrojtjen e Polonisë në 1939 dhe shërbeu në çetat nëntokësore pro-pavarësisë polake gjatë gjithë pushtimit.

Të dy të dënuarit u dërguan në bodrumin e qendrës së përmendur të paraburgimit. Prokurori major Wiktor Suchocki dhe mjeku Kapiten Mieczysław Rulkowski ishin të pranishëm. Dënimi do të ekzekutohej nga disa ushtarë me mitraloza nën komandën e Toger të 2-të Franciszek Sawicki. Disa funksionarë të UB-së qëndruan pas skuadrës së pushkatimit dhe abuzuan verbalisht të dënuarit. Një moment para vdekjes së tyre, ushtarët e patundur u bërtitën ekzekutorëve të tyre: "Rroftë Polonia!" Inka shtoi: "Rroftë Łupaszka!" U dha urdhri dhe u qëlluan. Zagończyk dhe Inka nuk vdiqën menjëherë. Komandanti i skuadrës së qitjes u dha fund jetës së tyre me të shtëna pistolete.

Ushtarët e majorit "Łupaszka" luftuan në Pomerania deri në fund të nëntorit 1946 dhe më pas u shpërndanë nëpër Poloni. Disa prej tyre, përfshirë edhe majorin, ranë në duart e UB-së.

Më 10 qershor 1991, Divizioni i 4-të Penal i Gjykatës Krahinore në Gdańsk lëshoi një vendim, që shfuqizon vendimin e marrë gjysmë shekulli më parë nga Gdańsk ËSR. Në Republikën Sovrane të Polonisë gjykata e konsideroi atë të pavlefshme, pasi Danuta Siedzik kishte luftuar për pavarësinë e Polonisë.

KONTRIBUT I INSTITUTIT TË KUJTESËS KOMBËTARE

GJERMANIA

Pas disfatës në Luftën e Parë Botërore, Gjermania vuajti krizën ekonomike botërore duke filluar në vitin 1929 dhe partitë radikale të djathta dhe radikale të majta radikale fituan mbështetjen e fortë publike gjatë zgjedhjeve.

REGJIMI NAZIST

Në 1933 udhëheqësi i Partisë të Punëtorëve Gjerman Nacional-Socialist (NSDAP), Adolf Hitler u emërua si kancelar. Brenda disa vitesh nazistët futën një diktaturë totalitare militante. Në vitin 1935, u miratuan ligjet raciste dhe filloi persekutimi i hebrenjve, i cili më pas çoi në holokaust. Një "Bosht" u krijua me Japoninë dhe Italinë në 1936. Gjermania aneksoi Austrinë në 1938 dhe shpërbëri Çekoslovakinë në 1939. Në gusht 1939 u nënshkrua një marrëveshje me Bashkimin Sovjetik dhe u ndanë "sferat e ndikimit" në EUROPËn Lindore. Në shtator 1939 Gjermania sulmoi Poloninë dhe filloi Lufta e Dytë Botërore. Në 1941, Hitleri sulmoi Bashkimin Sovjetik, i cili së bashku me Aleatët Perëndimorë, arritën të mposhtnin Gjermaninë naziste në 1945.

REGJIMI KOMUNIST NË GJERMANINË LINDORE

Pas Luftës së Dytë Botërore, Gjermania u nda në zonat e pushtuara të Bashkimit Sovjetik, SH.B.A., UK dhe Francës, përkatësisht. Në zonën sovjetike, Social Demokratët u bashkuan me komunistët dhe partia përfundimtare e krijuar, Partia e Bashkimit Socialist të Gjermanisë (SED), fitoi gjysmën e votave në zgjedhjet e 1946 dhe shumicën zgjedhjet e manipuluar të vitit 1949. Më 7 tetor 1949, u themelua Republika Demokratike Gjermane totalitare. Kryengritja punëtore në 1953 u shtyp nga ushtria sovjetike. Në 1961 u ndërtua

një mur përmes qytetit të ndarë të Berlinit, për të parandaluar arratisjen e gjermanëve për në Perëndim. Në 1989, ndodhi eksodi i qytetarëve përmes Hungarisë dhe ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Pragë, pasuar nga demonstrata të mëdha, që çuan në rënien e Murit të Berlinit në 9 nëntor 1989. Zgjedhjet e lira u mbajtën në mars 1990 dhe më 3 tetor 1990 Gjermania Lindore u ribashkua me Republikën Federale të Gjermanisë.



MARGARETE BLANK lindi më 21 shkurt 1901 në Kiev, i cili në atë kohë i përkiste Perandorisë Ruse. Prindërit e saj ishin gjermanë baltikë. Nëna e saj ishte dentiste dhe babai i saj inxhinier. Familja u transferua në Gjermani në 1919 dhe Margarete u bë qytetare gjermane në 1924.

Ajo studioi mjekësi dhe mori titullin e doktoraturës nga Fakulteti Mjekësor i Universitetit të Leipzigut në 1932.

Margarete ishte një mjeke e përkushtuar dhe gjithmonë i vinte pacientët e saj në radhë të parë. Ajo u denoncua nga një mjek tjetër në vitin 1944, për dyshimet e saj rreth "fitores përfundimtare" të Gjermanisë në Luftën e Dytë Botërore.

Ajo u dënua me vdekje për krimin e "korrupsionit të forcës ushtarake" dhe u ekzekutua më 8 shkurt 1945 në Dresden. Regjimi SED më vonë e stilizoi atë si një "luftëtare antifashiste", gjë që ajo nuk ishte. Ajo ishte një person i pavarur me një besim njerëzor.



ARKIVA SHITETËORE E SAXON,
ARKIVA SHITETËRORE LEIPZIG

Margarete Blank

Një Portret

shkruar nga Dr. Birgit Sack

Në gjashtë e dy minuta të mbrëmjes së 8 shkurtit 1945, mjekja Margarete Blank u ekzekutua me gijotinë në oborrin e ndërtesës të Gjykatës së Rrethit në Sheshin e Mynihut në Dresden. Së bashku me të, njëmbëdhjetë gra dhe burra të tjerë vdiqën në këtë ditë të fundit të ekzekutimit në këtë vend gjatë diktaturës Nacional-Socialiste. Pas kësaj, sulmet me bomba në Dresden shkatërruan aq shumë gijotinën dhe ndërtesat e drejtësisë në Sheshin e Mynihut, sa që makineria vrasëse nuk mund të vazhdonte. Më shumë se 1,300 njerëz kishin rënë viktime të saj midis 1933 dhe 1945 në Sheshin e Mynihut.

Kush ishte Margarete Blank dhe pse duhej të vdiste?

RINIA DHE TRAJNIMI

Margarete Blank lindi më 21 shkurt 1901 në Kiev, i cili atëherë pas i përkiste Perandorisë Ruse. Ajo ishte vajza e një dentisti dhe një inxhinierje. Prindërit e saj ishin gjermanë baltikë. Ata ishin pasardhës të emigrantëve gjermanë, të cilët u vendosën në provincat e Detit Baltik të Perandorisë Ruse. Margarete, vëllai dhe saj motra e më të mëdhenj morën një edukatë protestante të klasës së mesme; arritja dhe përpjekja për përparim luajti një rol të rëndësishëm në familje.

Pasi ndoqi shkollën në Kiev, Margarete Blank filloi të studioje në kolegjin lokal të grave. Nga fundi i Luftës së Parë Botërore punoi si përkthyesë për zyrat administrative të ushtrisë gjermane. Forcat e armatosura gjermane kishin marshuar në Kiev, nën traktatin e paqes Brest-Litovsk të vitit 1918 me Rusinë, në mënyrë që të detyronin qeverinë ruse të dorëzonte Ukrainën tek Rajhu Gjerman. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, trupat gjermane u tërhoqën nga Kiev. Të nxitur nga prindërit e tyre, Margarete dhe motra e saj Eleonore u larguan nga atdheu i tyre me trupat gjermane në dimrin e 1918/1919. Një luftë e re civile kishte shpërthyer midis ukrainasve që përpiqeshin për një shtet sovran dhe popullsisë ruse. Motrat Blank fillimisht shkuan në Kolberg (Pomerania Lindore)¹; ato morën mësimë private dhe u diplomuan në shkollën gramatikore lokale. Pastaj u zhvendosën në Leipzig. Vendimi i tyre për të lëvizur

¹ Sot Kołobrzeg në Poloni, një resort buzë detit jo larg nga kufiri gjerman

drejt qytetit tregtar të Saksonit, u bë ndoshta për shkak të faktit se vëllai i tyre avokat Herberti, ishte vendosur atje si përkthyes.

Nga ana profesionale, Margarete Blank ndoqi hapat e nënës së saj dhe u regjistrua për të studiuar mjekësi në Universitetin e Leipzig në maj 1921. Vëllai i saj e mbështeti atë financiarisht. Më 23 korrik 1923 Margarete kaloi provimin e ndërmjetëm mjekësor me notën e përgjithshme "shkëlqyeshëm". Pas përfundimit të dhjetë semestrave të studimit, ajo kaloi provimet shtetërore, përsëri duke fituar nota të larta. Margarete gjatë vitit të detyrueshëm të praktikës shërbeu në një poliklinikë gjinekologjike në Leipzig. Katër vite pas provimit të ndërmjetëm, mori licencën mjekësore. Më pas kaloi katër muaj si stazhiere mjekësore në Departamentin e Mjekësisë së Brendshme në Klinikën Universitare në Leipzig. Tetë muaj të tjerë vijuan në Departamentin e Kirurgjisë. Margarete më pas punoi për një vit tjetër në të njëjtën klinikë si mjeke praktikante. Në mënyrë që të mbante veten dhe motrën e saj që po studioje në atë kohë, ajo ndihmoi në zyrat e mjekëve praktikues, të cilët zbuluan se ajo i zëvendësonte shumë mirë. Një mjek në 1928 shkruajti: “Ajo është e aftë, e besueshme dhe e arsimuar mirë në kirurgji, obstetrikë, si dhe në mjekësinë e brendshme. Ajo pa dyshim ishte shumë e kërkuar nga pacientët.”

Në fund të viteve 1920, mjekja e re filloi të shkruajë tezën e saj të doktoraturës nën mbikëqyrjen e Henry Ernest Sigerist (1891-1957), i cili kishte qenë Shefi i Institutit për Historinë Mjekësore në Universitetin e Leipzig që nga viti 1925. Më në fund, në 1932, Margarete mori titullin e doktoraturës nga Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Leipzigut. Në disertacionin e saj ajo përktheu dhe komentoi një histori mjekësore, e cila ishte regjistruar në shkrime më të gjata shtjelluese nga mjeku holandez Herman Boerhaave (1668-1738).

NJË MJEKE E DEDIKUAR BASHKËSIE

Margarete Blank, ndërsa përgatiste tezën e saj të doktoraturës, ishte duke punuar në krijimin e jetesës së saj. Ajo tashmë kishte mbledhur përvojën e nevojshme profesionale, e cila ishte një parakusht për të filluar si mjek i përgjithshëm. Në vjeshtën e vitit 1928 ajo bleu një copë tokë jashtë Leipzigut dhe kishte ndërtuar një shtëpi të vogël prej druri. Në fund të janarit 1929 ajo dhe motra e saj u transferuan në shtëpinë në fshatin Panitzsch. Në nëntor 1929 këshilli vendor i Panitzsch dha pëlqimin e tij për vendbanimin e përhershëm të Margarete Blank si mjekja e parë zyrtare në bashkësi. Deri në atë kohë, një mjek nga Borsdorf fqinjë, kishte trajtuar kujdesin mjekësor të fëmijëve në Panitzsch dhe i cili kishte siguruar ndihmën e parë në rast aksidentesh. Për të qenë në gjendje të pajiste zyrën dhe për të siguruar jetesën e saj, Margarete duhej të vazhdonte ende të punonte si mjeke zëvendësuese për të tjerët. Rreth kësaj kohe, motra e saj braktisi studimet dhe vazhdoi të punonte si recepcioniste dhe shtëpiake në shtëpinë dhe zyrën e Margarete. Nga fundi i vitit 1929, kjo familje përfshinte gjithashtu dhe orientalistin Dr. Siegfried

Behrsing, burrin e ardhshëm të Eleonore Blank. Edhe ai ishte gjerman baltik. Rrethi i të majtëve-intelektual u formula dhe nga prania e ruso gjermanëve të tjere, miq të motrave.

Margarete Blank nuk kaloi shumë kohë duke u kujdesur për miqësitë e saj dhe lidhjet familjare. Ajo bëri një jetë të vetmuar, pas transferimit të Eleonore dhe Siegfried Behrsing në Berlin në fund të viteve 1930. Ajo gjithmonë vinte punën të parën.

Menjëherë pas fillimit të diktaturës nacional-socialiste, Margarete do kalonte përvojën e procedurës së rreptë të sundimtarëve të rinj, kundër racës "të ndryshme". Një dekret i ri në prill 1933 kërkonte, që të gjithë mjekët e punësuar të provonin prejardhjen e tyre "arjane". Në korrik 1933 Shoqata Zyrtare e Mjekëve e Leipzig, shfuqizoi licensën e Margarete Blank, sepse ajo nuk mundi të paraqiste dokumentet e kërkuara. Vendimi sidoqoftë u revokua në vjeshtën e të njëjtit vit, pas një apelimi nga Margarete, vendimi u revokua. U pranua se ajo nuk mund të siguronte një "provë arjane", për shkak të origjinës ruse gjermane të familjes së saj dhe se nuk kishte asnjë tregues të prejardhjes "jo-ariane".

Në vitin 1938 mjekja u vu përsëri nën vëzhgimin e regjimit. Këtë herë qëndrimi i saj politik ishte në gjyq. Rasti ishte një ankesë me shkrim nga Margarete Blank për përfaqësuesit e saj profesional,

zyrën rajonale në Leipzig e Shoqatës Zyrtare të Mjekëve të Gjermanisë. Ajo shkroi se "në rastet e aksidenteve, përpjekjeve për vetëvrasje dhe sëmundjeve të ngjashme që ndodhin në fshat, duhet të thirret një mjek tjetër që jeton diku tjetër dhe jo unë si mjeke rezidente". Kjo procedurë nuk ishte e zakonshme. Normalisht, në raste të tilla do të konsultohesh me mjekun rezident. Në fillim Shoqata Zyrtare e Mjekëve ndërhyri me kryebashkiakun e Panitzsch në favor të çështjes së drejtë të ngritur nga Margarete Blank. Kur kryetari i bashkisë i shprehu Shoqatës dyshime për besnikërinë e saj ndaj regjimit, Shoqata gjithashtu u distancua nga mjekja. "Ndoshta do kishte bërë më mirë mos ta ngrinte zërin aq shumë për disa raste të humbura". Kryebashkiaku kishte raportuar, se Margarete Blank nuk e përdorte përshëndetjen e Hitlerit dhe as kishte marrë pjesë në takimet e partisë. Për më tepër motra e saj kishte pasur kontakte me Partinë Komuniste në të kaluarën. Ky incident siç duket nuk pati pasoja të drejtpërdrejta politike për mjekun, e cila nuk i përkiste as Shoqatës Nacional Socialiste Gjermane të Mjekëve dhe as NSDAP. Kjo megjithatë tregon, se besnikëria e demonstruar në mënyrë aktive ndaj regjimit Nacional Socialist, ishte një parakusht që dikush të ishte në gjendje të mbronte interesat e arsyeshëm profesional.



Margarete Blank (e para majtas), Eleonore Blank dhe një shok i motrave, pas vitit 1930.

ARKIVA QËNDRORE E SAKSONISE, ARKIVA QËNDRORE LEIPZIG

PARTIA NACIONAL SOCIALISTE E PUNËTORËVE GJERMANË (NSDAP)

Partia Nacional Socialiste e Punëtorëve Gjermanë (Nationalsozialistische Deutsche Arbeiterpartei - NSDAP) ishte një parti politike e ekstremit të djathtë, që ekzistonte në vitet 1920-1945 në Gjermani. Parimet themelore të axhendës së saj përfshinin nacionalizmin ekstrem, antisemitizmin radikal, demagogjinë sociale, kritikën ndaj demokracisë përfaqësuese dhe refuzimin e marksizmit. NSDAP përdori radikalizmin pas Luftës së Parë Botërore dhe situatën e vështirë ekonomike. Struktura e partisë kishte një karakter ushtarak dhe bazohej në parimin e liderit. NSDAP u krijua në shkurt 1920 duke riemëruar Partinë e Punëtorëve Gjermanë (Deutsche Arbeiterpartei - DAP) e cila ishte themeluar një vit më parë në Mynih. Në korrik 1920, Adolf Hitler u ngrit në krye të NSDAP, ku gradualisht krijoi një pozicion udhëheqës. Partia vazhdoi të krijojë njësi paraushtarake (Sturmabteilung - SA, dhe Schutzstaffeln der NSDAP - SS), të cilat i përdori për të frikësuar kundërshtarët. Në 1923 ajo kreu një përpjekje të pasuksesshme grusht shteti në Mynih dhe u shpërbë për dy vite. Në fund të viteve 1920, rëndësia e saj filloi të rritet ndjeshëm pas shpërthimit të krizës ekonomike. Në zgjedhjet e vitit 1930 ajo u bë partia e dytë më e fortë. Në 1933, Hitleri u emërua Kancelar dhe NSDAP shpejt u bë partia e vetme ligjore. Kishte karakter totalitar. Anëtarësia e saj arriti në 3.9 milion njerëz deri në fund të vitit 1933. Pas Luftës së Dytë Botërore, NSDAP u ndalua dhe u klasifikua si një organizatë kriminale. Përfaqësuesit e saj u gjykuan në gjykimet e Nurembergut.

KUTI NJOFTIMI

ARRESTIMI

Më pak se një vit para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, më 14 korrik 1944, departamenti i policisë së shtetit Leipzig, Gestapo², arrestoi Margarete Blank si "spiune dhe agjente bolshevike". Arrestimi i cili ishte urdhëruar tashmë, u shty për një ditë sepse mjekja ishte e nevojshme për trajtimin e pacientëve me difteri.

Pse u arrestua ajo? Dr. Werner Benne i cili ishte mobilizuar në frontin Lindor në Rusi si një oficer i lartë mjekësor, e denoncoi atë në Gestapo gjatë pushimive të tij në shtëpi. Arsyja e denoncimit nga kolegu i saj, ishin deklaratat pro-ruse dhe kritike ndaj regjimit të bëra nga Margarete thënr gruasë së tij Erika, e cila informoi burrin e saj në lidhje me to në një letër drejtuar frontit. Këto deklarata ndodhën gjatë bëri një vizite të Margarete në shtëpinë e çiftit, kur kujdesej për fëmijët e tyre që ishin të sëmurë me kollë të mirë. Sipas dëshmisë së mëvonshme të Margarete Blank në gjykatë, të dy gratë po flisnin për origjinën e saj ruse. Erika Benne i kërkoi asaj më shumë informacion në lidhje me vendin dhe njerëzit. Do të ishte e pamundur të rindërtohej ekzaktësisht ajo çfarë Margarete Blank tha. Ajo, padyshim, shprehu hapur bindjen e saj për rusët si një popull paqedashës, i vetëdijshëm për vendin. Sipas Margarete Blank, vetë gjermanët duhej të fajësoheshin për bombardimet e qyteteve gjermane. Për më tepër, ajo parashikoi fundin e afërt të regjimit nazist.

Werner Benne i cili denoncoi Margarete Blank, gjatë kohës së lejes në shtëpisë, pranoi dhe miratoi përndjekjen e saj për arsye politike. Ky lloj denoncimi për sjellje të papëlqyeshme nga njerëz të rrethit i të denoncuarëve, ishte shumë shpesh shkaku i parë për fillimin e hetimeve. Gjatë diktaturës Nacional-Socialiste, kjo gjë ishte shumë e zakonshme dhe nxiti një klimë të përgjithshme

² Policia Sekrete Shtetërore, *Geheime Staatspolizei* shkurt Gestapo

mosbesimi.

Shumë informatorë përdorën denoncimin, për të rregulluar çështje të tyre personale. Ata u nxiteshin nga zilia ose hakmarrja. Presioni shoqëror gjithashtu luajti rol. Werner Benne, i cili e njihte vetëm pak ose ndoshta aspak Margarete Blank, me shumë gjasa veproi nga bindja politike. Besnikëria ndaj regjimit nazist e motivoi atë për të kryer veprimin e tij të mbrapshtë. Ai ndoshta u përkiste atyre ndjekësve "besimtarë" të Hitlerit, që nuk donin të pranonin fundin e afërt të regjimit dhe denoncin njerëzit që shprehnin vlerësime kritike ndaj regjimit, sepse ata vetë nuk mund ta duronin këtë "të vërtetë".


Pasi Werner Benne denoncoi Margarete Blank në Gestapo, udhëheqësi i grupit lokal të NSDAP në Panitzsch ndërmori hetime të mëtejshme. Udhëheqësja e shoqatës lokale të grave naziste Frieda Schnabel, e informoi atë se tre nga pacientët e Margarete Blank i kishin thënë asaj, se në vitet 1940 dhe 1942, mjekja kishte bërë deklarata miqësore ndaj Anglisë dhe Rusisë. Këto tre gra dhe Erika Benne, më vonë u shfaqën para Gjykata Popullore (Volksgerichtshof) si dëshmitare gjatë ndjekjes penale të Margarete Blank.

Pas arrestimit të saj, Margarete Blank u transferua nga burgu i policisë së Leipzig në burgun e hetuesisë në Rrugën Moltke të Leipzig. Gjatë kësaj kohe, gjëja e parë që ajo u përpoq të bënte ishte të siguronte kujdesin mjekësor për pacientët e saj dhe të organizonte punët e saj personale. Ajo i bëri kërkesë Shoqatës Zyrtare të Mjekëve nga burgu i Leipzig të lejohej të vazhdonte praktikën mjekësore. Pacientët e saj «në asnjë rast nuk mund të kalonin nën përkujdesen e përhershme të kolegëve të mbingarkuar nga vendet fqinjë». Megjithëse nuk ndihej “përgjegjëse për pasojat e mos-disponueshmërisë së saj”, ajo me mirësi u kërkoi atyre që “të zvogëlonin dëmet në popullatë sa më shumë që të ishte e mundur”. Sidoqoftë, në kundërshtim me lutjen e Margarete Blank, Shoqata nuk e mbrojti lirin e saj nga burgu, por përkundrazi në vendin e saj caktoi një mjek tjetër në mënyrë të përhershme.

Kërkesa për të mbështetur lirin e saj nga burgu tregon se ajo qartë nuk priste një dënim me vdekje. Në tetor 1944 ajo u transferua nga Leipzig në burgun hetimor në Dresden në rrugën Georg Bähr, pasi gjyqi i saj do të zhvillohej në ndërtesën e gjykatës ngjitur me burgun.

NDJEKJA PENALE

Instrumentet për ndjekjen penale të Margarete Blank iu përmbajtën dekretit të jashtëzakonshëm të ligjit penal të kohës së luftës të 17 gushtit 1938. Ai lidhet me veprën penale të "korrupsionit të forcës



Zyra e Margarete Blank, rreth vitit 1930.

ARKIVA QËNDRORE E SAKSONISE, ARKIVA QËNDRORE LEIPZIG



Margarete Blank, ca. 1940.

FRIENDS OF THE DR. MARGARETE BLANK HOUSE PANITZSCH
MEMORIAL

ushtarake". Sipas nenit 5 të këtij dekreti, i cili u përdor për të dënuar Margarete Blank, personat të cilët "u përpoqën publikisht të korruptonin ose të paralizonin vullnetin e popullit gjerman ose popujve aleat për t'u vetë-deklaruar me forcë", duhej të dënoheshin me vdekje. Formulimet shumë të paqarta janë karakteristike. Ato bënë të mundur klasifikimin e një numri të madh deklaratah si "korruptive". Për më tepër, u përdor një interpretim jo i zakonshëm dhe tepër i gjerë i termit "publik". Në aktakuzë u sugjerua se "duke marrë parasysh nivelin e saj të arsimit" ajo duhet të kishte pritur që deklaratat e saj do të përcilleshin në persona të tretë, që do të thotë se ajo ishte shprehur "publikisht".

Më 15 dhjetor 1944, Senati i 6-të i Gjykatës Popullore, i pranishëm në sallën e gjyqit të Gjykatës së Rrethit Dresden në Sheshin e Mynihut, dënoi Margarete Blank me vdekje dhe humbje të përhershme të të drejtave civile për "deklarata tepër korruptuese" ndaj një "gruaje gjermane burri i së cilës është në fushën e betejës". Gjykatësit pranuan se Margarete Blank ishte një "mjeke e njohur e aftë", e cila "me vetëmohim ndihmoi popullatën gjatë sulmeve terroriste". Sidoqoftë "Tradhtia e rëndë ndaj popullit gjerman, gjatë luftës së tij më të ashpër për fatin" anulloi "të gjitha meritat e të akuzuarës" dhe u kërkua "përfundimi

i saj nga bashkësia e popullit gjerman".

Qeveria nacional socialiste, edhe para se të nxirrte dekretin e jashtëzakonshëm të ligjit të kohës së luftës, i dënoi si vepra penale deklaratat kundër regjimit. Shumë pak pas marrjes së pushtetit nga Hitleri, regjimi penalizoi deklaratat "e pavërteta", të cilat pretendoheshin se dëmtonin Rajhun ose qeverinë, nëpërmjet të ashtuquajturit "dekret tradhtie" të marsit 1933. Çdokush mund të përfundonte në gjykatë vetëm se kishte thënë një shaka, ose për përhapje thashethemi.

Me fillimin e luftës, mendimet e shprehura kritike përndiqeshin më shpesh në bazë të dekretit e ri për "korrupsion i forcës ushtarake". Në ndryshim nga "tradhtia", ato shpesh dënoheshin me ekzekutim. Dënimi më i lartë që ju dha Margarete Blank, për deklaratat kritike të bëra në një bisedë tek për tek, nuk ishte përfundim. Fjalët e Margarete po dilnin të vërteta pas disfatës në Stalingrad në 1943, kur fitorja përfundimtare e luftës për Rajhun Gjerman ishte bërë gjithnjë e më e pamundur.

Në këtë kohë, lufta e regjimit u përqendrua veçanërisht kundër të ashtuquajturve "disfatistë". Termi u shpik gjatë Luftës së Parë Botërore në Francë. Ai përshkruan nxitjen sistematike të dëshpërimit, dorëheqjes dhe

dyshimeve për fitoren ushtarake në radhët e veta. Shuarja e zërave kritikë supozohej se do të shmangte dyshimet dhe pasiguritë, që ekzistonin edhe ndër nacional-socialistët e bindur për "fitoren përfundimtare". Në të njëjtën kohë, në sfondin e humbjeve ushtarake, bombardimeve intensifikuese dhe humbjes së të afërmeve të ngushtë, gjithnjë e më shumë njerëz po bënin deklaratat kritike ose pesimiste.

Shumica e denoncimeve politike u ndëshkuan nga autoritetet e partisë dhe Gestapo pa përfshirë gjyqësorin. Vetëm disa prej ankesave i kaluan prokurorit. Pse Margarete Blank përfundoi në gjyq? Dy arsye ndoshta ishin vendimtare. Dihej tashmë që Margarete Blank ishte armiqësore ndaj regjimit Nacional Socialist. Kjo u regjistrua në fund të viteve 1930. Për më tepër, luajti rol pozicioni i saj si mjeke. Si e tillë ajo ishte një nga njerëzit e shkolluar në fshat, mendimi i të cilës ndikonte të tjerët.

PËRBALLË VDEKJES

Pas marrjes së vendimit të dënimit me vdekje, Margarete Blank u vendos në një nga qelitë e vdekjes në krahun e grave të burgut të Dresdenit. Në të njëjtën qeli ndodhej dhe luftëtarja çeke e rezistencës Anna Pollertová (1899-1944). Sipas kujtimeve të Eleonore Behrsing, gjatë vizitave Margarete vazhdonte të ankohej për fatin e shoqes të saj të qelisë e cila "u dënua krejtësisht pa faj, sepse ajo kishte vepruar vetëm nga dashuria për atdheun e saj dhe që patjetër duhej ndihmuar".

Përballë vdekjes, ishte veçanërisht e dhimbshme për Margarete Blank që nuk mund të ushtronte profesionin e saj, i cili e kishte përmbushur. Në fillim të janarit 1945 ajo i tha ish recepsionistit të saj: "Kur hyj në dhomën e mjekut këtu [në burg], harrohem për një moment. Do ta kuptoni. "

Pas dënimit, Ministria e Drejtësisë e Rajhut nisi procedurën e detyrueshme të zbutjes së dënimit. Lutjet për mëshirë nga Eleonore Behrsing, gjithashtu dhe në emër të pacientëve dhe nga një fqinj ishin të pasuksesshme. Më 17 janar 1945 Ministri i Drejtësisë i Rajhut urdhëroi "ekzekutimin e dënimit nga autoriteti i Führer".

Në ditën e ekzekutimit të saj, 8 shkurt 1945, Margarete Blank falënderoi vëllain e saj në një letër lamtumire për mbështetjen e tij gjatë studimeve. Në këtë mënyrë ai e kishte "ndihmuar atë të kishte një jetë përmbushëse, vërtet të lumtur". Ajo kërkoi falje sepse ndonjëherë i kishte dhënë përparësi detyrës së saj ndaj pacientëve të sëmurë, më shumë sesa marrëdhëniet familjare.


Rreth tre javë pas ekzekutimit të saj Margarete Blank u varros në Varrezat e Shën Gjonit në Dresden.

Pas përfundimit të luftës eshtrat e saj u transferuan në Leipzig. Ajo gjeti prehjen e saj të fundit në një koriye nderi në Varrezat Jugore të Leipzig së bashku me "luftëtarë të shquar kundër Fashizmit" dhe "antifashistë dhe funksionarë të merituar të ndërtimit të socializmit në RDGJ".

PASOJAT

Gjatë ndjekjes penale të krimeve nacional-socialiste pas vitit 1945 në zonën e pushtimit Sovjetik, gjyqi i Margarete Blank u rishikua nga prokurori i shtetit. Meqenëse informuesi Werner Benne ishte shpallur i zhdukur, gruaja e tij Erika Benne dhe ish-udhëheqësja e Shoqatës së Grave Naziste Frieda Schnabel u desh të përballen me akuza në Gjykatën e Rrethit Leipzig në 1946. Gjyqi përfundoi me dënimin e të dy të akuzuarave me dënime të larta me burg, si "bashkëpunëtorë në kryerjen e një krimi kundër njerëzimit" - dhjetë vjet për Erika Benne dhe dymbëdhjetë vjet për Frieda Schnabel. Direktiva e Këshillit të Kontrollit Nr. 38, tetor 1945 ishte themeli ligjor për dënimin. Ai u lëshua nga Këshilli i Kontrollit Aleat, i cili u caktua nga forcat pushtuese pas përfundimit të luftës si autoriteti më i lartë qeverisës në Gjermani. Ndër të tjera, Direktiva përshkruan dënimin e Nacional Socialistëve dhe kriminelëve të luftës.

Erika Benne u akuzua se ia transmetoi deklaratat e Margarete Blank burrit të saj. Gjykata vlerësoi fajin e Frieda Schnabel në faktin, se ajo siguroi llogari të dëshmitarëve inkriminues pa qenë e detyruar ta bënte atë. Në mënyrë që të paraqitej akti si veçanërisht i dënueshëm, të dy gratë u akuzuan gjithashtu në mënyrë të pafavorshme bazuar në "personalitetin e mjekut që ra viktimë e vrasjes gjyqësore ... vlerat e larta etike dhe profesionale të të cilit qëndrojnë mbi çdo dyshim".



**Vendimi i Gjyqit Popullor kundër Margarete Blank
në 15 Dhjetor 1944, duke u dënuar me vdekje.**

ARKIVA FEDERALE, R 3001/159050

Erika Benne dhe Frieda Schnabel i përkisnin afërsisht 2500 personave që u dënuan midis 1945 dhe 1964 në zonën pushtuese Sovjetike, sepse ata i kishin shërbyer regjimit nazist si informator. Dënimet penale varionin midis dënimeve me burg prej një viti dhe pesëmbëdhjetë vjet për ndëshkime të rënda. Dënimet drastike normalisht jepeshin kundër spiunëve të paguar ose informatorëve të Gestapos, si dhe kundër njerëzve që kishin marrë pjesë në gjykime spektakolare në Gjykatën e Popullit.

Duke iu kundërvënë këtij trendi, Erika Benne dhe Frieda Schnabel u ndëshkuan relativisht ashpër. Paragrafi përkatës i Direktivës së Këshillit të Kontrollit Nr. 38, drejtohej kundër informatorëve që kishin filluar ose u përpoqën të fillonin procedurat. Rasti i të dyja grave nuk ishte kështu. Krijohet përshtypja se Erika Benne

u dënua në vend të burrit të saj. Në shqyrtimin e Frieda Schnabel, gjykata duke mos prova të mjaftueshme fajësimi, i dha peshë zyrove të saj në organizatat e NSDAP për të qenë në gjendje ta dënonte ashpër. Për më tepër, ne nuk mund të injorojmë si element në dënim, shfrytëzimin propagandistik dhe politikisht të procedurave. Në raportet gjyqësore bashkëkohore të dy të akuzuarat referohen si "vrasës të njerëzimit". Nga këndvështrimi i prokurorit të shtetit, procedimet kundër mjekes me vlera të larta të padyshimta si politikisht dhe moralisht, ishin të tregues perfekt të përshtatshëm për të demonstruar gatishmërinë e forcave të reja politike për të pastruar pa reshtur hesapet me Fashizmin e Hitlerit.

Regjimi SED më vonë e stilizoi Margarete Blank si një "luftëtare antifashiste të rezistencës", në mënyrë që të mundte ta integronte atë në konceptin e tyre të historisë. Regjimi përdori termin "luftëtar i rezistencës antifashiste" për të përshkruar komunistët të cilët pretendohet se ishin organizuar dhe udhëhequr nga komunistët gjermanë të mërguar nga Bashkimi Sovjetik për të luftuar diktaturën Nacional-Socialiste. GDR u pozicionua në traditën e luftëtarëve të rezistencës Komuniste nga e cila nxori pretendimin e saj për pushtet. Grupet dhe format e tjera të rezistencës dhe sfidës vështirë se u njohën.

Gjatë diktaturës Nacional-Socialiste njerëzit u persekutuan politikisht, u dënuan dhe u ekzekutuan jo vetëm se i rezistuan regjimit në një mënyrë aktive dhe të organizuar. Shumë u persekutuan thjesht për bindjet e tyre. Margarete Blank ishte njëra prej tyre, një mjekë e arrirë profesionalisht, e cila iu përkushtua pacientëve të saj përtej standardeve të zakonshme, duke e lënë veten të fundit. Megjithatë, drejt regjimit, ajo ishte e gatshme të shfaqte vetëm një minimum besnikërie formale. Ajo ishte vetëm e anëtarësuar në Mirëqenien e Popullit Nacional Socialist, por jo e NSDAP ose Shoqatës Nacional Socialiste Gjermane të Mjekëve. Të tjerët, të tillë si informuesi Werner Benne i cili mbështeti dhe kontribuoi në regjim, ishin të gatshëm të denonconin njerëz me mendime ndryshe, nxitur nga besnikëria ndaj regjimit. Që sjellja e tij ishte krejtësisht e mundur, u favorizua nga një klimë shoqërore ku kundërshtarët e pretenduar ose të vërtetë u veçuan dhe normat etike dhe tradicionale deri më tani të vlefshme, ishin zbratur ose mbivendosur me ideologjinë.

KONTRIBUT I FONDACIONIT PËRKUJTIMOR TË SAKSONISË PËR MEMORIEN E VIKTIMAVE TË TIRANISË POLITIKE

HEINZ BRANDT lindi më 16 gusht 1909, në qytetin e atëhershëm prusian të Posen (Poznań i sotëm, Poloni), në një familje hebreje gjermane. Nëna e tij ishte mësuese dhe babai i tij ishte shkrimtar dhe kritik arti. Në vitin 1926, Heinz u transferua në Berlin. Në 1928 ai u bë anëtar i Organizatës së Rinisë Komuniste dhe i grupit studentor Berlini Kuq, dhe në 1931 anëtar i Partisë Komuniste të Gjermanisë. Ai u burgos nën regjimin Nacional Socialist nga 1934 deri në 1945. Pas mosmarrëveshjeve politike dhe kërcënimeve për dëbim nga Partia Komuniste, ai u arratis në Gjermaninë Perëndimore në 1958.

Në 1961 ai u rrëmbye nga Sigurimi i Shtetit i Gjermanisë Lindore dhe u dërgua në Berlinin Lindor. Ai u dënua me 13 vjet burg dhe kaloi dy vjet në izolim deri në 1964, kur u lirua për në Perëndim pas një fushate ndërkombëtare. Ai vazhdoi të punojë për idealin e tij për një shoqëri më të mirë. Heinz Brandt vdiq më 8 janar 1986 në Frankfurt am Main.



KOLEKSIONI PRIVAT
I STEFAN BRANDT

Heinz Brandt

Në Rezistencë kundër Nacional Socializmit dhe Stalinizmit

shkruar nga Dr. Bert Pampel dhe Siegfried Reiprich

Heinz Brandt ishte një nga shumë njerëzit që u persekutuan për bindjen e tyre politike dhe rezistencën, si nga Nacional Socialistët ashtu edhe nga Komunistët. Ai mbijetoi burgjet dhe kampet nacional-socialiste Luckau, Brandenburg, Sachsenhausen, Auschwitz dhe Buchenwald. Më vonë, në GDR, ai u burgos në burgjet e Ministrisë për Sigurinë e Shtetit në Berlin-Hohenschönhausen dhe Bautzen. Përkundër të gjitha fatkeqësive dhe mësimëve të jetës ai mbeti mbrojtës i një shoqërie njerëzore, demokratike socialiste deri në vdekjen e tij.

FËMIJËRIA DHE RINIA

Heinz Brandt lindi më 16 gusht 1909 në qytetin e atëhershëm prusian të Posen (Poznań i sotëm, Poloni). Nëna e tij Gertrude Brandt (1879-1943) punoi si mësuese në kopësht dhe në shkollë. Siç ai shkroi më vonë, ajo e mësoi atë "të notonte kundër rrymës. Jo të përsëriste si papagall njerëzit që besuan se gjithçka 'nga lart'. Vetëm budallallëqet, gënjeshtat dhe krimi mund të priteshin nga lart ". Babai i tij Georg Brandt (1874-1940) ishte një shkrimtar dhe kritik arti.

Gjyshi i tij, Rabini Ludwig Krause, një studiues i mirënjohur i Talmudit dhe xhaxhai i psikanalistit të mëvonshëm Erich Fromm, ndikoi gjithashtu shumë mbi të. Ai rrënjosi tek Heinz një ide njerëzore, radikale dhe revolucionare të Judaizmit: "Të mos jesh skllav dhe të mos robërosh askënd ..." Në autobiografinë e tij *Ein Traum, der nicht entführbar ist* (Një ëndërr e cila nuk mund të rrëmbehet), ai hap një kapitull me një citim nga Manès Sperber's *Etre juif* (Të jesh hebre), i cili do të bëhej udhëzuesi i jetës së tij: "Unë kurrë nuk kam hasur në një ide, që do të më tejmbushte më shumë dhe do të përcaktonte rrugën time, aq shumë sa ideja se kjo botë nuk mund të qëndroj në mënyrën që është, se mund të bëhet krejtësisht ndryshe dhe se kështu do ta bëhet. "Së bashku me motrën e tij të vogël Lili dhe vëllezërit Richard dhe Wolfgang, ai u rrit në një shtëpi liberale të klasës së mesme kozmopolite, ku katolikët, protestantët dhe hebrenjtë u bënë bashkë me tolerancë dhe harmoni reciproke. Në Posen, Brandt dëshmoi shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, e cila u shndërrua në një përvojë dramatike dhe e udhëhoqi drejt bindjes se bota duhej të ndryshohej. Përvojat e fëmijërisë zhvilluan dëshirën e

madhe për informacion, vlerësimin e veçantë të dijes, të cilën ata që ishin në pushtet u përpoqën ta shtypnin, përbuzjen për njerëzit që thjesht përsërisin fjalët e të tjerëve dhe indinjatën për fshehjen dhe falsifikimin e informacionit.

Në vitin 1926, Heinz Brandt u transferua në Berlin. Ai ndoqi shkollën e mesme të Friedrichswerder, nga e cila u diplomua në 1928. Pas mbarimit të shkollës ai filloi studimet e tij për ekonomi politike në Berlin, por u përjashtua nga Universiteti i Berlinit për shkak të një dënimi me burgim. Si redaktor i gazetave "Betejat e Shkollës" dhe "Studentët e Kuq", për arsye politike iu dha një gjobë monetare, të cilën ai nuk e pagoi, por e shleu me burg.

Përvoja e krizës botërore ekonomike forcoi bindjen e Heinz Brandt, se situata shoqërore duhej të ndryshohej rrënjësisht. Në vitin 1928, ai u bë anëtar i Organizatës së Rinisë Komuniste dhe i grupit studentor të Berlinit të Kuq dhe në 1931 anëtar i Partisë Komuniste të Gjermanisë (KPD). Atëherë gjithçka iu duk e qartë; pikëpamja e tij komuniste për botën kishte themele të forta. Ai ishte i bindur në idenë e një shoqërie pa klasa, për çlirimin e njerëzimit nga shfrytëzimi, shtypja dhe lufta: "Nuk kishte asnjë dyshim, gjithçka ishte në rregull, ne ishim në rrugën e duhur".

Shumë shpejt filloi të kishte dyshime, pasi veprimtaritë e KPD-së nuk përputheshin më me idealet dhe qëllimet e tij. Ai kritikoi "politikën e pjesshme dorë-për-dorë", që ndoqi KPD-së Staliniste bashkë me Nacional Socialistët, kundër Republikës së Weimarit. Politika të cilat u demonstruan për shembull gjatë referendumit të vitit 1931, kundër qeverisë socialdemokrate Prusiane dhe gjatë grevës së Berlinit të punëtorëve të transportit në nëntor 1932. Ai u bë anëtar i fraksionit të paligjshëm të quajtur "Pajturesit" (*Versöhner*), duke anuar nga Bukharin dhe Trocki, të cilët kërkuan zëvendësimin e liderit të KPD Ernst Thälmann dhe bashkëpunim me Partinë Social Demokrate të Gjermanisë (SPD), në mënyrë që të parandalonin marrjen e pushtetit nga Nacional Socialistët.

Për shkak të lidhjes së tij me këtë grup, i cili u etiketua armiqësor ndaj partisë, ai u përjashtua nga zyrat e partisë - ai kishte qenë përgjegjës për propagandën politike për disa kohë. Bashkëluftëtari dhe shoku i tij në grupin e "Pajturesve" Heinrich Süßkind (emri i partisë Kurt Heinrich), më vonë ra viktimë e spastrimeve Staliniste në Bashkimin Sovjetik, ndërsa shoqja e tij e fushatës Anka Vikova u vra nga Nacional Socialistët.

PERSEKUTIMI GJATË NACIONAL SOCIALIZMIT

Heinz Brandt e cilësoi transferimin e pushtetit tek Hitleri më 30 janar 1933, si një disfatë të rëndë të lëvizjes punëtorëve dhe si drejtim stalinist në Gjermani. Në ndryshim nga shumë të tjerë, ai nuk kishte iluzione për sundimin e afërt të terrorit. Më 13 mars 1933 ai u rrëmbye nga SA një njësi paraushtarake e Nacional Socialistëve, dhe u dërgua në një bodrum torturash në Berlin-Weißensee. Ai u keqtrajtua rëndë, por më pas u la i lirë. Kjo nuk e pengoi të përfshihej kundër nacional-socialistëve si një bashkë-botues i gazetës ilegale të fabrikës komuniste Siemens-Lautsprecher (Altparlant Siemens).

Më 4 dhjetor 1934 ai u arrestua dhe më 15 mars 1935 u dënua me akuzën e "përgatitjes për tradhëti të lartë" me gjashtë vjet burg, të cilat i kreu në burgjet e Luckau dhe Brandenburg. Në burgun e Brandenburgut, të burgosurit komunistë hynë në diskutime të nxehta rreth Paktit Molotov-Ribbentrop. Heinz Brandt kritikoi traktatin si tradhëti ndaj socializmit, të krahasueshme me miratimin e huave të luftës më 1914 nga Social Demokratët gjermanë, që në këtë mënyrë kishin siguruar financimin e nevojshëm për shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. Mosmarrëveshjet e vazhdueshme në burg midis Komunistëve të Partisë Staliniste dhe "Pajtusve" çuan në prishje të solidaritetit të tyre të ndërsjellë, i cili vinte si pasojë e burgosjes së dy palëve nga Nacional-Socialistët. Në Brandenburg Heinz Brandt gjithashtu mësoi, se prindërit dhe vëllai i tij i vogël Wolfgang ishin dëbuar si hebrenj nga Posen për në afërsi të qytetit të Lublinit. Kushtet e jetesës atje ishin katastrofike për hebrenjtë. Babai i tij u sëmur dhe vdiq nga pneumonia në janar 1940 dhe vëllai i tij Wolfgang vdiq në 1942. Nëna e tij ishte i vvarë në Auschwitz në 1943.

Ndryshe nga të akuzuarit e tjerë, që u dënuan së bashku me të në gjyqin e vitit 1935, Heinz Brandt nuk u la i lirë më 8 dhjetor 1940 pas mbarimit të 6 viteve burgim. Në vend të kësaj, në shkurt 1941 u dërgua në "mbikëqyrjen parandaluese" në kampin e përqendrimit Sachsenhausen. Në burg dhe në kampin e përqendrimit ai takoi shokë të cilët kishin kërkuar strehim në Bashkimin Sovjetik, por Stalini i kishte dorëzuar te Nacional Socialistët. Kjo ishte një përvojë tronditëse për të: "Gjithçka filloi të më rrotullohej para syve. Bota për të cilën kisha ëndërruar nuk gjendej askund. Unë kisha besuar deri atëherë se e Reja ishte ngritur tashmë, duke i hapur derën Humanizmit, por gjithçka që pashë tani ishte errësira". Vetëm shumë më vonë Heinz Brandt mësoi se edhe vëllai i tij Richard kishte rënë viktimë e terrorit stalinist në Bashkimin Sovjetik dhe se motra e tij Lili jetonte në dëbim në Siberi. Përvoja e hidhur e jetës, bëri që Brandt të njihnte se midis Fashizmit dhe Stalinizmit kishte një analogji të pjesshme, pavarësisht se rrënjët e tyre shoqërore dhe ideologjike ishin të ndryshme.

Në tetor 1942 të gjithë të burgosurit hebrenj u morën nga kampi i përqendrimit Sachsenhausen për në kampin e përqendrimit Auschwitz. Heinz Brandt përfundoi në nën kampin Budy. Ai mbijetoi vetëm falë rrethanave fatlume dhe ndihmës nga miqtë. Në kamp, ai vazhdoi rezistencën e tij kundër Nacional

REPUBLIKA E WEIMAR-IT

Ky term përdoret për të përshkruar shtetin federal gjerman, i cili ekzistoi midis rënies së perandorisë dhe shpalljes së republikës në nëntor 1918 dhe ngritjes së nazistëve në pushtet në 1933. Emri rrjedh nga qyteti gjerman i Weimar, ku në shkurt 1919 u mbledh Parlamenti i sapozgjedhur. Republika e Weimar u konsiderua pasardhëse e monarkisë së mposhtur nga aleatët fitimtarë (kushtet e dëmshpërblimeve u përcaktuan nga Traktati i Versajës). Rrethanat e krijimit të kësaj republike të re, të kombinuara me krizën pasuese ekonomike botërore dhe largimin e shumicës së shoqërisë së asaj periudhe nga parimet e demokracisë përfaqësuese, ndikuan negativisht në stabilitetin e saj dhe çuan në rënien e saj. Sistemi politik i Republikës së Weimarit u dobësua ndjeshëm nga veprimtaria e dy partive politike ekstremiste masive, komunistëve dhe nazistëve, përfaqësuesit e të cilave përdorën në mënyra të ndryshme nostalgjinë për drejtimin nga një dorë e hekurt. Nga ana tjetër, Republika e Weimar u shoqërua me një lulëzim të kulturës, veçanërisht në Berlin.

Socialistëve në një grup të paligjshëm. Së bashku me të tjerët, ai shkroi mesazhe të fshehta të cilat kishin për qëllim të informonin publikun në Perëndim për gjenocidin. Mesazhet u nxorën kontrabandë jashtë kampit, e punëtorëve civilë polakë. Pas shpërbërjes të kampit të përqendrimit Auschwitz në janar 1945, ai u dërgua në një marshim vdekjeje në këmbë dhe me kamionçinë bagëtish, në kampin e përqendrimit Buchenwald, ku arriti gjysmë i vdekur më 23 janar 1945. Ai mbijetoi vetëm falë mbështetjes së të burgosurve të tjerë politikë që e furnizuan me ushqim shtesë. Më 11 prill 1945, ndërsa trupat Amerikane iu afruan kampit dhe SS filluan të iknin për të shpëtuar, ai mori pjesë në kryengritjen e Komitetit Ndërkombëtar të Kampit, mbas së cilës të burgosurit morën kontrollin e kampit.

Në autobiografinë e tij, Heinz Brandt përmbledh fatin e tij të persekutimit nën Nacional Socializmin midis 4 dhjetorit 1934 dhe 11 prillit 1945 - 3.778 netë - nga një këndvështrim thellësisht personal dhe njerëzor, gjë që e bën të qartë pa dyshim se çfarë do të thoshte kjo kohë për të: Secila prej këtyre netëve ishte një natë pa dashuri. Në moshën 25 vjeç, unë u dërgova në burg - në moshën 35 vjeç, po largohem nga kampi i përqendrimit. Kam kaluar dhjetë vjet pa vajzë, kam jetuar dhjetë vjet pa krahët e butë të një gruaje dhe ato ishin vitet në të cilat rinia, burri përvlohet nga etja për dashuri, për çlirim seksual.”

PERSEKUTIMI NË GDR

Menjëherë pas çlirimit nga kampi i përqendrimit Heinz Brandt së bashku me tre shokë morën rrugën për në Berlin. Gjatë rrugës, ata dhe të kapurit e SS, u mbajtën për pak kohë nga trupat sovjetike në paraburgim



Heinz Brandt (majtas) në një konferencë shtypi të IG-Metall pas lirim të tij në 1964.

KOLEKSIONI PRIVAT I STEFAN BRANDT

në një bodrum. Më vonë ai mësoi se kishin qenë me fat, pasi të burgosurit e tjerë hebrenj të liruar nga kampi i përqendrimit Buchenwald, u dëbuan si "spiunë amerikanë" në kampin special sovjetik Sachsenhausen, i cili tani drejtohej nga policia sekrete Sovjetike. Në një fazë të hershme - në verën e vitit 1946 - një ish-bashkëluftëtar nga ditët e Republikës së Weimar, u përpoq ta bindte atë të transferohej në Gjermaninë Perëndimore, sepse herët a vonë komunistët gjermanë stalinistë në Gjermaninë Lindore do ta shpallnin armik. Por Heinz qëndroi në Berlin, ai punoi për administratën e qytetit dhe me ish të burgosurit e tjerë të kampit të përqendrimit themeloi Komisionin Kryesor të Berlinit "Viktimat e Fashizmit". Më 1 dhjetor 1945 ai u bë shefi i departamentit të shtypit të KPD në Berlin dhe më vonë

sekretar i udhëheqjes së rrethit Berlin të SED, që përgjigjej për propagandën politike. Pas një martesë që mbijetoi vetëm një vit dhe përfundoi në divorc në 1947, ai u martua përsëri në qershor 1949. Martesa me Annelie (se) zgjati deri në vdekjen e tij. Ata patën dy fëmijë.

Në prill 1946, KPD dhe SPD u bashkuan për të formuar Partinë e Bashkimit Socialist të Gjermanisë (SED). Brandt në atë kohë nuk e shihte një bashkim të detyruar, siç u pa nga kritikët e saj të atëhershëm dhe siç shihet nga shumica e historianëve të sotshëm, për të ishte një hap logjik dhe një mësim i nxjerrë nga përçarja e lëvizjes së punëtorëve në Republikën e Weimar. Shumë shpejt megjithatë komunistët, të cilët kishin emigruar në Bashkimin Sovjetik gjatë diktaturës Nacional-Socialiste dhe që u kishin mbijetuar spastrimeve të Stalinit duke demonstruar besnikëri të pakushtëzuar ndaj tij, eliminuan demokracinë brenda partisë dhe e kthyen SED në një parti të kuadrit stalinist. Kushdo që u priste rrugën u burgos. Gjyqet teatrale Staliniste kundër "Titistëve", "Agjentëve" dhe "Kozmopolitëve" në fillim të viteve 1950, veçanërisht gjykimi i Slánský në Çekoslovaki, shqetësuan Heinz Brandt sepse shumë nga njerëzit që po përballen tani me gjykimet, në vitet 1930 i përkisnin "Pajtusëve". Rreziku për të u bë edhe më i madh në fillim të vitit 1953, kur anëtarët hebrenj të SED do të shqyrtoheshin si armiq të mundshëm të klasës. Vdekja e Stalinit, për të cilën Brandt besonte se ishte një "revolucion i pallatit"³, e zvogëloi rrezikun fillimisht. Brandt shpresonte për një zëvendësim të shefit të SED Walter Ulbricht, i cili ishte regjenti i Stalinit në GDR dhe për një fillim të ri demokratik. Megjithatë, të gjitha shpresat u shpërbënë; Ulbricht nuk ra me Stalinin, ai mbeti në detyrë.

Më 16 qershor 1953 në Berlinin Lindor, punëtorët e ndërtimit marshuan për në selinë e qeverisë, që të paraqitnin kërkesën e tyre të shfuqizimit të normave të larta të punës. Me mijëra njerëz iu bashkuan atyre në mënyrë spontane dhe zgjeruan kërkesat nga ekonomike në politike: "Ne duam të jemi njerëz të lirë dhe jo skllevër", "Zgjedhje të lira", dhe "Mjekra me majë duhet të iki". Ky ishte pseudonimi popullor për shefin me mjekër të SED Walter Ulbricht. Tërheqja e ngutshme e normave të rritura të punës bazuar në një kërkesë të Heinz Brandt drejt politikës së SED, nuk mund ta ndalonte më kryengritjen në zhvillim. "Punëtorët u ngritën kundër shtetit të punëtorëve dhe fshatarëve". Gjatë natës, rebelimi i Berlinit u zhvillua në një kryengritje popullor mbarëkombëtare të popullit. Tanket sovjetike megjithatë arritën ta shuanin atë më 17 qershor 1953. Brandt i cili u befasua dhe vetë nga kryengritjen e popullit të 17 qershorit 1953 në GDR, e konsideroi atë një tragjedi. Ai u simpatizua me kryengritësit, megjithatë sipas mendimit të tij, ata me veprimin e tyre kishin anuluar në mënyrë të pakthyeshme shpresën për ndryshim shoqëror, si rezultat ekstremistët në Partinë Komuniste konfirmuan pushtetin e tyre, ndërsa "reformistët" në Moskë dhe Berlinin Lindor humbën zyrat e tyre, lirine apo edhe jetët. Në gusht 1953, si rezultat i spastrimeve, Brandt u largua nga pozicioni i tij drejtues në parti dhe u vendos në një departament për punën e SED të Berlinit Perëndimor. Në 1954 e transferuan në shtëpinë botuese "Ekonomia" (*Die Wirtschaft*) ku u bë kryeredaktor.

³ Një grusht shteti nga ata që ishin në pozitia drejtuese [shënim i botuesve]

ARRATISJA DHE RRËMBIMI NGA STASI

Zbulimi i krimeve të Stalinit në Kongresin e 20-të të Partisë Komuniste në Moskë në shkurt 1956, humbja e reformatorëve hungarezë dhe polakë dhe përforcimi i ripërtërirë i pozitës së pushtetit të Ulbrichtit, rezultuan në një largim përfundimtar nga Komunizmi Sovjetik. Heinz Brandt kërkoi të kishte pasoja edhe brenda SED, ndër të tjera kërkoi zëvendësimin e Walter Ulbricht dhe të Ministres së Drejtësisë Hilde Benjamin. Në vitin 1956 vendosi kontakte me "zyrën Lindore" të SPD në Gjermaninë Perëndimore dhe u raportoi atyre për tendencat e opozitës në GDR. Në shtator 1958 bashkë me gruan dhe fëmijët e tij u arratis në Berlinin Perëndimor, pasi mori një paralajmërim rreth kërcënimit të debimit nga partia të pasuar nga një arrestim. Në vitin 1959, Brandt u transferua në Frankfurt am Main dhe u bë redaktor i revistës sindikaliste Metall (Metal). Më vonë, ai u bashkua me SPD.

Sigurimi i Shtetit, policia sekrete e SED Komuniste, filluan menjëherë përgatitjen e masave kundër "tradhtarit". Më 16 qershor 1961 me urdhër të drejtpërdrejtë të Ministrit të Sigurimit të Shtetit Erich Mielke, u rrëmbye me forcë nga Berlini Perëndimor në pjesën Lindore të qytetit, pasi një i njohur i ri i administroi fshehurazi një lëndë narkotike. Njeriu që luajti rol të rëndësishëm në këtë ishte Hans Beyerlein, një mik dhe fqinj i familjes Brandt në Frankfurt të Main. Nëpunësi në departamentin për anëtarët e këshillit të punëtorëve dhe për personat e besueshëm të ndërmarrjes IG Metall, punonte për Sigurimin e Shtetit të GDR.

Në paraburgimin e burgut të Ministrisë së Sigurimit të Shtetit në Berlin-Hohenschönhausen Brandt u mor në pyetje për muaj të tërë. Ata ofruan ta lirojnë nëse ai do të pranonte gabimet e tij politike dhe të deklaronte se ishte kthyer në GDRD me vullnetin e tij të lirë. Heinz Brandt refuzoi propozimet e tyre.



Heinz Brandt, 1973.

KOLEKSIONI PRIVAT I STEFAN BRANDT

Më 10 maj 1962 ai u dënua me 13 vjet burg në një gjyq të fshehtë në Gjykatën e Lartë të GDR. Bashkë me të u dënuan dhe dy ish-bashkëluftëtarë të tjerë SED, të cilët ishin persekutuar gjatë kohës së Nacional Socializmit me akuzën e "spiunazhit të rëndë në koincidencë me propagandën dhe agjitacionin shtet-kërcënues në rrethanë rënduse". Midis 27 korrik 1962 dhe 20 maj 1964, Brandt u burgos në izolim në burgun special të Sigurimit të Shtetit në Bautzen. Burgosja e tij në një qeli të vetmuar i krijoi një krizë nervore. Ai në mënyrë të përsëritur kishte makthe të rënda në gjumë, ku shihte për burgosjen e tij në kampin e përqendrimit.

Lirimi i tij më 23 maj 1964 u arrit kryesisht falë një fushate solidariteti ndërkombëtar në të cilën morën pjesë sindikatat, filozofi britanik Bertrand Russell, Amnistia Ndërkombëtare, si dhe Komitetet Ndërkombëtare të Kampit të Auschwitz dhe Buchenwald.

KTHIMI NË PERËNDIM

Pas lirimit të tij Brandt vazhdoi punën si redaktor i gazetës IG-Metall derisa doli në pension. Në vitin 1967 autobiografia e jetës së tij *Ein Traum, der nicht entführbar ist. Mein Weg zwischen Ost und West* (Një ëndërr që nuk mund të rrëmbëhet. Udhëtimi im midis Lindjes dhe Perëndimit) u botua nga Paul List Verlag, Mynih. Brandt vazhdoi fushatën për një socializëm demokratik, duke kritikuar të majtën për qëndrimin e saj pozitiv ndaj Bashkimit Sovjetik. Ai gjithashtu kritikoi antifashizmin e majtë: "vetëm ata që mbrojnë kudo të drejtat themelore dhe dinjitetin njerëzor, demokracinë dhe lirinë mund të jenë anti-nacional socialistë të besueshëm". Brandt kërkoi një "rrugë të tretë" midis kapitalizmit perëndimor dhe sistemit komunist, duke e klasifikuar këtë të fundit qartë si një sistem shfrytëzimi. Që prej vitit 1961 ai u përfshi në aktivitete kundër energjisë bërthamore dhe militarizimit, më vonë ai mori pjesë në bllokadat e uljes (protestë ku qëndron ulur, për të paralizuar punën) në Gorleben dhe bashkëpunoi në themelimin e partisë "Të Gjelbrit" (*Die Grünen*). Shpejt u largua nga partia, për shkak se u desh shumë një qëndrim jokritik ndaj Komunizmit, si për të kaluarën dhe të tashmen dhe sipas mendimit të tij ajo u zhvillua në një "parti të kuadrit të majtë". Idealisti komunist i dikurshëm dhe më vonë Komunist i partisë, i cili adhuronte vizionin Utopik u rrit në një socialist të përkushtuar, por realist: "Ne mbrojmë diçka që mund të mos ketë sukses, e cila mund të shkojë keq. Ne veprojmë edhe pse e dimë që sukcesi është i dyshimtë dhe sepse e dimë që - nëse ka ndonjë sukses - sukcesi mund të arrihet vetëm me këtë aktrim tonin. Ne nuk kemi më shumë se një shans dhe varet nga ne nëse e përdorim atë." Edhe një herë duket se kemi dëgjuar Heinz Brandt kur citon Manès Sperber me fjalët: "Unë jam një revolucionar i vjetër që i kam qëndruar besnik shpresave që i është dashur të varrosë."⁴ Heinz Brandt vdiq më 8 janar 1986 në Frankfurt am Main. Me kërkesën e Brandt, nuk ka vendvarrim të tij, ashtu siç nuk ka për prindërit e tij të vrarë nga Nacional Socialistët, ose për vëllain e tij të vrarë nga ithtarët e Stalinit.

Që nga 17 qershori 1999, një shkollë e mesme në Berlin-Weißensee mbanë emrin e tij. Në ish-rripin kufitar të Murit të Berlinit, në periferi të zonës industriale Pankow-Park, një rrugë mori emrin e tij.

□ LEXIMI I MËTEJSHËM:

Knud Andresen: Widerspruch als Lebensprinzip: der undogmatische Sozialist Heinz Brandt (1909-1986), Dietz, Bonn, 2007. Manfred Wilke: Heinz Brandt - në Selbstzeugnissen, në: Wege nach Bautzen II. Biographische und autobiographische Porträts, Dresden 2003. Förderverein der Heinz-Brandt-Oberschule Berlin: Heinz Brandt. Eine Skizze seines Lebens, Berlin, 2004.

KONTRIBUT I FONDACIONIT PËRKUJTIMOR TË SAKSONISË PËR MEMORIEN E VIKTIMAVE TË TIRANISË POLITIKE

⁴ Të gjitha kuotat e cituara janë marrë nga botimi i zgjeruar i përshkrimit të jetës së Brandt "Ein Traum, der nicht entführbar ist. Mein Weg zwischen Ost und West", Fischer Taschenbuch Verlag, Frankfurt am Main, 1985.

AUSTRIA



Perandoria Austro-Hungareze u mund në Luftën e Parë Botërore dhe në ish territorin e saj u themeluan shtetet e Çekosllovakisë, Hungarisë dhe Austrisë. Bashkimi Austriak me Gjermaninë ishte i ndaluar sipas një prej traktateve të Versajës të vitit 1919.

REGJIMI NAZIST

Austria nuk ishte në gjendje të stabilizonte shoqërinë e saj dhe në 1933 Kancelari Dollfuß vendosi një regjim autoritar. Në vitin 1934, ai u vra në një përpjekje naziste për grusht shteti. Në 1936, Kancelari Schuschnigg pranoi një marrëveshje me Gjermaninë, duke adoptuar anëtarë të partisë naziste në qeverinë e tij. Gjermania aneksoi Austrinë më 13 mars 1938 (e ashtuquajtura Anschluss). Hebrenjtë u shpronsuan dhe u persekutuan. Austriakët luftuan në Luftën e Parë Botërore në Forcat e Armatosura Gjermane si shtetas gjermanë.

Pas disfatës së Rajhut të Tretë, Austria u nda në zona pushtimi të Bashkimit Sovjetik, SHBA, UK dhe Francë. Social Demokrati Karl Renner me mbështetjen e sovjetikëve krijoi një qeveri të përkohshme në prill 1945. Austria mbeti nën pushtimin zyrtar të Aleatëve deri në 1955. Austria e deklaroi veten përgjithmonë neutrale, nuk u bashkua me NATO-n dhe u bë anëtare e Bashkimit Europian vetëm pas përfundimit të Luftës së Ftohtë në 1995.

ALMA ROSÉ lindi më 3 nëntor 1906 në Vjenë, në një familje hebreje me një traditë muzikore. Babai i Almës, Arnold ishte violinist i parë i Orkestrës Filarmonike të Vjenës dhe kreu i grupit Kuarteti Trëndafil.

Xhaxhai i saj ishte kompozitori i njohur Gustav Mahler.

Ajo vetë ishte një violiniste e talentuar, që performonte me orkestrën e zonjave të saj në Vjenë në vitet 1930. Burri i saj i parë ishte violinisti Çek Váša Příhoda.

Në vitin 1942, ajo u martua me një Hollandez. Në 1943, ndërsa përpiquej të ikte përmes Francës në Zvicër, për t'iu shmangur

persekutimit nazist të hebrenjve, Alma Rosé u arrestua dhe u dërgua në kampin e përqendrimit në Auschwitz.

Ajo drejtoi orkestrën e grave të burgosura në Auschwitz, duke fituar respekt të madh nga autoritetet e kampit dhe në të njëjtën kohë duke mundur kushte më të mira jetese për muzikantët e saj dhe mbijetesën e tyre. Alma Rosé vdiq në kampin e përqendrimit më 4 prill 1944, ndoshta nga helmimi i ushqimit.



BIBLIOTEKA
KOMBËTARE
AUSTRIAKE

Alma Rosé

Häftlingsfrau Nr. 50831

shkruar nga Łukasz Martyniak

Alma Rosé lindi më 3 nëntor 1906 në Vjenë në një familje hebreje, e cila ruante traditat e gjalla muzikore. Babai i Almës, Arnold ishte violinist i parë i Orkestrës Filarmonike të Vjenës dhe kreu i grupit Rose Quartet. Alma i detyrohej atij për arsimimin e saj muzikor dhe karrierën e saj të mëtejshme, të cilën ajo e nisi nën krahët e tij. Burri i saj i parë ishte Váša Příhoda, i cili ishte një violinist i famshëm europian. Në vitet 1930, Alma ishte udhëheqësja e grupit *Die Wiener Walzermädeln*, i cili gëzonte një reputacion të konsiderueshëm në EUROPË.

Pasi nazistët morën shtetin Austriak, Alma emigroi në Angli. Kur ushtria e Hitlerit bastisi EUROPËN Perëndimore në 1940, ajo ishte në Hollandë. Në mars 1942, ajo u martua me Hollandezin Constant van Leeuwen Boomkamp. Ajo shpresonte që martesja do ta mbronte nga shtypjet e forcave pushtuese kundër qytetarëve hebrej. Por doli që e kishte gabim dhe iu desh të ikte nëpër Francë për në Zvicër. Arratisja e planifikuar dështoi - ajo u arrestua në Dijon dhe u transportua në 12 janar 1943 në kampin e internimit Drancy pranë Parisit.

AUSCHWITZ

Më 18 korrik 1943, Alma ndau fatin e njëjtë të mijëra hebrejve dhe u dërgua në lindje në Auschwitz, për të cilën u deshën dy ditë (ajo u rendit në regjistrin e transportit si Obna Vanleeuwen). Ajo ishte një nga një mijë hebrejtë e sjellë në kamp me të njëjtin transport. Pas mbërritjes të sapoardhurit u ndanë në grupe. Ushtarët SS renditën 369 burra dhe 191 gra si të aftë për punë. 440 personat e mbetur u dërguan në dhomat e gazit dhe u vranë atje. Alma ishte me fat që i përkiste grupit "të aftë për punë".

Ajo u regjistrua si *Häftlingsfrau*¹ numër 50831 dhe u burgos në Bllokun 10 në ambientet e kampit kryesor Auschwitz I. Blloku fitoi një reputacion të keq në kamp, pasi aty ishte mjeku nazist Prof. Carl Clauberg që aplikonte eksperimentet e tij të egëra të sterilizimit të grave.

Ndërsa ishte në bllok, një prej grave të burgosura e njohu Almën. Falë përpjekjeve të kreut të bllokut, u bë e mundur të sigurohej fshehurazi një violinë për të, kështu që ajo të mund të performonte mbrëmjeve

¹ E burgosur femër

për të burgosurat. Situata nuk mund të mbahej e fshehtë për shumë kohë dhe lajmet për talentin e saj muzikor mbërritën te ushtarët SS. Kjo u dha arsye për ta zhvendosur në kampin në Brzezinka (Auschwitz II-Birkenau), ku, në gusht, u caktua në rolin e drejtuesit të bandës dhe dirigjentit e orkestrës së grave të burgosura.

PUNA ME ORKESTRËN E GRAVE

Orkestra e grave ishte themeluar në kampin e përqendrimit Auschwitz para se Alma të mbërrinte në Birkenau, d.m.th. në prill 1943. Ajo u iniciua nga autoritetet e kampit në bashkëpunim me mbikëqyrësen e kampit të grave Marie Mandel, e cila ishte e njohur për mizorinë e saj. E burgosura e parë që drejtoi bandën ishte polonezja Zofia Czajkowska, me profesion mësuese muzike. Orkestra, të cilën ajo drejtoi në periudhën fillestare, përbëhej nga 30 të burgosur, kryesisht amatorë, 14 prej të cilëve ishin hebrenj. Shumica dërmuese e tyre nuk kishin pasur ndonjë përvojë muzikore më parë. Detyra kryesore e orkestrës së sapo-themeluar ishte të luante për punëtorët e burgosur Kommandos, kur ata largoheshin për punë në mëngjes dhe ktheheshin në mbrëmje. Orkestra luajti edhe për të burgosurit e sëmurë në spitalin e kampit.

Shpejt pasi mori drejtimin e orkestrës, Alma filloi riorganizimin e saj. Përpjekjet e saj çuan në një rritje të numrit të anëtarëve të orkestrës së të burgosurve. Kështu, në ndërrim të viteve 1943 dhe 1944, orkestra numëronte mbi 40 të burgosur (30 instrumentistë, gjashtë këngëtarë, katër deri në gjashtë kopjues të notave muzikore dhe katër ndihmës). Nga mesi i vitit 1944, radhët e saj ishin rritur në pothuajse 50 të burgosur, kryesisht hebrenj. Pjesëmarrja në orkestrën e kampit u konsiderua nga të burgosurit si sigurimi i një potenciali shumë më të madh për mbijetesë, sesa puna në Kommandos të tjerë. Anëtarët e orkestrës nuk u detyruan të bënin punë të rënda fizike dhe rekrutimi u krye gjatë apelit, si dhe duke spikatur kandidatët midis të sapoardhurve në kamp. Vendimi përfundimtar për pranimin në orkestër shpallej nga vetë dirigjenti, pasi kishte "ekzaminuar" kandidatin.

Në periudhën fillestare të funksionimit të orkestrës, pajisjet e saj muzikore siguroheshin nga anëtarët e burgosur të orkestrës për burra në kampin kryesor Auschwitz I. Sapo Alma kishte marrë pozicionin e saj si drejtoreshë e orkestrës së grave, filluan duke u zëvendësuar shumica e instrumenteve me shumë më të mira. Partiturat muzikore dhe materialet e tjera ndihmëse nuk siguroheshin më ekskluzivisht nga orkestra e burrave të kampit kryesor, por direkt nga autoritetet e kampit. Alma paraqiti kërkesa për pajisjet e nevojshme. Si dirigjent i ri, ajo gëzonte më shumë të drejta autorizimi: autoritetet e kampit caktuan një bllok të veçantë për orkestrën e saj, i cili përveç sektorit të qëndrimit ishte i kompletuar dhe me një sallë provash. Përveç pajisjeve të nevojshme si stendat ose tribuna, salla gjithashtu përmbante dollapët e përshtatshëm për ruajtjen e instrumentave dhe partiturave muzikore. Për të mbrojtur instrumentet nga lagështia u instalua një sobë dhe dyshemeja e sallës u vesh me dru. Nën drejtimin e Alma Rosé, orkestra e

grave u bë një Kommando e vlerësuar për autoritetet e kampit dhe vet dirigjentja gëzonte vlerësimin e tyre të madh. Zofia Cykowiak, një ish e burgosur e Auschwitzit dhe anëtare e orkestrës, kujton:

“... Komandantët shpesh vinin në bllokun tonë gjatë provave për të dëgjuar Almën kur luante. Repertori i saj përbëhej nga shumë pjesë solo me orkestrën. Më shumë se për kënaqësinë e tyre, ata ftuan mysafirë dhe haptazi ‘krenoheshin’ me orkestrën e grave, veçanërisht me një violiniste të një klasi të tillë ... Ishte e habitshme sesi ajo ishte në gjendje të mbante distancë midis vetes dhe autoriteteve. Duke pasur parasysh kushtet e përgjithshme në kamp, ajo u trajtua me mirësjellje të jashtëzakonshme, madje me respekt. Asaj iu drejtuan si Znj (Frau) Alma - kjo absolutisht nuk kishte ndodhur më parë ... ”

Sapo mori detyrën e drejtorit të orkestrës së kampit, Alma vendosi disiplinë relativisht të ashpër ndaj vetes dhe anëtarëve të tjerë të grupit.

Të burgosurit - anëtare femra të orkestrës - përmirësuan aftësitë e tyre nën bastunin e saj. Standardet e Almës ishin të larta. Ajo nuk toleroi asnjë gabim gjatë provave, të cilat zgjatën për orë të tëra. Anëtarëve të orkestrës shpesh u duhej të interpretonin pjesët e gabuara derisa arrinin nivelin që kënaqte Almën. Ajo ndonjëherë do ta humbte durimin dhe do të dënonte shoqet e saj të burgosura. Edhe pse ndëshkimi fizik ishte i zakonshëm në kamp, Alma nuk do ta përdorte kurrë atë. Ndëshkimi i zakonshëm për disa mosmbarëvajtje ishte pastrimi i dyshemesë së sallës së provashkove.

E burgosura Manca Švalbová, shoqja e Almës në kamp, kujton:

“Ajo trajnoi vajzat dhe niveli i grupit u rrit çdo ditë. Alma punoi nga agimi deri në muzg ... dhe praktikoi, praktikoi. Ende nuk është luajtur ne ritmin e duhur ... ky tingull duhet të jetë i pastër, ai zë ka shumë pak temperament. Edhe një herë, edhe një herë ”.

KËRKESA E PËRSOSMËRISË

Provat e vazhdueshme të mundimshme shpesh çonin në stërmundim të të burgosurave. Kishte raste

901	Tella	Jacques	19.1.34	Kind	2921
902	Tella	Salomon	2.7.95	ohne	2075
903	Tepelok	Albert	14.1.28	Feldarbeiter	2052
904	Tepelok	Bernard	1898	Schneider	2051
905	Terras	Gentil	8.1.05	ohne	2078
906	Térras	Michel	16.8.99	Arbeiter	2077
907	Tragars	Chaskiel	19.5.21	Heisungsmeister	2058
908	Tragar	Odetta	9.3.15	Medistin	2095
909	Treuillet	Lydia	8.12.17	ohne	2009
910	Tuchmann	Abraham	4.11.23	Ledararbeiter	2086
911	Udry	Yvonne	28.2.05	Sekretäarin	2109
912	Unger	Joseph	3.4.98	Schneider	2119
913	Unikowski	Michel	20.12.92	Markthandl.	2135
914	Usan	Joseph	1908	Orthopäde	2131
915	Van Gelderen	Ikarus	11.11.19	Student	2361
916	Vanleeuwen	Obna	8.11.06	Gelganspieler	2133
917	Van Lee	Adrienne	30.8.76	ohne	2125
918	Vidal	Cécilte	6.5.27	Kind	2148
919	Vidal	Nedjma	2.6.67	ohne	2146
920	Vidal	Preaper	5.1.87	Feldarbeiter	2145
921	Vidal	Hacbel	18.1.25	Kind	2147
922	Vieyra	Bernard	11.8.20	Jeweller	2136
923	Vieyra	Jacques	2.2.19	Steinmesser	2136
924	Villard	Liba	25.10.95	ohne	2137

Obna Vanleeuwen (Alma Rosé) e listuar në numrin 916 në regjistrin e transportit.

ARKIVA E MUZEUT SHITETËROR TË AUSCHWITZ-BIRKENAU NË OŚWIĘCIM

kur të burgosurat femra të lodhura shembeshin në tokë dhe u binte të fikët. Ndërhyrja e Almës bëri që autoritetet e kampit të lejonin të burgosurit të pushonin një orë gjatë ditës. Ata e kaluan këtë orë duke pushuar në shtrat dhe në mënyrë sporadike duke shëtitur jashtë mjediseve të kampit.

Në periudhën e parë, kërkesa e Almës për përsosmëri nuk u prit me mirëkuptim nga disa të burgosura. Mund të thuhet me siguri se ata nuk ishin në gjendje të pranonin metodat e saj të punës. Ne

mund të hamendësojmë se ato mbanin mëri për ndëshkimin që ajo u jepte nëse gabonin gjatë lojës muzikore. Në sytë e të burgosurave të Birkenau - dëshmitare të ngjarjeve tragjike, për të cilat çdo ditë në kamp ishte luftë e vazhdueshme për mbijetesë, me vdekjen e kudogjendur rreth tyre - të qenit i apasionuar pas detyrës së caktuar ishte thjesht absurde. Prandaj, ata mund të mos kenë gjetur kuptim në përpjekjen për përsosmëri, kur luanin pjesës muzikore.

Vetë Alma punoi jashtëzakonisht shumë duke drejtuar provat e ditës me bandën. Përfshirja e saj e jashtëzakonshme në muzikë, për të cilën u angazhua në Birkenau, padyshim shpjegohet si një arratisje nga atmosfera mizore e kampit. Në mbremje pas apelit, ajo praktikonte vetëm. Shpesh i kalonte netët duke hartuar partitura muzikore për t'i përgatitur për kopjuesit në mëngjes. Në vlerësim të angazhimit të saj, autoritetet e kampit bënë një përjashtim dhe e lejuan atë të ndizte një llambë në dhomë ndërsa punonte natën. Nën drejtimin e Almës, aftësitë e orkestrës përmirësoheshin vazhdimisht. Ajo ishte shumë precize dhe profesionale kur punonte në pjesë të ndryshme muzikore, të cilat ndër të tjera ishin marshe, muzikë për argëtim por edhe pjesë klasike. Repertori përbëhej nga fragmente të pjesëve nga Brahms,

Tchaikovsky, Lehar, Ravel, Rossini, Sarasate, Verdi, Schubert, Strausses dhe të tjerë. Helena Tichauer vlerësoi qasjen e Almës si më poshtë:

"Ajo arriti diçka që ndryshe nuk do të ishte në gjendje ta arrinte në jetën normale. Ajo bëri diçka nga asgjëja. Ishte gjenialiteti i Almës që katapultoi një grup amatorësh në një nivel të pranueshëm të performancës muzikore. ... Mbjaj mend kohët kur Alma i bërtiste në frëngjisht një vajze veçanërisht të ngathët, e cila vazhdonte të bënte gabime. Por Alma kurrë nuk e përzuri jashtë bllokut, që do të ishte njësoj si dënimi me vdekje, sepse ajo vajzë ... nuk do të mbijetonte askund tjetër në Birkenau. "



Një faqe partiture e përdorur nga orkestra në kampin e përqendrimit Auschwitz.

ARKIVA E MUZEUT SHITETËROR TË AUSCHWITZ-BIRKENAU NË OSWIĘCIM

Me kalimin e kohës, Alma filloi të gëzonte respekt të madh nga anëtarët e orkestrës, si dhe magjepsje me talentin e saj muzikor. Për ta u bë e qartë se përpjekja e saj e jashtëzakonshme kishte çuar në një rritje të nivelit të performancës së bandës, gjë që gjithashtu rriti shanset e tyre për të mbijetuar në kamp. Zofia Cykowiak kujton:

"... Ne ishim të hipnotizuar nga loja muzikore e Almës. Ne e ndjemë se muzika që ajo erdhi të praktikonte atje ishte e gjithë bota e saj, ku ajo struku veten me zell, edhe pse për të ishte një tragjedi të praktikonte atë muzikë në atë mbretëri çnjerëzore. E di direkt prej saj. M'u rrëfye një mbrëmje, kur po shikonim transportimin e grave hebreje të zgjedhura për ekzekutim nga kampi në dhomat, plotësisht të vetëdijshme për fatin e tyre. Ato u transportuan me kamionë të zbuluar, të zhveshura lakuriq. Ato po ulërinin. 'Lagersperre' i rreptë ishte në fuqi ndërkohë që u krye transporti, me fjalë të tjera ndalohej të lëvizje jashtë bllokut. Por unë ndonjëherë përvidhesha larg bllokut dhe i vëzhgoja dhe i përjetoja ato veprime në hijen e tyre. Një herë kam takuar Almën atje. Më tha atëherë se do të urrente të vdiste në një mënyrë kaq çnjerëzore ... "

Helen Scheps deklaroi:

"Alma na shpëtoi jetën sepse diti të na shndërronte në orkestër. Nëse Alma nuk do të kishte qenë atje, ne nuk do të ishim këtu."

Mund të supozohet se niveli i përfaqësuar nga orkestra, i cili zotëronte kënaqësinë e autoriteteve të kampit, si dhe aftësitë dhe personaliteti unik i Almës, çuan në përmirësimin e konsiderueshëm të kushteve të jetesës së anëtarëve të orkestrës. Ato nuk ishin të detyruar të bënin punë të mundimshme me punëtorët e tjerë Komandos, ose të merrnin pjesë në apelin e përgjithshëm të kampit. Ato numëroheshin çdo mëngjes brenda bllokut ku jetonin. Morën të njëjtin ushqim si të burgosurit e tjerë Kommandos, por u trajtuan disi më shpesh me racion shtesë të bukës ose margarinës, marmelatës ose sallamit. Ashtu si të burgosurit e tjerë, ato mbanin veshjen me shirita të kampit, megjithatë kur luanin, veçanërisht gjatë koncerteve të së Dielës dhe festave, vishnin bluza të bardha, funde blu të errët dhe shami blu. Për më tepër, autoritetet e kampit i lejuan të posedonin të brendshmet e tyre dhe të përdornin ambjentin e banjës, dhomën e larjes së rrobave dhe tualetin që ishin në dispozicion vetëm për të burgosurit e kombësisë gjermane. Anëtarët e orkestrës përfituan nga situata që u krijua nën drejtimin e Almës edhe në një mënyrë tjetër - ato nuk ishin të ekspozuara ndaj rrahjeve, ngacmimeve dhe abuzimeve të vazhdueshme nga rojet ose ushtarët SS. Shansi i tyre për të mbijetuar ishte dukshëm më i lartë krahasuar me gratë që punonin në Kommandos e tjerë.

Në kujtimet e ish të burgosurve, Alma shfaqet si një person me një rezervë të caktuar ndaj bandës, e cila zakonisht ishte introverte, por e sjellshme me shoqet e saj të burgosura. Ajo bëri një jetë mjaft të vetmuar, duke ruajtur një ndjenjë njerëzore ndaj të tjerëve, pavarësisht nga rrethanat. Zofia Cykowiak kujton:

"... Alma ishte një grua e drejtë me një kulturë të shkëlqyer të mendjes dhe zemrës. Unë pata një shans ta përjetoja sepse mbaja kontakt më të ngushtë me të. Filloi me ndërhyrjen time tek Alma në lidhje me një grua

polake, shoqen time në kamp. Midis nesh shpërtheu një konflikt i rëndë, i cili ndodhi si rezultat i një keqkuptimi. Alma mund ta kishte dëbuar atë grua nga banda, para se të arrinim ta zgjidhnim konfliktin dhe pasojat do ishin potencialisht fatale (riedukim i Kommandos). Por ajo nuk e bëri. Dhe më vonë i toleroi më shumë se një herë shpërthimet e acarimit të asaj të burgosure, duke kuptuar tragjedinë që po jetonte, pasi kishte marrë një mesazh se tre vëllezërit e saj u vranë në Auschwitz ... "

VDEKJA E ALMËS

Alma Rosé vdiq në kamp në fillim të prillit 1944 për arsye që nuk marrin shpjegime shteruese. Deri në 2 prill, ajo ishte akoma në gjendje të merrte pjesë në një "pritje" të organizuar në ditëlindjen e Alsa Schmidt - e cila ishte përgjegjësjja e magazinës së veshmbathjeve në kamp për të burgosurit. Ajo u kthye nga festa me dhimbje të forta, trullosje dhe dhimbje gjoksi. Më pas i filluan spazmat dhe të vjellat. Ditën tjetër - 3 prill, Alma u dërgua në bllokun e spitalit. Mjekët dyshuan për meningjit. Iu morë për ekzaminim mostër e lëngut cerebrospinal. Megjithatë, analiza në Institutin e Higjienës SS nuk e konfirmoi diagnozën. Gjendja e saj nuk u përmirësua, pavarësisht përpjekjeve të mëtejshme gjatë trajtimit në spitalin e kampit.



Alma Rosé (në këmbë djathtas) me Vajzat e Valsit Vienes, 1934.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE AUSTRIAKE

Ajo ndërroi jetë natën në 4 prill 1944.

Vdekja e papritur e Almës nxiti një mori dyshimesh. U hamendësua se ajo ishte helmuar qëllimisht, ose se ajo vdiq për shkak të intoksikimit me alkool metilik ose ushqimi gjatë "prijtes" së përmendur kishte kaluar datën e skadencës.

Pas vdekjes së Almës, anëtarët e orkestrës u lejuan të vizitojnë spitalin e kampit për t'i dhënë asaj lamtumirën e fundit. Kjo nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë në historinë e kampit. Po ashtu dhe mënyra e trajtimit të trupit ishte krejtësisht e jashtëzakonshme. Siç kujton Zofia Cykowska:

“Ajo ishte shtrirë para bllokut të spitalit, në stolat e bashkuarë të mbuluar me çarçaf të bardhë... Shumë njolla të vockla mund të shiheshin në fytyrën dhe duart e saj. Dikush kishte vendosur një tufë bimësh mbi rrobën. Një ‘varrim’ i tillë ishte i pashembullt në kampin e përqendrimit”.

Një trajtim i tillë i trupit të Almës dëshmon për mënyrën e qasjes se autoriteteve të kampit ndaj asaj. Bożena Kaczyńska jep një deklaratë mjaft prekëse për vdekjen e Almës:

“Nuk mund të besoja se një talent i tillë muzikor kishte shkuar përgjithmonë, i cili u çlirua mes dhimbjes dhe mjerimit. Orfeu, i cili zbuti kafshët e egra me muzikë, kishte shkuar në Tokën e Hijeve. Një gjeni muzikor i epokës kishte pushuar së ekzistuari.”

Pas vdekjes së Almës, funksioni i saj u mor nga një e burgosur tjetër, gjithashtu një anëtare e orkestrës së grave, Sonia Winogradowa, e cila luajti në piano. Në muajt në vijim, orkestra vazhdoi të luante marshe për punëtorët Kommandos dhe muzikë për ushtarët SS. Me kalimin e kohës, autoritetet e kampit reduktuan orët e provës së orkestrës dhe të burgosurat u detyruan të kryenin detyra shtesë, kryesisht qepja dhe riparimi i të brëndshmeve të kampit. Historia e orkestrës së grave mori fund kur anëtarët e saj hebrenj u transportuan në kampin Bergen-Belsen, ku jetuan deri në ardhjen e çlirimit të tyre.

□ LEXIMI MËTEJSHËM:

R. Newman, K. Kirtley: Alma Rosé. Vienna To Auschwitz, Cambridge University Press, Cambridge, 2000.

J. Lachendro: Alma Rosé – ucieczka w muzykę, in: Człowiek wobec totalitaryzmu. Od prostych recept do ‘Ostatecznego Rozwiązania’, ed. by A. Bartuś, Auschwitz-Birkenau State Museum, Oświęcim, 2012.

Z. Cykowiak: Kobięca orkiestra w oświęcimskim obozie, Pro Memoria No. 5, 1996.

Memories and accounts by Zofia Cykowiak, Helena Niwińska, Bożena Kaczyńska and Hanna Palarczyk stored in the archive of the Auschwitz-Birkenau State Museum (PMA-B) in Oświęcim.

KONTRIBUT I MUZEUT DHE MEMORIALIT SHTETËROR AUSCHWITZ-BIRKENAU

HOLLANDA



PUSHTIMI NAZIST

Më 10 maj 1940, Gjermania sulmoi Holandën pavarësisht neutralitetit të saj dhe deri në fund të muajit e pushtoi atë. Regjimi pushtues u krijua në formën e një qeverie civile, Reichskommissionariat Niederlande, i kryesuar nga një austriak, Arthur Seyss-Inquart. Gjatë pushtimit rreth 75% e popullsisë hebreje të vendit u shfaros.

Kishte një bashkëpunim të rëndësishëm hollandez me nazistët, si dhe një lëvizje rezistence. E vetmja parti e ligjshme politike gjatë pushtimit ishte Lëvizja Nacional Socialiste (NSB), e cila luajti një rol të rëndësishëm në administratën lokale. Njësi vullnetare Holandeze Eëaffen-SS luftuan në Frontin Lindor. Një pjesë e vendit u çlirua në gjysmën e dytë të vitit 1944. Popullsia në pjesën perëndimore të Hollandës pësoi zi urie në dimrin e 1944-1945, që u shkaktua nga një bllokadë. Më 5 maj 1945, i gjithë vendi u çlirua nga Forcat Aleate.

MARINUS SOETERS lindi më 6 mars 1923 në Oosterhout, në Hollandë. Në fillim të luftës ai ishte 18 vjeç dhe punonte në një fabrikë. Menjëherë pas pushtimit gjerman në maj 1940 Marinus refuzoi kërkesën për t'iu bashkuar dhe për t'u bërë udhëheqës i shoqatës së të rinjve të partisë naziste. Në 1942 ai u dërgua të bënte punë të detyruar në fabrikën e armëve Krupp në Essen, Gjermani. Kushtet ishin të pabesa. Ai arriti të shpëtonte dhe u kthye në Hollandë, ku iu desh të fshihej në një fermë afër shtëpisë së tij.

Në vitin 1943 ai u dërgua përsëri në Essen dhe shpëtoi për herë të dytë. Ai u tradhtua dhe u dërgua në kampin e përqendrimit në Amersfoort, para se të dërgohej përsëri në Gjermani për të punuar në impiantet e municionit. Ai u çlirua nga trupat polake në mars 1945. Ai vazhdoi të krijonte familje dhe u diagnostikua me çrregullim të stresit post-traumatik në vitet 1980. Ai vdiq më 30 prill 2004.



KOLEKSIONI I FAMILJES
SOETERS

Marinus Soeters

Kujtime Luftë

shkruar nga Marinus Soeters

Emri im është Marinus dhe kam lindur në 6 mars 1923 në Oosterhout, në provincën e Brabantit të Veriut në Hollandë. Kam jetuar atje gjatë gjithë jetës time. Kur filloi lufta, unë isha 18 vjeç dhe natyrisht i friksohesha asaj që mund të ndodhte. Askush nuk mund ta kishte parashikuar që kaq shumë vuajtje do të shkaktoheshin nga gjermanët, të cilët morën çnjerëzorisht gjithçka që dëshironin, përfshirë njerëzit. Sidomos më vonë gjatë luftës, ata hoqën maskat dhe zbuluan se nga çfarë ishin gatuar me të vërtetë.

Shpejt pas pushtimit në maj 1940, punëtorët holandezë të detyruar u caktuan për punë të ndryshme të rënda dhe të rrezikshme në industrinë gjermane të luftës. Në atë kohë, unë punoja në fabrikën e kartonit Vandra në Oosterhout. Pas shpërthimit të luftës, puna në fabrikë ishte pezulluar për një periudhë gjatë javore të gjithë duhej të qëndronin në shtëpi dhe të prisnin thirrjen për të rifilluar punën. Kur erdhi thirrja, të gjithë ishin të lumtur që mund të ktheheshin në punë dhe ishte sikur nuk kishte ndodhur asgjë. Më 8 tetor 1940, unë u betova si ndihmës udhëheqës rinor i Gardës Rinore Qendrore Katolike të dioqezës së Bredës. Shpejt pasi mora atë pozicion, mu afrua z. Van Geel, një kontraktor nga Oosterhout dhe anëtar i NSB (Lëvizja Nacional Socialiste). Ai më pyeti nëse doja të isha udhëheqës rinie në shoqatën e të rinjve Nacional Socialiste. Unë nuk iu përgjigja këtyre kërkesave dhe u përpoqa të injoroja presionin në rritje që po ushtrohej mbi mua. Në naivitetin tim mendova se gjërat do të harroheshin. Fatkeqësisht nuk ishte kështu. Jam i bindur se refuzimi im për t'u bashkuar me një organizatë naziste ishte arsyeja pse më vonë u përzgjedha për punë në Gjermani.

Në gusht 1942, tre njerëz nga fabrika jonë u zgjodhën për t'u paraqitur në zyrën e punësimit në Oosterhout. Johan van Gool, unë dhe një djalë tjetër, emrin e të cilit e kam harruar, u inspektuan fizikisht në ndërtesën e NSB në Janstraat në Oosterhout. Mbërrita atje i sëmure si një qen dhe i zbehtë për vdekje.

Kisha përshtypjen se nuk mund të pranohesha. Kisha bërë gjithçka që ishte e mundur për t'u dukur sa më i sëmure. Ndiheha vërtet i sëmure. Shkova në inspektim duke supozuar se do të refuzohesha. Aty e kuptova shpejt se nuk isha i vetmi që kisha pasur atë ide. Çdokush që ishte thirrur dukej sikur do të binte i vdekur në vend. Sigurisht që të gjithë u aprovuam dhe morëm pasaportë falas për të udhëtuar për në Gjermani.

FILLIMI I PUNËS NË ESSEN

Më 10 shtator 1942, më hipën forcërisht në një tren për t'u dërguar për të punuar për Krupp në Essen. Më strehuan në *Fabrikslager* - depoja e fabrikës. Rastësisht, kishte shumë pak holandezë, por shumë polakë dhe rusë. Kushtet në të cilat duhet të punonim ishin të rënda dhe të rrezikshme. Akomodimi (kazermat) dhe ushqimi ishin të këqija. Dita e punës filloi në 7.00 të mëngjesit dhe përfundoi në 7.00 të pasdites.

Unë isha i punësuar në një fabrikë ku avulli i nxehtë nën presion kalonte përmes tubave. Njerëzit

plagoseshin dhe vriteshin shpesh, sepse tubat shpërthenin herë pas here, duke shkaktuar daljen e avullit të nxehtë. Kështu humbi jetën holandezi i vetëm me të cilin kisha kontakte të rregullta. Ai ishte një burrë nga Groningen, emrin e të cilit e kam harruar. Ai u godit nga shpërthimi i avullit të nxehtë kur plasi një tub. Presioni i avullit e hodhi disa metra në ajër. Përveç kësaj, nxehtësia në fabrikë ishte pothuajse e padurueshme. Sikur të mos mjaftonte, kishte bombardime të ashpra nga Forcat Aleate në zonën e Ruhr, në mënyrë që të ndërprisnin përpjekjet gjermane të luftës sa më shumë që të ishte e mundur. Ende e mbaj mend shumë mirë bombardimin e 9 dhe 10 dhjetorit 1942. Më pas dëgjova se mbi 1,200 avionë ishin përfshirë në atë bombardim.

PËRDORIMI I PUNËS SKLLAVËRUESE NGA KOMPA-NITË GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Gjatë luftës shumë kompani, ndërmarrje private dhe gjithashtu fermerë të thjeshtë gjermanë, por edhe holandezë, danezë, italianë, përdorën në forma të ndryshme punën e robërve të luftës, të burgosurve politikë dhe punëtorëve të huaj të detyruar ose gjysmë vullnetarë nga vendet e pushtuara. Nga Ukraina, Bjellorusia, Lituania dhe tokat e pushtuara Ruse, disa miliona të ashtuquajtur "punëtorë lindorë" (Ostarbeiter) u mblodhën dhe u dëbuan në Gjermani gjatë luftës. Nga vendet e pushtuara Europiane, "punëtorët e huaj" kryesisht rekrutoheshin ose detyroheshin të shkonin në Gjermani përmes zgjedhjeve të kufizuara, të diktuar nga autoritetet pushtuese. Gjatë luftës gjithpërfshirëse që filloi në shkurt 1943, gjithnjë e më shumë burrat gjermanë u mobilizuan në ushtri dhe vendet e tyre të punës u mbushën me punëtorë të detyruar të statusit të ndryshëm. Ata duhej të jetonin në kampe të veçanta, ushqimi i tyre ishte i pamjaftueshëm dhe ditët e punës ndonjëherë zgjasnin më shumë se 12 orë. Ata trajtoheshin si qenie njerëzore të klasës së ulët me shumë pak të drejta dhe shpesh marrëdhëniet e tyre me popullsinë gjermane ishin të ndaluara. Përveç kësaj, shumë prej tyre ranë viktimë të sulmeve strategjike të bombardimeve Aleate kundër qendrave të rëndësishme industriale gjermane dhe objekteve të infrastrukturës. Pas Luftës së Dytë Botërore, Republika Federale e Gjermanisë dhe ndërmarrjet gjermane paguanë kompensime për grupe të ndryshme viktimash, punëtorësh të detyruar midis tyre.

KUTI NJOFTIMI

DY ARRATISJE TË PENGUARA

Menjëherë pas bombardimit, unë bëra një përpjekje për t'u arratisur dhe arrita të hipi në një tren që po largohej nga Essen plot me vajza të ushtarëve (vajza për të argëtuar ushtarët). Për habinë time, arrita në Den Bosch, por aty më mbaroi fati. Në stacionin e trenit në Den Bosch më zbritën nga treni anëtarët e SS dhe më dorëzuan tek përgjegjësi i stacionit, i cili ishte i detyruar të më transferonte tek autoritetet. Ky njeri ndoshta nuk kishte zemër të

më dorëzonte, por në të njëjtën kohë nuk donte të humbte shansin për të fituar ca para shtesë. Pasi dhashë një kontribut prej 32 markash për Ndihmën e Dimrit, u lejova të udhëtoj më tej.

Pasi arrita në Oosterhout më duhej të gjeja një vend të sigurt për t'u fshehur. Arrita ta bëja këtë në ditën e shtatë pas arratisjes sime. Më dhanë një vend për t'u fshehur në një shtëpi në fermën e fshatit Rijen, afër Oosterhout. Kështu munda të mbaja kontakte të rregullta me familjen time. Ata kontrolloheshin rregullisht nga gjermanët, duke pyetur nëse e dinin se ku ndodhesha unë. Përfundimisht u lodhën. U thanë prindërve të mi që nëse nuk regjistrohesh, babai im do të transportohej në Gjermani, për të zënë vendin tim në fabrikën e Krupp. Kështu që u detyrova të raportoja përsëri dhe në maj 1943 u dërgova për herë të dytë për të punuar në Essen.

Pas një bombardimi tjetër të rëndë me shumë viktime ika përsëri. Gjatë kthimit për në shtëpi u arrestova nga dy ushtarë gjermanë në një kamion. Ata synonin të më dorëzonin tek autoritetet gjermane në Kleve. Duke ditur se çfarë më priste pas një arratisje të dytë, u hodha nga kamioni kur po ecte në errësirë dhe kalova kufirin në këmbë. Në Oosterhout u ktheva në vendin e fshehtë të vjetër. Dikush aty ndoshta më tradhtoi, sepse u arrestova gjatë një bastisje dhe u dërgova në burgun SD në Breda. Më mbajtën atje për gjashtë javë në një qeli me 200 të burgosur, në pritje të transportit të mëtejshëm. Përfundimisht, mua me disa të rinj të tjerë, përfshirë dikë të quajtur Rinus Smit, na dërguan në *Polizeiliches Durchgangslager Amersfoort* (Kampi Policor i Tranzitit Amersfoort)

KAMPI POLICOR I TRANZITIT NË AMERSFOORT

Nuk e di saktësisht se kur arrita atje, por kur i bashkoj të gjitha copëzat, mendoj se duhet të ketë qenë diku në fund të gushtit. Ajo kohë përbënte vetëm një pjesë të vogël të endjeve të mia, por ishte padyshim një nga përvojat më të vështira dhe më tronditëse që kam kaluar. Nuk jam i sigurt për kohëzgjatjen e qëndrimit tim në kampin Amersfoort. Mendoj se duhet të kenë qenë rreth tre muaj. Me të mbërritur na u desh të regjistroheshim për numrin dhe veshjen e kampit tonë. Isha mjaft nervoz dhe për këtë arsye i shqetësuar, gjë që rojës nuk i pëlqeu. Për shkak të kësaj më dha një goditje me një shkop të hollë të gjatë. Kjo ishte përvoja ime e parë në kampin në Amersfoort.

Nuk e di në cilat kazerma isha dhe gjithashtu harroj numrin e kampit tim. Por, ka akoma disa njerëz që mund t'i mbaj mend. Më qartë nga të gjithë më kujtohen dy burrat që ishin në kazermat ku kam qenë vetë: Ben van den Berg nga Utrecht dhe një berber që u priste flokët të burgosurve, një z. Peters nga Nijmegen. Më vonë, Peters u mor nga gjermanët dhe u pushkatua. Nuk e mbaj mend datën, por mbaj mend që ishte një ditë pasi më kishte prerë flokët mua. De Jong është një emër tjetër që më vjen në mendje. Ai ishte një i burgosur i cili gjithashtu ishte një monitorues kampi.

Puna ishte e vështirë, ditët ishin të gjata dhe ushqimi i dobët dhe i pakët. Thirrja e zgjimit ishte

në orën 6.00 të mëngjesit. Na duhej të rreshtoheshim më pas, një proces që shoqërohej gjithmonë me një numër të caktuar shtyrjesh dhe goditjesh. Nëse, gjatë procedurës së thirrjes së numrave të burgosurve, një numër mungonte ose një nuk përgjigjej në kohë, goditej i gjithë grupi. Në orën 7.00 të mëngjesit marshonim për në Amersfoort Heath për të prerë pemë. Unë punoja nën komandën në ambjente të jashtme të quajtur *Holzschillkommando*. Komandanti i atij grupi ishte Willie Lages.

Në mbrëmje e gjithë kolona kthehej në kamp dhe nxitoni të laheshin. Nëse do të ishe me fat do arrije dhe të pije diçka. Pastaj kishte dhe një thirrje tjetër, në të cilën na duhej të qëndronim krah për krah me katër persona të tjerë dhe duhej të zbraznim xhepat. Çfarë kishim nëpër xhepa duhej t'i vendosnim në tokë dhe pastaj të tërhiqeshim katër hapa mbrapa. Pastaj disa nga rojet kalonin afër për të parë nëse kishte ndonjë gjë të veçantë mes sendeve. Nëse në xhepa gjendej ushqim ose ndonjë gjë tjetër me interes, ndëshkohesh në mënyrën më të tmerrshme. Goditeshe me shkop në pjesën e sipërme dhe të poshtme të shpinës dhe në përgjithësi duhej të kaloje dy ditë në "Kopshtin e trëndafilave". Atje duhej të bëje rrotullime "gramafoni". Me një gisht në vesh dhe një gisht tjetër në rërë, duhej të ecje vazhdimisht në formë rrethi, me një roje që të kontrollonte nëse e bëje siç duhet. Ky ritual përsëritej pa pushim, për dy ditë të tëra. Ishte jashtëzakonisht e vështirë të rezistojë.

Gjatë netëve të pastroje morrat dhe të kontrolloje këmbët. Kur dikush kalonte afër duhej t'i nxirrje këmbët nga shtrati. Nëse roje nuk i pëlqente si e kishe bërë, merrje një të rrahur tjetër me shkop. Gjatë këtij procesi duhej të numëroje me zë të lartë numrin e goditjeve që merrje. Mbjaj mend një nga të burgosurit që ishte ndotur për shkak të diarresë së papritur, e detyruan të bënte rrathë duke u zvarritur lakuriq në në baltë.

Një herë, gjatë thirrjes kur ishte Kotälla (komandanti sadist i kampit) harrova të përshëndes dhe të them numrin tim të kampit; U sulmova nga qeni i tij. Si ndëshkim më duhej të qëndroja në Kopshtin e Trëndafilave për dy ditë. Ja ku isha duke u rrotulluar rreth gishtit tim, i cili duhej futur në rërë. Dy ditë jashtë pa çati mbi kokë, në erë, pa ushqim dhe me një gllënjë ujë ndonjëherë.

IG FARBEN NË NEUSS DHE DORMAGEN

Pas kësaj periudhe gati tre mujore u transportova në IG Farben në Neuss¹, së bashku me rreth 30 të burgosur të tjerë. Në atë kohë ishte shumë ftohtë. Mbërritëm në një kamp ku shumë kombësi të ndryshme u vunë në punë. Sidoqoftë, shumica e të burgosurve ishin rusë dhe të tjerë nga Lindja. Ikja ishte e pamundur, sepse në tren ishin rreth njëzet persona që qëllonin me armë drejt gjithçkaje që lëvizte përgjatë hekurudhës.

¹ Fabrika e përmendur ndoshta është Rheinmetall. Rheinmetall disa herë është përshkruar si filial i IG Farben gjatë Luftës së Dytë Botërore. Rheinmetall në Neuss prodhonte municione për artilerin. [shënim i botuesve]

Unë nuk kisha asnjë bagazh, sepse i kisha veshur të gjitha rrobat që kisha, që të mos mund të m'i vidhnin.

Në IG Farben m'u desh të lustroja më letër smeril sipërfaqen e ashpër të predhave mortajë, 100 copë në orë. Kjo ishte punë e rrezikshme dhe e vështirë, e kryer pa veshje mbrojtëse ose maskë. Meqenëse shëndeti im po përkeqësohej progresivisht dhe shpesh më binte të fikët gjatë punës, mjeku i kampit siguroi që unë të kisha një punë tjetër dhe unë u caktova të mbushja predhat mortajë. Kushtet ishin shumë të këqija edhe atje. Bombardimet ishin shumë të egra. E gjithë fabrika u shkatërrua nga bombardimet që ndodhën në dimrin e 1943-1944, gjatë së cilës u përdorën bomba fosfori dhe bomba zinxhir.

Një imazh që nuk do ta harroj kurrë është ai i një vajze të vogël që luante sipër një tuneli gjatë alarmit para bombardimit. Fillimi i sulmit ajror përhapri panik, shumë njerëz po përpiqeshin të arrinin në tunelet në periferi të kampit. Në këtë gjendje kaosi, nuk ishte e mundur të shkohej deri tek vajza dhe ta çoje në strehë. Tuneli mori një goditje të drejtpërdrejtë dhe shumë njerëz në të u vranë. Unë isha në krater me tre burra, në përpjekje për të shmangur mbetjet fluturuese të bombave. Pas bombardimeve u bë e qartë se askush nuk e kishte marrë vajzën në strehë, ajo ishte goditur nga copa dhe mbeturina fluturuese dhe kishte vdekur. Të burgosurit e mbetur i grumbulluan së bashku dhe i vendosën në një mjet transporti.

Shkova në Dormagen, së bashku me një Frizian të quajtur van Veer. Atje isha përsëri në një fabrikë të IG Farben. Ky kompleks shtrihej përgjatë një hekurudhe kryesore dhe kështu ishte objektivi i bombardimeve të përditshme intensive. Gjumi ishte praktikisht i pamundur për shkak të zhurmës së trenave dhe rënies së bombave. Detyra ime ishte të pastroja trenat e transportit me një solucion amoniaku, pa veshur asnjë veshje mbrojtëse sigurisht.

Shëndeti im vazhdoi të përkeqësohej dhe në një moment më duhej të hiqja dorë nga puna. Kam kaluar dy javë i sëmurë në shtrat, gjë që ishte një katastrofë, sepse një person që nuk punonte nuk mund të hante. Solidariteti i shokëve të burgosur më ndihmoi ta kaloja. Ndonjëherë merrja një copë bukë dhe pak ujë, derisa u përmirësova sa të punoja përsëri.



Marinus Soeters (rreshti mbrapa, fund majtas) në një grup të rinjsh të Gardës Katolike.

KOLEKSIONI I FAMILJES SOETERS

ÇLIRIMI

Më 6 mars 1945, u çliruam nga trupat polake dhe të gjithë u desh të largoheshim nga Dormagen. U enda nëpër zonë për dy javë me disa burra të tjerë, duke u përpjekur të gjeja një strehë nga ngjarjet që ndodhnin rreth nesh. Një banakier miqësor nganjëherë na jepte ushqim. Kur e konsideruam të sigurt, filluam udhëtimin drejt shtëpisë. Gjatë rrugës, na mori një kamion britanik dhe na u desh përsëri të shkonim në një kamp, ku duhej të dorëzonim të gjitha furnizimet tona. Pas rreth dy javësh u lejuam të largoheshim dhe të shkonim në shtëpi me tren dhe autobus.

Askush në shtëpi nuk tregoi shumë interes për përvojat e mia të luftës. Pritej të mos ankoheshe dhe të filloje shpejt gjetjen e një pune, për të ndihmuar familjen të ushqehet. Kjo është historia e peripecive të mia gjatë luftës, të cilën më në fund mund ta tregoja vetëm pas shumë insistimeve të djalit im.

RRETH BABAIT

shkruar nga by Sion Soeters



Marinus Soeters gjatë turit në ish kampin Amersfoort, 19 janar 2004.
KOLEKSIONI I FAMILJES SOETERS

Pasi u kthye në shtëpi nga Gjermania, babai im gjeti punë në një fabrikë lëkurësh dhe u takua me mamanë time. Ata u martuan në vitin 1950 dhe kishin dy fëmijë. Një vajzë lindi në 1952 dhe një djalë (unë) lindi në 1958. Babai u bë menaxher i fabrikës së lëkurës dhe punoi atje derisa u sëmur në 1980.

Për sa e mbaj mend vuajti gjithmonë nga pagjumësia. Kur isha fëmi, ndonjëherë zgjohesha nga gjumi sepse e dëgjoja të bërtiste dhe të rënkonte. Nuk folëm kurrë për këtë, sepse ishim të bindur se po ta bënim do të kontribuonim në mjerimin e tij. Lufta ishte gjithmonë e pranishme në shtëpinë tonë.

Babai u sëmur rëndë në gjysmën e dytë të viteve 1970 dhe hynte e dilte nga spitali. Në vitin 1979 ai u diagnostikua si skizofrenik dhe u trajtua për këtë. U detyrua të ndërpresë punën në 1980. Ekzaminimi i mëtejshëm provoi se ai nuk ishte skizofrenik, por u diagnostikua me Çrregullim të Stresit Post-Traumatik.

Ai aplikoi për statusin e "viktimës civile të luftës" dhe iu dha një pension i vogël kur iu njoh statusi në fillimin e viteve 1990. Ai

u njoh gjithashtu si një "viktimë civile e luftës" nga qeveria gjermane dhe u dha *Wiedergutmachung*².

Në vitin 2001, e shoqërova atë në vendin e ish-kampit të përqendrimit në Amersfoort. Ky ishte kthimi i tij i parë në këtë vend ku kishte vuajtur aq shumë. Pas asaj vizite ai më tregoi gjithë historinë e tij për aq sa i kujtohej. Ishte hera e parë që e kisha dëgjuar ndonjëherë të thoshte më shumë se një fjali për luftën.

Pas asaj vizite ai dukej shumë më mirë dhe më i shëndetshëm. Ai kishte gjetur njerëz të tjerë që kishin pasur të njëjtin fat si ai.

Babai vdiq papritmas për shkak të një ataku në zemër në 30 prill 2004. Ai na mungon shumë dhe *Koninginnedag* (Dita e Mbretëreshës, 30 prill) nuk është një ditë festive për ne. Ai u varros në 4 maj (në Ditën tonë Kombëtare të Përkujtimit të të Vdekurve të Luftës së Dytë Botërore). Siç tha dikush në varrimin e tij, Marinus u çlirua një ditë më herët se pjesa tjetër e Hollandës (5 maj).

KONTRIBUT I FONDACIONIT HISTORIA E REGJIMEVE TOTALITARE DHE VIKTIMAVE TË TYRE

² Dëshmëpërblimet që qeveria gjermane ra dakort t'u paguaj të mbijetuarëve të Holokaustit dhe personave që ishin viktimë të punës së detyruar nga Nazistët [shënim i botuesve]

REPUBLIKA ÇEKE



Republika e Çekosllovakisë u themelua pas Luftës së Parë Botërore nga rajonet Çeke dhe Sllovaqe të Perandorisë Austro - Hungareze (Bohemia, Moravia, Silesia Austriake, Sllovakia dhe Ruthenia Karpate). Në gjysmën e dytë të viteve 1930, Çekosllovakia ishte demokracia e vetme në EUROPËn Qendrore dhe Lindore.

PUSHTIMI NAZIST

Pas Marrëveshjes së Mynihut të 29 shtatorit 1938, Gjermania aneksoi rajonet veriore, perëndimore dhe jugore të Bohemisë dhe Moravisë (Sudetenland). Më 14 mars 1939, Sllovakia shpalli pavarësinë dhe më 15 mars 1939 Gjermania pushtoi pjesën tjetër të vendit, duke krijuar protektoratin e Bohemisë dhe Moravisë. Në protektorat u persekutuan dhe u vranë hebrenjtë, romët dhe kundërshtarët politikë. Shumë anëtarë të ushtrisë së para luftës luftuan në ushtritë Aleate, në frontin Perëndimor dhe Lindor. Aleatët perëndimorë çliruan pjesën perëndimore të vendit në ditët e para të majit 1945. Ushtria sovjetike arriti në Pragë më 9 maj 1945.

REGJIMI KOMUNIST NË ÇEKOSLLOVAKI

Në mars 1945, qeveria çekosllovaqe në mërgim dhe partia komuniste nënshkruan një program qeveritar në Moskë i cili, ndër të tjera, nxori të jashtëligjshme partinë politike konservatore më të madhe të para luftës. Statuti shtetëror i Çekosllovakisë u rivendos, por në qershor 1945 u aneksua Ruthenia nga Bashkimi Sovjetik. Në 1946, komunistët fituan në zgjedhjet e kufizuara. Më 25 shkurt 1948, pasoi një grusht shteti komunist. Periudha e zbutjes së politikave komuniste, e njohur si Pranvera e Pragës, u shtyp nga pushtimi ushtarak i vendeve të paktit të Varshavës më 21 gusht 1968.

Regjimi ra në Revolucionin e Kadifenjtë që filloi nga një demonstratë studentore më 17 nëntor 1989; Zgjedhjet e lira u mbajtën në qershor 1990.

Më 1 janar 1993 Çekosllovakia u nda paqësisht në Republikën Çeke dhe Republikën e Sllovakisë.

MILADA HORÁKOVÁ lindi më 25 dhjetor 1901 në Pragë. Në prag të shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, vdiqën brenda një jave motra dhe vëllai i Miladës. Lindja e një fëmije tjetër, motra e vogël e Miladës, Vëra, solli përsëri një shkëlqim në jetën e familjes. Milada studioi për drejtësi në Pragë. Ajo u bë një figurë e shquar në jetën publike, një mbrojtëse e të drejtave të grave dhe një politikane demokrate. Pas pushtimit gjerman ajo u bashkua me lëvizjen e rezistencës nëntokësore. Ajo u arrestua nga Gestapo në 1940 dhe u dënua me vdekje për "agjitacion" kundër regjimit, por u fal. Pas vitit 1945 ajo u zgjodh Anëtare e Parlamentit, por dha dorëheqjen pas grushtit të shtetit Komunist në shkurt 1948.

Në 1949 ajo u arrestua dhe u akuzua për përpjekje të hamendësuar për të përmbysur regjimin Komunist. Një gjyq teatral u organizua kundër saj dhe dymbëdhjetë personaliteteve të tjera të jetës politike ("Milada Horáková dhe Co."). Milada Horáková ishte një nga katër personat që u dënuan me vdekje dhe u varën në Pragë më 27 qershor 1950. Kjo ditë festohet si dita përkujtimore e viktimave të Komunizmit në Republikën Çeke.



ARIVA E KLUBIT
MILADA HORÁKOVÁ

Milada Horáková

Një Grua e Cila Mbeti Besnike ndaj Bindjeve të Saj

shkruar nga Zora Dvořáková

Koha po afrohej. Në më pak se gjashtëdhjetë orë jeta e saj do të mbaronte. Ata e vendosën atë në spitalin e vjetër në Burgun Pankrác të Pragës. E çuan në qelinë e vdekjes, një dhomë e vogël bosh me një tavolinë dhe karrige. Ata e ruanin dhomën vazhdimisht, por e lejuan t'u shkruante letra njerëzve më të afërt dhe më të dashur në momentet e fundit të jetës së saj.

Ndërsa shkruante rreshtin hyrës "Papa im gjithnjë aq i dashur, gjithnjë aq i mirë", ajo ndjeu se kishte babanë e saj tetëdhjetë e një vjeç përballë. Ata ishin shumë të ngjashëm me njëri-tjetrin në karakter, prirje intelektuale dhe përfshirje emocionale. Ishte ai, një mbështetës i përjetshëm i parimeve humaniste dhe demokratike të presidentit të parë të Republikës Çekoslloake, T. G. Masaryk, i cili udhëhoqi mendimin e vajzës së tij, pikëpamjen e saj për jetën dhe orientimin e saj politik në këtë frymë.

Ajo gjithmonë u qëndroi besnike këtyre parimeve; prandaj ishte e natyrshme që ajo të bashkohej me rezistencën pas pushtimit gjerman të pjesës tjetër të ish-Çekosllovakisë, Protektoratit të Bohemisë dhe Moravisë. Megjithatë, ajo u arrestua, e pa veten në një gjykatë gjermane në Dresden dhe për herë të parë u përball me kërcënimin e dënimit me vdekje. Atë kohë ajo i shpëtoi atij dënimi.

Disa vjet më vonë një gjykatë komuniste arriti ta dërgonte atë në vendin e ekzekutimit. Edhe atëherë, ajo u qëndroi besnike parimeve në të cilat besonte, duke mos hezituar të thoshte në fjalën e saj të fundit para selisë së gjyqimit: "... Unë i qëndroj besimit tim, sepse jam mbështetur në qëndrimin dhe informacionin e njerëzëve që unë i konsideroja si autoritete, në radhë të parë të dy Presidentëve të Republikës Çekoslloake TG Masaryk dhe Dr. Edvard Beneš, të cilët ndikuan tek unë gjatë gjithë jetës sime." Për gjykatën Komuniste deklarata e saj ishte tërbuese dhe u mbajt e fshehtë gjatë gjithë epokës totalitare Komuniste.

VAJZA E BABAIT TË SAJ

Kuptimi i ndërsjellë që ajo kishte me babanë e saj ishte shumë i thellë. Megjithëse të dy ishin racionalë dhe të pavarur intelektualisht, ajo gjithashtu ishte e mbushur me ndjeshmëri të madhe, cilësi të cilën ndoshta e trashëgoi nga nëna e saj, një grua e brishtë dhe emocionale që vdiq para kohe. Ajo

shfaqti një lloj kujdesi mbrojtës për nënën e saj. Në vitet formuese të saj, ajo dhe prindërit e saj kaluan një tragjedi familjare, duke humbur brenda një jave motrën dhe vëllain e vogël të Miladës, gjë që çoi nënën e saj në një krizë nervore. Kjo ndodhi në kohërat e vështira afër shpërthimit të Luftës së Parë Botërore. Vetëm lindja e një fëmije tjetër, motra e saj Vëra, sollti më shumë shkëlqim në jetën e tyre.

Duhet të ketë qenë kjo përvojë që i tregoi Miladës se jeta mund të jetë mizore dhe e papritur dhe që nxiti në të një vendosmëri për të ndihmuar ata që vuanin dhe kishin nevojë. Aty pa detyrën e jetës së saj dhe mendoi se mund ta përmbushte më së miri duke studiuar mjekësi. Megjithatë ishte përsëri babai i saj që e drejtoi ndryshe. Ai e bindi se si një avokate e specializuar në fushën sociale dhe humanitare, do të ishte e aftë të mbështeste me efikasitet dhe të ishte e dobishme për ata që kishin nevojë për ndihmë dhe kujdes të tillë.

Babai i saj qëndroi gjithmonë pranë saj; ai e mbështeti dëshirën e saj për të studiuar dhe për të qenë publikisht aktive. Ai vetë ka pas vepruar si një qytetar i lirë. Shumë herë nëna e Miladës shqetësohej kur babai i saj largohej nga shtëpia për të marrë pjesë në demonstrata të ndryshme. Edhe në këtë ai ishte një shembull për Miladën dhe nuk është për t'u habitur që ai qëndroi pranë saj edhe në pranverën e vitit 1918, kur ajo u përjashtua nga shkolla e mesme që po ndiqte. Disa informatorë të policisë e kishin denoncuar se u shpërndau lule protestuesve në një tubim kundër vazhdimit të luftës. Fatmirësisht, ata e lanë të mbaronte studimet në një shkollë tjetër të mesme në Rrugën Slezská, të cilën e filloi në vjeshtën e vitit 1918. Sidoqoftë, kur ajo u akuzua nga gjykata Komuniste, propaganda komuniste përhapri një trillim absurd se ajo kishte qenë një personazh i dyshimtë tashmë në rininë e saj sepse ishte përjashtuar njëherë nga shkolla për pjesëmarrje në rrëzimin e Kolonës Mariane¹ në Sheshin e Qytetit të Vjetër në Pragë më 3 nëntor 1918. Megjithëse realiteti ishte krejt i ndryshëm dhe kohët nuk përputheshin, u tha se ishte Milada ajo që hodhi litarin rreth qafës së Virgjëreshës Mari.

Ndërsa i shkruante letrën e saj të fundit babait, ajo ndjeu trishtim të thellë për barrën që po i vinte mbi shpatulla, por edhe atëherë ajo u lut që ai të qëndronte, të mbizotëronte dhe t'i tregonte vajzës së saj Janës gjithçka që ajo vetë nuk kishte arritur të bënte për familjen dhe të afërmit e tyre. Rritja e vajzës me dijen se nga vinte dhe ku përkiste, do të siguronte një vazhdimësi, një ekzistencë të pandërprerë dhe të dy do të jetonin në jetën e saj të re.

Midis mbarimit të letrës drejtuar babait të saj dhe rreshtave të para që ajo filloi t'i shkruante burrit të saj, kishin kaluar rreth tridhjetë e gjashtë orë. Në atë kohë, ajo shkroi disa letra të tjera: motrës së saj Vëra dhe burrit të saj, nënës së burrit të saj, mikeshave të saj femra nga Sadská², amvisës që mbajti shtëpinë e saj në rregull dhe së fundi vajzës së saj të vogël Jana - një letër plot dashuri dhe këshilla të

¹ Monument fetar kushtuar Virgjëreshës Mari [shënim i përkthyeses]

² Vend në lindje të Pragës [shënim i përkthyeses]

shqetësuar, sepse ajo ishte e vetëdijshme se po linte pas një vajzë adoleshente.

LAMTUMIRË BURRIT TIM

Kur ajo filloi t'i shkruante letrën burrit të saj Bohuslav, asaj i erdhën në mendje njëzet e tre vitet e kaluara së bashku. Ajo u takua me të kur ishte studente e Fakultetit të Drejtësisë. Në atë kohë, ai ishte një inxhinier i bujqësisë i cili më vonë fitoi një doktoraturë në shkencat teknike. Ai punoi për Radion Çekosllovake ku kishte programin e tij bujqësor. Ata ndanin një marrëdhënie të thellë emocionale në të cilën Bohuslav tregoi mirëkuptim të madh për punën dhe aktivitetet publike të gruas së tij. Ai gjithmonë i vinte interesat e saj në radhë të parë. Në letrën e saj, Milada pranon se e di që ai kurrë nuk e pengoi atë në rrugëtimin e saj. Ajo përmbushi dëshirën e saj për të ndihmuar dhe për të qenë në dobi të nevojtarëve si avokate e punësuar në Zyrën Qendrore Sociale të Kryeqytetit të Pragës. Punoi me vetëmohim për Kryqin e Kuq Çekoslovak. Por kjo nuk ishte e mjaftueshme për të kënaqur idenë e saj për të qenë e dobishme për të mirën e përgjithshme. Si një grua e re moderne që jetonte në kohën pas Luftës së Parë Botërore, kur të drejtat e grave po fitonin ndjeshëm, ajo u përfshi në lëvizjen e grave. Ajo admironte aktivitetet e themelueses të Këshillit Kombëtar të Grave, Senatores Františka Plamínková, dhe u bë bashkëpunëtoresh e saj. Ajo shërbeu si CEO e Këshillit Kombëtar të Grave, gjithashtu drejtuese e departamentit të tij ligjor.

Në spektrin politik, ajo ndihej më afër Partisë Nacional Socialiste të Edvard Beneš. Ajo u bë anëtare e saj qysh gjatë kohës së Republikës së Parë³.

Milada ishte shumë me fat në jetë, pasi dy burrat që e shoqëruan në udhëtimin e saj të jetës - babai dhe burri i saj - kishin mirëkuptim të plotë për të dhe të gjitha aktivitetet e saj. Burri i saj i qëndroi pranë në kohë të mira dhe të këqija. Pas pushtimit gjerman, ata të dy u bashkuan me lëvizjen e rezistencës, Selinë Politike dhe Komitetin e Peticioneve *Věrní zůstaneme* (Besnik do të qëndrojmë). Ata u arrestuan së bashku



Milada Horáková në një mbledhje publike në Český Krumlov, 1947.

ARKIVA E SHËRBITIT SEKRET TË REPUBLIKËS ÇEKE

³ Emri i Partisë Nacional Socialiste të Çekoslovakisë është çorientues. Ishte një parti demokratike e qendrës së majtë dhe nuk kishte asgjë të përbashkët me Partinë Nacional Socialiste Demokratike të Punëtorëve (NSDAP) të Adolf Hitlerit në Gjermani. Termi Republika e Parë në Çekoslovakë përdoret për të përshkruar periudhën midis vitit 1918, themelimit të Çekoslovakisë pas Luftës së Parë Botërore dhe Marrëveshjes së Mynihut të vitit 1938, bazuar në të cilën Hitleri aneksoi rajonet kufitare të Çekoslovakisë me popullsi gjermanofolëse [shënimi i përkthyeses].

gjatë pushimeve të tyre verore më 2 gusht 1940 në fshatin Horní Bradlo afër Nasavrky⁴ ku erdhi Gestapo për t'i arrestuar. Ata e panë njëri-tjetrin vetëm për pak kohë në Kalanë e Vogël në Terezín⁵ dhe më pas në 1944 pas dënimit të *Volksgesicht* (Gjykata e Popullit) në Dresden, kur ajo u dënua me tetë vite burg dhe ai me pesë.

Milada kishte frikë se lufta do të shkatërronte familjen e tyre; për fat të mirë kjo nuk ndodhi. Në atë kohë, ajo u premtoi njerëzve të saj të dashur se do t'u përkushtojë vetëm atyre, se do të kompensonte atë që kishte neglizhuar deri atëherë. Por ngjarjet e pasluftës e tërhoqën përsëri në trazirat e rrjedhës. Ajo u ndie e detyruar të vazhdonte punën e Františka Plamínková që ishte ekzekutuar gjatë luftës. Kur u formua Këshilli i Grave Çekosllovaqe, ajo u bë kryetare e tij.



Vëra, Motra e Milada Horáková, burri Bohuslav dhe vajza Jana.

ARKIVA E SHËRBIMIT SEKRET TË REPUBLIKËS ÇEKE

Ajo pa se ishte e nevojshme të ndihmonte ata që ktheheshin nga kampet e përqendrimit dhe burgjet. Prandaj nuk hezitoi të bëhej një nga pesë nënkryetaret e Bashkimit të të Burgosurve Politikë të Çliruar. Dhe së fundmi, në një diskutim me Presidentin Beneš, iu bind kërkesës së tij se ishte e nevojshme të kishte njerëz si ajo në jetën publike dhe që ajo të pranonte mandatin e një deputeti në Asamblenë e Përkohshme Kombëtare. Mandati i saj u konfirmua në zgjedhjet e vitit 1946 kur kandidoi për rrethin e České Budějovice⁶ dhe u bë deputete për Partinë Nacional Socialiste në Asamblenë Kombëtare Kushtetuese.

Burri i saj i qëndroi pranë gjatë kësaj faze të ngarkuar. Ai gjithmonë e mbështeste atë dhe ajo ndjente mirënjohje dhe dashuri të sinqertë për të. Ai kishte futur një dimension tjetër në jetën e saj. Ai vinte nga një familje evangjeliste dhe Milada, nga katolike deri atëherë u kthye në Protestantizëm. Ajo reflektoi shumë në çështjet e besimit dhe fesë, dhe gjatë fatkeqësive që përjetoi në burgjet naziste dhe komuniste, ajo gjeti forcë në besimin e saj në Zot.

Kur iu kërkua të shprehte dëshirën e saj të fundit para ekzekutimit, ajo kërkoi të dinte se çfarë kishte ndodhur me burrin e saj. E digjte dëshira të dinte fatin e tij. Pas arrestimit të saj dyshoi se ai mund të kishte arritur të ikte; megjithatë nuk e dinte me siguri nëse e kishin arrestuar edhe atë, apo edhe nëse ai ishte akoma gjallë. Ata i thanë se nuk dinin asgjë për të, megjithëse ishin të vetëdijshëm se ai ishte arratisur në mërgim

⁴ Vend në lindje të Bohemisë [shënim i përkthyeses]

⁵ Terezín, një ish-qtet garnizon në veri të Pragës, ishte vendi i një burgu (Kalaja e Vogël), një geto hebreje dhe një kamp përqendrimi gjatë Luftës së Dytë Botërore [shënim i përkthyeses]

⁶ Një qytet i madh në Bohemian jugore [shënim i përkthyeses]

për të shpëtuar. Duke ia nxitur këtë pasiguri, ata ia shtuan vuajtjet asaj. Kështu që i shkroi atij në letrën e saj: *“...Unë as nuk e di nëse je ndër të gjallët dhe nëse do të jetë ndonjëherë e mundur që t'i lexosh këto fjalë. Kjo është dhimbja më e madhe në zemrën time, që nuk di asgjë për ty dhe që nuk kam asnjë siguri, madje as të trishtuar, dhe janë ndoshta vetëm disa orë më shumë nga jeta ime e mbetur.”*

Ndërsa po shkruante letrat për të dashurit e saj në qelinë e vdekjes, iu kthyen në mendje përvojat e tmerrshme ndaj të cilave ishte ekspozuar në dhomat e hetimeve naziste dhe në burgjet e tyre. Mendonte se gjëra të tilla nuk do të përsëriteshin kurrë më në jetën e saj - dhe megjithatë ato ndodhën vetëm brenda disa vitesh, kur Sigurimi i Shtetit Komunist e arrestoi dhe e vuri para pyetjeve pafund.

PËRKUSHTIMI NDAJ PUNËS PUBLIKE

Megjithatë në letrat e saj nuk la gjurme vuajtja që ajo kishte duruar. Ajo shkruan për dashurinë, për marrëdhëniet e bukura njerëzore, për jetën që do të kishte një perspektivë dhe që ishte plot mirëkuptim dhe mirësi. Ajo çfarë dëshiron është që (duke folur figurativisht) llogaritë e saj të zgjidhen; ajo dëshiron të largohet nga bota pa asnjë borxh. I lutet të dashurve të saj që ta falin për dhimbjen që po u shkakton. Ajo është më e shqetësuar për ta, vuajtjet e tyre, iu lutet që të mbrojnë Janën dhe të vazhdojnë jetën. Në letrat e saj, nuk ka asgjë nga momentet e komplikuara dhe të tensionuara të aktiviteteve të saj publike, ose nga absurditetet mizore të cilave iu desh të kalonte pas arrestimit nga Sigurimi i Shtetit.

Vitet e pasluftës gjatë të cilave ajo ishte deputete dhe qëndroi në krye të Këshillit të Grave Çekosllovake ishin një periudhë jashtëzakonisht dramatike gjatë së cilës sinjalet e afrimit të totalitarizmit komunist po shfaqeshin me intensitet në rritje. Si politikane e bindjeve demokratike, ajo hyri në përplasje dhe konflikte me deputetë dhe autorë komunistë. Ata i vëzhguan aktivitetet e saj në Këshillin e Grave Çekosllovake me një armiqësi të madhe sepse ajo arriti të drejtojë lëvizjen e grave në një frymë jopartiake, ndërsa Komunistët përpiqeshin të merrnin kontrollin mbi të dhe ta bashkonin me të ashtuquajturin Balli Kombëtar. Këshilli i Grave Çekosllovake ishte i lidhur me organizata të ngjashme të huaja dhe për këtë arsye ata i vëzhguan me shumë dyshim këto kontakte të saj ndërkombëtare. Me kalimin e kohës, ata u përpoqën ta fitonin atë. Ajo kishte autoritet, kishte një të kaluar të pastër, kishte një dhunti e cila ndikonte te njerëzit. Ajo ishte e pasur me një talent të shkëlqyeshëm për retorikë. Një person i tillë supozohej të ishte në anën e tyre. Në vend të kësaj, ajo i tërhoi ata me kritikën e saj të patundura në parlament dhe në raste të ndryshme publike.

Në Parlament, ajo punoi në Komisionin për të Drejtën Kushtetuese dhe në Komisionin e Punëve të Jashtme, i cili përsëri zgjeroi kontaktet e saj të shumëfishta. Falë kësaj ajo ishte gjithmonë e informuar në mënyrë perfekte. Nuk ishte e mundur ta bëje të besonte trillime apo gënjeshtër. Jashtë vendit, ajo mori pjesë në konferenca të ndryshme dhe takime ndërkombëtare. Kjo rriti dyshimet ndaj saj. Shumë kohë përpara shkurtit 1948 ajo u ndoq nga Sigurimi i Shtetit.

Menjëherë pas luftës humbi iluzionet e saj fillestare rreth Bashkimit Sovjetik. Disponohet një kujtesë e deklaratës së saj: "... *Stalini është i interesuar për një kufizim të ngjashëm të statutit Çekoslovak dhe një skllavërim të ngjashëm të popullit Çekoslovak, siç ishte Hitleri. Kjo duhet të kundërshtohet që nga fillimi. Me anë të forcimit dhe zgjerimit sistematik të kontakteve miqësore me Perëndimin, ne duhet ta krijojmë në kohë një kundërpeshë për qëllimet e Stalinit ndaj Çekoslovakisë.* " Në fjalimet publike ajo shpesh kthehej në idenë se edhe nëse mbështetemi politikisht në Bashkimin Sovjetik, ne duhet të zbatojmë politikën tonë. Bashkëpunimi me Bashkimin Sovjetik duhet të jetë i ekuilibruar me kontakte miqësore ndaj Perëndimit.

Megjithëse marrëdhëniet e saj me njerëzit ishin shumë miqësore dhe fytyra e saj ishte stolitur zakonisht me një buzëqeshje, ajo nuk ishte as naive dhe as torollake. Ajo ishte e aftë të sulmonte linjat e partisë së saj kur zbuloi, pak para shkurtit 1948, se disa funksionarë të rëndësishëm të Partisë Nacional Socialiste kishin filluar të bashkëpunonin me Komunistët në këmbim të favoreve të premtuara.

Pas fillimit të totalitarizmit komunist në shkurt 1948, Milada Horáková donte të dorëzonte menjëherë mandatin e saj të deputetit. Ajo donte ta bënte këtë në një fjalim në Parlament ku do të jepte arsyet pse nuk mund të mbështeste qeverinë Komuniste. Anëtarët e saj të partisë dhe burri i saj e bindën kundër atij veprimi. Shoqëria ishte e rrethuar nga frika; komunistët kishin filluar menjëherë të arrestonin kundërshtarët e tyre politikë. Përfaqësuesit e partive demokratike po iknin në mërgim.

Milada dha dorëheqjen nga mandati i deputetit në 10 mars 1948, në prag të vdekjes tragjike dhe të pashpjegueshme të Ministrisë të Punëve të Jashtme Jan Masaryk. Në atë kohë, disa organizata, në të cilat ajo ishte anëtare e nderit, nga frika, kishin filluar ta përjashtonin atë. Dyert e Këshillit të Grave Çekoslllovakë u mbyllën për të, megjithëse ishte ende kryetare e tij. Si ajo, ashtu edhe burri i saj mbetën pa punë, derisa pas një farë kohe ajo arriti të gjejë një pozicion të thjeshtë në administratë.

Sidoqoftë, ajo ishte e bindur se totalitarizmi Komunist nuk mund të zgjaste shumë. Rezistenca po fillonte të formohej kundër tij, bazuar në përvojat e rezistencës anti-naziste. Ishte e nevojshme për të ndihmuar të prekurit, për të ndihmuar ata që donin të arratiseshin përtej kufirit. Ishte e nevojshme të përpunoheshin koncepte dhe procedura të reja për ndryshimin e ardhshëm të regjimit. Rezistenca e brendshme duhej të lidhej përmes një kanali informacioni me përfaqësuesit e rezistencës së huaj.

E ashtuquajtura "gjashtëshja politike" e rekrutuar nga anëtarët e Partisë Nacional Socialiste filloi të përmbushte këto detyra dhe Milada kishte pozicionin e saj të pazëvendësueshëm në të. Ishte ajo që përpunoi lajmet për rezistencën e huaj dhe që mori lajme prej tyre. Ajo mendoi të shkonte jashtë vendit por arsyetoi se ishte më e rëndësishme për tani të qëndronte në shtëpi. Ajo mbështeti idenë se do të ishte mirë të bashkoheshin forcat rezistence të të gjitha partive demokratike. Kjo u diskutua në një takim në Vnoř në shtator 1948, por nuk u arrit asnjë marrëveshje. Sidoqoftë, ky takim u konsiderua nga Sigurimi i Shtetit dhe gjyqësori komunist si provë e ekzistencës së një qendre armiqësore.

ARRESTIMI DHE GJYOI

Kur E arrestuan, Milada Horáková më 27 shtator 1949, ata nuk kishin asnjë provë bindëse kundër saj. Por këto ishin kohërat e linjës së Stalinit të luftës së intensifikuar të klasave. Si pjesë e përgatitjeve për "gjqet e përbindëshave", ekspertët sovjetikë filluan të punonin në Çekosllovakia. Gjyqi i etiketuar "Udhëheqja e komplotit diversant kundër republikës: Milada Horáková dhe co." u bë një gjyq përbindësh i orkestruar artificialisht që i shkaktoi terror shoqërisë. Sipas shembullit sovjetik, pyetjet dhe përgjigjet në protokollet e marrjes në pyetje u krijuan nga hetuesit. Ata manipuluan faktet dhe i zhvendosën ato në kontekste inekzistente. Të akuzuarit u detyruan të mësojnë protokollet përmendësh dhe të përgjigjen në gjykatë në përputhje me rrethanat.

Gjatë procedurave gjyqësore që filluan më 31 maj dhe përfunduan më 8 qershor 1950, Milada Horáková u përpoq disa herë të braktiste procedurën e imponuar dhe të fliste për vullnetin e saj. Ajo nuk po mbronte veten; ajo më tepër shpjegoi qëndrimin dhe veprimet e saj. Në tërësi, trembëdhjetë persona të akuzuar u dënuan, katër prej të cilëve morën dënimin me vdekje. Dënimet e tjera varionin nga burgimi i përjetshëm deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur ajo mbaroi së shkruari letrën e saj të dhjetë në qelinë e vdekjes, ishte pasditja e 26 qershorit 1950. Ata i plotësuan dëshirën e saj për të dërguar një prift evangjelist të cilin ajo kishte kërkuar. Dhe pastaj e çuan në një korridor nëntokësor ku do të takonte vajzën e saj Jana dhe motrën e saj Vëra me burrin e saj. Kështu i plotësuan një tjetër nga dëshirat e saj të fundit. Ky takim do të thoshte shumë për të; i solli qetësi shpirtit të saj. Ata nuk e lejuan të puthte vajzën e saj, por ishte Jana ajo që i bëri me shenjë se halla Vëra ishte në pritje të një fëmije. U prek nga nocioni i shkëmbimit të jetës së saj për jetën e një foshnjeje që do të vinte në botë si një lloj kalimi i pishtarit dhe e perceptoi këtë si një lehtësim të jashtëzakonshëm dhe një mënyrë pajtimi me fatin e vet. Kjo është ajo që rrëfeu në letrën e saj të fundit (njëmbëdhjetë) të shkruar në dy e gjysmë të mëngjesit të ekzekutimit të saj.

Të Martën, 27 qershor 1950, ajo u shoqërua në vendin e ekzekutimit, si e fundit nga grupi prej katër personash i dënuar me vdekje. Jeta e saj u ndërpre në orën 5.45 të mëngjesit.

Sot, Milada Horáková perceptohet si një simbol i rezistencës antikomuniste. Fati i saj mbetet një trashëgimi paralajmëruese për të tashmen dhe të ardhmen. Me koston e jetës së saj, ajo eci në rrugën e drejtësisë. Ajo besoi në vërtetësinë e vargut biblik: "Në rrugën e drejtësisë ka jetë; përgjatë asaj rruge është pavdekësia."



Milada Horáková në fjalimin e fundit në gjyqin e saj, Gjykata Shtetërore në Pragë, 1950.

AGJENCIA E SHTYTIPIT ÇEK ČTK

KONTRIBUT I INSTITUTIT PËR STUDIMIN E REGJIMEVE TOTALITARE

JOSEF BRYKS lindi më 18 mars 1916 pranë qytetit Olomouc. Ai u diplomua në një akademi ushtarake. Pas pushtimit gjerman në 15 mars 1939 ai u arratis në Francë përmes Ballkanit dhe më pas në Angli, ku u bë një pilot luftarak i Forcave Ajrore Mbretërore.

Më 17 qershor 1941 ai u qëllua mbi Francë.

Ai u dërgua në kampe të ndryshme të burgosurish dhe ndërmori disa përpjekje të jashtëzakonshme arratisjeje. Në 1944 u bashkua në përgatitjet për të ashtuquajturën "Arratisja e Madhe" nga kampi Stalag Luft III në Sagan.

Historia e tij e jetës frymëzoi filmin britanik të pasluftës Zemra

e Robëruar. Pas luftës u martua dhe u vendos në Olomouc me gruan e tij angleze. Pas grushtit të shtetit komunist në shkurt 1948 u përpoq pa sukses të arratisëj përtej Perdes së Hekurt. Ai u burgos, u dënua në një gjyq të trilluar dhe u dërgua për të gërmuar uranium në kampin e burgut Jáchymov, ku vdiq nga një atak në zemër natën e 12 gushtit 1957. Familja e tij nuk u njoftua; varri i tij u zbulua vetëm në 2009.



ARKIVA E KAREL BRYKS

Josef Bryks

Arratisja e Josef Bryks

Shkruar nga by Luděk Navara

Eshtë dita e fundit e vitit 1952. I burgosuri Nr. 868 po plotëson një pyetësor. Përmban mjaft pyetje të pakuptimta. Njëra prej tyre lexon: Cilat dështime dhe zhgënjime keni pasur në jetë?

I burgosuri Nr. 868 përgjigjet: «Për mirësinë dhe vetëmohimin ndaj njeriut dhe për kuptimin e gabuar unë jam burgosur pafajësisht për më shumë se nëntë vjet tani. Kam përjetuar zhgënjim duke mbivlerësuar shumë shpirtin çek.»

I burgosuri nënshkroi emrin e tij - Josef Bryks. Anëtar i Urdhrit të Perandorisë Britanike, mbajtës i Medaljes Çekoslovake për Trimëri përballë Armikut dhe dekorata të tjera. Një pilot luftarak për guximin e të cilit do të tregoheshin legendat e mëvonshme. Dhe një nga arratisjet e të cilit frymëzoi krijuesit e filmit britanik të pasluftës Zemra e Robëruar.

Në mënyrën e vet, titulli i filmit qëndroi i vërtetë edhe në këtë ditë të fundit të vitit 1952. Tani megjithatë, Bryks ishte një i burgosur i Komunistëve. Dhe kjo ishte më keq. Ai kurrë më nuk do të kthehej në liri, kurrë nuk do të shihte gruan dhe vajzën e tij, kurrë më nuk do të fluturonte.

Nëse shtojmë vitet e kaluara në robërinë gjermane dhe në burgjet komuniste, Bryks jetoi gjithsej 13 vjet pas telave me gjemba. Kur vdiq ai ishte vetëm 41 vjeç.

Megjithëse Bryks u bë i famshëm gjatë luftës për arratisjet e tij nga paraburgimi gjerman, ai përfundoi në një burg komunist sepse arratisja e tij përtej Perdes së Hekurt dështoi. Ai çoi dëm ikjen thelbësore të jetës së tij.

Epo, ai nuk e bëri; nuk ishte faji i tij. Arratisja u provokua nga shërbimi i inteligjencës Komuniste dhe Bryks thjesht u kap në një kurth që ishte ngritur për të.

KTHE LIBRAT

"Kthe librat" ishte fraza e koduar e zgjedhur nga një grup ish ushtarësh që po bëheshin gati të arratiseshin në Perëndim. Të gjithë, përveç njërit, kishin gra angleze dhe nëse dëshironin të jetonin me të në botën e lirë, ata praktikisht nuk kishin zgjidhje tjetër përveç se të kalonin Perden e Hekurt në mënyrë të paligjshme, pasi regjimi Komunist nuk u kishte dhënë pasaporta. Ata po planifikonin të kalonin kufirin

për në Perëndim afër Kynšperk, por kurrë nuk arritën as afër tij.

Bryks u arrestua në shtëpi në 2 maj 1948.

“Unë u kapa në një banesë në Olomouc me akuzën e dyshimit të përgatitjes së arratisjes jashtë vendit. ... sepse kisha një grua me origjinë angleze, interesi im i vetëm ishte të ikja jashtë vendit në mënyrë që të ndërtoja një familje të re me anë të një pune të ndershme në Australi. As me vetëdije dhe as padashur nuk doja t'i shkaktoja dëm vendit tim për të cilin kisha vuajtur aq shumë gjatë luftës”, shkruajti Bryks në një nga shumë historitë e jetës që të burgosurit fatkeq u detyruan të prodhonin në burgjet komuniste në mënyrë që të reflektonin” kritikisht” për të kaluarën e tyre.

Edhe ashtu, në verën e vitit 1948, situata nuk dukej aq e keqe për Bryks, pavarësisht arrestimit të tij. Komunistët nuk kishin ende të gjithë gjyqësorin nën kontroll, dhe kështu Gjykata Superiore Ushtarake e liroi atë nga të gjitha akuzat. Ishte vetëm një fitore e shkurtër - pas një apeli, ndërhyri Gjykata e Shtetit që funksiononte me direktiva komuniste, duke e dënuar Bryks me dhjetë vite burg.

Në intervistën e tij të hyrjes në burgun Pilsen-Bory, Bryks shprehu qartë atë që mendonte për burgosjen e tij. I pyetur se çfarë e shtyu atë të kryente veprën e pretenduar penale, ai u përgjigj: *“Dëshira për të jetuar mes njerëzve të drejtë që respektojnë trimërinë dhe sakrificën që unë i solla vendit tonë - dhe veçanërisht mundësinë për të jetuar i lumtur me familjen time.”* Familja e tij megjithatë tani ishte larg në anën tjetër të Kanalit Anglez.

Trudie dhe Josef u takuan në Angli, ku Josef arriti pas një largimi aventuresk nga Çekosllovakia e pushtuar. Gjatë arratisjes së tij ai kaloi nëpër shumë gjëra: i diplomuari akademisë ushtarake në Hranice dhe më vonë një anëtar i Skuadriljes së 33-të RAF me gradën toger i aviacionit iku nëpër Sllovaki dhe



Pas luftës. Josef Bryks me gruan e tij Trudie Bryks née Teller.

ARKIVA E KAREL BRYKS

Hungari në një mënyrë kaq fatkeqe sa u arrestua në Budapest dhe u dërgua në burg për tre muaj. Pas kësaj e kthyen në Sllovaki, por edhe nga atje u arratis, dhe nuk u ndal derisa arriti në Siri, ku u bashkua me Legjionin e Huaj. Dhe pastaj rruga e çoi në Ushtrinë Çekosllovake jashtë vendit. Ishte më 4 gusht 1940 që ai u ul për herë të parë në kabinën e një avioni që mbante shenjat sovraane të Forcës Ajrore Mbretërore Britanike ...

Ai dhe Trudie u takuan në maj 1941. Por qëndruan bashkë vetëm pak – më 17 qershor 1941 u zgjodh nga komanda e Forcës Ajrore Mbretërore si data më e mirë për bombardimin e një termocentrali në Francë.

Aksioni përfundoi në një betejë të përgjakshme; Aeroplani i Bryks ishte midis 13 të rrëzuarve. Ai luftoi me trimëri. *“Unë sulmova edhe një herë, por disa minuta më vonë u shfaq tym i zi në kabinën që më bëri të pamundur për të kontrolluar aparaturat. Pas pak, një zjarr shpërtheu në kabinë,”* tha Bryks më vonë, duke përshkruar betejën ajrore të cilës ai i mbijetoi duke bërë një kërcim të guximshëm nga avioni që digjej.

Vetëm më vonë u mor vesh që aeroplani i tij ishte rrëzuar nga vetë Adolf Galland, asi fluturues gjerman. Bryks arriti të shpëtonte jetën e tij në atë kohë; ai nuk e dinte se do të kalonte katër vitet e mbetura të luftës në robëri ose në arrati ...

I mbuluar me vaj të djegur, pa këpucë, por çuditërisht i padëmtuar, ai zbarkoi në një fushë. Francezët e një fshati aty pranë i dhanë rroba të vjetra civile por maskimi nuk e ndihmoi. Gjermanët e gjetën, e rrahën (mund ta kishin rrahur edhe më shumë) dhe e dërguan në kampin e të burgosurve. Sidoqoftë, Bryks pati sukses në një drejtim: fshehjen e identitetit të tij. Edhe gjatë hedhjes së tij me parashutë ai kishte kontrolluar xhepat e tij për t'u siguruar që nuk kishte asnjë letër me vete.


Ata që kalojnë nëpër duar listat e të burgosurve në arkivat gjermane të luftës mund të hasin disa emra të ndryshëm: për shembull njëfarë Ricks që u arrestua në Berlin gjatë një përpjekje arratisjeje. Ose një Bruno Sax që figuron mes të burgosurve. Këta emra i përkisnin një personi: Josef Bryks ose i shpiku emrat ose i ndërroi me shokë të burgosur ose të njohur. Ai e dinte që Çekët në paraburgim trajtoheshin shumë më keq se anglezët dhe gjithashtu e dinte që ai mund të rrezikonte jo vetëm jetën e tij, por edhe të afërmit e tij në Protektorat. Kështu që letrën e tij të parë nga robëria për Trudie e dërgoi me emrin e rremë Ricks. (" E kuptova menjëherë nga shkrim i dorës se nga kush ishte!" - kujtoi Trudie më vonë.)

ARRATISJA E MADHE

Në fillim, gjermanët mendojnë se Bryks është polak. Dhe ai përpiqet të shpëtojë me çdo kusht. *“Gjatë natës së 19-20 prillit 1942 u arratisa përmes një tuneli nga kampi Oflag VIB në Warburg. E kisha organizuar arratisjen së bashku me Otakar Černý, Zdeněk Procházka dhe tre polakë. Černý u kap pas rreth tetë ditësh në Hamburg. Vazhdova në këmbë edhe një ditë dhe natën vodha një biçikletë ... Vazhdova në drejtim të Zvicrës përmes Offenbach dhe Stuttgart ku policia gjermane më qëllloi ndërsa kaloja një urë. Për shkak të mungesës së ushqimit dhe ujit u sëmura nga dizenteria. Unë u gjeta i sëmurë rëndë në pyjet në jugperëndim të Shtutgartit nga një anëtar i Hitlerjugend,”* kështu ua përshkroi më vonë ai arratinë e tij të parë oficerëve anglezë.

Shtatëmbëdhjetë shtatori e gjen përsëri duke u arratisur. Pa ushqim, çorape ose këpucë ai kalon malet dhe përpiqet të hyjë në një fushë aviacioni gjermane nga ku dëshiron të fluturojë larg me një avion luftarak gjerman Messerschmitt. Por arratisja dështon përsëri dhe Bryks u vendos pas telave me gjemba.

Dhe kështu ai ikën për herë të tretë. Këtë herë në një fuçi për mbetje njerëzore. Dhe arrin deri në Poloni, në komandën e fshehtë lokale të Ushtrisë Vendase (Armia Krajowa). Ai arrestohet nga Gestapo në



Poster i filmit "Zemra e Robëruar" (1946) bazuar ne historinë e jetës së Josef Bryks në Luftën e Dytë Botërore.

STUDIOCANAL FILMS LTD.

Varshavë. Ndërsa "flasin me të" gjatë marrjes në pyetje, gjermanët e godasin në bark dhe i shkatërrojnë daullen e veshit. Kështu ka diçka për të kujtuar, thonë ata. Ata ia dolën me sukses; ai mbeti me vështirësi dëgjimi deri kur vdiq. *"Më 5 qershor 1943 unë u godita dhe shqelmova brutalisht në bark në qeli nga SS-Scharführer Grün derisa humba vetëdijen,"* do të dëshmonte Bryks më vonë.

Bryks madje merr pjesë në përgatitjen e "Arratisjes së Madhe" legjendare nga Sagan, e cila hyri në histori për larje të përgjakshme llogarish me oficerët e arratisur dhe më vonë nga filmi eponim me protagonist Steve McQueen. Arratisja ishte planifikuar përmes tuneleve sekrete dhe rendi numerik ishte vendosur paraprakisht nga të burgosurit. Josef Bryks kishte një numër të lartë dhe kështu nuk hyri në tunel sepse arratisja u zbulua para se t'i vinte radha. Në fakt, ai ishte me fat: pavarësisht marrëveshjeve ndërkombëtare për trajtimin e robërve të luftës, shumica e të arratisurve u vranë.

Megjithatë, paraqitet një rrezik i ri: nazistët zbulojnë identitetin e tij të vërtetë dhe e dërgojnë në Pragë, tek i frikshmi Pallati Petschek, selia e Gestapos. Një gjyq për tradhti të lartë është në pritje (ai tradhtoi atdheun e tij Protektorat) dhe po ashtu edhe vdekja. Këtë herë ai mund të jetë "i kënaqur" që do të varet "siç duhet": nën emrin e tij të vërtetë.

Por ai mbijeton. Kampi në të cilin ai po pret fundin (e jetës së tij ose e luftës, cilado që të vijë e para) është çliruar nga amerikanët dhe Bryks është një hero, në shtëpi dhe në Angli. *"Ai po qëndronte atje në stacionin e autobusit; të gjithë në rrugë e dinin që një pilot i RAF po më priste atje. Ne nuk e kishim parë njëri-tjetrin për gati pesë vjet, por ai më njohu menjëherë dhe më mori në krahët e tij. U surprizova. Dhe ai pyeti menjëherë nëse do të martohesha me të,"* kujton Trudie. *Por ajo prapë hezitoi. Bryks e telefononte disa herë në ditë. Derisa e humbi durimin. "Dera u hap me vrull dhe ai tha se ose unë do të martohesha me të ose se ai do të largohej menjëherë dhe nuk do të kthehej më në Angli."*

Dhe ja ku ishte. Në atë moment ai kishte një unazë fejeze gati në xhep. Dukej si një fund i lumtur, ashtu si në një roman luftime. Ata e kaluan muajin e mjaltit në Ishullin e Njeriut dhe kur u nisën për në Çekosllovakia, ata shkuan me një tren të vendosur posaçërisht për kthimin e veteranëve të luftës dhe bashkëshorteve të tyre të reja angleze. Kishte rreth një mijë gra. Një bandë po priste në stacionin e trenit në Pragë, një qilim i kuq dhe një banderolë festive: "Mirësevini nuse britanike të luftës".

Në fakt përralla mund të kishte vazhduar: heroi martohet me gruan që e priste me besnikëri (u

krye), ata kanë një fëmijë (u krye) dhe ata janë të lumtur së bashku (u krye). Sikur Bryks të mos e kishte idenë idiote të kthimit në Çekoslovakia, mund të ishte një histori shumë e lumtur. Por nuk ishte e thënë.

NJË ROMANCË IDILIKE E SHKURTËR

Ata u vendosën në qytetin e Olomouc; babai i tij drejtonte fermën e familjes pranë Laš'tany. Ata nuk interesoheshin për politikën, por konflikti i parë erdhi shpejt, në 1946. Oficeri (dhe jo-komunist) Bryks që dinte anglisht dhe gjermanisht, interpretoi në gjykatë gjatë një gjykimi që përfshinte bashkëpunëtorë gjermanë. *“Atje dikush e akuzoi si tradhtar ngaqë ai ishte larguar dhe kishte shkuar në Perëndim. Kur ai u përgjigj, u shfaq në gazeta një kërkesë e kryeredaktorit Komunist që ai të kërkonte falje”* kujton Trudie Bryks. Ky ishte një paralajmërim, por ata nuk e morën shumë seriozisht.

Ata po jetonin në kohën e tyre më të bukur atëherë. Vajza e tyre Sonia lindi, babai dhe burri i dashur dhe i lumtur po i mësonte Trudie, në malet Jeseníky aty pranë, kalërimin, ski dhe ngjitjen në mal.

Më 24 shkurt 1948 romanca mbaroi. *“Më kujtohet që isha te dentisti; një vajzë që na ndihmonte me punët e shtëpisë erdhi duke vrapuar dhe duke qarë tha: duhet të shkoh në shtëpi menjëherë; majori po merret; ai nuk e di se për ku.”* Pastaj doli që oficerët ishin nxjerrë jashtë qytetit në ditët kritike të puçit komunist. Josef u detyrua të pastronte stallat e derrave me të burgosurit gjermanë, kundër të cilëve kishte luftuar jo shumë kohë më parë. U detyrua të marrë pjesë në kurse të riedukimit. Pasi i mbaroi ato "Certifikata" dukej kështu:

“- Edukimi politik: i pakënaqshëm. Nuk është i përshtatshëm për edukimin politik të vartësve të tij për shkak të qëndrimit të tij negativ ndaj të gjitha arritjeve të institucionit të njerëzve demokratik. Si pasojë e paaftësisë së tij për të vlerësuar ideologjinë e demokracisë së njerëzve dhe të ushtrisë - i papërshtatshëm.”

"- Dobia: i padobishëm."

Ata e pushuan nga ushtria dhe e urdhëruan të paraqitej në zyrën e punës që nga 1 maj 1948 ku do t'i jepej një punë krahu e pakualifikuar. E ardhmja dukej e zymtë për "të padobishmin". *“Unë doja që ai të arratiset jashtë vendit; vajza jonë dhe unë do të dilnim disi me pasaportën time britanike,”* tha



Lumturi e shkurtër pas luftës. Josef Bryks me vajzën e tij Sonia në Olomouc pak para arrestimit të tij, 1948.

ARKIVA E KAREL BRYKS

PERDJA E HEKURT

Termi "Perde e Hekurt" u përdor për kufirin midis bllokut lindor dhe perëndimor në EUROPË. Ajo është e lidhur me fjalimin e Winston Churchill që mbajti më 5 mars 1946 në Kolegjin Westminster në Fulton, SHBA, megjithëse ishte përdorur edhe para kësaj.

Në kufijtë e shteteve Komuniste, gradualisht u instaluan gardhe dhe pajisje kurth të ndryshme që do të parandalonin banorët e vendit të largoheshin në mënyrë të paligjshme. Shpesh shumica e fshatrave në zonën kufitare u zbrazën gradualisht. Në vitin 1961, muri i famshëm u ndërtua në qytetin e ndarë të Berlinit. Rënia e tij u bë simbol i rënies së perandorisë Sovjetike.

Në një shkallë më të vogël, Perdja e Hekurt u ul gjithashtu në mënyrë të përsëritur brenda bllokut Sovjetik, e shoqëruar me shpërthimin e krizës së sistemit të regjimit Komunist (Hungaria në 1956, Çekosllovakia në 1968 dhe Polonia në fillim të viteve 1980).

KUTI NJOFTIMI

Trudie. Ai u pajtua me sugjerimin e gruas së tij, kështu që u përpoq.

Bryks u përpoq të arratisë së bashku me gjeneralin Karel Janoušek, ish-komandanti i Forcave Ajrore Çekosllovaqe në Britani. Ai e njihte mirë; Janoušek madje kishte qënë dhe në dasmën e tij. Kalimi i Perdes së Hekurt megjithatë përfundoi në katastrofë. Bryks dhe miqtë e tij, përfshirë Janoušek, i cili kishte patur komunikim me Ambasadën Britanike, ishin nën mbikëqyrje nga policia sekrete. Pika më e afërt që arritën me kufirin ishte në Kynšperk nad Ohří, por gruaja në vendin e së cilës u takuan, u tha atyre se kalimi nuk ishte i mundur. Ajo tha se kishte shumë dritë jashtë. Ishte një tronditje. Çfarë mund të bënin ata? Ata duhej të ktheheshin. Janoušek u përpoq të arratisë në një vend tjetër dhe u arrestua.

Trudie Bryks nuk flinte mirë. Burri i saj (i

cili kishte qënë aq i guximshëm sa u arratis nga mbikqyrja gjermane!) nuk ishte i aftë të shpëtonte nga ky vend komunist. *"Isha gati të dremisja kur mendova se dëgjova një trokitje në dritare. E kisha imagjinuar apo po bëhesha paranojake?"* ishte se si Trudie Bryks më vonë përshkroi momentet fatale në librin e saj.

Fatkeqësisht, ajo nuk po tregojë paranojake. Bryks ishte kthyer pas arratisjes së tij të pasuksesshme. Pastaj dy zyrtarë të lartë të partisë iu afruan me një ofertë të çuditshme: nëse do të divorcohej nga "ajo grua angleze", ai mund të bëhej anëtar i Partisë Komuniste të Çekosllovakisë (KSČ) dhe para tij do shtrihej karriera. Ai nuk pranoi. Mundësia e vetme e mbetur ishte një arratisje e realizuar si duhet në Perëndim.

Nuk ishte i vetmi që e kuptoi këtë, dhe një ditë më vonë ata erdhën për të. Ai sapo ishte kthyer nga kinemaja me Trudie. Ishte rreth njëmbëdhjetë e natës. Ndërsa po e arrestonin, ata i thanë gruas së tij: *"Ti e di e dashur, është si në kohërat e vjetra. Atëherë, armiku ishte ndryshe. Sot është populli ynë."*

Së pari, u dënua me dhjetë vjet për përpjekje për t'u arratisur përtej Perdes së Hekurt, tradhëti e lartë dhe spiunazh. Ata më pas shtuan edhe njëzet vjet të tjera për një përpjekje të pretenduar arratisjeje nga burgu në Bory. Ata kishin frikë prej tij. *"Josef Bryks ishte, me sa di unë, shumë i vështirë. I vështirë me veten. Kishte diçka të pathyeshme në të. Më në fund e dërguan atë tek Jáchymov, mbase për të rënë rehat prej tij,"* tha më vonë Josef Šišpera kolegj i tij nga Forca Ajrore Britanike dhe shok burgu gjatë burgimit në Çekosllovakia.

Tani e tutje bisedat mes burrit dhe gruas u bënë vetëm pas hekurave. Sidoqoftë, nuk ishin shumë. E pa vajzën e tij Sonia për herë të fundit në burg pak para se ajo dhe nëna e saj të largoheshin për në Angli. Ishte në verën e vitit 1948. Ai e mbajti atë në krahë dhe e puthi derisa rojet e burgut erdhën ta paralajmëronin se koha e vizitave kishte mbaruar. Në një farë mënyre, Trudie Bryks ishte me fat. Ajo arriti të merrte leje për t'u larguar dhe kaloi Kanalin me vajzën e saj. Ajo nuk u martua më kurrë, megjithëse burri i ofroi asaj divorcin në një nga letrat e tij nga burgu Komunist. Edhe një herë, kjo tingëllon si një temë për një roman. Në të vërtetë mund të ishte vëllimi i dytë, por le të llogarisim: Trudie dhe Josef e njihnin njëri-tjetrin për gjashtëmbëdhjetë vjet në total. Në dymbëdhjetë prej tyre ishin të martuar. Sa vite jetë kanë kaluar së bashku? Rreth tre. Për pjesën tjetër të kohës, burri dhe gruaja prisin kot njëri-tjetrin, duke dërguar letra të trishtueshme përtej Perdes së Hekurt. Sigurisht nëse ato letra dorëzoheshin mbi të gjitha. *"Kurrë nuk u pendova që u martova me Josef"*, tha më vonë Trudie gruaja e Bryks, dhe kështu do të qëndronte derisa të vdiste.

NJË SHUARJE SIMBOLIKE

Pas perdes, Bryks u bë thjesht një numër: "i burgosuri Nr. 868". Dhe komunistët merrnin vazhdimisht hakmarrje të padenjë ndaj të gjithë të burgosurve: Josef nuk u lejua t'i dërgonte gruas dhe fëmijës së tij në Londër as ato pak para që fitoi duke gërmuar uranium. Në fund, heroi i filmit Zemra e Robëruar vdiq në një mënyrë pothuajse simbolike: më 12 gusht 1957, në spitalin e burgut të minierës së uraniumit Rovnost, zemra i plasi.

"Bryks vdiq dhe ata bënë autopsinë. Asnjëherë në jetën e tyre nuk kishin parë një sulm kaq të tmerrshëm në zemër, më thanë ata. Zemra shpërtheu sikur të ishte prerë me bisturi," dëshmoi disa vjet më vonë Zdeněk Kessler, shok i burgosur i Bryks dhe më vonë Kryetar i Gjykatës Kushtetuese.

Komunistët dinin të komplikonin jo vetëm jetën e një burri, por edhe vdekjen



Një numër i thjeshtë. Pas hekurave Josef Bryks u bë "i burgosuri numër 868". Sigurisht atij i janë hequr të gjitha shenjat dalluese ushtarake. Ai në fund do të vdiste në burg.

ARKIVA KOMBËTARE

e tij. Autoritetet Çekoslllovakë nuk u shqetësuan të informonin Trudie gruan e Bryks për vdekjen e tij. Regjimi u hakmor edhe ndaj të afërmeve: nuk lejoi që trupi t'u lihej për një varrim dinjitoz.

Familja e Bryks përtej Kanalit supozohej të harronte heroin çek. Dhe sipas një kompleti djallëzor u bë të dukej sikur edhe Bryks i kishte harruar ata. Kjo ishte arsyeja pse ai nuk u lejua t'i dërgonte para gruas së tij ...

Historiani Jiří Rajlich nuk dyshon se Bryks ishte një kërcënim për regjimin Komunist: *“Thjesht mendo për ato që ai kishte kaluar. Padyshim që ai ishte potencialisht një person tmerrësisht i rrezikshëm për komunistët! Shumë shpesh këta njerëz nuk përfundonin në burg për kryerjen e diçkaje, por sepse regjimi frikësohej tmerrësisht prej tyre. Ata ishin edukuar në tradita krejtësisht të ndryshme, ata besuan në atë që bënë, shumë prej tyre e vërtetuan këtë gjatë luftës. Kështu që kishte edhe arsye parandaluese.”*

Nëse Bryks do kishte mbijetuar, sipas dënimit ai do të ishte larguar nga burgu vetëm në 1978 ...

Trudie Bryks më në fund u ndihmua nga një fondacion britanik për veteranët e Forcave Ajrore. Vajza e saj Sonia mori një vend në një shkollë me konvikt dhe Trudie punoi si gazetare, fillimisht në Angli, dhe më vonë në SHBA. *“Unë doja ta edukoja fëmijën tonë dhe doja ta edukoja mirë,”* tha ajo. Ajo pati sukses por më vonë fati i ktheu kurrizin: Sonia u sëmur me sklerozë të shumëfishtë dhe vdiq në 2000.

Trudie Bryks kaloi më shumë kohë duke luftuar për burrin e saj sesa bashkë me të në martesë. Së pari ajo u përpoq ta nxirrte atë nga burgu Çekoslllovak, më vonë, pas vitit 1989, ajo bëri fushatë për rehabilitimin e tij pas vdekjes dhe u përpoq të arrinte njohjen e tij në atdheun e tij. Atdheu që e dërgoi në burg dhe e la të vdiste atje.

Vendi i varrit të Bryks u identifikua në 2009 në varrezat Prague-Motol; Trudie Bryks vdiq në vitin 2011. Ajo ishte 91 vjeç. Ajo mundi të arrijë edhe një gjë më të rëndësishme gjatë jetës së saj: më 28 tetor 2006 ajo mori Urdhrin e Luanit të Bardhë për burrin e saj të vdekur nga presidenti Çek.

I dashur zotëri!

Më falni që po ju shkruaj edhe pse jam e huaj; megjithatë në kërkimin e drejtësisë, ne i lëmë formalitet mënjanë. Meqenëse kam jetuar më parë në Çekosllovaki, unë apeloj për ndihmën tuaj: Po u drejtohem juve veçanërisht pasi e di që mbani pozicionin më të rëndësishëm në KSČ dhe pasi e di që duhet të jeni një njeri i ndershëm dhe i drejtë përderisa mbani këtë pozicion, pasi këto janë cilësitë që vlerësohen më së shumti këtu.

Unë besoj se ju me shumë gjasa e dini rastin e personave të lartpërmendur dhe se duhet t'i keni harruar deri tani, duke pasur parasysh që ngjarjet në jetën njerëzore ndodhin dhe bëhen të harruara pothuajse në një çast: gratë dhe të afërmit e këtyre personave megjithatë nuk mund t'i harrojnë dhe me kalimin e kohës, ata bëhen gjithnjë e më të dëshpëruar dhe me vështirësi gjithnjë e më të mëdha

ne përpiqemi për lirim e këtyre burrave fatkeq, këtyre ish heronjve Çekoslovakë të cilët tani janë burgosur në mënyrë të paligjshme: krimi i tyre i vetëm është se ata u përpoqën të merrnin një pasaportë për të qenë në gjendje të jetojnë me gratë e tyre në Angli

A ishte i kotë gjaku që ata derdhën, mundimet dhe vuajtjet e tyre? A është harruar tashmë? A është kjo mënyra për të trajtuar njerëzit që vuajtën kaq shumë për Çekoslovakinë?

Z. Slánský, unë jam njohur me të gjitha faktet e kësaj çështje të turpshme dhe unë jam gati të vij në Pragë për t'ju thënë gjithçka - këta njerëz nuk mbajnë asnjë faj, akuzat kundër tyre janë interpretuar në një mënyrë fantastike...

Letra në të cilën gruaja e Bryks që jetonte në Britani u lut për mëshirë për burrin e saj. Letra iu drejtua Rudolf Slánský, sekretarit të përgjithshëm të KSČ, ende i fuqishëm në atë kohë⁷. Ajo kurrë nuk mori përgjigje.

KONTRIBUT I SHOQATËS QYTETARE PAMËT (MEMORIE)

⁷ Në një kthesë ironike të fatit, Rudolf Slánský u ekzekutua partia e tij më 3 dhjetor 1952 pas një gjykimi teatral të organizuar kundër katërbëdhjetë anëtarëve të rangut të lartë të Partisë Komuniste, shumica prej tyre me origjinë hebreje. U dhanë njëmbëdhjetë dënime me vdekje dhe tre dënime me burgim të përjetshëm (i ashtuquajtur "gjyqi Slánský") [shënim i përkthyeses].

SLLOVAKIA



Republika e Çekosllovakisë u themelua pas Luftës së Parë Botërore nga rajonet Çeke dhe Sllovae të Perandorisë Austro-Hungareze (Bohemia, Moravia, Silesia Austriake, Sllovakia dhe Ruthenia Karpate). Në gjysmën e dytë të viteve 1930, Çekosllovakia ishte demokracia e vetme në EUROPËn Qendrore dhe Lindore.

REGJIMI PRO NAZIST

Në tetor 1938, Partia Popullore Sllovae Hlinka (HSLS) deklaroi autonominë brenda Çekosllovakisë dhe mori pushtetin në pjesën e saj sllovae.

Deklarata e Pavarësisë e 14 marsit 1939 ishte rezultat i presionit të Hitlerit; megjithatë qeverisë një-partiake HSLS të kryesuar nga Jozef Tiso iu la hapësirë e madhe për të ndjekur politikat e saj në punët e brendshme.

Shteti sllovak ishte një aleat i Hitlerit dhe divizionet sllovae luftuan në Frontin Lindor. Hebrenjtë u persekutuan dhe u dëbuan në kampe përqendrimi. Kryengritja sllovae e gushtit 1944 u mposht nga forcat gjermane. I gjithë territori u çlirua nga ushtria sovjetike deri më 1 maj 1945.

REGJIMI KOMUNIST NË ÇEKOSLLOVAKI

Në mars 1945, qeveria çekosllovae në mërgim dhe partia komuniste nënshkruan një program qeveritar në Moskë, i cili ndër të tjera, ndaloi partinë politike më të madhe konservatore të para-luftës. Statuti shtetëror Çekosllovak u rivendos, por Ruthenia u aneksua nga Bashkimi Sovjetik në qershor 1945. Në 1946 komunistët fituan në zgjedhjet e kufizuara. Më 25 shkurt 1948 pasoi një grusht shteti komunist. Periudha e zbutjes së politikave komuniste, e njohur si pranvera e Pragës, u shtyp nga një pushtim ushtarak i vendeve të paktit të Varshavës më 21 gusht 1968.

Regjimi ra në Revolucionin e Kadifenjtë që filloi nga një demonstratë studentore më 17 nëntor 1989; Zgjedhjet e lira u mbajtën në qershor 1990.

Më 1 janar 1993 Çekosllovakia u nda paqësisht në Republikën Çeke dhe Republikën e Sllovakisë.

JOZEF REMŽA lindi më 17 korrik 1940 në Kátlovce në rajonin Trnava të asaj që tani është Sllovakia. Ai vinte nga familja e një punëtori. Babai i tij Ján Remža ishte punëtor në ndërmarrjen elektroteknike të Bratislavës dhe nëna e tij ishte punëtore në kooperativën fshatare Kátlovce e Bashkuar.

Në korrik 1959, 19-vjeçari Jozef dhe shoku i tij Stanislav Štrbo u përpoqën të arratiseshin përtej kufirit Çekoslovak për në Austri, në kërkim të një jete më të mirë në Perëndim. Ata u diktuan kur zbritën nga treni në një stacion kufitar dhe vuajtën dënime me gjashtë muaj burg.

Sidoqoftë, Jozef nuk u demoralizua dhe vazhdoi të ëndërronte për lirinë. Gjatë një përpjekje të dytë arratisjeje më 15 gusht 1960, ndërsa ndiqej nga rojet kufitare, Jozef Remža u vra nga rryma e tensionit të lartë e Perdes së Hekurt të elektrizuar.



ARKIVA E INSTITUTIT TË MEMORIES KOMBËTARE

Jozef Remža

Një Fat Tragjik në Rrugën drejt Lirisë

shkruar nga Ľubomír Morbacher, Ph.D.

PËRPIEKJA E PARË

Raporti i arrestimit, i cili është një pjesë e dosjes hetimore për dy punëtorë të rinj, Jozef Remža dhe Stanislav Štrbo, përshkruan se si u pengua përpjekja e tyre për të ikur në Perëndim, në një mënyrë shumë të ngjashme me rastin e qindra të arratisurve të tjerë. Po e theksoj që në fillim statusin e tyre shoqëror, megjithëse do të shfaqet disa herë të tjera në histori, për t'i rikujtuar vetes faktin se propaganda zyrtare komuniste paraqiti shtetin "demokracinë e popullit" dhe më vonë shtetin "socialist" si një sistem shoqëror të krijuar për punëtorët, që do të thotë për klasën punëtore.

Në orët e mbrëmjes së 27 korrikut 1959, saktësisht në orën 7.35 të pasdites, dy të rinjtë u ndaluan nga një patrullë e rojes kufitare menjëherë pasi zbritën nga një tren në stacionin Devínska Nová Ves. Meqenëse ata nuk kishin me vete dokumente që ishin të detyrueshme në atë kohë - një leje për të hyrë në zonën kufitare - ata u dërguan në njësinë e Rojës Kufitare Devínska Nová Ves. Pas "pyetjeve paraprake", ata pranuan qëllimin e tyre për të shkuar në Austri dhe u arrestuan nga togeri i parë Vendelín Vincúr, oficer i departamentit të inteligjencës të brigadës së 11-të të Rojës Kufitare. Pas kësaj, filloi hetimi i çështjes së tyre nga rreshteri hetues i Sigurimit të Shtetit Lipták i Administratës së Rrethit të Ministrisë së Brendshme në Bratislavë. U ngritën akuza e përpjekjes për të kryer veprën penale të largimit nga republika siç përcaktohet në Nenin 5 dhe Nenin 95 par. 1 të Kodit Penal¹. Të dy miqtë u burgosën dhe dënimi i pakthyeshem me burg (i cili nuk mund të zëvendësohet me dënim tjetër, si p.sh. me punë të detyruar), bëri që të kalonin përvojën e tyre të parë me hetuesit e Sigurimit të Shtetit. Për njërin prej tyre, nxitësin e arratisjes Jozef Remža, çështja nuk mbaroi me vuajtjen e dënimit. Ai u bind se duhej të largohej nga një vend i tillë dhe u përpoq të arratisëj përsëri. Këtë here vetëm, dhe mjerisht, me pasoja tragjike.

Kush ishte Jozef Remža i cili me naivitët u përpoq, së bashku me shokun e tij, të udhëtonte pa rënë në sy në fshatin kufitar të Devínska Nová Ves në korrik 1959?

¹ Neni Nr. 86/1950 Coll.

Jozef Remža, një i ri 19-vjeçar i lindur në Kátlovce në rajonin Trnava vinte nga familja e një punëtori, siç thuhet në fjalët e tij në raportin e hetuesisë të Sigurimit të Shtetit. Babai i tij Ján Remža ishte një punëtor në ndërmarrjen elektroteknike në Bratislavë dhe nëna e tij ishte punëtore në kooperativën fshatare Kátlovce e Bashkuar. Pas mbarimit të arsimit të tij fillor, Jozef kaloi një vit duke ndihmuar në fermën e familjes prej dy hektarësh, e cila ishte ende e tyre në atë kohë. Duke filluar nga viti 1955, ai u trajnuar për operator traktori në shkollën e shëgertëve në qytetin e Galanta. Pas diplomimit, ai fillimisht punoi për dy muaj në stacionin e makinerive dhe traktorëve në Trnava. Nga atje u transferua për të punuar në ndërmarrjen e puseve të naftës Çekosllovake, departamenti i kërkimeve në Brno, ku takoi Stanislav Štrbo, një punëtor nga



Barriera e gardhit të trefishtë me tela e elektrizuar në kufirin e Çekoslllovakisë e parë nga lart, 1952.

ARKIVA E SHËRBIMEVE SEKRETE TË REPUBLIKËS ÇEKE

fshati Modranka. Kur puna në puset e naftës Çekosllovake u mbyll në dimër, e këshilluan të kërkonte një punë tjetër. Pa ditur për njëri-tjetrin, djemtë u takuan përsëri në Bratislavë në ndërmarrjen kimike Georgi Dimitrov ku të dy filluan punën e tyre të re.

Miqtë e shfrytëzuan mundësinë e strehimit në "lagjet e beqarëve" në Bratislavë - Gaštanový hájik (Korija e Gështenjave) që u mundësoi atyre të jetonin në Bratislavë dhe të takoheshin shpesh. Ishte ideja e Remža për t'u arratisur në Austri nga Çekoslllovakia Komuniste. Ai shpjegoi motivimin e tij për të emigruar te oficeri i inteligjencës së njësisë së Rojës Kufitare Nr. 5947 Bratislava (brigada e 11-të e Rojës së Kufirit) në mënyrën vijuese:

“Rreth dy muaj më parë vendosa që të ikja në mënyrë të paligjshme në Austri për arsye se nuk isha i kënaqur me punën time këtu, sepse ishte punë e rëndë për mua. Kam punuar si punëtor në departamentin Oleum 2 ku punoja për 8 orë, pasuar nga 24 orë pushim. Mesatarisht kam fituar në muaj 1,300 korona çekosllovake. Megjithëse këto para duhej t'i shpenzoja vetëm për veten time, ndonjëherë ndodhte që ato të mos mjaftonin as për jetesën time. Kjo është arsyeja pse vendosa të ikja në Austri në mënyrë të paligjshme.”¹²

Në vlerësimin e Georgi Dimitrov nga departamenti politik i ndërmarrjes kimike, Remža nuk haset si dikush që mungon pa arsye dhe që ka probleme me punën e rëndë ose që ka të ngjarë të "tradhtojë" klasën punëtore. Në vlerësimin e krijuar për qëllimin e hetimit të Sigurimit të Shtetit, punëdhënësi i tij thotë: *“Sipas një deklaratë nga eprori i tij, i lartpërmenduri e ka kryer punën e tij mirë dhe me ndërgjegje. Pjesëmarrja e tij në*

² Arkivi i Institutit të Kujtesës Kombëtare (NMI), fondi i Administratës së Qarkut të Korpusit të Sigurisë Kombëtare Bratislavë, V-1391, Dosja personale e hetimit. Remža Jozef. Të gjitha citimet e mëtejshme në tekstin italik në këtë histori janë marrë nga dokumentet e Arkivit të NMI.

punë ishte e rregullt, ai nuk ka patur mungesa... Natyra e tij ishte e qetë, e tërhequr, ai ishte i shoqërueshëm me kolegët e kolektivit të tij.”

Me këtë vlerësim stereotipik duhet të kemi parsysh se qytetarët i nënshtroheshin vazhdimisht vlerësimit të "kuadrit" dhe të performancës (natyrisht jo vetëm nga punëdhënësi). Ata shpesh vlerësoheshin nga njerëz me cilësi të ulta morale - të prirur më shumë për të marrë pjesë në mbledhjet e partisë sesa për të bërë punë të specializuar dhe në këtë mënyrë zgjidhnin gjithashtu edhe konfliktet e ndryshme personale. Megjithatë, vlerësimet ishin jashtëzakonisht të rëndësishme për ekzistencën e mëtejshme të njerëzve në profesionet e tyre, për ndikimin në ndëshkimet penale dhe për situata të pafundme në të cilat shteti ishte vendimmarrës. Në rastin e punëtorit Jozef Remža as vlerësimi i mirë nuk pati peshë.

Le të kthehemi te përpjekja e dy të rinjve. Miku i Remžas, Štrbo u pajtua me propozimin për t'u larguar nga Çekosllovakia. Miqtë kishin një botëkuptim shumë naiv të rreziqeve me të cilat përballeshin të arratisurit edhe kur mblidhnin informacione shumë thelbësore rreth pajisjeve mbikëqyrëse dhe teknike inxhinierike që siguronin kufirin me Perëndimin, dhe pa dyshim ata nuk kishin asnjë ide për rrjetin e përhapur informues të "Ndihmësve të Rojës Kufitare" dhe për rrjetin agjent të Shërbimit Inteligent të Rojës Kufitare dhe Sigurimit të Shtetit. Pavarësisht kësaj, ata kishin një afat kohor të arsyeshëm për të menduar mënyrën e arratisjes deri në momentin kur u arrestuan në stacionin hekurudhor Devínska Nová Ves, veçanërisht duke ditur që Remža interesohej për situatën në kufi si me kolegë ashtu edhe me të huajt. Më 7 gusht 1959 Remža i dëshmoi Lipták-ut rreshterit hetues të Sigurimit të Shtetit nga Administrata e Rrethit të Ministrisë së Brendshme:

“Rreth dy muaj më parë, kur Štrbo dhe unë ramë dakord se do të ishte mirë të largoheshim nga vendi në mënyrë të paligjshme, u nisëm të nesërmen për në Kështjellën e Bratislavës për të fituar disa njohuri se si mund të ishte situata në kufi. Po atë ditë unë u nisa me Štrbo për në Vesta Viedenská³ për të marrë informacion se si ruhet kufiri përgjatë këtij seksioni dhe nëse do të ishte e mundur të largoheshim në këtë mënyrë dhe të shkonim jashtë vendit në mënyrë të paligjshme. Ndërsa po ecnim përgjatë Viedenská cesta, takuam një peshkatar që po kthehej nga peshkimi në anën e djathtë të rrugës. Štrbo e ndaloi dhe e pyeti se sa larg ishin rojet e kufirit dhe nëse kishin qenë. Peshkatarin u përgjigj se rojet e kufirit ishin rreth 1 km larg nga ai vend dhe se jo të gjithë kishin qenë. Pastaj Štrbo e pyeti nëse dikush mund të kalonte për në Austri përmes pyllit që ishte në anën e djathtë të rrugës.”

Remža pyeti edhe shumë njerëz të tjerë për kufirin. Megjithatë diçka e ndihmoi. Ai e shpjegoi kuriozitetin e tij në një mënyrë pjesërisht të vërtetë - së shpejti ai do të fillonte shërbimin e tij të detyrueshëm ushtarak dhe kur pyeste se si dukej në kufi ai pretendoi se do të regjistrohej në Rojën Kufitare. Kur Remža dhe Štrbo shkuan në stacionin kryesor në Bratislavë në orët e mbrëmjes së 26 korrikut për të parë se kur niseshin trenat për Devínska Nová Ves, u kontrolluan nga një anëtar i Trupave të Sigurisë Kombëtare.

³ Rruga vjeneze, një rrugë që të çon nga Bratislava për në Vjenë përmes kufirit austriak. Vjena është vetëm rreth 50 km nga Bratislava, megjithatë, gjatë diktaturës Komuniste, u ndërtua në mes Perdja e Hekurt. [shënimi i përkthyeses]

Sidoqoftë, kur mori vesh se ata vinin nga zonat afër Trnavës siç dhe ai vetë dhe kur Remža po e bënte të besonte se do bashkohej me Rojën Kufitare, burri filloi të shpjegonte situatën. Siç deklaroi Remža në dëshminë e tij:

“Pastaj ai filloi të fliste për telat në kufi, duke përmendur gjithashtu se kishte një zonë të ndaluar dhe se telat vinin vetëm pas kësaj. Ai tha se nga Bratislava në Devín është një zonë e ndaluar prej rreth 20 km dhe më pas telat, dhe se rreth Devínska Nová Ves ekziston vetëm (lumi) Morava, se atje nuk ka tela⁴. Në bisedë ai gjithashtu përmendi se shumica e njerëzve që shpëtojnë, e bëjnë atë rreth Kúty. Ai gjithashtu përmendi që kufijtë shtetërorë janë më të mbrojtur këtu sesa në Šumava⁵ dhe se ai kishte bërë shërbimin ushtarak atje, dhe se madje kanë ndodhur raste të tilla në të cilat anëtarët e Rojës Kufitare kanë kërcyer nga kulla e lartë 10 metra drejt e në territorin gjerman ku thuhet se janë pritur mirë, me shtrëngime duarsh etj.”

Anëtarë i Trupave të Sigurisë Kombëtare natyrisht duhej të vuante pasojat e "Ilafazanërisë" së tij. Në shoqërinë totalitare, këto fakte ishin rreptësisht sekrete dhe detyra për të ruajtur konfidencialitetin kërkohej aq më shumë nga anëtarët e Trupave të Sigurisë Kombëtare. Më 10 gusht 1959, hetuesi i Sigurimit të Shtetit propozoi të lëshojë një urdhër udhëzues për anëtarët e Trupave të Sigurisë Kombëtare në mënyrë që raste të tilla të mos përsëriteshin.

Ashtu si në shumicën dërrmuese të rasteve të tjera të arratisjeve të kapura, asnjë armë nuk iu gjet Remža ose Štrbo në kontrollin personal gjatë ndalimit të tyre. Dosjes së hetimit i ishte bashkangjitur një provë materiale vërtet "serioze": *"Remža me bashkëpunëtorin e tij kishin blerë dylbi dhe dy harta për këtë qëllim që do t'u shërbenin si ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror."* Remža i kishte patur dylbitë që nga Lufta e Dytë Botërore dhe hartat e Maleve Karpate të Vogla Jugore dhe Veriore⁶ i kishin blerë bashkë me Štrbo në një librari në Bratislavë. Absurditeti i regjimit totalitar të asaj kohe demonstron më tej nga një shkresë vërtetuese në dosjen e hetimit në të cilën departamenti qendror në Pragë i Ministrisë së Brendshme vërteton se më 23 janar 1961, dy harta të Maleve Karpate të Vogla Jugore dhe Veriore që lidheshin me çështjen penale të Jozef Remža ishin marrë nga Administrata e Rrethit të Bratislavës të Ministrisë së Brendshme. Pranë vulës dhe nënshkrimit, një shënim i shkruar me dorë thotë: "i shkatërruar me komision". Megjithëse kjo ishte saktësisht në përputhje me procedurën e vlefshme të ligjit penal të kohës, nuk mund të mos të krijohet përshtypja se përfaqësuesit e regjimit ndoshta do të kishin qenë më të kënaqur që qytetarëve të rregullt të mos u shitej asnjë hartë.

Megjithatë, çfarë nuk mund të ishin të papërfillshme ishin dënimet e vendosura nga gjykatat për largimin e paautorizuar nga republika, apo frikësimi që bëhej nga shërbimet e sigurisë. Dëshmia e Jozef

⁴ Sigurisht kjo nuk ishte e vërtet

⁵ Pylli Bohemian, një varg mal përgjatë kufirit me Gjermaninë Perëndimore [shënim i përkthyeses]

⁶ Rajon malor në veri të Bratislava, rajon turistik tërësisht në territorin Sllovak [shënim i përkthyeses]

Remža e bërë më 28 korrik 1959 na bën të ditur në mënyrë të drejtëpërdrejt të kuptojmë fatin e çdo "shkelësi" kufiri, nëse nuk do të kapej. Këto fjali që anëtari i Sigurimit të Shtetit kishte diktuar në raport pa u përpjekur të ndryshonte thelbin e tyre, tregojnë pa dyshim se në rastin e kufirit, ligji dhe normat e brendshme ishin një gjë, ndërsa praktika tjetër gjë:

“Në bisedën në njësi ne mësuam, korrigjim, unë mësova se në kufirin shtetëror në hapësirën e Devínska Nová Ves ka tela gjithashtu, se ka energji elektrike që do të na vriste ose do të na qëllonin të vdekur ose do të mbyteshim. Kjo u tha si nga ushtarët ashtu edhe nga oficerët.”

Jozef Remža dhe Stanislav Štrbo, edhe pse të rinj dhe pa përvojë, me siguri nuk ishin vetëvrasës. Nëse do të ekzistonte një mundësi që ata të largoheshin lehtësisht nga vendi i tyre, ata me siguri do ta kishin shfrytëzuar atë dhe nuk do të rrezikonin jetën e tyre ose, në rastin më të mirë, do të rrezikonin të përballëshin me metodat e hetimit të Sigurimit të Shtetit dhe burgun. Edhe pasi zbuluan se nuk mund të arrinin në Perëndim legalisht, ata fillimisht u përpoqën të gjenin një mënyrë për të shpëtuar me të cilën do të shmangnin "kufirin e gjelbër". Në korrik 1959 ata u përpoqën të zbulonin nëse mund të hipnin në një anije me të cilën delegacioni çekoslovak do shkonte në një festival ndërkombëtar në Vjenë. Ata zbuluan se delegatët e përzgjedhur në mënyrë rigoroze ishin kontrolluar plotësisht nga anëtarët e Rojës Kufitare. Vetëm atëherë ata filluan të planifikonin një arratisje përtej "kufirit të gjelbër". Përgjigjet e sinqerta të punëtorit të Jozef Remža para hetuesit të Sigurimit të Shtetit dëshmojnë që ai nuk u përpoq të "luante lojëra" as gjatë hetimit:

“Çfarë tjetër doni të shtoni në dëshminë tuaj? Përgjigje: Dëshmisë time unë i shtoj vetëm se e kisha imagjinuar ndryshe. Mendova se nuk do të na ndalonin dhe do të arrinin në Austri dhe se do të ishim më mirë në Austri sesa në Republikën Çekoslllovakë.”

Për deklarinimin e qëllimit të vërtetë të veprimit të tij, ai u ndëshkua "siç e meritonte".

DËNIMI

Më 10 shtator 1959, Gjykata Popullore e periferisë së Bratislavës lexoi një dënim në procedurat penale kundër Jozef Remža dhe Co. në përputhje me Art. 5 paragrafi 1 dhe Art. 95 paragrafi 1 i Kodit Penal - për veprën penale të tentativës për t'u larguar nga republika: dhjetë muaj burg i pakthyeshem për Jozef Remža dhe



Vendi ku u vra një person në Perden e Hekurt. Tabelat me numra tregojnë vendet ku janë gjetur copat e provave nga hetuesit komunist.

ARKIVA E SHËRBIMEVE SEKRETE TË REPUBLIKËS ÇEKE

tetë muaj burg i pakthyesëm për Stanislav Štrbo.

Pasi Remža dhe Štrbo apelian, Gjykata e Rrethit në Bratislavë uli secilin prej dënimeve të tyre në gjashtë muaj burgim të pakthyesëm. Pavarësisht nga zbutja e ndëshkimit të Remža dhe Štrbo për, le të themi, zbritjen nga treni në Devínska Nová Ves, është e rëndësishme të theksohet formulimi i mëposhtëm i arsytimit të dënimit për të kuptuar gjendjen e sistemit të drejtësisë komuniste të kohës:

"Të akuzuarit në fjalë kryen një veprim shumë të rëndë, sepse në rastin kur ata do ta kishin realizuar largimin e tyre jashtë vendit, ata me siguri do të shfrytëzoheshin nga vendi armik për aktivitete spiunazhi kundër republikës sonë, pasi ata janë djem të rinj dhe të shëndetshëm."

Në vitin 1959, disa vjet pas vdekjes së Stalinit, parimi i biografisë po zbatohet ashtu siç ishte në fund të viteve 1940 dhe fillimin e viteve 1950⁷. Prandaj është e nevojshme të perceptohet e kaluara e Çekosllovakisë Komuniste në të gjithë realitetin e saj, jo vetëm e bazuar në zbutjen relative në disa sfera të shoqërisë si për shembull artet dhe letërsia, të cilat me kujdes e ulnin figurën e stalinizmit. Në fund të viteve 1940 dhe fillim të viteve 1950, sistemi i drejtësisë përbëhej nga gjyqtarë me mendësi ideologjike - që do të thotë një luftë e intensifikuar e klasave. Në fillim dhe në fund të viteve 1950, përfaqja e regjimit komunist ndaj vlerave të tilla si drejtësia dhe sundimi i ligjit (në atë kohë realiteti ishte krejt e kundërta), nuk kishte dallime të rëndësishme.

PËRPIEKJA E DYTË

Edhe pas vuajtjes së dënimit, Jozef Remža vazhdoi të dëshironte të ikte drejt lirisë, jashtë ndikimit të shtetit totalitar. Kjo u bë fatale për të në rrethin Petržalka të Bratislavës më 15 gusht 1960:

*"Sipas dëshmisë së patrullës së Rojës Kufitare - njësia në detyrë në zonën e ndaluar pranë komunitetit të Petržalka – Kopčany, ata zbuluan një burrë të panjohur që hynte në një fushë misri në rrethana të dyshimta, që kishte me vete një shkop druri dhe po ecte në drejtim të pengesave me tela. Patrulla e Rojës Kufitare filloi ta ndiqte këtë njeri përmes fushës së misrit, të cilit vazhdimisht i kërkuan të ndalonten, por ai nuk u ndal pas thirrjes dhe vazhdoi arratisjen e tij në drejtim të pengesave me tela. Gjatë ndjekjes pas një kërkese të dështuar, patrulla vazhdoi të përdorë armë për të paralajmëruar të arratisurin, e cila gjithashtu nuk pati rezultat, dhe pasi Jozef Remža ishte larguar nga fusha e misrit, i sapopërmenduri u fut në mes të pengesave me tela, ku goditi me kokë linjën e energjisë, si rezultat i së cilës ai u vra nga rryma elektrike dhe mbeti i shtrirë i rënë mënjanë përgjatë pengesave me tela..."*⁸

⁷ "Parimi i biografisë (dhe namit të keq)" si term ligjor është në përgjithësi një fakt i njohur gjerësisht i cili nuk ka nevojë të provohet

⁸ Stili i shkrimit në tekstin e burimit është shumë i varfër [shënim i përkthyeses]

ELEKTRIFIKIMI VDEKJEPRURËS I PERDES SË HEKURT

Disa fjali më shumë për periudhën para vitit 1989, gjatë së cilës shteti po vriste qytetarët e tij vetëm se ata donin të largoheshin lirisht nga atdheu i tyre. Rreth vitit 1952, një barrierë me gardh trefish me tela u ngrit përgjatë të gjitha pjesëve të kufirit të Çekosllovakisë me Austrinë dhe Republikën Federale të Gjermanisë, duke vulosur praktikisht hermetikisht kufirin. Me urdhër të 12 qershorit 1953 të komandantit të parë të Rojës Kufitare dhe të Brendshme të gjeneral-major Ludvík Hlavačka të Ministrisë së Sigurisë Kombëtare, barrierave me tela iu instalua dhe rrymë elektrike e tensionit të lartë, që mbante 2,000-4,000 volt⁹.

Në legjislacionin dytësor që kodifikon veprimtarinë e Gardës së Kufirit dhe qëllimin e pajisjeve teknike inxhinierike në kufi thuhet qartë se përdorimi i rrymës së tensionit të lartë në barrierat me tela supozohej të përmbushte rolin e "likuidimit të armikut". Në shumicën e rasteve nënkupton të arratisurit. Terminologjia e përdorur në dosjet e hetimit që përshkruan shkaqet e vdekjes në kufi dëshmon për frikën e përfaqësuesve të regjimit nga veprat e tyre dhe përgjigjen e mundshme nga popullata. Në protokollet në lidhje me ekzaminimin e kufomave, gjyqtarët kryesisht përdorin fjalinë:

“Sipas gjetjeve të autoriteteve të sigurisë, i vdekuri ka pësuar një dëmtim nga rryma elektrike e tensionit të lartë.”

Në vitin 1994, Ludvík Hlavačka u akuzua për veprën penale të kërcënimit ndaj publikut të gjerë, të cilin ai e kreu si komandant i Rojës Kufitare dhe të Brendshme të Ministrisë së Sigurisë Kombëtare, kur propozoi dhe organizoi elektrifikimin e barrierave me tela, si rezultat i së cilës humbën jetën të paktën 61 persona, bazuar në fakte të njohura në atë kohë. Numri i vërtetë është shumë më i lartë, më shumë se 96 viktima. Sidoqoftë, kriminelit komunist nuk u ndëshkua kurrë, as për gardhet elektrike, as për fushat e minave përgjatë kufirit, as për torturat sadiste ndaj të burgosurve politikë me rrymë elektrike në burgun në Uherské Hradiště. Ai vdiq në Pragë në 2005 në moshën 94 vjeç.

Ja si dukej monstruozeziteti i "përmirësuesve" komunistë në terren: transformatori ishte vendosur në një dhomë me



Një viktimë e elektrizuar tek Perdja e Hekurt.

ARKIVA E SHËRBIMEVE SEKRETE TË REPUBLIKËS ÇEKE

⁹ Kryerja e detyrës për të mbrojtur kufijtë shtetërorë - në instalimin elektrik për mbrojtjen e kufijve shtetërorë (EZOH). Urdhri i komandantit të Rojës Kufitare dhe të Brendshme Nr. 0090/1953 i 12 qershorit 1953.

mure speciale në vendrojen e njësisë. Kabllo nga transformatori në shtyllën e parë ishte i izoluar, dhe prej andej linjat e energjisë vazhdonin direkt në barrierën me tela. Në gardhin e mesëm të barrierës me tela kishte katër linja elektrike të vendosura në mënyrën vijuese: e para kalonte 30 cm mbi tokë, e dyta dhe e treta secila kalonte 50 cm mbi vijën paraardhëse dhe linja e katërt elektrike kalonte përgjatë pjesës së sipërme të gardhit të mesëm. Në portat e barrierës, telat elektrik u gruposën nën dhë në një thellësi prej 60 cm, të izoluar dhe të mbuluar me tulla. Çelësi automat i barrierës së telit të elektrizuar u vendos në një dollap prej druri në vendroje e rojeve. Çelësi i dollapit mbahej nga komandanti i njësisë. Kur ai nuk ishte i pranishëm, çelësi ishte në zotërim të zëvendësit të tij ose të oficerit mbikëqyrës të njësisë¹⁰.

Barriera me tela e elektrizuar ishte vendosur në rreshtin e dytë të gardhit të trefishtë dhe ishte e rrezikshme për të arratisurit për shkak të tensionit të lartë. Transformatori shndërroi rrymën e tensionit të ulët nga rrjeti lokal në tension të lartë prej 2,000-4,000 Volt. Nëse arratisësi prekte vetëm njërin nga telat elektrikë, në shumicën e rasteve ai vritej si rezultat i shkarkimit të rrymës së qarkut të shkurtër midis telit të ngarkuar dhe tokës ose midis telave¹¹.

Komandantët e brigadave të Gardës së Kufirit kishin një shkallë të lartë përgjegjësie për mbikëqyrjen e kufijve dhe mirëmbajtjen e sistemit të krijuar përgjatë kufirit me Perëndimin, përgjatë pjesëve të veçanta të kufirit. Nga raporti ditor i informacionit i Administratës Kryesore të Rojës Kufitare më 16 korrik 1960, del se instalimi elektrik për mbrojtjen e kufijve shtetërorë në kohën e vrasjes së Jozef Remža¹² ishte ndezur me urdhër të drejtpërdrejtë të komandantit të brigadës së 11-të të Rojës Kufitare Florián Čambal për shkak të "trysnisë së madhe në zonë". Kjo do të thoshte se ishte pjesë e kufirit me përpjekje të shpeshta arratisjeje¹³. Sërish, jo rastësisht nën komandën e këtij personi ndodhën tragjedi të tmerrshme në kufirin Sllovaki-Austri. Ndër të tjera, ai ishte përgjegjës për masakrën e refugjatëve në dhjetor 1952 në kufirin në Petřalka kur e gjithë familja Ehrenfeld, përfshirë fëmijët, u qëlluan dhe u vranë.

Elektrifikimi i barrierave në kufi zgjati deri në mesin e viteve 1960. Ai u hoq si rezultat i kostove të larta financiare dhe rrezikshmërisë për anëtarët e Rojës Kufitare, por kryesisht për shkak se u zëvendësua nga instalime teknike më të avancuara të sinjalizimit. Perdja e Hekurt e elektrizuar mori jetën e të arratisurve në zonën ku ishin vendosur edhe njësitë e brigadës së 11-të të Rojës Kufitare. Njëri prej tyre ishte i riu i delirë Jozef Remža i cili refuzoi të pranonte idenë se nuk mund të jetonte në një botë të lirë.

¹⁰ Arkiva e Institutit të Kujtesës Kombëtare, fondi: Ushtria e Rojës Kufitare, njësia e inventarit:180. Protokoll i inspektimit të EZOH të njësisë së 3-të Gajary – paraqitja.

¹¹ Vaněk, P.: Për zhvillimin e përforcimit teknik inxhinierik të kufirit shtetëror në vitet 1951-1955, në: Procedura e Arkivit të Ministrisë së Brendshme, 2004, Nr. 2, f.197-198.

¹² Do të thotë gjatë ditës; për shkak të konsumit të lartë të energjisë dhe rrezikshmërisë, ai normalisht ndizej gjatë orëve të natës në vitet 1960

¹³ Arkivi i Shërbimeve të Sigurisë të Republikës Çeke, raporti i informacionit OD HS PS Nr. 218

Njerëzit që humbën jetën në Perden e Hekurt të elektrizuar në pjesën Sllovaqe-Austriake të kufirit (Rastet e dokumentuara deri më tani):

Tibor Walter, lindur 18 maj 1938	† 30 Nëntor 1954
Antal Pangracz, lindur 1936	† 20 Tetor 1955
Illés Tóth, lindur 14 qershor 1937	† 29 Korrik 1956
František Borka, lindur 17 janar 1941	† 18 Prill 1957
Franciszek Lukaszek, lindur 18 shtator 1930	† 22 Korrik 1958
Ján Krivák, lindur 8 shtator 1927	† 6 Gusht 1959
Mashkull i panjohur	† 4 Qershor 1960
Jan Ignacy Mrohs, lindur 29 maj 1938	† 1 Gusht 1960
Jozef Remža, lindur 17 korrik 1940	† 15 Gusht 1960
Pawel Medwid, lindur 3 maj 1939	† 11 Korrik 1961
Jozef Kolarczyk, lindur 9 mars 1929	† 20 Korrik 1962
Jozef Maksymilian Holota, lindur 27 shtator 1931	† 6 Qershor 1964

KONTRIBUT I INSTITUTIT TË MEMORIES KOMBËTARE

FEDOR GÁL, sociolog, politikan, sipërmarrës, shkrimtar dhe eseist me prejardhje hebreje, u lind në mars 1945 në kampin e përqendrimit Terezín ku familja e tij u dëbua nga fundi i luftës. Ai u mbajt në kuti këpucësh në vend të djepit. Nëna e tij arriti ta ushqente atë dhe një foshnje tjetër në kamp; duke mundësuar kështu mbijetesën e tyre. Babai i tij vdiq gjatë një marshimi vdekjeje nga kampi i përqendrimit Sachsenhausen në Schwerin. Fedor Gál studio inxhinieri kimie dhe sociologji në Bratislavë. Në 1989 ai ishte bashkëthemelues dhe udhëheqës i lëvizjes së opozitës qytetare Publiku Kundër Dhunës, e cila fitoi zgjedhjet e para të lira në Sllovakia në 1990. Pas shpërbërjes së Çekosllovakisë ai u transferua në Pragë, ku jeton akoma. Në 2008 ai ripërshkoi marshin e fundit të babait të tij, duke krijuar një film dokumentar të titulluar Udhëtimi i shkurtër i Gjatë. Fedor Gál është një avokat i të drejtave të pakicave – veçanërisht hebrenjve dhe romëve.



MIRO SVOLÍK

Fedor Gál

Udhëtimi im i shkurtër i Gjatë

shkruar nga Fedor Gál

NUK E PASHË KURRË BABANË

Për një kohë të gjatë besoja që ai ishte arrestuar, dikur rreth 1942, kur ai u përpoq të siguronte mbrojtjen e familjes. Pas vdekje së mamasë time zbulova një fragment të biografisë së saj “zyrtare”, të cilën iu desh ta shkruante gjatë kohëve të Komunizmit. Një pjesë e fragmentit: “...im shoq ishte me një njësi ushtarake; unë u fsheha në male. Pas shtypjes së kryengritjes në fund të tetorit 1944 u tërhoqa zvarrë bashkë me djalin tim katër vjeçar dhe bashkëshortin tim, i cili kishte ardhur të na shpëtonte, në kampin e përqendrimit në Sereď, ku na ndanë menjëherë. Unë bashkë me djalin tim u dërgova në Terezín, ndërsa bashkëshorti im, si anëtar i një çete ushtarake, u dërgua në një kamp përqendrimi diku në Gjermani, ku u qëllua bashkë me anëtarë të tjerë të ushtrisë Çekosllloake në Sllovakia. Në kampin e përqendrimit të Terezín solla në jetë djalin tim të dytë, Fedor, i cili nuk e pa kurrë babanë se lindi pas vdekjes së tij”.

Në 1994, në funeralin e mamasë time, Z. Zoltán Lenský tregoi se kishte qenë me babanë tim në marshimin e vdekjes nga Sachsenhausen në Schwerin. “...Dhe në atë marshim vdekjeje në mbrëmje kaluam përmes një fshati Gjerman. Ishte ora dymbëdhjetë fiks; e mbaj mend si të ishte dje, sepse trokiti dymbëdhjetë nga kulla e sahatit. Në atë moment sapo erdhi turni tjetër i trupave SS. E tërhoqëm atë [Gál] aq sa mundëm. Një prej burrave SS pyeti se çfarë problemi kishte ai dhe tha që duhej të ecte vetë. Por ai nuk kishte më fuqi. ‘Nuk ju lejohet ta tërhiqni! Nuk ju lejohet ta mbani! Do qëlloj shumë prej jush!’ Pra, çfarë mund të bënim? Urdhërat janë urdhëra. E dinim çfarë do të thoshte. Trupa të vdekur shtriheshi gjatë gjithë rrugës së atij marshimi. Dhe pikërisht atëherë, në atë fshat, fiks në dymbëdhjetë, burrat SS ndërruan turnin. Dhe një nga ata derrat tha: ‘Epo mirë, nëse s’mundet...’ Gál tërhoqi xhakatën e tij sipër kokës, të mbulonte sytë që të mos shihet, por ai burrë ia shqeu dhe me armën e tij gjysëm automatike të zezë e qëlloi atë mu në mes të ballit.”

Atëherë e dija që duhej të nisja një udhëtim. Duhej të mbushja atë zbrazëti të lënë mbrapa pas jetës së papërmbushur e të shkurtër të babait tim. Por babait tim meriton t’i thuret një epik. Historia e një të riu i cili u lind nga prindër hebrenjë në një qytet të vogël në Sllovakia, prindër që e mbështetën me studimet e tij që ai të mund të merrte përsipër fermën. Një burrë të cilit rrethanat i mundësuan vetëm pak vite martesë. Një burrë i cili, nën shtetin Sllovak fashist, u kthye nga një bashkëqytetar i respektuar hebre në një çifut i

MARSHIMET E VDEKJES

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, kur forcat Aletate po i afroreshin kampeve Naziste të shfarosjes dhe të përqendrimit, Nazistët i hoqën gradualisht të burgosurit dhe i transferuan nëpër kampe të tjera. Në shumë raste kjo bëhej nga marshimet në këmbë për distanca të gjata në dimër, me ushqim dhe ujë minimal. Kur të burgosurit e sëmurë osë të rraskapitur nuk ishin të aftë të vazhoin, ata shpesh vriteshin. Të burgosurit transportoheshin shpesh me vagona të mbyllur të cilët fillimisht ishin përdorur për të transportuar bagëti. Shumica e marshimeve të vdekjes u kryen në ndërrimin e viteve 1944 – 1945 ndërsa ushtria Sovjetike po pushtonte gradualisht Poloninë.

KUTLINJOFTIMI

fëlliqur. Një burrë 35 vjeç që u qëllua për vdekje gati në përfundim të luftës vetëm sepse ai nuk mund të ecte më tej.

Dua ta shkruaj këtë histori për fëmijët e mi dhe për fëmijët e fëmijëve të mi. Dua që ata ta dinë se gjyshi dhe stërgjyshi i tyre jetuan, kishin një emër, një shtëpi dhe një familje. Ai u çua drejt vdekjes nga disa prej komshinjeve të tij. Dhe do doja të shtoja historinë e jetës time. Për arsye se kam përjetuar veprat e fëmijëve dhe të fëmijëve të fëmijëve të disa prej bashkëfshatarëve të babait tim. Nëse do t'iu jepej mundësia, ata përsëri do të më çonin mua, fëmijët e mi dhe fëmijët e tyre drejt vdekjes. Nuk është se besoj që fjala e shkruar mund të ndalojë dorën e një tradhtari maskara, por e quaj si detyrë timen. Si të ecësh nga Sachsenhausen në Schwerin ose të ngresh një pllakë përkujtimore në Partizánska Ľupča. Do ishte mirë nëse fëmijët e mi, fëmijët e tyre dhe fëmijët e fëmijëve të tyre të ndalonin herë pas herë në Partizánska Ľupča, të linin një gur të vogël për kujtim¹⁴, të ndalonin në ndonjë shtëpi të afërt për pak djath dhe qumësht dele të thartuar¹⁵ dhe të bisedonin me vendasit. Me siguri do jetë e nevojshme gjithashtu, që të ringrihen gurët e shkatërruar të varreve.

MË TË AFËRMIT DHE MË TË DASHURIT

Përvoja ime personale e intolerancës kombëtare, etnike apo racore ka qenë e rastësishme. Zakonisht i hasja të gjitha këto njëherësh dhe në një qoshe të shpirtit tim kam qenë gjithë jetën disi i përgatitur për këto ngjarje. Megjithatë, faktikisht, unë - mjaft çuditshëm - u përballa me ato ndjenja vetëm pas rënies së komunizmit, në demokracinë tonë. Ato lartësoheshin nga grupime anonime dhe ishin fshehur prapa miteve për poshtërsinë e hebrenjve, për komplotet e tyre të errëta dhe parazitizmin e tyre. Por vetëm kur isha fëmijë disa nga të rinjtë më drejtoheshin drejtpërdrejt si “Ti çun çifut”.

Kurdo që kam folur me dëshmitarët apo viktimat e Holokaustit i kam degjuar pa i kuptuar historitë se si marrëdhëniet e komshinjeve kundrejt hebrenjve të integruar dhe shpesh të laicizuar, kishin ndryshuar

¹⁴ Një traditë Hebreje [shënimi i botuesve]

¹⁵ Qumshti i freskët përzihet me pak limon ose uthull. Përngjason me dhallën tonë të thartë [shënimi i përkthyeses]

papritur. Nga njëra ditë në tjetrën shokët mund t'ua përplasnin dyert e shtëpive në fytyrë, do largoheshin prej tyre nga tavolinat që kishin qenë ulur bashkë prej vitesh ose do ndërprisnin komunikimin me ta. Ata u sollën kështu edhe para se uniformat e nazistëve vendas apo nazistëve gjermanë të shfaqeshin në rrugë dhe para se ligjet racore të miratoheshin. Këto porta digash u hapën nga doktrinat politike pro fashiste, nga udhëheqësit dhe nga shpresat e përfitimit vetjak.

Holokausti i ciganëve nxori në pah këtë anë të errët të shpirtit njerëzor me urrejtje të veçantë. Ciganët zotëronin asgjë nga e cila dikush mund të përfitonte. Dhe fati i tyre dekada pas luftës është një kujtim. Sot, sondazhet e opinionit publik tregojnë se shumica e çekëve refuzojnë të merren me pakicat rome, të cilët ata i shohin si bandë parazitësh të zhurmshëm e dembelë. Janë po këta çekë që e shohin veten e tyre si miqësorë, tolerant dhe punëtorë të mëdhenj.

Udhëtimi im në rrënjët e sjelljes degjeneruese nga njerëzit më bindi që këto nuk janë ndjenja për zgjedhëse anti-hebreje apo anti-cigane. Ato nxjerrin në pah aftësinë e njeriut për të urreyer mikun e tij thjesht se ashtu janë të prirur. Arsytimi i kësaj prirjeje është një çështje dytësore. Por nëse unë them A, duhet gjithashtu të them edhe B. Pas çdo personi të gjallë apo të mbijetuar ekziston edhe një histori tjetër – e mbrojtësit të tij, e personit të drejtë e të mirë. Fakti që këto ngjarje janë të pakta në numër në përmbledhjen e dëshmive nuk duhet të na mbyllin sytë ndaj ekzistencë së vërtetë të të dy anëve të barabarta të shpirtit njerëzor.

Për shembull, në rrugën e gjurmëve të babait tim, unë hasa historitë e antifashistëve gjermanë. Që nga fillimi i herëshëm i Rajhut të Tretë ata u transferuan në kampe si Dachau, Sachsenhausen, etj. Vetëm pak nga ata mbijetuan, por ata ishin ndër të parët që, pas kthimit të tyre, kërkuan falje për Holokaustin. Presupozohet që, ata thanë se mund të kishin bërë më shumë. Në Sllovaki për shembull, ndërsa shkruaj këto rreshta ka ende njerëz në qeveri të cilët e mbrojnë shtetin fashist Sllovak dhe mes klerit Katolik, disa vende të rëndësishme mbahen ende nga ata që e konsiderojnë Presidentin dhe priftin e Kishës Katolike Romake, Jozef Tiso (president i shtetit fashist Sllovak gjatë Luftës së Dytë Botërore), si të denjë për shenjtërim.

Në Sachsenhausen dhe në pyjet afër Below pashë gjurmë zjarri nga neo-nazistët gjermanë. Fakti që unë përmenda kombësinë e tyre nuk ka



Revolucioni i 1989 arriti të gjitha sferat e shoqërisë, përfshirë burgjet. Fedor duke përfaqësuar lëvizjen Publiku Kundër Dhunës u përfshi në euforinë e të burgosurve në Burgun Leopoldov, Sllovaki, dhjetor 1989.

ARKIVA E FEDOR GÁL

ndonjë domethënie. Kisha hasur edhe më parë me neo-nazistë sllovakë dhe çek. Kokat e tyre ishin të rruara, kishin veshur çizme ushtarake, trupa muskulozë dhe pas tyre një seri shkeljesh të dhunshme të motivuara nga raca, etniciteti apo kombësia. Plot gjashtëdhjetë e tre vite pas lufte dhe akoma në vendin e kampit të përqendrimit në Leti pranë Písek, qëndron një stallë derrash.

SI E SHOH VETEN

Gjatë gjithë jetës time si i rritur kam dëgjuar për veten. Njih vetveten, puno me vetveten, zhvillo personalitetin tënd, egon tënde, praktiko vetë – përsosjen e kështu me rradhë. E zhyta veten në letërsinë e dedikuar të filozofisë, sociologjisë, psikologjisë, misticizmit, Budizmit Tibetan dhe jogës. Dëgjova atë që quhet muzikë shpirtërore. Ishte një kohë kur, ditë pas dite, u përqëndrova qëllimisht në një pikë të caktuar dhe u përpoqa të pastroja mendjen time nga çdo gjë që i përngjante qoftë një mendimi. U ula këmbëkryq, mora frymë sipas udhëzimeve, mbajta një ditë, kontrollova ndërgjegjen time, lexova Biblën. Dhe prapë u ndjeva si ngordhalaq. Zot i mirë, si mundet dikush të afrohet me ata që mund të kontrollojnë trupat e tyre me vetëdije, të lëvizin objektet me forcën e vullnetit, të agjërojnë me javë, të futen në jetët e tyre të shkuara thjeshtë duke u përqëndruar, të thonë fjalë të mençura? Dhe si mundet dikush që, me përsëritjen e mantrave, me disiplinimin e trupit të tyre dhe me meditim, të heqë qafe vuajtjen dhe të jetë i lumtur?? Dhe, pas vitesh pune të kujdeshme me egon e tyre, të mos ndjejnë më të ftohtin e dhimbjen, të kuptojnë vdekjen? Ku po gaboj? Mos vallë po i përkushtohem jo mjaftueshëm dhe në mënyrë të gabuar shpirtit tim, mendjes time, emocioneve të mia?

Kështu që një ditë u ngrita në tre të mëngjesit dhe fillova të analizoja edhe një herë egon time. Pas të gjithave, unë gjithmonë thjesht kam jetuar nga një ditë në tjetrën. Për shumë vite punova në fabrika kimike me erë të keqe, me turne, sepse më duhej të siguroja jetesën, për veten time si fillim dhe më pas për të gjithë familjen time. Frekuentoja tavernat sepse shokët e mi ishin atje dhe atje krijoheshin miqësi. Nga ana tjetër, e ushqeva trupin dhe abuzova me të, sepse e para është e drejtë dhe e dyta është shpesh e këndshme. Lexova dhe shkrova sepse doja të kënaqja kuriozitetin tim, të fitoja famë dhe të thoja atë që dëshiroja të thoja. Ndihmova njerëz që kërkonin ndihmë osë që ju nevojitej ndihmë. I mpreha aftësitë e mia profesionale, kështu që nuk kisha nevojë të përsërisja mekanikisht gjithçka ose tu bindesha atyre që ishin më të aftë apo se kishin pozicion më të lart se unë. Prapë gjithë kohës isha i vetëdijshëm për disa mangësi – lumturia më erdhi vetëm me raste, me kalimin e viteve muskujt humbën gradualisht tonin e tyre, dhe shkrimi e mendimi nuk ishin më si më përpara. A kisha filluar shumë vonë? A e kisha humbur çastin e duhur vite më parë?

E panevojshme të thuhet por në ato raste e rris vetëvlerësimin duke rikujtuar periudhat heroike të jetës time. Dhe unë pyes veten: “Pra çfarë dreqin është e gjithë kjo?” Çështja është se askush nuk kujton më arritjet tona shkencore gjatë të shtatëdhjetave dhe tetëdhjetave apo samizdate të botuar gjatë epokës

Komuniste. Madje edhe revolucioni në nëntor 1989 ishte amatoresk, me shumë gabime të bëra. Librave të mi të shitur në tirazhe të pakta, vështirë që ndokush tu citojë artikujt tani dhe madje as vetë nuk duroj dot t'i shoh shumë prej tyre. Por të dy djemtë e mi dukshëm kishin mundësi më të mëdha se unë dhe i tejkaluan aftësitë e mia me disa shkallë. Po – ata janë unë. Dhe unë jam gjithashtu ata fëmijë që i zë gjumi duke dëgjuar përrallat e shkruara nga bashkëshortja ime, një shkrimtare e përkryer e librave të fëmijëve. Kështu vështroj ngadalë se si egoja ime ndahet nga trupi në mënyrë progressive. E vështroj qetësisht atë proces, me një cigare në dorë dhe – kurdoherë që është e mundur - me një gotë verë dhe një libër. Sepse tani e di që Udhëtimi i shkurtër i Gjatë i babait tim nuk mbaroi në Linde dhe nuk do të mbarojë me mua.

ABOUT FEDOR GÁL

shkruar nga Prof. Peter Zajac¹⁶

E takova Fedorin e ri, të lumtur, të tejmbushur me energji, vetëm për pak kohë. Ai erdhi, tha se çfarë po ndodhte, një, dy, tre dhe u largua. Ai kurrë nuk rrinte diku më gjatë se gjysmë ore. Ai kishte shumë për të bërë. Ai shkruante në mëngjes, ishte shefi gjatë gjithë ditës dhe pushonte në mbrëmje. Ishte në ato ditë kur barazia gjinore ende nënkuptonte se djemtë miqësoheshin me vajzat. Në fytyrën e tij, rrudha të imëta të së qeshurës bashkoheshin mbi hundë. Më vonë, kishte më pak të qeshura, rrudhat u bënë brazda por ende ishin brazda të qeshurash.

Fedor e donte grumbullin e njerezve në Shtëpinë e Mozartit ku Publiku Kundër Dhunës¹⁷ kishte selinë pas nëntorit 1989. Ne punuam bashkë ditë e natë, formuam

PUBLIKIMET E SAMIZDAT-IT

Termi “samizdat” vjen nga Rusishtja. Në vitet 1940, poeti Nikolaj Glazkov shkroi fjalën “samsebyaizdat” (publikuar për veten) në titullin e faqes së një koleksioni të poemave të tij të shtypur me makinë shkrimi. Termi u vu në përdorim për tekste të kopjuara dhe të shpërndara në mënyrë të fshehtë të cilat regjimi Sovjetik i perceptonte si armiqësore. Për shembull, tekste të shkruara nga Alexander Solzhenitsyn u shpërndanë në këtë formë. Gradualisht, termi u adoptua edhe për regjimet e tjera Komuniste (në Poloni sidoqoftë, ku kjo lloj veprimtarie arriti kulmin në gjysmën e dytë të viteve 1970, nuk zuri rrënjë; por në vend të saj u përdor shprehja drugji obied, që do të thotë “qarkullim i dytë”). Megjithatë në disa shtete, shpërndarja jozyrtare e teksteve kishte një traditë më të vjetër, për shembull që nga koha e pushtimit nazist. Besimtarët fetarë ishin veçanërisht me përvojë të mirë në përpjekjen për të siguruar letërsinë fetare në këtë mënyrë. Në Çekoslovakia, samizdat u bënë një nga format më të dukshme të rezistencës qytetare në vitet 1970 dhe 1980. Në këtë formë u botuan vepra letrare të rëndësishme në disa seri. Më të njohurat u krijuan nga Ludvík Vaculík (Edice Petlice [Padlock Series] dhe Václav Havel (Edice Expedice [Dispatch Series]). Përveç kopjeve të shtypura individualisht, u përdorën gradualisht teknologji më efikase kopjimi. Gjatë kohës së publikimeve samizdat, një numër tekste të autorëve të censuruar u botuan njëkohësisht edhe në mërgim, nga ku ato u futën kontrabandë prapa Perdes së Hekurt.

¹⁶ Në 2009 Fedor Gál iu dhurua Çmimi Ján Langoš për punën e tij. Teksti i Prof. Zajac ishte fjalimi i nderit me këtë rast.

¹⁷ Një lëvizje politike e themeluar në Bratislavë, Sllovakia, më 20 nëntor 1989. Homologu Sllovak i Forumit Qytetar Çek.

një trup dhe një mendje të përbashkët, merrnim frymë me një ritëm të njëjtë. Jam akoma i bindur edhe sot se kjo ishte arsyeja kryesore pse ne patëm sukses, pavarësisht mungesës së përvojës dhe gabimeve. Ishte një moment i rrallë, i jashtëzakonshëm, një dëshirë e cila gjeti identitetin e saj kolektiv në atë trup nëntori. Pak para kësaj kisha lexuar romanin e Mary Renault ‘Demi nga Deti’. Banda Theseus e burrave nga Athina të cilët u nisën për në Kretë për të ofruar flijimin vjetor njerëzor, arrin të krijojë një lloj trupi kolektiv të përbashkët në labirint, për të mundur Minotaurin dhe të lirojë Ariadne, vajzën e mbretit. Ishte një histori magjepëse dhe më solli ndër mend atë trup të përbashkët nëntori. Megjithatë historia e kishte një vazhdim. Pasi u kthyen në Athinë, trupi kolektiv u shpërbë dhe u kthye në histori të vetme individuale plot me trishtim. Po prisja të shihja se çfarë do të ndodhte me atë trup të përbashkët nëntori. Disa e gjetën rrugën e tyre, disa vdiqën, të tjerët avulluan, disa u kthyen në morra, disa mbetën ata që ishin. Fedor mbeti ai që ishte.

Unë përjetova një nga skenat më absurde të jetës time pas zgjedhjeve fitimtare të qershorit 1990. Fedor u ul në një tavolinë, duke lëkundur këmbët, krahët e tij të gjatë shtriheshin përgjatë trupit, duke tundur kokën ritmikiht. Që atëherë, kam qenë shumë herë dëshmitar i kësaj gjendje trupore të rraskapitjes absolute, por ajo ishte hera e parë. Fitorja ishte përfundimisht e jona, dhe ne u copëtuam pjesë-pjesë. Prej atëherë e tutje, gjërat ecën shpejt. Fedor u bë një armik i popullit, dhe ata me të cilët kishim krijuar së fundmi një grup të përbashkët, na lanë si minj, disa me qetësi, disa duke përplasar derën zhurmshëm. Ishte një kohë tradhtie e cila e flaku Fedor në bregun e detit çek. Ai u bë një vagabond. Rrudhat u thelluan në brazdat e para të kripura.¹⁸



Varrezat simbolike parballë Fortesës së Vogël në Terezin me të paktën disa emra që përkujtojnë viktimat e kampit të përqendrimit, 2008.

MIRO ŠVOLÍK

Kaluan pesëmbëdhjetë vjet. Urrejtja u zbeh, njerëzit filluan t'i buzëqeshnin sërish atij në rrugët e Bratislavës. Pastaj u nis në rrugën drejt vetvetes. Në fund të filmit Udhëtimi i shkurtër i Gjatë, një Fedor Gál i vetmuar ecën përmes një fshati të rregullt gjerman midis Sachsenhausen dhe Schwerin, me një gurë të vogël në dorë. Ai kurrë s'ka qenë këtu më parë dhe ndoshta s'ka për të ardhur më kurrë. Por këtu të çontë rruga e vdekjes dhe në këtë

¹⁸ Pasi arriti sukses të madh në zgjedhjet e para pas Revolucionit të Kadifenjtë, ndodhi një përçarje në partinë Publiku Kundër Dhunës. Fedor e kundërshtoi ndarjen e Çekosllovakisë dhe u kthye në figurë të urrejtjes publike. Ai ishte gjithashtu shënjestër e abuzimit ani – Semitik nga të ashtuquajturit “nacionalistë” [shënimi i botuesve].

zonë mund t'ia këne vranë babain. Këtu është ku Fedor e gjen atë në një moment dhe e humb sërish. Ai vendos gurin pas gardhit në varrin imagjinar prej ajri, si i cili ka plot në këtë botë. Është një histori si në një film që luhet së prapthi. Por çfarë do të thotë kjo lëvizje mbrapsht. Në fillim ka një gjë të sigurt – linda, mbijetova, jam. Në fund të filmit një pasiguri e rrudhosur – kush jam unë në fund të fundit? Kjo pasiguri do ta shqetësojë Fedor deri në fund të jetës së tij; ai thjesht nuk e di akoma. Sepse identiteti njerëzor është autobiografik. Është ajo ç'ka mbetet në fund si kujtesë e jetës. Gjithë jetën e tij Fedor e ka ditur se ç'do të thotë të jesh një person laik. Se ç'do të thotë të jesh ungjillor apo mënyrën se si u pagëzua, ai nuk do ta mësojë në këtë rrugë Dante-eske. I duhet të qëndrojë më gjatë për këtë. Dhe ndoshta nuk do ta mësojë kurrë. Por këtë herë, ai patjetër do ta mësojë se ç'do të thotë të jesh një hebre në këtë botë. Kjo do të thotë të jesh njëri të cilin e vrasin vetëm pse ekziston. Pavarësisht besimit, racës, familjes, kombësisë.

Pas një sulmi të neo-nazistëve çekë në 2009, Natálka¹⁹ u dogj si një kurban. Fedor dhe miqtë e tij e ndihmojnë sot atë t'i rikthehet jetës. Ajo u dogj vetëm se është një vajzë e vogël rome. Çfaë lloj bote është kjo, pyet rrudha më e re në fytyrën e Fedor. Rrudha po thellohet, po kthehet në brazdë, njësoj siç po kthehet në brazda e tërë fytyra e Fedor e cila krijon portretin e tij sot.

KONTRIBUT I FONDACIONIT JÁN LANGOŠ

¹⁹ Natálka Kudriková dy vjeçare u dogj rëndë në një sulm zjarrvënije të qëllimshme nga neo-nazistët çekë [shënimi i botuesve].

HUNGARIA

Pas shpërbërjes së Perandorisë Austro-Hungareze u rivendos monarkia Hungareze më 1920 dhe Admirali Miklós Horthy u zgjodh regjent.

REGJIMI NAZIST

Hungaria iu bashkua Aksit, e frikësuar nga sovjetikët dhe në mënyrë që të fitonte territoret e humbura pas Luftës së Parë Botërore. Ushtria hungareze luftoi në frontin Lindor që nga 1941. Në mars 1944 Gjermania pushtoi vendin dhe instaloi një qeveri kukull, por Horthy mbeti në detyrë. Pas pushtimit gjerman të 1944 shumica e hebrenjve hungarezë u dëbuan në kampet e përqendrimit. Horthy u përpoq të përmbyllte një armëpushim me Sovjetikët në tetor 1944, por u rrëzua nga një grusht shteti i organizuar nga gjermanët. Udhëheqësi i nazistëve hungarezë (Partia Kryq Shigjetë) Ferenc Szálasi u bë Kryeministër. Ushtria sovjetike hyri në Hungari në shtator 1944, duke fituar kontroll mbi vendin në prill 1945.

REGJIMI KOMUNIST


Në zgjedhjet kryesisht të lira të 1945, Komunistët fituan 17% të votave. Por prapë, Sovjetikët imponuan në pozicionet kyçe një koalicion me komunistët dhe aleatët e tyre në pozicionet. Në zgjedhjet thellësisht të manipuluar të 1947, Komunistët, të mbështetur nga forcat Sovjetike, nuk fituan as gjysmën e votave, megjithatë, ata vazhduan të ushtronin kontroll të plotë dhe në 1949 u shpall Republika Popullore e Hungarisë. Në 1956, diktatura komuniste u përmbys në një revolucion mbarëkombëtar i cili u shtyp nga Ushtria Sovjetike. Regjimi u shemb në 1989 dhe në 1990 u mbajtën zgjedhjet e lira.



JÓZSEF PEHM u lind në fshatin Csehimindszent, Hungari, në 29 mars 1892. Besimin e thellë fetar e mori nga familja. Ai nisi studimet teologjike dhe nga 1917 ishte mësues i katekizmit në një shkollë të mesme për djem.

Filloi të përfshihej në jetën publike në fund të Luftës së Parë Botërore. Kundërshtoi publikisht të dy regjimet, nazist dhe komunist. Ai mori mbiemrin Mindszenty, pjesërisht për të nderuar fshatin e tij të lindjes dhe pjesërisht për të shprehur mospajtimin mbi ndikimin në rritje të Gjermanisë në Hungari. Ai u arrestua dhe u dënua me burgim të

përjetshëm në 1949. Gjatë Revolucionit Hungarez të 1956 ai u lirua për pak ditë por ndërhyrja Sovjetike e shtypi revolucionin. Kardinali kaloi 15 vjet në ndërtesën e Ambasadës Amerikane në Budapest. Ai u lejua më në fund të largohej nga vendi në 1971. Ai vdiq në mërgim në Vjenë në 1975.



FONDAZIONI
MAGYARORSZÁGI
MINDSZENTY

Kardinali József Mindszenty

Ndërgjegja Hungareze

Shkruar nga Tamás Stark

Kardinali József Mindszenty përjetoi një periudhe vuajtjesh të skenarëve të ndyshëm politik, duke jetuar në hijet e diktaturave të ndryshme të shekullit të 20. I lindur si fëmijë i një familjeje modeste, ai arriti të përparoj nga një famullitar i thjeshtë në nivelin më të lartë të hierarkisë Katolike Hungareze. Pavarësisht sprovave e mundimeve që iu desh të kalonte, ai nuk ndryshoi në thelb: kurrë nuk dështoi në këmbënguljen e të qenit zemërgjerë në mënyrë që të ndihmonte të varfërit e të nëpërkëmburit, i vendosur të luftonte padrejtësinë dhe i palëkundur në shprehjen e besimit të tij.

VITET E PARA DHE STUDIMET

Historia e tij filloi në fshatin e Csehimindszent, jo larg nga kufiri perëndimor i Hungarisë, ku ai erdhi në këtë botë më 29 mars 1892 si József Pehm. Ai mori mbiemrin Mindszenty në 1941, pjesërisht për të nderuar fshatin e tij të lindjes dhe pjesërisht për të shprehur mospajtimin mbi ndikimin në rritje të Gjermanisë në Hungari. Besimin e thellë fetar e fitoi nga familja e tij. Mamaja e tij, Borbála Kovács, vërtetoi të ishte një nga mbështetëset e tij më të forta edhe në moshën e tij madhore. Ai ishte student i shkollës së mesme Premonstratensian të Szombathely midis viteve 1903 dhe 1911 dhe u diplomua me nota të shkëlqyera. Në 1911 ai shkoi për të studiuar në fakultetin e kolegjit teologjik të dioqezës së Szombathely. Gjatë këtyre viteve ai pati mundësinë të udhëtonte përmes pjesës perëndimore të Hungarisë dhe të njihej më në thellësi me jetët e përditshme të banorëve.

KARRIERA E MËSIMDHËNIES DHE JETA PUBLIKE

Pasi mbaroi studimet e tij teologjike në 1915, ai shërbeu në një fshat të vogël të quajtur Felsőpaty, në pjesën perëndimore të Hungarisë. Pasuar nga një periudhë prej një viti e gjysmë duke shërbyer si mesues katekizmi dhe si ndihmës famullitar, më 26 janar 1917 ai u dërgua në Zalaegerszeg¹ si mesues katekizmi

¹ Një qytet me madhësi mesatare i ndodhur përkatësisht rreth 60 kilometra larg nga kufijtë e Austrisë, Slovenisë dhe Kroacisë

në shkollën e mesme publike për djem. Ai filloi të përfshihej në jetën publike në fund të Luftës së Parë Botërore, nën ndikimin lëvizjeve shoqërore të shfaqura si pasojë e rënies së ushtrisë Hungareze. Në shkurt 1919 ai anëtar i komitetit përgatitor të zgjedhjeve parlamentare. Aktiviteti i tij publik u qortua nga qeveria “demokratike qytetare” e Mihály Károlyi, rrjedhimisht, më 9 shkurt 1919 gjatë rrugës për në Szombathely për të sistemuar disa çështje, u arrestua nga policia nën dyshimin e “nxitjes kundër-revolucionare” dhe e izoloi atë në Pallatin e Peshkopëve. Ditën e grushtit të shtetit të komunistëve hungarezë më 21 mars, ai u transportua në qelin e gjykatës së vendit. Nga atje u dërguar sërish në Zalaegerszeg më 15 maj, ku kreu i drejtorisë komuniste e lejoi të qëndronte në qytet me kushtin që të shmangte çdo aktivitet klerik. Meqë ai nuk ra dakord me këtë kusht, u dëbua nga qyteti Zala si një “element i pakorrigjueshëm” më 20 maj. Fshati i tij i lindjes u caktua si vendbanim i përhershëm; mbi të gjitha, ai ishte i detyruar të paraqitej dy herë në ditë te këshilli i punëtorëve të fshatit. Ai arriti të kthehet në Zalaegerszeg në gusht 1919, pas rënies së regjimit jetëshkurtër Komunist.

Pak vitë më vonë në 1921, ai u emërua famullitar i të njëjtit qytet, detyrë që e mbajti për 25 vjet. Gjatë kësaj periudhe ai bëri më të mirën për të modernizuar famullinë dhe për të ndihmuar të varfërit. Ai ndërtoi Kishën dhe Manastirin Françeskan të Zalaegerszeg dhe themeloi disa shkolla, siç ishte shtëpia e nënës dhe kolegji i trajnimit të mësuesve të Motrave Notre Dame. Ai ndërtoi streha për të varfërit dhe mbështeti djemtë e fshatit nga rrethanat e papërshtatshme gjatë studimeve të tyre. Për më tepër, në mënyrë që të ndihmonte të varfërit dhe të përkrahte integrimin e tyre në jetën fetare, ai themeloi organizatën “apostuj në shtëpi”, e cila përfshinte besimtarët e famullisë të cilët, në kohën e tyre të lirë vizitonin familjet e lagjes dhe ndihmonin sa më shumë të mundnin kudo që nevojitej.

Ai gjithashtu u përpoq të gjallëronte jetën kulturore të Zalaegerszeg, kështu që nxiti aktivitetet në shtëpinë kulturore katolike dhe kontriboi në themelimin e Muzeumit Göcsej. Pjesë e përpjekjeve të tij ishte edhe themelimi i një gazete, të cilën e redaktoi vetë dhe e botoi në një shtypshkronjë të themeluar nga po vetë ai. Në këtë gazetë dhe në gazeta të tjera po ashtu, ai përfaqësoi vendosmërisht shpirtin Katolik, duke u përpjekur që ta bënte të mbizotëronte. Pas njëfarë kohe ai ndërmori një rol drejtues në jetën klerike publike rajonale e kombëtare duke kërkuar të gjente zgjidhje për problematikat kryesore shoqërore dhe përkrahu mësimet e kishës të formuluar në qarkoret papnore². Ai gjithashtu u përpoq të tërhiqte vëmendjen për rreziqet e komunizmit dhe nazizmit të cilat përbënin një kërcënim, jo vetëm për Kishën Katolike Hungareze, por për shoqërinë hungareze në tërësi. Veprimtaria e tij e jashtëzakonshme si pastor u pranua nga Kisha Katolike Hungareze dhe Selia e Shenjtë³

² Letrat qarkulluese të lëshuara nga Papa [shënim i botuesve]

³ Juridiksioni peshkopial i Kishës Katolike në Romë (gjerësisht i njohur por gabimisht si “Vatikani”) [shënim i botuesve]

LUFTA E DYTË BOTËRORE

Me shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore aktiviteti i tij publik u rrit. Në 1939 Kryeministri Pál Teleki i kërkoi atij të merrte përsipër drejtimin e Shërbimit Politik Kombëtar Trans-Danubian. Qëllimi kryesor i kësaj organizate ishte të barazpeshonte veprimtarinë e dyfishtë propagandistike të ndjekur nga Gjermania, e cila u mundua të zgjeronte ndikimin e saj në Hungari përmes organizatës Kombëtare Socialiste Gjermane, Volksbund, dhe përmes Partisë Kryq Shigjetë Hungareze ekstremisht të djathtë.

Papa Piu XII e emëroi Mindszenty Peshkop të Veszprém më 4 mars 1944, në një periudhë tepër kërcënuese, vetëm pak ditë përpara pushtimit gjerman. Shugurimi i tij ndodhi më 19 mars, gjashtë ditë pas ardhjes së forcave pushtuese gjermane. Kryepastori i sapo emëruar ishte thellësisht i shqetësuar rreth situatës së re politike nga pasojat e pushtimit. Ai i shkroi një letër konfidenciale Kryepeshkopit Jusztinián Serédi në 14 prill, duke e vënë atë në dijeni për forcimin e fuqive të krahut ekstrem të djathtë dhe duke i kërkuar të ndërhynte me Guvernatorin Horthy, në mënyrë që të pengonte përparimin e tyre.

Ndërkohë që në vazhden e pushtimit Gjerman persekutimi i Hebenjve kishte filluar, Mindszenty u ngrit për ta njësoj si me fjalë dhe me vepra, duke protestuar kundër dëbimit dhe krijimit të getove në fshat. Ai u përpoq gjithashtu t'i ndihmonte ata në dioqezën e tij: i kërkoi priftërinjve të tij të tregonin dashuri vëllazërore ndaj hebenjve që regjistroheshin për pagëzim dhe e përshpejtoi ritualin e shndërrimit të tyre në Kristianizëm. Ai i ndaloi institucionet katolike që të praninin çdo mall apo pronë të plaçkitur nga hebenjtë e dëbuar. Në kohën e dëbimit masiv të hebenjve nga fshati, ai i bëri thirrje drejtëpërdrejt Guvernatorit Horthy në letrën e tij të 19 qershor 1944, duke iu lutur atij të ndalonte të paktën dëbimin e fëmijëve të pagëzuar me prejardhje hebreje.

Përpyekjet e tij të jashtëzakonshme kundër persekutimit të hebenjve hungarezë bashkë me zëra të tjerë midis drejtuesëve katolik kontribuan gjithashtu në anulimin e dëbimit nga getoja e Budapestit në verën e 1944.



József Mindszenty në një degjesë publike gjatë Konferencës Botërore Eukaristike që u mbajt në Hungari më 1938.

ARKIVA FORTEPAN

Në orvatjet e tij për të ndihmuar hebrenjtë, u përball edhe me Partinë Kryq Shigjetë nacional socialiste. Së pari, i ndaloi ata të kremtonin meshë të shenjtë falenderimi në Kishën Françeskane të Veszprém për të festuar dëbimin e Hebrenjve. Pastaj, në fund të tetorit, pasi Partia Kryq Shigjetë kishte marrë pushtetin me mbështetjen gjermane, Mindszenty bashkë me dy peshkopë të tjerë përgatitën një memorandum për qeverinë e re ku insistonin që e gjithë lufta në rajonin Trans – Danubian të Hungarisë duhej të ndërpritej menjëherë sepse lufta nuk kishte më interes për popullin hungarez. Për t'u hakmarrë ndaj veprimit të tij, autoritetet vendase



Mindszenty dhe klerikë të tjerë të rangut të lartë më 1948, një vit para arrestimit të tij.

ARKIVA FORTEPAN

synonin të zaptonin Pallatin e tij të Peshkopatës plot me refugjatë dhe ta përdornin atë për qëllime lufte. Për shkak se refuzoi t'i bindej këtij udhëzimi, Mindszenty u arrestua në 27 nëntor 1944. Fillimisht, ai bashkë me priftërinjtë dhe rishtarët e tij u mbajtën në burgun e qarkut vendas, por më 23 dhjetor me afrimin e vijës së frontit, ata u transportuan në pjesë më perëndimore të vendit, Sopronkőhida, ku ndodhej një burg i madh i mbushur me kundërshtarë të shumtë të qeverisë Kryq Shigjetë, shumë prej të cilëve më vonë u ekzekutuan.

Në prill 1945, pasi vija e frontit dhe pjesa e mbetur e anëtarëve të Partisë Kryq Shigjetë kishin lënë vendin, Mindszenty dhe shokët e tij të burgut u liruan. Kështu, Mindszenty mund të rifillonte shërbimin e tij në Veszprém, ku ai u përpoq të ndreqte

shkatërrimin moral e material të shkaktuar nga lufta. Si peshkop, ai duhej të vazhdonte shërbimin aktiv dhe organizativ siç bëntë më parë në vitet e tij në Zalaegerszeg. Ai bëri shumë për dioqezën e tij edhe pse e mbajti atë detyrë për një kohtë shumë të kufizuar. Vetëm për gjysmë viti ai themeloi 34 famulli të reja dhe 11 shkolla fshati të reja.

Meqë paraardhësi i tij kishte vdekur në mars 1945, Papa Piu XIII e emëroi Mindszenty kryepeshkop të Esztergom më 16 gusht 1945. Me këtë emërim Mindszenty u bë drejtuesi i Kishës Katolike Hungareze. Papa e shuguroi atë si kardinal në Bazilikën e Shën Pjetrit në Romë më 21 shkurt 1946.

PUSHTIMI SOVJETIK

Pas Luftës së Dytë Botërore, Hungaria u pushtua nga trupat Sovjetike dhe filloi të bënte pjesë në sferën e ndikimit të Bashkimit Sovjetik, kështu që nuk kishte asnjë hapësirë për ndonjë ndryshim të

vërtetë demokratik. Mindszenty e ngriti zërin në emër të demokracisë shumë herë në shumë vende. Në letrën kryesore pastorale të nxjerr para zgjedhjeve të vjeshtës në 1945, ai mbajti një qëndrim tashmë të prerë, duke thënë: “jeta hungareze është endur nga një tirani totale në tjetrën”. Mindszenty gjithashtu vazhdoi me punën e tij duke luftuar kundër padrejtësisë dhe për të drejtat e të shtypurve. Ai dëshironte të mbronte këdo që i ishin shkelur të drejtat, pa marrë parasysh prejardhjen, kombësinë, besimin fetar apo statusin shoqëror. Gjatë kohës së pushtimit të huaj dhe shpалosjes së diktaturës Komuniste, kur qeveria dhe partitë politike gjithmonë e në heshtje nuk i shprehnin këto mendime, ai ndërmori barrën për të shprehur shqetësimet e tij rreth problematikave kryesore të hungarezëve. Ai i kushtoi vëmendje të plotë të ardhmes së të arrestuarve e të të internuarve dhe shkoi rreth e qark duke vizituar të gjithë burgjet dhe kampet e internimit të mbushur plot me kundërshtarë politikë të regjimit të ri. Ai kërkoi të gjente mënyra që t'i kthente në shtëpi të burgosurit hungarezë të luftës dhe civilët e internuar që ishin dëbuar në Bashkimin Sovjetik.

Ndërsa fundi i Luftës së Dytë Botërore solli dëbime masive të cilat prekën kryesisht pakicat hungarezë dhe gjermane që jetonin përtej kufijve të atdheut të tyre, Mindszenty protestoi kundër persekutimit të Hungarezëve në ish territoret hungareze të Çekosllovakisë e Jugosllavisë dhe kundër dëbimit të gjermanëve nga Hungaria. Për më tepër, ai protestoi edhe kundër mizorive të dhunshme dhe çnjerëzore të kryera gjatë zhvendosjes së detyruar të popullsisë sllovakë–hungareze e cila synonte eliminimin e pakicave hungareze në Çekoslllovakë. Kryepeshkopi kundërshtoi me vendosmëri përparimin gjithnjë e në rritje të diktaturës së re Komuniste. Kjo vendosmëri e guximshme ishte baza e respektit dhe popullaritetit të pashembullt që e rrethoi atë.

Përveç ngritjes kundër regjimit të ri dhe praktikave çnjerëzore të tij, ndaj të shtypurve dhe të keqtrajtuarve, ai gjithashtu u përpoq t'i jepte shpresë vendit të shkatërruar përmes fuqisë së besimit. Ai bëri më të mirën që të ringjallte fenë katolike. Dhuntia e tij pastorale dhe predikuese ndriçoi veçanërisht mes viteve 1945 – 1948. Në predikimet e tij, temat e paqësimit⁴, një jete të devotshme, respektimit të Virgjëreshës Mari, adhurimit të shenjtëve hungarezë dhe dëlirësisë së familjes, zunë vend kryesor. Ai gjithashtu organizoi një ngjarje madhështore të quajtur “Viti i shenjtë i Virgjëreshës Mari” (Vigjërësia Mari kishte qenë mbrojtësja e Hungarisë për shekuj), e cila u zhvillua midis 15 gusht 1947 dhe 8 dhjetor 1948, dhe tërhoqi një numër të madh besimtarësh. Për të sqaruar përmasat e vërteta të kësaj ngjarje, mjafton të thuhet që faltoret e ndryshme anëmbanë vendit u vizituan nga 1.5 milionë dhe 1.7 milionë pelegrinë më 15 gusht dhe më 8 shtator 1947, përkatësisht, ndërsa në tetor 1947 rreth 480,000 të rinj dhe punëtorë morën pjesë në një kongres të mbajtur në Budapest. Ndërkohë, autoritetet e punëve të brendshme të shtetit të kontrolluara nga komunistët, ndaluan shoqatat katolike dhe grumbullimet shkollore, kërcënuan

⁴ Të pajtohesh me Zotin (të shlyhesh) [shënimi i botuesit]

prifiterinjte dhe penguan besimtarët të praktikonin fenë e tyre. Kështu që është vërtet kuptimplotë që u zhvillua kjo lëvizje masive e jashtëzakonshme pavarësisht fushatave anti klerike dhe sulmeve të hapura nga autoritetet komuniste.

ARRESTIMI I MINDSZENTY

Ndërkohë që partitë dhe organizatat demokratike ishin detyruar të shpërbëheshin midis 1947 dhe 1948, u bë thelbësore për qeverinë e re të eliminonte organizatat e fundit kryesor të afta për ndikimin dhe mobilizimin e turmave të mëdha: katër kategoritë kryesore mbizotëruese fetare të vendit. Kisha Katolike ishte me e madhja nga të katërtat – përfaqësonte më shumë se dy të tretat e popullsisë- dhe kishte udhëheqësin më të palëkundur, prandaj nuk ishte ndonjë habi që katolikët ishin të ekspozuar ndaj sulmeve më të ashpra. Si rrjedhim, pas pothuajse një viti përgatitjesh, Mindszenty u arrestua në Pallatin e tij të Kryepeshkopatës në Esztergom më 26 dhjetor 1948. Akuzat e sajura ndaj tij ishin tradhtia, komploti për rënien e republikës, spiunazhi dhe trafikimi i valutës së huaj. Ai u mor në paraburgim dhe u dërgua në selinë qendrore të Autoritetit të Mbrojtjes së Shtetit të Budapestit, ndërtesa famëkeqe dhe dhoma e torturës në Rrugën 60 Andrassy (Autoriteti i Mbrojtjes së Shtetit ose ÁVH , ishte shërbimi i policisë sekrete të shtetit të ri Hungarez, i njohur për metodat e marrjes në pyetje dhe brutalitetin). Prandaj, vetë Mindszenty ishte marrë në pyetje dhe torturuar për një kohë të gjatë përpara të fillonte gjyqi teatral i tij i orkestruar në fillim të shkurtit. Në fakt, i gjithë procesi kundër Mindszenty, që nga fillimi, ishte drejtuar dhe zbatuar sipas udhëzimeve të lëshuara nga vetë drejtuesi i partisë komuniste Mátyás Rákosi.

Seanca e tij gjyqësore “publike” u zhvillua midis 3 dhe 5 shkurt 1949. Në ato kohë çeshtjet ndiqeshin nga e ashtuquajtura “Gjykata e Popullit”. Këto gjykata u krijuan pas Luftës së Dytë Botërore për t’i sjellë kriminelët e luftës para drejtësisë, por ato vazhduan të funksiononin edhe pasi u përmbush qëllimi i tyre kryesor. Ato vepruan si një lloj jurie, anëtarët e së cilës vinin nga rradhët e partive që bashkëpunonin me komunistët. Si të tilla ato shërbyen si mjet për të dënuar armiqtë social ose politikë të Komunistëve. Në gjyqin e Mindszenty, siç drejtohej nga Rákosi, anëtarët e jurisë që i përkisnin Partisë së Pronarëve të Vegjël kërkuan 15 vjet burg të sigurisë së lartë, anëtarët e Partisë së Fshatarëve kërkuan dënim të përjetshëm, ndërsa anëtarët e dy partive Komuniste kërkuan ndëshkim me vdekje për të pandehurin Mindszenty.

Përfundimisht, vendimi i gjykatës i lëshuar në 8 shkurt shpalli dënim të përjetshëm për kardinalin dhe ky gjithashtu u miratua nga një seancë e gjykatës eprore të Këshillit Kombëtar të Gjykatavë të Popullit që u mbajt në 6 qershor 1949.

Vendimi i gjykatës shkaktoi një jehonë të madhe në botën Perëndimore. Si Papa Piu XII dhe

Presidenti i SH.B.A Harry S. Truman, të dy e dënuan vendimin. Qeverisë Hungareze më 2 prill 1949 iu dha memorandum i Britanik – Amerikan, i cili dektaroi se vendi po shkelte të drejtat themelore të njeriut të përcaktuara në nenin e dytë të traktatit të paqes dhe të drejtave themelore të lirisë. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara gjithashtu e dënoi sjelljen e qeverisë dhe e deklaroi burgosjen e kardinalit si një shkelje ndërkombëtare.

Mindszenty u mbajt në izolim në një burg dhe më pas në një burg publik. Sidoqoftë shëndeti i tij përkeqësua si pasojë e torturës dhe e terrorit fizik e psikologjik që vuajti. Meqenëse regjimi Komunist nuk do të kishte përfitime nga martirizimi i tij në një qeli burgu, ai u transportua në fshat dhe u mbajt nën arrest shtëpiak që nga vera e 1955. Por edhe kur ishte në arrest shtëpie ai u izolua nga bota e jashtme dhe nuk kishte të drejtë të lexonte shtypin ose të dëgjonte radion.

NJË SHIJE E SHKURTËR E LIRISË

Në tetor 1956 popullit Hungarez i kishte mbaruar durimi prej shtypjes që kishin kaluar për pothuajse një dekadë dhe pas protestave studentore anëmbanë vendit, më 23 tetor ata ndezën një revolucion i cili më vonë u përshkallëzua në një luftë për liri kundër shtypjes Sovjetike. Pak ditë pas shpërthimit të revolucionit më 30 tetor, Mindszenty u lirua nga një grup ushtarësh hungarezë. Të nesërmen ai ishte në Budapest duke punuar me zell dhe devotshmëri të

PERSEKUTIMI I KISHAVE NËN REGJIMIN KOMUNIST

“Feja është opiumi i popullit” – ky citim i Karl Marx përcaktoi qëndrimin ndaj fesë nga të gjitha regjimet Komuniste. Kisha ishte një konkurrente e Komunistëve dhe ideologjive të tyre ateiste dogmatike, veçanërisht në vendet me nivel të ulët arsimimi dhe shkrim – leximi. Prandaj komunistët huazuan thjesht disa metoda sipërfaqësore të ritualeve fetare. Ngjashmëria midis adhurimit të ikonave të Kishës Ortodokse Greke me portretet e mëdha publike të udhëheqësve Komunistë është e dukshme, gjithashtu edhe midis ceremonive fetare të kryqit me ceremonitë e detyrueshme publike të festave zyrtare Komuniste duke mbajtur portretet dhe parrullat e udhëheqësve.

Gjatë 1918 – 1943 kleri u persekutua brutalisht në Bashkimin Sovjetik. Qindra mijëra klerikë u ekzekutuan, u mbyllën manastiret, u shembën kishat dhe u konfiskua prona e kishës. Në 1943 Stalini, i njohur deri atëherë si Antikrisht nga besimtarët, vendosi të përdorte besimin e njerëzve në propagandën e tij – shtypjet kundër Kishës Ortodokse Ruse u pezulluan dhe priftërinjtë u urdhëruan të luteshin për fitoren e ushtrisë sovjetike. Pas Luftës së Dytë Botërore pushteti komunist vazhdoi t’i shtypte kishat. Shërbimet e kishës u lejuan por propaganda ateiste çnjerëzore dhe persekutimi i klerikëve të njohur vazhdoi, përfshirë rrëmbimin dhe vrasjet e priftërinjve nga Sigurimi i Shtetit. Policia sekrete u infiltrua nëpër kisha, si midis klerit dhe atyre që shkonin në kishë. Besimtarët ishin të frikësuar dhe preferuan ta fshihnin besimin e tyre. Megjithatë politika ishte disi e ndryshme në vende të ndryshme. Në Poloni Kisha Katolike arriti ta ruante pozicionin e saj midis njerëzve, ndërsa p.sh. Shqipëria u deklarua të ishte një vend ateist. Në Gjermaninë Lindore ku kishat përfitonin nga lidhjet me homologët e tyre të Gjermanisë Perëndimore, qarqet e Kishës Protestante luajtën një rol të rëndësishëm në lëvizjen disidente e cila çoi në rënien e regjimit totalitar.

madhe. Ai pati një seri negociatash me politikanët, anëtarët e peshkopatës, udhëheqësit e dioqezës së tij, me Ministrin e Shtetit Zoltán Tildy, zyrtarë kryesorë të kishave Calviniste dhe Luterane, madhe edhe me përfaqësuesit e organizatave të huaja të ndihmave. Pas kërkesës së Kryeministrit Imre Nagy, ai mbajti një fjalim 15 – minutësh që u transmetua më 3 nëntor nëpërmjet stacionit të Radiosë së Lirë Hungareze. Ai shprehu që edhe pse kishte vuajtur prej vitesh, ai nuk kishte mllef në zemrën e tij; ai mbështeti objektivat e luftës për liri dhe përshkruajti në publik një shoqëri të ardhshme demokratike.

Megjithatë, të nesërmen më 4 nëntor 1956, pas një sulmi në vend nga trupat Sovjetike, ai u detyrua të kërkonte azil politik nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara. Fillimisht ai mendoi se qëndrimi i tij atje do të zgjaste vetëm pak kohë për shkak të tensionit të pritshëm ndërkombëtar mbi Bashkimin Sovjetik. Megjithatë, strehimi i tij “ i përkohshëm” politik në ambasadë zgjati 15 vjet. Në ambasadë ai u informua rreth lajmeve dhe ngjarjeve në Hungari e botë nga mediat dhe diskutimet personale. I detyruar të rrinte pasiv, kryepastori e kaloi kohën e tij duke shkruar ditarin, duke drejtuar kërkime historike dhe duke shtjelluar kujtimet e tij.

Qeveria e Hungarisë do ta miratonte largimin e tij nga vendi vetëm me kushtin që Vatikani garantoj që kryepeshkopi nuk do të fliste rreth dënimit të gjyqit, mbajtjes në paraburgim dhe kushteve të përgjithshme në Hungari. Ata gjithashtu kërkuan dorëheqjen e Mindszenty si kryepeshkop. Megjithëse Selia e Shenjtë i refuzoi këto kushte për një kohë të gjatë, përfundimisht më 9 shtator 1971 u arrit një marrëveshje për fatin e kardinalit – por pas shpinës së tij.

MËRGIMI NGA VENDLINDJA

Përfundimisht, duke iu bindur kërkesës së Papa Paul VI Mindszenty la ambasadën për Romën në 28 shtator 1971 dhe qëndroi atje deri më 23 tetor 1971. Më pas ai shpërngul në Vjenë, ku Kisha Katolike Hungareze kishte një seminar të sajën, dhe u vendos aty. Ai u angazhua në veprimtari shumë intensive priftërore; e konsideroi si detyrë të tijën të forconte besimin dhe identitetin kombëtar të Hungarezëve të shpërndarë kudo nëpër botë. Kryepastori i mërguar vizitoi Amerikën e Veriut dhe Jugut, Afrikën e Jugut, Australinë si dhe Zelandën e Re dhe u përgëzua kudo me entuziazmin dhe respektin më të madh, ndërsa shumë njerëz i bënë vizita në rezidencën e tij në Vjenë.

Autoriteti i lartë i kardinalit dhe suksesi spektakolar i veprimtarisë së tij pastorale gjatë udhëtimeve të tij i irritoi udhëheqësit komunistë hungarezë. Ata i kujtuan Vatikanit që kushti parësor i negociatave për lirin e kryepeshkopit kishte qenë dorëheqja e tij nga pozicioni i kryepeshkopit të Esztergom. Kështu. Papa Paul VI, si një gjest ndaj politikës së “hapur” kundrejt vendeve Lindore socialiste, e deklaroi të lirë vendin e kryepeshkopit të Esztergom më 18 dhjetor 1973. Mindszenty u pajtua me vendimin papnor dhe nuk e përdori më titullin e kryepeshkopit. Megjithatë ai nuk u

tërhoq: vazhdoi të kryente veprimtarinë e zellshme kishtare deri në vdekjen e tij më 6 maj 1975 në Vjenë.


Në përputhje me amanetin të tij të fundit ai u varros në Faltoeren Shën Ladislaus të Kishës së Shenjtë të Mariazell në 15 maj 1975. Një numër i madh besimtarësh në zi morën pjesë në ceremoninë funebër dhe në shenjtërimin e varrit të tij më 30 maj 1976. Megjithatë, ky varr nuk do ishte vendi përfundimtar i prehjes së tij pasi Mindszenty në testament kishte shprehur dëshirën për t'u prehur në paqe në dheun e vendlindjes sapo të bëhej vend i lirë. Riatdhesimi solemn i eshtrave të tij dhe ceremonia e rivarrimit në bodrumin e nëndheshëm të Bazilikës së Esztergom ndodhi më 4 maj 1991.

Në fund të 1989 Zyra e Prokurorisë Publike të Hungarisë urdhëroi procedurën e rigjykimit pas vdekjes të çeshtjes Mindszenty. Ai u "rehabilitua" në 18 maj 1990. Proçesi i lumnimit (deklarata nga Papa se një person i vdekur është martir, dhe që përbën hapin e parë drejt ligjërimit si shenjt dhe lejimin e nderimit publik) të tij u fillua në vjeshtën e 1996. Kompensimi i tij i plotë i ligjshëm ndodhi jo më shpejt se 2012.

Vite pas vdekjes së tij, kujtimi i Kardinalit Mindszenty është ende i gjallë, i cila u pa qartë në kremtimet dhe përkujtimoret e shumta që u mbajtën në 120 vjetorin e lindjes së tij. Karakteri i tij besnik dhe i patundur vazhdon të jetë një shembull i mirë për të gjithë hungarezët, duke iu dhënë atyre shpresë e qetësi. Si i tillë, ai do të mbetet gjithmonë ashtu siç e njeh populli hungarez atë: Ndërgjegja e Hungarezëve.

KONTRIBUT I FONDACIONIT PUBLIK PËR STUDIMIN E SHOQËRISË DHE HISTORISË SË EUROPËS LINDORE DHE QËNDRORE – MUZEU I SHTËPISË SË TERRORIT

JÓZSEF UNGÁR u lind më 3 shkurt 1932, në Vörösberény në Hungarinë Perëndimore. Ai vinte nga një familje punëtorësh; megjithatë statusi i tij shoqëror ishte intelektual sipas dokumentave zyrtarë. I ati ishte piktor, e ëma rrobaqepëse. Për shkak të problemeve financiare të familjes, ai filloi të punonte pas vitit të parë të shkollës së mesme. Në 1951 József dhe një grup shokësh të tij themeluan një lëvizje anti – komuniste. Organizata e rezistencës synoi në dobësimin e diktaturës, rivendosijen e pluralizmit dhe demokracisë. Ata u armatosën sa më mire që mundën dhe planifikuan sulme kundër Komunistëve. Ata vendosën kontakte të jashtme klandestine dhe vazhduan veprimtari spiunazhi. József u arrestua në tetor 1952. Ai u gjykua bashkë me shokët e tij, u dënua me vdekje dhe u ekzekutua në 1953 në moshën 21 vjeçare. Eshtrat e tij nuk janë gjetur.



ARKIVA E MUZEUT
TË SHTËPISË SË TERRORIT

József Ungár

Një luftëtar i rezistencës antikomuniste

shkruar nga Dorottya Baczoni

Në Hungari, diktatura komuniste e bazuar në modelin sovjetik, u vendos gradualisht pas 1945. Sistemi i ri politik, social, dhe ekonomik provokoi reagime të ndryshme nga shoqëria. Përgjithësisht, një pjesë e shoqërisë zgjodhi dorëzimin, ndërsa pjesa tjetër rezistuan, qoftë në mënyrë pasive ose aktive.

Këtu, ne tregojmë historinë e një luftëtarit aktiv të rezistencës, historinë e një djaloshi i cili u ngrit kundër regjimit komunist dhe autoriteteve shtypëse të tij. Ai ishte udhëheqësi i Shoqata Kombëtare e Mbrojtjes e Hungarisë⁵, dhe dha jetën për të. Veprimtaria e tij ndodhi në Hungari, në fillim të viteve 1950, një periudhë e quajtur epoka Rákosi. Ishtë një sistem një-partiak i cili u përpoq ta ruante pushtetin e tij nëpërmjet mjeteve të terrorit. Terrori mbahej nga forca policore politike e quajtur ÁVO deri në 1948 dhe ÁVH nga atëherë e tutje.

József Ungár dhe shokët e tij themeluan një organizatë në fshatin e tyre kundër regjimit totalitar. U desh vetëm një vit deri sa ata u arrestuan dhe më pas u ekzekutuan. Rasti i József Ungár dhe ndjekësve të tij na tregon qartë si funksiononte sistemi politik dhe drejtësia në Hungari në atë kohë.

Këta djem të rinj besuan se sistemi do shfuqizohej dhe ata në pushtet do binin.

DITËT E PARA

József Ungár u lind më 3 shkurt 1932, në Vörösberény, i cili në atë kohë ishte port i qytetit të Balatonalmádi në Hungarinë Perëndimore. Ai vinte nga një familje punëtorësh; megjithatë statusi i tij social siç është regjistruar në dokumentat zyrtare, ishte intelektual. Për shkak të problemeve financiare të familjes, ai filloi të punonte pas vitit të parë të shkollës së mesme. I ati ishte piktor, e ëma rrobaqepëse. Ai kishte një motër dhe një vëlla të cilët jetonin në Gjermani. Fillimisht ai u bë një nëpunës regjistrimi në zyrën e sportit të Veszprém dhe më pas u ngrit në detyrë në pozicionin e drejtuesit të zyrës. Ai ishte kandidat për anëtar të MDP (e cila ishte Partia e Popullit Punëtor Hungarez e themeluar në 1948, pas bashkimit të Partisë Social Demokratike dhe Komuniste, dhe që shpejt u bë partia e vetme e vendit) dhe i DISZ (Bashkimi i Rinisë Punëtore). Vitet e shkollës së Ungár dolën që ishin vendimtare për lëvizjen pasi ai dhe tre prej bashkëpunëtorëve të tij Jenő Hugó Hatvári, Gábor Kuti dhe István Tolner ishin shokë klase në shkollë fillore. Një ditë një shok

⁵ *Magyar Nemzetvédelmi Szövetség*. Ka patur më shumë se një organizatë në historinë e Hungarisë që mund të përkthehej në anglisht si Shoqata Kombëtare e Mbrojtjes e Hungarisë [shënimi i botuesve].

i Ungár gjeti trupin e një burri që ishte rrahur për vdekje. Ai ishte vrarë nga policia politike e Veszprém, i cili ishte kryeqyteti i vendit. Ky rast i bëri përshtypje të thellë Ungár saqë vendosi të organizonte një grup rezistence me shokët e tij që ndanin të njëjtat parime.

SHOQATA KOMBËTARE E MBROJTJES E HUNGARISË

Në 1951 ata themeluan një lëvizje, në fillim e quajtur Shoqata Partizane e Hungarisë e më pas e quajtur ndryshe si Shoqata e Mbrojtjes Kombëtare Hungareze. Drejtuesi i këtyre organizatave ishte vetë József Ungár. Qëllimet kryesore të tyre shkuan kundër të ashtuquajturës “demokracia e popullit”. Në të vërtetë, si çdo demokraci që bazohet në vullnetin e njerëzve, emri “demokracia e popullit” ishte diçka krejtësisht e pakuptimtë. Komunistët prapë e quajtën si të tillë sistemin e tyre, duke u përpjekur të fshihnin forcën drejtuese të vërtetë të diktaturës. Ungár dhe bashkëpunëtorët e tij kërkuan tërheqjen e trupave sovjetike nga vendi dhe kthimin e të djave, pluralizmit dhe demokracisë së 1948. Ata po i përhapnin këto parime si privatisht dhe haptas në gazetatat e shkollës. Ata bënë një betim tek Ungár, i premtuan se do ishin shërbëtorë të përlulur të lëvizjes dhe ranë dakord që ndëshkimi i një tradhëtari do ishte vdekja. Betimi u mbajt me ceremoni rrethore, ndërsa Himni Kombëtar Hungarez luhej në gramafon. *“Unë... biri i lëvizjes së rezistencës së Hungarisë betohem që do të jem një partizan besnik i Shoqatës së Mbrojtjes Kombëtare Hungareze”*. Ata gjithashtu kishin një çertifikatë të thjeshtë dhe një vulë. Takimet u mbajtën në apartamentin e Ungár në Vörösberény.

Cilat ishin qëllimet e organizatës? Ata u përpoqën të mblidhnin më shumë anëtarë, armë, që të përgatishin veten në rast se do të plaste një Luftë e re Botërore; ata kishin qëllim të mbështesnin ushtritë perëndimore që duhej të arrinin në territorin e Hungarisë si dhe të kryenin sulme terroriste kundër ushtrisë komuniste hungareze dhe sovjetike. Ata siguruan disa armë por shumica prej tyre ishin përdorur gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe nuk ishin shumë të dobishme. Gjithashtu gjetën një revolver të vjetër e me vlerë; ishte prodhuar në shekullin e 19 dhe s’kishte asnjë fishek, por një ekspert në gjykimin e tyre konfirmoi që ai ishte “i përshtatshëm për shfarosjen e jetës njerëzore”. Grupi zotëronte dy mitralozë, dy pistoleta dhe tre apo katër granata dore. Ata planifikuan të hidhnin në erë hekurudha e ura në qytetet fqinjë (Eplény and Vörösberény), dhe të dëmtonin rrjetin telefonik. Në një rast në maj, József Ungár dhe Hugó Jenő Hatvári vizatuan grafite (shkrime murale) “antidemokratike” përgjatë një rruge kryesore. Ata kishin një granatë dore në rast se kapeshin.

KOMUNIKIMI ME PERËNDIMIN

Organizata kishte kontakte të huaja gjithashtu. Një nga anëtarët e saj, Lajos Sz. Molnár, u arratis

në Perëndim me Ferenc Bata. Misioni i tyre ishte të krijonin lidhje me botën perëndimore që mund t'i ndihmonte ata për të siguruar armë dhe ndihmë financiare. Ata kishin lidhje me Graz në Austri, nga ku ata merrnin furnizime të rregullta me armë.

Ungár i shkroi tre letra të koduara Perëndimit duke iu dhënë informacion rreth Metalurgjikut të Veszprém ku prodhoheshin fishekët e armëve automatike. Ai detajoi sa punëtorë ishin në fabrikë, raportin e grave dhe burrave dhe gjithashtu shkroi targa të rreth 20 makinave sovjetike e hungareze. Për dorëzimin e atij informacioni, në fillim ai mori 500 dhe më pas 300 Forint Hungarez. Anëtarët e tjerë të organizatës gjithashtu e ndihmuan atë që të merrte informacionin.

Ferenc Bata erdhi në shtëpi më 22 shtator 1952 për tre ditë. Ai ndenji në papafingo në apartamentin e Ungár. Ai i mësoi grupit çdo natë bazat e spiunazhit: kriptografi, rekrutim, etj. Ungár i dha atij formularë bosh aplikimi për strehim dhe karta sporti⁶ që t'i merrte jashtë shtetit.

ARRESTIMI DHE GJYKIMI

József Ungár e kishte çuar Ferenc Bata në Ják⁷ me motorçikletën e tij përpara së ai të largohej nga vendi. Megjithatë Bata u arrestua pak para se kalonte kufirin. Ungár u kthye në Vöröberény dhe më pas shkoi të punonte te zyra e sportit më 1 tetor. Dikush e bindi atë që ta çonte në fshat se i duhej të bënte diçka dhe i kërkoi Ungár që ta merrte me motoçikletën e tij. Kur arritën në një kafene në Veszprém, zotëria i vuri armën pas shpine dhe tha : “kthehu këtu, jo atje”. Ata hynë përmes një porte hekuri, ku Ungár u arrestua nga ÁVH. Pas pak ditësh të gjithë anëtarët e Shoqatës së Mbrojtjes Kombëtare Hungareze u arrestuan. Kur u takuan përsëri, Ungár tha me indinjatë: *“I lashë të më torturonin për dy ditë që t’ju ndihmoja të arratiseshit. Por ju nuk kuptuat për çfarë ishtë e gjitha kjo. Nuk u duka për dy ditë”*.

Fillimisht ata u mbajtën në ndërtesën e ÁVH në Veszprém dhe më pas u transferuan në burgun e rrugës Fő në kryeqytet, Budapest.

Gjykimi i parë u mbajt më 5 shkurt 1953. Ungár u akuzua për komplot të armatosur kundër shtetit, tradhti të lartë, dhe spiunazh. Avokati i tij këmbënguli se ai ishte tepër i ri dhe i papërgjegjshëm të kuptonte plotësisht seriozitetin e veprimeve të tij. Fjalët e fundit të Ungár në gjykimin e tij ishin: *“Nuk e dija që po kryeja një krim kaq serioz. U rrita i vetëm pa prindër⁸. Jam i ri; lutem për një dënim të lehtë”*.

Gjyqi e shpalli atë fajtor për spiunazh dhe krime kundër shtetit, për të cilat ai u dënua me vdekje me varje dhe konfiskim të plotë të pronësisë.

Katër të akuzuarit e parë bënë një apel, i cili u refuzua më 16 prill 1953: *“Si shkaktar i ndëshkimit, gjykata e shkallës së parë sqaroi saktë rrezikun e lartë të veprimtarisë së akuzuar. Të gjithë të akuzuarit janë*

⁶ Karta të lëshuara për anëtarët e federatave sportive [shënim i botuesve]

⁷ Një fshat në qarkun Vas, në kufirin perëndimor të Hungarisë

⁸ Kjo nuk ishte tamam e vërtetë, por ai po lutej për mëshirë dhe po përpiqej të kërkonte ndihmë te gjykatësi [shënim i botuesve]

armiq të kombit tonë që ka hedhur bazat e socializmit; qëllimi i tyre ishte të rrëzonin pushtetin e njerëzve punëtorë me forcën imperialiste. I akuzuari i dytë ishte drejtuesi aktual i bandës komplotuese. Ai jo vetëm organizoi lëvizjen, por ishte aktiv në spiunazh gjithashtu. Në dritën e këtyre fakteve, dënimi me vdekje është i vetmi vendim që i shërben mjaftueshëm interesit të demokracisë së popullit, dhe kështu që apeli duhet të refuzohet”.

Në shënimin e seancës së apelit, më 16 prill 1953, Ungár tha: “Armët ishin të gjitha të papërdorshme, ne i mblodhëm ato gjatë luftës si fëmijë. Ne nuk donim një lëvizje serioze; e kuptova seriozitetin e krimeve vetëm pasi hetimi kishte filluar. Gjërat dihetin shumë mirë në lagje. Nisma erdhi nga Sz. Molnár; ishte ai që më dha urdhërat dhe ne themluam organizatën si gjest foshnjarak e jo për qëllime politike. Unë pendohem thellësisht për veprimet e mia, por kërkoj një ndëshkim të butë”.

Si përfundim, më 14 korrik 1953 Gjykata e Lartë Ushtarake nuk i fali Ferenc Bata dhe József Ungár, por ndëshkimet me vdekje të Jenő Hugó Hatvári dhe István Turi u ndryshuan në burgim të përjetshëm.

Gjykata ushtarake nuk e mori parasysh moshën e tyre të re si rrethanë lehtësuese në mënyrë që të miratonte një gjykim më të lehtë se ndëshkimi me vdekje.

Sipas një prej bashkëpunëtorëve të tij, Ungár i përballoi torturat mjaft mirë. Ai nuk u rrëzua në dritën e llampës, për këtë arsye ata e lanë të qëndronte në ujë, ku ai pësoi inflamacion të veshkës dhe fshikëzës urinare. Ai kishte dhimbje të forta gjatë urinimit, por kur doktori e mori vesh që ai ishte dënuar me vdekje, i dha mjekime për më gjatë. József Ungár dhe Ferenc Bata u ekzekutuan në oborrin e burgut ushtarak më 18 gusht 1953. József ishte vetëm 21 vjeç kur vdiq.

Edhe pse përfundoi në burg, Ungár refuzoi të besonte që dikush e kishte tradhtuar organizatën. Ai nuk ishte besimtar më përpara, por iu kthye krishtërimin në burg dhe u bë besimtar.



Vërtetimi i ekzekutimit me varje të Ferenc Bala dhe József Ungár nga kryetari i gjykatës ushtarake.

ARKIVA E MUZEUT TË SHTËPISË SË TERRORIT

Eshtrat e tij nuk janë gjetur por një bust mban gjallë kujtimin e tij në varrezat e Vörösberény. Më 25 maj 2002 u ngrit një statujë në vendlindjen e tij, Balatonalmádi, me një shkrim që thotë: Në kujtim të “vitéz ” József Ungár, 1932 – 1953. *Ekzekutuar nga diktatura komuniste për shkak të pjesëmarrjes në lëvizjen kombëtare të rezistencës. 2002.*

Fotografia e tij mund të gjendet në murin e Muzeumit të Shtëpisë së Terrorit në Budapest, duke i kujtuar kujtdo për guximin dhe vendosmërinë e këtyre djemve të rinj.

KONTRIBUT I FONDACIONIT PUBLIK PËR STUDIMIN E HISTORISË DHE SHOQËRISË SË EUROPËS LINDORE DHE QËNDRORE - MUZEU I SHTËPISË SË TERRORIT

SLLOVENIA

Deri në vitin 1918 pjesa më e madhe e territorit të Sllovenisë së ditëve të sotme, i përkiste provincës Austro – Hungareze të Karniolës. Në tetor 1918 Këshilli Kombëtar Slloven vendosi t'ia bashkojë Slloveninë shtetit Jugosllav. Disa toka sllovene u aneksuan nga Italia.

REGJIMI FASHIST DHE PUSHTIMI NAZIST

Pasi Benito Musolini erdhi në pushtet në Itali në 1922, u ushtrua dhunë kundër pakicës sllovene, në rajonet e Triestes, Gorizia dhe Istria. Forcat e Aksit pushtuan mbretërinë e Jugosllavisë në 6 prill 1941, duke e ndarë territorin slloven midis Gjermanisë, Italisë, Hungarisë dhe shtetit të Kroacisë, themeluar pas shpërbërjes së Jugosllavisë. U formua një lëvizje e fortë çlirimtare partizane komuniste. Që nga 1942, lufta u shtri në një luftë civile midis partizanëve dhe forcave anti-komuniste, duke çuar në masakra të kryera rreth fundit të luftës nga partizanët.

REGJIMI KOMUNIST

Në fundin e Luftës së Dytë Botërore, u vranë pa gjykim afërsisht 130,000 njerëz nga Ushtria Jugosllave e Titos, ku mes tyre ishin edhe rreth 15,000 sllovenë. Shumë prej tyre ishin civilë. Në Slloveni deri tani janë gjetur më shumë se 600 varre massive të fshehura. Pas Luftës së Dytë Botërore Sllovenia u bë pjesë e Jugosllavisë së udhëhequr nga komunistët. Kampet e përqendrimit, polici sekrete politike, përndjekja fetare, internimi i detyruar, kolektivizimi, shtetëzimi, gjykimet teatrale dhe censura ishin pjesë e jetës së përditshme. Zgjedhjet e para të lira në prill 1990 u fituan nga një koalicioni demokratik Demos. Sllovenia u bë e pavarur më 25 qershor 1991.



IVANA VALIČ lindi në 1901 në një familje fermerësh dhe tregtarësh në një fshat të vogël në luginën Vipava, e cila atëherë ishte pjesë e Mbretërisë Austro-Hungareze, Sllovenia e sotme.

VIKTOR VALIČ ishte nga i njëjti fshat me Ivanën dhe ata e

njihnin njëri-tjetrin që në fëmijëri. Ai lindi në një familje të varfër me tetë fëmijë. Studimet për mjekësi të Viktorit u paguan nga babai i Ivanës, vjehri i tij i ardhshëm. Ivana dhe Viktori jetuan disa vite në Jugosllavi para se të largoheshin për në pjesën veriore të Sllovenisë, që ishte e pushtuar nga trupat gjermane në 1941. Pasi provuan italianizimin e

detyruar në rininë e tyre, tani çifti u përball me gjermanizimin. Pas Luftës së Dytë Botërore, erdhi në pushtet Komunizmi. Një natë maji të 1948, Viktori u nis me biçikletë për tu kujdesur për një pacient dhe nuk u kthye më kurrë në shtëpi. Ai u vra nga policia komuniste sekrete. Ivana nuk u martua më kurrë. Ajo vdiq në vitin 1994.



ARKIVA FAMILJARE
E LJUDMILA VALIČ

Ivana dhe Viktor Valič

Një jetë në tre regjime totalitare

shkruar nga Andreja Valič Zver, Ph.D.

Në shekullin e 20, slovenët përjetuan tre regjime totalitare: Fashizmin, Nazizmin dhe Komunizmin. Jeta e Ivana dhe Viktor Valič u prek nga dhuna e të tre regjimeve totalitare.

Ivana lindi në 1901 një një familje fermerësh dhe tregtarësh në një fshat të vogël në luginën Vipara, e cila atëherë ishte pjesë e Perandorisë Austro-Hungareze. Banorët e fshatit në fillim të Luftës së Parë Botërore u zhvendosën në pjesën e brendshme të vendit, për shkak të afërsisë së tyre me frontin Soča. Pas mbarimit të luftës, pjesa perëndimore e territorit të Sllovenisë, u bë pjesë e Italisë në përputhje me vendimin e superfuqive fitimtare.

Lugina Vipava që ishte shtëpia e familjes Valič, pati të njëjtin fat. Për slovenët, kjo ishte periudha e italianizimit, e cila ishte veçanërisht intensive pas ngritjes në pushtet të Musolinit në 1922. Ivana duhet të fliste italisht në shkollë dhe slovenishten duhet ta fliste vetëm në shtëpi dhe në kishë. Shkollat, dokumentat zyrtare, emri dhe mbiemri ishin vetëm italisht dhe gjuha sllovene ishte e ndaluar. Me kalimin e viteve, u intensifikuan forma të ndryshme të dhunës kundër slovenëve.

ITALIANIZIMI

Viktori ishte nga i njëjti fshat me Ivanën dhe ata njiheshin që në fëmijëri. Ai lindi në një familje të varfër me tetë fëmijë, të gjithë ata ishin jashtëzakonisht të talentuar. Fatkeqësisht, ata nuk kishin mundësi të studionin të gjithë. Viktori dhe vëllai i tij France, ishin të vetmit që me ndihmën e fshatarëve, mundën të regjistroheshin në Universitet. Studimet për mjekësi të Viktorit u paguan nga babai i Ivanës, vjehri i tij i ardhshëm, në fillim në Pragë dhe më pas në Graz. Intelektuali i ri, që ishte dëshmitar i tmerreve të frontit Soča, dëshironte të kthehej në luginën e tij të lindjes Vipava. Ai dhe Ivana u dashuruan dhe në 1924 ata u martuan.

Për shkak të presionit nga autoritetet Fashiste italiane, menjëherë pas dasme, ata vendosën të largoheshin nga shtëpia dhe të shkonin në Mbretërinë e Serbisë, Kroacisë dhe Sllovenisë¹. Fillimisht Viktori

¹ Shtet Ballkanik që u riquajt Jugosllavia në 1929 [shënim i botuesve]



Viktor Valič (në fund djathtas), kursi mjekësor në Golnik, 1928.

KOLEKSIONI I ANDREA VALIČ ZVER, PH.D.

u largua në Lubjanë; Ivana me fëmijën e tyre i'u bashkua pas një viti bashkë. Shtëpia e tyre e parë ndodhej në Sodražica në rajonin Dolenjska, dhe më pas Viktori u dërgua si mjek rajonal në Preddvor në rajonin Gorenjska. Ai u konsiderua një element i rrezikshëm nga autoritetet italiane. Viktori ishte me dhimbje i vetëdijshëm nga fakti që nuk do të mund t'i përqafoje kurrë prindërit, të takonte motrat dhe vëllezërit dhe të shëtiste në vreshtat dhe livadhet e fshatit të tij të lindjes. Frika e tij u realizua pjesërisht. Herën tjetër që u kthye në shtëpi, ishte gjashtë vjet më vonë kur nëna e tij vdiq.

Ivana dhe Viktori ndërtuan një shtëpi në rajonin Gorenjska për ta dhe katër fëmijët e tyre. Viktori kishte një fizik të dobët dhe të vogël, por të fort. Në rininë e tij, ai ishte një vrapues i mirë dhe e ruajti shkathtësinë fizike. Ai ishte i dhënë pas sportit, kështu që ishte pjesë aktive e e jetës sportive në Preddov. Viktori ishte anëtar i shoqatës së qitjes dhe ndonjëherë për çlodhje shkonte në fshat për qitje. Ai iu fut skive dhe të katër djemtë e tij ndoqën shembullin e tij. Shëtitjet në natyrë për të ishin çlodhëse, por ai asnjëherë nuk shkoi larg, pasi ishte gjithnjë i vetëdijshëm për faktin se një pacient mund të kishte nevojë për ndihmën e tij në çdo kohë. Ai e shijonte shumë punën e tij. I pëlqente të pranonte njerëz gjatë operacioneve që kryente dhe nuk e kishte kurrë të vështirë të kalonte një pjesë të mirë të kohës për vizita te pacientët e shumtë që kishin nevojë për të. Shoqëruesi i tij besnik gjatë këtyre vizatave ishte një biçikletë me frena dore.

Pak para Luftës së Dytë Botërore, ai i përdori kursimet e tij për të blerë një motorçikletë, që do t'i lehtësonte ndjeshëm vizitat në shtëpitë e pacientëve të tij. Ai, megjithatë, nuk pati shumë fat me motorçikletën. Në fillim të luftës, mjeti u konfiskua nga një korrier ushtarak i ushtrisë Jugosllave, i cili ia shkatërrojë atë që në udhëtimin e parë. Viktori mbeti pa motorçikletë dhe vazhdoi prap me mënyrën e tij të vjetër, të njohur – në këmbë, me biçikletë ose karrocë me kuaj² në rrugët ose shtigjet me çakëll gjithë pluhur ose me slitë në dimrin e ftohtë dhe në dëborën e thellë.

Kur Gjermania sulmoi Jugosllavinë në 1941, Viktori u mobilizua në ushtrinë Jugosllave, ku mbajti gradën rreshter. Ai ishte i inatosur me autoritetet e ushtrisë për shqiptimin gabim të emrit të tij (duke e shkruar me “č” të butë me një shenjë të gabuar dalluese). Shpërbërja e shpejtë e Jugosllavisë në prill e

² Karrocë me kuaj

gjete atë në Ratitovec, nga ku ai iku në Lubjanë. I veshur me rroba civile, i mbrojtur nga nata dhe në ajër pasigurie të madhe dhe frike, ai u kthye në shtëpi në këmbë.

GJERMANIZIMI

Në 1941 rajoni Gorenjska u pushtua nga gjermanët. Skena e shtëpisë së tij në luginën Vipava u përsëritën edhe një herë. Ivana, Viktori dhe katër djemtë e tyre duhet të flisnin gjermanisht në publik, emrat dhe mbiemri i tyre u gjermanizuan, gazetatat dhe librat po botoheshin vetëm gjermanisht dhe fëmijët në shkolla ndëshkoheshin nëse shqiptonin një fjalë të vetme sllovenisht. Çdo lëvizje e fshatarëve ishte e rrezikshme, nën mbikqyrjen të rreptë dhe e ndaluar gjatë orëve të shtetërrethimit.

Si mjek, Viktori u lejua nga autoritetet pushtuese të merrte pjesë në urgjencat mjekësore të pacientëve edhe ndërmjet orës shtatë të mbrëmjes dhe shtatë të mëngjesit, kur banorët e tjerë duhet të mbikqyreshin në shtetërrethim. Rreziqet që kishin vizitat e tij tek pacientët u shoqëruan nga frika. Çdo vizitë do të thoshte përplasje me vdekjen; çdo veprim i “doktorit” ishte nën mbikqyrje të rreptë. Përveç kësaj, autoritetet pushtuese gjermane kishin vendosur një mësues gjerman në shtëpinë e tyre, e cila shërbente gjithashtu edhe si sallë operacioni. Djali i madh u mobilizua në Ushtrinë Gjermane dhe u dërgua me shërbim në Francë, ndërsa dy djemve më të vegjël iu desh të vazhdonin shkollimin në një gjimnaz në Klagenfurt. Në mes të tërbimit të luftës, familja u nda dhe u desh të përballej me sprovat e vështira. Njerëzit i mbuloi frika, jo vetëm për veten e tyre, por edhe për të dashurit e tyre.

Dhuna gjermane nxiti rezistencë. Trupat e çetës Kokrica gjendeshin shpesh në periferi të Preddvor, ndërsa informatorët dhe korrierët partizanë ishin përreth vendbanimeve të Mače dhe Bašelj. Ndodhë disa përplasje midis gjermanëve dhe forcave të rezistencës, si djegia e fshatrave dhe shtëpive, pushkatimet e pengjeve dhe ekzekutime të fshehta të njerëzve gjatë natës për gjoja tradhti. Frika pllakosi jetën e të gjithëve.

Në 1943 Viktori mori një telefonatë nga çeta Kokrica për mobilizimin e tij në forcat partizane. Ai vendosi të mos largohej për në mal, por qëndroi me pacientët e tij, dhe në përputhje me Betimin e Hipokratit, ndihmoi të gjithë ata që kishin nevojë. Ka mundësi që vendimi i tij për të mos i'u përgjigjur mobilizimit partizan vulosi fatin e tij. Ai vazhdoi me kryerjen e detyrave të mjekut të tij si në kirurgji dhe në terren, ndërsa ndiqte rregullisht raportet e Radio Klagenfurt për ngjarjet në fushat e betejës në



Viktor Valič

KOLEKSIONI I ANDREA VALIČ ZVER, PH.D.

botë dhe duke heshtur para familjes së tij, sidomos fëmijëve për pacientët e tij, gjermanë, partizanë dhe të gjithë të tjerët. Çdo fjalë e thënë mund të nënkuptonte një vendim midis jetës dhe vdekjes.

Pas përfundimit të luftës, ai vazhdoi punën e tij. Ai ndihmoi njerëzit që ende kishin nevojë për ndihmën dhe këshillën e tij mjekësore, receta, injeksione, fasho, ndihmë gjatë lindjeve dhe sëmundjeve të fëmijërisë, certifikatat e vdekjes dhe herë pas here ai ishte thjesht një dëgjues dashamirës ndaj problemeve të tyre të përditshme. Infektimet me zgjebe, skuqje lëkure dhe morrat u shfaqën përveç sëmundjeve të cilat ishin të përhapura dhe vdekjeprurëse para luftës, veçanërisht tuberkulozi. Ai trajtoi partizanët invalidë, të cilët jetonin në Danica Villa dhe fëmijë jetimë nga Bosnja që jetonin në kështjellën pranë kishës. Si mjek ai udhëhoqi kurset e ndihmës së shpejtë në Preddvor dhe në Jezersko. Ai mbrojti dhe promovoi ndërtimin e sistemit të furnizimit me ujë në Preddvor, dhe përdorimin e këtij uji për pirje dhe higjienë personale, pasi ai e dinte mirë se ndodhnin infeksionet të shumta për shkak të ujit të papastër nga përrrenjtë dhe pusët.

KALIMI NGA NJË REGJIM TOTALITARIZMI NË NJË TJETËR

Autoritete Naziste u zëvendësuan nga ato Komuniste, me një formë të totalitarizmit që zë vendin e tjetrit. Në vitet pas luftës mijëra Sllovenë (burra, gra dhe fëmijë) u burgosën dhe u vranë në pyje, hendekët dhe gropat e minave, thjesht sepse autoritetet e reja komuniste kishin frikë se mund të rrezikonin sundimin e tyre. Territori slloven u bë fusha e vdekjes.

Një natë maji të vitit 1948, si shumë herë më parë, Viktori u thirr për të shkuar te një pacient i supozuar. Ai shkoi në errësirë me biçikletën e tij, së bashku me çantën e tij prej lëkure ngjyrë kafe që mbante pajisjet e ndihmës së shpejtë. Ai nuk u kthye më në shtëpi. Ai u gjet i vdekur, me kafkë të copëtuar, i shtrirë buzë rrugës nën male. Në errësirën e natës, vendasit dëgjuan thirrjet e tij të largëta për ndihmë, por ata nuk e dinin nga vinin. Kohët ishin të egra, dhe të dije shumë ose të bëje shumë pyetje ishte potencialisht fatale ... Shkaku zyrtar i vdekjes përmendi një aksident të lidhur me punën, edhe pse vendasit që jetojnë nën male mund të dëshmojnë deri më sot faktin se dy anëtarë të OZNA kryen një veprim hakmarrës dhe e goditën për vdekje "dokun". Ivana mbeti vetëm me katër fëmijë. Ajo pranoi versionin



Familja Valič, Preddvor, pranverë 1944.

ARKIVA E FAMILJES LJUDMILLA VALIČ

zyrtar të historisë, pasi të bënte ndryshe do të kishte rrezikuar jetën e saj dhe të fëmijëve të saj. Ajo nuk u rimartua më deri në vdekjen e saj në vitin 1994, ajo çmoi kujtimin e Viktorit, dashurinë e jetës së saj. Kujtimi i "gjyshit" jetoi në fotografi, në histori dhe në kujdesin ndaj varrit dhe pllakës përkujtimore në vendin e ngjarjes tragjike ... Shkaku i vërtetë i vdekjes së Viktorit nuk u diskutua kurrë. Kush e di se çfarë mund të ndodhë me këdo që do të përpiqet të hulumtojë prapaskenën dhe të vërtetën e kësaj historie të errët, e cila gradualisht u zbulua në të gjitha dimensionet e saj vetëm pasi Sllovenia arriti pavarësinë e saj në fillim të viteve 1990.

□ Autori botoi një artikull mbi jetën dhe veprën e Dr. Viktor Valič në koleksionin e punimeve në Preddvor (Dr. Viktor Valič: Jeta dhe Puna e një Mjeku të Vendit, në: Preddvor në kohë dhe hapësirë, redaktuar nga Tone Roblek, Preddvor 1999, f. 357–361). Të dhënat për jetën e tij ruhen në arkivin familjar, ndërsa kopjet e dëshmimeve gojore për vdekjen e tij tragjike mbahen nga SCNR (Qendra e Studimit për Pajtimin Kombëtar).

KONTRIBUT I QENDRËS SË STUDIMEVE PËR PAJTIMIN KOMBËTAR

JOŽE PUČNIK lindi në 9 mars 1932 në një familje fermerësh në fshatin Črešnjevca pranë Slovenska Bistrica. Ishin vitet e shkollës së mesme kur ai fillimisht u ndesh me mungesën e cilësisë demokratike të regjimit Jugosllav të pasluftës. Së bashku me dy shokë të tij të klasës, Pučnik themeloi një grup që diskutoi për revolucionin francez dhe të drejtat e njeriut. Pas përfundimit të shërbimit ushtarak ai studioi Filozofi dhe Letërsi Krahasuese në Fakultetin e Arteve të Lubjanës. Pučnik ishte një kritik i hapur i regjimit komunist të Josip Broz Titos. Ai u burgos për shtatë vite dhe më pas u detyrua të emigronte. Ai u kthye në Slloveni në fund të viteve 1980 dhe u bë Udhëheqësi i Opozitës Demokratike të Sllovenisë, e cila mundi komunistët në zgjedhjet e para të lira në vitin 1990. Ai vdiq në janar të vitit 2003.



ARKIVA FAMILJARE E MAG.
MAJDA PUČNIK RUDL

Jože Pučnik

Historia e një disidenti

shkruar nga Andreja Valič Zver, Ph.D.

Dr. Jože Pučnik është disidenti politik sloven më i njohur i pasluftës. Ai e përballoi përndjekjen me një forcë të jashtëzakonshme dhe kontribuoi vendosmërisht në aktin më të rëndësishëm në historinë politike Slovene – arritjen e pavarësisë.

NJË MENDIMTAR I LIRË QË NË VITET E SHKOLLËS SË MESME

Pučnik lindi në 9 mars 1932 në një familje fermerësh në fshatin Črešnjevca afër Slovenska Bistrice. Që në fëmijëri, ai dëgjoi për shtetëzimet në fshat, për "likuidimet", mizoritë, veprimet e presionit. Ishte në vitet e shkollës së mesme kur u ndesh për herë të parë me mungesën e cilësive demokratike të regjimit jugosllav të pasluftës. Së bashku me dy shokë të tij të klasës, Pučnik themeloi një grup që diskutoi për revolucionin francez dhe të drejtat e njeriut. Informatorët në klasë njoftuan autoritetet në Maribor dhe ajo që pasoi ishte përpjekja e parë për ta përjashtuar nga shkolla. Pučnik e kundërshtoi atë dhe protestoi duke dhënë dorëheqjen nga organizata rinore, ndërsa ai vazhdoi të ndiqte shkollën. Në fillim të viteve 1950, ai dhe shokët e tij të klasës filluan publikimin e botimit të paligjshëm *Iskanja* (Kërkimet). Pučnik tha që «*vetëm disa, ndoshta pesë numra u botuan. Kishte kopertinë të zezë, ndërsa Iskanja ishte shkruar mbi të me shkronja të bardha. Rreth 10 ose 12 veta veta nga ne merrnin pjesë në këtë botim. Botimi nuk ishte regjistruar dhe ne e shpërndam atë në fshehtësi. Kishte rreth 20 deri në 30 faqe dhe ishte shtypur nga disa vajza. Ne botuam me pseudonime. Ishte kryesisht një artikull letrar, por me një ndjesi politike*». Pučnik kontribuoi në artikullin hyrës për numrin e parë të *Iskanja*, njëllon programi, të cilin ai vetë e përshkroi si pjesërisht kundërshtar dhe natyrisht edhe pak romantik. *"Me sa mbaj mend, kam shkruar se kufijtë ishin të mbyllur, se të gjithë ishim të rrethuar me tela me gjemba dhe gjëra të tilla,"* tha ai.

Për shkak të dëgjimit të informacionit në lidhje me përjashtimin e tij në pritje nga shkolla, Pučnik vendosi të tërhiqej vetë. Vetëm në këtë mënyrë ai do ishte në gjendje t'i nënshtrohej provimit për gjithë vitin e tetë të shkollës së mesme dhe ai e kaloi atë edhe pse disa ditë më parë ai u ndalua në degën Maribor të UDBA-s dhe u dërgua në një burg gjyqësor për t'u marrë në pyetje. Pas një dite të tërë në pyetje, gjatë së cilës ai u akuzua për prishjen e socializmit, u krye një kontroll i shtëpisë së tij në Črešnjevca. Pak para provimit të tij të diplomimit, Pučnik u ndalua nga asambleja e mësuesve të merrte pjesë në provim për një vit. Ai u

ankua në Ministrinë e Arsimit me arsyetimin se nuk ishte më një nxënës i shkollës, por një student privat që ndiqte provimin në mënyrë të pavarur. Përrjashtimi i tij nga shkolla u zgjat për katër vjet. Pučnik ishte shumë i mërzhitur nga ky vendim. Ai vendosi të hynte në shërbim ushtarak dhe u lejua të merrte pjesë në provimin e diplomës vetëm pas përfundimit të shërbimit të tij.

Ai studioi Filozofi dhe Letërsi Krahasuese në Fakultetin e Arteve të Lubjanës. Kolegët e tij me të cilët ai kaloi vitet e studimit ishin intelektualët e shquar sllovenë Janko Kos, Taras Kermauner, Veljko Rus dhe Juš Kozak dhe shkrimtarët Venko Taufer, Dane Zajc dhe Dominik Smole. Pučnik u bë aktiv në organizatën studentore dhe ai gjithashtu shkroi artikuj për botimin *Naši razgledi*³. Çështja kryesore e artikujve të tij të hershëm ishte çështja e lirisë së njeriut, në lidhje me të cilën ai arriti në përfundimin se dikush duhet "të ushtrojë lirinë", domethënë, të përpiqet në mënyrë aktive për ta arritur atë. Ishte ky koncept aktiv i ushtrimit të lirisë i cili, sipas mendimit të tij, bëri më vonë që ai të përfundonte në burg.

Pas diplomimit në vitin 1958, Pučnik u punësua si asistent në departamentin e filozofisë. Dukej se ky intelektual i ri i zgjuar po kërkonte një karrierë të suksesshme. Sidoqoftë, gjërat morën kthesë tjetër. Artikujt e Pučnik, veçanërisht njëri në botimin *Revija 57*⁴ me titull *Realiteti Ynë Shoqëror dhe Iluzionet Tona*, në të cilin ai vlerësoi në mënyrë kritike situatën shoqërore, çuan në arrestimin e tij në vjeshtën e të njëjtit vit.

Pučnik punoi mbi artikullin *Realiteti Ynë Shoqëror dhe Iluzionet Tona* në verën e vitit 1958. Ai trajtoi një çështje të ndjeshme, domethënë mospërputhjen midis ideologjisë sunduese dhe realitetit. Artikulli u shkrua mbi bazën e një artikulli mbi Partinë që Pučnik kishte shkruar për botimin *Naši razgledi*. Ai tërhoqi vëmendjen për hendekun midis njerëzve dhe autoriteteve dhe për rritjen e mosbesimit që autoritetet kishin ndaj njerëzve. Pučnik dëshironte të botonte artikullin tek botimet *Revija 57*; gjë e cila çoi në një mosmarrëveshje të madhe midis anëtarëve të bordit të redaksisë, por shumica e tyre votuan në favor të botimit. Pučnik ishte shumë i sinqertë gjatë këtyre diskutimeve të nxehta dhe vetëm shumë vite më vonë ai mësoi se UDBA kishte përgjuar konfliktet e tyre, ndërsa një anëtar i shquar i Partisë, Miha Marinko, thuhet se tha që botimi duhej zhdukur. Komiteti universitar i Lidhjes së Komunistëve parandaloi botimin e artikullit të lartpërmendur.

AKTIVITETI POLITIK, ARRESTIMI DHE BURGOSJA

Jože Pučnik u bë politikisht aktiv në të njëjtin vit. Në 8 janar 1958, ai u bashkua me Lidhjen e Komunistëve, pasi besonte se sistemi mund të ndryshohej nga brenda. Megjithatë, Pučnik me zgjuarsin vuri re faktin që organizata studentore ishte një mjet i thjeshtë në duart e Partisë dhe anëtarëve të saj "studentëve më të këqinj". Përpjekja e tij për të vepruar nga brenda strukturave, u përmbys shpejt. Pučnik nuk ishte një

³ Do të thotë "Pikëpamjet tona" [shënim i botuesve]

⁴ Do të thotë "Rishikimi 57" [shënim i botuesve]

njeri që thjesht shkonte së bashku me rrjedhën e ngjarjeve; ai ishte nga natyra një njeri që transformonte gjërat. Kështu që shpejt besimi i tij se do të ishte në gjendje të ndryshonte gjërat nga brenda, se do të ishte në gjendje të kryente një "marshim nëpër institucione", u ndesh me kufizimet e vendosura nga sistemi.

Në vjeshtën e 1958, Pučnik ishte subjekti tematik i forumeve të ndryshme politike dhe, menjëherë më pas, nga organet ligj zbatuese. Në fund të tetorit 1958, ai u ndalua dhe në muajt në vijim iu nënshtrua marrjeve në pyetje intensive në burgun e Lubjanës. Në të njëjtin vit u përjashtua në mungesë nga Lidhja e Komunistëve. Në takimin e jashtëzakonshëm të Partisë, dy anëtarë të UDBA thuhet se informuan pjesëmarrësit se Administrata e Sigurimit të Shtetit kishte zbuluar lidhjet e Pučnikut me emigracionin. Hetuesi i tij bëri një shënim zyrtar mbi këtë çështje, duke deklaruar se qëndrimi i Pučnik kur mori lajmin e dëbimit të tij ishte një sarkazëm.

Në mars 1959 gjykata e rrethit të Ljublanës e dënoi Pučnik me nëntë vite burg të ashpër. Pučnik pretendohet se u përpoq të gjente një grup njerëzish qëllimi i të cilëve ishte të minonin fuqinë e njerëzve punëtorë. Ai gjoja kishte kurdisur komplotin e krijimit të troikas⁵ për të kryer akte sabotimi dhe gjithashtu se kisht përhapur propagandë armiqësore me shkrim kundër shtetit dhe rendit shoqëror. Në lidhje me këtë, aktakuza së pari përmendi artikullin *Realiteti Ynë Shoqëror* dhe *Iluzionet Tona*. Pučnik sigurisht që nuk i pranoi kurrë akuza të tilla absurde.

Pas vendimit, Pučnik u vendos në burgun Maribor nga ku bashkë me një tjetër të burgosur u përpoqën të arratiseshin vetëm pas një muaji. Shoku i tij u kap në arrati, ndërsa Pučnik, i tmerruar nga brutaliteti me të cilin rojet trajtuan shokun e tij të pafat, u dorëzua. Në një intervistë në fillim të viteve 1990, tha se atëherë ishte *"rrahur barbarisht dhe tërhequr zvarrë. Kalova një muaj në bunker. Çdo natë, vinin të më rrihnin"*. Në muajt dhe vitet që pasuan ai u dhunua rëndë në burg: ndalimi i të shkruarit, rrahja gjatë natës, privimi i gjumit, nëntë muaj në një qeli të veçuar betoni. Atij i'u lejua të bënte vetëm një vizitë në shtëpi pasi nëna e tij u sëmurë rëndë. Me rastin e amnistisë së përgjithshme në 1961, dënimi i tij u shkurtua në shtatë vjet, ndërsa ai u la i lirë me kusht pas pesë vjetësh në 1963.

Pavarësisht nga lirimi me kusht, Pučnik dëshironte të kthehej në aktivitetet e tij intelektuale dhe punën botuese. Ai u kthye në Lubjanë dhe botoi një disertacion *Mbi Dilemat e Bujqësisë Sonë*. Dukej se pati një puhizë liberalizimi të kufizuar, megjithëse Pučnik mbeti skeptik ndaj saj.

Në pjesën hyrëse, Pučnik theksoi se bujqësia nuk ishte një

⁵ Grupet e tre aktivistëve



Jože Pučnik, Ljubljana, shkurt 1989 (kongresi i themelimit të Shoqërisë Social Demokratë të Sllovenisë).

ARKIVA E FAMILJESË SË MAG. MAJDA PUČNIK RUDL

problem ekonomik, por që metoda revolucionare e kishte shndërruar atë në një problem ideologjik, politik dhe shoqëror. U tha se kolektivizimi "i detyrueshëm" kishte shkaktuar dëme të mëdha. Pučnik kritikoi "aktivistët e pamëshirshëm të fushës" të cilët dhunuan fermerët. Botimi u shit shpejt dhe u pasqyrua edhe në media. Për shkak të rečensionit të një filmi në 1964 ai u arrestua edhe një herë dhe u akuzua për propagandë armiqësore. Artikulli me titull *Mbi Metodat dhe Perspektivat e Veprimit Shoqëror* çoi në arrestimin dhe dënimin e tij, për rrjedhojë ai nuk arriti ta botoj atë. Lirimi me kusht iu anulua dhe u burgos përsëri; kësaj here në burgun Dob. Ai kaloi njëzet muaj në izolim.



Jože Pučnik në shtëpinë e tij në Verje, verë 2002.

ARKIVA E FAMILJESË SË MAG. MAJDA PUČNIK RUDL

EMIGRIMI NË GJERMANI

Kur u lirua pas dy viteve burg, ai kërkoi një punë, por pa sukses. Ndjehej i përjashtuar, i mashtruar dhe i vetmuar dhe ikja jashtë ishte mundësia e vetme e mbetur në atë kohë. Pasi emigroi në Republikën Federale të Gjermanisë, u vendos në Hamburg, ku jetoi si punëtor ndihmës në uzinën e zinkut dhe në port. Kur vendosi të regjistrohej në studimet pasuniversitare, Universiteti i Ljubjanës refuzoi t'i lëshonte certifikatën e diplomimit. Pa kopjen e diplomës së tij universitare, ai nuk mund të regjistrohej në studime pasuniversitare, për këtë arsye ai u regjistrua në studime me kohë të pjesshme në Universitetin e Hamburgut, ku studioi Sociologji, Filozofi dhe Pedagogji dhe përfundoi studimet e tij në 1971 me një Ph. D. Ai fitoi pozicionin e asistent profesorit të sociologjisë në Universitetin e Lüneburg, nga ku doli në pension si këshilltar i lartë akademik në 1989.

Në gjysmën e dytë të viteve 1980, Pučnik u bashkua edhe një herë në mënyrë aktive në politikë. Së pari si botues dhe pastaj gjithnjë e më shumë si politikan. Guximi, vendosmëria dhe aftësia e tij analitike patën një ndikim shumë të rëndësishëm në procesin e demokratizimit dhe arritjen e pavarësisë në Slloveni.

KTHIMI NË SHTËPI DHE PUNA POLITIKE

Vitet liberale 1980, të lidhura me botimin *Nova Revija*⁶, e ftuan atë në shtëpi. Ishte koha kur sistemi i vjetër po thërrmohej, ndërsa publiku i ri që po shfaqej kërkonte përgjigje të reja. Shoqëria civile sllovene

⁶ Meaning "New Review" [editor's note]

po lindte. Arrestimi i Janez Janša dhe i kolegëve të tij shkaktoi një lëvizje masive për të drejtat dhe liritë njerëzore. Organizatat politike alternative po themeloheshin. Pučnik u bashkua me Shoqatën Social Demokrate të Sllovenisë, të cilën ai e udhëhoqi që nga 1989 e më pas. Ai ishte një nga bashkëthemeluesit e lëvizjes shumë-partiake Demos, dhe gjithashtu e udhëhoqi atë si një autoritet i padiskutueshëm i opozitës. Demos fitoi zgjedhjet e para demokratike në prill 1990 dhe kreu një rol historik - ai zbatoi demokracinë formale dhe në vitin 1991 arriti pavarësinë për Slloveninë.

Pučnik nuk ishte nga ta që kërkonin mënyra të lehta; ai eci nëpër shtigje të thepisura, në rrugë të pashkelura, plot me ferra dhe shkëmbinj. Kjo është arsyeja pse pikëpamja e tij ishte më e thellë dhe më largpamëse, dhe gjykimet, vendimet dhe veprimet e tij kishin shumë peshë. Kur e dorëzoi udhëheqjen e partisë të Janša në 1993, ai iu përkushtua komisionit parlamentar që hetonte vrasjet e pasluftës. Ai përpiloi një raport, i cili përfaqëson një themel të shkëlqyeshëm për kërkimin e pajtimit me Sllovenët. Joachim Gauck, me të cilin Pučnik bashkëpunoi, ja kaloi më qetë në Berlin, ku pati pëlqim në masë për nevojën e shkatërrimit të strukturave totalitare dhe korrigjimin e padrejtësive. Në Slloveni, nuk ka një pëlqim të tillë.

Pučnik kurrë nuk foli shumë për tmerret që përjetoi në burg. Sidoqoftë, ai shkroi: *“Kuptimi që jetuam në një sistem totalitar çnjerëzor më ndihmon t’u jap disa kuptime të gjitha përvojave që kam duruar. Komunistët nuk e respektuan kurrë të drejtën themelore për paprekshmërinë e jetës dhe lirisë. Regjimi i tyre ishte thjesht një regjim totalitar, ashtu si Fashizmi Italian dhe Nazizmi i Hitlerit”*.

KONTRIBUT I QENDRËS SË STUDIMEVE PËR PAJTIMIN KOMBËTAR

RUMANIA

REGJIMI PRO-NAZIST

Rumania nga 1938-1940 ishte diktaturë nën sundimin e Mbretit Carol II, i cili hoqi dorë në favor të djalit të tij Michael i I-rë dhe gjatë viteve 1940-1944 nën sundimin e Kryeministrit Ion Antonescu. Protokolli sekret i paktit Molotov-Ribbentrop i vitit 1939 përcaktoi një interes sovjetik për Bessarabia Rumune, e aneksuar nga sovjetikët në 1940. Rumania u bashkua me Aksin në vitin 1940 dhe luftoi kundër Bashkimit Sovjetik në Frontin Lindor, duke pushtuar rajonet e Moldavisë dhe Odesës. Popullsia hebreje në rajonet e pushtuara nga Rumania i'u nënshtrua vrasjeve dhe dëbimeve, megjithatë shumica e hebrevje rumunë i mbijetuan Luftës së Dytë Botërore. Antonescu u arrestua nga mbreti Michael i I-rë më 23 gusht 1944, disa ditë para se trupat sovjetike të hynin në Bukuresht.

REGJIMI KOMUNIST

Më 6 mars 1945, komunisti Petru Groza u emërua Kryeministër me mbështetjen sovjetike. Në 1946, Komunistët falsifikuan zgjedhjet dhe formuan qeverinë. Në 1947, të gjitha partitë politike të tjera u shpërbënë, mbreti Michael i I-rë u detyrua të hiqte dorë dhe, në 1948, kushtetuta rumune përcaktoi që partia komuniste ishte e vetmja forcë politike në shoqërinë rumune. Komunizmi në Rumani u shënua nga shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe egërsia e sigurimsave (policia sekrete). Regjimi u shemb me dhunë në Revolucionin Rumun të dhjetorit 1989. Diktatori i fundit komunist, Nikola Çauçesklu, u gjykua nga gjykatë ushtarake dhe u ekzekutua.



ARISTINA POP lindi në maj 1931 në tokën Lăpuș, Rumania veri-perëndimore. Ajo ishte vajza e pylltarit Nikolae Pop – udhëheqësi i një grupi të rezistencës anti-Komuniste në Rumani – dhe e Maria Pop. Babai i saj shpëtoi një numër fëmijësh hebrenj nga dëbua për në Auschëitz gjatë pushtimit hungarez në 1940-1945. Pas luftës, në 1948, për shkak se ai kishte fshehur të arratisurit anti-komunist, Nikola u detyrua të ikte dhe fshihej në malet Țibleș. Ai mori me vete Aristinën e vogël dhe vëllain e saj Achim. Pjesa tjetër e familjes u dëbua në stepat e Rumanisë jugore. Pas katër vitesh drejtimi të operacioneve të rezistencës nga malet, Nikolai u ekzekutua pa gjyq. Aristina u burgos për 11 vite, deri në faljen e përgjithshme të vitit 1964. Ajo jeton aktualisht në Bukuresht.



ARKIVA E QENDRËS
NDËRKOMBËTARE
PËR STUDIMET
MBI KOMUNIZMIN,
PËRKUJTIMORJA
E VIKTIMAVE TË
KOMUNIZMIT DHE
TË REZISTENCËS
ANTI-KOMUNISTE.

Aristina Pop Săileanu

Një karusel terrori

shkruar nga Romulus Rusan

Në një shtëpi në qendër të Bukureshtit, fshehur larg në fund të kopshtit me perime dhe fruta, jetonte një zonjë me një biografi të bujshme. Historia që e formoi atë gjithashtu e pengoi atë të tregonte historinë e saj së fundmi.

Babai i saj, një pylltar i famshëm nga tokat Lăpuș (rajon i Rumanisë veri-perëndimore), shpëtoi një numër fëmijësh hebrej nga dëbimi në Auschwitz gjatë pushtimit hungarez në vitet 1940-45 dhe është listuar nga Përkujtimorja Yad Vashem në Jeruzalem si një nga të Drejtët midis Kombeve. Por pas luftës, në vitin 1948, për shkak se ai kishte fshehur të arraturit antikomunistë në kantonin (vendstrehimin) e tij, ai vetë u detyrua të ikë në malet Țibleș, duke u kërcënuar me arrestim pasi refuzoi propozimin e sigurimsave që të bëhej informator. Ai mori me vete dy nga fëmijët e tij. Vajza ishte shtatëmbëdhjetë dhe kishte emrin mitologjik Aristina. Djali, Akimi, ishte katër vjet më i madh. Pas largimit të tyre, anëtarët e tjerë të familjes - gruaja, fëmijët e tjerë dhe shumë të afërm të tjerë ose të afërt më të largët - u dëbuan në stepat e Rumanisë jugore.

Në vitin 1953, pasi udhëhoqi grupin e rezistencës Țibleș (shih kutinë e informacionit) për katër vjet, i sëmuri rëndë Nicolae Pop kërkoi që ta zbrisnin nga malet, në mënyrë që të mos ishte pengesë për bashkëluftëtarët e tij dhe për të liruar të afërmit e persekutuar. Sigurimsat e gjetën por nuk pritën që sëmundja t'i merrte jetën: ata e ekzekutuan pa gjyq. Pak më vonë, ata në male ose u pushkatuan ose u kapën dhe u dënuan: Achim u dënuua me njëzetë e dy vjet dhe Aristina Pop me njëzetë vjet burg. Aristina kaloi njëmbëdhjetë vjet në burg deri në amnistinë e përgjithshme të 1964, e sëmure rëndë, por e mbrojtur nga miqësia e bashkëvuajtësve të saj, midis të cilëve ajo ishte gjithmonë më e reja

Aristina Pop ka përjetuar vuajtjet më të tmerrshme, por gjithmonë



Familja e Aristina Pop (majtas-djathtas):prapa - Gheorghe Bendrea (kunati), Ion Pop (vëllai), në mes - Elena Bendrea (motra), Mariuca Pop (nëna), Cornelia Pop (kunata), përpara - Viorel Bendrea (nipi), Nicolae Pop (vëllai).

ARKIVA E QENDRËS NDËRKOMBËTARE PËR STUDIMET MBI KOMUNIZMIN, PËRKUJTIMORJA E VIKTIVAVE TË KOMUNIZMIT DHE TË REZISTENCËS ANTI-KOMUNISTE.



Aristina Pop, fotografi nga arrestimi i saj në 1953.

ARKIVA E QENDRËS NDËRKOMBËTARE PËR STUDIMET MBI KOMUNIZMIN, PËRKUJTIMORJA E VIKTIVAVE TË KOMUNIZMIT DHE TË REZISTENCËS ANTI-KOMUNISTE.

Pas lirimit të saj nga burgu, sigurimsat u përpoqën ta përdorë, por ajo u kërkon që më mirë ta dërgojnë sërish pas hekurave. Ajo u martua “me shikim të parë” me një djalë të ri, Nicolae Săileanu, i cili kishte qenë në të njëjtin burg dhe kishte rënë në dashuri me të pa e ditur se si dukej, thjesht pasi kishte dëgjuar historinë e saj. Ajo ka të njëjtin fat të mirë me vjehërit e saj, në shtëpinë e të cilëve zhvendoset, por dhe në punë, ku u punësua "pa autobiografi". Ajo u zhduk në qytetin e Bukureshtit të mbushur plot, me kujdes, por pa komplekse.

NË KOHË TERRORI, NË KOHË LIRIE

Si arrin një person i tillë ta bënte veten të dashur në një botë urrejtjeje dhe lufte klasash? Sekret i padyshim qëndron në aftësinë e natyrshme se si të mbetesh normal në një botë jo normale.

Përveç këtyre të dhënave psikologjike, Aristina Pop është gjithashtu një dëshmitare dhe rrëfimtare e jashtëzakonshme.



Ish të burgosurit politikë që vizitojnë ish burgun politik Miercurea Ciuc, 1991.

ARKIVA E QENDRËS NDËRKOMBËTARE PËR STUDIMET MBI KOMUNIZMIN, PËRKUJTIMORJA E VIKTIVAVE TË KOMUNIZMIT DHE TË REZISTENCËS ANTI-KOMUNISTE.

gjeti një dorë për t'a mbrojtur. Ajo është person që mundet ta bëjë veten të dashur pikërisht sepse është e paaftë të urrej. Ajo i çarmatosi hetuesit me zgjuarsinë e saj, rojet femra me faktin se është aq e re sa të ishte vajza e tyre, mjekët me vetëmohimin e rinisë së saj. Megjithëse jeton në mesin e grave të sëmura dhe dëshmon vdekjen e shumë prej tyre pranë saj, nuk e humbi kurrë besimin, nuk pranon të heq dorë, vazhdon të shpresojë. Intelktualët, gratë fshatare, murgeshat dhe zonjat e shoqërisë së lartë formojnë një botë ideale, një komunitet mbështetës të vuajtjeve fisnikëuese.

Rrëfimi i saj është i thjeshtë, i qartë dhe ndriçues. Njerëzit e shumtë me të cilët ka jetuar - në male, në burg, dhe në jetën private pas lirimit të saj – portretizohen me anë të një tipari të vetëm, të një gjesti apo një ngjarje biografike, dhe gjithmonë përshkruhen me veçorinë e tyre më të hijshme. Një mirësi që nuk është ajo e vargjeve idilike të krijuara aty për aty, por ajo ekzistenciale që pluskon mbi fatkeqësitë e botës, një lloj "shenjtërie" në gjendjen e sakrificës dhe vuajtjes.

Dëshmitë e saj, si dokumentet, rriten në mënyrë të papritur numrin e atyre që i rezistuan komunizmit dhe atyre që mbushën burgjet. Përtej horizontit vetvetiu të ngushtë në guvat e fshehta nëpër male ose burgje ekzistojnë dhjetëra, qindra njerëz, pas të cilëve qëndrojnë mijëra e mijëra të tjerë, një mori njerëzish të besueshëm, të cilët vuajnë në

heshtje dhe janë të gatshëm t'ju ndihmojnë. Shumë më tepër atëherë, në kohë terrori, sesa sot, në kohë lirie.

RATËSI DHE SURPRIZA

Rastësitë dhe surprizat janë mahnitëse. Ndonjëherë ndodhte që disa anëtarë nga e njëjta familje mbaheshin në të njëjtin burg pa ditur për praninë e njëri-tjetrit aty. Një e burgosur e sheh motrën e saj të rrahur egërsisht nga Securitate, por nuk e njeh atë për shkak të plagëve që e kanë shpërftyruar. Një baba tek të tetëdhjetat dënohet me tetëdhjetë vjet punë të rëndë, sepse ai nuk pranon të denoncojë djalin e tij, i cili u soll në vend me parashutë nga amerikanët. Të burgosurit lirohen dhe kthehen në të njëjtin burg, vite më vonë, në një karusel terrori. Dhe së fundmi, në kthimin e saj nga burgu në shtëpi, në fillim "Teto Aristina" nuk njihet nga të afërmit e saj të moshuar, por nga një mbesë dymbëdhjetë vjeçare, e cila ka lindur gjatë mungesës së saj dhe e njeh atë vetëm nga historitë e të tjerëve

Po kështu, ndonjëherë ndodhin gjëra të pabesueshme: në një shtëpi në papafingon e së cilës fshihen partizanët, mbahet një mbledhje e Partisë, në fund të së cilës të arratisurit dëgjojnë komunistët e dehur duke kënduar refrenin që kemi përdorur si titull të një libri: "Rrofshin partizanët, / Këtu vijnë amerikanët." Oportunizëm? Cinizëm? Shpresë e kotë? Për një vend, burgjet e të cilit po shpërthenin nga të burgosurit politikë, ëndrra amerikane ishte një ilaç universal, por edhe një iluzion.

Këto janë detaje të cilat, megjithëse varen nga rastësia, flasin për dimensionet dhe nuancat e tmerrshme, në hapësirë dhe në kohë, të sistemit të kampeve dhe burgjeve.

REZISTENCA E GRUPIT ȚIBLEȘ

Një grup i armatosur rezistence që vepronte në Truallin Lăpuș nën komandën e pylltarit Nicolae Pop nga Lăpușul Românesc.. Gjatë ekzistencës së tij, grupi kishte rreth njëzet anëtarë, me rotacion. Grupi u përlesh në shumë raste me forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Duke miratuar një strategji mbrojtëse - ata nuk sulmuan kurrë - ata arritën të shpëtonin. Në dimrin e vitit 1952, rezerva e ushqimit të grupit u plaçkitën. Trupat e shërbimit sekret Securitate po përhapeshin nëpër male dhe metodat që ata përdorën për të asgjësuar grupin u bënë të shumëllojshme: ata rekrutuan një numër të madh informatorësh, kërcënuan prindërit, vëllezërit, motrat dhe të afërmit. Këto masa bënë që grupi të ndahej në njësi më të vogla në vitin 1952, në mënyrë që të rezistonte më lehtë. Në vitin 1953, grupi i rezistencës Țibleș u shtyp plotësisht. Një nga një anëtarët e saj ranë në duart e sigurimsave. Dumitru Hotico u qëllua në shtator 1952, Atanasie Oniga në janar 1953 dhe Vasile Hotea në mars 1953.

KONTRIBUT I FONDACIONIT TË AKADEMISË CIVILE – MEMORIALI I VIKTIMAVE TË KOMUNIZMIT DHE REZISTENCËS ANTIKOMUNISTE

REMUS RADINA lindi në një familje të varfër Rumune në 1924. Pas zgjedhjeve të manipuluar të 1946, ai dha dorëheqjen nga posti i tij si nëntoger në ushtri me arsyetimin se ishte betuar për besnikëri ndaj njerëzve më shumë sesa Partisë, ndaj së cilës tani ishte i detyruar të bënte një betim. Ai punoi në punët më të rëndomta për të mbajtur veten ndërsa studionte për të Drejtën Ndërkombëtare. Ai bëri disa përpjekje për të ikur në Perëndim. Gjatë marrjes në pyetje, pas përpjekjeve të tij të dështuara, ai u dha leksion oficerëve të sigurimit të shtetit për të drejtat e njeriut. Gjatë viteve të gjata të burgimit ai hyri shumë herë në grevë urie në mbrojtje të shokëve të persekutuar të burgut. Në vitin 1978, ai arriti të shkonte në Francë ku shkroi librin e tij Testament nga Morgu, një tregim i burgosjes së tij politike. Ai vdiq në Paris më 7 maj 2012.



ARKIVA E QENDRËS
NDERKOMBËTARE
PËR STUDIMET
RRETH KOMUNIZMIT.
PËRKUJTIMORJA
E VIKTIMAVE TË
KOMUNIZMIT DHE
TË REZISTENCËS
ANTIKOMUNISTE

Remus Radina

Një njeri normal në një botë anormale

shkruar nga Romulus Rusan

Një emigrant nga një vend në Europën Lindore, nga ku kishte emigruar tridhjetë e katër vjet më parë, vdiq në Paris më 7 maj 2012. Ai jetonte i vetëm në një bllok apartamentesh, për të cilin kujdesej një bashkatdhetar i përkushtuar që e vizitonte çdo ditë për t'i sjellë ushqime dhe ilaçe. Ai u varros në Varrezat Montmartre, ku ishte organizuar një komplot kundër tij, dhe lapidari i tij lexonte thjesht: REMUS RADINA, rumun.

Kush ishte ky rumun, shumë pak i njohur për njerëzit e Parisit? Ai ishte një nga luftëtarët më të palëkundur për lirinë e vendit të tij. Me mikun e tij të përjetshëm Cicerone Ionițoiu, ai ishte fortesa e fundit e të mërguarve antikomunistë Rumunë në Francë, të cilët karakterizoheshin nga natyra e tyre pa kompromise, vetëmohuese, besimi dhe shpresa.

TESTAMENT NGA MORGU

Në 1978, Remus Radina arriti të shkonte në Francë, një vit më vonë shkoi edhe Cicerone Ionițoiu, pas protestave nga ana e të mërguarve Rumunë, të cilët kërkuan që Nicolae Ceaușescu¹ të respektonte Marrëveshjet e Helsinkit të 1975, në veçanti paragrafit që i referohet lirisë së lëvizjes. Me arritjen e tij në Paris për një qëndrim dy mujor për trajtimin e sëmundjes që kishte marrë gjatë dhjetë viteve hetuesi, rrahjeve në burgje dhe kampe pune, Radina jetoi në një apartament me një dhomë me kushte të mjerueshme dhe punoi me kohë të pjesshme si elektrikist ndërsa shkruajti, ulur në stolin e një parku, një libër me 150 faqe me titull Testamenti nga Morgu², një tregim i burgosjes së tij politike. Ishte libri që revolucionarizoi pikëpamjen perëndimore për terrorin shtypës në Rumani. Shkruar në stilin lapidar, si i skalitur në gur, i mbushur me citate dhe aforizma nga shprehjet e të burgosurve, si dhe nga mendimtarët e mëdhenj të botës, libri u bë libri më i shitur. Në

¹ Drejtues i Rumanisë Komuniste nga 1965 deri në 1989, Sekretar i Përgjithshëm i Partisë Komuniste Rumune (1965-1989) dhe president i Republikës Socialiste të Rumanisë (1974-1989)

² Testamenti nga Morgu (një titull simbolik, pasi autori e kishte ndjerë se ishte në pragun midis jetës dhe vdekjes që nga fillimi i burgosjes së tij) është një autobiografi shqetësuese, një përzierje e kokëfortësisë dhe heroizmit, e papajtueshmërisë përballë tiranisë dhe altruizmit ndaj shokëve në vuajtje, i qëndrueshmërisë ndaj rregullave të normalitetit dhe sakrificës ndaj atyre të pafuqishëm dhe pa përkrahje.

parathënie, dramaturgu i madh Eugène Ionesco, me origjinë rumune, i famshëm për stilin dhe moralin e tij të papërkulshëm, deklaroi admirimin e tij të përzemërt për autorin thuajse të panjohur, të cilin e vendosi midis "heronjve dhe shenjtorëve të epokës sonë".

Dhe kështu Remus Radina u bë një model i admirueshëm për miqtë dhe i frikshëm për ata që kërcënonin lirinë e vendit të tij të dashur. Gjithësesi, duke u përballur me të gjitha reziqet, Radina u kthye në Rumani, ku sigurimi i shtetit do të hakmerrej ndaj tij. I përndjekur, i filmuar fshehtazi në rrugë, thirrjet e tij telefonike të përgjuara (madje edhe në kabinat e telefonit publik), Radina u soll në gjyq në tetor 1980 dhe

para një audience publike me udhëzime për ta trazuar ai u dënua për thyerjen e Ligjit për Shtypin. Arsyet: "botimi i një vepre, përmbajtja e së cilës është e dëmshme për rendin shtetëror në vendin tonë". Si rezultat i demonstratave në Paris të organizuara nga Cicerone Ionițoiu dhe nga të mërguar të tjerë të shumtë, dënimi i Radinës u zbut në një gjobë dhe ai u lejua të largohej nga Rumania, këtë herë për mirë. Dhe kështu filloi faza e fundit e luftës së Radinës, e cila do të zgjaste nga viti 1980 deri në vdekjen e tij.

Pas kthimit në Paris, menjëherë u mor me aktivitetet e mërgimtarëve rumunë: duke u kujdesur për Varrezat Soultzmatt në Alsace, ku u varrosën 678 ushtarë rumunë gjatë Luftës së Parë Botërore; duke krijuar varrin e heroit të mërguar antikomunist në Paris; duke promovuar përmes Radio Europa e Lirë propozimin e një ligji për lirinë e të burgosurve politikë në Rumani; festimi i përvjetorit të Heronjve; botimin e artikujve rreth Rumanisë. Në të njëjtën kohë, ai u përpoq të trajtojë sëmundjen e pashërueshme që kishte marrë gjatë burgimit.

Jeta e tij u etiketua nga veprime të shumta të dinjitetit ekstrem në dukje ëndërrimtare, por që e bënë atë pjesë të historisë.

Në 1946 ai dha dorëheqjen nga posti i nën-togerit në ushtri me arsyetimin se ishte betuar për besnikëri më shumë ndaj njerëzve sesa ndaj Partisë, për të cilën tani ishte i detyruar të bënte një betim.

Ai punoi në punët më të rëndomta për të mbajtur veten ndërsa studionte për të Drejtën Ndërkombëtare, me të cilën mbështolli veten për pjesën tjetër të jetës në mënyrë që të mbronte, të paktën në teori, lirinë individuale.

Në 1949 ai iku në Jugosllavi, në të cilën mendoi se kishte më shumë liri sesa në vendin e tij, por atje ai u burgos në një kamp pune para se të dorëzohet sërish në duart e Sigurimit të Shtetit Rumun.

I dënuar dhe i burgosur për pesë vjet në kanalën Danub – Deti i Zi "vendi i ndërtimit të vdekjes", ai sfidoi dobësinë e tij fizike, duke organizuar greva të shumta urie, greva etjeje dhe greva heshtjeje, jo në



**Kopertina e librit
"Testament nga Morgu".**

ARKIVI I QENDRËS NDËRKOMBËTARE PËR
STUDIME RRETH KOMUNIZMIT, MEMORIALI I
VIKTIMAVE TË KOMUNIZMIT DHE RESISTENCA
ANTIKOMUNISTE

mbrojtjen e tij, por në mbrojtje të bashkëburgosurve të sëmurë, të keqtrajtuar dhe të urituar, të detyruar të kryenin punë që e kalonin fuqinë e tyre. Përpjekjet për ta ushqyer me forcë dështuan. Ai u ngujua në qelinë e tij derisa erdhi një komision nga zyra e prokurorëve për të hetuar dhe marrë masa për përmirësimin e kushteve të të burgosurve.

Menjëherë pas lirim, në vjeshtën e 1956 ai shkroi një memorandum duke kërkuar lirimin e të gjithë të burgosurve politikë në Rumani dhe tërheqjen e trupave sovjetike nga Hungaria. Më 10 dhjetor 1956 (Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut) ai dorëzoi memorandumin në Ambasadën e SH.B.A.-së në Bukuresht. Pasi u largua nga ambasada ai u ndoq, në përgatitje të një arrestimi të ri, i cili e bëri atë të vendosur të përpiqej të ikte në Jugosllavi edhe një herë (e vetmja rrugë e mundshme arratisjeje për në Perëndim për rumunët). Ai u arrestua sapo shkeli në tokën serbe dhe u dorëzua edhe një herë tek Sigurimi i Shtetit.

BURGOSJA

Gjatë marrjeve në pyetje që pasuan, në Timișoara, ai u poshtërua dhe u torturua nga një oficer i Sigurimit të Shtetit, por nuk u dorëzua derisa i dha leksion oficerit për të drejtat e njeriut, duke filluar me paragrafët e Deklaratës së Pavarësisë së SHBA-së dhe duke përfunduar me nenet e Deklaratës Universale



Remus Radina, regjistri penal, 1949.

ARKIVI I QENDRËS NDËRKOMBËTARE PËR STUDIME RRETH KOMUNIZMIT, MEMORIALI I VIKTIMAVE TË KOMUNIZMIT DHE REZISTENCËS ANTIKOMUNISTE

VENDET E NDËRTIMIT TË PUNËS SË DETYRUAR NË KOMUNIZËM

Puna e detyruar e të burgosurve politikë dhe e të dëbuarve në të njëjtin vend me kriminelët u përdor kryesisht në Bllokun Lindor. Kampet e veçanta të burgjeve u themeluan për të siguruar punë për vende ndërtimi më të mëdha. Shkalla e vdekshmërisë së të burgosurve ishte e lartë për shkak të punës së rëndë, dhunës së rojeve, kequshqyerjes, pajisjeve dhe veshjeve të papërshtatshme dhe gjithashtu mungesës së sigurisë dhe kujdesit mjekësor. Kushtet e tmerrshme higjienike do të thoshin se sëmundjet përhapeshin me shpejtësi. Të burgosurit punuan krah për krah me punëtorët e lirë, me batalionet e ndërtimit të rekrutëve ushtarakë dhe me vullnetarët e rinisë komuniste. Vendi më i famshëm që përdorte punën e detyruar e të burgosurve politikë ishte Kanali Detit i Bardhë- Detit Baltik, i hapur në vitin 1933. Qyteti i Komsomolsk-on-Amur (nga viti 1932), Linja Kryesore Baikal-Amur (1932-1984) dhe shumë të tjerë pasuan. Shembulli kryesor rumun ishte Kanali Danub-Det i Zi me gjatësi 64 km, shkurtonte rrugën ujore të Danubit në Detin e Zi. Kanali u ndërtua gjatë viteve 1949-1953 kryesisht nga të burgosurit politikë, por u përfundua vetëm në vitet 1974-1987 me përdorimin e punës së lirë dhe njësisë të ndërtimit ushtarak.

të të Drejtave të Njeriut miratuar në 1948 nga Kombet e Bashkuara. Procesverbali i marrjes në pyetje, i zbuluar në arkivat e ish Sigurimit të Shtetit, është unik: viktima i shpjegon torturuesit të tij se sa ligje gjyqësore dhe morale po shkelte. Është një version i Davidit dhe Goliathit. U dënua me dhjetë vjet burgim dhe rifilloi grevat e tij i vetëm. Por në burgun e tmerrshëm Gherla, më 14 qershor 1958, protesta e tij nga ajo e një personi u bë grevë e përgjithshme, duke përfshirë qindra të burgosur, duke e bërë atë një symbol të burgimit politik.

Ai u mësua me torturat, në burgun djallëzor me gozhda në mure dhe ujë në dysHEME; dhe vuajtjet, të cilat ai i pranon dhe madje i nxit, u bënë natyrë e dytë për të. Fjala për të u përhap në të gjithë Gulagun rumun dhe rojet e burgut, të dëshpëruar nga indiferenca e tij para vdekjes, vijnë për t'u gëzuar kur ai do lirohej dhe më në fund do shihnin shpinën e tij. Por lirimi nga burgu nuk solli qetësi, sepse mbikëqyrja, shantazhi dhe kërcënimet nga Sigurimi i Shtetit ia bëjnë jetën një makth të përditshëm.

Gjesti vëllazëror i autoriteteve franceze, të cilët e strehuan atë pas ferrit që kishte duruar, ishte në vetvete një njohje e çnjerëzimit të regjimit politik nga i cili ai erdhi dhe, në mënyrë të nënkuptuar, I anormalitetit të sistemit komunist në krahasim me normalitetin e qytetarëve të zakonshëm, ata që e kuptojnë se bota është ndërtuar (ose duhet të ndërtohet) nga dashuria, besimi dhe shpresa...

KONTRIBUT I FONDACIONIT TË AKADEMISË CIVILE – MEMORIALI I VIKTIMAVE TË KOMUNIZMIT DHE REZISTENCËS ANTIKOMUNISTE

BULLGARIA



LUFTA E DYTË BOTËRORE

Pas pushtimit gjerman të Greqisë, Mbretëria e Bullgarisë u bashkua me forcat e Aksit më 1 mars 1941, duke pushtuar një pjesë të Maqedonisë Lindore dhe Trakën Perëndimore. Bullgaria nuk i shpalli luftë Bashkimit Sovjetik; megjithatë këtë e bëri kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qeveria bullgare shpëtoi 50,000 hebrenjtë e saj, megjithatë bashkëpunoi me nazistët në dëbimin e 11,343 hebrenjve nga "Bullgaria e Re" në kampin e vdekjes në Treblinka. Tsar Boris vdiq më 28 gusht 1943, pasi u kthye nga një takim me Hitlerin. Më 5 shtator 1944, Bashkimi Sovjetik pushtoi vendin. Një grusht shteti komunist pasoi më 9 shtator 1944.

REGJIMI KOMUNIST

Me mbështjen e ushtrisë sovjetike, grushti i shtetit i 9 shtator 1944 vendosi një qeveri të udhëhequr nga komunistët. Në 1946, vasali i Stalinit Georgi Dimitrov u bë kryeministër dhe u formua një diktaturë me një parti. Opozita politike dhe fetare u persekutuan; mbreti iku jashtë vendit. Diktatori i fundit komunist, Todor Zhivkov, u tërhoq pas 35 vjetësh në pushtet më 10 nëntor 1989. Zgjedhjet e para të lira u mbajtën në 10 qershor 1990. Ato u fituan nga ish-komunistët, Partia Socialiste Bullgare.

LYUDMILA SLAVOVA lindi më 1913 në familjen e një avokati të famshëm, politikan Social Demokrat dhe anëtar i parlamentit. Ajo u diplomua për drejtësi në Universitetin e Sofjes më 1936 dhe ishte sekretare e Bashkimit Rinor Social Demokrat. Ajo u ngrit në mënyrë aktive kundër bashkëpunimit të Bullgarisë me Gjermaninë naziste. Pas grushtit të shtetit komunist, ajo kandidoi në zgjedhjet parlamentare të 1946 si kandidate e Opozitës së Bashkuar. Megjithatë, në ditën e zgjedhjeve, ndërsa kryente inspektimet rutinë të vendvotimeve, ajo u rrëmbye nga një bandë burrash të Sindikatës së Rinisë së Punëtorëve (RMS), një organizatë e të rinjve komunist bullgar. Ata e rrahën, torturuan dhe e lanë për të vdekur. Por ajo mbijetoi dhe vazhdoi t'i kundërvihet tiranisë komuniste. Lyudmila Slavova vdiq më 16 tetor 1948, në moshën 35 vjeçare, pasi ishte djegur me ujë të vluar nën mbikqyrjen e sigurimit të shtetit komunist. Vendi i varrimit të saj nuk dihet.



KOLEKSION I FAMILJES

Lyudmila Slavova

Një Lule në Makinerinë Ogurzezë

shkruar nga Angel Filchev

Emri i Lyudmila Slavova nuk ka kuptim në ditët e sotme për qytetarët bullgarë. Sot, përveç familjarëve të saj të mbijetuar dhe një rrethi të ngushtë të anëtarëve të së njëjtës mendje të partisë Social-Demokrate të shkatërruar nga komunistët, publiku bullgar nuk ka dëgjuar fare për të. Ky nuk është vetëm fati i saj, por edhe fati i dhjetëra mijëra bullgarëve - me varre të pidentifikuara të dënuar me harresë nga shteti totalitar dhe imituesit¹ e tij. Gazetarët e mediave të sotme bullgare shmangen të flasin për viktimat e komunizmit - në mënyrë që të mos u kujtojnë njerëzve ngjarjet që u zhvilluan pas përmbykses së sistemit më 9 shtator 1944. Për pronarët e vërtetë të atyre mediave, ata janë kryesisht njerëz të ish-shërbimit sekret të shtetit komunist.

Ngjarjet pas 9 shtatorit 1944 morën emrin "Revolucioni Socialist" nga partia Komuniste e cila rrëmbeu pushtetin me "ndihmën vendimtare të ushtrisë sovjetike". Në këto kushte, ai përpigjet të bind ata që nuk e dinë të vërtetën për të kaluarën dhe se i është dashur të kryejë krime nga nevojshmëria historike - në emër të zhvillimit të njerëzimit drejt "së ardhmes Komuniste së ndritshme" të pashmangshme.

NJË E KALUAR E TRAZUAR POLITIKE

Para makinerisë së llahtarshme vrastare, Lyudmila Slavova ishte thjesht një lule e vogël në rrugën e asaj makinerie të keqe. Ajo kaloi fëmijërinë dhe rininë e saj në kohë të trazuara dhe të vështira. Ajo lindi më 1913 në familjen e një avokati të famshëm dhe aktivisti social-demokrat. "Milya", siç e quanin miqtë dhe të afërmit e saj, u rrit me idealet e lirisë, demokracisë dhe drejtësisë shoqërore dhe ëndërronte ditë paqësore dhe të begata për vendlindjen e saj, por koha e saj ishte mjaft e ndryshme.

Pjesëmarrja e Bullgarisë në Luftën e Parë Botërore solli një katastrofë makthi kombëtare. Vendi u përgjak ngado – territore të reja me popullsi bullgare u shpëputën prej tij. Mijëra refugjatë të pastrehë dhe të shkatërruar, për të cilët shteti nuk mund të kujdesej, u dyndën nëpër kufijtë e tij të gjymtuar. Indinjata për fajtorët e katastrofës u rrit së bashku me dëshpërimin. Tsar Ferdinand humbi fronin e tij, filluan trazirat dhe

¹ Imituesit inferiorë [shënime të botuesit].

u krijuan kushte të favorshme për depërtimin e ideologjisë dhe agjentëve të perandorisë së sapothemeluar bolshevike në Moskë në veri, e cila gjithashtu frymëzoi krijimin e Partisë Komuniste Bullgare (BKP).

Ndërhyrja ruse në punët e saj të brendshme nuk ishte asgjë e re për Bullgarinë, por mori dimensione të reja. Në strategjinë e Bolshevikëve Rusë, Bullgaria ishte shënjestra kryesore në Ballkan në përpjekjet e tyre për të nxitur "valë të reja revolucionesh" në Europë. Udhëheqësit bolshevikë nuk i lëshuan kurrë mirazhet e një republike socialiste Sovjetike në mbarë botën nën kontrollin e tyre. Moska caktoi burime të konsiderueshme financiare për të destabilizuar shoqërinë dhe forcuar agjentët komunistë në Bullgari, pavarësisht vdekjes nga uria dhe shkatërrimit të vetë Ruisë Sovjetike.

Varfëria dhe sëmundjet të sjella nga Lufta e Parë Botërore shtynë bashkimin e masave me lëvizjet shoqërore dhe partitë që kërkonin drejtësi sociale në Bullgari. Disa prej tyre ishin mjaft radikalë. Një krah komunist ndau partinë Social Demokrate. Grupet anarkiste u rritën në numër. Më 1920, Bashkimi Kombëtar Agrar Bullgar (BZNS) formoi një qeveri të kontrolluar vetëm nga BZNS që mbronte interesat e pronarëve të tokave rurale të klasës së ulët dhe të mesme. Në atë kohë Bullgaria ishte një vend agrar me një sektor të dobët industrial dhe fshatarët përbënin shumicën e popullsisë, e cila përcaktoi mbështetjen e tyre për qeverinë. Por qeveria e kontrolluar nga BZNS gjithashtu përdori disa metoda diktatoriale për të zbatuar politikën e saj.

Më 9 qershor 1923, kjo qeveri u përmbys nga një grusht shteti i udhëhequr nga Lidhja Ushtarake dhe Aleanca Popullore, Aleksandar Stamboliyski u torturua dhe u vra. Një periudhë dhune pasoi në vend. Përveç faktorëve të brendshëm, ai gjithashtu u frymëzua dhe nga jashtë - nga fuqia konsoliduese totalitare në Bashkimin Sovjetik. Në shtator 1923, funksionarët e partisë Komuniste Georgi Dimitrov dhe Vasil Kolarov nxitën rovoltën e fshatarëve nga Bullgaria Veri-perëndimore, por kryengritja u shtyp brutalisht nga regjimi i "Aleancës Demokratike". Urdhri për fillimin e kryengritjes erdhi nga Comintern² në Moskë.

Pas rebelimeve komuniste të shtatorit Georgi Dimitrov dhe Vasil Kolarov u larguan nga vendi. Por më shumë se 1.000 rebelë u vranë nga forcat ushtarake dhe policore të qeverisë së Aleancës Demokratike. Guerilast komunistë dhe anarkistë dolën në male për të luftuar terrorin me terror. Më 16 prill 1925, krahu ushtarak i partisë Komuniste vrau dhe plagosi qindra njerëz në sulmin e Kishës St. Nedelya. Pas sulmit, disa qindra komunistë, anëtarë të krahut të majtë të BZNS dhe intelektualë demokratë, u vranë pa akuza dhe pa gjyq dhe burgjet u mbushën me të majtë të dënuar.

RRUGA DREJT TOTALITARIZMIT

Normalizimi i jetës politike në gjysmën e dytë të viteve 1920 dhe fillimin e viteve 1930 u ndërpre nga një tjetër grusht shteti më 19 maj 1934. Zhvillimi politik i Bullgarisë u vendos në rrugën drejt totalitarizmit.

² Komunistët Ndërkombëtarë, një organizatë ndërkombëtare komuniste e formuar në Moskë në vitin 1919 [shënime të botuesit]

Lyudmila Slavova u diplomua për drejtësi në Universitetin e Sofjes në 1936. Në atë kohë gratë nuk pranoheshin në avokati, kështu që ajo punoi si juriste e brendshme në një kompani që ndërtonte shtëpi. Gjatë studimit të saj ajo ishte dëshmitare e grushtit të shtetit të 19 maj 1934. Ai drejtohej nga Kimon Georgiev, kryeministri i ardhshëm i qeverisë së parë "antifashiste" pas pushtimit sovjetik. Por në 1934 autorët e grushtit të shtetit (nga Lidhja Ushtarake dhe grupi politik Zveno) kishin qëndrime tipike fashiste - ata shfuqizuan kushtetutën, shpërndanë Parlamentin, ndaluan të gjitha partitë politike dhe dënuan shumë aktivistë politikë, përfshirë Komunistët. Praktikata qeveritare të autorëve të grushtit të shtetit të 19 majit u huazuan nga Musolini. Por regjimi vendosi marrëdhënie diplomatike me BS dhe, mbi këto baza ata u vlerësuan pozitivisht nga Moska, për shkak të përvojës që patën me grushtin e shtetit dhe të gatishmërisë së tyre për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme. Dhe kështu u krijua bashkëpunimi midis komunistëve të Kremlinit dhe fashistëve bullgarë...

Që në fillim, e gjithë ideologjia dhe historia e komunizmit u përshkua nga një gënjeshtër totale dhe cinike, kështu që bashkëveprimet midis komunistëve dhe social-demokratëve nuk po ecnin mirë edhe pas orientimit të ri të shpallur hipokrizisht nga Komiterni më 1935 për të ndërtuar një front të përbashkët kundër fashizmit dhe luftës. Megjithatë, mjaft njerëz me bindje demokratike iu nënshtruan demagogjisë së Stalinit. Midis tyre ishin shumë social-demokratë. Lyudmila Slavova gjithashtu u mashtrua. Atë kohë, ajo ishte pjesëmarrëse aktive në jetën e Partisë Social-Demokrate. Ajo ishte e famshme si një personalitet me mendje publike dhe një oratore e shkëlqyer. Nuk vonoi shumë dhe ajo u zgjodh sekretare e Bashkimit Rinor Social Demokrat dhe më pas në një pozicion udhëheqës të Partisë. Lyudmila miratoi me gjithë zemër idenë e luftës për të mbrojtur paqen dhe demokracinë. Në emër të tyre ajo ishte e gatshme të bashkëpunonte edhe me organizatën rinore komuniste bullgare Shoqata Rinore e Punëtorëve (RMS). Dhe pastaj ajo u zhgënjye përsëri.



Njerëz të arrestuar në Sofie pas grushtit të shtetit komunist.

ARKIVA E QENDRËS HANNAH ARENDT - SOFIE

LUFTA E PASUAR NGA TERRORI KOMUNIST

Më 23 gusht 1939, lideri sovjetik Josef Stalin, zëri më i lartë antifashist të cilin shumë e perceptuan si "kreu antifashist", nënshkroi papritur një pakt me Hitlerin, duke hapur dyert e Luftës së Dytë Botërore. Pakti dhe agresioni i përbashkët sovjetiko-gjerman kundër Polonisë i acaroi marrëdhëniet midis social-demokratëve dhe komunistëve dhe atyre brenda Partisë Social-Demokrate. Lyudmila Slavova ishte ndër

ata që refuzuan të pranonin mendimin e urdhëruar nga Kremlini kundrejt komunistëve bullgarë se demokracitë perëndimore të Anglisë dhe Francës duhet të fajësoheshin për masakrën globale që kishte filluar. Mosbesimi i saj ndaj komunistëve nuk u zhduk edhe kur Hitleri sulmoi BS dhe Partia Komuniste Bullgare ndryshoi plotësisht pozicionin e saj. Dyshimet e Lyudmila mbetën edhe pas korrikut 1942 kur Georgi Dimitrov, kreu i Komiternit, i cili shërbeu si krahu ndërkombëtar i Partisë Komuniste të bolshevikëve dhe në të njëjtën kohë udhëheqësi i BKP, shpalli projektin e tij të formimit të "Frontit të Atdheut" për të luftuar "monarkofashizmin dhe pushtuesit Hitleristë".

Por situata ishte e tillë që megjithëse Social Demokratët menduan se ishte mbrojtje komuniste që do të përdorej në të ardhmen për të marrë pushtetin, ata prapë se prapë u bashkuan me të. Veç njëri nga udhëheqësit e tyre të kahershëm, Krastyo Pastuhov, arriti të shihte se komunistët po i përdornin vetëm për kohësisht social-demokratët si aleat dhe se ata po përgatiteshin të vendosnin një diktaturë. Kështu, pasi Ushtria e Kuqe pushtoi vendin dhe pas grushtit të shtetit të 9 shtatorit 1944, dy social-demokratë fituan vende në qeverinë e "Frontit të Atdheut". Por kjo nuk i ndaloi komunistët të fillonin të përziheshin aktivisht në çështjet e Partisë Social-Demokrate. Një ditë, katër "social-demokratë të majtë" të shoqëruar nga militantë sulmuan selinë e partisë, rrëzuan Sekretarin e Përgjithshëm Lulchev dhe ngarkuan në vend të tij agjentin komunist Neykov. Ky veprim e bëri të pashmangshme ndarjen e partisë dhe në 1945 Lulchev regjistroi "Partinë Social-Demokrate të Punëtorëve Bullgarë - të Bashkuar", e cila u bashkua me Opozitën Demokratike kundër diktaturës që përparonte.

Komunistët ishin mjaft mizorë me social-demokratët të cilët në propagandën e tyre imituan idealet autentike të drejtësisë shoqërore. Social-demokratët ishin ata që zbuluan fytyrën e vërtetë të funksionarëve komunistë - një nga karrieristët e pamëshirshëm që përpiqeshin për pushtet me anë të gënjeshtreve, propagandës dhe terrorit.



Nikola Petkov, udhëheqës i opozitës demokratike.

ARKIVA E QENDRËS HANNAH ARENDT - SOFIE

Fillimisht Stalini urdhëroi udhëheqësit komunistë në Bullgari të krijonin aleanca me partitë e majta dhe të premtonin "demokracinë popullore" derisa të vendosnin me terror kontrollin e plotë të shoqërisë. Kur kjo u përmbush në një mënyrë banditeske, siç ishte menduar nga Stalini, aleatët naivë duhej të hiqeshin nga pushteti dhe më vonë të vriteshin. Nikola Petkov i Bashkimit Kombëtar Agrar Bullgar (BZNS) mori pjesë në qeverinë "Fronti i Atdheut" si ministër pa portofol, por në verën e 1945 ai dha dorëheqjen dhe drejtoi Opozitën ndaj regjimit, e cila përfshihej në Partinë Social Demokrate të Punëtorëve Bullgarë (të Bashkuar) dhe Partinë Demokratike.

Rezistenca ligjore e Opozitës Demokratike zgjati deri në fund të 1947 kur e ashtuquajtura "Kushtetuta Dimitrov" (emëruar sipas

udhëheqësit komunist Georgi Dimitrov dërguar në vend nga Joseph Stalin) u imponua me anë të terrorit komunist. Gjatë këtyre dy vjet e gjysmë, udhëheqësit e opozitës - Nikola Petkov, Dimitar Gichev, GM Dimitrov (BZNS), Kosta Lulchev dhe Krastyo Pastuhov (Social Demokratë) dhe Nikola Mushanov (Partia Demokratike) së bashku me mijëra mbështetës të tyre, kryesisht agrarët, u ngritën kundër regjimit çnjerëzor totalitar të imponuar nga Bashkimi Sovjetik dhe për vlerat demokratike në Bullgari.

Me anë të arrestimeve, vrasjeve, burgjeve dhe kampeve të përqendrimit, ndalimeve dhe censurës, funksionarët komunistë Stalinistë të ardhur nga Moska, të udhëhequr nga Georgi Dimitrov dhe Valko Chervenkov, thyen Opozitën dhe krijuan një qeveri të monopolizuar nga partia Komuniste dhe mbështetur nga një sistem organizatash kukull. Nikola Petkov, i cili u arrestua më 5 qershor 1947, u ekzekutua në 23 shtator 1947, vetëm tre ditë pasi Shtetet e Bashkuara njohën qeverinë Bullgare. Më vonë u vranë edhe Nikolla Mushanov dhe Krastyo Pastuhov, ndërsa Kosta Lulchev dhe Dimitar Gichev u burgosën për shumë vite. G. M. Dimitrov (Gemeto) arriti të arratiset, por sekretarja e tij, 23-vjeçarja Mara Racheva, e cila e ndihoi të arratiset, u vra brutalisht në Selinë e Milicisë Popullore³. Faji i vetëm i gruas së re ishte se ajo shoqëroi për në banesën e një diplomati britanik aktivistin e opozitës Gemeto, i cili arriti t'i shpëtonte arrestit shtëpiak.

VRASJA ÇNJERËZORE E NJË TË PAFAJSHMI

Partia Komuniste në Bullgari është përpjekur gjithmonë t'ua hedhë fajin për çdo krim të tyre të zbuluar funksionarëve komunistë "të papërgjegjshëm" sikur këta kanë vepruar në kundërshtim me udhëzimet e udhëheqjes. Por vrasja e Mara Racheva vërteton të kundërtën. Ditën e vdekjes së saj, Traycho Kostov (i dyti në komandën hierarkisë së Partisë Komuniste) informoi Georgi Dimitrov, udhëheqësin komunist që tashmë kishte marrë një status prej kulti, se Mara Racheva kishte filluar të jepte prova interesante rreth ujdive për arratisjen e Gemetos dhe përfshirjen e britanikëve në të. *"Por sot, ai shkruajti në shënimin e tij, ajo u hodh nga kati i katërt i Selisë së Milicisë dhe bëri vetëvrasje."*

Se sa i vërtetë është rrëfimi i tij është e qartë nga komunikimi i kolonelit S.W. Bailey, një zyrtar i Shërbimit Sekret Britanik në Sofie me Zyrën e Jashtme: *"Unë jam informuar nga mjeku, që ishte duke u përkujdesur për nënën e vajzës kur arkivoli u hap, që u vunë re plagët e mëposhtme, përveç plagëve nga plumbi dhe thika:..."* Ajo që vijon është një dëshmi e tmerrshme e gjymtimeve të shumta të lemeritshme.



Mara Racheva

ARKIVA E QENDRËS HANNAH ARENDT - SOFIE

³ Polic Komunist [shënim i përkthyeses]

Të tilla ishin rrethanat në të cilat Lyudmila Slavova iu përkushtua plotësisht betejës së pashpresë për të mbrojtur mbetjet e fundit të demokracisë bullgare. Gruaja e re udhëtoi në të gjithë vendin, inkurajoi të dëshpëruarit dhe bisedoi me njerëzit ballë për ballë me gjithë pasionin dhe entuziazmin vetëmohues të zemrës së saj. Në mbledhjet e organizuara, ajo gjithmonë fliste në shtëpi plot me njerëz, pavarësisht ndjekjes së egër



Sofia në 1945.

ARKIVA E QENDRËS HANNAH ARENDT - SOFIE

të agjentëve të Shërbimit Sekret Komunist dhe topuzëve të gjakosur të bandave komuniste. Lyudmila u bë një përfaqësuese popullore e jashtëzakonshme e Opozitës Demokratike, të cilën komunistët nuk do ta falnin kurrë.

Atmosfera politike po bëhej tmerrësisht e më e erret. Vorbulla e saj thithte gjithnjë e më shumë fytyra, mes tyre shumë prej më të afërme dhe më të dashurve të Lyudmilës - të afërm, miq, njerëz me të njëjtin mendim që kishte takuar në udhëkryqet e zymta bullgare. Kjo është arsyeja pse janë ruajtur vetëm disa fragmente nga jeta e saj, si dhe nga jeta e shumë të tjerëve.

NJË SHPIRT I FORTË

Këtu është rrëfimi i Vasil Gatev nga Nova Zagora, një avokat i Lyudmilas kur ajo kandidoi si kandidate e Opozitës së Bashkuar gjatë zgjedhjeve parlamentare të viti 1946:

"...Ditën e zgjedhjeve Lyudmila Slavova dhe unë u nisëm në këmbë nga [fshati] Konyovo në [fshatin] Mladovo për të kontrolluar vendvotimet dhe për të depozituar aty autorizimin e avokatit. Mes dy fshatrave, pranë urës, ne u sulmuam nga dhjetëra burra të armatosur me topuza, të gjithë nga Konyovo, disa prej tyre të afërmit e mi. Më lidhën dhe rrahën në mënyrë çnjerëzore derisa humba ndjenjat. Pas kësaj, u shtriva e mbështjellë në lëkurë deleje për të paktën 40 ditë... Gjithsesi, mbijetova, jam mirë dhe është mirë që jam gjallë tani që të mund të tregoj për Milya... Ata e çuan atë në korijën me akacie që gjendej aty pranë, ajo po kërkonte ndihmë me zë të lartë dhe u lutej atyre, e shkreta, por askush nuk guxonte të përgjigjej nga frika se mos kishin të njëjtin fat. Kishte njerëz në fushat dhe pemishtet fqinje... Atje ata e rrahën dhe fyen, e përdhunuan në grup e gjithë RMS, i thyen të dy krahët dhe një këmbë, i dogjën fletëvotimet që ne kishim me vete për qendrat e votimit... Pas rrahjes, e mbuluar e gjitha me gjak, Lyudmila arriti të zvarritet në kopshtin e perimeve të plakut Dinyo Penchev, pranë shinave të hekurudhës. Kjo ndodhi pasdite vonë dhe kur plaku Dinyo shkoi atje për të ujitur kopshtin e tij, dëgjoji një rënkim dhe një zë që lutej për ndihmë. Në një fare mënyre plaku arriti t'i ngjiste krahët e thyer të Lyudmilës duke përdorur lecka dhe shkopinj, i bleu asaj një biletë për në Sofie me trenin e natës dhe e ndihmoi të hipte në vagonin e fundit ... "

Çfarë shpirti kishte ajo grua e re e brishtë në mënyrë që të shëronte mendjen dhe trupin e saj pas

asaj tronditje monstruoze dhe të vazhdonte e patundur përgjatë rrugës së saj prej dëshmoreje! Vetëm një muaj pasi ndodhi zemërimi çnjerëzor, në gazetën e Partisë Social Demokrate Svoboden Narod (Njerëz të Lirë), u botua një artikull me titull Paturpësia Politike, shkruar nga duart e saj të gjymtuara. Në të ajo nuk bërtiti për atë që i kishte ndodhur por ngriti zërin kundër dhunës ndaj të gjithë popullit bullgar dhe kundër vëzhguesve të huaj të korruptuar:

"Komisioni Qendror i Monitorimit Publik të Zgjedhjeve thotë se 'Votuesit bullgarë kanë pasur një mundësi të plotë për të shprehur lirshëm vullnetin e tyre'. Me anë të këtij veprimi, i vë në dispozicion Komisionit kartën time elektorale dhe pohoj se mua, Lyudmila Slavova, kandidatë për deputete në fushatën zgjedhore, zona Nova Zagora, m'u ndalua votimi dhe jam e gatshme që kjo çështje të hetohet. Unë fajësoj jo vetëm autorët e drejtpërdrejtë të bindur të krimeve të paimagjinueshme që ata bënë ditën e zgjedhjeve; por gjithashtu fajësoj edhe ata që dhanë direktivën e partisë siç më tha një nga dhunuesit dhe torturuesit e mi. Atë ditë, shkova për të kontrolluar qendrat e votimit në fshatin Konyovo dhe, midis dhjetëra personave të rrahur, vizitova personalisht edhe dy avokatët tanë të dhunuar. Unë guxoj t'i fajësojë pa frikë për atë çka pashë dhe përjetova, dhe mendja njerëzore nuk mund të imagjinojë diçka më të tmerrshme për veten dhe për nënat e fëmijët që ende i shoh duke qarë, akoma dëgjoj britmat e tyre, akoma shoh tmerrin në sytë dhe në mavijosjet e tyre, si edhe gjakun në shpinën e tyre. Të njëjtën gjë mund të them edhe për tmerrin që kam përjetuar vetë dhe që nuk mund të konsiderohet si moral njerëzor 'gjatë zgjedhjeve më paqësore dhe të ligjshme.'"

Në fund të artikullit të saj Lyudmila u bëri thirrje të gjithë atyre që ende nuk kishin frikë të luftonin kundër tiranisë: *"Gra, nëna, motra, qytetarë bullgarë, në emrin tuaj unë fajësoj dhe kërkoj një siguri për lirinë dhe jetën tonë. Për atë arsye, në emër të njerëzimit, lirisë dhe demokracisë, ne, shumica dërrmuese e njerëzve mes të cilëve kam qenë gjithmonë, jam dhe do të jem, duhet të vazhdojmë luftën."*

"Nuk kanë rëndësi njerëzit që votojnë. Por njerëzit që numërojnë votat!" mësonte Stalini, "udhëheqësi i proletarietit botëror". Georgi Dimitrov, "udhëheqësi dhe mësuesi i popullit Bullgar", na mëson të njëjtën gjë. Por, megjithë fitoren e njoftuar zyrtarisht, rezultatet e zgjedhjeve i zemëruan fituesit. Megjithë tmerrin e pamëshirshëm, më shumë se 1.2 milion njerëz guxuan të votojnë kundër diktaturës së tyre, duke dërguar 110 deputetë të opozitës në Parlament. Diçka që BKP nuk mund t'ua falte, as Opozitës, as njerëzve të panënshtuar. Për shumë persona, si deputetë edhe aktivistë të partive të opozitës, që prej atij momenti ajo që po venitej, nuk ishin vetëm karriget e tyre në Asamblenë Kombëtare, por edhe ekzistenca e tyre fizike. Shfarosja kishte filluar kohë më parë, sistematikisht dhe në përditshmëri, nga vrasje të papërgjegjshme, nga "Gjykata e Popullit", vrasje dhe rrëmbime në errësirën e natës, në kampe përqendrimi, qelitë e burgjeve. Koha e Lyudmila Slavova gjithashtu ishte duke mbaruar. Në përputhje me zakonet komuniste, ajo i bëri varrin vetes për shkak të qëndrimit të papajtueshëm. Dhe ajo shtoi edhe një akuzë tjetër të pafalshme në verdiktin e saj - pavarësisht nga "aksidenti" ajo fitoi zgjedhjet në rrethin e saj. Duke shtrënguar dhëmbët numëruesit falsifikuan atë që u duhej dhe anuluan fitoren e saj elektorale.

Pjesë nga kujtimet e Penka Neykova nga qyteti Nova Zagora:

“U takova me Lyudmila në 1946 sepse po garonim në fushatën zgjedhore si kandidatë të Opozitës së Bashkuar, unë si përfaqësuese e BZNS, ndërsa Nikola Petkov dhe ajo si përfaqësues të Partisë Social-Demokrate. Kishim në dispozicion një xhip me të cilin udhëtuam në zonën tonë gjatë fushatës zgjedhore. Zona jonë kishte 72 fshatra. Kjo ndodhi gjatë zgjedhjeve në tetor 1946. Së bashku morëm pjesë në takime publike në Nova Zagora, ajo foli me shumë entuziazëm dhe njerëzit e dëgjuan me shumë vëmendje. Javën e fundit shkuam në fshatrat malorë - Tvarditsa, Gurkovo, Kozarevo, Konare dhe Sborishte ... Në ditën e zgjedhjeve Lyudmila u nis me Vasil Gatev për në fshatin Konyovo afër Nova Zagora.

Takimi im i dytë me Lyudmila ndodhi në kampin e përqendrimit Bosna (Nozharevo) në zonën Silistra. Ata më futën në një dhomë ku kishte vetëm të burgosur politikë femra; personi i vetëm që njoha ishte Lyudmila. Takimi ynë ishte sa tragjik dhe i gëzueshëm; ne ndamë shtratin prej dërrase e kashte për një muaj. Papritur, Lyudmilas i thanë se do të lirohej, por ajo nuk ishte shumë e lumtur për lajmin. Ajo sikur e ndjente që ajo çfarë do të ndodhte nuk ishte liria, por diçka më e keqe. Më tha ‘Penke, nuk e di se çfarë do të më ndodhë...’ Kështu u ndamë. Jo shumë kohë më vonë erdhi Magda, një grua nga Sofja, shumë e singërtë dhe e besueshme. Ajo më tha se kishte qenë në të njëjtën qeli me të. Kur i çuan në tualet, Magda donte të shkonte e para, por milici në detyrë urdhëroi që Lyudmila të hynte e para. Dhe kështu ndodhi. Koha e larjes mbaroi, por Lyudmila nuk doli dhe kur Magda hapi derën e pa ndjenja, uji i nxehtë binte përsipër. Kjo ndodhi në selinë e Shërbimit Sekret. Fatkeqësisht, Magda, e cila ishte dëshmitarja e vetme e ‘aksidentit’ tragjik të Lyudmila Slavova, u përplas më vonë nga një tramvaj dhe sot ajo nuk mund ta ritregojë historinë e saj. Magda ma ka treguar vetë. Ajo është një dëshmitare okulare e krimin.”

Pjesë nga kujtimet e Dr. Nikola Grozev nga qyteti Pomorie, prill 1991:

“Si mjek më është dashur të marr pjesë në vdekjen e shumë njerëzve. Jeta ime ka qenë e tillë që në shumicën e rasteve kam qenë dëshmitar i vdekjeve të dhunshme. Sapo u diplomova në 1943 shkova të punoj si mjek në repartin e kirurgjisë. Gjatë bombardimeve sillnin shumë të vrarë ose të plagosur, atëherë unë mora pjesë në luftë, më shumë të vrarë dhe të plagosur. Pastaj, nga 1945 e tutje, kishte më shumë kampe, burgje... Kështu u mësova me vdekjen. Njerëzit reagojnë ndryshe kur ndjejnë se fundi i tyre është afër: disa ju shtrëngojnë fort dhe ju luten për ndihmë, të tjerët zhyten në apati, bëhen indiferentë, dorëzohen. Por pamja e saj ishte krejt ndryshe, një pamje e ngjashme me Madonën, paqësore, plot hir të krishterë, nuk do ta harroj kurrë. Edhe tani sikur më del para syve, pamja e një gruaje që mblodhi dhimbjen, besimin dhe shpresën e mbarë kombit tonë gjatë viteve të shfarosjes së intelektualëve tanë nga 1944-1950. Ajo u soll në spitalin e Burgut Qendror të Sofies si rast urgjence: e gjitha e përvëlur! Po, e përvëlur në kuptimin e plotë të fjalës... Unë pashë lëkurën e përvëlur me ngjyrë të bardhë në gri në pothuajse gjithë trupin e saj. Ajo ishte e vetëdijshme vetëm për tre ditë. Nuk pranoi të merrte morfinë. Ndërsa më mbante dorën, pëshpëriti një herë: “Thuaju të gjithë miqve të mi se bëra detyrën time aq sa munda. Por kështu duhej të ndodhte...”

“Njerëzit, qytetarët, hiqni kapelen me nderim për Lyudmila Slavovan. Ajo vdiq në lule të rinisë, vdiq për të gjithë ne që kemi jetuar mjaftueshëm për të shijuar lirinë dhe demokracinë për pak kohë,” tha Dr. Grozev, duke u bërë thirrje qytetarëve të sotëm bullgarë.

Kjo është pothuajse gjithçka që ka mbetur nga Lyudmila: fragmente kujtimesh të dëshmitarëve të rastit, shokëve dhe të afërmve, pjesë të pakta të provave në raportet e mjerueshme të informatorëve të Shërbimit Sekret të Shtetit të mbështjella nga propagandistët e shquar komunistë me lavdi hipokrite dhe një fotografi e zbehtë e një gruaje të re, të thjeshtë dhe njëkohësisht kaq e jashtëzakonshme, sytë e së cilës na shikojnë përgjatë viteve.

Lyudmila Slavova vdiq në moshën 35 vjeçare më 16 tetor 1948; vendi i varrit të saj nuk dihet. Atë kohë babai i saj, i zhveshur nga imuniteti i tij i deputetit, u arrestua, duke pritur dënimin së bashku me drejtuesit e fundit të Partisë Social-Demokrate që ishin gjallë. Më vonë ai u dënua me dhjetë vjet burg. Vëllai i saj Dimitar Slavov ishte në kampin e përqendrimit Kutsian kur mësoi për vdekjen çnjerëzore të motrës së tij më shumë se një vit pasi ajo kishte ndodhur. Duke u zhvendosur nga një kamp në tjetrin ai e mori lajmin nga një i njohur i rastësishëm, i cili u burgos pas vdekjes së saj.

Përveç Mara Racheva dhe Lyudmila Slavova, dhjetëra mijëra mbrojtës të tjerë të demokracisë në Bullgari u takuan me vdekjen në ndërtesën e errët që strehonte Drejtorinë e Milicisë Popullore në Lavov Most⁴ në Sofje. Sot, 23 vjet pas 1989, në atë ndërtesë nuk ka asnjë pllakë përkujtimore për ata heronj.

KONTRIBUT I QENDRËS HANNAH ARENDT – SOFJE




Ish Drejtoria e Milicisë Popullore në Sofje.

VASIL KADRINOV

⁴ Ura e luanëve [shënim i përkthyeses]

GEORGI MARKOV lindi më 1 mars 1929, në Knyazhevo, një rreth në Sofje. Në 1946 ai u diplomua në shkollë të mesme dhe shkoi në universitet për të studiuar kimi industriale. Ai punoi si inxhinier kimist dhe si mësues në një shkollë teknike. Ishte një shkrimtar i talentuar dhe shkroi disa novela, drama dhe koleksione tregimesh. Nga mesi i viteve 1960 ai u bë një autor i respektuar dhe i mirënjohur, por u bë gjithnjë e më i zhgënjyer me regjimin komunist, i cili censuroi çdo gjë që ai prodhoi. Ai emigroi në Londër dhe i komunikoi idetë e tij nëpërmjet programeve të radios në Shërbimin Botëror të BBC, Radio Europa e Lirë dhe Deutsche Welle. Kritikkat e tyre ndaj qeverisë komuniste e bënë Markov edhe më shumë armik me regjimin. Më 7 shtator 1978 ai u qëllua me një plumb të helmuar i shkrepur nga një ombrellë e modifikuar. Ai vdiq në spital katër ditë më vonë në moshën 49 vjeçare. Vrasja ishte kryer nga Sigurimi i Shtetit Komunist Bullgar me mbështetjen e KGB.



AGJENCIA TELEGRAFE
BULLGARE

Georgi Markov

Zëri i Bullgarisë

shkruar nga Gillian Purves⁵

NJË SHKRIMTAR

Georgi Markov lindi më 1 mars 1929 në Sofie. Ai u diplomua në shkollë të mesme në 1946 dhe shkoi në universitet për të studiuar kimi industriale. Ai punoi si inxhinier kimist dhe si mësues në një shkollë teknike. Në moshën 19 vjeç ai u sëmur nga tuberkulozi dhe shpesh shtrohej në spital. Përpjekjet e tij të para në letërsi, i bëri gjatë kohës që ishte sëmurë. Romani i tij i parë “Nata e Celsius” u shfaq në 1957. Romani “Fituesit Ajax” (1959) dhe dy koleksione tregimesh të shkurtra (1961) pasuan më vonë. Në 1962 Markov botoi romanin Burrat, i cili fitoi çmimin vjetor të Bashkimit të Shkrimtarëve Bullgarë. Në atë moment Georgi Markov filloi të punojë për shtëpinë botuese Narodna Mladezh. Koleksionet e tij me tregime “Një Portret i Kopjes Time” (1966) dhe “Gratë e Varshavës” (1968) i siguruan vendin si një nga shkrimtarët e rinj më të talentuar në Bullgari. Nga mesi i viteve 1960 ai ishte një autor i njohur dhe i respektuar. Gjatë asaj kohe ai u gjykua nga zyrtarë të lartë të komunizmit dhe u prezantua me diktatorin komunist Todor Zhivkov. Megjithatë, përpjekja për ta zgjedhur krahas të tjerëve, dështoi. Gjendja që përshkonte shkrimet e tij u errësua edhe më tepër dhe shumë nga rreshtat rreth komplotit që ai shkroi mund të lexoheshin si kritika të fshehura në hollësi për sistemin komunist. Ai e kishte gjithnjë e më të vështirë të përballej me censurën e përhapur atë kohë. Markov gjithashtu shkroi një numër dramash por shumica e tyre nuk u vunë në skenë ose u hoqën nga repertori i teatrit nga censorët komunistë. Romani i tij “Çatia” u ndalua në mes të printimit pasi përshkroi në mënyrë faktike dhe alegorike shembjen e çatisë të Mullirit të Çeliktë të Leninit. Në atë pikë, Markov ishte plotësisht i zhgënjyer nga regjimi.

EMIGRIMI JASHTË

Më 1969 ai u transferua për t’u bashkuar me vëllain në Bolonja, Itali. Kur qeveria bullgare refuzoi të

⁵ Burime të përdorura: Georgi Markov, Biografia, bulgaria.globalmuseumoncommunism.org. Hristo Hristov: Kush ishte Georgi Markov dhe Vrasja e Tij, hristo-hristov.com; Richard H. Cummings: Kush e Vrau Endacakun? Vrasja në 1978 e Georgi Markov Mbetet e Pazgjidhur, 9/9/2011, coldwarradios.blogspot.com.

zgjaste afatin e pashaportës së tij në vitin 1971 Markov u zhvendos në Londër ku mësoi anglisht dhe filloi të punonte për seksionin bullgar të Shërbimit Botëror të BBC. Ai më vonë u bë gjithashtu gazetar i transmetimit të pavarur për Radion Europa e Lirë dhe Deutsche Welle, shërbimi ndërkombëtar gjerman i transmetimit. Markov filloi transmetimin në Radio Europa e Lirë më 8 qershor 1975 me një program të titulluar Borxhet e Letërsisë Bashkëkohore Bullgare dhe transmetimet kryesore të së Dielës në mbrëmje tërheqnin një numër të madh dëgjuesish në Bullgari.

Në 1972, Markov u dënua në mungesë nga një gjykatë Komuniste Bullgare me gjashtë vjet e gjashtë muaj burg për "bashkëpunimin e tij me organizata të huaja që vepronin kundër Republikës Popullore të Bullgarisë (PRB)" dhe për "komentimet dhe esetë e tij në Radio Deutsche Welle kundër rendit shtetëror në PRB..."

Të gjitha gjurmët e punës së Markov u spastruan nga jeta publike në Bullgari. Veprat e tij u hoqën nga bibliotekat dhe librarit dhe mediat zyrtare bullgare nuk i referoheshin më punimeve të tij deri në 1989. Sigurimi i shtetit komunist bullgar *Durzhavna Sigurnist* hapi dosje hetimi mbi Markov me emrin e koduar "Endacaku".

Në 1975, Markov u martua me Annabel Dilke dhe pas një viti lindi vajza e tyre Alexandra-Raina. Në 1974 shfaqja e tij "Të Zvarritesh Nën Ylber" u vu në skenë në Londër, ndërsa shfaqja "Kryeëngjëlli Michael", e shkruar në anglisht, fitoi çmimin e parë në Festivalin e Edinburgut. Romani "Shimpanzeja e Drejtë e Nderuar", me bashkautor David Phillips, u botua pas vdekjes së tij. Midis 1975 dhe 1978 Markov punoi në "Raporte në Mungesë" për Bullgarinë, i cili analizoi jetën në Bullgarinë Komuniste. Ato transmetoheshin çdo javë në Radion Europa e Lirë. Kritikkat e tyre ndaj qeverisë komuniste dhe diktatorit komunist Todor Zhivkov e etiketuan personalisht Markovin edhe më shumë si armik të regjimit.

NJË ARMIK I REGJIMIT

Sipas ish-gjeneralit të KGB, Oleg Kalugin, në qershor 1977, diktatori komunist bullgar Zhivkov kryesoi takimin e Byrosë Politike në të cilën deklaroi se dëshironte t'i jepte fund aktiviteteve të Markov. Në fillim të vitit 1978, Ministri i Brendshëm Dimitar Stoyanov kërkoi ndihmën e KGB për vrasjen e Markov. Ai donte që Markov të vritej në një mënyrë që mos të lindnin dyshime për përfshirjen e Bullgarisë.

Kryetari i KGB, Yuri Andropov, ra dakord të ndihmonte për vrasjen, për sa kohë që nuk do të kishte asnjë dyshim për ndërhyrjen e Sovjetikëve.

Ish-gjenerali i KGB, Oleg Kalugin, shkruan⁶:

"Takimi në të cilin u ngrit çështja e vrasjes së Georgi Markov u mbajt në zyrën e madhe të Andropov, në Lyubyanka. Të pranishëm ishin Andropov, Kryuchkov, kundër admiralit Michail Usatov - zëvendësi i parë i shefit të

⁶ Oleg Kalugin dhe Fen Montaigne: Kryespiuni: Oficeri me gradën më të lartë të KGB që ka thyer heshtjen, Publikimet Blake Ltd., 1995.

inteligjencës dhe unë. Pasi diskutoi disa çështje të tjera, Kryuchkov mori fjalën.

‘Ne kemi marrë një kërkesë nga ministri bullgar i punëve të brendshme Stoyanov për t’i ndihmuar ata të merren me një nga kundërshtarët e regjimit, i cili jetonte në Londër – shkrimtari Markov’, tha Kryuchkov. ‘Ata duan ndihmë për zhdukjen fizike të Markovit. Kjo kërkesë është bërë nga shoku Stoyanov, por që vjen nga vetë presindeti Zhikov.’

Ne qëndruam në heshtje për disa sekonda. Nuk do ta harroj kurrë eufemizmin e pastër që Kryuchkov përdori për vrasjen e Markov – ‘zhdukjen fizike’... Ndjeva të më kalonin të dridhura në shpinë dhe pastaj mendova: ‘Në drejt me këta bullgarë. Ata mund të bëjnë çfarë të duan me kundërshtarët e tyre politikë. Pse po na fusin edhe neve në këtë mesele?’

Andropov gjithashtu u befasua. Ai u ngrit me shpejtësi nga tavolina dhe filloi të ecte nervoz para dhe mbrapa. Kryetari, me sa duket, ishte i humbur në mendime për disa sekonda, atëherë ai tha: ‘Unë jam kundër vrasjeve politike. Nuk mendoj se kjo është mënyra e duhur për tu marrë me këto probleme. Koha kur gjëra të tilla bëheshin pa u ndëshkuar ka ikur qëkur. Ne nuk mund të kthehemi te skemat e vjetra. Unë jam vërtet kundër.’ Kishte përsëri heshtje, përveç zhurmës së trafikut në Sheshin Dzerzhinsky. Kryuchkov më në fund foli përsëri.

‘Por shoku Andropov,’ tha Kryuchkov⁷. ‘Kjo është një kërkesë personale nga shoku Zhivkov. Nëse ia refuzoni ndihmën, Zhivkov mund të mendojë se shoku Stoyanov ka humbur besimin tonë ose reputacioni i vetë atij në sytë e sovjetikëve është njetosur. Shoku Zhivkov mund ta marrë këtë si një shenjë se ne jemi duke u distancuar prej tij. E përsëris: Kjo është një kërkesë personale nga Zhivkov. Ne duhet të merremi disi me problemin. ’

Andropov vazhdoi të ecte përreth dhomës.

‘Mirë, mirë’, tha ai, duke ndalur papritmas. ‘Por nuk duhet të ketë ndonjë përfshirje të drejtpërdrejtë nga ana jonë. Jepuni bullgarëve gjithçka që u nevojitet, tregojuni se si ta përdorin atë dhe dërgoni dikë në Sofje për të stërvitur njerëzit e tyre. Por kjo është e gjitha. Asnjë ndërhyrje të drejtpërdrejtë. Nuk do të lejoj asgjë më shumë se kaq...’

Atentati i parë ndodhi në Mynih në pranverën e 1978 kur Markov vizitoi miqtë dhe kolegët në Radion Europa e Lirë. U organizua një komplot për të helmuar pijen e tij në një darkë festive. Megjithatë, pasi vëllai i Markov u paralajmërua për planin, Georgi Markov e anuloi udhëtimin e tij. Përpjekja e dytë e dështuar do të bëhej në ishullin italian të Sardenjës, ndërsa Markov shijonte një pushim veror me gruan e tij Annabel dhe vajzën Alexandra. Me sa duket agjentët vendosën të mos vepronin nga frika se gruaja ose vajza e tij do të bëheshin viktime kolaterale.

ÇADRA E HELMUAR

Përpjekja e përfundimtare dhe e suksesshme u bë në Londër, në ditëlindjen e diktatorit Zhivkov më 7 shtator 1978. Atë ditë, Markov punoi dy turne në BBC. Pasi mbaroi turnin herët në mëngjes, thuhet se ai

⁷ Kryuchkov më vonë drejtoi një grusht shteti kundër Gorbachev.

shkoi në shtëpi për të ngrënë. Më vonë, ai shkoi drejt një parkingu në pjesën jugore të Urës Waterloo, si pjesë rutinës së tij. Ai parkoi makinën pranë urës dhe rreth orës 2 pasdite ngjiti shkallët lart deri tek ura. Ndërsa i afrohej rradhës që priste autobuzin, papritur ai ndjeu një dhimbje therëse në pjesën e prapme të kofshës së djathtë. Ai u kthye dhe pa një burrë që po përkulej për të marrë çadrën e rrëzuar.

TRANSMETIMET E RADIO SË HUAJ NË BLLOKUN KOMUNIST

Radio u bë shumë shpejt një mjet i rëndësishëm i propagandës pas Luftës së Parë Botërore. Gjatë Luftës së Dytë Botërore të gjitha partitë u përpoqën të ndikonin jo vetëm popullin, por edhe ushtarët e armiqve nëpërmjet transmetimit në radio. Në disa raste u konfiskuan të gjithë aparatat marrëse të radiove private dhe për përhapjen e informacionit mbeti vetëm rrjeti publik i transmetimit i bazuar në altoparlantë në rrugë dhe në institucione publike. Dëgjimi i fshehtë i radiove të huaja u ndëshkua ashpër nga sovjetikët dhe gjithashtu nga nazistët, por praktikohesh masivisht nga populli. Gjatë Luftës së Ftohtë, transmetimet e jashtme të radios me valë të shkurtër AM vazhduan të ishin një burim i rëndësishëm informacioni për qytetarët e vendeve komuniste për jetën në botën e lirë demokratike, si dhe për disidentët dhe aktivitetet kundër-regjimit në vendet e veta. Të gjithë transmetuesit publik të vendeve kryesore të Europës Perëndimore (BBC, Deutsche Welle, Radio Franca), por edhe Radio Vatikani, kishin programe të veçanta në shumë gjuhë të huaja, të drejtuara posaçërisht për vendet e Bllokut Lindor dhe gjithashtu për Azinë dhe Afrikën. Personeli zakonisht përbëhej nga emigrantë politikë nga vendet përkatëse. Autoritetet komuniste u përpoqën të "interferonin" me qëllim këto transmetime duke transmetuar zhurma ndërhyrëse në të njëjtat frekuenca, gjë që e bënte dëgjimin më të komplikuar. Radiostacionet më të njohura jashtë shtetit, të financuara nga buxheti federal i SHBA, ishin Zëri i Amerikës dhe Radio Freedom / Radio Europa e Lirë.

KUTI NJOFTIMI

Burri, i cili po kthehej nga Markov, tha fjalën "më fal" me një theks të huaj dhe u fut në një taksi. Burri nuk u identifikua kurrë dhe vetë Georgi Markov është dëshmitari i vetëm i njohur për këtë ngjarje. Edhe pse kishte ca dhimbje, Markov vazhdoi rrugën për në ndërtesën e BBC. Ai më pas vuri re një njollë të vogël gjaku në pantallonat e tij dhe u tregoi kolegëve çfarë i ndodhi në Urën Waterloo. Ai i tregoi një të njohuri një ënjtje të vogël të kuqe në kofshë. Sidoqoftë, ai punoi deri në fund të turnit të tij në radio dhe shkoi në shtëpi atë natë si zakonisht. Gjatë natës Markov i filloi temperaturë e lartë dhe nuk ishte në gjendje të paraqitej në punë të nesërmen.

Temperatura u përkeqësu dhe mbrëmjen tjetër Markov u dërgua në Spitalin St. James të Londrës, ku mjekët e mjekuan për një formë të papërcaktuar të helmimit të gjakut. Megjithatë ai nuk reagoi nga trajtimi mjekësor, pas disa ditësh dhimbjeje dhe deliri, Georgi Markov vdiq në moshën 49 vjeç në Londër më 11 shtator 1978.

Me sa duket, laboratorit sekret i fshehtë i KGB i njohur si "Dhoma" zhvilloi si armën e fshehur në një çadër të prodhuar nga SH.B.A., ashtu edhe plumbin/saçmën prej platin-iridiumi të veshur me dyll në madhësinë e një koke gjilpëre të mbushur me biotoksinën vdekjeprurëse ricin.

Varri i Markov ndodhet në një oborr të vogël kishe në Dorset, Angli. Raportet Në Mungesë të tij u botuan në Bullgari në 1990, pas rënies së qeverisë Komuniste. Në 2000, Markov iu dha pas vdekjes nderi më prestigjioz i Bullgarisë, Urdhri i Stara Planina, për "kontributin e tij të rëndësishëm në letërsinë bullgare, dramën dhe ngjarjet jo-trilluese dhe për pozicionin e tij të jashtëzakonshëm civil dhe përballjen me regjimin Komunist".

Georgi Markov ishte një shkrimtar që luftoi kundër totalitarizmit në Europë përmes eseve të tij dhe mënyra më e mirë për ta kuptuar atë dhe jetën e tij është leximi i veprave të tij. Këtu paraqesim esenë e tij Fashizmi Ynë, të cilin ai e lexoi në Radion Deutsche Welle.

FASHIZMI I VETVETES TONË

shkruar nga Georgi Markov (i shkurtuar)

Duket se ne kemi krijuar një rregull të përshtatshëm për të fajësuar vetëm rendin publik, sistemet, ideologjitë ose individët që qeverisin njerëzit për problemet tona. Shpesh dhe pa hezitim ne i japim vetes të drejta më të drejta se nga të gjithë gjyqtarët dhe, duke qenë të privuar nga sensi i humorit, e vendosim "veten" tonë jashtë planetit. Dhe, sigurisht, ne jemi aq fisnikë sa të harrojmë pjesëmarrjen tonë në ekzekutimin e shkeljeve, mëkateve ose krimeve që gjykojmë. Ne me kënaqësi gjykojmë gjithëkënd, përveç vetvetes. Të gjithë do të thoshim se ky është një nga mëkatet më njerëzore, sepse është tipik për të gjithë.

Megjithatë, filloj me këtë jo sepse dua të justifikoj ekzistencën e sistemeve publike të korruptuara, ideologjive dhe udhëheqësve, por sepse dua të kuptoj qëllimin e fajit tonë, qëllimi i asaj që ushqen në të vërtetë, mbështet dhe ruan në mënyrë të qëndrueshme padrejtësinë publike. Kjo është një çështje po aq e vjetër sa bota. Shumë herë shumë njerëz e kanë pyetur veten: "A është e vërtetë që vetëm format publike të fashizmit ishin arsyeja e shqetësimeve të miliona njerëzve?" Shumë herë shumë njerëz e kanë pyetur veten: "A është e vërtetë që vetëm ideologjia komuniste është arsyeja e shqetësimeve të miliona njerëzve të tjerë?"; "A ishin Stalini dhe Beriya të vetmit përgjegjës?" Dhe, sigurisht, përgjigja e deritanishme është një "JO VETËM" e madhe.

Më lejoni të them së pari se në këtë linjë mendimesh nuk bëj dallimin midis fashizmit dhe komunizmit. Po përdor termin "fashizëm" si historikisht më të qartë dhe specifik, pa hijeshinë iluzionare të fjalës "komunizëm". Të dyja shprehin në të njëjtin nivel refuzimin e njerëzimit që të kenë fytyrën e vet, karakterin e vet, personalitetin e vet, refuzimin e njerëzve për të qenë vetvetja duke u kthyer në një pjesë pa formë të tufës së dikujt me mendimin e tufës, zërin e tufës, llojin e tufës. Për mua nuk ka absolutisht asnjë rëndësi se në emër të kujt një individ shndërrohet në një anëtar të tufës - qoftë në emër të një kombi të madh, apo në emër të një imagjinate, një të ardhme të lumtur.

Por, para se të shkojmë tek tufa, le të shohim se çfarë e formoi atë në të vërtetë dhe çfarë nuk është jashtë ideologjisë ose personalitetit të pranuar, d.m.th. [saktësisht] FASHIZIMI I VETVETES TONË. Le të shohim vetveten, të studiojmë rrënjët dhe të shohim në thellësitë e tyre.

Ndoshta shenja e parë e fashizmit tonë është refuzimi për të njohur ekzistencën e njerëzve të tjerë që kanë të drejta të barabarta, vlera të barabarta dhe të pavarur nga ne. Vetë fashizmi ynë fillon nga momenti

⁷ Lavrentiy Beriya, Chief of Soviet security and the secret police under Joseph Stalin during World War II

i ndjenjës së këndshme që unë jam dikush më shumë sesa personi para meje, nga arbitrariteti dhe disa herë instikti i papërmbytur se qënia ime është më e kuptimplotë sesa e tij/saj. Dhe pothuajse menjëherë instikti tjetër - të tregoj epërsinë time duke realizuar çdo lloj nënshtrimi të personit tjetër. Pra, një nga burimet origjinale të fashizmit tonë është kjo uri e pakufizuar për të qenë më shumë se të tjerët.

Të gjithë mund ta shohin që ideologjia komuniste dhe të gjitha veprimet e komunizmit janë arsye të veçanta për zhvillimin në nivelin më të lartë të mundshëm të kësaj origjine të tmerrshme të fashizmit tonë. Teoria e luftës së klasave, marksizmi në përgjithësi, ajo që quhet leninizëm, nuk është asgjë tjetër përveç se zhvillimi ideologjik i fashizmit tonë.

Për shkak se refuzimi për të njohur barazinë dhe pavarësinë e njerëzve të tjerë çon në fillimin e dytë të fashizmit tonë - refuzimi për të kuptuar të tjerët. Ne jemi të detyruar t'i shohim ato vetëm përmes formave të ngushta të epërsisë sonë. Ne mbyllim të gjitha rrugët dhe mënyrat e kontaktit të vërtetë me të tjerët dhe analizojmë të gjitha mesazhet përmes censurës së epërsisë sonë. Ne themi "Ai/ajo është i/e tillë dhe i/e këtillë" dhe e trajtojmë atë si "të tillë dhe të këtillë" që zakonisht është shumë larg nga çfarë është



Georgi Markov me të bijën Alexandra-raina dhe bashkëshorten Annabel.

KOLEKSION I FAMILJES MARKOV

në të vërtetë "ai/ajo". Ne refuzojmë të kuptojmë të gjitha motivet, arsyet, hapat, ndjenjat, veprimet që nuk korrespondojnë me idenë tonë për "këtë".

Gjithashtu, të mos harrojmë se natyra e "kësaj" vjen nga origjina e parë e fashizmit tonë - domethënë që ai/ajo nuk ka as të drejta të barabarta, as vlerë të barabartë, as pavarësi nga ne. Epërsia jonë është verbëria jonë. Ne nuk duam të shohim fytyrën e vërtetë të personit para nesh dhe gjithashtu nuk duam të kuptojmë të vërtetën që qëndron në origjinalitetin unik të tij/saj. Sepse çdo njeri është unik dhe origjinal. Ne komunikojmë vetëm me atë pjesë të tij/saj që i përshtatet epërsisë sonë. Në këtë

mënyrë, ne kemi mangësi të të kuptuarit qartësisht dhe plotësisht të personit para nesh, ne insistojmë me fanatizëm se mendimi dhe gjykimi ynë është i vetmi i duhur. Besoj se nuk duhet t'i përmend shembujt e habitshëm të dukshëm të realitetit bullgar, duke ilustruar përmasat e mëdha të fashizmit tonë, të rrënjësura thellë në pothuajse të gjitha marrëdhëniet tona.

Mangësia jonë e të kuptuarit të të tjerëve na privon nga aftësia për të vendosur kontakte të vërteta, na privon nga elementët më të çmuar të komunikimit njerëzor - dashuria, falja, bujaria, justifikimi...

...Fashizmi ynë - këto janë shpirtrat djallëzorë brenda; kjo është ndoshta ajo që të gjitha fetë e quajnë Djalli. Dhe tani më lejoni të theksoj një pikë shumë të rëndësishme: ndërsa mohoj të drejtën e njerëzve të tjerë për pavarësi, fashizmi ynë gjithashtu na mohon të drejtën tonë për pavarësi. Kjo është ajo që na kthen

nga individë të lirë në anëtarë të tufave të ndryshme.

Gjithmonë më ka hutuar fakti që miliona individë e pranojnë idenë për t'u bërë pjesë e një tufe dhe vullnetarisht, shpesh me entuziazëm, bëhen anëtarë fanatikë të asaj tufës. Pse? Çfarë i bën ata të heqin dorë nga liria e tyre dhe të pranojnë me nënshtrim dhe gjuhëzime një vend në tufë? A nuk është e palogjikshme që ata mohojnë barazinë dhe pavarësinë e individëve të tjerë, por njohin tufën? Ndoshta pikërisht sepse askush nuk është i lirë tek tufa, sepse garanton siguri, mbrojtje dhe mbështetje. Përveç kësaj, marrëdhëniet në tufë korrespondojnë mundësisht me fashizmin tonë që vjen nga brenda. Çështjet mbi zhvillimin profesional, lufta për të fituar, bërja e miqve ose armiqve, përmbushja e ambicieve dhe kotësisë - e gjithë kjo lulëzon vetëm në atmosferën e tufës, pa marrë parasysh nëse është më shumë ose më pak demokratike. Tufa ndrydh personalitetin e lindur shpirtëror të anëtarëve të saj në një shkallë përfundimtare, heq rrobat e tyre me shumë ngjyra dhe i vesh me uniforma, duke u dhënë në këmbim mbështetjen e saj dhe triumfin e fashizmit tonë - që ti ose unë i përkasim jo vetvetes por tufës dhe udhëheqësve të saj. Fashizmi ynë kulmon në mohimin e plotë të personalitetit tonë njerëzor...

...Duke u hequr personalitetin, tufa ju ofron një numër lehtësimesh. Së pari, nuk ke për të menduar asgjë, është dikush që mendon për ty. Së dyti, tufa ka një të vërtetë - të vërtetën e shumicës, pa marrë parasysh nëse kjo shumicë është vërtetë apo e trilluar. Së treti, tufa nuk toleron përjashtime - përpjekjet për t'u ndarë prej saj quhen tradhëti ose pabesi. Përpjekjet për të mos blegërirë kolektivisht, por për të shprehur zërin tuaj quhen individualizëm dhe ndëshkohen. Së katërti, tufa drejtohet nga bariu dhe askush nuk ka të drejtë të diskutojë drejtimin ku ai e udhëheq tufën, përndryshe do kenë punë me qentë. Së pesti, tufa kërkon nënshtrim të pakushtëzuar. Së gjashti, tufa kërkon shërbim... është e mundur të renditim shumë karakteristika të tjera tipike të tufës, por tema ime është fashizmi ynë vetjak, ose më mirë, dëshira e mundshme e shumë njerëzve që t'i përkasin një tufe...

...Fashizmi ynë është në qendër jo vetëm të marrëdhënieve tona shoqërore, por kryesisht në marrëdhëniet tona personale. Ai është shumë më serioz dhe i tmerrshëm kur përfshin bashkëshortët, fëmijët, miqtë, të afërmit.

Ideologjia, mëkatarët në pushtet dhe ngjarjet dramatike janë e vetmja arsye për manifestimin e fashizmit tonë, ashtu si Stalini nuk ishte thjesht një vrasës, por më saktë një arsye për njerëzit e fiksuar nga fashizmi i tyre për të vrarë njerëz të tjerë. Dhe së fundmi, ka diçka që nuk duhet ta lë pa përmendur. Fashizmi ynë është ai që ofron me mëshirë transferimin e përgjegjësinë personale të veprimimeve tona tek masa e tufës. Por le të mos mashtrojmë veten. Tufat janë të papërgjegjshme dhe përgjegjësia e anëtarëve të tyre do të mbetet përgjithmonë personale, individuale. Fashizmi ynë është drama jonë më e tmerrshme...

□ LEXIM I MËTEJSHËM: GEORGI MARKOV: E VËRTETA QË VRET, TICKONR & FIELDS, 1984.

KONTRIBUT I QENDRËS HANNAH ARENDT - SOFJE

MOLDAVIA

REGJIMI KOMUNIST

Gjatë 1918-1940 Moldavia Lindore, Besarabia, i përkiste Rumanisë. Në vitin 1924 Republika Autonome Socialiste e Moldavisë (ASSR) u formua në bregun lindor të lumit Dniestr në Bashkimin Sovjetik. Sipas protokollit sekret të paktit Molotov-Ribbentrop të 23 gushtit 1939, Besarabia ra nën "sferën e ndikimit" sovjetik dhe u pushtua nga Ushtria e Kuqe në fund të qershorit 1940. SSR moldave u krijua nga Besarabia dhe ASSR moldave. Sovjetizimi i detyruar filloi menjëherë në ish-Besarabinë, duke arritur kulmin në një dëbim masiv në qershor 1941.

REGJIMI PRO-NAZIST

Rumania pushtoi Moldavinë përsëri në verën e 1941. Vetëm rreth 10% e hebrenjve të Besarabisë nën qeverisjen rumune i mbijetuan holokaustit. Më shumë se 2,000 romë vendas u dëbuan; gjysma e tyre vdiqën nga kushtet çnjerëzore. Më shumë se 20,000 burra nga Moldavia shërbyen në ushtrinë rumune.

REGJIMI KOMUNIST

Bashkimi Sovjetik ripushtoi territorin e Moldavisë së sotme në mars 1944. Sovjetizimi dhe shtypjet sovjetike vazhduan me dëbime masive në korrik 1949 dhe prill 1951. Një uri masive gjatë 1946-1947 vrau 150,000 deri 200,000 njerëz. Pas vdekjes së Stalinit arrestimet politike u lehtësuan, por regjimi mbeti shtypës deri në shpërbërjen e bashkimit sovjetik. Moldavia deklaroi pavarësinë e saj në gusht 1991.



AGLAIA ARAPU was lindi më 1935 në një familje rome në fshatin Ursari, Republika e Moldavisë. Ajo u dëbua në Transnistri në nëntor 1942 si pjesë e një përpjekjeje të bashkërenduar për të zhdukur të gjithë fshatin, i cili kishte një popullsi kryesisht rome. Kushtet ishin aq të vështira sa, nga një total prej 25,000 romësh rumunë të dëbuar në Transnistri, 11,000 vdiqën atje. Pas 1944, kur ushtria gjermane dhe rumune u tërhoqën nga Transnistria dhe Besarabia, romët që mbijetuan u kthyen në shtëpitë e tyre. Nga fshati i Aglaia ishin vetëm rreth një në katër. Sot Aglaia Arapu është e mbijetuara e vetme e komunitetit rom që u dëbua nga Ursari në vitin 1942.



LUKÁŠ HOUDEK

Aglaia Arapu

Një i mbijetuar i vetëm

shkruar nga Igor Casu, Ph.D.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kombet e Aksit ndoqën një politikë të pastrimit racor në territoret e tyre. Rumania nuk bënte përjashtim në këtë kuptim¹. Një nga grupet më të njohura etnike dhe racore - përveç hebrenjve - të shënjestruar në këtë proces të pastrimit racor – ishin ciganët ose pakica rome. Dëbimet e romëve filluan në nëntor 1942. Ky proces preku komunitetet rome nomade dhe ato të vendosura. Në përgjithësi, rreth 25,000 Romë u dëbuan nga Rumania në Transnistri, duke përfshirë burra, gra, pleq dhe fëmijë. Nga ky numër, anëtarët e komunitetit rom Bessarabian numëronin 2,237 (114 persona nga romët nomadë dhe 2,123 nga komunitetet rome të vendosura).

Një nga viktimat e politikës racore rumune gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte Aglaia Arapu, e lindur në 1935 në fshatin Ursari, ish Qarku Lăpușna, tani në rrethin e Călărași, Republika e Moldavisë. Në një intervistë dhënë më 2007 për studiuesit moldav, Ion Duminica dhe Tatiana Sîrbu, Aglaia Arapu tregoi historinë e saj sesi kur ishte një fëmijë u dëbua në Transnistri në nëntor 1942. Ajo kujtoi se dëbimi i romëve nga Ursari ishte planifikuar të ndodhte në dy faza të dallueshme me qëllimin përfundimtar të shkatërrimit të të gjithë fshatit në të cilin ata formuan një shumicë absolute. Sipas Aglaia Arapu, dy fazat e dëbimit korrespondonin me dy listat e personave që do të dëboheshin të bëra nga Samuilă Arapu, vetë një rom nga fshati.

Romët që duhej të dëboheshin më vonë, në fazën e dytë në 1943, ishin ata që i paguanin një shumë të caktuar parash Samuilă Arapu. Ata që nuk paguanin u dëbuan në vitin 1942, Aglaia ishte mes tyre. Faza e dytë e dëbimit nuk u zhvillua më 1943; ajo u anulua nga autoritetet rumune në kontekstin e humbjeve të shkaktuara ushtrisë gjermane në frontin lindor. Sa i përket qëndrimit të moldavëve/ rumunëve etnikë fqinjë ndaj dëbimit të Romëve, Aglaia tha se njerëzit ishin të kënaqur që në këtë mënyrë toka dhe prona e romëve do të bëheshin të tyre.

Romët e dëbuar në Transnistria jetonin në vende të veçanta, zakonisht punonin në fermat kolektive

¹ Pjesa më e madhe e territorit të sotëm të Republikës së Moldavisë - Besarabia - ishte një pjesë e Rumanisë në atë kohë; dhe Transnistria - një pjesë e vogël e së cilës është gjithashtu pjesë e Moldavisë tani - është territori midis lumenjve Bug dhe Dniester dhe ishte në atë kohë nën administrimin civil të Rumanisë dhe të ushtrisë gjermane.

bujqësore të rajonit. Ata paguheshin shumë pak, ushqeheshin pamjaftueshëm dhe jetonin në kushte shumë të këqija higjienike. Nga 25,000 – numri total i romëve të Rumanisë të dëbuar në Transnistri - 11,000 vdiqën atje për arsye të ndryshme - ushqim i keq, ftohje, epidemi dhe arsye të tjera. Aglaia Arapu tregoi një histori mbresëlënëse rreth mënyrës se si u trajtuan romët në Transnistri.

DJALLI MBI KALIN E BARDHË

Një ditë, një oficer rumun duke ngarë një kalë të bardhë erdhi në barakat ku jetonin romët e dëbuar. Në fillim, romët menduan se ai kishte ardhur për të organizuar ekzekutimin e tyre masiv siç ndodhte zakonisht me hebrenjtë dhe disa prej tyre filluan të qanin. Në vend të kësaj, oficeri i çoi në një banjë publike. Gëzimi i Romëve ishte i pamasë, pasi ata nuk kishin patur mundësinë të bënin një banjë të ngrohtë qysh kur ishin dëbuar në Transnistri (një vit e gjysmë më parë). Ata i lanë rrobat mënjane dhe hynë në banjën publike, por u habitën që kur dolën, rrobat ishin zhdukur. Ngaqë ishte dimër, një numër i madh romësh vdiqën nga të ftohtit. Të mbijetuarit ishin ata më rezistentët që arritën të vraponin shpejt dhe të arrinin në fshatrat fqinje. Midis tyre ishte Aglaia Arapu, asokohe 9 vjeçe.

PORAJMOS – PERSEKUTIMI I ROMËVE NË EUROPË GJATË LUFTËS II BOTËRORE

Termi Porajmos (shkruhet gjithashtu Porrajmos ose Pharrajmos) vjen nga gjuha rome ku fillimisht do të thoshte konsumim ose shkatërrim. Në kuptimin figurativ përdoret për t'iu referuar shfarosjes së romëve gjatë Luftës së Dytë Botërore nga Gjermania naziste, Kroacia Ustasha dhe Hungaria Horthy dhe aleatët e tyre. Përndjekja ndaj romëve ishte një vazhdim i shtypjes së paraardhësve të tyre në shekujt e hershëm, e cili mori formë të ndryshme. Këto varionin nga ndalimet për të bërë një jetë nomade dhe nga kriminalizimi në përjashtimin e tyre nga hapësirat publike. Pas ngritjes së nazistëve në pushtet në Gjermani, gradualisht u adoptuan disa dekrete në bazë të së cilave romët lokalë së pari u etiketuan si "të pashoqërueshëm" dhe së fundi si një grup i paracaktuar për "likuidim fizik". Në shtator 1935 romët, së bashku me hebrenjtë dhe njerëzit me origjinë afrikane, u quajtën së pari "njerëz jo-arianë" dhe ata u bënë qytetarë pa të drejta të plota politike. Bazuar në një dekret të datës 8 dhjetor 1938 mbi "luftën kundër kërcënimit cigan" listat e "ciganëve, gjysmë-ciganëve dhe personave që enden në mënyrë cigane" u përpunuan në territorin gjerman dhe më vonë në tokat e aneksuara. Këta njerëz u mblodhën në kampe pune pas të cilave shumica e tyre u dëbuan në kampe shfarosjeje. Vrasja e parë masive e romëve ndodhi në janar 1940, kur 250 fëmijë romë u vranë në Buchenwald. Numri i përgjithshëm i viktimave rome të regjimit nazist vlerësohet midis 220,000 dhe 500,000 viktimave me origjinë nga Gjermania dhe vendet e pushtuara nga ajo. Të paktën 90,000 romë të tjerë megjithatë, ranë viktimë të regjimit Ustashe në Kroaci dhe rreth 36,000 njerëz, përfshirë edhe njerëz nga Moldavia, ranë viktimë të regjimit pro-nazist në Rumanë. Për një kohë të gjatë, gjenocidit të romëve europianë nuk iu dha vëmendja e duhur dhe, deri më sot, ende nuk është bërë subjekt i kërkimeve historike të hollësishme. Praktikisht asnjë autor i këtyre krimeve nuk është ndëshkuar kurrë për to.

Pas 1944, kur ushtria gjermane dhe rumune u tërhoqën nga Transnistria dhe Besarabia, romët që mbijetuan u kthyen në shtëpitë e tyre. Vetëm një në katër romë nga Ursari mbijetuan dhe u kthyen në shtëpi. Sot Aglaia Arapu është e mbijetuara e vetme e komunitetit Rom të dëbuar nga fshati Ursari në 1942.

Historia e Aglaia Arapu është e rëndësishme sepse në Europë sot dihet shumë pak për fatin e komunitetit Rom gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kjo na tregon historinë e njerëzve që u dëbuan dhe jetuan në kushte çnjerëzore, thjesht sepse ata i përkisnin një grupi të caktuar etnik dhe racor. Detyra jonë është të mbajmë gjallë kujtimin e këtyre njerëzve të pafajshëm dhe të ndihmojmë pakicën rome që të integrohet në shoqëritë në të cilat jetojnë, pasi shumë shpesh ata trajtohen ende keq në Europë edhe sot.

KONTRIBUT I QENDRËS PËR STUDIMIN E TOTALITARIZMIT

GHEORGHE DAVID lindi më 1943 në fshatin Pepeni, në rrethin e Sângerei (ish Lazovsk). Në 1970, ai u diplomua në Institutin Politeknik me bazë në Chişinău. Nga 1970 deri në 1979, David punoi si inxhinier për organizata të ndryshme dhe ishte shumë i vlerësuar në fushën e tij. Gjatë viteve 1970 deri në fillim të viteve 1980, Gheorghe David shprehu hapur pikëpamjet e tij për natyrën e sistemit komunist, duke shkruar letra kritike për politikanë të ndryshëm. Ai u arrestua përfundimisht më 1 gusht 1986 gjatë një udhëtimi pune dhe u dërgua në një spital psikiatrik në Dnepropetrovsk, Ukrainë, një vend që përdorej rregullisht për depozitimin e të burgosurve politik në Bashkimin Sovjetik. Ai u la i lirë më 1988 vetëm pas ndërhyrjeve të organizatave të huaja për të drejtat e njeriut. Vdiq më 2007, vetëm disa muaj para se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut të pranonte se ai ishte një viktimë e shtypjes së politikës komuniste dhe se psikiatria ishte përdorur në mënyrë të paligjshme kundër një personi të shëndetshëm.



CURAJ.NET

Gheorghe David

Viktimë e Mjekësisë Ndëshkuese

shkruar nga Igor Casu, Ph.D.

Regjimi komunist persekutoi miliona njerëz duke përdorur metoda të ndryshme, përfshirë dëbimin masiv, ekzekutimet e përmbledhura dhe urinë masive. Vetëm në ish-Republikën Socialiste Sovjetike të Moldavisë, regjimi Komunist Sovjetik dëboi më shumë se 130,000 njerëz që konsideroheshin të rrezikshëm për regjimin për shkak të klasës që ata i përkisnin, kombësisë ose arsimimit të tyre. Uria masive e organizuar në 1946-1947 solli një numër të vdekurish prej të paktën 150,000 njerëzish. Disa mijëra njerëz u ekzekutuan në 1940-1941 dhe 1944-1953.

E gjithë kjo ndodhi gjatë periudhës staliniste. Sidoqoftë, pak dihet që pas 1953 regjimi Sovjetik vazhdoi me politikën e tij shtypëse, megjithëse në një shkallë më të vogël. Nuk kishte dëbime masive, uri masive ose ekzekutime të përmbledhura, por grupe dhe individë të caktuar u dërguan në Gulag për arsye të ndryshme politike: kritikimi i monopolit të partisë Komuniste, diskriminimi bazuar në besnikërinë kombëtare, kushtet e këqija ekonomike, etj. Specifike për regjimin komunist post-stalinist në BS është se disa nga disidentët, si ata që kundërshtonin doktrinën dhe si ata që kundërshtonin klikën në pushtet, dërgoheshin në spitalet psikiatrike për t'u "shëruar" nga qëndrimet e tyre kritike ndaj regjimit. Konsiderohej se individët që shprehnin pakënaqësi ndaj komunizmit ishin të tjetërsuar mendërisht².

Rasti i parë i dokumentuar në territorin e Republikës së sotme të Moldavisë është ai i Alexei Sevastianov, një rus etnik i cili u dërgua në një spital psikiatrik më 1958 sepse dogji një foto të Nikita Hrushovit. Në Bashkimin Sovjetik, çështja më e rëndësishme dhe më e njohur e përdorimit të psikiatrisë kundër protestuesve politikë ishte ajo e Vladimir Bukovsky, i cili kaloi 12 vjet i burgosur midis viteve 1963 dhe 1976, përfshirë këtu edhe një *psikhushka* (spital psikiatrik). Ai emigroi në Perëndim më 1976 dhe u bë profesor në Universitetin e Kembrixhit.

KRITIKA NDAJ SHTETIT

Në ish-SSR Moldave, çështja më e njohur ishte ajo e Gheorghe David. Ai lindi më 1943 në fshatin Pepeni, rrethi i Sângerei (ish Lazovsk). Më 1970, u diplomua në Institutin Politeknik në Chişinău. Nga 1970

² Nikita Khrushchev, lideri sovjetik që filloi destalinizimin, e thënë në një fjalim publik në vitin 1959.

deri në 1979, David punoi si inxhinier për organizata të ndryshme dhe ishte shumë i vlerësuar në fushën e tij. Në fillim të viteve 1970, Gheorghe David shprehu hapur pikëpamjet e tij mbi natyrën e sistemit komunist dhe mbi mënyrën se si u krijua shteti sovjetik. Më saktësisht, ai vuri në pikëpyetje mitin kryesor të regjimit, që BS ishte krijuar gjoja nga vullneti i lirë i njerëzve. Gheorghe David kritikoi gjithashtu vendimin për të pushtuar Çekoslovakinë në 1968.

Si pasojë, më 1974, ai u thirr nga KGB dhe u paralajmërua se do të ndëshkohej në përputhje me Kodin Penal nëse "e përsëriste". Përpjekja për ta frikësuar atë nga organet shtypëse Sovjetike dështoi dhe në 1982, menjëherë pas vdekjes së Brezhnev³, Davidi dërgoi një letër Presidiumit të Sovjetikëve Suprem të BS (Parlamenti Sovjetik), duke argumentuar se situata katastrofike shoqërore dhe ekonomike në Bashkimi Sovjetik, në përgjithësi, dhe SSR Moldave, në veçanti, u krijua nga shpenzime shumë të mëdha në sektorin ushtarak. Gheorghe David deklaroi në mënyrë të qartë se Ushtria Sovjetike ishte një ushtri agresive (duke cituar pushtimin ushtarak Sovjetik të Afganistanit në dhjetor 1979), më shumë sesa një ushtri mbrojtëse, siç pretendonte propaganda zyrtare. Pas vdekjes së Andropov⁴ (shkurt 1984), Gheorghe David i dërgoi një letër Konstantin Chernenko, Sekretari i Ri i Përgjithshëm i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, duke shprehur mendimin e tij në lidhje me situatën kritike ekonomike të shumicës dërrmuese të popullsisë Sovjetike dhe duke renditur disa nga shkaqet e saj. Në prill 1985, ai i dërgoi një letër Mikhail Gorbaçovit, menjëherë pas emërimit të tij si Kryetar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Meqenëse ai nuk kishte marrë asnjë përgjigje për letrat e tij dhe se mbi të po ushtrohej presion, Gheorghe David vendosi t'i dërgojë një letër tjetër Gorbaçovit më 26 tetor 1985.

Në të njëjtën kohë, ai e dërgoi atë në redaksinë e disa gazetave sovjetike dhe të huaja, të tilla si *Tinerimea Moldovei* (në Chişinău), *Pravda* (Moskë), *Rahva Heacle* (Talinn), *România Liberă* (Bukuresht), *Unità* (gazeta e Partia Komuniste Italiane), *L'Humanité* (e Partisë Komuniste Franceze), si dhe disa individëve privatë. Në letër, Gheorghe David i shkruajti Gorbaçovit se BS kishte promovuar një politikë të jashtme perandorake, se e gjithë historia Sovjetike ishte plot falsifikime, ai kritikoi faktin që historianët mbaheshin të heshtur mbi përmbajtjen e paktit nazist-sovjetik të 23 gusht 1939 (i ashtuquajtur Pakti Molotov-Ribbentrop si rezultat i të cilit BS pushtoi shtetet Baltike, Besarabinë dhe Bukovinën Veriore, etj.). Ai gjithashtu kërkoi rivendosjen e alfabetit latin në SSR Moldave pasi ishte ndaluar që prej 1941 dhe në këtë mënyrë rumunët etnikë nga SSR Moldave, që formonin shumicën e popullsisë vendase, dhe nuk ishin në gjendje të lexonin botimet në gjuhën rumune të botuara në Rumani. Kjo politikë, besoi David, pasqyronte diskriminimin ndaj rumunëve vendas dhe ishte pjesë e strategjisë së rusifikimit të popullatës vendase.

³ Leonid Ilyich Brezhnev, Sekretari i Përgjithshëm i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i cili shërbeu nga viti 1964 deri në vdekjen e tij më 1982 [shënime të botuesit]

⁴ Yuri Vladimirovich Andropov, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nga data 12 nëntor e 1982 deri në vdekjen e tij pesëmbëdhjetë muaj më vonë [shënime të botuesit]

ARRESTIMI DHE "SHTRIMI NË SPITAL"

Përveç mesazhit anti-sovjetik dhe anti-perandorak, Gheorghe David kritikoi në mënyrë të hidhur regjimin dhe ideologjinë komuniste, duke e përkufizuar Komunizmin si një sistem të bazuar në gënjeshtra dhe shfrytëzimin e njerëzve. Ai gjithashtu theksoi se përvoja e Luftës së Dytë Botërore i dëshmoi të gjithë botës nevojën për të siguruar një të ardhme më të mirë që do të ishte "më paqësore, më të begatë, pa perandori ose luftëra". Si rezultat i veprimeve të tij të guximit, në 1986 Gheorghe David u ul në detyrë, duke u bërë një punëtor i zakonshëm. Ndërsa idetë e tij u konsideruan të rrezikshme për diktaturën e partisë totalitare që mbante gjithë pushtetin e BS, ai u arrestua më 1 gusht 1986 gjatë një udhëtimi pune në Tiraspol, një qytet në bregun e majtë të lumit Dniester. Ndërsa u mor në pyetje nga Zyra e Prokurorit me qendër në Chişinău, atij iu tha se regjimi Sovjetik kishte mjetet e nevojshme për "shpëlarje truri" dhe se së shpejti ai do ta shihte atë. David kishte qenë tashmë në paraburgim për disa muaj kur u transferua në seksionin psikiatrik kriminal të burgut të Chişinău, ku ai iu nënshtua "trajtimit" të premtuar nga autoritetet

Në dhjetor 1986, një komision i posaçëm psikiatrik diagnostikoi Gheorghe David si "të tjetërsuar mendërisht" dhe e internoi atë në spitalin psikiatrik në Dnepropetrovsk, Ukrainë, një nga psikhushkas më të tmerrshme për të burgosurit politikë në BS. "Argumentet" kryesore që komisioni kërkoi për të mbështetur diagnozën e tij ishin mendimet e David në lidhje me shkëljen e sovranitetit dhe pavarësisë së Çekosllovakisë në 1968 dhe të Afganistanit në 1979, si dhe për identitetin e gjuhës "Moldave" dhe asaj Rumune. Gheorghe David u gjykua dhe u dënua në mungesë më 12 janar 1987. Vetëm në verën e vitit 1988 David u la i lirë si rezultat i raporteve të botuara nga shtypi Sovjetik, i cili po bëhej gjithnjë e më i lirë, dhe falë protestave të organizuara nga organizata të huaja për të drejtat e njeriut, mes tyre Amnesty International, si edhe transmetimet e Radios Europa e Lirë/

PSIKIATRIA SI NJË MJET POLITIK I KOMUNIZMIT

Në prill 1969 shefi i KGB Yuriy Andropov urdhëroi krijimin e një rrjeti institucionesh psikiatrike tek të cilat do të internoheshin dhe "trajtoheshin" kundërshtarët politikë të regjimit. Dëshmitë tronditëse të dëshmitarëve në lidhje me këtë sistem psikhushkas (një term jo zyrtar i gjuhës ruse, që fillimisht do të thotë një klinikë psikiatrike) u dhanë nga një numër disidentësh, mes tyre Vladimir Bukovsky, Natan Shcharansky dhe Natalia Gorbanevskaya. Atyre u dhanë ilaçe psikofarmaceutike të ndryshme dhe iu nënshtuan terapisë me elektroshok. Në të njëjtën kohë, ata u mbajtën në një hapësirë së bashku me pacientë vërtetë psikiatrik të sëmurë rëndë. Psikiatria zyrtare Sovjetike u përpoq t'i legjitimonte këto procedura me anë të botimeve pseudo-shkencore. Shoqata Botërore e Psikiatrisë i denoncoi këto praktika në Kongresin e 6-të Botëror më 1977, duke kërkuar hetimin dhe dhënien fund të tyre. Përfaqësuesit e shteteve të kritikuar më vonë dhanë dorëheqjen nga anëtarësia e tyre në këtë organizatë profesionale. Psikiatria si shkencë shpesh abuzohej në vendet e tjera ku partia Komuniste ishte gjithashtu në pushtet. Rasti i aktivistit të krishterë çek Augustin Navrátil, për shembull, tërhoqi shumë vëmendje jashtë vendit në fund të viteve 1970.

Radio Freedom. Pasi u la i lirë, ai dha mësim në Universitetin Teknik të Moldavisë dhe ishte përgjegjës për dy shpikje teknike. Ai vdiq më 2007, vetëm disa muaj para se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut të pranonte se ai ishte një viktimë politike e shtypjes komuniste dhe se psikiatria ishte përdorur në mënyrë të paligjshme kundër një personi të shëndetshëm.

Rasti i Gheorghe David tregon se shtypja politike në Bashkimin Sovjetik në përgjithësi dhe në veçanti në Moldavi nuk u ndal me vdekjen e Stalinit. Për më tepër, ajo vazhdoi deri në vitet e fundit të regjimit komunist, ndryshimi ishte se ajo vazhdoi përmes metodave më të sofistikuara, të cilat nuk ishin më pak çnjerëzore dhe në kundërshtim me të drejtat themelore të njeriut që komunizmi pretendonte të manifestonte dhe mbronte. Rasti tregon gjithashtu se liria e fjalës - një e drejtë themelore e njeriut - nuk u respektua në BS dhe europianët e sotëm nuk duhet të harrojnë se liria dhe demokracia nuk duhet të merren si të mirëqena.

KONTRIBUT I QENDRËS PËR STUDIMIN E TOTALITARIZMIT

UKRAINA

REGJIMI KOMUNIST

Gjatë luftës së 1918-1921 Ushtria e Kuqe sovjetike pushtoi pjesën më të madhe të Ukrainës dhe Republika Socialiste Sovjetike Ukrainase u krijua si pjesë e Bashkimit Sovjetik në 1922. Ukraina Perëndimore iu dha Polonisë pas Luftës Polako - Sovjetike (1919-1920) dhe u bashkua me SSR Ukrainase pas disfatës së Polonisë në 1939. Politikat sovjetike shkatërruan shoqërinë ukrainase. Midis tyre kolektivizimi i motivuar ideologjikisht dhe industrializimi i filluar në 1929 (1.2 milion viktima), detyroi shtypjet kundër intelektualëve të njohur si "Rilindja e Ekzekutuar" dhe Pastrimi i Madh (300,000 viktima). Në 1932-1933 pasoi zia e bukës, e njohur si Holodomor, duke shkaktuar më shumë se 4.5 milion vdekje nga uria ekstreme. Në 1939 - 1941 pasuan dëbimet nga Ukraina Perëndimore (300,000 njerëz). Gjatë tërheqjes sovjetike më 1941, gati 24,000 të burgosur politikë u vranë.

PUSHTIMI NAZIST

Ukraina ishte nën pushtimin gjerman në 1941-1944. Gjatë kësaj periudhe, u vranë deri 4.5 milion banorë ukrainas, mes tyre 900,000 hebrenj. Territori u nda në të ashtuquajturën "distrikti Galizien", i cili u bë pjesë e Qeverisë së Përgjithshme dhe në Reichskomissariat ukrainase. Ukraina ishte një zonë e rezistencës aktive të armatosur. Ushtria kryengritëse ukrainase (UPA), Armia Krajowa Polake dhe njësitë e kuqe partizane të mbështetura nga sovjetikët luftuan kundër gjermanëve por edhe kundër njëra-tjetrës. Ukrainasit shërbenin gjithashtu në njësitë e formuara nga gjermanët, midis tyre divizioni SS "Galizien".

REGJIMI KOMUNIST

Gjatë 1944-1991 SSR Ukrainase ishte përsëri pjesë e Bashkimit Sovjetik. Shtypjet masive vazhduan, por edhe transferimet e popullsisë. Dëbimet u kryen në 1944 (150,000 Tatarë krimean), 1944-1953 (deri në 203,000 anëtarë të rezistencës kombëtare) dhe më vonë. Midis 1944-1946, më shumë se 800,000 polak u dëbuan në Poloni dhe gjysmë milioni ukrainas në Ukrainë. Megjithëse SSR Ukrainase ishte ndër kombet e themeluara të Kombeve të Bashkuara në 1945 pavarësia e saj u shpall vetëm gjatë shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në gusht të 1991.



OMELIAN KOVCH lindi më 20 gusht 1884 në familjen e priftit Greko-Katolik Grygorij Kovch. Foshnja ishte e destinuar të bëhej prift, si babai, xhaxhai dhe gjyshi i tij. Vendlindja e tij ishte toka e Galicias, ku ukrainasit, polakët dhe hebrenjtë jetonin për shekuj së bashku. Omelian studioi në Romë, u martua dhe u bë prifti i Kishës Greko-Katolike. Ai kishte gjashtë fëmijë. Mori pjesë në luftën për pavarësi 1919-1920 si klerik në Ushtrinë Galiciane të Ukrainës.



Ai qëndroi dhe u persekutua njësoj si nga bolshevikët dhe nazistët. Gjatë pushtimit gjerman në Luftën e Dytë Botërore ai shpëtoi me guxim hebrenjtë dhe u përpoq t'i ndihmonte duke i pagëzuar dhe duke i fshehur. Për këto aktivitete, ai u arrestua nga Gestapo dhe u dërgua në kampin e përqendrimit majdanek ku vdiq më 25 mars 1944. Në vitin 2001, gjatë një vizite në Ukrainë, Papa Gjon Pali II e shpalli At Omelian Kovch një Martir të Bekuar.

ARKIVA E QENDRËS PËR
KËRKIME MBI LËVIZJEN
ÇLIRIMTARE

Omelyan Kovch

Një Prift, një Patriot, një Njeri i Drejtë

shkruar nga Volodymyr Birchak dhe Volodymyr Viatrovych

“Ai ishte djali i një prifti të një kombi dhe vdiq në tokat e një kombi tjetër, sepse kishte shpëtuar bijtë dhe bijat e një të treti.”

Këto fjalë nga kardinali Lubomyr Husar përfaqësojnë historinë e jetës së Omelyan Kovch, një njeri që ishte patriot i flaktë i vendit të tij, por megjithatë arriti të ngrihej mbi paragjykimet kombëtare. Vendlindja e tij ishte toka e Galicisë, ku ukrainasit, polakët dhe hebrenjtë jetuan për shekuj së bashku. Faqet e historisë së bashkëjetesës së tyre shënohen nga shumë ngjarje dhe konflikte dramatike. Por figura e Omelyan Kovch simbolizon një njeri që u ngrit për të gjithë përfaqësuesit e këtyre tre kombeve.

Kur më 20 gusht 1884, në familjen e priftit katolik grek Grygorij Kovch, lindi një djalë i quajtur Omelyan, të gjithë ishin të sigurt për fatin e tij. Foshnja ishte e sigurt se do të bëhej prift, si babai i tij, xhaxhai dhe gjyshi i tij. Si çdo prift katolik grek në Galicia në ndërrimin të shekujve nëntëmbëdhjetë dhe njëzet, ai do t'i bashkohej shërbimit klerik me punën aktive publike në zonat rurale. Mbi të gjitha, ky ishte stili i jetës së gjyshit të tij, babait, xhaxhait dhe qindra priftërinjve të tjerë të Kishës Katolike Greke të Ukrainës, të cilët u bënë figura kryesore të ringjalljes kombëtare të Ukrainës në Galicia, e cila, në atë kohë, ishte pjesë e Perandorisë Austro-Hungareze.

Pothuajse të gjitha këto parashikime dolën të sakta. Por përveç aktiviteteve të mundshme klerike dhe publike të pritshme, djali duhej të duronte vuajtjet që askush nuk kishte mundur të imagjinonte - dy luftëra botërore, pjesëmarrjen në lëvizjen çlirimtare të Ukrainës, persekutim nga fuqitë polake, sovjetike dhe naziste dhe vdekje në Kampin e shfarosjes majdanek.

Familja kishte edhe tre fëmijë të tjerë. Por, pavarësisht vështirësive financiare, Grygorij Kovch bëri më të mirën që t'i siguronte arsim të mirë djalit të tij. Pasi kishte mbaruar shkollën fillore në Kosmach, ku babai i tij ishte prift famullie, Omelyan vazhdoi studimet në gjimnazin (shkollën e mesme) e Lviv, qyteti kryesor në Galicia dhe më pas u nis edhe më larg nga shtëpia - në Romë, ku në 1905- 1911 ai ishte student në Shenjtët Sergius dhe Kolegjin Bacchus.

STUDIMI NË QYTETIN E PËRJETSHËM

I riu gjeti mundësinë të jetonte dhe studionte në Qytetin e Përjetshëm falë ndihmës së dhënë nga Kreu



Omelyan Kovch i dyti nga e majta ulur, ndërsa studionte në Shenjtët Sergius dhe Kolegji Bacchus në Romë, 1908.

ARKIVA QENDRORE PËR KËRKIME MBI LËVIZJEN ÇLIRIMTARE

i Kishës Katolike Greke në atë kohë, Metropolitan i Andrey Sheptytsky. Më vonë, pas shumë vitesh, Kreu i Kishës do të bënte një përpjekje tjetër për të ndihmuar Omelyan Kovch, kësaj here do ta shpëtonte atë nga vdekja, dhe jo nga varfëria.

Madje para diplomimit dhe marrjes së urdhrave të shenjtë, Omelyan Kovch u martua me Marie-Anne Dobriansky, e cila ishte gjithashtu vajzë e një prifti. Familja e lumtur kishte gjashtë fëmijë - tre djem dhe tre vajza. Famullia e pare ku u caktua prifti i ri, ishte shumë larg shtëpisë, në skajin tjetër të Perandorisë Austro-Hungareze në qytetin Kozarats (Bosnje dhe Hercegovina moderne). Famullitarët e tij ishin emigrantë të varfër ukrainas, dhe për këtë arsye familja e

priftit jetonte në kushte materiale të vështira.

Por shumë shpejt ngjarjet e trazuara historike ndryshuan jetën e qetë të Omelyan Kovch. Në 1914, kur filloi Lufta e Parë Botërore, prifti u kthye në tokën e tij të lindjes, e cila u bë një nga arenat e luftës së përgjakshme. Galicia u pushtua nga ushtria ruse, pastaj u ripushtua nga Perandoria Austro-Hungareze, pastaj u kthyen rusët. Ndoshta tragjedia më e madhe e ukrainasve në atë kohë ishte fakti që në luftën që po bëhej në tokat e tyre, ata po luftonin kundër njëri-tjetrit për interesa të huaja në ushtritë perandorake. Ky ishte çmimi që ata paguan ngaqë nuk kishin një vend të vetin.

Ukrainasve iu dha një mësim i mire. Ata u ngritën për të luftuar për pavarësi. Në fazën e fundit të Luftës së Parë Botërore perandoritë u shembën dhe, shtetet e kombeve të shtypura më parë, filluan të ngriheshin mbi rrënojat e tyre. Në Lviv në nëntor 1918 u shpall Republika Popullore e Ukrainës Perëndimore. Megjithatë, përfaqësuesit e një populli tjetër që përbënin më parë Perandorinë Austro-Hungareze, d.m.th. polakët, gjithashtu pretenduan pronësinë e Galicisë. Kështu që filloi një luftë midis ukrainasve dhe polakëve.

NË USHTRI

Midis atyre që u bashkuan me Ushtrinë Galiciane Ukrainase (UGA), për të mbrojtur Republikën Popullore të Ukrainës Perëndimore të sapo krijuar atje, ishte Yevstahiy, vëllai i Omelyan. Omelyan Kovch, duke qenë klerik, nuk kishte të drejtë të merrte armë, por ai nuk mund ta injoronte shtysën e tij patriotike

dhe u bë klerik i ushtrisë ukrainase. Ndër priftërinjtë e tjerë, që kryenin detyrat e tyre midis ushtarëve të UGA, ndodhej Grygoriy Kovch, babai i Omelyan. Prifti i vjetër vdiq nga tifoja në ushtri në fund të 1919. Djali i tij shërbeu në ushtri deri në ditët e saj të fundit. Pasi u mund nga polakët në Galicia, ushtria u tërhoq në lindje dhe mbrojti Republikën Popullore Ukrainase në luftën me bolshevikët.

Ishte gjatë luftës kur njerëzit panë për herë të parë besimin ekstrem të Omelyan Kovch, disa herë të tejmbushur me kurajo sfiduese. Ai shpesh ishte parë me ushtarë në frontin e parë. "E di," thoshte ai "që ushtari në vijën e frontit ndihet më mirë kur sheh afër një mjek dhe një rrëfyes". Dhe me shaka, ai shtonte: "Ju e dini që unë jam i shenjtëruar dhe një person i shenjtëruar nuk është shënjestër e lehtë për një plumb." Ky besim lejoi që ai të dilte nga situata shumë të komplikuar dhe të frymëzonte siguri tek të tjerët.

Ai u kap përfundimisht nga bolshevikët, së bashku me ushtarë të tjerë të UGA. Të burgosurit ishin ngarkuar në vagonë që i çonin në vendin e ekzekutimit. Në një nga ndalesat, roja e trenit, një ushtar rus tha, le të shkojë pastori, duke i thënë "At, mos harro të lutesh për Lukën". Por në vend të lirisë, Omelyan Kovch përsëri u gjend në një kamp për të burgosurit e luftës, këtë herë në kampin polak. Sëmundja e tifos ishte fatkeqësia më e madhe; ajo u merrte jetën qindra ushtarëve çdo ditë. At Omelyan, i cili ishte ulur me njerëz deri në frymën e tyre të fundit, ishte i sigurt që do të sëmurej. Sidoqoftë, ai arriti të mbijetojë dhe pas një lufte të gjatë u kthye në shtëpi.

MIDIS LUFTËRAVE

Më 1922 ai mori një famulli në qytetin Peremyshlyany në rajonin e Lviv. Pas luftës, ky territor i përkiste Polonisë së re. Peremyshlyany, si qytetet e tjera të këtij lloji në Galicia, ishte shumëkombësh; përveç ukrainasve, polakëve, hebrenjve, ciganëve, madje atje jetonin edhe disa familje gjermane. Pavarësisht nga lufta e fundit dhe historia e ndërlikuar e marrëdhënieve midis kombeve, popullsia e qytetit jetoi mjaft paqësisht, duke u përpjekur të toleronte dhe respektonte traditat dhe zakonet e popujve të tjerë. Kur të krishterët kishin një ditë festive të rëndësishme fetare, hebrenjtë mbyllnin dyqanet e tyre dhe e deklaroronin ditë pushimi, edhe të krishterët bënin të njëjtën gjë në festat hebreje.

Omelyan Kovch jetoi dhe punoi në Peremyshlyany gjatë periudhës së shkurtër të paqes midis dy luftërave botërore. Sigurisht që ai nuk u kufizoi veten nga puna në kishë, por gjithashtu ishte pjesëmarrës aktiv në jetën



Peremyshlyany, Galicia, 1925.

ARKIVA E QENDRËS KËRKIMORE MBI LËVIZJEN ÇLIRIMTARE

publike të qytetit. Ai ishte themeluesi i Shtëpisë së Popullit (vendi për festat kombëtare të ukrainasve), dhe sallës së leximit të "Shoqatës Prosvita", qëllimi i së cilës ishte përhapja e ndërgjegjësimit tek ukrainasit. Ai gjithashtu nisi krijimin e Bankës Ukrainase, e cila supozohej të ishte një mjet për sigurimin e pavarësisë financiare të komunitetit ukrainas.

Aktivitetet e Kovch shkaktuan shtypje nga qeveria polake, e cila u përpoq të kufizonte zhvillimin e lëvizjes kombëtare ukrainase, të cilën e pa si një kërcënim për integritetin e shtetit. Kontrollat e shtëpisë së priftit u bënë një traditë fatkeqe lokale; nga 1925-1934 ishin rreth 40 të tilla. Pas gjysmës së tyre ai u arrestua dhe u burgos për një kohë më të gjatë ose më të shkurtër. Pavarësisht nga persekutimi, At Kovch ishte gjithmonë i hapur për të gjithë. Ai e gjente kohën për besnikët e tij, por edhe për anëtarët e besimeve të tjera – madje shpesh edhe polakët dhe hebrenjtë i kërkonin këshilla.

SHTYPJET SOVJETIKE

Në shtator 1939, pasi filloi Lufta e Dytë Botërore dhe u vendos pushteti sovjetik në Galicia, situata në qytet ndryshoi me shpejtësi. Polakët, të cilët gëzonin privilegje si përfaqësues të kombit në drejtim nën qeverinë e mëparshme, ishin viktimat e para të shtypjeve komuniste. Arrestimet dhe shtypjet prekën para së gjithash ata që kishin qenë nëpunës publikë dhe më vonë prekën drejtuesit e partive politike dhe shoqatave publike. At Omelyan ishte ndër të parët që nxitoi për t'i ndihmuar ata. Ose me ushqim ose me para ose vetëm me një fjalë të mirë ai vizitoi familjet e oficerëve polakë të dërguar në Siberi. Gratë e tyre e pyesnin priftin - *"Si mund të na ndihmoni, kur burri vetëm pak kohë më parë ushtroi kontrolle në shtëpinë tuaj?"* Por ai vetëm buzëqeshi dhe ua kthente se kjo ishte detyra e tij.



Omelyan Kovch ishte baba i gjashtë fëmijëve, por ai ndihmoi gjithashtu edhe në rritjen e fëmijëve të tjerë. Djali më i ri u mor nga prifti nga një familje e varfër ukrainase.

ARKIVA E QENDRËS KËRKIMORE MBI LËVIZJEN ÇLIRIMTARE

Gjatë muajve të parë të regjimit sovjetik ukrainasit dhe hebrenjtë ndjenë një farë lehtësimi (propaganda komuniste po fliste për "çlirimin e tyre nga shtypja polake"). Por shumë shpejt edhe ata u bënë çështje e persekutimit të NKVD. Pasi trenat çonin polakë në Lindje, vagonët e mbushur me ukrainas dhe hebrenj filluan gjithashtu rrugën e tyre. Lëvizja kombëtare ukrainase u shpall "nacionaliste borgjeze" dhe armiqësore ndaj qeverisë së re; aktivistët e saj u arrestuan dhe u dënuan me burgim apo edhe ekzekutim. Omelyan Kovch i shpëtoi shtypjes gjatë asaj kohe të tmerrshme. Ai vazhdoi me shërbimin e tij klerik; për më tepër ai guxoi

të organizonte ngjarje masive fetare për besimtarët, pavarësisht qeverisë anti-fetare të theksuar.

Më 1941 shtypjet nga qeveria e re u rritën vazhdimisht. Burgjet e Ukrainës Perëndimore (në atë kohë e aneksuar në BS) ishin mbushur me të burgosur, kryesisht politikë, ata që qeveria i quante "armiqtë të kombit". Shumica e tyre ishin djem dhe vajza të reja, aktivistë të Organizatës së Nacionalistëve Ukrainas, të cilët filluan një luftë të fshehtë anti-Sovjetike.

Më 22 qershor 1941 filloi një fazë e re e Luftës së Dytë Botërore me sulmet e trupave gjermane kundër Bashkimit Sovjetik. Qeveria Sovjetike doli të ishte e papërgatitur për ngjarje të tilla të shpejta dhe nuk ishte në gjendje të organizonte një mbrojtje efektive. Çdo orë që kalonte, gjermanët përparonin më tej në lindje. Ndërkohë, forcat e policisë politike sovjetike - NKVD – ishin të zëna me arrestime të të gjithë individëve "politikisht jo të besueshëm". Atë ditë At Omelyan Kovch ishte mes tyre. Disa qytetarë (disa dëshmitarë thonë se ishin hebrenj) e fshehën priftin dhe kështu ai i shpëtoi jo vetëm arrestimit, por ndoshta edhe ekzekutimit. Qeveria Sovjetike la një vazhdë gjaku në të gjithë Ukrainën Perëndimore – pas tërheqjes së saj trupat e mijëra njerëzve u gjetën në burgje. Ata ishin pushkatuar pa gjyq pasi nuk kishte kohë për seanca dhe nuk kishte asnjë mënyrë për të evakuuar të burgosurit. Midis të ekzekutuarve ishin shumë priftërinj.

Ndërkohë tashmë ishte ndryshimi i pestë i autoriteteve që Omelyan Kovch kishte vërejtur në atdheun e tij. Nazistët nuk do të rivendosnin ndonjë shtet atje; as polak dhe as ukrainas. Territori do të ishte vetëm një koloni e Rajhut të Tretë dhe popullsia e tij do të ishte skllave për sundimtarët e rinj. Autoritetet gjermane i trajtuan me neveri ukrainasit dhe polakët dhe i privuan nga shumë të drejta. Por qëndrimi i tyre ndaj popullsisë hebreje ishte më i keqi. Vrasjet masive filluan që në ditët e para të këtij pushteti të ri.

BESIMI PA KOMPROMIS

Të frikësuar nga shtypjet e vazhdueshme, shpesh njerëzit përpiqeshin të injoronin mizoritë që u bëheshin të tjerëve. Të gjithë ishin të shqetësuar me problemet e veta dhe mbetën vetëm me dhimbjen dhe frikën e tyre. Kjo frikë u shoqërua gjithashtu me paragjykime të ndryshme kombëtare, kujtime të problemeve dhe konflikteve të së kaluarës. E gjithë kjo i lejoi disi njerëzit të harronin vuajtjet e të tjerëve dhe të injoronin shfarosjen e kombësive të tjera. Por Omelyan Kovch kurrë nuk i kompromentoi vlerat e tij morale edhe në një kohë të tillë, pa marrë parasysh se çfarë mund t'i kushtonte atij. Dhe përsëri besimi dhe siguria e tij bënë mrekulli.

Në shtator 1941, një grup burrash SS gjermanë mbyllën sinagogën në qytetin Peremyshlyany të mbushur me njerëz që kishin ardhur të luteshin pikërisht në atë moment. Dikush hodhi bomba brenda. Filloi zjarri, njerëzit nxituan për tek dera dhe e kuptuan që ishin zënë në një kurth vdekjeprurës. "Një prift katolik dhe një grup njerëzish vrapuan tek At Kovch duke i kërkuar që t'i ndihmonte për të shpëtuar

sinagogën", kujton ish-banori i Peremyshlyany Leopold Klyajman-Kozlovsky. "Kovch, i cili fliste gjermanisht në mënyrë të përsosur, u thirri ushtarëve gjermanë duke u kërkuar që ta linin të futej në sinagogë. Ushtarët u shtangën nga befasia dhe e lanë të futej. Kovch nxitoi të nxirrte njerëzit nga sinagoga që digjej.

Aaron Roqueah, rabini i Belz ishte midis atyre që u shpëtoi nga At Kovch.

Omelyan Kovch ishte i aftë jo vetëm për një vepër heroike, por edhe për një punë me rrezik afatgjatë. Kur në Peremyshlyany u kthye në geto, prifti hyri brenda në më shumë se një rast për të ndihmuar hebrenjtë. Ai u sollti atyre ushqim, ilaçe, rroba të pastra, etj. Një mënyrë tjetër ku prifti arriti të shpëtonte hebrenjtë nga shfarosja, kishte të bënte me të ashtuquajturat "dokumente ariane" (informacione të nxjerra nga librat e kishës rreth pagëzimit). Individët Rubin dhe Itka Piza arritën të mbijetojnë falë dokumenteve të siguruara nga Omelyan Kovch.

Për një veprimtari të tillë, At Kovch u arrestua nga Gestapo në janar 1943 dhe u burgos në burgun e Lviv në rrugën Lontskyy. Familja e tij, miqtë dhe madje edhe Kryepeshkopi Metropolitan i Kishës Katolike Greke Ukrainase Andrey Sheptytsky bënë gjithçka që ishte e mundur për t'a liruar. Nazistët vendosën një kusht të vetëm për lirim të tij: prifti ukrainas duhet të paraqesë një zotim të shkruar për të mos ndihmuar më hebrenjtë. At Omelyan refuzoi. *"Më dëgjoni, zoti Stavitsky, " i tha ai një oficeri të Gestapos "ju jeni një oficer policie. Detyra juaj është të kërkonit kriminelët. Ju lutemi, lini punët e Zotit në duart e Zotit".* Oficeri, i indinjuar për shkak të përgjigjes së priftit, urdhëroi që ai të kthehej në burg.

KAMPI I PËRQENDRIMIT NË MAJDANEK

Këtë herë ai u torturua për një kohë të gjatë në burg dhe më pas u dërgua në kampin e përqendrimit majdanek. Por edhe qëndrimi në fabrikën e tmerrshme të vdekjes nuk e theu priftin. *"Unë e kuptoj që po përpiqeni të më lironi," i shkruajti ai familjes së tij, "por ju kërkoj të mos bëni asgjë. Ata qëlluan 50 persona dhe; nëse nuk jam këtu, kush do t'i ndihmonte ata të shkonin në botën tjetër? Ata do të vazhdojnë përgjithmonë me mëkatet e tyre në dëshpërim të thellë të mbetura në këtë ferr. Por tani ata po largohen me kokën lart, me mëkatet e tyre të lëna pas. Ata e kalojnë urën me gëzim në zemrat e tyre dhe shoh që paqja dhe qetësia zënë vend tek ata kur bisedoj me ta për të fundit herë."* Omelyan Kovch besonte se atje, midis njerëzve të dënuar me vdekje, ai do të përmbushte misionin e tij në mënyrën më të përshtatshme. Dhe kjo ishte gjëja më e rëndësishme për të.

"I jam mirënjohës Zotit që është kaq i sjellshëm ndaj meje", mund të lexojmë në një nga letrat e tij. "Por për atë Qiell, ky është i vetmi vend ku do të doja të isha. Të gjithë jemi të barabartë këtu. Polakë, hebrenj, ukrainas, rusë, lituanes ose estonezë. Unë jam i vetmi prift këtu. Nuk mund ta imagjinoj se çfarë do të bënin ata pa mua. Këtu, unë mund të shoh Zotin - ka vetëm një Zot për të gjithë, pavarësisht nga dallimet tona fetare. Ndoshta kishat tona janë të ndryshme, por të gjitha ato dominohen nga Zoti i Plotfuqishëm. Kur unë shërbej liturgjinë, ata luten. Ata luten në gjuhë të ndryshme, por Zoti i kupton të gjitha gjuhët, apo jo? Ata vdesin në mënyra të

ndryshme dhe unë i ndihmoj ata të kalojnë urën. A nuk është ky një bekim? A nuk është kjo kurora më e mirë që Zoti mund të vendosë ndonjëherë mbi kokën time? Kjo është e vërtetë. Falenderoj Zotin mijëra herë në ditë që Ai më dërgoi këtu. Nuk mund të kisha kërkuar më shumë prej tij. Mos u dëshpëro për shkakun tim. Gëzohu me mua. Lutuni për ata që kanë krijuar këtë kamp dhe këtë sistem. Ata kanë nevojë për lutjet tuaja mbi të gjitha... Zoti qoftë i mëshirshëm me ta...”

Omelyan Kovch, i burgosuri nr. 2399 i majdanek, punoi si të gjithë të tjerët në kamp, por pas punës së rëndë fizike ai përsëri shërbeu si prift i një fabrike të tmerrshme vdekjeje. Ai u siguroi të gjithë atyre që kishin nevojë për ngushëllim të brendshëm, pavarësisht nga kombësia ose feja e tyre.

Kushtet çnjerëzore të kampit më në fund thyen shëndetin e priftit, i cili nuk ishte më i ri. Ai vdiq pas telave me gjemba më 25 mars 1944, vetëm disa muaj para çlirimit të majdanek. Arsyeja zyrtare e vdekjes së tij ishte dobësia e zemrës. Trupi i priftit, si mijëra të tjerë, u dogj në një nga krematoriumet e tmerrshme të kampit.

Por kujtesa e këtij njeriu të drejtë nuk mund të shkatërrohej aq lehtë sa trupi i tij. Njerëzit që ai shpëtoi i kujtuan të tjerëve veprën e tij. Më 2001, gjatë një vizite në Ukrainë, Papa Gjon Pali II e shpalli At Omelyan Kovch një Martir të Bekuar.

KONTRIBUT I QENDRËS PËR KËRKIME MBI LËVIZJEN ÇLIRIMTARE



Kampi i përqendrimit në majdanek, “famullitari” i fundit i At Omelyan Kovch.

ARKIVA E QENDRËS KËRKIMORE MBI LËVIZJEN ÇLIRIMTARE

OLEKSANDRA RADCHENKO (1896-1965) punoi si mësuese në Ukrainë për pjesën më të madhe të jetës së saj. Ajo dhe tre fëmijët e saj i mbijetuan zisë së bukës Holodomor në 1932-1933. Ajo shkroi në ditarin e saj për ato kohëra, duke dokumentuar tmerret e asaj që në thelb ishte uria ekstreme e qëllimshme e njerëzve. Në gusht 1945 ajo u arrestua dhe akuzua për propagandë antisovjetike. Ditari i saj u përdor si provë gjatë çështjes së saj. Ajo u dënua me dhjetë vjet në një kamp përqendrimi komunist. Oleksandra u kthye në Ukrainë në gusht 1955 pasi përfundoi gjithë kohën e burgimit. Si rezultat i shëndetit të dobët, ajo jetoi si një person i lirë për vetëm dhjetë vjet më shumë.



ARKIVA DIXHITALE
E LËVIZJES ÇLIRIMTAE
UKAINASE

Oleksandra Radchenko

Persekutuar për Kujtesën e saj

shkruar nga Volodymyr Viatrovych

Ekaluara historike e Ukrainës nën sundimin komunist është e ngjashme me vendet e tjera post-komuniste të EUROPËS Qendrore dhe Lindore. Ndryshe nga vendet e tjera të ish-bllokut lindor, rregulli totalitar arriti në Ukrainë shumë më herët - jo pas Luftës së Dytë Botërore, por disa dekada më parë. Krimet më të tmerrshme të regjimit komunist - vrasje masive, dëbime, Holodomori - ishin kryer para Luftës së Dytë Botërore. Ukraina u bë "laborator" për regjimin Komunist: metodat e vërtetuara të shtypjes së kundërshtarëve dhe mjetet e një sistemi totalitar, të cilat më vonë u përdorën në vendet e tjera "të çliruara" nga Ushtria e Kuqe nga pushtimi nazist.

Pas rënies së Republikës Kombëtare Ukrainase në 1921 sundimi komunist erdhi në Ukrainë si rezultat i pushtimit të Ushtrisë së Kuqe Bolshevike në pjesën më të madhe të territorit të Ukrainës. Midis aktivistëve komunistë kishte shumë ukrainas, por formimi i regjimit u bë i mundur vetëm pasi ushtria bolshevike me mbështetje të Moskës, pushtoi Ukrainën. Për shkak të rezistencës masive anti-komuniste, rebelime të shumta zgjatën deri në fund të viteve 1920.

UKRAINIZIMI

Për të kontrolluar territorin, komunistëve iu desh të bënin kompromis me lëvizjen kombëtare ukrainase. Ata filluan politikën e "ukrainizimit" - gjuha ukrainase u bë zyrtare në institucionet qeveritare dhe u hapën teatrot dhe universitetet ukrainase. Këto kushte të favorshme rezultuan në rilindje të kulturës ukrainase duke krijuar një brez të ri poetësh, shkrimtarësh, artistësh dhe regjisorësh të kinemasë dhe teatrit. Një politikë e re ekonomike, e shpallur nga komunistët, lejoi që fshatarët të ishin pronarë tokash dhe të përmirësonin fermat e tyre. Por dhjetë vjet më vonë, pas marrjes së pushtetit nga komunistët, një zi buke do të shkatërronte fshatin dhe "inteligjenca" e rilindur do të bëhej pjesë e "Rilindjes së Ekzekutuar".


Bolshevikët kuptuan se lejimet kulturore dhe ekonomike për ukrainasit rebelë mund të ishin vetëm të përkohshme dhe në fund të viteve 1920, pas përfundimit të sundimit të Stalinit, filloi një sulm i madh kundër gjithçkaje ukrainase. Ky sulm u quajt "gjenocidi sovjetik i ukrainasve" nga avokati me fame botërore dhe autori i termit "gjenocid", Raphael Lemkin. Gjenocidi përfshiu shtypjet (d.m.th. ekzekutimet dhe burgosjet) e inteligjencës dhe "asgjësimin" e Kishës Ortodokse të Ukrainës. Për më tepër, gjenocidi çoi në

vdekje masive të fshatarëve ukrainas - të cilët përbënin burimin kryesor të identitetit kombëtar. Zia artificiale e bukës e sjellë gjatë 1932-1933 mori jetën e miliona njerëzve (vlerësimet variojnë nga 4 në 7 milionë). Ky krim i tmerrshëm u bë i njohur si Holodomori (nga fjalët ukrainase holod [uria] dhe mor [vdekja] ose "Vdekja nga Uria"), e cila nuk është vetëm një pjesë e historisë së Ukrainës por gjithashtu edhe e historisë botërore.

Gjatë fillimit të viteve 1930, kolektivizimi i fshatrave ukrainas mbaroi dhe banorët e saj u dëbuan me forcë në fermat kolektive. Si rezultat i kësaj politike, fermerët dhe fshatarët u bënë plotësisht të varur nga ndihmat qeveritare. Duke përdorur dëbimet dhe shtypjet masive, komunistët ishin në gjendje të eleminonin pronarët e pasur dhe të pavarur të tokave - kulakët - të cilët mund të formonin bazën e një lëvizjeje kombëtare. Por edhe pas kësaj periudhe shtypëse, rebelimet lokale anti-Sovjetike vazhduan. Për të shkatërruar përfundimisht lëvizjen e rezistencës, qeveria vendosi të ndëshkojë fshatarët jo-bashkëpunues me uri dhe uri ekstreme.

URIA EKSTREME SISTEMATIKE

Së pari, qeveria vendosi kuota të larta të paarsyeshme të sigurimit të drithit. Dështimi i pritur u shpall si sabotim dhe rezistencë ndaj qeverisë. Pas kësaj, filluan kërkesat e detyruara dhe brigadat speciale u dërguan në fshatra. Ata konfiskuan të gjithë drithin që u gjet. Qeveria ndëshkoi me dhunë këdo që përpiqej të fshihte drithin, i cili u shpall pronë e qeverisë.



Viktimat e urisë, rajoni Kharkiv, 1933.

KOLEKSIONI I KARDINALIT THEODOR INNICIR

Në gusht 1932, u miratua një ligj i veçantë që u bë i njohur si "ligji i pesë kallinjve të grurit". Shkelësit e këtij ligji u dënuan me burgim apo edhe ekzekutim për të ashtuquajturën "plaçkitje të pronës socialiste". Në të vërtetë ishte një përpjekje për t'i parandaluar njerëzit që të mos mbanin për vete drithë qoftë edhe për një vakt, ose kur gjenin copa drithi pas mbledhjes së të korrave. Një metodë alternative për zinë e urisë së fshatarëve ishte vendosja e të ashtuquajturave "gjoba natyrore": fshatarëve që nuk plotësonin kuotën e pritshme të dorëzimit të drithërave i konfiskohej i gjithë ushqimi. Përgjegjësia për "sabotim" u vu gjithashtu në fshatra të tërë, të cilët ishin regjistruar në

të ashtuquajturat "listat e zeza". Fshatra të tillë ishin plotësisht të izoluar nga bota e jashtme dhe u ndaluan dërgesat e çdo malli ose furnizimi. Përfundimisht, i gjithë territori i Ukrainës u bë një "geto e urisë"; kufijtë e saj ishin të rrethuar nga një ushtri që nuk lejonte njerëzit e uritur të arratiseshin.

Të privuar nga çdo ushqim dhe mundësia për tu larguar nga rajoni i prekur nga zia e bukës, miliona njerëz vdiqën, përfshirë fshatra të tërë. Fshatarët e vdekur u varrosën në gropa të mëdha afër fshatrave të tyre, sepse kishte shumë të vdekur për t'u varrosur në varre të veçanta. Ndonjëherë edhe njerëzit e

gjallë varroseshin, sepse ata që mblidhnin trupat ishin aq të pafuqishëm sa nuk mund të ktheheshin dot dy herë në të njëjtin vend.

Kjo vdekje tragjike e miliona ukrainasve u mbajt e fshehur për botën. Ishte e ndaluar të flitej për zinë e bukës në Ukrainë. Gazetat e censuruara shkruanin për sukseset e mëdha të qeverisë Sovjetike dhe çdo lajm në lidhje me zinë e bukës interpretohej si propagandë antiqeveritare dhe dënohej rëndë.

Disa nga viktimat e zisë së bukës ishin të sigurt se zia e bukës ishte rezultat i veprimtarive kriminale nga autoritetet lokale dhe gjithçka që duhet të bënin ishte të informonin qeverinë qendrore në mënyrë që të ndalonin këto krime. Njerëzit i shkruanin letra Stalinit, në mënyrë që të "hapnin sytë e liderit kombëtar" në lidhje me tmerret e zisë së bukës. Qeveria Komuniste dëgjoji me vëmendje ata që shkruan letra të tilla dhe më pas i arrestoi.

Sidoqoftë, të mbijetuarit e Holodomorit u përpoqën të ruanin kujtimet e tyre dhe t'i kalonin ato tek pasardhësit. Mykola Bokan nga rajoni i Chernihiv bëri fotografi të familjes së tij në ato vite të tmerrshme.

Disa kohë më vonë, këto fotografi u bënë prova në çështjen penale kundër tij. Si rezultat, ai u dënua me tetë vjet burg. Por Mykola Bokan nuk u kthye kurrë nga kampet e përqendrimit të Gulag dhe vdiq në tokë të huaj.

NJË DËSHMITAR PËR HORRORIN

Oleksandra Radchenko ishte një nga miliona dëshmitarë të vdekjeve nga uria ekstreme. Në atë kohë ajo punoi si mësuese në rajonin Kharkiv.

Ajo kishte një racion ushqimor dhe kjo e ndihmoi atë dhe familjen e saj për të shmangur urinë ekstreme. Por "racioni" që ajo mori nga shteti nuk mund ta izolonte nga terrori që e rrethonte. Ishte e vështirë të izolohesh, sepse si mësuese ajo duhej të shikonte në sytë e uritur të nxënësve të saj dhe shikonte sesi numri i nxënësve të saj zvogëlohej vazhdimisht. Ajo e dinte që çdo përpjekje për të përhapur informacion në lidhje me situatën në



Roje e armatosur në një depo të grurit, fshati Vilshany në rajonin e Kharkiv.

ARKIVI DIXITAL I LËVIZJES ÇLIRIMTARE TË UKRAINËS



Mykola Bokan me fëmijët që i kishin mbetur, gjatë funeralit të të birit Kostya, i cili vdiq nga uria më 10 Korrik 1933.

ARKIVI DIXITAL I LËVIZJES ÇLIRIMTARE TË UKRAINËS

Ukrainë do të rezultonte me burgosjen e saj dhe vdekje për fëmijët e saj, të cilët do të liheshin të përkujdeseshin për vetveten. Oleksandra Radchenko e kuptoi se çfarë rreziqesh ndërmori duke ia besuar ditarit të saj të vërtetën e asaj që pa dhe çfarë e priste nëse ai ditar do të zbulohet. Por ajo nuk mund të kufizohej nga të shkruarit në ditarin e saj:


"E Martë, 5 prill 1932. Uria, një krizë artificiale urie, po merr një karakter monstruoz. Pse po na marrin edhe kokrrën e fundit të grurit të bukës? Askush nuk e kupton përse. Dhe ata vazhdojnë të marrin gjithçka deri në kokrrën e fundit, duke e parë mirë se cilat janë rezultatet. Fëmijët torturohen nga uria ekstreme dhe kanë krimba nga ngrënia e panxharit të papërpunuar, gjë e cila nuk do zgjasë deri në korrrjen tjetër brenda katër muajve. Çfarë do të ndodhë atëherë?? "

"E Mërkurë, 6 prill 1932. Ndonjëherë më kap një zemërim i pakontrollueshëm dhe ndihem e sëmurë. Kam lexuar për "shpejtësinë sovjetike" (raportuar në gazetën Komuniste 'Pravda '), për hapjen e furrënaltës së parë në EUROPEË, për përfundimin e digës në Dniprostroy dhe shumë më tepër. Kjo e gjitha është një gjë e mirë, por çfarë dobie ka kjo shpejtësi krahasuar me fëmijët dhe burrat e ënjtur për shkak të urisë dhe urisë ekstreme? Në përgjithësi uria fillon të bëhet gjithnjë e më e keqe dhe sjell me vete të gjitha problemet tona, gjithçka që mund të imagjinoni. Krimi zhvillohet me një shpejtësi të veçantë... Mendimet për fëmijët e ënjtur, të uritur më torturojnë dhe zemërimi më rritet"

"E Enjte, 2 qershor 1932. Është zor të mbijetosh dhe sa vjen e vështirësohet dëshpërimisht më shumë. Është një kohë e pazakontë, që muk ka ndodhur kurrë më parë në histori. Të gjithë vuajnë për shkak të keqshqyerjes ose urisë dhe ekzistencës së varfërisë. Për më tepër, e papërcaktueshmja është e tmerrshme dhe dëshpëruese."

"E Dielë, 20 nëntor 1932. Plaku, i cili punonte në kasollen e lepurit, u 'grabit' nga autoritetet, siç tha ai. Kjo do të thotë se gjithçka si drithërat dhe perimet ia morën. Ai është shpronësuar për dy vjet, pothuajse një lypës, përveç që nuk lyp. Ai është 70 vjeç, gruaja e tij është 65 dhe vajza e tyre me aftësi të ndryshme jeton me ta. Dhe tani, të mjeruar, ato pak që kishin e që mund të zgjatnin deri në shkurt, ua morën."

"E Hënë, 9 janar 1933. Tmerret e urisë po përhapen në Kharkiv. Fëmijët po rrëmbehen dhe po shiten salçiçe të bëra me mish njeriu. Të rriturit më të shëndetshëm po mashtrohen dhe rrëmbehen nga individë që supozohet se shesin këpucë. Kjo u raportua në gazeta, duke u kërkuar njerëzve të ishin të qetë, sepse po merren masa... por fëmijët ende po zhduken."



**Një faqe nga ditar i
Oleksandra Radchenko.**

ARKIVI DIXHITAL I LËVIZJES ÇLIRIMTARE
TË UKRAINËS

“E enjte, 23 mars 1933. Në këtë ditë pashë tmerrësisht shumë vuajtje njerëzore. U ktheva në shtëpi me përshtypje të rënda. Rrugës për në fshatin Zarozhne, në fushën afër rrugës, pamë një plak, i cili ishte i dobët, me rroba zhele dhe pa çizme. Mbase ai ra i tretur dhe i rraskapitur dhe pastaj ngriu për vdekje, ose thjesht vdiq dhe ra... dhe dikush i mori çizmet. Kur u kthyem nga fshati e pamë përsëri. Askush nuk kishte më nevojë për të...”

“Duke u nisur nga Babka, arritëm një djalë shtatë vjeç. Shoqëruesi im e thirri. Sidoqoftë, djali vazhdoi të ecte duke iu marrë këmbët dhe u duk sikur nuk na dëgjoi. Kur kali arriti tek ai, unë bërtita dhe djali u largua pa dëshirë nga rruga. Unë isha kurioze ta shihja në fytyrë. Shprehja e fytyrës së tij më bëri një përshtypje të tmerrshme, tronditëse dhe të paharrueshme. Ndoshta një shprehje e tillë e syve ndodh tek njerëzit kur ata e dinë që po i afrohen vdekjes. Megjithatë, ata nuk duan të vdesin. Por ky ishte një fëmijë! Nuk mund t'i kontrolloja dot emocionet: Për çfarë arsye? Pse fëmijë? Qava në heshtje, që shoqëruesi im të mos shihte. Mendimi se nuk mund të bëj asgjë, se miliona fëmijë po vdesin nga uria, tmërri i pashmangshëm, më çoi në dëshpërim...”

“Disa ditë më parë erdhi një stallier - fytyra dhe krahët i ishin ënjtur të gjitha. Ai tha se këmbët i janë rënduar dhe është gati të vdesë. Është për të ardhur keq për fëmijët. Ata nuk kuptojnë asgjë – ata nuk janë fajtorë.”

Oleksandra Radchenko dhe tre vajzat e saj, më e vogla e të cilave lindi në vitin 1931, i mbijetuan Holodomorit. Ato nuk u prekën nga vala e shtypjeve të Terrorit të Madh më 1937 – 1938. Por shumë fatkeqësi do t'u ndodhnin më pas.

Në vitin 1940, familja Radchenko u transferua në Bukovyna, e cila kohët e fundit ishte aneksuar nga Bashkimi Sovjetik. Në verën e vitit 1941, ata u gjendën në fillim të Luftës Gjermano-Sovjetike. Oleksandra dhe burri i saj, Vasyl, u arrestuan nga ushtria rumune, e cila, si aleate e Rajhut të Tretë, pushtoi këtë territor ukrainas. Ata ishin bashkë në kampet e burgut për disa javë, derisa u çliruan nga kolegët e burrit të saj - inxhinierë të pyjeve. Pasi doli nga burgu, Vasyl Radchenko vazhdoi të punonte si pylltar.

SHPRESË E RREME

Në ditët e para pas ndryshimit të pushtetit, shumë banorë të vendit, përfshirë Oleksandra Radchenko, besuan në "çlirimin gjerman nga komunistët". Kjo është arsyeja pse ajo i tregoi një zyrtari gjerman, i cili kishte punuar si korrespondent në shtëpi, për ditarët e saj. Ai i propozoi që t'ia botonte ato. Në mënyrë rutinë, propaganda gjermane përdorte informacione në lidhje me krimet komuniste (ky ishte rasti me informacionin në lidhje me ekzekutimin masiv të të burgosurve në verën e vitit 1941 dhe në lidhje me zbulimin e oficerëve polakë të varrosur në Katyń). Por ditari për Holodomorin nuk u botua nga regjimi



Oleksandra me bashkëshortin dhe vajzën e saj.

ARKIVI DIXHITAL I LËVIZJES ÇLIRIMTARE TË UKRAINËS

i ri. Shpejt Radchenko kuptoi se ky regjim i ri nuk ishte më i mirë se ai i mëparshmi. Për këtë arsye, ajo shkroi në shënimet e saj nga viti 1941 deri në vitin 1942 për krimet e regjimit nazist. Më 1943 një politikë mizore pushtimi preku drejtpërdrejt familjen e saj – vajza e saj 17-vjeçare Elida u dërgua forcërisht për të punuar në Gjermani.

Kthimi i pushtetit Sovjetik në Ukrainë në 1944 rezultoi në një humbje tjetër për familjen Radchenko. Vasyl, burri i Oleksandrës, u dërgua për ndëshkim në një batalion në front, sepse ai kishte "shërbyer nën mbikqyrjen gjermane si pylltar".

Më 1945 lufta mbaroi. Para kësaj, Elida u kthye në shtëpi nga Gjermania. Në gusht, Vasyl Radchenko u kthye, pasi ishte vlerësuar me një "Medalje për Meritat e Betejës". Familja Radchenko më në fund ishte përsëri bashkë.

Por kohërat e mira ishin jetëshkurtra dhe regjimi totalitar ndërhyri përsëri në jetën e tyre. Më 7 korrik 1945, hetuesi i zyrës rajonale Kamyansky-Podilsk të NKVD nënshkroi një urdhër për arrestimin e Oleksandra Radchenko. Gjatë kontrollit në banesën e saj u gjetën shtatë fletore të ditarit që mbulonin periudhën 1926-1943. Ditarët u bënë prova kryesore në padinë e Radchenkos për "agjitacion dhe propagandë anti-sovjetike".

Vajza e saj, Elida, kujton atë moment tragjik në historinë familjare: *"Nëna nuk i fshehu kurrë ditarët e saj. Ata gjetën kutinë ku gjendeshin fletoret e ditarit. Unë munda të fshihja pesë ose gjashtë fletore të tjera nën një jastëk. Kur nëna u arrestua, ne filluam t'i lexonim dhe zbuluam aq shumë tmerre të së shkruarës për Holodomorin sa që kishim frikë se e gjithë familja do të ekzekutohej dhe kështu i dogjëm ato..."* Por informacioni i gjetur në fletoret e kapura nga NKVD ishte i mjaftueshëm për të dënuar mësuesin.

HETIMI

Hetimi zgjati gati gjysmë viti. Oleksandra pranoi menjëherë se ishte autore e ditarëve. Por kjo nuk mjaftoi. Hetuesi u përpoq ta detyronte që të pranonte se shënimet ishin gënjeshtër, se ishin shkruar për të diskredituar regjimin Sovjetik. "Hetimi ishte thellësisht i paramenduar," shkroi ajo pas disa kohësh në ankesën drejtuar prokurorit. "Unë u kërcënova se hetimi im do të zgjaste e do zvarritej, nëse nuk do të nënshkruaja një deklaratë, në të cilin ishte shkruar paraprakisht se në fillim të viteve 1930 unë po mbaja një ditar me përmbajtje kundërrevolucionare. Përshtypjet e mia për burgun, frikën dhe shëndetin e dobët ishin arsyet pse e nënshkrova atë deklaratë."

Sapo hetimi përfundoi, çështja shkoi në gjykatën Proskuriv më 14 dhjetor 1945. Në komentet e

saj para gjykatës, Oleksandra Radchenko mohoi praktikisht provat e regjistruara në çështje duke u thënë gjykatësve: *"Qëllimi kryesor i shkrimeve të mia ishte t'ia kushtoja ato fëmijëve të mi. Shkruajta sepse pas 20 viteve fëmijët nuk do të besojnë se çfarë metodash të dhunshme u përdorën për të ndërtuar socializmin. Populli ukrainas pësoi tmerre gjatë viteve 1930-1933..."*

Sigurisht që gjykatësit nuk e dëgjuan atë, prandaj në akuzë shkruhej se Oleksandra Radchenko *"ishte armiqësore ndaj regjimit sovjetik gjatë viteve 1930-1933 dhe shkruajti një ditar me përmbajtje kundërrevolucionare, i cili dënonte veprimet e Partisë Komuniste për organizimin e fermave kolektive në BS dhe përshkroi kushtet e vështira të jetës së punëtorëve"*. Pavarësisht absurditetit të akuzës, dënimi ishte shumë i vërtetë dhe mizor – dhjetë vjet në Gulag, kampin e përqendrimit. Sapo shkoi në kamp ish-mësuesja vazhdoi të luftonte për lirinë e saj, duke shkruar ankesa dhe protesta; megjithatë kjo gjë nuk e ndryshoi fatin e saj.

KTHIMI NË UKRAINË

Oleksandra Radchenko u kthye në Ukrainë në gusht 1955 pasi përfundoi tërë kohën e burgimit. Si rezultat i shëndetit të saj, ajo jetoi si njeri i lirë për vetëm dhjetë vjet më shumë.

Disa javë para shpërbërjes dhe shembjes së regjimit Sovjetik në vitin 1991, Radchenko ishte "rehabilituar pas vdekjes". Sovjetikët pranuan se ajo ishte burgosur padrejtësisht. Ditaret e saj (fatkeqësisht jo kompleti i plotë – tre fletore u dogjën gjatë hetimit sepse "nuk kishin informacion të dobishëm") ishin ruajtur në arkivat e KGB dhe askush nuk dinte për ekzistencën e tyre. Pas rënies së Bashkimit Sovjetik, Shërbimi Sekret i Ukrainës (SSU) trashëgoi këto arkiva, të cilat përmbanin ditarët e mbetur të Radchenkos.

Dokumentet e arkivuara u zbuluan në vitin 2001, përfshirë ditarët që përshkruanin mizoritë e Holodomorit. *"Vetëm rastësisht, dëgjova në radio, se ishte e mundur të rishikohen dokumentet arkivore të Oleksandra Radchenkos," kujton vajza e saj, Elida, "që mbaheshin nga Shërbimi Sekret i Ukrainës. Unë u preka dhe fillova të qaja. Koha e nënës në burg nuk kishte shkuar dëm dhe puna e saj nuk u zhduk. Ajo shkroi të vërtetën..."*

Në vitin 2007, fragmente nga ditarët e saj u botuan në librin *Kujtesa e Deklasifikuar*. Sot, ky libër është një burim i rëndësishëm historik për të hetuar ngjarjet e viteve 1930 në Ukrainë. Fjalët e sinqerta të një mësueseje të dashur, ditarët Radchenko, shkatërrojnë mitet propagandistike të regjimit Sovjetik për një "jetë të lumtur sovjetike" dhe përshkruajnë të vërtetën e tmerrshme në lidhje me ngjarjet gjatë 1932-1933 në Ukrainë.

Në fund, Oleksandra Radchenko përmbushi misionin e saj: ajo e ruajti kujtimin për tragjedinë e Holodomorit dhe ua dorëzoi atë pasardhësve të saj.

KONTRIBUT I QENDRËS PËR KËRKIME PËR LËVIZJËN ÇLIRIMTARE

AYSHE SEITMURATOVA lindi në 1937 në fshatin Hadzhi-Elie të gadishullit të Krimesë. Babai i saj, Seitmurat Borseitov, u vra në aksion duke mbrojtur BS. Kur Ayshe ishte vetëm shtatë vjeçe, bashkë me mamanë Naime dhe gjashtë motrat e vëllezërit e saj, u dëbua në rajonin e Samarkand në Uzbekistan (Azia Qendrore). Studimet universitare të saj u ndërpre në vazhdimisht nga autoritetet për shkak të anëtarësisë së saj aktive në lëvizjen kombëtare Tatar të Krimesë. Ajo u burgos për punën si aktiviste që nga 1971 deri në 1974. Emigroi në Nju Jork më 1979. Qysh atëherë, ajo ka bërë fushatë në emër të Tatarëve të Krimesë, një minoritet musliman, e vendosur për të treguar historinë e tyre dhe për t'u siguruar atyre një mënyrë për t'u kthyer në tokën mëmë. Ajo aktualisht është drejtoresha e shërbimit të infermierisë shtëpiake për tatarët krimean të vetëm, të quajtur Qartlar Evi në Simferopol.



ARIKIVA PRIVATE
E AYSHE SEITMURATOVA

Ayshe Seitmuratova

Historia e një Populli që Refuzon të Vdesë

shkruar nga Ali Khamzin

Shkaku kryesor i historisë tragjike të shekullit të njëzet, me krimet e tmerrshme kundër njerëzimit, me shumë luftëra të tërbuara që rezultuan në humbjen e jetëve njerëzore në shkallë masive, ishte vendosja e një regjimi totalitar në Rusi. Një përpjekje e zbatimit praktik të parullave të çmendura ideologjike në lidhje me nevojën për "fitoren e revolucionit socialist në të gjithë botën". Ishte i ashtuquajturi "revolucionit socialist" i Rusisë në 1917, me parullat e tij të rreme të barazisë sociale, që më vonë u bënë një fazë nga e cila do të përhapej ideologjia e Nacional-Socializmit Gjerman, dhe nazistët morën pushtetin politik në Gjermani.

Sistemi nazist pohoi gjithashtu nevojën për të vendosur një lloj barazie shoqërore dhe drejtësie që i përkisnin "racës gjermane Ariane". Kjo frymë ideologjike ishte e kundërta e regjimit komunist. Krime të tilla të tmerrshme të dëbimit të popujve të tërë nga vendlindjet e tyre, u shoqëruan me gjenocid të bashkësive etnike. Ky ishte rezultat i veprimit komunist rus me regjimin totalitar.

Populli Tatar i Krimesë ishte një nga grupet e shumta të njerëzve që në maj të 1944 u dëbuan nga ai regjim nga Krimea në Azinë Qendrore dhe Rusinë Veriore. Gjatë viteve të para të mbikëqyrjes së NKVD (anuluar vetëm në 1956), kombi humbi rreth gjysmën e popullsisë së tij. Ishin kryesisht fëmijë, gra dhe burra të moshuar, përfshirë ushtarë tatarë të Krimesë që kishin luftuar kundër Gjermanisë naziste dhe kishin punuar në ushtrinë e punës.

Ka shumë njerëz të zgjuar dhe patriotë në historinë e luftës kombëtare që ndikuan në kthimin e tatarëve të Krimesë në atdheun e tyre. Ayshe Seitmuratova ishte një grua e guximshme që sfidoi regjimin totalitar të BS.



Ayshe si studente, Samarkand, 1957.

ARKIVA PRIVATE E AYSHE SEITMURATOVA



Ayshe (lart majtas) me shoqërinë konviktore në Universitetin Shtetëror të Samarkand, gjatë viteve të hershme 1960.

ARKIVA PRIVATE E AYSHE SEITMURATOVA

u vra në aksion duke mbrojtur BS. Nëna e saj Naime, me shtatë fëmijë, u dëbua në rajonin e Samarkand në Uzbekistan (Azia Qendrore).

Dëbimi, poshtërimi dhe vuajtja e duruar nga familja dhe njerëzit e saj, lanë një gjurmë të thellë në shpirtin e Ayshe. Kështu, pasi mbaroi shkollën e mesme, ajo synoi të eksploronte historinë e popullit të saj dhe të zbulonte arsyet e persekutimit dhe diskriminimit të tyre. Më 1958, ajo filloi studimet në Fakultetin e Historisë në Universitetin e Samarkand. Më 1963, Ayshe u diplomua me nderime nga Universiteti. Ajo filloi të punojë në një shkollë lokale dhe si asistente në Fakultetin e Historisë.

Më 1964, ajo bëri një përpjekje për të fituar pranimin në shkollën pas-universitare të historisë në Akademinë e Shkencave të BS. Ajo i kaloi me sukses të gjitha provimet. Megjithatë nuk u pranua, për shkak të aktivitetit të saj në Lëvizjen Kombëtare të Tatarëve të Krimesë.

Ayshe ishte anëtare e grupit nismëtar në Samarkand dhe më vonë u bë pjesë e Grupit Nismëtar të Uzbekistanit. Si përfaqësuese kombëtare e tatarëve të Krimesë ajo udhëtonte vazhdimisht në Moskë. Së bashku me bashkëpunëtorët e saj, në takimet me udhëheqësit e partisë, ajo u përpoq të provonte padrejtësinë dhe pavlefshmërinë e dëbimit të tatarëve të Krimesë.

Aktiviteti dhe pozicioni i saj kryesor monitorohej gjithmonë nga qeveria Sovjetike dhe KGB.

Në fund të vitit 1965, ajo u përjashtua nga universiteti.

Më 14 tetor 1966 gjatë marrjes në pyetje nga KGB e Samarkand, Ayshe u arrestua. Ajo u shoqërua me roje në Moskë. Më 24 tetor ajo u akuzua për kryerjen e një krimi, duke pretenduar se ajo "merrej me përgatitjen, shtypjen dhe shpërndarjen e dokumenteve shpifëse që turpëronin dhe irritonin BS". Një gjyq i fshehtë u bë në maj të 1967 dhe ajo u dënua me tre vjet mbikëqyrje nga autoritetet.

Ajo dha një kontribut të madh në luftën për kthimin e popullit të saj në Krime dhe rivendosjen e të drejtave kombëtare (1979-1990). Si korrespondente e stacionit radiofonik të Zërit të Amerikës në SHBA, ajo informoi të gjithë botën dhe publikun Sovjetik për gjendjen e rënduar të popullit tatar të Krimesë, për luftën e tyre vetëmohuese dhe afatgjate, për të drejtën për të jetuar në atdheun e tyre në Krime.

JETA E HERSHME

Ayshe Seitmuratova lindi në 1937 në fshatin Hadzhi-Elie, rrethin e Mayak-Salynsky, që ndodhej në gadishullin e Krimesë. Babai i saj, Seitmurat Borseitov,

Brenda një viti, Ayshe Seitmuratova u bë përfaqësuese e popullit të saj vendas në Moskë. Ajo gjithashtu mori pjesë aktive në mbledhjen e materialeve të shumta për tatarët e Krimesë, libra të vetështypur, etj. Ajo përpiloi tekste, protesta dhe thirrje drejtuar autoritetit suprem shtetëror të BS. Ajo shkroi materiale rreth Lëvizjes Kombëtare të tatarëve të Krimesë dhe i shpërnda ato përmes organizatave sovjetike për të drejtat e njeriut.

Në vjeshtën e 1967, ajo bëri një përpjekje të katërt për t'u bërë studente pasuniversitare. Ajo i ndërthuri studimet me kontributin e saj në betejën e popullit për t'u kthyer në mëmëdhe.

BURGOSJA

Në qershor të vitit 1971, disa muaj para se të mbronte tezën e saj, ajo u arrestua përsëri dhe u dënua me tre vjet burgim sipas Kodit Penal të Uzbekistanit dhe Rusisë. Ayshe kreu dënimin e saj në kampet e Mordovias.

Ajo u la e lirë në 1974. Iu mohua mundësia për të bërë kërkime dhe për të dhënë mësim. Por as burg, as privimet dhe poshtërimet nuk mund ta thyenin shpirtin e Ayshe. Si një figurë e mirënjohur publike, Ayshe kuptoi se Bashkimi Sovjetik i kufizonte aktivitetet dhe përpjekjet e saj për të luftuar.

Më 1978, Ayshe zbuloi se autoritetet kishin plan që ta shtronin me forcë në një spital psikiatrik. Ajo deklaroi hapur: *“Do të ishte më mirë t'i vija flakën vetes dhe të digjesh në Sheshin e Kuq. Nuk kam asgjë për të humbur. Por para se ta bëj këtë, unë do t'i drejtohem botës myslimane dhe do përshkruaj jetën e grave muslimane në BS”*.

Ayshe i shkruajti Andropov¹: *“Të gjitha format e përndjekjes në këshillat e vendit po vonojnë vdekjen time.”*

Më 23 qershor 1978, gjatë një proteste kundër politikave diskriminuese të autoriteteve në Krime, të cilët nuk i lejuan tatarët e Krimesë të jetonin lirshëm në vendin e tyre, Musa Mamut² kreu një akt vetëfljimi. Autoritetet Sovjetike nuk dëshironin të kishin një skandal tjetër që mund të shkaktonte një reagim negativ në opinionin publik sovjetik dhe ndërkombëtar. Përfundimisht, Ayshe u lejua të emigronte.

EMIGRIMI DHE NJË JETË E RE AKTIVIZMI

Në nëntor 1978, me ndihmën e një "ftese Hebreje", Ayshe udhëtoi për herë të parë në Vjenë dhe në janar 1979, ajo arriti në Nju Jork.

¹ Yuri Vladimirovich Andropov, një politikan Sovjetik dhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik nga 12 nëntor 1982 deri në vdekjen e tij pesëmbëdhjetë muaj më vonë [shënim i botuesit]

² Musa Mamut lindi në një familje barinjsh në Krime. Më 23 qershor 1978, ai derdhi benzinë mbi trup dhe i vuri flakën vetes për të protestuar kundër dëbimit të tatarëve të Krimesë. Ai vdiq pesë ditë më vonë [shënim i botuesit].

Revista e pavarur myslimane *Ndikimi Ndërkombëtar* (Impact International) shkroi: “*Sovjetikët besuan se i kishin dhënë fund Ayshe, por gabuan. Ajo u tregoi të gjithëve se si një komb i vogël mysliman u shkatërrua në Krime*”. Emigrimi në Shtetet e Bashkuara, përtej Perdes së Hekurt shënoi një kapitull të ri në jetën e Ayshe

dhe një fazë të re në luftën për të drejtat e njeriut dhe ato kombëtare të tatarëve të Krimesë.

Ajo u vendos në Nju Jork dhe u bë korrespondente tek transmetuesi radiofonik i Zërit të Amerikës. Transmetimet në gjuhën ruse, gjuhët uzbeke dhe azere informuan publikun për çështjet e tatarëve të Krimesë. Zëri i saj mund të dëgjohej në valët e Radio Svoboda (Radio Europa e Lirë), BBC dhe Deutsche Welle.

Transmetimet e Ayshe eksploruan historinë, kulturën, gjuhën dhe situatën politike të njerëzve. Temat përfshinë: “Gjuhët kombëtare të BS (duke përdorur shembullin e gjuhës Tatarë të Krimesë)”, “Eliminimi i letërsisë së Tatarëve të Krimesë”, “Shkatërrimi i Inteligjencës së Tatarëve të Krimesë (1917-1940)”, “Dokumente mbi politikën e asimilimit të Tatarëve të Krimesë”, etj.

Përveç punës në stacionet radiofonike kryesore në botë, Ayshe mori pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare për të drejtat e njeriut: në Uashington, Otava, Montreal, Londër, Stokholm, Oslo, Ankara, Stamboll dhe Romë. Duke vlerësuar pjesëmarrjen e saj në Konferencën e Pestë Ndërkombëtare Sakharov, e cila u zhvillua nga 10 deri më 11 prill 1985 në Londër, revista *Ndikimi Ndërkombëtar* shkruajti: “*Prania e saj në seancë ishte veçanërisht e rëndësishme pasi realiteti i ashpër i trajtimit sovjetik të pakicave nuk ishte i njohur përgjithësisht. Ishte gjithashtu një kujtesë se 'njerëzit e harruar' të BS përbëheshin nga myslimanë. Ishin më shumë se 50 milionë, megjithëse problemi pothuajse nuk u ngrit kurrë në forumin ndërkombëtar. Kjo ishte domethënëse, sepse dihej shumë pak për ta. Ayshe, një nga emigrantët e pakët myslimanë nga Bashkimi Sovjetik, ishte në gjendje të*

EMIGRIMI NGA VENDET KOMUNISTE

Emigrimi nga Blloku Lindor, në shumicën e rasteve, ishte i ndaluar me urdhër të prerë. Arratisja ishte e komplikuar për shkak të lejeve jashtëzakonisht të kufizuara për të udhëtuar jashtë vendit, kontrollit efektiv të kufijve dhe kufijve që ruheshin shumë në Europën Perëndimore (Perdja e Hekurt). Mijëra u vranë duke u përpjekur të kalonin kufijtë për në Perëndim; shumë më tepër u kapën gjatë përpjekjes për të lënë vendin dhe u dënuan me vite të gjata në kampe burgimi.

Shumë pak grupe turistike që u lejuan të udhëtonin jashtë vendit u kontrolluan në mënyrë rreptë nga udhëheqësit e grupeve dhe gjithashtu nga agjentët e policisë sekrete të cilët ishin përfshirë në secilin grup. Një mënyrë tjetër e largimit nga vendi ishte dëbimi nga atdheu si dënim. Të ndëshkohesh në një mënyrë të tillë ishte "privilegji" i vetëm i disa disidentëve të shquar, të cilët zakonisht ishin bërë të mirënjohur jashtë vendit para dëbimit të tyre, si romancieri Alexander Solzhenitsyn.

Të gjitha llojet e metodave u përdorën për t'i shpëtuar "parajsës komuniste". Njerëzit merrnin me forcë komandën në avionët e pasagjerëve, kapërcenin me sukses kufijtë të ruajtur në mënyrë të rreptë, shkaktonin defekte gjatë udhëtimit turistike, të biznesit ose ato private, etj. Por të gjitha këto metoda u përdorën gjithashtu nga shërbimet sekrete Komuniste për të infiltruar agjentët e tyre në Perëndim. Prandaj, shumica e emigrantëve u desh të kalonin nëpër "kontrolle të hollësishe" nga agjencitë perëndimore përkatëse.

Kufizimet e udhëtimit në disa vende të Europës Lindore ishin më të buta në disa periudha. Kështu p.sh., shumë njerëz arritën të arratiseshin nga Hungaria pas Revolucionit të 1956 dhe Çekoslovakia pas shtypjes së Pranverës së Pragës më 1968 dhe miliona gjermanë u larguan nga Gjermania Lindore para ndërtimit të Murit të Berlinit më 1961.

Gjermania Lindore gjithashtu "shiti" në mënyrë famëkeqe qytetarët e saj që dëshironin të emigronin në Gjermaninë Perëndimore.

jepte një përshkrim autoritar dhe të besueshëm për kushtet në të cilat ata jetonin.”

Në mënyrë që të paralajmëronte publikun për problemet e tatarëve muslimanë të Krimesë, Ayshe Seitmuratova mori pjesë në tre konferenca ndërkombëtare myslimane të iniciuara nga Organizata e Konferencës Islamike (e cila përfshin 43 vende) në Londër (1980), Paris (zyra e UNESCO në dhjetor të 1980) Kuala Lumpur (nëntor - dhjetor 1981). Ayshe ishte gruaja e vetme midis pjesëmarrësve në një konferencë në Malajzi në 15 vjetorin e një shekulli të Islamit. Ajo foli e veshur me rrobat kombëtare të tatarëve të Krimesë, duke i treguar pjesëmarrësve kulturën e popullit të saj.



Ayshe midis delegatëve të mbledhjes së dytë të Popullit të Tatarëve të Krimesë, Simferopol, qershor 1991.

ARKIVA PRIVATE E AYSHE SEITMURATOVA

Ayshe Seitmuratova lloboi në mënyrë aktive për interesat e tatarëve të Krimesë në Aktin Përfundimtar të Konferencës mbi Marrëveshjet e Helsinkit. Në nëntor 1980, ajo u ftua të merrte pjesë në një konferencë në Madrid dhe në nëntor 1986 në Vjenë. Duke folur në Konferencën e Madridit, si përfaqësuese e autorizuar e tatarëve të Krimesë në Perëndim, ajo iu drejtua Aktit Përfundimtar të Marrëveshjeve të Helsinkit për të mbështetur popullin tatar të Krimesë në përpjekjen për t'u kthyer në tokën e tyre amtare në Krime dhe të përkrahte anëtarët e dënuar të lëvizjes kombëtare të tatarëve të Krimesë: Mustafa Dzhemilev, Seydameta Memetova, Eldar Shabanov, Mamedov Chobanov, Dzhemilev Kadyeva Roland dhe të tjerë.

"Shpresoj," tha ajo, "që anëtarët do të respektojnë parimet e Aktit Final të Helsinkit. Anëtarët do të respektojnë barazinë e të gjithë popujve dhe të drejtën e tyre për vetëvendosje, duke vepruar çdo kohë në përputhje me kërkesat dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe Ligjit Ndërkombëtar. Delegatë të dalluar të takimit të Madridit, mbronin të drejtat kombëtare dhe njerëzore të Tatarëve të Krimesë!"

Ayshe Seitmuratova prodhoi një broshurë në anglisht në Konferencën e Vjenës, për mbrojtjen e Mustafa Dzhemilev, i cili në atë kohë ishte në burg në Magadan. Broshura përmbante fakte të ndryshme dhe fotografi të Dzhemilev.

Konferenca e Vjenës nxiti lirinë e të burgosurve politikë të BS. Pas kësaj, me urdhër të Mikhail Gorbaçov, Sakharov u kthye në Moskë nga internimi dhe Dzhemilev u lirua nga kampi.

Ayshe Seitmuratova ka folur për vështirësitë e tatarëve të Krimesë në parlamentet e Kanadasë, Britanisë së Madhe, Italisë, Turqisë, Francës dhe Kongresit Amerikan. Këto shfaqje ngjallën një përgjigje dhe një dëshirë për të ndihmuar tatarët e Krimesë. Kështu, gjatë vizitës së saj në Itali, pak para se në vend

të bëhej vizita e Gorbaçovit, Ayshe gjithashtu arriti të kërkonte mbështetjen e senatorëve italianë, të cilët i kushtonin vëmendje të madhe problemeve të tatarëve të Krimesë. Gjatë një bisede me senatorin kanadez Paul Yuzik, ky i fundit e përfundoi takimin me thirrjen për gazetaret, "Unë dua që ju t'i thoni botës me zë të lartë se këta njerëz duhet të shpëtohen."

Ajo u takua me udhëheqës nga e gjithë bota, për të ngritur zërin e bashkësisë ndërkombëtare në mbështetje të popullit tatar të Krimesë. Ayshe u ftua dy herë në Shtëpinë e Bardhë për t'u takuar me Presidentin Reagan (1982, 1988). Ajo bisedoi me presidentët Turgat Ozal (Turqi), Václav Havel (Republika Çeke) dhe Leonid Kravchuk (Ukrainë).

Për të tërhequr vëmendjen për problemin e studentëve dhe studiuesve tatarë të Krimesë, Ayshe ligjëroi në universitete dhe kolegje të ndryshme nëpër botë për tatarët e Krimesë dhe bëri thirrje që ata të lejohen të kthehen në shtëpitë e tyre.

Ayshe gjithashtu mori pjesë në organizata ndërkombëtare si Amnesty International, Lidhja Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Grupi i Helsinkit të SHBA, Qendra për Demokraci në Bashkimin Sovjetik dhe më shumë.



Festimi i Kurban Bajramit (Eid al-Adha) festë zyrtare në shtëpinë infermiere të Qartlar Evi, Simferopol, 2001.

ARKIVA PRIVATE E AYSHE SEITMURATOVA

Në 1986, ajo organizoi Komitin për Mbrojtjen e Mustafa Dzhemilev në 12 vende, duke lobuar për lirim të Yuri Osmanov, Reshat Ablaev, Sinaver Kadyrov dhe anëtarëve të tjerë të lëvizjes kombëtare të tatarëve të Krimesë.

Fjalimet dhe artikujt nga Seitmuratova kishin një rëndësi të madhe në mediat ndërkombëtare në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit ndërkombëtar dhe publik të problemit të tatarëve të Krimesë. Puna e saj u shfaq në botime të tilla me ndikim si *Kontinent*, *Le Nouvel Espoir*, revista *Rabitat Al-Alam Al-Islami*, *Bota e Re Ruse* dhe të tjerë.

Ajo e ngriti zërin në mbrojtje të kombeve të shtypura të tjera nga regjimi Komunist. Revista RCDA botoi një artikull të quajtur *Gjenocidi në Bullgari* (bashkautor me Ibrahim Tuna), kushtuar bullgarizimit të dhunshëm të myslimanëve turq. Artikujt e saj mund të shihen në libra të botuar nga Universiteti i Kolumbias, Harvardit dhe të tjera. Në 1997, u botua një broshurë e quajtur *Lëvizja Kombëtare e Tatarëve të Krimesë*. Në fund të viteve 1980 deri në fillim të viteve 1990 Ayshe ishte e zënë me shpërndarjen e ndihmës humanitare për bashkatdhetarët, të cilët ishin kthyer në shtëpi pa ndihmën e agjencive qeveritare në periudhën e krizës së

rëndë ekonomike dhe sociale të BS dhe shkatërrimin e mëvonshëm të tij. Këta njerëz u përballën me shumë sfida, përfshirë vështirësitë financiare të shkaktuara nga mbajtja e kursimeve të tyre bankare.

Në 1992, ajo krijoi dhe drejtoi një fond bamirësie të quajtur *Merhamet Evi* (Shtëpia e Mëshirës). Qëllimi i saj ishte të siguronte ndihmë materiale, mjekësore dhe juridike për të moshuarit që ishin vetëm dhe për familjet me shumë fëmijë.

TRASHËGIMIA E SAJ

Sigurisht, veprimtaria e Ayshe Seitmuratova si korrespondente e Zërit të Amerikës ishte e paçmuar. Ishte një kontribut i madh në luftën e lëvizjes për të drejtat e njeriut në Bashkimin Sovjetik dhe lëvizjen kombëtare të popullit tatar të Krimesë kundër regjimit Komunist. Ajo ishte aktivistja më e rëndësishme Sovjetike për të drejtat e njeriut dhe një nga pjesëmarrëset më aktive në lëvizjen kombëtare të popullit tatar të Krimesë, një figurë e shquar publike, e cila i kuptoi në mënyrë komplekse krimet e regjimit Komunist të BS, brenda dhe jashtë, dhe e kuptoi rrezikun e ideologjisë dërrmuese të urrejtjes për njerëzimin. Në mbrojtje të të drejtave të njerëzve të shtypur, ajo dha një kontribut të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në "perandorinë e djallëzore", e cila natyrshëm u shemb në fund të vitit 1991.

Aktualisht ajo është drejtoresha e shërbimit infermieror në shtëpi për tatarët e vetëm të Krimesë të quajtur Qartlar Evi në Simferopol. Rruga e jetës së Ayshe Seitmuratova, lufta e saj vetëmohuese për rivendosjen e të drejtave kombëtare dhe civile të tatarëve të Krimesë, është një shembull kryesor i luftës së popullit atar të Krimesë për mbijetesë, ringjallje dhe zhvillim në atdheun e tyre në Krime. Një revistë ndërkombëtare i referohej historisë së Ayshe Seitmuratova si historia e një populli që refuzon të vdesë.

□ Ky abstrakt u shkrua në bazë të gazetave, revistave, burimeve të internetit dhe librave, përfshirë kontributin e Gulnara Bekirova, Ph.D. dhe Edie Muslyumova "Ayshe Seyitmuratova është në mikrofon: transmetimi në Radio Freedom"; dhe artikulli nga Eldar Seydametov, Ph.D.: "Roli i Ayshe Seitmuratova në lëvizjen e solidaritetit të tatarëve të Krimesë të diasporës në SH.B.A. për kthimin e bashkatdhetarëve në atdheun e tyre, Krime".

KONTRIBUT I MEJLIS POPULLIT TATAR TË KRIMESË

FRANCË

Gjatë Republikës së Tretë në vitet 1930, Franca ndërtoi një sistem fortifikimi masiv kundër sulmeve të mundshme gjermane të quajtur linja Maginot. Ajo kalonte përgjatë kufijve të saj me Italinë, Zvicrën, Gjermaninë dhe Luksemburgun.

LUFTA E DYTË BOTËRORE DHE PUSHTIMI NAZIST

Pasi Gjermania naziste pushtoi Poloninë, Franca së bashku me Britaninë e Madhe i shpallën luftë Gjermanisë më 3 shtator 1939. Gjermania filloi Betejën e Francës më 10 maj 1940. Trupat gjermane tejkaluan vijën Maginot përmes Belgjikës dhe Parisi u pushtua më 14 qershor 1940. Vichy Francë u vendos më 10 korrik 1940 për të qeverisur pjesët e pushtuara të Francës Juglindore, me trupat gjermane që kishin në zotërim gjashtëdhjetë përqind të territorit. Deri në nëntor 1942, i gjithë territori francez në Europë u pushtua. Regjimi Vichy bashkëpunoi me Gjermaninë naziste. 76,000 hebrenj u dëbuan në kampet e shfarosjes naziste. Pas një thirrjeje të Charles de Gaulle nga Britania, u formua një lëvizje e gjerë e rezistencës së armatosur që më vonë luftoi së bashku me aleatët. Forcat aleate zbarkuan në Normandi më 6 qershor 1944 (Dita-D). Parisi u çlirua në gusht 1944. Ushtria franceze vazhdoi të luftonte deri në humbjen e Gjermanisë në maj 1945. Një qeveri e përkohshme e udhëhequr nga Charles de Gaulle u krijua më 3 qershor 1944 dhe funksionoi deri në krijimin e Republikës së Katërt më 27 tetor 1946. Humbjet totale franceze në Luftën e Parë Botërore ishin rreth 210,000 ushtarë dhe 350,000 viktima civile.



NËNA MARIA SKOBTSOVA - Elisabeth Pilenko lindi më 8 dhjetor 1891 në Riga në Perandorinë Ruse. Poete, artiste, eseiste, ishte gruaja e parë që kreu Akademinë Teologjike të Shën Petersburgut. Ajo u largua nga Bashkimi Sovjetik dhe u vendos në Paris në vitin 1923. E tronditur nga vdekja e vajzës së saj, gjatë së cilës mori një "thirrje" nga Zoti, ajo u bë murgeshë dhe mori emrin Maria, nisur nga Shën Maria Egjiptiane. E angazhuar në aksionin e krishterë studentor rus, ajo arriti të lirojë një numër të madh rusësh që gabimisht qenë mbyllur në spitalet mendore. Në vitin 1935, ajo krijoi Aksionin Ortodoks, një shoqatë bamirëse dhe shoqërore. Në tetor 1939, asaj iu bashkua At Dimitri Klepinin, dhe në verën e vitit 1940, ajo organizoi një rrjet rezistence me të, objektivi i të cilit ishte të mbronte të gjithë ata të gjuajtur nga regjimi nazist, duke filluar nga hebrenjtë. Në korrik 1942, ajo shpëtoi tre fëmijë hebrenj gjatë grumbullimit masiv të Vélodrome d'Hiver në Paris. Ajo u arrestua me At Klepinin në shkurt 1943 dhe u deportua në kampin e përqendrimit Ravensbrück, ku vdiq më 31 mars 1945. Ajo u njoh nga Memoriali Yad Vashem si e Drejtë Ndër Kombet në 1985 dhe u shpall shenjtorë nga Kisha Ortodokse në 2004.



FOTO PUBLIKE

Nënë Maria Skobtsova

Një revolucionare që u bë shenjto

shkruar nga Dr. Antoine Arjakovsky

Nënë Maria Skobtsova lindi si Elisabeth Pilenko më 8 dhjetor 1891 në Rigë, në Perandorinë Ruse. Duke qenë poete, ajo ishte pjesë e të njëjtëve rrethe si figurat më të shquara të Epokës së Argjendtë të kulturës ruse, si Anna Akhmatova, Marina Tsvetaeva dhe veçanërisht Alexander Blok. Gjithashtu, ajo ishte gruaja parë që përfundoi studimet në Akademinë Teologjike të Shën Pjetërburgut. Në vitin 1910, ajo u martua me Dimitri Kuzmin-Karavaev dhe pati një vajzë të quajtur Gayana. Tre vite më vonë, në moshën 21-vjeçare, ajo u divorcua prej tij. E angazhuar politikisht me socialistët revolucionarë, partia i besoi asaj detyrën e vrasjes së Leon Trotskyt¹. Megjithatë, ajo e refuzoi këtë detyrë për shkak të besimit të saj të krishterë. Më pas, në vitin 1934, kur Leon Trotsky shkoi në Paris, ajo i tregoi për këtë ngjarje. Në shenjë mirënjohjeje, drejtuesi i dëbuar bolshevik pagoi faturën për qymyrin që përdorej në shtëpinë që ajo kishte ngritur për gratë e reja beqare.

Në vitin 1917, ajo u emërua kryetare e komunës së Anapës në Krime, qyteti ku kishte kaluar një pjesë të fëmijërisë së saj. Megjithatë, shumë shpejt ajo pati konflikt me autoritetet bolshevike. Ajo u gjykua nga një tribunal revolucionar, por gjyqtari i saj u dashurua me të! Në vitin 1919, ajo u martua me të. Emri i tij ishte Daniel Skobtsov dhe me të ajo pati dy fëmijë, Yuri dhe Anastasia. Familja u largua nga Bashkimi Sovjetik dhe, duke kaluar përmes Gjeorgjisë, Kostandinopojës dhe Serbisë, u vendos në Paris në vitin 1923. Asokohe, kryeqyteti francez ishte një nga vendet kryesore të emigrantëve rusë. Në atë vend u ngrit Instituti Teologjik Ortodoks Shën Sergius, ku At Sergius Bulgakov jepte mësim, dhe ku ndodhej gjithashtu Akademia e Filozofisë Fetare, e themeluar nga filozofi Nikolai Berdyaev. Ajo krijoi një lidhje të ngushtë me të dy ata dhe morën pjesë bashkërisht në aktivitetet e Aksionit të Krishterë të Studentëve Rusë, një organizatë e krijuar në Prešov, Çekosllovakia, në vitin 1923.

Në vitin 1926, ajo humbi të bijën, Anastasian, e cila ndërroi jetë pas një beteje të gjatë me gripin dhe meningjtitin, gjatë kësaj periudhe Elisabeth pati një thirrje nga Zoti; madje ajo foli për një “vizitë” të

¹ Leon Trotsky (1879 - 1940) ishte një udhëheqës komunist sovjetik. Dikur një aleat i ngushtë i Leninit, ai u dëbua nga Bashkimi Sovjetik nën pasardhësin e Leninit, Stalinin në 1929. Ai i mbijetoi disa përpjekjeve për vrasje dhe u vra nga një agjent sovjetik i NKVD në Mexico City në 1940.

tij. Kjo dramë, por gjithashtu kjo përvojë e dashamirësisë së Zotit, ishte tronditëse për të. Ajo dhe i shoqi vendosën të ndaheshin dhe ajo mori vendimin që t'i përkushtohej tërësisht Zotit. Ajo filloi me botimin e një sërë librave, duke përfshirë dy botime mbi jetën e shenjtorëve, të titulluar *The Harvest of the Spirit* [Vjelja e Shpirtit]. Forma e shenjtërisë që e tërhiqte ishte sakrifica e plotë. Sado i varfëruar të jetë murgu, gjithmonë do të hasë dikë më të varfër se vetja, dikë të cilit mund t'i sakrifikojë dhe të vetmen gjë të mbetur, rrobën e tij të leckosur dhe Ungjillin e tij. Për të, sakrifica e të gjitha sakrificave ishte marrja mbi vete e mëkateve të të tjerëve dhe vuajtja për mëkatet që nuk i ke kryer vetë. Gjithashtu, ajo botoi një sërë studimesh mbi natyrën shpirtërore në revistën *Put'* [Rruga], e redaktuar nga Nikolai Berdyaev, një prej revistave më të rëndësishme në historinë e kulturës ruse të shekullit të XX. Në vitin 1932, me vendim të peshkopit Eulogius (Georgievsky) (1868-1946), “zemrat e të varfërve si shkretëtirë”, ajo u bë murgeshë. Shkretëtira është një referencë për historinë e lashtë të krishterë. Nga shekulli i 3 pas Krishtit, murgjit dhe murgeshat e krishtera do të largoheshin nga qyteti i Aleksandrisë për të jetuar në shkretëtirat e Egjiptit. Ata themeluan komunitete monastike ku ia kushtuan jetën lutjes, agjërimit dhe punës. Elisabeth mori emrin e Marisë, si referencë ndaj një asketeje të krishterë të shekullit të V, “Egjiptianina Mari - një murgeshë e shkretëtirës”.

PËRKUSHTIMI NDAJ NJERËZVE NË NEVOJË

REGJIMI VICHY

Vichy France ishte emri i shtetit francez të kryesuar nga marshalli Philippe Pétain gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pétain ishte një plak dhe një hero i Luftës së Parë Botërore. Kur Franca u sulmua nga gjermanët në qershor 1940, presidenti emëroi Pétain kryeministër. Qeveria nënshkroi armëpushime me Gjermaninë dhe Italinë dhe u transferua në qytetin Vichy në Francën qendrore. Ajo transformoi Republikën e Tretë në një shtet autoritar, diktatorial. Pasi Italia dhe Gjermania pushtuan Francën në nëntor 1942, qeveria e Pétain bashkëpunoi ngushtë me administratën ushtarake gjermane. Regjimi Vichy persekutoi në mënyrë aktive hebrenjtë, romët, komunistët, homoseksualët, emigrantët nga rajoni i Mesdheut dhe aktivistët e krahut politik të majtë. U miratuan ligjet raciste dhe kampet e internimit u përdorën si stacione tranziti për zbatimin e Holokaustit. Pas luftës, marshal Pétain u gjykua dhe u dënua për tradhti. Ai e kaloi pjesën tjetër të jetës së tij në burg.

KUTI NJOFTIMI

Si përgjegjëse për punën sociale në Aksionin e Krishterë të Studentëve Rusë, ajo udhëtoi në shumë qytete të Francës për t'iu dhënë mbështetje emigrantëve rusë, të cilët shpesh jetonin në skamje. Në veçanti, ajo arriti të lironte një numër të madh rusësh, të cilët ishin mbyllur gabimisht në spitale psikiatrike. Falë fondeve që mundi të mblidhte, në vitin 1932 ajo hapi një shtëpi për gratë e reja të izoluara, në rrugën *9 Avenue de Saxe* në Paris. Qendra më pas u zhvendos në rrugën *77 de Lourmel*, pasi ajo themeloi Aksionin Ortodoks më 27 shtator 1935, një shoqatë bamirëse dhe sociale e bazuar në modelin e Aksionit Katolik. Kjo shoqatë u mbështet nga YMCA. Nënë Maria vizitonte çdo ditë pazarin *Les Halles* për të ndihmuar njerëzit e saj, duke lypur nga tregtarët. Kredoja e saj ishte e thjeshtë:

*“Do të doja që secilit t’i jepja shpirtin tim,
që të uriturit të mund të ushqehen,
të zhveshurit të mbathen,
të eturit të shuajnë etjen dhe
të shurdhët të dëgjojnë të rejat.*

*Nga bubullima e qiellit,
tek pëshpëritja e flladit,
gjithçka më urdhëron:*

“Jep dhe qindarkën e fundit.”

*Me plotësinë solemne të një përvoje të shenjtë,
shpirti im është i tejmbushur.”*

Nënë Maria realisht e krijoi qendrën *Lourmel* me duart e saj. Ajo pastroi dyshemetë, mbushi dyshekët prej kashte, dekoroi faltoren e përkushtuar Mbrojtjes së Nënës së Zotit me qëndisje të shkëlqyera, duke përfshirë dhe një punë të quajtur “Jeta së Mbretit David” të frymëzuar nga sixhadet Bayeux². Shtëpia e pritjes shërbente vakt dreke me mish për dy franga. Buka mundësohej pa pagesë nga një bukëpjekës polak. Në pak kohë, dhomat u mbushën me shumëllojshmëri njerëzish: të përjashtuar, endacakë, kriminelë, ish-prostituta, artistë, të rinj dhe të vjetër, të vetmuar ose me familje.

“Është një përzierje e çuditshme. Kemi vajza të reja, të marrë, të çmendur, të papunë dhe, aktualisht, korin e Operës Ruse dhe korin gregorian të Dom Malherbe³, një qendër misionare, dhe tanimë edhe shërbime në faltore në mëngjes dhe mbrëmje,” shkruante At Lev Gillet, një murg ortodoks që jetoi disa kohë në vitin 1936 në “manastirin” e pazakontë të Nënë Maries, të cilit i pëlqeu atmosfera boheme ungjillore.

PËRFSHIRJA NË REZISTENCË

Nënë Maria Skobtsova shkroi edhe një sërë studimesh, duke përfshirë atë të vitit 1937 të titulluar *Llojet e jetës fetare*, në të cilin shprehej në favor të reformës në Kishën Ortodokse. Krahas katër llojeve të jetës fetare, asaj institucionale, asketike, rituale dhe estetike, ajo dalloj dhe një lloj veçanërisht ungjillor të natyrës shpirtërore, të përkushtuar ndaj dashurisë për fqinjët në të gjitha format e saj. Në tetor të vitit



Nënë Maria Skobtsova dhe Atë Dimitri Klepinin në mes të një grupi në rrugën Lourmel 77. Gruaja majtas është e ema e Marias, Sofia Pilenko.

ARKIV I ANTOINE ARJAKOVSKY

² Sixhadeja Bayeux është një vepër arti e shekullit të 11-të, që përshkruan pushtimin normand të Anglisë. Është një copë pëlhure e qëndisur gati 70 metra e gjatë dhe 50 cm e gjatë. Qëndron permanent e ekspozuar në një muze në Bayeux, Francë.

³ Dom Benoit de Malherbe ishte një murg benediktin, autor i këngëve gregoriane.



Nënë Maria Skobtsova

FOTO PUBLIKE

1939, asaj iu bashkua At Dimitri Klepinin, i cili u bë rektori i famullisë së Aksionit Ortodoks, dhe ajo organizoi me të një rrjet rezistence në verën e vitit 1940. Në fakt, ajo kishte lexuar Mein Kampf të Hitlerit dhe e njihte shumë mirë natyrën e regjimit totalitar gjerman. Falë kontakteve të saj të shumta në Gjermani dhe pjesëmarrjes së saj në konferencat ekumenike, në veçanti me Kishën Anglikane, ajo ishte plotësisht në dijeni të përndjekjeve antifetare të regjimit nazist.

Rrjeti i Aksionit Ortodoks ishte i afërt me atë të Boris Vildé, një etnolog emigrant rus. Në korrik 1940, Boris Vildé ishte një i burgosur i arratisur nga lufta që qëndronte fshehur në qendrën Lourmel. Ai përfitoi nga mbrojtja miqve të tij rusë ndërsa kryente aktivitetet e tij të fshehta. Në gusht 1940 ai krijoi një Komitet Kombëtar për Sigurinë Publike në Musée de l'Homme dhe revistën *Resistance* [Rezistenca], nga ku mori dhe emrin e gjithë lëvizja. Ky rrjet i Musée de l'Homme ishte i përbërë nga intelektualë parisienë dhe kolegë nga muzeu. Grupi u zgjerua me shpejtësi. Revista e tyre katërfaqëshe pati domethënie të konsiderueshme për francezët që refuzuan të nënshtroheshin. Ndërmjet muajve dhjetor 1940 dhe mars 1941, u shpërndanë pesë numra të revistës. Botimi i fundit i 25 marsit të vitit 1941 u shkrua nga Pierre Brossolette, një nga heronjtë kryesorë të Rezistencës franceze. Pas arrestimit në mars të vitit 1941, Boris Vildé u pushkatua një vit më vonë, në mars 1942.

Rrjeti i Rrugës Lourmel synonte të mbronte të gjithë personat e ndjekur nga regjimi nazist, duke filluar që nga hebrenjtë, për të cilët gjeti dhe strehim afatgjatë jashtë Parisit. At Dimitri arriti të krijonte certifikata të rreme pagëzimi për qindra hebrenj gjatë viteve 1940-1943. Në mars të vitit 1942, ai shpëtoi Anne Wellers duke i dhënë asaj një dokument që i vërtetonte Komisarariatit të Përgjithshëm famëkeq për Çështjet Çifute⁴ se ajo ishte prej dy brezash e besimit ortodoks, bashkërisht me prindërit dhe gjyshërit e saj. Anne Wellers ishte e shoqja e Georges Wellers-it, një hebre rus i arrestuar në dhjetor të vitit 1941, i cili u dërgua në kampet e përqendrimit në Auschwitz dhe më pas në Buchenwald. Pas rikthimit në Francë në vitin 1945, Georges Wellers u bë presidenti i Shoqatës për Fondacionin në Kujtim të Auschwitz-it, dhe drejtor shkencor i Qendrës për Dokumentimin Bashkëkohor Hebraik, nga ku u ngrit Memoriali Shoah në Paris.

⁴ "Commissariat Général aux Question Juives" ishte një autoritet i regjimit të Vichy, i cili prezantoi masa ligjore që synonin largimin, arrestimin dhe asgjësimin e popullsisë hebraike (dhe rome) në Francë.

ARRESTIMI DHE VDEKJA

Në korrik të vitit 1942, ndodhi i ashtuquajturi *Velodromi famëkeq i Dimrit* [Vélodrome d'Hiver] u në Paris. Policia franceze arrestoi më shumë se 13,000 hebrenj, përfshirë mbi 4,000 fëmijë, dhe i mbajti ata pa ushqim, ujë ose kushte higjienike në një stadium të sporteve dimërore për pesë ditë. Pas kësaj, ata u dërguan në disa kampe përqendrimi dhe më në fund, në Aushvic. Nënë Maria shpëtoi tre fëmijë hebrenj gjatë këtij grumbullimi në Paris. Ajo arriti t'i nxirrte ata nga stadiumi falë grumbulluesve të mbeturinave, të cilët i fshehën fëmijët në kazanët e tyre. Gjithashtu, rrjeti i Rugës Lourmel u mobilizua për të dërguar pako ushqimore për hebrenjtë e internuar në kampin tranzit Drancy. Rrjeti siguroi edhe dokumente të rreme identifikimi, veshje, ushqime, si dhe gjeti vende për t'u fshehur.

Nënë Maria u arrestua bashkë me të birin, Yuri Skobtsov dhe At Dimitrin në muajin shkurt 1943. Fillimisht, të tre u morën në pyetje në selinë e Gestapos në rrugën *Saussaies*. Oficeri SS gjerman i kërkoi priftit ortodoks të shkëputej nga Nënë Maria. At Dimitri refuzoi. *“Jeni duke ndihmuar çifutët!”*, i bërtiti oficeri nazist. At Dimitri e korrigjoi, duke thënë: *“Jo, po ndihmoj hebrenjtë”*. Më pas, ai i tregoi kryqin në gjoksin e tij dhe shtoi: *“Po këtë hebre, a e njihni?”* Pas kësaj, ai u qëllua me grusht në fytyrë dhe ra përdhe. Ata u internuan në Fortesën Romainville, më pas në kampin Royallieu në Compiègne, dhe më vonë në Drancy. Nënë Maria u dërgua në kampin e përqendrimit në Ravensbrück në prill të vitit 1943, ndërsa At Klepinin u dërgua në kampin Dora. Ai ndërroi jetë më 9 shkurt 1944 dhe trupi i tij u dogj në kremator në Buchenwald. Nënë Maria jetoi thuajse dy vjet në kamp, në një kazermë ku ndodheje burgosur edhe Geneviève de Gaulle-Anthonioz, një mbesë e Gjeneralit De Gaulle. Më vonë, presidentja e ATD Fourth World, një OJQ humanitare e rëndësishme, shkroi kujtimet mbi bashkëshoqëruesen e saj në fatkeqësi:

“Të gjithë e dimë se si ishte jeta e saj në Bllokun 27. Ajo

EMIGRIME NGA RUSIA BOLSHEVIKE DHE BRSS NË FRANCË

Revolucioni komunist në Rusi më 1917 dhe lufta civile që pasoi (1917-1922) çuan në emigrimin masiv të disa qindra mijëra njerëzve që ikën nga dhuna e regjimit bolshevik.

Më shumë se 100,000 persona gjetën strehim në Francë, shumica në kushte shumë të vështira. Shumë prej tyre mbërritën me të ashtuquajturat pasaporta Nansen, të lëshuara nga Lidhja e Kombeve pasi Bashkimi Sovjetik ua hoqi shtetësinë rusëve që jetonin jashtë vendit, përfshirë refugjatët nga lufta civile, në vitin 1921. Pjesa më e madhe e emigrantëve rusë ishin të besimit ortodoks. Nuk ishte e pazakontë të takoje ish-gjeneralë të ushtrisë cariste mes taksistëve parizienë. Pati edhe raste tragjike të emigrantëve rusë të internuar me forcë në spitalet psikiatrike, sepse nuk ishin në gjendje të flisnin frëngjisht. Mes atyre që jetuan në Francë mes luftërave, gjejmë shkrimtarë si Vladimir Nabokov, nobelistin Ivan Bunin, Elsa Triolet, Nina Berberova dhe Marina Tsvetaieva, poetja që u kthye përfundimisht në Bashkimin Sovjetik më 1937; skulptori Ossip Zadkine dhe piktorët Vassily Kandinsky dhe Marc Chagall, të gjithë francezë të natyralizuar në vitet 1930; filozofë dhe teologë si Nicolas Berdyaev dhe Sergius Bulgakov, të cilët ishin në mesin e treqind mendimtarëve të dëbuar nga BRSS nga Lenini me varka në 1922; ose balerini kryesor baletit rus, Vaslav Nijinsky.



Një ikonë që përshkruan nënën Maria, e ekspozuar në Kolegjin des Bernardins në Janar 2020.

ARKIV I ANTOINE ARJAKOVSKY

është e rrethuar nga respekti i shoqeve të saj. Ende vazhdon të pikturojë, ndër të tjera, një ikonë prekëse të Vurgjërshës, e cila mban Jezusin e kryqëzuar në krahët e saj. Në Ditën e Pashkës së vitit 1944, dritaret e kasolles së saj i kishte dekoruar me punime të mrekullueshme prej letre. Para stolit të saj mblidhen grupe të vogla, të cilave ajo u flet për revolucionin rus, komunizmin, përvojat e saj politike dhe sociale, dhe, ndonjëherë, më gjerësisht, për përvojën e saj fetare. Nga një Doracak për të Krishterët, që një prej shoqeve tona arriti ta mbante fshehur nga kontrolllet, Nënë Maria lexon një pasazh nga Ungjilli ose nga një prej Letrave të Apostujve. Ajo reflekton për to shkurtimisht.

Pranë saj, ndonjëherë ne lutemi dhe këndojmë, mezzo voce. Këto takime që na kanë lënë kujtime të paharrueshme, shpesh ndodhin në blloqe të tjera, ku është më e lehtë për t'u fshehur, ose në një nga rrugicat e kampit, pranë murit rrethues, teksa njëra prej nesh bën roje. Shpeshherë, Nënë Maria shkon te blloku i “ushtareve” ruse, të cilat e mirëpresin me dashamirësi. Ajo na tregon me admirim për kurajën e tyre. Mos vallë ajo gjen në fytyrat e tyre të reja atë të së bijës, Gayanas, e cila dëshironte të kthehej në Rusi pasi u martua me një student sovjetik dhe vdiq atje?

Kur makthi i muajve të fundit mbërriti, unë u ndava përfundimisht nga Nënë Maria. Vetëm pas rikthimit arrita të mësoj, me dhimbje të madhe, për vdekjen e saj në dhomën e gazit në Ravensbrück. Sipas një sërë dëshmish nga shoqet tona të kampit, dhe veçanërisht sipas dëshmisë së Jacqueline Péry, në fillim të vitit 1945 ajo arriti në limitet e fuqisë së saj:

“Qëndronte gjithnjë shtrirë ndërmjet thirrjeve, nuk fliste më, ose thujse fare, dhe u përfshi e tëra në një meditim të pafundmë... Pamja e fytyrës së saj ishte mbresëlënëse për t'u parë, jo për shkak të tipareve të dërrmuara, pasi ishim mësuar me këto pamje, por për shkak të shprehisë së përqendruar të vuajtjes së tmerrshme të brendshme që reflektonte. Ajo shfaqte dukshëm shenjë e vdekjes. Megjithatë, Nënë Maria nuk ankohej. Sytë i mbante mbyllur dhe dukej sikur ishte në lutje. Besoj se ishte, Mali i saj i Ullinjve⁵”.

Nënë Maria vdiq më 31 mars 1945, pasi zuri vendin e një gruaje hebre që do të dërgohej në kremator. Memoriali i Yad Vashem e vlerësoi atë si një Fisnike mes Kombeve në janar të vitit 1985. Ajo u kanonizua nga Kisha Ortodokse në janar të vitit 2004.

Deri më sot ajo njihet si Shenjtëresha Marie e Parisit.

□ LEXIME TË MËTEJSHME:

Jim Forest: Silent as a Stone: Mother Maria of Paris and the Trash Can Rescue, St. Vladimir's Seminary Press, NY, 2007.

Mother Maria Skobtsova: Essential Writings, Maryknoll, NY, Orbis Books, 2003.

H. Arjakovsky-Klépinine: Et la vie sera amour. Destin et lettres du père Dimitri Klépinine, Le Sel de la Terre, Cerf, Paris, 2005.

KONTRIBUT I COLLÈGE DES BERNARDINS

⁵ Sipas Biblës, Mali i Ullinjve në Jeruzalem është vendi ku vuajti Jezusi dhe prejnga u ngjit në parajsë.

SPANJË

Pas një periudhe të diktaturës ushtarake nacionaliste të kryesuar nga Primo de Rivera (1923-1930), mbreti shkoi në mërgim dhe një Republikë e Dytë demokratike u krijua në Spanjë në prill 1931. Duke përdorur tensionet shoqërore, një grupim i ushtrisë së bashku me të djathtën ekstreme dhe fashistët kryen një grusht shteti në 17 korrik 1936.

LUFTA CIVILE

Grushti i shtetit nxiti një revolucion të majtë. Pasi një Luftë Civile, e cila zgjati deri më 1 prill 1939. Gjatë luftës, pala nacionaliste e udhëhequr nga gjenerali Francisco Franco, krijoi një shtet totalitar të tipit fashist, të mbështetur nga Hitleri dhe Musolini. Ushtria nacionaliste, së bashku me milicitë fashiste, vranë më shumë se 100,000 njerëz. 50,000 të tjerë u ekzekutuan pas luftës. Dhuna republikane veçanërisht gjatë fillimit të luftës çoi në rreth 50,000 ekzekutime. Në 1936-1938, rreth 40,000 të huaj luftuan në anën e republikanëve në brigadat ndërkombëtare, të mbështetur nga Bashkimi Sovjetik dhe shërbimi i tij sekret NKVD.

DIKTATURA FASHISTE

Pasi fitoi luftën, gjenerali Franko imponoi një diktaturë mizore. Më shumë se 150,000 njerëz u ekzekutuan. Në vitet 1940, një milion njerëz kaluan përmes një rrjeti të gjerë kampesh përqendrimi.

Mijëra njerëz vdiqën në kampe dhe burgje. Të burgosurit u përdorën për të ndërtuar rrugë, kanale dhe infrastruktura të tjera. Regjimi krijoi një forcë policore brutale politike. Tortura ishte e zakonshme në burgje dhe stacione policie. Pllakosja e urisë e shkaktuar nga politika ekonomike e regjimit në vitet 1940 solli të paktën 200,000 vdekje. Pas vdekjes së Francos më 1975, pasoi një tranzicion në demokraci (monarki kushtetuese). Zgjedhjet e para të lira u mbajtën më 15 qershor 1977, kurse kushtetuta e re u miratua më 1978.



FEDERICO GARCÍA LORCA lindi në vitin 1898, në një qytet në Andaluzi. I konsideruar si dramaturgu më i shkëlqyer spanjoll i shekullit të XX, ai ishte anëtar i të ashtuquajturit “Generación del 27” (Brezi i 27-ës), një grup legjendar shkrimtarësh. Me një personalitet të butë dhe të ndjeshëm, mbështetja e tij për të varfrit dhe të marginalizuarit, ideologjia e tij progresive, si dhe homoseksualiteti i tij e bënë armik me fashistët e asaj kohe. Ai u vra në ditët e para të Luftës Civile Spanjolle, në vitin 1936.




FOTO PUBLIKE

Federico García Lorca

Vrasja e Poetit të Ndjeshëm

shkruar nga prof. Dr. José m. Faraldo

Diktatura e Frankos la pas mijëra varre në Spanjë ku u varrosën me nxitim trupat e mijërave njerëzve të vrarë gjatë luftës civile dhe periudhës menjëherë pas lufte. Pjesa më e madhe e tyre nuk u hapën kurrë; të tjerë janë gjetur pak nga pak në vitet e fundit. Më e famshmi nga të gjithë është gryka e luginës në qytetin Víznar në provincën e Granadës. Natën e 18 gushtit 1936, një grup fashistësh dhe ushtarësh vranë atje poetin dhe dramaturgun Federico García Lorca, së bashku me tre persona të tjerë. Është një nga krimet e shumta të regjimit të Frankos, por një nga më të njohurit, duke qenë se poeti ishte konsideruar si i parrezikshëm dhe i pafajshëm.

KUSH ISHTE GARCÍA LORCA?

Federico del Sagrado Corazón de Jesús García Lorca lindi në vitin 1898 në një qytet, në provincën e Granadës të quajtur Fuente Vaqueros, ku babai i tij ishte pronar tokash, ndërsa nëna ishte mësuese shkolle. Në moshën dhjetë vjeç, familja u transferua për të jetuar në kryeqytetin Granada. Federico, si anëtar i borgjezisë provinciale, të ndritur dhe liberale, u rrit në një mjedis që vlerësonte letërsinë, artet dhe tolerancën politike. Thirrja e tij e parë ishte muzika; ai mësoi t'i binte pianos, ishte i interesuar në muzikën popullore spanjolle dhe në risitë e muzikës moderne, që po arrinte kulmin e saj në Spanjë në atë kohë. Ai ndoqi leksione pianoje në qytetin e tij së bashku me të motrën. Në vitin 1920, Lorca njohu Manuel de Falla, kompozitorin e famshëm spanjoll, i cili e ndikoi shumë atë dhe vizionin e tij për artin. Së bashku me Encarnación López Júlvez, të quajtur La Argentinita, një këngëtar dhe valltar i flamengos, Federico regjistroi disa këngësh tradicionale spanjolle, për të cilat ai luajti në piano.

Por atëherë Lorca ishte bërë i njohur si poet dhe dramaturg. Pasi studioi filozofi, letërsi dhe juridik në Universitetin e Granadës, ai shkoi në Madrid, ku tanimë ishte një qendër e madhe kulturore. Lorca iu bashkua të ashtuquajturës *Residencia de Estudiantes*¹ së bashku me disa të rinj, që shpejt do të bëheshin artistët më të njohur të të ashtuquajturës "Epoka e Argjendte" e kulturës spanjolle: piktori Salvador Dalí, me të cilin Lorca kishte një marrëdhënie sentimentale, kineasti Luis Buñuel, dhe poet Rafael Alberti. Lorca filloi të botonte

¹ E themeluar për të ofruar akomodim për studentët, si Cambridge ose Oxford, Residencia de los Estudiantes sot është qendra e jetës kulturore në Madrid.

poezi që qëndronin midis surrelizmit dhe letërsisë klasike spanjolle, në të cilat ai lavdëronte ciganët dhe përshkruante jetën e ashpër të fshatit. Në dramën e tij ai e përshkruante modernizimin e Spanjës në mënyrë poetike dhe simbolike. Vënia në skenë e veprave të tij të para i bëri ato shumë të njohura në Spanjë dhe më vonë në Amerikë, ku ai do të udhëtonte - si në Shtetet e Bashkuara dhe në Argjentinë dhe Uruguai - në disa raste.

Në vitin 1931, me vendosjen e Republikës, Federico së bashku me kolegë të tjerë krijoi një kompani teatrale të njohur të quajtur La Barraca, me të cilën udhëtuan në të gjithë Spanjën, duke çuar kulturën klasike në qytete dhe fshatra që në atë kohë ishin të mbushur me njerëz që nuk dinin të lexonin apo shkruanin. Në vitin 1936, Lorca ishte poeti më i famshëm në vend.

PERSEKUTIMI I FEDERICOS

Në sfondin e tensioneve dhe dhunës politike në vitin 1936, Lorca ishte abuzuar verbalisht nga shtypi i krahut të djathtë dhe nga lëvizjet fashiste. Lorca nuk i përkiste asnjë partie dhe nuk u bë asnjëherë anëtar i Partisë Komuniste - gjë që ishte e zakonshme mes intelektualëve të rinj të kohës. Por konservatorët, veçanërisht ata të qytetit të tij e sulmuan për miqësinë e tij me socialistët si Ministri Fernando de los Ríos ose aktoren Margarita Xirgu. Federico ishte gjithnjë në anën e të varfërve, të marginalizuarve dhe atyre në nevojë. Por ai i kishte urreyer gjithnjë partitë politike dhe në veprat e tij letrare preferonte të bënte të pavdekshëm të varfrit. Gjithashtu, ai u sulmua për homoseksualitetin e tij, të cilin ndonëse privatisht e jetoi me vetëdije dhe haptazi.

Maçizmi dhe homofobia e Falangistëve (anëtarët e partisë politike të Fashistëve Falangë) e kthyen atë në një viktimë të propagandës fashiste, e cila gjithashtu e akuzoi atë se ishte "marksist", "mason" dhe "çifut". Ai ishte ndoshta një nga personazhet më të urreyer të totalitarëve të krahut të djathtë në Spanjë në atë kohë.



Federico García Lorca duke lexuar një tekst përpara prezantimit të La Barraca të shfaqjes «Roja e kujdesshme», nga Miguel de Cervantes (Almazán, Soria).

MUZEU KOMBËTAR REINA SOFÍA

GRUSHTI I SHTETIT DHE ARRATISJA

Më 17 korrik 1936, trupat koloniale spanjolle zhvilluan një kryengritje në Marok nën komandën e Gjeneral Frankos. Ditën e ardhshme, në vazhdim të konspiracionit që ishte zhvilluar për muaj, garnizone të ndryshme ushtarake në të gjithë Spanjën u rebeluan dhe morën pushtetin kudo mundën. Qeveria e ligjshme, e mbingarkuar nga këto ngjarje, ia dorëzoi armët në disa

qytete sindikatave dhe punonjësve, të cilët së bashku me një pjesë të besuar të ushtrisë dhe oficerëve të policisë, ia dolën të ndalonin grushtin e shtetit në Madrid, Barcelonë dhe qytete të tjera. Por grushti i shtetit kishte triumfuar në gjysmën e Spanjës, që çoi në fillimin e një lufte civile të përgjakshme.

Në Granada, ku Lorca kishte shkuar për të festuar ditën e shenjtit të tij, Shën Federico më 18 korrik, grushti nuk triumfoi deri më datë 19. Dhuna dhe përleshjet në rrugë ndoqën njëra-tjetrën. Pak e nga pak, komplotuesit e grushtit morën qytetin dhe filluan operacionin “pastrimi”. Grupet e ushtrisë dhe Falangistët marshuan në rrugë, hynë në shtëpi dhe arrestuan politikanët republikanë, të majtët, sindikalistët, intelektualët dhe madje edhe atyre drejt të cilëve kishin urrejtje të fortë për arsye personale. Gjatë këtyre ditëve ata kontrolluan shtëpinë e familjes García Lorca disa herë. Më 15 gusht, duke parë se situata sa vjen po përkeqësohej, Federico u fsheh në shtëpinë e Luis Rosales, një mik poet. Familja Rosales respektohej nga Falangistët dhe pjesëmarrësit në grushtin e shtetit dhe pranuan ta mbronin atë aty. Ata besonin se ai do të ishte i sigurt. Federico nuk donte të dilte në rrugë, ai qëndronte me gratë në shtëpi duke luajtur në piano dhe duke pritur. Ai nuk e dinte se këto do të ishin orët e fundit të lirisë së tij.

DËNIMI

Në orët e pasdites së 16 gushtit, tre vendas të krahut të djathë u shfaqën në derën e shtëpisë së familjes Rosales, së bashku me disa ushtarë. Ata hynë me forcë në shtëpi dhe arrestuan Federico-n. Ata kishin një dokument të nënshkruar nga guvernatori civil, i imponuar nga disa komplotistët të grushtit dhe askush nuk mundi t'i ndalojë ata. Federico u mor në një makinë Oaklandi², në pronësi të liderit të krahut të djathtë Juan Luis Trescantos. U zhvillua një operacion i madh policor, me burra në çati dhe postobloqe, sikur poeti të ishte një kriminel. Lorca kaloi disa ditë në burg, ku me shumë gjasë edhe u torturua. Disa miq, si muzikanti Manuel de Falla, shkuan në zyrën e Qeverisë Civile për të ndërhyrë për të, pavarësisht rrezikut se edhe ata mund të arrestoheshin. Ata u siguruan se poeti nuk ishte në rrezik.



Salvador Dalí dhe Federico García Lorca, Barcelonë, 1925.

FOTO PUBLIKE

² Një markë amerikane automobilësh prodhuar në vitet 1907-1931.

VRASJA

Në orën 3:15 të mëngjesit më 18 gusht, rojet dhe falangistët që po shoqëronin Federico-n u panë duke dalë nga Qeveria Civile e Granadës. Një i njohur, i cili e njihte sepse luanin letra e pa skenën dhe kuptoi qëllimin e tyre. Të ashtuquajturat "shëtijtje", vrasjet gjatë natës, ishin bërë ngjarje të përditshme që nga fillimi i luftës. Burri bërtiti me të madhe: *"Kriminelë, ju do vrisni një gjenë."* Ata nuk i kushtuan vëmendje dhe gati sa e arrestuan edhe atë. Federico u prangos së bashku me një burrë tjetër, një mësues shkolle, Dióscoro Galindo. Pak më vonë atyre iu bashkuan edhe dy të tjerë, anarkistë të gjorë me profesion banderilleros (asistentë të luftës me dema). Ata u çuan me një kamion në zonën e quajtur Fuente Grande, në Víznar, ndonëse vendndodhja e saktë nuk do mësohej kurrë. Atje, në dritën e fenerëve të makinave, ata u ekzekutuan nga një togë ushtarësh të cilëve u ishin premtuar para shtesë për pjesëmarrjen në krim. Njëri prej tyre piu një cigare të fundit me poetin. Ishte një natë pa hënë.

FALANGE - LËVIZJA POLITIKE E FRANCOS

Falange [fala'nkhe], që do të thotë një falangë, kolonë trupash, ishte një grup politik ekstrem i djathtë në Spanjë i ndikuar nga Fashizmi Italian. Ai ekzistoi midis viteve 1933-1937 dhe anëtarët e tij quheshin falangistë. Programi i tyre ishte vendosja e një diktature, ringjallja dhe promovimi i Perandorisë Spanjolle dhe përdorimi i dhunës për të rigjeneruar Spanjën. Gjatë Republikës së Dytë Spanjolle (1931-1936), ata nuk fituan një vend të vetëm në Parlament. Sidoqoftë, pas fillimit të Luftës Civile, ata u ngritën shpejt në pushtet. Më 1937, falangistët u bashkuan me një parti tjetër, monarkistët Carlistë të gjeneralit Franco, për t'u bërë partia shtetërore, që qëndroi e vetme në pushtet deri më 1975. Diktatori Franco e shpalli veten Udhëheqës ("Caudillo") të lëvizjes të quajtur Falange Española Tradicionalista y de la Juntas de Ofensiva Nacional Sindicalista (F.E.T y de las JONS). Më 1970 partia u riemërua zyrtarisht "Movimiento Nacional". Ajo u shfuqizua më 1977.

KUTI NJOFTIMI

NJË SKANDAL NDËRKOMBËTAR

Më 13 tetor 1936, H.G. Wells, presidenti i Klubit PEN në Londër, u dërgoi një telegram autoriteteve ushtarake të Granadës për të hetuar rreth vendndodhjes së Lorca-s. Ai mori një deklaratë të shkurtër nga ushtria që thoshte se ai ishte "i humbur". Organizatat dhe intelektualët antifashiste në të gjithë botën filluan t'i shkruajnë shtypit duke shprehur neverinë e tyre; diplomatët e huaj pyesnin për Lorcan. Poeti u bë padashur dëshmori më i madh për kauzën e Republikës. Varri i tij nuk u gjet kurrë, pavarësisht kërkimeve intensive. Eshtrat e tij prehen në një varr masiv së bashku me bashkudhëtarë të tjerë të pafat.

Deri në fund, regjimi i Frankos nuk e pranoi kurrë përfshirjen e vrasjes së poetit, i cili ishte një nga skandalet ndërkombëtare më të mëdha që dëmtoi reputacionin e Frankos. Për një farë kohe, ata donin t'i bënin të besonin se kjo nuk kishte ndodhur, se poetit thjesht ia kishte mbathur jashtë vendit. Më pas ata pretenduan se vdekja e tij ishte si rrjedhojë e

grindjeve personale ose urrejtjes. Pak vite më parë, u zbulua një raport policor që përshkruante se në fakt ishte lëshuar një urdhër zyrtar për të vrarë Lorca-n. Regjimi e mohoi gjithnjë. Pas luftës, kur familja Lorca mundi të regjistronte vdekjen e tij në regjistrin civil, autoritetet i detyruan ata të vendosnin si shkak të vdekjes se Federico "vdiq në gusht të vitit 1936 si rezultat i dëmtimeve të shkaktuara nga një akt lufte". Sikur ai të kishte qenë një ushtar dhe jo një poet.

NJË POEMË NGA FEDERICO GARCÍA LORCA

ÇUNI MEMEC

Çuni i vogël po kërkon zërin e tij.
(Ia ka marrë mbreti i gjinkallave.)
Në një pikë uji
kërkonte zërin çunaku.

Nuk e dua për me fol;
dua të bëj me të një unazë
që t'ia mvesh heshtjes sime
në gishtin e vogël.

Në një pikë uji
Kërkon zërin çunaku.

(Zëri i mbajtur rob, në distancë,
po mbathte kostum gjinkalle.)

EL NIÑO MUDO

El niño busca su voz.
(La tenía el rey de los grillos.)
En una gota de agua
buscaba su voz el niño.

No la quiero para hablar;
me haré con ella un anillo
que llevará mi silencio
en su dedo pequeño.

En una gota de agua
buscaba su voz el niño.

(La voz cautiva, a lo lejos,
se ponía un traje de grillo.)

Canciones 1921-1924



Monument i Federico García Lorca në Plaza de Santa Ana në Madrid, Spanjë. Ai mban në duar një lak, një zog që shfaqet shpesh në poezitë e tij.

FOTO PUBLIKE

□ LEXIME TË MËTEJSHME:

Ian Gibson: *The Assassination of Federico Garcia Lorca*, Penguin Books, 1983.

Ian Gibson: *Vida, pasión y muerte de Federico García Lorca (1898-1936)*, Debolsillo, 2016.

KONTRIBUT I UNIVERSIDAD COMPLUTENSE DE MADRID

MARGARITA NELKEN ishte një intelektuale, shkrimtare dhe politikane e krahut të majtë, një pioniere e lëvizjes feministe spanjolle në vitet 1930. Ajo lindi në Madrid më 5 korrik 1894 në një familje hebreje me origjinë gjermane dhe franceze. Nelken mori një arsimim që i mundësoi asaj të zhvillonte një personalitet të fortë dhe të pavarur, i cili ishte i pazakontë për gratë e kohës së saj. Ajo ndërtoi karrierën e saj si shkrimtare, përkthyes dhe kritike arti, pati dy fëmijë si një nënë beqare dhe u bë anëtare e Partisë Socialiste. Një kampione e shkëlqyer për të drejtat e grave dhe fshatarëve, ajo u zgjodh anëtare e Parlamentit gjatë Republikës së Dytë më 1931, 1933 dhe 1936. Simpatia e saj me klasën punëtore e bëri atë të bashkohej me Partinë Komuniste pas shpërthimit të Luftës Civile më 1936. Pas rënies së Republikës më 1939, ajo u arratis në Francë dhe më pas në Meksikë. Kritike ndaj komunistëve pas paktit mes Hitlerit dhe Stalinit, ajo u përjashtua nga Partia Komuniste në vitin 1942. Në Meksikë, ajo arriti të vlerësohej si një kritike arti dhe shkrimtare. Vdiq atje më 8 mars 1968.



ARKIV I L. HERRILLO SÁNCHEZ

Margarita Nelken

Një Politikane që u Arratis në Meksikë

shkruar nga Dr. Luis Horrillo Sánchez

Margarita Margarita dhe motra e saj më e vogël, Carmen Eva, ishin vajza të një familje hebreje. Prindërit e tyre ishin Julius Nelken Waldberg, një argjendar gjerman, i cili emigroi në Spanjë në 1889 dhe Jeanne Esther Mansberger, një grua franceze e lindur në Bayonne. Babai i Jeanne ishte Enrique Mansberger Klein, një hebre hungarez i vendosur në Madrid më 1866. Ai ishte orëndreqës në oborrin e mbretit Alfonso XII. Julius dhe Enrique kishin një biznes orësh dhe bizhuterish në sheshin e famshëm Puerta del Sol. Më 1893, Julius u martua me vajzën e partnerit të tij të biznesit në sinagogën e Bayonne. Margarita lindi më 5 korrik 1894 dhe mori emrin Maria Teresa Lea Nelken.

Motrat u rritën në një familje intelektuale dhe morën arsim të lartë, gjë që ishte e pazakontë në atë kohë. Margarita mësoi frëngjisht nga nëna e saj, gjermanisht nga babai, spanjisht në shkollë dhe anglisht nga dado e saj. Të dy vajzat nuk kishin një fëmijëri të lehtë në Spanjën konservatore: ato ishin të margjinalizuara sepse ishin të huaja dhe nuk ishin rritur si katolike. Në fund, Margarita la shkollën dhe vazhdoi studimet sipas kurrikulës franceze me mësues personale në shtëpi. Falë studimeve të tyre, Margarita dhe motra e saj zhvilluan një ndjenjë të fortë vetëbesimi ndryshe nga vajzat e tjera të moshës së tyre që rriteshin në mënyrë tradicionale, të nënshtruara dhe të pavetëdijshme për jetën jashtë Spanjës.

Margarita kishte ambicien për të qenë piktoresh, kështu që kur ishte trembëdhjetë vjeç, ajo shkoi në Paris për të studiuar art. Një nga shokët e saj të klasës ishte Diego Rivera, piktori i ardhshëm i famshëm meksikan. Paralelisht me pikturën, ajo gjithashtu studioi muzikë dhe u bë shoqe e skulptorit Auguste Rodin dhe kompozitorit Manuel de Falla. Ajo ekspozoi veprat e tyre në disa galeri, por së shpejti asaj iu desh të linte karrierën e saj si piktoresh, sepse filloi të vuante nga mungesa e shikimit në një nga sytë. Prandaj në vitin 1911, në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç, ajo filloi të punojë si kritike arti, duke botuar artikuj të rëndësishëm në revista ndërkombëtare. Ajo shpesh shkruante ese artistike në revista në Spanjë, Francë, Itali, Angli dhe në Amerikën e Jugut. Për shkak të fuqisë së saj si folëse publike, ajo shpesh mbante fjalime rreth artit. Po atë vit ajo u zhvendos nga Parisi në Madrid.

MBROJTËSE E TË DREJTAVE TË GRAVE

Rreth vitit 1914, Margarita ra në dashuri me skulptorin José Antonio me të cilin pati vajzën e saj të parë, Magda. Ajo nuk jetoi me José pasi lindi fëmija, duke u bërë një nënë beqare krenare dhe e guximshme. Ajo vazhdoi jetën e saj si artiste dhe, hap pas hapi, edhe si mbrojtëse e të drejtave të grave. Në vjeshtën e vitit 1917, Margarita filloi një lidhje me Martín de Paul, një biznesmen nga Sevilla. Djali i tyre Santiago lindi në mars 1921. Martín de Paul ishte i martuar me një grua tjetër, por nuk mund të divorcohej dhe të zyrtarizonte marrëdhënien e tij me Margaritën, sepse divorci nuk ishte i ligjshëm në atë kohë në Spanjë.

Ndërsa ishte nënë e dy fëmijëve, Margarita po arrinte gjithashtu në kulmin e aftësive të saj si shkrimtare. Ajo shkroi një roman, një biografi të Gëtes dhe përktheu libra nga frëngjishtja, anglishtja dhe gjermanishtja në spanjisht. Në të vërtetë, ajo ishte përkthyesja e parë spanjolle e Kafkës. Për shkak

të personalitetit të saj, inteligjencës dhe mençurisë, ajo u bë shoqe e ngushtë me shkrimtarët e famshëm si Pérez Galdos, Miguel de Unamuno, Antonio Machado dhe Federico García Lorca, si dhe shkencëtarin laureat të Çmimit Nobel Santiago Ramón y Cajal. Ajo njihej si një intelektuale brilante dhe esetë e saj shoqërore dhe politike ishin jashtëzakonisht të njohura.

Margarita fitonte mjaft të ardhura për të ruajtur pavarësinë e saj ekonomike dhe për t'i rritur vetëm fëmijët e saj. Ajo nisi të mbante fjalime në Shtëpinë Popullore të Partisë Socialiste, ku organizonte klasa arti për fëmijët në lagjet më të varfra të Madridit. Ajo u prek shumë duke parë kushtet e varfërisë në disa zona të kryeqytetit. Prandaj krijoi një jetimore të vogël më 1918 dhe një qendër për nënat beqare që punonin, e cila ishte çerdhja e parë jofetare në Madrid. Në vitin 1922, ajo shkroi një libër të quajtur *Gjendja shoqërore e grave në Spanjë*, e cila hodhi themelet e lëvizjes feministe në Spanjë. Në librin e saj të vitit 1931 *Gratë para Asamblesë Kushtetuese*, Margarita pastaj shqyrtoi çështje që lidheshin me të drejtat riprodhuese, lirinë seksuale, ligjshmërinë familjare dhe personalitetin juridik të grave, i cili u krijua përfundimisht në atë kohë. Ajo gjithashtu shkroi libra për shkrimtarët spanjollë dhe politikanet femra.



Margarita Nelken në çerekun e parë të shek.XX. Një grua e pavarur e cila u konsiderua si kërcënim për shumë burra në atë kohë.

ARKIV I L. HERRILLO SÁNCHEZ

POLITIKANE NË KOHËN E REPUBLIKËS SË DYTË

Margarita hyri në politikë gjatë Luftës së Parë Botërore. Në vitin 1920, ajo krijoi një Komitet për të ndihmuar fëmijët e uritur në Gjermani dhe në Perandorinë Austro-Hungari. Ajo shkoi në Berlin ku u prek nga i ftohti, uria dhe mjerimi i njerëzve pas luftës. Gjatë diktaturës Primo de Rivera në Spanjë, ajo shkoi në rajonin e Asturias për të mbajtur fjalime si të përmirësosheshin kushtet e minierave, por kur shteti u bë i vetëdijshëm për veprimet e saj, ajo u etiketua si armike e sistemit.

Kur Republika e Dytë Spanjolle u krijua në vitin 1931, pas rënies së Diktatura e Primo de Rivera dhe Monarkisë së Alfonsit XIII, Margarita dhe burri i saj iu bashkua zyrtarisht Partisë Socialiste. Divorci u lejua me ligj në Spanjë në dhjetor 1932 dhe kështu ajo mundi të martohet me Martín de Paul, kur ai u çlirua ligjërisht nga martesja e tij e mëparshme. Pas ceremonisë, Martín de Paul e njohu Magdën si vajzën e tij të ligjshme. Në jetën e saj politike, Margarita u promovua me shpejtësi dhe u zgjodh deputete e qytetit Badajoz në Spanjën jugperëndimore në vitin 1931.

Në rolin e saj të ri ajo u përqëndrua në kushtet e këqija për fshatarët në rajon, sepse ata po shfrytëzoheshin nga pronarët si në Mesjetë. Megjithë angazhimin e Partisë Socialiste për të bërë reforma të thella në bujqësi dhe për të zvogëluar ndarjen e pasurisë, Margarita nuk ishte popullore midis shokëve të saj. Në shumicën e rasteve socialistët që kontrollonin partinë nuk i toleronin gratë në strukturat e tyre politike. Në të vërtetë ajo ishte një figurë kontradiktore, sepse qe kundër të drejtave të grave për të votuar sipas Kushtetutës Spanjolle të vitit 1931 - por për këtë kishte arsyet e saj. Sipas Margaritës, gratë spanjolle ishin nën kontrollin e kishës katolike dhe burrave të tyre dhe prandaj nuk ishin ende gati për të votuar

Margarita Nelken u rizgjodh në Parlament në 1933 dhe 1936 dhe shërbeu si deputete deri në vitin 1939. Ajo ishte e vetmja grua deputete e zgjedhur në të tre legjislaturat e Republikës. Në fushatën elektorale më 1933, ajo ishte aq e zemëruar nga kushtet e fshatarëve në Badajoz, sa filloi të besonte se sistemi republikan po tradhtonte klasën punëtore. Sipas Margaritës ishte e nevojshme të prishej lidhja midis socialistëve dhe republikanëve për të promovuar një lëvizje revolucionare e cila do të zvogëlonte hendekun e pasurisë në vend. Prandaj, pas fitores



Francisco Largo Caballero dhe Margarita Nelken në Parlamentin Republikan. Të dy përfaqësonin seksionin e majtë të Partisë Socialiste.

ARKIV I L. HERRILLO SÁNCHEZ



Margarita Nelken me deputetët, 1932.

ARKIV I L. HORRILLO SÁNCHEZ

klasës punëtore në Spanjë. Pas udhëtimit të saj në vendet skandinave, ajo shkoi në Bashkimin Sovjetik, ku u frymëzua për t'u bërë anëtare e Partisë Komuniste. Kur u kthye në Spanjë në 1936, ajo ishte në favor të lëvizjes revolucionare brenda Partisë Socialiste të kryesuar nga Largo Caballero. Ai po kundërshtonte pozicionet e ministrit Indalecio Prieto dhe Presidentit Manuel Azaña, të cilët donin një bashkim midis socialistëve dhe republikanëve për të fituar zgjedhjet dhe për të marrë kontrollin e shtetit ligjërish, për të shmangur kërcënimin e një revolucioni të majtë në vend.

LUFTA CIVILE SPANJOLLE DHE KOMUNISTJA NELKEN

Në korrik 1936, një grusht shteti fashist filloi në Marruecos ku gjeneralë si Mola, Sanjurjo dhe Franco luftuan kundër sistemit republikan. Margarita mendoi se grushti i shtetit fashist do të mposhte nga klasa punëtore dhe se më pas do të kishte një revolucion në Spanjë të kryesuar nga kryeministri Largo Caballero, "Lenini spanjoll", si në Bashkimin Sovjetik. Sidoqoftë, gjatë mbrojtjes së Madridit kundër trupave të Francos, e cila zgjati nga tetori 1936 deri në mars 1939, Margarita filloi të mos pajtohej me politikën e Largo Caballero dhe kështu, në dhjetor 1936, ajo vendosi të bashkohej me Partinë Komuniste. Ky vendim doli të ishte një gabim, sepse Margarita humbi prestigjin e saj në Partinë Socialiste, ndërsa në Partinë Komuniste ajo nuk do të kishte asnjë ndikim.

Gjatë Luftës Civile, ajo promovoi një organizatë për t'u dhënë strehim 300 fëmijëve, prindërit e të cilëve po luftonin në luftë. Në të njëjtën kohë, ajo krijoi një organizatë tjetër për të dhënë ushqim dhe veshje për fëmijët, të moshuarit dhe refugjatët e luftës. Ishte një kohë e vështirë për familjen e Margaritës

së partive konservatore në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 1933, Margarita vendosi të bashkohej me një kryengritje të minorëve në Asturias që u zhvillua në tetor 1934. Përpjekja e majtë për një revolucion u mund nga forcat republikane dhe Margarita duhej të kërkonte azil në ambasadën kubaneze në Madrid. Ambasada i dha asaj një pasaportë kubane dhe ajo kaloi kufirin për në Francë.

Pas kësaj përvoje, ajo nisi një udhëtim rreth Danimarkës, Suedisë dhe Norvegjisë për të shpjeguar situatën e

sepse të gjithë ishin të përfshirë në luftë. Djali i saj, Santiago, u regjistrua si ushtar republikan dhe mori pjesë në beteja të rëndësishme të Jarama dhe Ebro në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare. Vajza e Margaritës, Magda, ishte infermiere në front. Mbesa e Margaritës, Cuqui, u dërgua në Amsterdam, ku burri i Margaritës, Martín de Paul, ishte konsull i përgjithshëm i Republikës së Dytë. Margarita ishte plotësisht e angazhuar në frontin e luftës: Më 1938 ajo vendosi të vizitonte Danimarkën, Holandën, Belgjikën, Zvicrën dhe Meksikën për të promovuar regjimin e Republikës së Dytë.

RËNIA E REPUBLIKËS DHE LUFTA PËR JETËN

Pasi Barcelona ra në duart e Francos në janar 1939, që do të thoshte humbjen përfundimtare të Republikës dhe fillimin e një diktature totalitare fashiste, rreth 450,000 refugjatë republikanë spanjollë vërshuan Francën. Margarita ishte mes tyre. Ajo u arratis në Francë me vajzën e saj Magda. Në ditët e ardhshme, nëna dhe mbesa e saj Cuqui u bashkuan me të. Franca, duke vuajtur nga një krizë ekonomike dhe e paaftë për të përballuar situatën, krijoi kampe internimi në bregdet pranë kufijve spanjollë, në të cilët rreth 350,000 refugjatë u mbajtën në kushte çnjerëzore, të mbrojtur nga ushtria. Djali i Margaritës, Santiago, ishte i mbyllur në kampin Saint Cyprien. Për fat të mirë, burri i Margaritës ishte konsulli i përgjithshëm në Amsterdam. Ai ndërhyri për të arritur lirin e djalit të tyre dhe Santiago shkoi në Amsterdam për të takuar babanë e tij. Në Amsterdam, megjithatë, burri i Margaritës kishte filluar një lidhje dashurieme me një grua më të re në moshë dhe ndoshta për këtë arsye Santiago vendosi të shkonte në Bashkimin Sovjetik për të studiuar inxhinieri.

Margarita qëndroi në Francë me familjen e saj, duke punuar si gazetare dhe kritike arti deri në fund të vitit 1939, kur emigroi në Meksikë si azilkërkuese, pikërisht në kohë për t'i shpëtuar pushtimit nazist gjerman. Ajo arriti të marrë me vete nënën, vajzën dhe mbesën. Motra e Margaritës, Carmen Eva, e cila ishte shkrimtare dhe aktore, u arratis në Meksikë në të njëjtën mënyrë. Më në fund, burri i Margaritës erdhi në Meksikë më 1940, por ata nuk jetuan më kurrë së bashku për shkak të tradhtisë së tij të vazhdueshme.



Margarita Nelken me anëtarët e grupeve politike të majta dhe milicët gjatë luftës Civile Spanjolle.

ARKIV I L. HERRILLO SÁNCHEZ

NDARJA NGA KOMUNISTËT DHE JETA NË MËRGIM

Pas pushtimit gjerman të Bashkimit Sovjetik, Santiago vendosi të bashkohej me Ushtrinë e Kuqe në 1941. Ishte e vështirë për Margaritën ta pranonte sepse ajo kurrë nuk e kishte kuptuar pozicionin e Partisë Komuniste në traktatin Gjermano-Sovjetik të vitit 1939. Në të vërtetë ky fakt shkaktoi ndarjen e saj totale me komunistët, të cilët e përjashtuan atë nga partia në tetor 1942. Largimi i saj nga Partia Komuniste pati pasoja të rëndësishme ekonomike për familjen, sepse ajo u bë një e huaj në shoqërinë artistike të Meksikës, e cila kontrollohej nga komunistët si Diego Rivera dhe David Alfaro Siqueiros. Dhe pastaj erdhi lajmi i tmerrshëm: Santiago u vra në aksion në Ukrainë, në janar 1944, në moshën njëzet e dy vjeç. Margarita nuk u shërua kurrë nga ky pikëllim.

Në 1947 Margarita u përpoq të vendosë përsëri familjen e saj në Europë. Ata udhëtuan në Belgjikë, Holandë dhe Itali dhe Margarita organizoi disa konferenca mbi artin meksikan. Sidoqoftë, Europa e pasluftës nuk ishte miqësore me të. Si rezultat i realitetit të ri në Luftën e Ftohtë, politikanët komunistë nuk pranoheshin si azilkërkues në Europën Perëndimore. Në Spanjë, komunistët u ekzekutuan nën regjimin e Frankos dhe në Europën Perëndimore Margaritës, si ish-komuniste, nuk iu dha leja për t'u vendosur, pavarësisht faktit se ajo ishte shumë kritike ndaj partive socialiste dhe komuniste në fund të karrierës së saj politike. Pra, pa asnjë perspektivë në Europë, Margarita e zhvendosi përsëri familjen e saj në Meksikë, i vetmi vend që u dha azil politikanëve republikanë spanjollë.

Në mërgim, Margarita nuk iu kthye më politikës. Ajo vazhdoi karrierën e saj si shkrimtare, përkthyes dhe kritike arti. Ajo u bë një nga kritikët më me ndikim dhe të respektuar të artit në Meksikë. Ajo mbeti aktive në punën e mërgimit republikan në Meksikë dhe vende të tjera. Në vitin 1954, ndodhi një ngjarje tjetër tragjike. Vajza e Margaritës, Magda, vdiq nga kanceri dhe kështu burimi i saj i vetëm i ngushëllimit u bë martesë midis mbesës së saj, Cuqui dhe José Ramón Rivas Ibáñez, nipit të Manuel Azaña, një nga Presidentët e Republikës së Dytë. Cuqui kishte katër fëmijë dhe i dha Margaritës plot nipër e mbesa.

Në vitin 1958, nëna e Margaritës vdiq, e ndjekur nga Martín de Paul në 1962. Më 8 mars 1968, Margarita vdiq në Meksikë, pa e parë Spanjën përsëri. Ajo po fiton sot njohjen si një nga personalitetet kryesore që hapi dyert për të drejtat e grave në shekullin e 20-të.

□ LEXIME TË TJERA:

Nash, Mary: Defying Male Civilization. Women in The Spanish Civil War, Arden Press, Denver, 1995.
Preston, Paul: Doves of war: four women of Spain, Harper Collins, London, UK, 2002.

KONTRIBUT I FEDERATËS SPANJOLLE TË MËSUESVE TË GJEOGRAFISË DHE HISTORISË

ITALI

Pas Luftës së Parë Botërore, Italia ishte në prag të një lufte civile. "Vitet e kuqe" (1919-1920) me demonstrata dhe greva të së majtës u pasuan nga "Vitet e Zeza" (1921-1922), ku këmishëzinjtë fashistë të Benito Musolinit erdhën në pushtet, duke sulmuar kundërshtarët politikë. Rreth 1.000 njerëz u vranë midis viteve 1919-1922.

REGJIMI FASHIST DHE LUFTA II BOTËRORE

Musolini organizoi një grusht shteti fashist, një "marshim në Romë", më 28 tetor 1922. Mbreti Viktor Emanueli III e emëroi atë kryeministër. Me ndalimin e të gjitha partive opozitare në nëntor 1926, u vendos një diktaturë totalitare. Regjimi i Musolinit u karakterizua nga dhuna sistematike, një nacionalizëm i ashpër dhe racist dhe anti-bolshevizëm, duke praktikuar shtypje sistematike të kundërshtarëve politikë brenda dhe jashtë vendit, si dhe përfshirë ekzekutime pa gjyq. Më 1935, Musolini filloi Luftën Abisiniane në Afrikë, kurse më 1936, ai bëri aleancë me Hitlerin. Italia e mbështeti Frankon në Luftën Civile Spanjolle. Ligjet raciste u miratuan në vitin 1938. Pothuajse 9,000 hebrenj u arrestuan, mbi 300 u vranë dhe të tjerët u internuan në kampet e shfarosjes naziste. Në vitin 1939, Italia pushtoi Shqipërinë, duke i shpallur luftë Britanisë së Madhe dhe Francës më 10 qershor 1940. Italia mori pjesë në luftën e Hitlerit kundër Bashkimit Sovjetik dhe në Afrikën e

Veriut. Më 10 korrik 1943, forcat aleate zbarkuan në Siçili. Më 25 korrik 1943, Musolini u rrëzua dhe u arrestua. Më 8 shtator 1943 pasoi armëpushimi me aleatët.

PUSHTIMI NAZIST

Trupat gjermane e liruan Musolinin dhe krijuan një "Republikë Sociale Italiane" fashiste nën mbrojtjen gjermane në gjysmën veriore të Italisë, e cila ekzistoi nga 23 shtatori 1943 deri më 25 prill 1945. Trupat nazifashiste luftuan kundër aleatëve të mbështetur nga një forcë e madhe rezistence. Musolini u kap nga partizanët dhe u pushkatua më 28 prill 1945. Të nesërmen, forcat gjermane kapitulluan. Zgjedhjet e lira u mbajtën më 2 qershor 1946, kushtetuta e re hyri në fuqi në 1948. Humbjet totale italiane të Luftës II Botërore qenë afërsisht 340,000 forca ushtarake dhe 150,000 viktima civile.



ADA ROSSI (10 shtator 1899 - 1993), partizane dhe mësuese, përfaqëson një model të gruas së emancipuar dhe të lirë, të aftë për të shënuar historinë e vendit të saj pa kërkuar kurrë ndonjë protagonizëm. Duke e njohur që në moshë të re fashizmin e Musolinit, Rossi, së bashku me bashkëshortin e saj Ernesto, do të jetë protagonistja e një lufte intelektuale dhe politike kundër diktaturës që shikonte për një të ardhme të aftë për të kapërcyer nacionalizmin vëllavrasës të kohës së saj, duke hapur dyert në një Europë të bashkuar dhe të shënuar nga paqja midis popujve.



ARKIV I
FONDACIONIT GARIWO

Ada Rossi

Një nënë e Bashkimit European

shkruar nga Simone Zoppellaro dhe stafi editorial i Gariwo¹

Ada Rossi mbarte tashmë brenda vetes, që nga lindja, pak nga ajo Europa të cilës ajo i kushtoi tërë jetën e saj si intelektuale dhe aktiviste. Stërgjyshi i saj nga ana e të atit ishte një oficer polak që mbërriti me ushtritë Napoleonike të Grand Duchy në Parma, ku ishte vendosur së bashku me gruan e tij zvicerano-gjermane. Midis paraardhësve nga ana e së ëmës, ishte edhe një grua franceze, Henriette, e cila supozohej të ishte vajza biologjike e një Habsburgu. Një grua e emancipuar dhe shumë e kulturuar, Ada e jetoi marrëdhënien e saj me politikanin dhe ekonomistin Ernesto Rossi (të dy, rastësisht, kishin të njëjtin mbiemër që nga lindja) duke ndërthurur dashurinë dhe përkushtimin ndaj lirisë që shënoi një faqe të rëndësishme në historinë italiane.

Me Altiero Spinellin dhe Eugenio Colornin, burri i saj Ernesto që në të vërtetë ndër promovuesit kryesorë në Itali - ende në mes të epokës fashiste - i idesë së një federalizmi european që mund të shpëtonte kontinentin nga luftërat vëllavrasëse që e kishin gjakosur në fillim të shekullit XX. Gjithmonë së bashku me mikun dhe shokun e tij të luftës Spinelli, ai hartoi të ashtuquajturin “Manifesti i Ventotenit”, botuar dhe redaktuar nga Colorni: një testament moral dhe politik, një libër thelbësor për lindjen e projektit pro-european në Itali, shkruar nga burra të cilët, mes mijërave kufizimeve të vendosura nga regjimi i Musolinit, ishin të internuar në një ishull të vogël, Ventotene, si ndëshkim për angazhimin e tyre politik dhe për t'i ndaluar ata që të vepronin publikisht. Dhe ishte falë

MANIFESTI PËR NJË EUROPË TË LIRË DHE TË BASHKUAR

Manifesti për një Europë të Lirë dhe të Bashkuar, i njohur gjithashtu si “Manifesti Ventotene”, nga ishulli ku dy autorët qenë burgosur si opozitarë të Fashizmit, është një vepër e Ernesto Rossit dhe Altiero Spinellit në vitin 1941. Fillimisht qarkulloi në mënyrë klandestine në rrethet opozitare ndaj regjimit fashist. Në mes të Luftës II Botërore, të dy autorët përfytyronin një federalizëm european si e vetmja rrugë për të dalë nga kriza e tmerrshme që kishte pllakosur kontinentin.

KUTI NJOFTIMI

¹ Fondacioni Gariwo, www.en.gariwo.net

Ada Rossi dhe Ursula Hirschman, gruas hebraike-gjermane të Colornit, që ky libër dhe shkrime të tjera shmangën censurimin fashist dhe u botuan. Por, të fshehura në ato faqe, ishin edhe idetë që gratë e jashtëzakonshme si Rossi dhe Hirschman kontribuan që të lindnin.

VITET E PARA

Partizania dhe kundërshtarja militante e regjimit fashist, Ada Rossi lindi në një qytet të vogël në Emilia, Golese, më 10 shtator 1899. Ajo ishte vajza e Concetta Montanari dhe oficerit Carlo Rossi, i cili vdiq nga tifoja



Ernesto dhe Ada Rossi në Gjenevë, 1944.

ARKIV I FONDAZIONIT GARIWO

pasi u kthye nga lufta e Libisë, që u krye dhe u fitua nga Italia kundër osmanëve në vitet 1911 dhe 1912. Ajo vinte nga një familje shumë e hapur dhe laike, ku u edukua nga nëna e saj me idealet e lirisë dhe barazisë të trashëguara nga Rilindja Italiane². Në vitin 1917, sapo u diplomua si mësuese, në Kolegjin “Villa della Regina” në Torino, ajo që dëshmitare e vuajtjeve të veteranëve të betejës Caporetto (Kaporetos), të cilët panë ushtritë italiane, austro-hungareze dhe gjermane të luftonin kundra njëra-tjetrës, me humbje që numëronin dhjetëra mijëra ushtarë. Në atë kohë, ajo ndjeu një neveri të fortë për retorikën nacionaliste dhe luftarake dhe një angazhim të fortë moral që çoi në aktivizmin e viteve në vijim.

Ajo u diplomua për matematikë në Universitetin e Parias - ku një nga shokët e saj u vra nga skuadristët (Bluzat e Zeza) e Musolinit - në një kohë kur kishte shumë pak gra në Itali që merreshin me studime shkencore dhe më pas iu përkushtua mësimdhënies, falë së cilës që në gjendje të mbante veten edhe në periudhat më të vështira në vitet që do pasonin. Në Bergamo, në shkollën ku punonte, ajo njohu Ernesto Rossin, edhe ai gjithashtu një profesor i ekonomisë dhe drejtësisë, si dhe një figurë kryesore dhe drejtues i grupit “Drejtësi dhe Liri”. Kjo ishte një lëvizje politike liberaleosocialiste e themeluar në Paris më 1929 nga një grup antifashistësh të mërguar dhe të udhëhequr nga Carlo Rosselli, i vrarë në Francë së bashku me vëllain e tij Nello nga vrasës

² Një lëvizje e shekullit të 19-të për bashkimin e Italisë që kulmoi me vendosjen e Mbretërisë Italiane më 1861.

të komanduar nga regjimi fashist.

Ada vendosi të martohej me Erneston pavarësisht se ky i fundit, i arrestuar ndërsa u jepte mësim nxënësve të tij në shkollë, ishte dënuar me njëzet vjet burg nga Gjykata Speciale për Mbrojtjen e Shtetit për shkak se ishte kundër regjimit fashist. Ernesto kaloi nëntë vite në burg dhe katër në izolim, një masë policore shtrënguese me të cilën regjimi i Musolinit synonte të izolonte dhe shtypte kundërshtarët dhe grupet e tjera shoqërore të konsideruara si “imorale”, siç janë homoseksualët. Martesa civile midis tyre u celebrua më 24 tetor 1931, në zyrën e drejtorit të burgut të Pallanzas me dy roje si dëshmitarë. Siç tregonte Ada më vonë, mbështetja që i jepte burrit të saj nuk ishte vetëm morale dhe intelektuale. Kur putheshin në fund të vizitave, Ernesto i linte asaj në gojë një toph dylli, në të cilin ishte fshehur një rrotull letre e hollë ku ai shkruante, me shkrim të imët, mesazhet për t'ua përcjellë shokëve të tij në luftën kundër fashizmit.

Gjatë burgosjes së Ernestos dhe izolimit, Ada luftoi vazhdimisht kundër masave të shumta të marra ndaj burrit të saj, duke ia dalë, për shembull, pas shumë protestash dhe vizitash në Ministrinë e Brendshme, dhe vetëm pak para përfundimit të burgimit të tij - që burri i saj të lejohej të shkruante. *"Mund të jem një grua e vetmuar, e pafuqishme, por nuk ka kërcënim të më pengojë,"* shkroi ajo në një letër drejtuar prefektit të policisë së Bergamos që e kërcënoi atë më 1942.

PERSEKUTIMI DHE BURGOSJA

Transferimi i Ernestos në burgun e Ishullit të Ventotenes, në bregun perëndimor të Napolit, në dhjetor 1939, për dy bashkëshortët kishte qenë pothuajse si një festë: nata e parë së bashku, nëntë vjet pas martesës së tyre, me një roje të ulur jashtë derës së dhomës së gjumit. Gjatë vizitave të saj në burg, Ada u dashurua me Manifestin e Ventotenes dhe e çoi atë në mënyrë klandestine në Bergamo së bashku me Ursula Hirschman për ta shtypur me makinë shkrimi, duke filluar kështu përhapjen e tij klandestine.



Vizatim nga Ernesto Rossi në një letër nga burgu, që përshkruan muajn e tij të ardhshëm të mjalit me Adën, i shtyrë për njëzet vjet më vonë, 1950, me veten të moshuar dhe tullac në një karrige me rrota, të shtyre nga një Ada po aq e rrudhur dhe gri.

MIRËNJOHJE FONDACIONIT ERNESTO ROSSI E GAETANO SALVEMINI

PARTIA NACIONAL-FASHISTE E MUSOLINIT

Fashizmi, që vjen nga fjala fascia dhe do të thotë paketim apo forcë përmes unitetit, ishte një ultranacionalizëm autoritar i ekstremit të djathtë, i zhvilluar nga Benito Musolini gjatë Luftës së Parë Botërore. Musolini themeloi dhe udhëhoqi Partinë Fashiste Kombëtare (Partito Nazionale Fascista/PNF), e cila sundoi Mbretërinë e Italisë në vitet 1922-1943. Në territorin e Republikës Sociale Italiane (1943-1945), ajo u pasua nga Partia Fashiste Republikane, e cila u shpërbë më 1945. Të dyja partitë janë të ndaluara sipas Kushtetutës së Italisë.

Musolini, i cili kishte qenë një politikan dhe gazetar socialist para Luftës së Parë Botërore, e quajti veten Udhëheqës ("Il Duce") të partisë. Partia Fashiste Kombëtare krijoi njësi paramilitare jashtë autoritetit të shtetit. Të ashtuquajturat "këmishëzinj" (camicie nere në italisht), veshën uniforma të zeza dhe iu betuan Duçes.

Ata përdorën dhunë dhe frikësim kundër kundërshtarëve të Musolinit. Krijuan Milicinë Vullnetare për Sigurinë Kombëtare që nga viti 1923, dhe u shpërndanë vetëm pas rënies së Musolinit më 1943.

KUTI NJOFTIMI

Europa Federale përfaqësonte për të, ashtu si për burrin e saj, mundësinë e vetme për të arritur demokraci dhe paqe në të ardhmen, jo vetëm për Italinë.

Por edhe Ada do të binte viktimë e policisë fashiste. Si gruaja e një kundërshtari të regjimit fashist, Ada humbi punën e saj në shkollë dhe u detyrua të jetonte duke dhënë mësimë private. Pra, ajo u skedua nga policia dhe në vitin 1942, u dërgua në internim në Forino (Avellino), më pas në Melfi dhe në fund në Maratea³. Angazhimi i saj aktiv gjatë Rezistencës shkon përtej të qënurit partnerja dhe mbështetësja e njërit prej autorëve të "Manifestit të Ventotenit", mbi të cilin do të bazohet Lëvizja Federaliste Europiane. Ada në fakt luajti një rol thelbësor në propagandimin, ndërlihdhjen dhe mbi të gjitha në edukimin politik të të rinjve ndaj vlerave antifashiste, dhe në idenë e një Europe të mundshme të bashkuar në solidaritet dhe të lirë. Disa nga studentët e saj do të bashkoheshin në radhët e para të Rezistencës së Bergamos⁴.

PUNA PËR NJË EUROPË TË BASHKUAR

Ada mundi të bashkohej me të shoqin vetëm pas rrëzimit të Musolinit. Në gusht 1943 ata të dy ishin

në Milano, me rastin e themelimit të Lëvizjes Federaliste, pastaj ata u zhvendosën në Zvicër, ku lëvizja kishte vendosur të dërgonte dy sekretarët e saj (Rossi dhe Spinelli) në kërkim të "derivateve të lëvizjeve të ndryshme gjysmë të lira klandestine" me të cilët do të bashkëpunonin jashtë Italisë. Nga shtatori 1943, ata qëndruan në Lugano dhe Gjenevë, dhe shtëpia e tyre u bë shpejt pika e takimit për refugjatët italianë.

Ada mori pjesë në lindjen e Lëvizjes Federaliste Europiane, dhe gjatë viteve të mërgimit të Ernestos në Zvicër, kontribuoi në përhapjen ndërkombëtare të vlerave të saj. Më 1945 ata u kthyen së bashku në

³ Vende në lindje të Napolit dhe një fshat më në jug përgjatë bregut.

⁴ Qyteti i Bergamos në Italinë e Veriut dhe rrethinat e tij ishin ndër vendet me qëndresën dhe aktivitetin më të fortë ndaj nazi-fashizmit.

Romë, ku ai filloi të punonte si gazetar për revistën *Il Mondo* dhe ajo vazhdoi përsëri të jepte mësimë private për të rinjtë, të cilët i konsideronte si fëmijët e saj.

Në tridhjetë e pesë vitet e kaluara pranë burrit të saj, i cili vdiq në 1967, por gjithashtu edhe më pas, ajo nuk e ndali kurrë dhënien e mësimit dhe angazhimin politik dhe shoqëror për të promovuar idealet që kishin frymëzuar militantizimin e saj dhe të bashkëshortit prej viteve të diktaturës fashiste. Ada Rossi vdiq në Romë më 1993.

Fjalët e saja, të marra nga një intervistë me Sergio Vetta më 31 tetor 1986, përmbledhin idealet dhe angazhimin e një jete të jashtëzakonshme: *“Unë them kurrë mos u dëshpëroni, jini gjithmonë të ndërgjegjshëm për idealin juaj, besoni në demokraci, liri dhe drejtësi. Unë u them të gjithëve që të qëndrojnë të vendosur për idetë e tyre dhe të mos dorëzohen, siç thotë shprehja jonë e vjetër: “Mos u dorëzo!”, parrulla e disa të rinjve që, për këto fjalë të thëna, kanë vdekur ose kanë qënë në burg ose internim. Ajo që u them të rinjve sot është të qëndrojnë të vendosur në këto parime thelbësore, të mos lejojnë që të blihen ose të mashtrohen nga ambicia”.*

KONTRIBUT I FONDACIONIT GARIWO, LA FORESTA DEI GIUSTI



Ernesto dhe Ada Rossi.

MIRËNJOHJE FONDACIONIT ERNESTO ROSSI E GAETANO SALVEMINI

Historia e GINO DE MARCHI (19 maj 1902 – 3 qershor 1938), një komunist i ri që ra viktimë e shtypjes staliniste në Bashkimin Sovjetik, përfaqëson një kujtim për një kohë të gjatë të mohuar si në BS dhe në Itali, ku bashkëpunimi i shokëve të tij të partisë qe vendimtar në vrasjen e tij. Vetëm falë guximit të vajzës së tij Luciana (1924), e cila i kushtoi jetën e saj përpjekjes për të rindërtuar historinë e tij dhe me qëllim që ajo të mos harrohej, ne mund të kujtojmë sot këtë figurë që e pagoi, si shumë të tjerë të brezit të tij, për besimin që kishte ndaj socializmit sovjetik duke rënë viktimë e tij.



MEMORIAL-ITALIA



ARKIV I LUCIANA DE MARCHI,
MIRËNJOHJE G. NISSIM

Gino dhe Luciana De Marchi

Beteja e një Vajze të re për të Ruajtur Kujtesën e Babait

shkruar nga Simone Zoppellaro

Mendohet se ka pasur rreth dyqind italianë, të cilët emigruan në BS midis viteve 1920 dhe 1930, të cilët përfunduan viktimat të spastrimeve staliniste. Komunistët, socialistët dhe anarkistët, shumica e tyre që shpëtuan duke u arratisuar nga Italia Fashiste, me të mbërritur në atë që ata besonin se ishte atdheu i lirisë, gjetën vdekjen me pushkatim ose vdiqën nga uria në Gulag, të akuzuar për trockizëm ose spiunazh. Një fat ky tragjik, i injoruar prej kohësh brenda dhe jashtë vendit, në të cilin kontribuan në shumë raste vetë shokët e tyre të partisë në Itali, të cilët i tradhtuan duke i denoncuar tek autoritetet sovjetike. Një përgjegjësi që, në shumë raste, arrin deri te krerët e Partisë Komuniste Italiane, të udhëhequr nga Palmiro Togliatti që nga viti 1926.

Midis tyre, ishte edhe Gino de Marchi. Poet dhe dokumentarist, i arrestuar dy herë pas mbërritjes së tij në Moskë, ai u pushkatua në moshën 36 vjeç. Vajza e tij Luciana – mamaja e të cilës ishte Vera Kornilova, një vajzë ruse e një ish-oficeri carist – do ta kalojë tërë jetën duke luftuar për rehabilitimin e emrit të babait të saj, jo vetëm në BS - që edhe pas përfundimit të epokës staliniste donte të fshinte krimet e veta - por edhe në Itali, ku kujtesa e tij u injorua, kryesisht nga vetë shokët e tij të partisë, për dekada të tëra.

Kjo histori është në qendër të një libri të shkrimtarit dhe gazetarit Gabriele Nissim, themelues dhe president i Fondacionit Gariwo. Një libër që, duke filluar nga dëshmia e Luciana De Marchit, ofron një fragment të rëndësishëm të një historie të ndrydhur: atë të shumë italianëve që, të rritur në mitin e Stalinit dhe socializmit sovjetik, paguan me jetën e tyre këtë iluzion.

VITET E RINISË SË GINO DE MARCHIT

Gino de Marchi kishte lindur në Fossano, në provincën e Cuneos, më 1902. Pas vdekjes së babait të tij, kush ai ishte vetëm katërbëdhjetë vjeç, Gino la shtëpinë e nënës dhe vendlindjen për të punuar në një fabrikë në Torino. Këto ishin vitet, në Itali, të cilat çuan shpejt në të ashtuquajturën periudhë dy-vjeçare të kuqe (1919-1920), kur gadishulli - midis luftërave fshatare dhe punëtore që prekën kryesisht qendrën e veriut të vendit - dukej sikur ishte në prag për t'u bërë një regjim komunist si BS.



Luciana, 13 vjeç. Kjo është fotografia e fundit me babain e saj, 1937.

ARKIV I LUCIANA DE MARCHI, MIRËNJOHJE G. NISSIM

De Marchi, si shumë të rinj të brezit të tij, i frymëzuar nga një idealizëm i singertë, u përkushtua me mish e me shpirt në atë përvojë, duke marrë pjesë në këshillët e fabrikave dhe betejat e punëtorëve të FIAT-it, fabrika e madhe e automjeteve në Torino. Inteligent dhe krijues – ai botoi në vitin 1919 një libër me poezi, kur ishte shtatëmbëdhjetë vjeç – dhe bëri karrierë brenda lëvizjes socialiste, duke qenë udhëheqës i federatës së të rinjve të Partisë Komuniste të Italisë, dhe duke u miqësuar, ndër të tjera, me filozofin dhe politikanin Antonio Gramshi.

DËRGIMI NË BASHKIMIN SOVJETIK

Megjithatë, fati i të riut De Marchi do të marrë së shpejti një kthesë tragjike. Duke u kthyer nga një kongres komunist në Berlin, më 26 prill 1921 ai u arrestua për fshehjen e armëve

në vendin e tij të lindjes. Nën shantazhin e karabinierëve për të arrestuar nënën e tij, i riu pranoi krimin e tij. Një gjest njerëzor, por që u interpretua nga shokët e tij të partisë si një tradhti e papranueshme, në një seri të pafund denoncimesh sekrete dhe akuzash ndaj tij që do të zgjasin me vite.

Nën pretekstin zyrtar për ta mbrojtur atë nga një gjyq i mëvonshëm, De Marchi u dërgua në Moskë për të marrë pjesë në Kongresin e Tretë të Internacionales. Por, menjëherë pas mbërritjes së tij, ai u arrestua nga autoritetet sovjetike. I mbyllur për një vit në kampin e punës në ish-manastirin e Shën Andronikovit, ai u sëmur nga tuberkulozi - një sëmundje që do t'a shenjonte atë për pjesën tjetër të jetës së tij të shkurtër. Ai u la i lirë falë ndërhyrjes së Antonio Gramshit - i vetmi nga ish-shokët e tij që i qëndroi besnik - por që i detyruar të qëndronte në ekzil.

Gjithnjë falë ndërhyrjes së Gramshit - i cili bëri presion për rehabilitimin e tij - De Marchi që në gjendje të kthehej nga ekzili i detyruar në Tashkent, Azia Qendrore, për në Moskë. Aty ai u njoh me Verën, një vajzë e re me të cilën pati një vajzë, Luciana (lindur më 1924), me të cilën De Marchi do të qëndrojë shumë i lidhur. Por, të gjitha përpjekjet e tij për t'u ripranuar si anëtar i Partisë Komuniste të Italisë qenë të kota. Reputacioni i tradhtarit i rëndonte akoma, që, në një parti të rreshtuar me idealet dhe praktikatat e stalinizmit sovjetik, peshonte si një dënim mbi të. Ardhja e fashizmit italian në pushtet më

1922 vetëm e përkeqësoi situatën e tij. I detyruar që të heqë dorë nga nënshtetësia e tij italiane në favor të asaj sovjetike dhe me Antonio Gramshin të arrestuar më 1926 (ai do të vdesë menjëherë pas lirim të tij, më 1937, për shkak të përkeqësimit të shëndetit të dëmtuar nga burgimi), De Marchi do ta gjente veten gjithnjë e më shumë vetëm, në një klimë të rritjes së shtypjes dhe krimeve që shënuan epokën më të përgjakshme në historinë sovjetike.

KARRIERA E SHKURTËR DHE EKZEKUTIMI

Me t'u bashkuar përsëri me familjen, në vitet në vijim De Marchi - gjithmonë duke luftuar për rehabilitimin e tij - filloi një karrierë të shkëlqyer si regjizor dokumentarësh për kompaninë prodhuese kinematografike që realizonte dokumentarë propagandistikë të regjimit mbi arritjet e socializmit dhe fitoret e klasës punëtore *stakhanoviste*, siç quheshin nga propaganda modeli i punëtorëve që punonin në kushte të vështira. Udhëtimet e shpeshta në brendësi të BS përfaqësonin një frymëmarrje të re për italianin që - siç dëshmojnë letrat e tij private të kohës - tanimë shikonte të shembej gjithë besimi që kishte pasur në socializmin sovjetik.

Në vitin 1937, në fillim të spastrimeve të mëdha staliniste, ai u përfshi në listat e armiqve politik të hartuara nga udhëheqësit e emigracionit të Partisë Komuniste Italiane dhe që i kaloheshin NKVD-së, policisë politike sovjetike, e cila kryente arrestimet dhe marrjet në pyetje, deri në dënimet me vdekje ose internimin në Gulag. I arrestuar më 2 tetor dhe i marrë në pyetje për muaj të tërë nën tortura, De Marchi u dënua me vdekje më 22 maj 1938 me akuzat e zakonshme të trockizmit dhe spiunimit në favor të Italisë fashiste, mbështetur nga deklaratat akuzuese të disa kolegëve të punës. Ai u pushkatua në poligonin e Butovos në Moskë, më 3 qershor, dhe u rehabilitua në heshtje më 14 korrik 1956, në fund të Kongresit të 20-të të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në të cilin Nikita Hrushov denoncoi krimet e Stalinit.

HISTORIA E LUCIANA DE MARCHI

E bija e De Marchit, Luciana, e cila që nga momenti i arrestimit të babait të saj nuk pranoi të besonte në fajësinë e tij dhe të mohonte lidhjen e gjakut me të, siç u impononte praktika e policisë sovjetike familjarëve të viktimave, ndërmoi gjatë gjithë jetës së saj një betejë personale për të vërtetën, së pari në Rusi dhe më pas në Itali. Një betejë që



Fotografia e fundit e disponueshme e Gino De Marchi, e realizuar pas arrestimit të tij në vitin 1937.

ARKIV I LUCIANA DE MARCHI, MIRËNJOHJE G. NISSIM



Luciana De Marchi dhe ish-presidenti i Republikës Italiane Giorgio Napolitano.

PORTAL I PRESIDENCËS SË REPUBLIKËS

trembëdhjetë vjeçarja (mosha në të cilën Luciana humbi babain e saj) e ndërmori gjithashtu pa të ëmën, e cila u detyrua të divorcohej nga burri i saj i burgosur italian - për të shpëtuar veten dhe vajzën e saj - dhe shkoi të jetonte me bashkëshortin e saj të ri, një oficer i Ushtrisë së Kuqe. Luciana nuk shkoi pas të ëmës, pasi e refuzoi atë bashkim dhe kompromisin e së ëmës me autoritetet sovjetike.

Në moshë shumë të re, Luciana zbuloi se jo vetëm babai i saj, por edhe e gjithë familja e saj ishte fshirë, pa asnjë mundësi ngushëllimi ose strehimi, nga dhuna shtypëse e shtetit, e cila shtrihej mbi trupat dhe mendjet e shtetasve të saj. Ky ishte fillimi i një lufte të vetmuar që do

ta angazhonte atë për gjatë gjithë jetës: rikuperimin dhe shpëtimin e kujtimit të figurës së babait të saj, të cilin të gjithë - përfshirë edhe nënën e saj - donin ta harronin.

Pas shumë vitesh pune për të zbuluar të vërtetën për babanë e saj në Rusi, ajo u transferua në Itali për të njëjtin qëllim pas rënies së Bashkimit Sovjetik. Luciana denoncoi liderët e Partisë Komuniste Italiane, të cilët kishin refuzuar (me përjashtim të Gramshit që e përmendëm më sipër) të ndërhyjnë me çdo mënyrë në favor të tij dhe arriti të merrte njohjen e pafajësisë së Ginos dhe rehabilitimin e kujtimit të tij. Në vitin 2004 ajo inaguroi në Rrugën “Fossano” një pllakë me emrin e babait të saj dhe më 2005 mori pjesë në inaugurimin në Milano të Parkut Valsesia, kushtuar viktimave italiane të stalinizmit. Në vitin 2007, Presidenti i Republikës Giorgio Napolitano priti zyrtarisht Luciana De Marchi, së bashku me Gabriele Nissim, libri i të cilit kishte kontribuar në rehabilitimin e babait të saj.

Shkatërrimi i familjes - një model i përhapur në BS, që inkurajonte edhe denoncimin e fëmijëve kundër prindërve të tyre – hasi në vullnetin kokëfortë të një vajze italo-ruse, Luciana De Marchi, por nuk e sprapsi atë që midis sakrificave të vazhdueshme dhe kërcënimeve të policisë sekrete sovjetike, të ruajë kujtimin e babait, i cili ishte destinuar nga regjimi totalitar dhe shtypës të binte në harresë (*damnatio memoriae*¹), si jetët e qindra mijëra njerëzve gjatë periudhës staliniste.

□ LEXIME TË MËTEJSHME:

Gabriele Nissim: Una bambina contro Stalin: L'italiana che lotto per la verità su suo padre, Mondadori, Milano, 2007.

KONTRIBUT I FONDACIONIT GARIWO, LA FORESTA DEI GIUSTI

¹ Latinisht për "dënim i kujtesës", që do të thotë se një person duhet të përjashtohet nga të dhënat zyrtare.

SHQIPËRI



Shqipëria ishte një republikë në vitet 1925-1928. Në vitin 1928, kryeministri Ahmet Zogu arriti të shpërbënte parlamentin, duke krijuar një monarki dhe duke u vetëshpallur Mbreti Zogu I.

PUSHTIMI NAZI-FASHIST

Italia fashiste pushtoi Shqipërinë më 7 prill 1939. Asambleja kushtetuese i ofroi kurorën mbretit të Italisë, Viktor Emanueli III. Pas kapitullimit të Italisë fashiste, vendi u pushtua nga trupat gjermane në 1943-1944. Nazistët formuan një qeveri kukull. Gjatë pushtimit nazi-fashist pati rreth 19,000 të vdekur dhe 6,500 njerëz të burgosur për arsye politike.

REGJIMI KOMUNIST

Pasi gjermanët u larguan nga Shqipëria në fund të nëntorit 1944, komunistët pushtuan institucionet e shtetit shqiptar. Ushtria partizane komuniste kreu spastrime politike në veri të vendit, duke vrarë, burgosur dhe internuar mijëra qytetarë. Më 2 dhjetor 1945 u mbajtën votimet për të legjitimuar sundimin komunist, në një klimë terrori dhe pa opozitë. Diktatori Enver Hoxha e drejtoi vendin me brutalitet deri në vdekjen e tij në 11 prill 1985, duke

ndërprerë vazhdimisht marrëdhëniet me aleatët e kampit komunist dhe duke izoluar vendin nga pjesa tjetër e botës. Pas vdekjes së Hoxhës, pasardhësi i tij, Ramiz Alia, vazhdoi këtë politikë deri në rënien e Perdes së Hekurt. Zgjedhjet e para pluraliste u zhvilluan më 31 mars 1991 dhe u fituan nga ish-komunistët. Për shkak të protestave masive, presidenti Alia u detyrua të japë dorëheqjen dhe të shpallë zgjedhje të reja, të cilat u fituan qartësisht më 22 mars 1992 nga të djathtët demokratë. Gjatë regjimit komunist, 6,027 persona (300 prej tyre gra) u ekzekutuan; kishte rreth 34,135 të burgosur politikë (nga të cilët rreth 7,000 ishin gra); 20,000 familje (rreth 60,000 njerëz) u burgosën ose u internuan.

VIKTOR MARTINI (1940) është një ish-i burgosur politik, i cili u arrestua kur ishte vetëm 16 vjeç. Ardhja e Partisë Komuniste Shqiptare në pushtet më 1944, shënoi për familjen Martini një kalvar të gjatë vuajtjesh dhe mundimesh, me burg dhe punë të rëndë. Viktor Martini ishte dëshmitar sesi tre vëllezërit e tij u burgosën dhe se si babai i tij vdiq në burg. Së bashku pesë burrat e familjes Martini vuajtën më shumë se 100 vjet në burgjet e Shqipërisë diktatoriale. Pas rënies së regjimi komunist, Viktori dhe gruaja e tij Elizabeta, e cila gjithashtu kishte vuajtur nga persekutimi për shkak të tij, emigruan në SHBA.



ARKIV I IDMC

Viktor Martini

Historia e Një Familjeje Qëndrestarësh

shkruar nga Valbona Bezati

Familja Martini përfaqëson një nga rastet më të rënda që dëshmon metodat dhe praktikat e ndjekura nga regjimi komunist për të ndëshkuar të gjithë ata që mendonin ndryshe nga linja e Partisë Komuniste. Të gjithë së bashku, pesë meshkujt e familjes Martini: Viktori, babai i tij Zefi, dhe tre vëllezërit e tij, kanë kryer në total 104 vite burg. Viktori, i cili lindi më 12 prill 1940, vuajti një kalvar dënimesh dhe persekutimesh.

FAMILJA DHE ARRESTIMI I BABAIT

Familja e Martinit rrjedh nga Hoti (Mali i Zi), ku pas shpalljes së pavarësisë në Shqipëri (1912), babai i tij, Zef Martini, së bashku me patriotë shqiptarë organizuan një kryengritje për liri e bashkim me trojet etnike. Sipas rëfimit të së birit, babai i tij konsiderohej “element i rrezikshëm” nga qeveria e Krajl Nikollës. Prandaj edhe u arrestua dhe u dënua me vdekje nga forcat malazeze. Një natë përpara se të ekzekutohej, Zefi ia doli të arratisë nga burgu dhe të kthehej në Shqipëri, me ndihmën e një ushtari. Pak ditë më pas, edhe familja e tij do të kalonte kufirin dhe do vendosej në Shqipëri përgjatë periudhës së mbretërisë në sundimin e mbretit Zog (1928-1939).

Nën mbretërinë e Zogut, ai mundi të kryejë shkollën e oficerëve dhe ka shërbyer si ushtarak në ushtri në zona të vendit. Siç e përshkruan i biri, Zefi ishte një burrë i gjatë dhe i pashëm. Pas diplomimit ai mori titullin “Oficer i Lartë i Mbretërisë”.

Me vendosjen e regjimit komunist më 29 nëntor 1944, Partia Komuniste përdoqi të gjithë ata që kishin shërbyer gjatë mbretërisë së Zogut, duke i shpallur ata “armiç”. Zefin e shkarkuan nga angazhimi i tij si ushtarak dhe e arrestuan për herë të parë, për ta dorëzuar si kriminel luftime në Jugosllavi. Prej kundërshtimeve të forta dhe vendosmërisë së bashkëshortes së Zefit në sallën e gjyqit, e cila dëshmoi mbi atdhetarizmin e tij, me një vendim të Mehmet Shehut¹ (atëkohë Shef i Shtabit të Përgjithshëm), ai u lirua dhe u dërgua të kryente punë të detyruar në qytetin e Shkodrës.

¹ Mehmet Shehu (1913-1981) ishte krahu i djathtë i diktatorit Enver Hoxha, i spikatur që gjatë luftës për brutalitetin e tij. Sipas versionit zyrtar të kohës, ai u gjet i vdekur me një plumb në kokë, pasi kishte kryer vetëvrasje. Deri më sot ka dyshime që ai mund të jetë eliminuar me urdhër të diktatorit Hoxha.

Katër vjet më vonë, gjatë verës së vitit 1949, pas pakënaqësive të shumta për punën e rëndë që i duhej të bënte dhe jetesën e vështirë, Zef Martini vendosi të arratiset. Por, pak ditë para kalimit të kufirit, më 2 gusht 1949, arrestohet me akuzën për pjesëmarrje në një “kryengritje të armatosur kundër regjimit popullor”. Bëhej fjalë për angazhimin e tij në *Kryengritjen e Postribës* (1946), e njohur si lëvizja e parë anti-komuniste pas vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Sipas dëshmimeve të familjarëve të tij, torturat që përjetoi Zefi dhe të burgosurit e tjerë në hetuesi ishin çnjerëzore. Ndër to mund të përmendet çarja e lëkurës dhe mbushja e plagëve me kripë derisa të burgosurit të mos duronin më nga dhembjet dhe t’u binin të fikët. Në përfundim të hetimeve, Zef Martini u dënua me 15 vjet burg dhe u dërgua ta kryente dënimin e tij në burgun e Burrelit², ku ai ndërroi jetë pas një sëmundjeje të rëndë më 1954.

Viktor Martini ishte vetëm 4 vjeç kur babai i tij u arrestua, dhe mundi ta takonte atë disa herë gjatë vizitave në burg. Pas arrestimit të Zefit, familja Martini konsiderohej “armike e regjimit” dhe presioni që vinte nga organet e regjimit si policia sekrete, Sigurimi, apo këshillat e lagjes ishte aq i lartë, sa të afërmit dhe fqinjët u distancuan. Nga ana tjetër, menjëherë pas arrestimit të të atit, Paskali, djali i tij i madh, u arratis nga Trovoja për në Jugosllavi në vitin 1951. Pak kohë më vonë, më 1953, pas presioneve që i bëheshin familjes, u arratisën edhe motra e tij, Maria (21 vjeç), si dhe vëllai tjetër, Angelini (17 vjeç), sërish drejt Jugosllavisë. Maria nuk u kthye më në Shqipëri. Ajo ndërtoi familjen dhe jetoi në Jugosllavi deri në fund të jetës së saj.

Në Shqipëri mbetën vetëm nëna, e cila punonte në fermën e Shtojit (Shkodër) dhe dy fëmijët më të vegjël, Viktori dhe Adolfi.

ARRESTIMI I VIKTORIT NË MOSHËN 16 VJEÇARE

Viktor Martini kaloi një fëmijëri të vështirë me nënën, e cila përveç punës në fermë, qe e detyruar të angazhohej në punë të rënda në fushën e ndërtimi dhe në komunale si pastrimi i rrugëve. Kur ai ishte 13 vjeç, në lojë e sipër me një shok pranë Lugines së Kirit, disa kilometra nga qyteti i Shkodrës, gjetën një bombë të mbetur pas Luftës II Botërore. Kureshtar për nga natyra, Viktori e mori bombën në duar për ta eksploruar, kur padashje ajo u aktivizua dhe shpërtheu. Ajo ditë do shenjojë jetën e tij sepse ai humbi këmbën nga shpërthimi.

Në vitin 1956, kur Viktor Martini ishte 16 vjeç, u njoftua se dy nga shokët e tij kishin vendosur të arratiseshin. Viktori, megjithatë, nuk kishte pasur asnjë herë qëllim të arratisjeje, pasi refuzonte të linte vetëm nënën e tij. Shokët e tij u kapën nga forcat e kufirit në tentativë arratisjeje drejt Malit të Zi. Viktori ishte i pranishëm në sallë gjatë procesit gjyqësor, kur u akuzua në mënyrë absurde si drejtuesi i këtij grupi dhe u arrestua. Viktori këmbënguli se ai ishte njoftuar për arratisjen vetëm në momentin e fundit dhe nuk ishte pjesë e këtij organizimi. Gjyqi e dënoi me 7 vjet burg dhe pjesën më të madhe të dënimit e kaloi në

² Burgu i Burrelit, i cili ende është në funksion edhe sot, ka qenë një ndër tre burgjet më famëkeq në Shqipërinë komuniste ku të burgosurit politikë torturoheshin dhe mbaheshin në kushte çnjerëzore, më së shumti pa gjyq dhe vendim gjyqate.

burgun famëkeq të Burrelit, ku kishte ndërruar jetë i ati.

Viktori tregon se gjatë viteve në burgun e Burrelit ka takuar disidentë, intelektualë dhe klerikë, nga të cilët ka mësuar shumë, duke filluar nga leksionet bazë të matematikës dhe letërsisë, deri te filozofia politike. Po ashtu, ai kujton se ushqimi në burg ishte i pamjaftueshëm dhe i ndotur, kurse trajtimi nga rojet përgjithësisht çnjerëzor.

Ai doli nga burgu në moshën 21 vjeçare, por vuajtjet nuk do të merrnin fund. Pas daljes nga burgu, edhe pse ishte invalid me një këmbë, Viktori qe i detyruar të bënte punë të rënda në ndërtim, të shtynte vagona apo të shtronte zift të nxehtë gjatë hapjes së rrugëve.

KATËR VËLLEZËRIT E FAMILJES MARTINI NË BURG

Përveç burgosjes dhe dënimit të Viktorit, edhe tre vëllezërit e tij u përndoqën dhe u burgosën nga regjimi komunist. Vëllai i madh, Paskal Martini, u dënua më 1953 me akuzën “agjent perëndimor”. Ai ishte arratisur më 1951 dhe qe vendosur fillimisht në Jugosllavi, ku kishte ndjekur shkollën e lartë të Edukimit Fizik në Beograd. Pas mbarimit të studimeve, u fut në ushtrinë e Gjermanisë Perëndimore, por një ditë u përfshi rastësisht në një aksidenti teksa kalonte kufirin mes Gjermanisë dhe Çekosllovakisë. Atë e dërguan për kurim në spitalin e Pragës dhe më pas e kthyen në Shqipëri. Paskali u dënua fillimisht me vdekje, më pas dënimi u reduktua në 25 vjet burg, nga të cilat 12 vjet i kreu në burgun e Tiranës dhe më pas punoi në komunale deri sa doli në pension.

“SIPPENHAFT” NË GJERMANINË NAZISTE DHE SHQIPRIA KOMUNISTE

Sippenhaft, që do të thotë burg për farefisën ose dënim kolektiv, ishte një term i përdorur nga Gjermania naziste për një politikë të ndëshkimit kolektiv të anëtarëve të familjes që konsideroheshin armiq të shtetit. Bashkëshortët, fëmijët, prindërit, vëllezërit e motrat e tyre, si dhe të afërm të tjerë u ekzekutuan ose u burgosën, fëmijët e vegjël u merreshin familjeve ose adoptoheshin me forcë. Sippenhaft, një term që rrjedh nga ligji gjermanik i Mesjetës, u zbatua p.sh. pas sulmit vrastar ndaj Reinhard Heydrich nga luftëtarët çekosllovak në mërgim, më 27 maj 1942 ose pas përpjekjes së dështuar për të vrarë Hitlerin më 20 korrik 1944 nga oficerët gjermanë të udhëhequr nga Claus von Stauffenberg.

Shqipëria komuniste praktikoi dënime të ngjashme kolektive. Në vitet e para të diktaturës, armiqtë e perceptuar të shtetit u persekutuan dhe u vranë pa mëshirë. Familjet e tyre u dërguan në kampet “me tela” të internimit ku ata vuanin në kushte të tmerrshme, duke kryer punë të detyruar pa ushqim, ujë ose higjienë të përshtatshme. Njerëz të panumërt vdiqën. Midis viteve 1945-1953, ekzistonin gjashtë kampe të tilla. Vetëm në kampin e Tepelenës vdiqën më shumë se 300 fëmijë. Nga viti 1954, kampet e përqendrimit i lanë vendin qindra kampeve për internim të përjetshëm në zona të largëta të vendit, të cilat ekzistuan deri në vitin 1991. Në këto kampe, familjet jetonin nëpër kazerma, rrethuar nga disa hektarë tokë ku duhej të kryenin punë të ndryshme krahu. Të rrethuar nga forca të armatosura, ata duhet të paraqiteshin për “apel” disa herë në ditë. Fëmijët e lindur në kampe u bënë të rritur që nuk e njihnin kurrë jetën jashtë. Këto dhe shkelje të tjera brutale të të drejtave të njeriut nga Shqipëria komuniste ende presin të dokumentohen dhe të ndiqen penalisht. Vlen të përmendet se ligji mesjetar shqiptar parasheh edhe gjakmarrjen dhe se ajo praktikohet me trishtim në disa rajone të Shqipërisë deri më sot.

Familja e tij, e cila asokohe jetonte në Shkodër, vendosi të transferohej në Tiranë, për t'i qëndruar pranë e për t'i ardhur në ndihmë Paskalit. Por hasën shumë probleme me shtëpinë. Vila e tyre, e cila edhe sot gjendet në zonën e bllokut të ambasadave në kryeqytet, ishte marrë nga shteti dhe zënë nga qiraxhinjtë. Atëherë, ata ndërtuan provizorisht një barake përdhese në oborrin e shtëpisë së tyre, të mbuluar me katrama, me një dritare sa të hynte drita. Në këto kushte kaluan vjeshtën dhe dimrin e vitit 1951. Më pas me urdhër të policisë sekrete, *Sigurimit*, dhe përmes një vendimi të Ministrisë së Brendshme, familja Martini u dëbua nga Tirana sepse konsideroheshin “tejet të rrezikshëm për të jetuar në kryeqytet”. Familja me katër persona u kthye sërish në Shkodër, ku jetuan në një dhomë të vogël.

Pas komunikimeve të shpeshta me Paskalin, vëllai i dytë, Angjelini, u riadhesua nga Jugosllavia për të qenë i pranishëm në gjyqin e vëllait. Por aty, edhe atë e arrestuan dhe e dënuan me 10 vjet për arratisje. Dënimin e kreu në burgun e Burrelit, në të njëjtën kohë me Viktorin.

Vëllai i tyre më i vogël, Adolfi, do të dënohej në moshën 13 vjeçare vetëm pse i kishte marrë me forcë xhaketen një shoku. Ai u arrestua më 1956 dhe u dënua në bazë të Kodit Penal të kohës, me motivin e “grabitjes me dhunë”. Viktori mësoi për burgosjen e të vëllait, vetëm kur e takoi atë në burgun e Burrelit.

Në fund të viteve 1960, nëna e tyre jetonte vetëm, me katër djem që kryenin dënimin me burg.



Elizabeta Martini në moshë të re, bashkëshortja e Viktorit, 1964.

ARKIV I IDMC



PËRNDJEKJA PAS DALJES NGA BURGU

Më 2 shtator 1961, Viktor Martini përfitoi nga një amnisti e Presidiumit Popullor dhe u lirua pas pesë vjetësh, duke lënë në burg vëllanë e tij më të vogël, Angjelinin.

Pas daljes nga burgu në moshën 21 vjeçare, Viktori njohu dhe u martua me Elizabetën, e cila vinte nga një familje e thjeshtë, punëtore. Ajo kishte studiuar në shkollën pedagogjike dhe për shkak të martesës me Viktorin, u emërua mësuese në fshatin e thellë Gimaj të Dukagjinit, disa orë larg nga Shkodra. Meqënëse ishte shtatëzanë dhe rruga për në shkollë që e rrezikshme, Elizabeta bëri një kërkesë që ta transferonin në një fshat më të afërt, por kërkesa nuk u miratua. Kështu, të detyruar nga varfëria ekstreme dhe të frikësuar se nuk do mund t'i krijonin kushtet minimale krijesës së tyre, ata zgjodhën punën! Abortimi ishte i paligjshëm gjatë regjimit komunist dhe kushdo që e kryente atë mund

të kishte pasoja fatale. Elizabeta ishte 22 vjeç në atë kohë dhe riskoi duke besuar se do të kishin me siguri fëmijë të tjerë në të ardhmen. Por ëndërra e tyre nuk do të realizohej më kurrë. Pasi punoi disa vjet si mësuese, Elizabetën e pushuan nga puna pasi nuk pranoi të divorconte bashkëshortin e saj dhe kësajsoj “nuk mund të ishte më e denjë për kolektivin e shkollës”.

AKTIVITETI POLITIK PAS RËNIES SË REGJIMIT KOMUNIST

Pas rënies së Murit të Berlinit në tetor 1989, Viktor Martini dhe ish-të burgosurit politikë patën shpresë se edhe diktatura në Shqipëri do të rrëzohej. Më 14 janar 1990, Viktori ishte njëri nga organizatorët e protestës ku morën pjesë mijëra banorë të Shkodrës, të cilët u grumbulluan në qendër të qytetit për të rrëzuar monumentin e Stalinit. Forcat e *Sigurimit*, arrestuan të gjithë organizatorët e kësaj demonstrate dhe i liruan ata vetëm dy muaj më vonë.

Në vitin 1991, Viktori themeloi shoqatën e parë antikomuniste në rrethin e Shkodrës, e cila kërkoi njohjen dhe dënimin e krimeve të komunizmit. Për fat të keq, idealet e tij ranë ndesh me rrjedhën që morën ngjarjet politike në vend pas rënies së regjimit.



Viktor Martini dhe bashkeshortja e tij Elizabeta, Boston, Massachusetts, 2016.

ARKIV I IDMC

EMIGRIMI NË SHBA

I zhgënjyer, Viktor Martini kërkoi strehim politik në SHBA, ku jeton ende sot me bashkëshorten e tij prej 22 prillit 1993. Në maj 1993, gazeta “*Lajmëtari*” botoi letrën e tij publike me titull “Themeluesi i Shoqatës së të Persekutuarve Politikë V. Martini kërkon strehim politik në SHBA”. Edhe sot e kësaj dite (viti 2021) ai vazhdon të shprehë zhgënjimin e tij për 30 vjet demokraci, ku sipas tij shoqëria shqiptare dështoi të reflektonte dhe të ballafaqohej siç duhej me diktaturën komuniste.

LEXIME TË MËTEJSHME:

Martini, Viktor, Dëshmoj (unë, hija dhe vuajtja), Shkodër, 1999

Dëshmia personale e Viktor Martinut për Institutin për Demokraci, Media dhe Kulturë, intervistuar nga Valbona Bezati, është publikuar online: <http://www.observatorikujteses.al/une-deshmoj-viktor-martini/>

KONTRIBUT I INSTITUTI PËR DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURË

Kjo është historia e YLBER MERDANIT (1940), një poet i talentuar dhe mësues i përkushtuar, i cili vinte nga një familje e pasur dhe e respektuar, por u burgos dhe u internua nga regjimi komunist për shkak të shkrimeve të tij. Ylberi ishte 27 vjeç kur u burgos në Spaç për tetë vjet. Historia e Ylberit është gjithashtu një histori e jashtëzakonshme dashurie. Gruaja e tij e ardhshme, Shpresa, e priti gjatë viteve që vuante dënimin. Ata kaluan 13 vjet në internim së bashku deri në rënien e diktaturës më 1991.



ARKIV I IDMC

Ylber dhe Shpresa Merdani

Dënimi i Poetit dhe një Histori Dashurie me Fund të Lumtur

shkruar nga Valbona Bezati

Historia e Ylber Merdanit është karakteristike për të kuptuar strukturën represive të regjimit komunist shqiptar, i cili nuk kursente askënd dhe mund t'i shkatërronte jetën gjithkujt. Ylberi lindi më 1940 në një familje të njohur tregtare që jetonte në qytetin e Korçës (në juglindje të Shqipërisë) prej 300 vjetësh. Fisi i Merdanëve kishte në pronësi një kompani të suksesshme tregtare „Magazija-Drejtësia“ dhe shumë dyqane dhe depo në të gjithë krahinën e Korçës. Ata njiheshin për akte bamirësie pasi ndihmonin familjet e varfëra, fëmijët jetimë, bizneset e vogla me kredi të ulëta, etj. Familja Merdani i qe kushtuar punës, dhe nuk ishte angazhuar politikisht.

Pas ardhjes në pushtet, në vitet 1945-1946 komunistët miratuan një sërë ligjesh që synonin konfiskimin e të gjitha pasurive private, përfshi këtu edhe punishtet apo fabrikat. „Ligji i Tatimit të Jashtëzakonshëm“ ishte një tjetër mënyrë për të legjitimuar „vjedhjen“ ndaj qytetarëve duke konfiskuar vlerat monetare në flori. Tregtarët e Korçës patën të njëjtin fat si në të gjithë Shqipërinë, dhe mes tyre edhe përfaqësuesit e familjes Merdani. Shteti u rrëmbeu gjithçka, u konfiskoi pronat, pasurinë, shtëpinë deri edhe kopshtin e madh plot me pemë.

PËNDJEKJA DHE INTERNIMI I MERDANËVE

Babai i Ylberit, Fuati, kishte hapur më 1935 një punishte të vogël për prodhimin e sapunit dhe ia kishte dalë ta zgjeronte biznesin e vet duke prodhuar disa asortimente dhe duke investuar në makineri më të mira e cilësore të blera në Amerikë dhe Gjermani gjatë luftës. Pas burgosjes së dajës dhe më vonë edhe të vëllait, në vitin 1951, vetëm pak javë pasi familja e Merdanëve qe dëbuar nga shtëpia e tyre dhe qe vendosur në një dhomë, në katin e dytë të një ndërtese të amortizuar dhe të papërshtatshme për jetesë, Fuati bashkë me tregtarë të tjerë korçarë u arrestua. Atë e mbajtën në hetuesi për 18 muaj me pretendimin se zotëronte flori të fshehur. Kur doli nga "burgu" i hetuesisë ai kishte pasoja fizike nga torturat, dhe njëra dorë i mbeti qysh atëherë gjysmë e paralizuar.

Në shtëpinë e konfiskuar të Merdanëve qenë strehuar komanda e burgut të qytetit. Ata qendruan aty deri në vitin 1958 kur familja Merdani u lejua të rikthehej.



Shpresa Merdani, 1961.

ARKIV I IDMC

Pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik në vitin 1961, Shqipëria u miqësua me Kinën dhe për disa vite u duk sikur „armiku i brendshëm“ u la në një farë qetësie. Por kjo situatë nuk zgjati shumë. Të frymëzuar nga revolucioni kulturor kinez, komunistët shqiptarë me në krye Enver Hoxhën ashpërsuan Luftën e Klasave. Me vendim Nr. 37 të Komisionit Qendror për internim-dëbimet më 1 gusht 1967, babai i Ylberit bashkë me familjen u internuan në një kooperativë malore në Pulahë të Oparit ku qëndruan 5 vjet, deri më 1972. Zhvendosja u krye nën koordinimin e *Sigurimit* dhe sekretarit të partisë në kooperativë. Të internuarit punonin në bujqësi kundrejt pagesave mjaft të vogla, sa për të mbajtur shpirtin gjallë dhe të distancuar nga pjesa tjetër "jo armike" e popullsisë. Nëse fshatarëve u lejohej të mbanin pak tokë dhe disa bagëti, të internuarit ishin të privuar nga ky privilegj. Rroga mujore e tyre ishte 5 lek (5 cent), ndërkohë që 1 kg bukë kushtonte 20 lek!) Më 28 tetor 1975, familja e Ylberit do të internohet sërish, këtë radhë në "geton" e internimit në Shtyllë, Vithkuq, ku do të vdesin gjyshja dhe babai i tij, Fuati, me brengën që po i linte djemtë e tij në një diktaturë represive.

HISTORIA E YLBERIT

Pavarësisht kushteve shumë të vështira të jetesës, Ylberi vijoi studimet e tij në shkollën pedagogjike për mësuesi deri në vitin 1959, ku gjatë kësaj kohe u njoh edhe me një vajzë re, Shpresa, me të cilën më vonë do të martohej. Ai u pushua nga puna si mësues në fshatrat e Librazhdit në vitin 1966 dhe deri në 1 gusht 1967 kur do të internoheshin, punoi si punëtor në zyrën e Monumenteve të Kulturës në qytetin e tij. Të njëjtin fat do të pësonte edhe motra e tij që do ta pushonin nga puna si mësuese dhe vëllai i tij i vogël gjimnazist që do ta dëbonin nga shkolla, kur familja Merdani u internua.

Gjatë punës si mësues në krahinën e Librazhdit, Ylberi qe përballur me varfërinë e thellë të nxënësve. Fryma e tij e pakënaqësisë dhe zemërimit ndaj sistemit politik u shtua pas internimit të familjes dhe kushteve në të cilat jetonin në fshat. Mendimet e tij mbi këtë situatë ai u përpoq t'i fiksonte në poezitë që shkruante, të cilat ndonjëherë i ndante me miqtë e tij të afërt. Por sistemi i përgjimit dhe spiunimit të njëri-tjetrit ishte forcuar tej mase dhe frymëzohej e mbështetej nga Partia në fuqi dhe strukturat e saj të represionit, si policia sekrete, *Sigurimi*. Kritikët kundrejt regjimit përpiqeshin të mos e thoshin hapur mendimin e tyre nga frika se mund të denoncoheshin te organet e *Sigurimit*. Dhe nga represioni i regjimit komunist në Shqipëri nuk ishte askush i mbrojtur. Askush nuk mund ta dinte se nga cila anë apo person mund t'i vinte e keqja. Në një moment të tillë pakujdesie, Ylber Merdani u arrestua nga *Sigurimi*.

DISIDENCA DHE ARRESTIMI

Më 9 qershor 1969, Ylberi u ndalua nga hetuesi (S.B) dhe dy policë në dyqanin e fshatit dhe u arrestua me shprehjen famëkeqe të kohës: “Në emër të popullit...”. Ylberi bëri fillimisht veten fajtor, pse nuk i kishte fshehur siç duhej shkrimet e tij kritike, të cilat hetuesi ia paraqiti përballë. Por shumë vite më vonë, ai do të mësonte se në fakt kishin qenë “miq” të tij, të afërm te familjet e tjera të përndjekura që e kishin spiunuar te Sigurimi shumë muaj para arrestimit të tij. Hetuesia përmes dy “ekspertëve letrarë”, me profesion mësues letërsie, i kishte vlerësuar poezitë e tij me përmbajtje armiqësore që “cënonin pushtetin popullor”. Në mënyrë të veçantë dallohej për këtë frymë poezia “Malet”:

*“Male male të vargosur,
Vargu i tyre i pasosur,
Qindra shpresa janë varrosur,
Thellë nëpër ta,*

*I shikoj dhe më shikojnë
Yjet, mallet më tregojnë,
Drithmat shpirtin ma përshkujnë,
Një ankth që s’mu nda.”*

Gjatë paraburgimit që zgjati tre muaj, situata emocionale e Ylberit ishte shumë e rënduar. Ndërkohë që ai merrej në pyetje, goditej dhe fyhej, nga dhomat e paraburgimit dëgjoheshin britma torturash të tmerrshme që sipas tij shkaktoheshin nga goditjet me mjete të forta e deri tek djegja e lëkurës me cigare.

Ylberi doli në gjyq më 25 gusht 1969 dhe u dënua me 8 vite burg dhe 4 vite humbje të drejtave civile me akuzën: “Për Agjitacion dhe Propagandë nëpërmjet poezive të tij në dorëshkrim”. Dënimin e kreu në burgun famëkeq të Spaçit³.

Burgu i Spaçit ishte ndërtuar në një zonë të thellë malore nga ku arratisjet ishin të pamundura. Dënimin të dënuarit e kryenin duke punuar si skllevër në minierën e Spaçit për të nxjerrë minerale si pirit dhe bakër. Regjimi komunist e shfrytëzonte punën e të burgosurve për të ulur kostot e prodhimit, si dhe për t’i mbajtur të burgosurit politikë larg qendrave të mëdha si Tirana. Të burgosurit banonin në baraka me rreth 100 persona secila, në kushte higjienike të vështira.

Në lidhje me vitet e burgimit në Spaç, Ylberi kujton punën e rëndë në minierë dhe ushqimin e pamjaftueshëm, por edhe miqesinë me intelektualë të tjerë të kohës. Në Spaç, Ylber Merdani përjetoi edhe revoltën e vetme të të burgosurve kundër pushtetit popullor në Shqipëri nga data 21 deri më 23 maj 1973. Momenti më emocionues i revoltës në kujtesën e tij ka mbetur ngritja e flamurit kombëtar kuqezi pa yllin komunist. Kurse më i dhimbshëm ishte më vonë momenti i pushkatimit të katër të burgosurve që iniciuan revoltën: Pal Zefi, Dervish Bejko, Skënder Daja dhe Hajri Pasha. Ylberi së bashku me të burgosur të tjerë

³ Burgu famëkeq i Spaçit pranë Rrëshenit ka funksionuar në vitet 1968-1991.

pjesëtarë të revoltës u rrahën dhe u goditën nga policët e kampit. *"Na shtrinë në tokë duke na vendosur mbi kurriz dërrasa me gozhda dhe na shkelën sipër me këmbë. Gozhdat më hynin në kurriz"*.

Ylberi u lirua nga Burgu i Spaçit në vitin 1977. Por me përfundimin e dënimit, nuk përfundoi edhe përndjekja e tij. Në dimrin e po atij viti, atë e internuan në fshatin Shtyllë të Korçës për shkak të pjesëmarrjes së tij në revoltën e Spaçit. Në të njëjtin fshat ishte internuar më parë edhe Shpresa, e dashura e tij, e cila e kishte pritur 8 vjet. Dy muaj pas vendosjes në Shtyllë të Korçës Ylberi dhe Shpresa u martua në internim.

NË EMËR TË DASHURISË: SHPRESA MERDANI

Historia e jetës së Shpresa Baholli Merdanit është shumë e ngjashme me atë të Ylberit për nga dhimbja dhe fakeqësitë e njëpasnjëshme që e kanë ndjekur. Shpresa lindi në qytetin e Korçës në dhjetor 1942. Babai i Shpresës, Veli Baholli, i rritur jetim nga babai i tij, mori rrugët e emigracionit për në Amerikë në moshën 16 vjeçare, si shumë korçarë të tjerë atë kohë. Aty punoi për 13 vjet në ndërtimin e hekurudhave dhe paratë e fituara në emigrim i investoi në Shqipëri, ku bleu 50 hektarë tokë në Llabanicë të Tresenikut (Korçë). Aty ndërtoi një shtëpi banimi dhe një "farm" me një mull të tipit amerikan. Në vitin 1947, Veli Ballollin e arrestuan bashkë me shumë persona të tjerë në zonën e Devollit me akuzën e padrejtë si anëtar i Grupit armiqësor të Deputetëve⁴. Duke e etiketuar si "kulak" sipas modelit stalinist, atij i sekuestruan tokën dhe çdo pasuri tjetër, dhe më në fund e burgosën, kur Shpresa, një nga gjashtë fëmijët e familjes, ishte vetëm 5 vjeç.

Shpresa kujton: *"Babain e dënuan me vdekje pa bërë asgjë. Më vonë ia ulën dënim me 101 vjet, ku nga 101 bëri 15 vite burg. Që në atë kohë nëna u vesh me të zeza deri në ditën që vdiq unë nuk e pashë nënën kurrë të vishte një fustan me ngjyrë të çelur ose të vinte një shami të bardhë, por vetëm e pashë të veshur me të zeza në pritje të lajmit ogurzi."*

Babai i Shpresës, do t'i kalonte vitet e burgut në të gjitha kampet e punës së detyruar nëpër Shqipëri, nga jugu në veri: Kampi i Maliqit, Kampet e punës në Nizhavec, në Orman e në Radostinë, në kanalën Peqin-Kavajë, në Rinas etj. Sipas këshillave që babai i jepte në letrat e tij nga burgu, e bija studioi për mësuesi ne shkollën pedagogjike. Kur babai doli nga burgu më 1960, ajo ishte gati 20 vjeç. Në vitin 1969 familja u dëbua nga qyteti i Korçës, me akuzën "kulakë" dhe u internua në fshatin Shtyllë të Vithkuqit. Pas 8 vitesh punë si mësuese, Shpresa u detyrua të bënte punë të rënda bujqësie, ndërsa kushtet ku jetonin ishin të mjeruara. *"Më caktonin punë më të vështira në bujqësi pasi unë isha me biografi të keqe dhe duhet të punoja si kafshë edhe në ato sektorë që nuk më takonin. Fshati na përbuzte deri në palcë, kaq shumë të indoktrinuara ishin atëkohë. Shpesh bëheshin mbledhje të partisë ku unë jam kritikuar pasi, sipas tyre, sillja modën e huaj duke bërë qëndisma"*.

⁵ Grupi i Deputetëve u dënua më 10 tetor 1947 nën akuzën e krijimit të një grupi armiqësor për të rrëzuar pushtetin popullor. Nga 16 persona, tre u dënuan me vdekje me litar, 13 me pushkatim. Kjo ishte goditja e parë e regjimit komunist për të eliminuar përhapjen e lëvizjeve dhe grupeve opozitare.

FAMILJE E RE NË INTERNIM

Gjatë studimeve, Shpresa i kishte premtuar Ylberit se do ta priste dhe ajo e mbajti fjalën. Fati e solli që Ylberi dhe familja e tij të internoheshin për herë të dytë pikërisht në fshatin ku ndodhej edhe familja e saj. Pas takimit të tyre më 1977 edhe pse në gjendje ekonomike të vështirë ata vendosën të martohen në një dasem shumë të vogël, pasi pjesën më të madhe të familjarëve e kishin në burg dhe në internim. 13 vjet me radhë, Shpresa dhe Ylberi jetuan së bashku në internim, ku punuan punë të rënda dhe rritën mes vështirësive shëndetësore dhe përbuzjes së komunitetit dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë. Në internim ndërruan jetë prindërit e Ylberit dhe të Shpresës bashkë me gjyshet e tyre. Madje babain e Shpresës nuk mundën as ta varrosnin në fshat, pasi banorët nuk e pranonin në varrezat e tyre për shkak të “biografisë së keqe”.

EPILOG

Pas vitit 1990, familja Merdani u kthye në Korçë, ku Shpresës iu dha mundësia të punonte disa vjet si mësuese deri sa doli në pension. Pas 30 vitesh përndjekjeje, Ylberi u kthye në qytetin e tij të lindjes në moshën 50 vjeçare, pa asnjë pasuri. Nga dokumentat e siguruar prej tij vërtetohet se në emër të pushtetit popullor, familjes Merdani i janë konfiskuar ose “vjedhur” në mënyrë arbitrare 450 kg flori. Sot Ylberi është 81 vjeç dhe në 30 vitet e fundit i është përkushtuar librave dhe mbledhjes së dëshmimeve mbi kalvarin e vujtjeve të shqiptarëve në diktaturë.

□ LEXIME TË MËTEJSHME:

Dervishi, Kastriot, Internimi dhe burgimi komunist në Shqipëri, Tiranë: Sh. Botuese 55, 2016
Merdani, F. Ylber, Saga e Merdanëve nën terrorin komunist, Tiranë: ISKK, 2016.

KONTRIBUT I INSTITUTI PËR DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURË



Ylber dhe Shpresa Merdani, 2017. Ylber mban një fotografi të familjes së tij të bërë në vitin 1936. Prindërit dhe gjyshërit e tij vdiqën në kampet e internimit komunist.

EVENWALLSHAVEEARS.ORG

PAJTIMI ME TOTALITARZMIN NË NIVEL EUROPIAN

Qytetarët e vendeve nën sundimin totalitar jetonin në një shtet pa ligje, ku një grup politik ushtronte kontroll të plotë mbi shoqërinë, duke kryer krime të tmerrshme dhe duke shkelur sistematikisht të drejtat themelore të njeriut. Pasojat e shkatërrimit të vlerave themelore në shoqëritë që vuajnë nga totalitarizmi gjatë disa breza janë ende të dukshme edhe sot. Ato manifestojnë, ndërmjet mënyrave të tjera, korrupsion i përhapur, keqfunksionim i institucioneve demokratike dhe në respektimin e pamjaftueshëm të parimeve të një shteti ligjor. Kjo kërkon një përpjekje të përditshme nga të gjithë ne për të promovuar zhvillimin e një shoqërie të vërtetë demokratike në të gjithë Europën.

Pas rënies së regjimeve komuniste në Europë në vitet 1989-1991 dhe me integrimin progresiv të Europës, janë bërë përpjekje të konsiderueshme politike për të ndihmuar shoqërinë që të pajtohet me trashëgiminë e totalitarizmit në nivelin europian, për të siguruar që mizoritë e kryera nga regjimet totalitare nuk mund të ndodhin më kurrë. Më poshtë janë disa rezoluta të rëndësishme të miratuara nga organet europiane të zgjedhura në mënyrë demokratike.

Asambleja parlamentare e Këshillit të Europës:

Rezoluta nr. 1096 e datës 27 qershor 1996 mbi Masat për Zbërthimin e Trashëgimisë së ish-Sistemeve Totalitare Komuniste

Rezoluta nr. 1481 e datës 25 janar 2006 mbi Nevojën për Dënimin Ndërkombëtar të Krimeve të Regjimeve Totalitare Komuniste

Parlamenti Europian:

Deklarata e datës 23 shtator 2008 mbi Shpalljen e 23 gushtit si Dita Europiane e Përkujtimit për Viktimat e Nazizmit dhe Stalinizmit

Rezoluta e datës 2 prill 2009 e Ndërgjegjes Europiane dhe Totalitarizmi

Rezoluta e datës 19 shtator 2019 mbi rëndësinë e Kujtesës Europiane për të Ardhmen e Europës

Asambleja Parlamentare e OSBE

Rezoluta e datës 3 korrik 2009 "Europa e Ndarë e Ribashkuar: Promovimi i të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Civile në Rajonin e OSBE-së në Shekullin 21"

MJETET THEMELORE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË EUROPE

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Europës - në fuqi që nga viti 1953

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian - në fuqi që nga viti 2009

NDËRGJEGJA EUROPIANE DHE TOTALITARIZMI

Rezoluta e datës 2 prill 2009 e Parlamentit Europian

Parlamenti Europian,

- duke pasur parasysh Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut,
- duke pasur parasysh Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 260 (III) A të datës 9 dhjetor 1948 mbi gjenocidin,
- duke pasur parasysh nenet 6 dhe 7 të Traktatit/Marrëveshjes së Bashkimit Europian,
- duke pasur parasysh Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian,
- duke pasur parasysh Vendimin Kuadër të Këshillit 2008/913 / JHA të datës 28 nëntor 2008 për luftimin e formave të caktuara dhe shprehjes së racizmit dhe ksenofobisë me anë të ligjit penal¹,
- duke pasur parasysh Vendimion/Rezolutën nr. 1481 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës të datës 25 janar 2006 mbi nevojat për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste,
- duke pasur parasysh deklaratën e saj të datës 23 shtator 2008 mbi shpalljen e 23 gushtit si Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Stalinizmit dhe Nazizmit²,
- duke pasur parasysh shumë vendime/rezoluta të mëparshme mbi demokracinë dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore, duke përfshirë edhe atë të datës 12 maj 2005 në 60 vjetorin e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në Europë më datën 8 maj 1945³, atë të datës 23 tetor 2008 mbi Përkujtimoren e Holodomor⁴, dhe ai i datës 15 janar 2009 në Srebrenicë⁵,
- duke pasur parasysh Komisionet e së Vërtetës dhe Drejtësisë së krijuar në pjesë të ndryshme të botës, të cilat kanë ndihmuar ata që kanë jetuar nën ish-regjime të shumta autoritare dhe totalitare për të kapërcyer mosmarrëveshjet e tyre dhe për të arritur pajtimin,
- duke pasur parasysh deklaratat e bëra nga Presidenti dhe grupet politike më datë 4 korrik 2006, 70 vjet pas grushtit të shtetit të përgjithshëm ndaj Frankos në Spanjë,
- duke pasur parasysh Rregullin 103 (4) të Rregullat e Procedurës së tij,

¹ OJ L 328, 6.12.2008, p. 55.

² Tekst i përshtatur, P6_TA(2008)0439.

³ OJ C 92 E, 20.4.2006, p. 392.

⁴ Tekst i përshtatur, P6_TA(2008)0523.

⁵ Tekst i përshtatur, P6_TA(2009)0028.

- A.** ndërsa historianët bien dakord që interpretimet plotësisht objektive të fakteve historike nuk janë të mundshme dhe rrëfimet objektive historike nuk ekzistojnë; sidoqoftë, historianët profesionistë përdorin mjete shkencore për të studiuar të kaluarën dhe përipiqen të jenë sa më të paanshëm që të jetë e mundur,
- B.** ndërsa asnjë organ politik ose parti politike nuk ka monopol në interpretimin e histories dhe organe dhe parti të tilla nuk mund të pretendojnë të jenë objektive,
- C.** ndërsa interpretimet zyrtare politike të fakteve historike nuk duhet të imponohen me anë të vendimeve të shumicës së parlamenteve; ndërsa një parlament nuk mund të nxjerrë ligje për të kaluarën,
- D.** ndërsa një objektiv kryesor i procesit të integritimit europian është të sigurojë respektimin e të drejtave themelore dhe sundimin e ligjit në të ardhmen dhe se mekanizmat e duhur për arritjen e këtij qëllimi janë parashikuar në nenet 6 dhe 7 të Traktatit e Bashkimit Europian,
- E.** ndërsa keqinterpretimet e historisë mund të ushqejnë politikat ekskluziviste dhe në këtë mënyrë të nxisin urrejtje dhe racizëm,
- F.** ndërsa kujtimet e së kaluarës tragjike të Europës duhet që politikat ekskluziviste të mbahen gjallë për të nderuar viktimat, për të dënuar autorët dhe për të hedhur themelet e pajtimit bazuar në të vërtetën dhe përkujtimin,
- G.** ndërsa miliona viktima u dëbuan, u burgosën, u torturuan dhe u vranë nga regjimet totalitare dhe autoritare gjatë shekullit të 20-të në Europë; ndërsa unifikimi i Holokaustit gjithsesi duhet të pranohet,
- H.** ndërsa përvoja dominante historike e Europës Perëndimore ishte nazizmi, dhe se vendet e Europës Qendrore dhe Lindore kanë përjetuar si Komunizmin ashtu edhe Nazizmin; ndërsa mirëkuptimi duhet të promovohet në lidhje me trashëgiminë kulturore e dyfishtë të diktaturës që ka lindur nga këto vende,
- I.** ndërsa që nga fillimi integrimi europian ka qenë një përgjigje ndaj vuajtjeve të shkaktuara nga dy luftërat botërore dhe tiranisë naziste që çuan në Holokaust dhe në zgjerimin e regjimeve totalitare dhe jodemokratike komuniste në Europën Qendrore dhe Lindore, si dhe një mënyrë për të kapërcyer përçarjet dhe armiqësitë e thella në Europë përmes bashkëpunimit dhe integritimit dhe përfundimit të luftës dhe sigurimit të demokracisë në Europë,
- J.** ndërsa procesi i integritimit europian ka qenë i suksesshëm dhe tani ka çuar në një Bashkim Europian që përfshin vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, të cilat jetuan nën regjimet komuniste nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri në fillim të viteve 1990, dhe ndërsa anëtarësimet e hershme të Greqisë, Spanjës dhe Portugalisë, të cilat vuajtën nga regjimet afatgjata fashiste, ndihmuan në sigurimin e demokracisë në jug të Europës,
- K.** ndërsa Europa nuk do të bashkohet nëse nuk është në gjendje të formojë një pamje të përbashkët të historisë së saj, të njoh nazizmin, stalinizmin dhe regjimet fashiste dhe komuniste si një trashëgimi të përbashkët dhe të sjellë një debat të ndershëm dhe të plotë mbi krimet e tyre në shekullin e kaluar,
- L.** ndërsa në vitin 2009 një Europë e ribashkuar do të festojë 20 vjetorin e shembjes së diktaturave Komuniste në Europën Qendrore dhe Lindore dhe rënien e Murit të Berlinit, i cili duhet të sigurojë një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin

për të kaluarën dhe për të njohur rolin e iniciativave të qytetarëve demokratë dhe një nxitje për të forcuar ndjenjat e bashkimit dhe tërheqjes reciproke,

M. ndërsa është gjithashtu e rëndësishme të kujtojmë ata që kundërshtuan në mënyrë aktive sundimin totalitar dhe që duhet të zinin vendin e tyre në ndërgjegjen e europianëve si heronj të epokës totalitare për shkak të përkushtimit të tyre, besnikërisë ndaj idealeve, nderit dhe guximit,

N. ndërsa nga këndvështrimi i viktimave është e parëndësishme se cili regjim i privoi ata nga liria ose i torturoi ose vrau për çfarëdo arsye,

1. Shpreh respekt për të gjitha viktimat e regjimeve totalitare dhe jodemokratike në Europë dhe u jep nderime atyre që luftuan kundër tiranisë dhe shtypjes;

2. Rinovon angazhimin e saj për një Europë paqësore dhe të begatë të themeluar nga vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut;

3. Nënvizon rëndësinë e mbajtjes gjallë të kujtimeve të së kaluarës, sepse nuk mund të ketë pajtim pa të vërtetën dhe përkujtimin; rikonfirmon qëndrimin e tij të bashkuar kundër të gjithë rregullit totalitar nga çfarëdo sfondi ideologjik;

4. Kujton se krimet më të fundit kundër njerëzimit dhe aktet e gjenocidit në Europë ishin ende duke u zhvilluar në korrik 1995 dhe se vigjilenca e vazhdueshme është e nevojshme për të luftuar idetë dhe tendencat jodemokratike, ksenofobike, autoritare dhe totalitare;

5. Nënvizon që, në mënyrë që të forcojë ndërgjegjen europiane për krimet e kryera nga regjimet totalitare dhe jodemokratike, dokumentimi dhe llogaritë që dëshmojnë, e kaluara e trazuar e Europë duhet të mbështetet, pasi nuk mund të ketë pajtim pa përkujtim;

6. Pendohet që, 20 vjet pas rënies së diktaturave komuniste në Europën Qendrore dhe Lindore, e drejta e dokumenteve që kanë lidhje personale ose janë të nevojshme për kërkime shkencore është ende e kufizuar në mënyrë të padrejtë në disa shtete anëtare; bën thirrje për një përpjekje të mirëfilltë të të gjitha shteteve anëtare drejt hapjes së arkivave, duke përfshirë ato të ish-shërbimeve të brendshme të sigurisë, policisë sekrete dhe agjencive të inteligjencës, megjithatë duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që ky proces të mos abuzohet për qëllime politike;

7. Dënon fuqishëm dhe pa mëdyshje të gjitha krimet kundër njerëzimit dhe shkeljet masive të të drejtave të njeriut të kryera nga të gjitha regjimet totalitare dhe autoritare; të shtrijë mirëkuptimin tek viktimat e këtyre krimeve dhe familjarëve të tyre, kuptimin dhe njohjen e vuajtjeve të tyre;

8. Shpall se integrimi europian si model i paqes dhe pajtimit përfaqëson një zgjedhje të lirë nga popujt e Europës për të zotohen për një të ardhme të përbashkët dhe se Bashkimi Europian ka një përgjegjësi të veçantë për të promovuar dhe mbrojtur demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit, si brenda dhe jashtë Bashkimit Europian;

9. Bën thirrje Komisionit dhe shteteve anëtare të bëjnë përpjekje të mëtejshme për të forcuar mësimin e historisë

europiane dhe për të nënvizuar arritjen historike të integritimit European dhe kontrastit të zyrtë midis të kaluarës tragjike dhe rendit shoqëror paqësor dhe demokratik në Bashkimin e sotëm European;

10. Beson se ruajtja e duhur e kujtesës historike, një rivlerësim gjithëpërfshirës i historisë europiane dhe njohja në mbarë Europën e të gjitha aspekteve historike të Europës moderne do të forcojë integritimin european;

11. Bën thirrje në këtë lidhje Këshillit dhe Komisionit të mbështesin dhe mbrojnë veprimtaritë e organizatave joqeveritare, siç është Përkujtimorja në Federatën Ruse, që janë të angazhuar në mënyrë aktive në kërkimin dhe mbledhjen e dokumenteve në lidhje me krimet e kryera gjatë periudhës staliniste;

12. Përsërit mbështetjen e tij të vazhdueshme për forcimin e drejtësisë ndërkombëtare.

13. Bën thirrje për krijimin e një Platforme të Kujtesës dhe Ndërgjegjes Europiane për të siguruar mbështetje për grupet e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimin midis instituteve kërkimore kombëtare të specializuara në temën e historisë totalitare, dhe për krijimin e një qendre dokumentuese/memorial pan-Europiane për viktimat e të gjitha regjimeve totalitare;

14. Bën thirrje për forcimin e instrumenteve ekzistuese financiare përkatëse me qëllim që të sigurojnë mbështetje për kërkime historike profesionale për çështjet e përshkruara më sipër;

15. Bën thirrje që shpallja e datës 23 gusht si Dita e Përkujtimit për viktimat e të gjitha regjimeve totalitare dhe autoritare, të përkujtohet me dinjitet dhe paanësi në të gjithë Europën;

16. është i bindur se qëllimi përfundimtar i zbulimit dhe vlerësimit të krimeve të kryera nga regjimet totalitare komuniste, është pajtimi, i cili mund të arrihet duke pranuar përgjegjësinë, duke kërkuar falje dhe nxitjen e rinovimit moral;

17. Udhëzon Presidentin e saj t'i përcjell këtë rezolutë Këshillit, Komisionit, parlamenteve të Shteteve Anëtare, qeverive dhe parlamenteve të vendeve kandidatë, qeverive dhe parlamenteve të vendeve të lidhura me Bashkimin European dhe qeverive dhe parlamenteve të anëtarëve të Këshillit të Europës.

Rezoluta mbi Ndërgjegjen dhe Totalitarizmin European që përfaqëson njohjen e parë zyrtare të krimeve komuniste nga Parlamenti European, u miratua nga seanca plenare me një votim 553: 44: 33.

MBI RËNDËSINË E KUJTESËS EUROPIANE PËR TË ARDHMEN E EUROPËS

Rezoluta e Parlamentit European, 19 shtator 2019

Parlamentit European,

- duke pasur parasysh parimet universale të të drejtave të njeriut dhe parimet themelore të Bashkimit European si një bashkësi e bazuar në vlerat e përbashkëta,
- duke pasur parasysh deklaratën e lëshuar më 22 gusht 2019 nga Zëvendës-presidenti i Parë Timmermans dhe Komisioneri Jourová përpara Ditës Europiane të Përkujtimit për viktimat e të gjitha regjimeve totalitare dhe autoritare,
- duke pasur parasysh Deklaratën Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut të miratuar më 10 dhjetor 1948,
- duke pasur parasysh rezolutën e tij të 12 majit 2005 me rastin e 60 vjetorit të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore në Europë më 8 maj 1945¹,
- duke pasur parasysh Rezolutën 1481 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës të 26 janarit 2006 mbi nevojën e dënimit ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste,
- duke pasur parasysh Vendimin e Këshillit 2008/913/JHA të 28 nëntorit 2008 mbi luftën ndaj formave dhe shprehjeve të caktuara të racizmit dhe ksenofobisë bazuar mbi kodin penal²,
- duke pasur parasysh Deklaratën e Pragës mbi Ndërgjegjen dhe Komunizmin European të miratuar më 3 qershor 2008,
- duke pasur parasysh deklaratën e tij mbi shpalljen e 23 gushtit si Dita Europiane e Përkujtimit të Viktimave të Stalinizmit dhe Nazizmit të miratuar më 23 shtator 2008³
- duke pasur parasysh rezolutën e tij të 2 prillit 2009 mbi ndërgjegjen dhe totalitarizmin european⁴,
- duke pasur parasysh raportin e Komisionit të 22 dhjetorit 2010 mbi kujtesën e krimeve të kryera nga regjimet totalitare në Europë (COM (2010) 0783),

¹ OJ C 92 E, 20.4.2006, p. 392.

² OJ L 328, 6.12.2008, p. 55.

³ OJ C 8 E, 14.1.2010, p. 57.

⁴ OJ C 137 E, 27.5.2010, p. 25.

- duke pasur parasysh Konkluzionet e Këshillit më 9-10 qershor 2011 mbi kujtesën e krimeve të kryera nga regjimet totalitare në Europë,
- duke pasur parasysh Deklaratën e Varshavës të 23 gushtit 2011 në Ditën Europiane të Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare,
- duke pasur parasysh deklaratën e përbashkët të 23 gushtit 2018 të përfaqësuesve të qeverisë të Shteteve Anëtare të BE -së për të përkujtuar viktimat e komunizmit,
- duke pasur parasysh rezolutën e tij historike mbi situatën në Estoni, Letoni dhe Lituani, miratuar më 13 janar 1983 në reagim ndaj “Apelit Baltik” të 45 shtetasve nga këto vende,
- duke pasur parasysh rezolutat dhe deklaratat mbi krimet e regjimeve totalitare komuniste të miratuara nga një numër i parlamenteve kombëtare,
- duke pasur parasysh Rregullin 132 (2) dhe (4) të Rregullores së tij Procedurale,

A. ndërsa ky vit shënon 80 vjetorin e shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore, e cila çoi në nivele të padëgjua të vuajtjeve njerëzore dhe pushtimi i vendeve në Europë për shumë dekada në vazhdim;

B. ndërsa 80 vjet më parë më 23 gusht 1939, Bashkimi Sovjetik komunist dhe Gjermania naziste nënshkruan një Traktat të Mos-Agresionit, i njohur si Pakti Molotov-Ribbentrop, dhe protokollet e tij sekrete që ndan Europën dhe territoret e shteteve të pavarura midis dy regjimeve totalitare dhe grupimi i tyre në sfera interesi, të cilat i hapën rrugën shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore;

C. ndërsa, si pasojë e drejtpërdrejtë e Paktit Molotov-Ribbentrop, e ndjekur nga Traktati i Kufirit dhe Miqësisë nazisto-sovjetik i 28 shtatorit 1939, Republika Polake u pushtua së pari nga Hitleri dhe dy javë më vonë nga Stalini - i cili i hoqi pavarësinë vendit dhe ishte një tragjedi e paparë për popullin polak - Bashkimi Sovjetik komunist filloi një luftë agresive kundër Finlandës më 30 nëntor 1939, dhe në qershor 1940 pushtoi dhe aneksoi pjesë të Rumanisë - territore që nuk u kthyen kurrë - dhe aneksoi republikat e pavarura të Lituanisë, Letonia dhe Estonia;

D. ndërsa pas humbjes së regjimit nazist dhe përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, disa vende europiane ishin në gjendje të rindërtonte dhe të fillonin një proces pajtimi, ndërsa vendet e tjera europiane mbetën nën diktatura - disa nën pushtimin ose ndikimin e drejtpërdrejtë sovjetik - për një gjysmë shekulli dhe vazhdoi të privohet nga liria, sovraniteti, dinjiteti, të drejtat e njeriut dhe zhvillimi socio-ekonomik;

E. megjithëse krimet e regjimit nazist u vlerësuan dhe u ndëshkuan përmes Gjyqeve të Nurembergut, ekziston ende një nevojë urgjente për të rritur ndërgjegjësimin, për të kryer vlerësimet morale dhe bërë hetimet ligjore për krimet e stalinizmit dhe diktaturave të tjera;

F. duke pasur parasysh se në disa shtete anëtare, ideologjitë komuniste dhe naziste janë të ndaluara me ligj;

- G.** ndërsa integrimi europian që nga fillimi, ka qenë një përgjigje ndaj vuajtjeve të shkaktuara nga dy luftërat botërore dhe nga tirania naziste që çoi te Holokausti, dhe në përhapjen e regjimeve komuniste totalitare dhe jodemokratike në Europën qendrore dhe lindore, dhe një mënyrë për të kapërcyer ndarjet e thella dhe armiqësinë në Europë me anë të bashkëpunimit dhe integritit dhe përfundimit të luftës dhe sigurimit të demokracisë në Europë; ndërsa për vendet europiane që vuajtën nën pushtimin sovjetik dhe diktaturat komuniste, zgjerimi i BE-së, duke filluar në 2004, nënkupton kthimin e tyre në familjen europiane, së cilës ata i përkasin;
- H.** duke pasur parasysh se kujtimi i së kaluarës tragjike të Europës duhet të mbahet gjallë, në mënyrë që të nderohen viktimat, të dënohen autorët dhe të krijohet terreni për një pajtim të bazuar në të vërtetën dhe përkujtimin;
- I.** duke pasur parasysh që kujtimi i viktimave të regjimeve totalitare dhe njohja dhe ndërgjegjësimi për trashëgiminë e përbashkët europiane të krimeve të kryera nga diktaturat komuniste, naziste dhe të tjera është me rëndësi jetike për unitetin e Europës dhe njerëzve të saj dhe për ndërtimin e qëndrueshmërisë europiane ndaj kërcënimeve të jashtme moderne;
- J.** ndërsa 30 vjet më parë, më 23 gusht 1989, u shënua 50 vjetori i Paktit Molotov-Ribbentrop dhe viktimave të regjimeve totalitare gjatë Rrugës Baltike, një demonstrim i paparë nga dy milionë lituanezë, letonezë dhe estonezë, të cilët u bashkuan dhe formuan një zinxhir të gjallë të shtrirë nga Vilnius në Talin përmes Rigës;
- K.** ndërsa përkundër faktit se më 24 dhjetor 1989 Kongresi i Deputetëve të Popullit të BRSS dënoi nënshkrimin e Paktit Molotov-Ribbentrop, përveç marrëveshjeve të tjera të bëra me Gjermaninë naziste, autoritetet ruse mohuan përgjegjësinë për këtë marrëveshje dhe pasojat e saj në gusht 2019 dhe aktualisht po promovojnë pikëpamjen se Polonia, Shtetet Baltike dhe Perëndimi janë nxitësit e vërtetë të Luftës së Dytë Botërore;
- L.** duke kujtuar viktimat e regjimeve totalitare dhe autoritare dhe njohjen dhe ngritjen e vetëdijes për trashëgiminë e përbashkët europiane të krimeve të kryera nga diktaturat staliniste, naziste dhe të tjera është e një rëndësie jetike për unitetin e Europës dhe njerëzve të saj dhe për ndërtimin e ripërtëritjes europiane ndaj kërcënimeve të jashtme moderne;
- M.** duke pasur parasysh se grupet radikale, raciste, ksenofobike dhe partitë politike kanë qenë të përfshira në dhunë në shoqëri, për shembull përmes përhapjes në internet të gjuhës së urrejtjes, e cila shpesh çon në një rritje të dhunës, ksenofobisë dhe intolerancës;
- 1.** Kujton se, siç parashikohet në nenin 2 të TEU, Unioni është i themeluar në vlerat e respektit për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që i përkasin pakicave; rikujton se këto vlera janë të zakonshme për të gjitha shtetet anëtare;
- 2.** Thekson se Lufta e Dytë Botërore, lufta më shkatërruese në historinë e Europës, filloi si rezultat i menjëhershëm i Traktatit famëkeq nazisto-sovjetik mbi mos-agresionin e 23 gushtit 1939, i njohur gjithashtu si Pakti Molotov-Ribbentrop, dhe protokollet e fshehta, ku dy regjime totalitare që ndajnë qëllimin e pushtimit botëror e ndanë Europën në dy zona ndikimi;

3. Kujton se regjimet naziste dhe komuniste kryen vrasje masive, gjenocid dhe dëbime dhe shkaktuan një humbje jete dhe lirie në shekullin e 20 -të në një shkallë të padukshme në historinë njerëzore, dhe kujton krimin e tmerrshëm të Holokaustit të kryer nga regjimi nazist; dënon me shprehjet më të forta aktet e agresionit, krimet kundër njerëzimit dhe shkeljet masive të të drejtave të njeriut të kryera nga regjimet naziste, komuniste dhe regjimet e tjera totalitare;
4. Shpreh respektin e tij të thellë për secilën viktimë të këtyre regjimeve totalitare dhe u bën thirrje të gjitha institucioneve dhe aktorëve të BE-së të bëjnë çmos për të siguruar që krimet e tmerrshme totalitare kundër njerëzimit dhe shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut të kujtohen dhe të sillen para drejtësisë, dhe garantojnë që krime të tilla nuk do të përsëriten kurrë; thekson rëndësinë e mbajtjes gjallë të kujtimeve të së shkuarës, sepse nuk mund të ketë pajtim pa kujtesë dhe përsërit qëndrimin e saj të bashkuar kundër çdo sundimi totalitar nga çfarëdo sfondi ideologjik;
5. I bën thirrje të gjitha shteteve anëtare të BE-së të bëjnë një vlerësim të qartë dhe parimor të krimeve dhe akteve të agresionit të kryera nga regjimet totalitare komuniste dhe regjimi nazist;
6. Dënon të gjitha manifestimet dhe përhapjen e ideologjive totalitare, të tilla si nazizmi dhe stalinizmi në BE;
7. Dënon revizionizmin historik dhe lavdërimin e bashkëpunëtorëve nazistë në disa shtete anëtare të BE-së; është thellësisht i shqetësuar për pranimin në rritje të ideologjive radikale dhe kthimin të fashizmi, racizmi, ksenofobia dhe format e tjera të intolerancës në BE, dhe është i shqetësuar nga raportimi në disa shtete anëtare të bashkëpunimit midis udhëheqësve politikë, partive politike dhe organeve të zbatimit të ligjit dhe lëvizjeve radikale, raciste dhe ksenofobike me emërtime të ndryshme politike; u bën thirrje shteteve anëtare të dënojnë akte të tilla në mënyrën më të fortë të mundshme pasi ato minojnë vlerat e BE-së, të paqes, lirisë dhe demokracisë;
8. U bën thirrje të gjitha shteteve anëtare që të përkujtojnë 23 gushtin si Ditën Europiane të Kujtimit për viktimat e regjimeve totalitare në nivel BE dhe kombëtar dhe të rrisin ndërgjegjësimin e brezit të ri për këto çështje duke përfshirë historinë dhe analizën e pasojave të regjimeve totalitare në kurrikulat dhe tekstet shkollore të të gjitha shkollave në BE; u bën thirrje shteteve anëtare të mbështesin dokumentimin e së kaluarës së trazuar të Europës, për shembull përmes përkthimit të procesverbaleve të gjyqeve të Nurembergut në të gjitha gjuhët e BE-së;
9. U bën thirrje shteteve anëtare që të dënojnë dhe kundërshtojnë të gjitha format e mohimit të Holokaustit, duke përfshirë banalizimin dhe minimizimin e krimeve të kryera nga nazistët dhe bashkëpunëtorët e tyre, dhe të parandalojnë banalizimin në diskursin politik dhe mediatik;
10. Thërret për një kulturë të përbashkët të kujtesës që refuzon krimet e regjimeve fashiste, staliniste dhe të tjera totalitare dhe autoritare të së kaluarës si një mënyrë për të nxitur qëndrueshmërinë kundër kërcënimeve moderne ndaj demokracisë, veçanërisht për brezin e ri; inkurajon shtetet anëtare të promovojnë edukimin përmes kulturës mainstream mbi diversitetin e shoqërisë sonë dhe mbi historinë tonë të përbashkët, duke përfshirë edukimin mbi mizoritë e Luftës së Dytë Botërore, siç është Holokausti, dhe dehumanizimin sistematik të viktimave të tij gjatë një numri vitesh;

- 11.** Thërret, për më tepër, që 25 maji (përvjetori i ekzekutimit të heroit të Aushvicit, Rotamaster Witold Pilecki) të vendoset si Dita Ndërkombëtare e Heronjve të Luftës kundër Totalitarizmit, e cila do të jetë një shprehje respekti dhe një haraç për të gjithë ata, të cilët duke luftuar tiraninë, demonstuan heroizmin dhe dashurinë e tyre të vërtetë për njerëzimin, dhe gjithashtu do t'u japin brezave të ardhshëm një shembull të qartë të qëndrimit korrekt për t'u përballur me kërcënimin e skllavërimit totalitar;
- 12.** I bën thirrje Komisionit të sigurojë mbështetje efektive për projektet e memorjes historike dhe kujtesës në shtetet anëtare dhe për aktivitetet e Platformës së Kujtesës dhe Ndërgjegjes Europiane, dhe të ndajë burimet e duhura financiare në kuadër të programit “Europa për Qytetarët” për të mbështetur përkujtimin dhe kujtesën e viktimave të totalitarizmit, siç përcaktohet në pozicionin e Parlamentit mbi Programin për të Drejtat dhe Vlerat 2021-2027;
- 13.** Deklaron se integrimi europian si model i paqes dhe pajtimit ka qenë një zgjedhje e lirë nga popujt e Europës për t'u angazhuar për një të ardhme të përbashkët dhe se BE ka një përgjegjësi të veçantë për të promovuar dhe mbrojtur demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit, jo vetëm brenda por edhe jashtë BE;
- 14.** Vë në dukje se në dritën e pranimit të tyre në BE dhe NATO, vendet e Europës Lindore dhe Qendrore jo vetëm që janë kthyer në familjen europiane të vendeve demokratike të lira, por gjithashtu kanë treguar sukses, me ndihmën e BE-së, në reformat dhe zhvillimi socio-ekonomik, thekson, megjithatë, se ky opsion duhet të mbetet i hapur për vendet e tjera europiane siç përcaktohet në nenin 49 TEU;
- 15.** Ruan qëndrimin se Rusia mbetet viktimja më e madhe e totalitarizmit komunist dhe se zhvillimi i saj në një shtet demokratik do të pengohet për aq kohë sa qeveria, elita politike dhe propaganda politike të vazhdojnë të fshehin krimet komuniste dhe të glorifikojnë regjimin totalitar sovjetik; i bën thirrje, pra, shoqërisë ruse që të pajtohet me të kaluarën e saj tragjike;
- 16.** Është thellësisht i shqetësuar për përpjekjet e udhëheqjes aktuale ruse për të shtrembëruar faktet historike dhe zbardhjen e krimeve të kryera nga regjimi totalitar sovjetik dhe i konsideron ato një komponent të rrezikshëm të luftës së informacionit të zhvilluar kundër Europës demokratike që synon të ndajë Europën, dhe për këtë arsye i bën thirrje Komisionit të kundërshtojë me vendosmëri këto përpjekje;
- 17.** Shpreh shqetësimin për përdorimin e vazhdueshëm të simboleve të regjimeve totalitare në sferën publike dhe për qëllime tregtare, dhe kujton se një numër vendesh europiane kanë ndaluar përdorimin e simboleve naziste dhe komuniste;
- 18.** Vëren se ekzistenca e vazhdueshme në hapësirat publike në disa shtete anëtare e monumenteve dhe memorialëve (parqe, sheshe, rrugë etj.) që glorifikojnë regjimet totalitare, gjë që hap rrugën për shtrembërimin e fakteve historike që lidhen me pasojat e Luftës së Dytë Botërore dhe propagimin e sistemit politik totalitar;
- 19.** Dënon faktin se forcat ekstremiste dhe ksenofobe politike në Europë gjithnjë e më shumë po i drejtohen shtrembërimit të fakteve historike dhe përdorin simbolikë dhe retorikë që i bëjnë jehonë aspekteve të propagandës totalitare, përfshirë racizmin, antisemitizmin dhe urrejtjen ndaj pakicave seksuale dhe të tjera;

- 20.** Nxit shtetet anëtare të sigurojnë pajtueshmërinë me dispozitat e Vendimit të Këshillit, në mënyrë që të kundërshtojnë organizatat që përhapin gjuhën e urrejtjes dhe dhunën në hapësirat publike dhe online, dhe të ndalojnë në mënyrë efektive grupet neo-fashiste dhe neo-naziste dhe çdo grup tjetër themeltar ose shoqatë që lartëson dhe glorifikon nazizmin dhe fashizmin ose çdo formë tjetër të totalitarizmit, duke respektuar rendin juridik të brendshëm;
- 21.** thekson se e kaluara tragjike e Europës duhet të vazhdojë të shërbejë si një frymëzim moral dhe politik për të përballuar sfidat e botës së sotme, përfshirë luftën për një botë më të drejtë, krijimin e shoqërive dhe komuniteteve të hapura dhe tolerante që përqafojnë pakicat etnike, fetare dhe seksuale, dhe për t'i bërë vlerat europiane të funksionojnë për të gjithë;
- 22.** Udhëzon Presidentin e tij që t'ia përcjellë këtë rezolutë Këshillit, Komisionit, qeverive dhe parlamenteve të shteteve anëtare, Dumës Ruse dhe parlamenteve të vendeve të Partneritetit Lindor.

Rezoluta mbi Rëndësinë e Kujtesës Europiane për të Ardhmen e Europës, duke avancuar axhendën e pajtimit me trashëgiminë totalitare të shekullit të 20-të dhe trajtimin e luftës dezinformative ruse mbi këtë temë, u miratua nga seanca plenare me votimin 535 : 66: 52

PASTHËNIE

Shekulli 20, dhe veçanërisht gjysma e parë e tij, ishte një periudhë e epifanisë së së keqes në botë. Ishte një kohë shpërthimi dhe tragjedie njerëzore të paimagjinueshme, si dhe humbesh thellësisht shkatërruese të trashëgimisë materiale europiane, të cilat lanë një shenjë të përherëshme në identitetin e europianëve.

“Që të mos harrojmë. Kujtesa e Totalitarizmit në Europë” është një sintezë e historisë europiane të shekullit të 20-të, çelësi narrativ i së cilës për të kuptuar kontekstin dhe kompleksitetet politike, por edhe për të dalluar qartë të mirën nga e keqja, është paraqitja e profileve të heronjve të asaj periudhe; këta ishuj të së mirës mu midis përmbytjes së të keqes që goditi dhe shkatërroi kontinentin e vjetër. Përmes dëshmive të individëve, duke marrë parasysh specifikat kulturore vendase dhe kushtet gjeopolitike, paraqitet një mozaik i ndritshëm i historive jetësore, të cilat të gjitha ndajnë një mision të përbashkët historik - për të shpërndarë errësirën e barbarisë dhe mjegullën e dyshimit moral.

Tejkalimi i së keqes është një proces i pafundëm në realitetin tokësor. Memorja e shenjuesve personale që përmbajnë referenca etike dhe kode të virtyteve karakteriale është një nga elementët e nevojshëm të këtij procesi. Identiteti europian bazohet në një trashëgimi historike dhe intelektuale që është e fuqishme dhe unike në pasurinë e saj. Mirëmbajtja e tij, si dhe bashkë-krijimi i tij krijues, ndodh si pasojë e kujtesës së vazhdueshme dhe rizgjimit të interesit në të kaluarën për një kuptim më të mirë të së tashmes, si dhe për formësimin e mençur të së ardhmes. Kanonike në këtë kontekst janë fjalët e Papa Gjon Palit II: “Njeriu thirret në liri. Nuk ka liri pa përgjegjësi dhe pa dashuri për të vërtetën. Liria i jepet njeriut për të zbuluar të vërtetën për të mirën”. Ky botim është një dëshmi pan-europiane e komunitetit për të vërtetën dhe, në të njëjtën kohë, një material frymëzues mësimor që kontribuon në promovimin e lirisë së përgjegjshme dhe punën e vazhdueshme në dobi të saj. Rëndësia e kësaj sipërmarrjeje është edhe më e madhe në atë që koleksioni është i destinuar për të rinjtë, brezi që së shpejti do të përcaktojë vektorët e zhvillimit europian dhe formën politike dhe simbolike të realitetit të qytetërimit perëndimor.

Witold Pilecki - një nga figurat e mëdha të diskutuara në këtë botim, një vullnetar i “ferrit në tokë” (Aushvic) pasi gjykata komuniste shpalli dënimin e tij me vdekje – i cili tha: “Unë u përpoqa të jetoj në atë mënyrë që në atë orë për vdekjen më shumë mund të gëzohem sesa të kem frikë”. Kjo mungesë frike është vetëdije për triumfin e së mirës mbi të keqen, lirinë mbi skllavërimin, të vërtetën mbi gënjeshtren dhe bukurinë mbi shëmtinë. Galeria e personazheve në këtë botim është një shembull i shkëlqyer i triumfeve lokale dhe njëherazi, universale që përbëjnë punën e hedhjes së prangave totalitare nga shoqëritë e Europës.

Një nga qëllimet themelore statutoare të Fondacionit Kombëtar Polak është ruajtja dhe përhapja e traditës kombëtare, kultivimi i zhvillimit kombëtar polak, dhe ndërgjegjësimin kulturor e qytetar, si dhe

përhapjen brenda dhe jashtë vendit të njohurive për historinë e Republikës së Polonisë, me theks të veçantë në historinë e kohëve të fundit, dhe përhapjen e martirizimit dhe bëmave heroike të kombit polak.

Duke pasur parasysh sa më sipër, patronazhi i Fondacionit Kombëtar Polak për këtë botim është një pasojë logjike e funksionimit të tij dhe një imperativ kategorik institucional. Bartja e kujtesës te brezat e ardhshëm është një detyrim etik, të cilin, së bashku me institucionet që janë pjesë e Platformës së Kujtesës dhe Ndërgjegjes Europiane, e trajtojmë si një nga detyrat kryesore të programit.

Ne jemi të bindur se pjesëmarrja në këtë përpjekje gjithashtu ka një karakter krijues të komunitetit. Ashtu si përvoja e totalitarizmit ka bashkuar Europën, ashtu edhe kujtesa e totalitarizmit duhet të forcojë atë unitet.

Deklarata e Ciceronit, e cila është bërë pjesë e korpusit të mençur të mendimit perëndimor – “Historia magistra vitae est” - ka mundësinë, falë këtij botimi, të jehojë edhe një herë me zë të lartë dhe të prerë.

Marcin Zarzecki

Michał Góras

Cezary Andrzej Jurkiewicz

Bordi i Fondacionit Kombëtar Polak

Varshavë, Poloni

SHKURTIME

ÁVO	Departamenti i Mbrojtjes Shtetërore së Policisë së Shtetit (Hungari)
AVO	Departamenti i Mbrojtjes Shtetërore së Policisë së Shtetit (Hungari)
AVH	Autoriteti i Mbrojtjes Shtetërore (Hungari)
BS	Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike, Bashkimi Sovjetik
CIA	Agjencia Qendrore e Inteligjencës (USA)
F.E.T y de las JONS	Falange Española Tradicionalista y de las Juntas de Ofensiva Nacional Sindicalista – Spanish Traditionalist Phalanx and the Unionist National Offensive Boards (Spain)
GDR	Republika Demokratike Gjermane, Gjermania Lindore
KGB	Komiteti për Sigurimin e Shtetit (Bashkimi Sovjetik)
KPSS	Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik
KSC	Partia Komuniste e Çekosllovakisë
MGB	Ministria për Sigurimin e Shtetit (Bashkimi Sovjetik)
NKVD	Komisariati Popullor i Punëve të Brendshme (Bashkimi Sovjetik)
NSDAP	Partia Kombëtare Socialiste e Punëtorëve Gjermanë (Gjermania Naziste)
NSV	Organizata Kombëtare Socialiste e Mirëqënies së Popullit (Gjermania Naziste)
OZNA	Departamenti i Sigurisë Kombëtare (Slloveni)
PNF	Partito Nazionale Fascista – Partia Nazionale Fashiste (Itali)
POW	Të burgosurit e Luftës
SA	Divizioni Sulmues i NSDAP-s (Gjermania Naziste)
SD	Shërbimi i Sigurisë të SS-s (Gjermania Naziste)
SED	Partia e Bashkimit Socialist Gjerman (Gjermania Lindore)
SiPo	Policia e Suigurimit (Nazist Gjerman)
SS	Skuadra e Mbrojtjes së NSDAP-s (Gjermania Naziste)
UB	Zyra e Mbrojtjes (Poloni)
UDBA	Administrata e Sigurimit të Shtetit (Slloveni)

TË MOS HARROJMË

Kujtesa e Totalitarizmit në Europë

Një doracak për nxënësit e shkollave të mesme kudo në Europë

Botimi i Dytë

Edituar nga Neela Winkelmann-Heyrovská dhe Gillian Purves

Hyrja: Riger Moorhouse, Stéphane Courtois

Hyrjet mbi shtetet dhe kutitë informative: Neela Winkelmann-Heyrovská, Toomas Hiio, Petr Blažek, Antoine Arjakovsky

Historitë: Penny Schreiber, Toomas Hiio, Meelis Maripuu, Lukáš Přibyl, Edward Anders, Valters Nollendorfs, Benita Plezere-Eglite, Darius Juodis, Vilma Juozevičiūtė, Jacek Pawłowicz, Grzegorz Berendt, Birgit Sack, Bert Pempel, Siegfried Reiprich, Łukasz Martyniak, Marinus Soeters, Sion Soeters, Zora Dvořáková, Luděk Navara, Lubomír Morbacher, Fedor Gál, Peter Zajac, Tamás Stark, Dorottya Bacsoni, Andreja Valič Zver, Romulus Rusan, Angel Filchev, Gillian Purves, Georgi Markov, Igor Casu, Volodymyr Birchak, Volodymyr Viatrovych, Ali Khamzin, Arjakovsky, José M. Faraldo, Luis Horrillo Sánchez, Simone Zoppellaro, Valbona Bezati

Përktthyes: Neela Winkelmann-Heyrovská, Alistair Ian Blyth, Jerzy Giebułtowski, Založba Sentenca, d.o.o., Eva Apelqvist, Akhtem Dzhelilov, Atanas Igov, Linutė Miknevičiūtė-Cohn, LTT Përktthyesit (Londër), Łukasz Mojsak, Danylo Salamin, Alina Shpak, Andre Swoboda, Peeter Tammisto, Toshi Trinity dhe vullnetarë të Nismës të Qytetarëve për Demontimin e Përkujtimeve të Ushtrisë Sovjetike në Sofje

Fotografitë dhe riprodhimet: Koleksioni Privat i Nina Lagergren, Karl Gabor, Koleksioni i Familjes Sarv, Zyra e Presidentit të Estonisë, Arkiva e Lukáš Přibyl, Edward Anders, Arkiva e Fotografive të USHMM-s, Koleksioni Privat i Benita Plezere-Eglite, Muzeu i Profesionit të Letonisë, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar Letoni, Muzeu i Viktimave të Genocidit, Koleksioni i Familjes së Juliana Zarchi, Arkiva Speciale Lituanese, Koleksioni i Institutit të Përkujtimeve Ndërkombëtare, Arkiva e Shtetit Sakson, Arkiva e Shtetit Leipzig, Miqtë e Dr. Margarete Blank Shtëpia e Përkujtimeve Panitzsch, Arkiva Federale, Koleksioni Privat i Stefan Brandt, Libraria Kombëtare Austriake, Arkiva e Muzeut Shtetëror Auschwitz-Birkenau në Oświęcim, Koleksioni i Familjes Soeters, Arkiva e Klubit të Milada Horáková, Arkiva e Shërbimit të Sigurimit Republikës Çeke, Agjencia Presd Çeke ČTK, Arkiva e Karel Bryks, STUDIOCANAL Films Ltd., Arkiva Kombëtare e Republikës Çeke, Arkiva e Institutit të Përkujtimeve Kombëtare, Miro Švolík, Arkiva e Fedor Gál, Fondacioni Magyarországi Mindszenty, Arkivat Fortepan, Arkiva e Muzeut të Shtëpisë së Terrorit, Arkiva e Familjes së Ljudmila Valič, Koleksioni i Andreja Valič Zver, Ph.D., Arkiva e Familjes së Mag. majda Pučnik Rudl, Arkiva e Qendrës Studimore Ndërkombëtare mbi Komunizmin, Përkujtimorja e Viktimave të Komunizmit dhe Rezistencës Antikomuniste, Familja e Lyudmila Slavova, Arkiva e Qendrës Hannah Arendt – Sofie, Vasil Kadrinov, Agjencia Telegrafike Bullgare, Koleksioni i Familjes Markov, Lukáš Houdek, curaj.net, Arkiva e Qendrës për Kërkime mbi Lëvizjen Çlirimtare, Arkiva Dixhitale e Lëvizjes Çlirimtare të Ukrainës, Koleksioni i Kardinalit Theodor Innicir, Arkiva Private e Ayshe Seitmuratova, Archive of Antoine Arjakovsky, Museo Nacional Reina Sofía, Archive of Luis Horrillo Sánchez, Archive of the Gariwo Foundation, Fondazione Ernesto Rossi e Gaetano Salvemini, Memorial - Italia, Archive of Luciana De Marchi courtesy of Gabriele Nissim, Portale storico della Presidenza della Repubblica, Archive of the Institute for Democracy, Media and Culture, evenwallshaveears.org

Fotografia e kopertinës: Kampi i përqendrimit në majdanek, Roland Geider

Ilustrimet: Gabriela Kopecká, Dana Bellany

Dizajni dhe faqesja: Gabriela Kopecká, Dana Bellany

Korrektim Gjuhësor (Proofreading): Sarah Dunham, Gillian Purves

Koordinatorë të projektit: Teun Janssen, Anabela žigová

Printuar nga: XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

Publikuar nga: Platforma e Përkujtimeve dhe Ndërgjegjjes Europiane, Londýnská 43, 120 00 Prag 2, Republika Çeke, 2021

Contact: coordinator@memoryandconscience.eu, www.memoryandconscience.eu

ISBN: 978-80-907355-7-6